

FATMIR
GJATA

vepra
letrare 2

E

BIBLIOTĚKA

824

9.23

LETT

GJROKASTĚR



DJALOSHI

Çeta ishte tërhequr, duke çarë rrethimin me bomba dore. Plluhuri dhe tymi i barutit po ngriheshin në qiell. Kodrina e vogël në rrëzën e maleve, që ishte mbuluar prej zjarrit e flakës së predhave, po dukej përsëri. Majat e borigëve të larta lëkundeshin në qiell, sikur do të përpinin retë.

Beteja kishte mbaruar; vetëm tek-tuk, nga grykat e maleve, dëgjoheshin krismat e armëve.

Një trup i vogël, me rrobë të shqyera dhe të plluhurosur, me nolla gjaku të zi në shpatullën e djathtë, lëvizte ngadalë dhe me mundim midis shkurreve të pyllit. Ishte partizani më i ri i çetës, strukur në rrënjët e një pise të rrëzuar, që mendohej të dilte, duke ngulur në tokën e fortë duart e tij të buta. Shtrëngonte nofullat, rruçhtë ballin, përpëllitej, por dhembja e plagës ia errësonte sytë dhe trupi i binte. Me duart e gjakosura mernte kapelën që i mbetej nëpër degët e borigës, e ngjishte mbi flokët e ngatërruar dhe përsëri humbte në njëfarë kllapie...

Pas dy orësh, në majën e bregores, një grup njerëzish me uniforma të njëllojta, me fytyra të zbehta, ku shquhej

egërsia, vraponin njëri pas tjetrit mbi lëndinën e lagur. Ishin gjermanë. Partizani i vogël, Djaloshi, siç e thërrisnin shokët, qëndronte pa luajtur, i mbështetur në trungun e një borige. Kapela me yllin e kuq i binte mbi sy. Gishtat e tij të hollë e të gjatë ishin ngulur fort në lëkurën e ashpër të pemës. Ai ngrinte kokën me vështirësi dhe vështronte me radhë fytyrat e gjermanëve që silleshin përreth.

Nuk i kishte parë kurrë aq pranë. Vërejtja në mes të grupit një ushtar trupmadh, me gjoks të dalë përpara, mbi të cilin vareshin krye të thyera. E mori me mend se ai do të ishte komandanti. Ai fliste me zë të trashë e të ngjirur, ishte i zemëruar dhe tregonte me gisht trupin e vogël që qëndronte pa luajtur në trungun e pemës. Për një çast ai qeshi. Pastaj me një të kërcyer dhe me hapa të gjatë u gjend fare pranë Djaloshit. E vështroi në sy, i lëmoi faqet e rumbullakëta me duart e ashpra e të spërkatura me gjak. Papritur i rrëmbeu kapelën nga koka dhe ia përplasi ndër këmbë, duke i folur me një shqipe të ngatërruar:

— Shkele, të shpëtosh!

Ushtarët vështruan me habi.

Partizani i vogël e vërejtja drejt në sy duke rrudhur ballin. Krejt në heshtje uli kokën dhe pa atje, midis këmbëve të tij, kapelën dhe yllin e kuq, pa atje simbolin e tij të luftës për liri. Hoqi me mundim duart e mbërthyer në lëkurën e borigës, përkuli trupin e dërrmuar nga plagët dhe shtrengoi midis grushteve kapelën e pluhurosur.

Vështroi përreth ushtarët gjermanë, ngriti kryet dhe e ngjeshi në flokët e ngatërruar.

Komandanti kërcyeri për një moment. Fytyrat e ushtarëve shprehën shokëri dhe shprehën shprehje të ashpër. Komandanti kërcyeri për një moment dhe e ngjeshi në flokët e ngatërruar. Komandanti kërcyeri për një moment dhe e ngjeshi në flokët e ngatërruar.

— Shkele, të shpëtosh! — Komandanti kërcyeri për një moment dhe e ngjeshi në flokët e ngatërruar.

Ushtarët vështruan me habi. Komandanti kërcyeri për një moment dhe e ngjeshi në flokët e ngatërruar.

ata e ngjeshi në flokët e ngatërruar. Komandanti kërcyeri për një moment dhe e ngjeshi në flokët e ngatërruar.

ata e ngjeshi në flokët e ngatërruar. Komandanti kërcyeri për një moment dhe e ngjeshi në flokët e ngatërruar.

dhe u përkul ngadalë, duke zgjatur duart përtokë. Komandanti u tërbua. Ngriti grushtin e madh dhe e lëshoi me forcë mbi shpatullën gjysmëlakuriqe e të gjakosur të Djaloshit. Pastaj rrëmbeu automatikun nga duart e një ushtari, i hoqi sigurecën dhe i dha zjarr menjëherë. Trupi i vogël qëndroi vetëm një çast pa lëvizur, pastaj u rrëzua përtokë. Duart e tij mezi u zbatën përpara, fërkuan lëndinën e lagur dhe mollëzat e gishtave prekën një send të ashpër, pastaj e preku gjithë pëllëmba. Gishtat e përfshinë menjëherë, grushti u mbyll dhe u ngjesh në kraharor.

Plumba të tjerë përshkuan trupin e vogël dhe gjaku u derdh nga vrimëzat e fytyrës si uji i një burimi.

Po kapela me yllin e kuq nuk u shkel. Ajo u përzie me gjakun e kulluar dhe u tret në gjoksin e partizanit të vogël...

1945

GJAK MBI AKULL

Qielli nxinte nga retë e ulëta e të dendura si pus. Flokët e borës binin mbi arat e kodrat. Ishte mesi i dimrit.

Asnjë lëvizje nuk kishte nëpër rrugët e ngushta të Lavdarit, vetëm ndonjë fëmijë aty-këtu zgjaste fytyrën e duart jashtë dritares dhe luante me flokët e borës. Fshati si i braktisur; as qentë, as macet nuk dukeshin e nuk ndiheshin.

Lart, mbi bregore, një tog burra me kazma e lopata, me fytyra e duar të skuqura nga thëllimi i mbrëmjes vinin rrotull, uleshin përroit të vogël e ngjiteshin përsëri. Ishin të gjithë të shqetësuar.

— Këtu, Ferit, këtu duken shenjat!

— Jo. Është e pamundur. Unë e mbaj mend fare mirë. Ka qenë në përrua.

Dhe vargu i burrave rrëshqet në heshtje në fund të përroit. Era e mbrëmjes që fryn me vërshëllima, u ngatërron këmbët, u ngre cepat e kapotave të grisura, u rrëmben kapat dhe fshatarët rrokullisen mbi borën e ngrirë. Ngrihen me të shpejtë, rrëmbejnë kazma e lopata

të hedhura tej dhe ocin përsëri duke mbledhur supet gjer te veshët.

– Këtu!

– Po, këtu... Ja!

Një gur i madh i rrumbullakët, i mbuluar me akull. Rreth e rreth tij varen qirinjtë si shpata. Një gropëz përbri mbuluar me borë të ngrirë. Më tej kërcasin degët e një borige. Dëgjohet gurgullima e ujit ndën gurin e madh.

Fshatarët vihen në lëvizje, godasin akullin me ngathtësi, pastaj nxehen, shpejtojnë duart dhe ciflat e akullit kërcëjnë përpjetë si copa sharapnele. Hukasin duart, fërkojnë veshët e zbardhur, fshijnë me mëngë borën nga vetullat e qepallat dhe fillojnë përsëri nga puna. Kazma godet fort mbi akull, lopata i flak copat tej, rënkimi që del me shtëllunga avujsh, bëhet më i mprehtë. Godasin pa pushim, thellojnë vendin, guri lëkundet. Edhe disa të goditura me tërë fuqinë e tyre, dikush fut një qysqi dhe guri rrokulliset në mes të përroit.

U dukën copa akuj të kuq e të gjakosur në një vrimë të madhe, pastaj një gjerdan pa fishekë, një bombë dore mbi të. Fshatarët u ngurrosën, heshtën. Kazmat e lopatat u ngrinë në duar. Fytyrat u vrenjtën. Sytë u mbërthyen te gropa...

Ishte trupi i një partizani...

Fshatarët heshtën një copë herë, pastaj e ngritën trupin e ronitur dhe, ndërsa furtuna mbështillte borën dhe ua përplaste me furi në fytyrë, u drejtuan për në fshat...

1945

ÇELIKU

Një predhë topi plasi me zhurmë të madhe mbi majën e bregut të zhveshur, ku ishin llogoret tona. Na u duk sikur u rrokullisën shkëmbinjtë e Krastafilakut. Tymi i barutit dhe pluhuri i tokës u ngritën si re të dendura që zënë diellin. Copat e çeliktë u përhapën me shpejtësi në të gjitha anët dhe ranë si breshër mbi llogoret tona.

Çeliku shkundi trupin e tij të imët e të shkathët të mbuluar me gurë të vegjël e pluhur dhe zgjati kokën nga pozicioni, sikur deshi të shikonte gropën e madhe që hapi predha pranë tij. Pastaj ndjeu një tronditje e një buçimë të fuqishme. Gjithë ana e majtë e gjoksit iu rëndua e iu mpi. Gjaku, si lëng i trashë i vakët, i rridhte prej majave të gishtave gjer në fund të bërrylit. Sytë iu errën dhe çdo gjë iu duk e mjegullt, e turbullt. Unë e pashë kur, duke u munduar të ngrihej, u rrokullis mbi gurët pa ndjenja.

— Çelik! Çelik! — i thirri Rizai që ishte pranë tij.

Çeliku kafshoi buzën fort, sa i dolën prej saj pikëza gjaku, përpëliti qerpikët dhe u përgjigj vetëm me një «of» që na ngjethi mishtë. U afruam tre-katër veta, Thomai,

Qemali, unë. Çeliku ngrinte vetëm njërin krah, të përgjakur edhe atë dhe e drejtonte nga armiku sikur donte të na thoshte: «Kini mendjen andej!» U bëmë vrer dhe na dogjën sytë nga dhimbja që ndiem.

– Duhet ta mjekojmë! – thashë.

– Me se? S'kemi asgjë! – u përgjigj njëri nga shokët.

– Do të gjejmë, – tha Thomai dhe hoqi këmbët nga trupi dhe e bëri fasha-fasha. Qemali zgjidhi shaminë e kuqe që mbante në qafë. Ne zhveshëm Çelikun. Nuk e kuptonim nga i dilte gjaku. Kishte marrë njëzet e dy plagë dhe të gjitha në kraharor e në krahët. Një plagë e kishte shumë të madhe, në anën e djathtë, pranë sisës. Nga plaga i dilte vazhdimisht gjak, po i dilte edhe frymë. Ia zumë me lidhëset tona. Çeliku hapi sytë dhe na shikoi për të fundit herë. U mundua të thoshte diçka, mbase lamtumirën e fundit, po gjaku i doli si çurkë nga goja dhe i rrëshqiti në qafën e hollë e të gjatë.

– Mbaroi! – pëshpëriti Thomai, duke hequr kapelën nga koka e duke fshirë me të sytë.

– Vdiq? – pyetën dy veta me një zë.

Heshtëm të katër. Nuk na besohej. Çeliku, pesë minuta më parë, ishte me ne, aty në majën e bregut, mbi një shkëmb, në një llogore. Zbrazte maliherin ashtu si ne. Hapte e mbyllte llozin e pushkës, mbështeste faqen mbi kondakun e lëmuar dhe tërhiqte këmbëzën, si të gjithë ne. Ai ishte gjallë pesë minuta më parë. Nuk na besohej që të mos ishte më...

– Duhet ta tërheqim!

– Ta shpiem te varret e Kolanecit!

– Patjetër... Ngriheni, shokë! Me ngadalë!

E morëm në krahë dhe zbritëm në përrua. Atje armiqët na diktuan dhe na qëlluan. E vendosëm në mes të lajthishtave, pranë ujit që gurgullonte. Gjaku i rridhte ende. I kulloi edhe në rrëkezën e vogël dhe uji mori ngjyrën e vjollcës. Nuk mund ta tërhiqnim më. Armiku na mori krahët, na doli në anën e sipërme dhe po na rrethonte. Duhet të mbaronim punë shpejt. Nuk hapëm gropë, as nuk e mbuluam me dhe. S'kishim as mjete, as kohë. E fshehëm me karthje, i hodhëm mbi trup ca gjete laj-

this e bar të njomë, e mbuluam lehtë, shumë lehtë, se na dukej sikur do t'ia lëndonim njëzet e dy plagët. Pastaj shtimë me breshëri, gjetëm një shteg të lirë në pyll dhe iu drejtuam Kolanecit, ku ishte batalioni ynë.

Luftuam tridhjetë e dy orë, ditën dhe natën, pa ndërprerje. Armiku vuri në përdorim ushtri të madhe, tërë ushtrinë e aytetit të Korçës dhe mundi t'i zinte pozitat tona të para. Luftonte me dëshpërim dhe kishte vendosur të përparonte me çdo kusht, të zinte kodrat mbi Krastafilak e mbi Maliq, të hynte në Kolanec e të hapte kështu rrugën për tërheqjen e trupave.

Trupi i Çelikut dergjej atje, në mes të gjetheve të lajthive, në mes të armiqtë. Mund që armiqtë ta kishin gjetur e ta kishin bërë copë-copë. Kjo s'durohej! Kjo ishte shumë e rëndë!

— Duhet të marrim patjetër pozicionet e mëparshme, për të tërhequr Çelikut. Dhe kjo duhet bërë që sonte! — urdhëroi Shabani, komandanti ynë. Ai ishte një burrë i shkurtër, kockë e lëkurë e gjithnjë i parruar. Ishte trim, dinak, i reptë dhe i shkathët, megjithëse çalonte nga një këmbë. Për shokët linte kokën.

Në mesnatë batalioni u nda në dy kolona, zbriti në përrain e errët dhe u drejtua nga pozicionet e armikut. Hëna ndriçonte e plotë mbi pyll, në qiellin e kaltër të shtatorit. Nga larg vinin lehjet e qenve të katundit. Në fillim u ndien kolla e trashë e ndonjë partizani të ftohur, hapat tanë dhe urdhrat me gjysmë zëri të shokëve, që porositnin të mbahej largësia e ndërlihdja. Pastaj çdo gjë ra në qetësi.

Ne ecnim përsëri të katër, Rizai, Thomai, Qemali dhe unë, në njëshkolonë, me hapa të numëruar. Kur arritëm në fund të grykës, Rizai na tha me zë të ulët.

— Bëni më të djathtë!

— E dimë vendin, — tha Thomai që ecte në krye. — Ja ku e kemi, pesëmbëdhjetë, njëzet metra, në mes të lajthishtave.

Qëndruam kokë më kokë, me sytë të mbërthyer në errësi.

– E shikoni? Atje është. Nuk e kanë diktuar.

– Prisnil Diçka lëviz atje! – tha Qemali që shikonte në errësirë më mirë nga ne të gjithë.

U shtrimë përtokë menjëherë duke bërë gati armët. Ia ngulëm sytë vendit ku kishim fshehur Çelikun dhe pritëm. Atje lëvizte diçka. Dukej si një dorë njeriu që ngrihej ngadalë, qëndronte një çast lart, pastaj binte me të shpejtë. Gjethet e thata fëshfërinin me një zhurmë të lehtë. Ishte me të vërtetë një dorë njeriu.

Nuk pipëtinte asgjë. Ne kishim ndalur edhe frymën. Ndihej herë pas here vetëm përplasja e krahut mbi gjethet e lajthive. Pastaj dëgjuam një rënkim të thellë që u përsërit pas pak. Na u duk sikur dikush thoshte me zë të mekur:

– Ndih... më!

– Do të jetë ndonjë italian i plagosur rëndë, – pëshpëriti Thomai.

– S'është e mundur. Ai flet shqip.

– Mos është ndonjë shok yni?

– Ne s'na mungonte njeri, veç Çelikut. Dhe ai na u vra.

– Ndih-më! – rënkonte i plagosuri.

Qemali nuk priti më. Largoi shkurret që e shpuan në fytyrë dhe u zvarrit përpara. E pamë që hoqi gjethet e barin me të shpejtë dhe dëgjuam zërin e tij të tronditur:

– Çelik! Çelik! Çelik!...

Pikërisht atëherë batalioni u hodh në sulm në anën tjetër të përroit, për t'i tërhequr vëmendjen armikut. Ne vepruam pa frymë mbi fletët e thata e degët e thyera. U bë zhurmë sikur fryu një erë e marrë. Pastaj papritur era u pre. Ne ngrimë në vend nga fjalët e Qemalit:

– Është gjallë!

U përkulëm mbi togun e gjetheve, të gëzuar dhe të zemëruar me vetveten që e kishim lënë shokun pa ndihmë. me njëzet e dy plagë në trup. Në dritën e hënës pamë fytyrën e tij të zbehtë lyer baltë e gjak, buzët e nxira e të përthara dhe sytë e venitur, në thellësinë e të cilëve shkrepnin shkëndija jete e gëzimi. I dhamë ujë, e vendosëm

mbi fletët e tendës dhe iu vumë së përpjetës që shpinte në Kolanec. Ndërkaq plumbat me zjarr që këmbësheshin nga të dy palët bënë në qiell figura të çuditshme, të bukura, sikur të ishin fishekzjarre.

Kur rrezet e para të diellit ranë në Hijen e Korbit, ne ecnim ende rripave e çukave, po jashtë rrezikut. Ecnim ngadalë e me kujdes, për të mos ia lënduar plagët. Kohë mbas kohe e ulnim, i jepnim ujë, ia lagnim ballin. Kur e mblodhi veten, na tregoi si i kishte kaluar tridhjetë e dy orët:

- Ju kam sharë rrënjë e degë që më latë atje. Ku ta dija unë se menduat që kisha vdekur? Ju kam sharë, s'ju lashë gjë pa thënë? Kur më sollli në vete uji i përroit, natën, m'u desh një kohë e gjatë për të mësuar se ku ndodhesha e ç'kishte ngjarë me mua. Hapa sytë dhe, në vend që t'ju shikoja ju, pashë gjethet, barin, yjet. M'u duk sikur u zgjova nga një ëndërr dhe po shikoja një ëndërr të dytë... Vonë m'u kujtuan të gjitha: predha, gjaku, dhembjet, ju... Atëherë ju shava: «Të poshtrit, thashë, menduan për lëkufën e tyre!» Ju shava pa të drejtë! Gabim bëra! E dija që do të vinit e do të më merrnit...

Ne ecnim të gëzuar, po dhe me një boshllëk të madh në zemër. Plagët i kishin zënë krimba. Në anën e djathtë të krahavorit i dilte ende frymë. Ai fliste me mundim:

- Ju më kujtuat të vdekur. Po si mund të vdes unë, pa e zbrazur edhe një herë?

Fliste me mundim, po nga zëri i tij gurgullonte dashuria e dëlirë për ne. Kurse ne të katër e ndienim zemrën të ndrydhur.

Kur e pa mjeku, nuk dha asnjë shpresë shpëtimi.

- Tepër vonë, - tha. - Ka njëzet e dy plagë. I kanë mbledhur të gjitha. S'ka pikë gjaku. Predha ia ka prishur mushkëritë.

Të nesërmen erdhi e ëma nga fshati, një plakë e gjatë, krenare. E mori vesh se Çeliku nuk do të shpëtonte. I qëndroi te koka duke gëlltitur lotët, tetë ditë e tetë net. Mëngjesin e nëntë ai i kërkoi pushkën.

– Nënë, vëri në gushë një fishek, – i tha.

Ajo ia vuri.

– Ma jep, – i tha.

Ajo ia dha.

– Mbaje ti, se unë s'e mbaj dot, – i tha.

Nëna e shtrëngoi pushkën me të dy duart me tytën nga dritarja. Çeliku vuri gishtin te këmbëza dhe e zbrazi. Xhami u bë copë-copë dhe ai nxori frymën e fundit.

1945



HALLË ZIKJA

Ajo ishte veshur e tëra me të zeza, rrinte në gjunjë në këndin e vatrës, thyente shkarpa të thata dhe i vinte në zjarrin që po shuhej.

— Ky dimri i sivjetëm mos e sjell të kokën kurrë! Ja si më shikon, kam mbetur kërcure... Dhe ju e kaluat maleve!

Ajo kishte një fytyrë të gjatë me rrudha të thella në ballë, faqe me gropëza dhe plot vijëza të holla, hundë të kthyer dhe dy sy të vegjël, të turbullt.

Ngriti kokën e vogël lidhur me shami dhe më vështroi me bishtin e syrit:

— Ngrohu, bir, se dhe ty të ka hyrë të ftohtët në palcë!

Pastaj përpëliti kapakët e zinj për të mbrojtur sytë që ia ngacmonte tymi, më pa kapelën, më lëmoi dorën dhe më puthi nga dy herë në faqe.

— Bir i nënës, ty do të t'i tregoj, të gjitha, — më tha dhe ndjeva ngashërime në zërin e saj.

Ajo nuk më njihte, as më kishte parë ndonjëherë. Por ylli i kuq, që mbanim ne, ishte për të shenja e njerëzve të

mirë. Prandaj më puthi e më shtrëngoi për qafe si djalin e vet, ndërsa unë ndjeva ngrohtësinë e nënës sime.

Më tha se kishte qenë shumë fanatike. Dikur, me orë të tëra fjalosej me vete. Ngranjëherë e ngrinte zërin dhe në dhomën e vogël dëgjoheshin fjalët arabishte të syreteve të kuranit, që ia kishte mësuar qysh në fëmijëri hoxha i fshatit. Më tregoi se një ditë, kur nusja e të birit kishte dalë në oborr dhe atje ia kishte hedhur sytë një djalë çapkën i fshatit, hallë Zikja e kishte sharë me tërë mend:

«Nusezeza! Të panë, moj damlla!»

Dhe e reja ishte trembur shumë, se, po ta merrte vesh fshati, s'i mbetej gjë tjetër veç të futej e gjallë në dhe me gjithë hallë Ziken. Dhe që prej asaj dite ajo s'e kishte kapërcyer më pragun e portës dhe s'u kishte dalë burrave.

Unë u çudita kur pashë nusen të hynte në dhomën ku rrinim ne. Ajo më përshëndeti, bisedoi me mua, më solli të laja duart, shtroi bukën dhe më ftoi të haja. Halla rrinte e shkujdesur. Më vështronte me sytë e saj të ëmbël dhe, duke skërmitur kërcurin e madh në zjarr, më tregoi me zë të ngadalshëm:

— Kur ikët ju dhe erdhën qafirët, eh, ç'kemi hequr! E bënë fshatin lesh e li! Pale ç'vuajti djali i Mankës, i këtij fqinjit që kemi këtu! E zunë te pragu i shtëpisë, e shpunë gjer te çezma, i thanë «Shko», pastaj i thirrën «Ndal» dhe i zbrazën përmbi kokë një krehër me fishekë. E lidhën, e shpunë te kumandari dhe i thanë këtij se deshi t'u ikte. U mundua i shkreti djalë t'i mbushte mendjen kumandarit se nuk kishte ndër mend të arratisej, po më kot. Më në fund, bënë si bënë dhe e ndreqën. U dha një palë vathë, dhjetë napolona kartë edhe viçin dhe e lëshuan. — Halla psherëtiu dhe u vrenjt. I uli vetullat aq shumë, sa nuk i dukeshin sytë fare. Trazoi zjarrin me mashë dhe vazhdoi: — Më erdhën edhe këtu nja tre syresh dhe m'u shtruan ja aty, si maçoku në thekër.

— Ç'jeni ju? — pyeta.

— Ballistë, — m'u përgjigjën.

— Buallica ruani ju? — i pyeta.

— Jo. Luftojmë për liri, — thanë dhe hopa, e hodhën këmbën mbi këmbë dhe përdrodhën mustaqet, që u për-

dredhsha kokën! Pale, ishte një kokëmadh e qeros, me një turi të shpëlarë e të fryrë. Më kërkoi memshanenë!). Ia tregova unë, 'se nusja s'u dilte, mazallah! Kur ngrihem në mëngjes, kërkoi andej, e kërkoi këtej këmishët që i kisha lënë atje, s'i gjeta. I kishin marrë. — Halla vuri buzën në gaz: — Mirë që më kishin lënë fshesën. Me të do t'u futem, po ta sjellin kokën përsëri.

Unë dhe nusja qeshëm. Halla vazhdoi të më kallëzonte një nga një të gjitha hallet. Papritur sytë iu errësuan. Rrudhat e ballit iu mbushën me djersë të ftohta. U ngrit ngadalë dhe, duke u mbajtur pas shkopit me gunga, afroi kokën në dritare.

— Shikoje! — më tha me zë të dridhur.

Bora binte përjashta dhe era e maleve e mbështillte dhe e përplaste në dritaren e vogël. Në oborr, pranë një dushku të zhveshur, ngrihej një kukumale me borë. Mezi dallova mbi të dy drurë të hollë që dukeshin si shtiza të vogla të ngulura në bardhësinë e pafund.

— E shikon?! — më pyeti duke më hedhur në qafë dorën e saj të lehtë pendë.

Fërkova me pëllëmbën e ngrontë xhamin e mbuluar me një cipë akulli dhe m'u duk atje, rrëzë dushkut, forma e një varri.

E pyeta i shqetësuar.

— Varr është ai?

Ajo pëshpëriti, sikur druhej mos zgjonte njeri nga gjumi:

— Është Xhemali im atje.

E pashë fytyrën e hallë Zikes që pasqyrohej në xhamat e ngrirë të dritares. I dridhej lehtë buza e poshtme; fryma i dilte me ngashërime të ndërprera; një lot i la një vazhdë mbi faqen plot vijëza të holla.

— Faqezinjtë! Ma vranë djalin! — tha dhe unë ndjeva buzët e saj të thara që më puthën faqen e parruar.

1945

1) (turq.) — nevojtojen

FSHATI IM

Ç'më shohin sytë atje tej, rrëzë shkëmbit maja-maja, atje lart mbi bregun me pemë e plepa!... Është fshati im, fshati ku linda, ku u rrita; fshati i nënës, i atit, i fshatarëve të mi!

Ç'kujtime!...

Aty linda; aty u lëkunda për herë të parë në djepin e vogëlisë, aty u përkëdhela nga duart e nënës, aty qava në varrime, aty qesha në gëzime.

Aty u rrita, në fshatin tim, mbi kodrën me plepa, rrëzë shkëmbit maja-maja; aty ujita me djersë arat, luadhet, kopshtet; aty ngava qetë e lërova tokën; aty ruajta e rrita dhentë e dhitë, aty, në fshatin tim, në bregun e hijshëm, në malin e lartë, në fushën e gjerë.

Aty pashë dasmat e ahengjet, dëgjova këngët e shtruar, që gufonin nga zemra e plakut, mësova vallet, që hidheshin e përdridheshin nga nuse e djem çapkënë, shkova në hell dashin rudak.

Ç'ditë gazmore! Ç'bukuri ky fshati im!...

Ç'më shohin syte atje tej, atje lart mbi kodrinën, rrëzë shkëmbit maja-maja!

Gërmadhë! Hije e zezë mbi të!

Plepa e pemë shkukur nga rrënjët dhe gremisur mbi luadhe, ara, kopshte. Gropa të thella plot llom e batak! Mure të rrëzuara e shtëpi të shkatërruara! Gurë të nxirë e trarë të djegur flakur andej-këtej!... Dhe korbat vërtiten e vijnë vërdallë mbi kërmat, mbi kockat, e qyqet vajtojnë mbi pullazet e qentë ulërijnë te pragjet e portave!

Sa fshatarë nuk i shoh më! Xha Veseli, plaku me sytë e zinj, me rudhat e trasha, me mjekrën e gjatë, babai i fshatit, nuk është më. Aty, nën një tog dheu, tretën eshtrat e tij!

Lemja, zemra e fshatit, nuk duket gjëkund. Kurmi i tij tretet aty, te pragu i portës, dhe nënës qyqe lot i pikon syri, e gjak i pikon zemra!... Një dorë e egër i vrau, i dogji! Dora e armikut, e tradhtarit!

Ç'mjerim!

S'ka më qengja rudakë, s'ka më dhen e dhi, s'ka më tinguj zilesh e këmborësh, s'ka më zhurmë fëmijësh!

Atje, në plevicën plot byk, lagështirë e pluhur të hidhur farmaq, gjyshe Hysnia, nusja e Hajros, Fatimka, pa mashkull në shtëpi... pa zjarr në vatër!... A është ky fshati im?!

...Ç'më shohin sytë atje tej, atje lart mbi kodrinën rrëzë shkëmbit maja-maja! Ç'mjerim!...

«Shkrumb e hi ky fshati im!...»

Po shkrep dielli e një zë buçet tejmbanë:

«Liria i ka rrënjët në gjak!»

Nga gjaku e gërmadhat do të rilindë fshati im...!

1945

LUFTON NËNA

Ishte shkurti i vitit të kaluar.

Frynte tufani në malet e gërxfhet e ashpra të Oparit. Në natën e errët e të ftohtë ujqrit e uritur ulërinin dhe hijet e tyre nxinin mbi dëborën e ngrirë. Devolli buçiste si ushtima e predhave të topit dhe kishte dalë jashtë shtratit.

Njëshkolona partizane, e lodhur prej rrugës së gjatë, ecte ngadalë, pa zhurmë. Aty, rrëzë një shkëmbi të madh, partizanët grumbullohen. Zhurma e ujit i shurdhonte, lumi vinte rrëmbyeshëm dhe dukej sikur do t'i përpinte, por duhej kaluar. Armiku ishte përtej, nën katundin Gobesh, në pozita të forta, po fshati duhej çliruar. Dikush pëshpëriti: «Ura është e prishur, do të kalojmë lumin» dhe u zhyt i pari në rrjedhën e ftohtë e të furrishme. Ishte Shabani, komandanti. Të tjerët e pasuan. U lidhën dorë mbas dore dhe iu futën ujit që u kapërcente mesin e trupit. U hodhën përtej. Kolona u vargos përsëri dhe mori rrugën e përpjetë të katundit...

Pas pak një batare pushkësh gjëmoi në atë natë të errët. Një sokëllimë e fortë, doli nga gjokset e çelikta të

«sulmuesve» dhe kjo mjaftoi. Armiku nuk u duk më. Tashti ai e ka mësuar përmendsh fjalën e urtë «Këmbët e lehta e faqja e bardhë». Dhe Gobeshi u çlirua...

Por aty, përbri një shkëmbi të madh e të mprehtë, mbi dëborën e ngrirë, digjet një zjarr i vogël. Një orë më parë ngroheshin rreth tij armiqtë e popullit. Tashti qëndrojnë partizanët me sy të përlotur, me nofulla të mbërthyera, të shqetësuar. Afrohen, ulen e ngrihen mbi një shok të shtrirë. Shohin njëri-tjetrin me fytyra të vrenjtura dhe psherëtimë thellë. Pastaj largohen përsëri. Në dritën e vogël të zjarrit dallohen fytyra e zbehtë e një trimi dhe gjurma të kuqe mbi dëborën e bardhë. Është gjaku i Shabanit! Është trupi i komandantit të vrarë!...

* * *

Në Porodinë, në rrëzë të qytetit, në fshatin e kaq luftërave, një nënë pret djalin e saj, që s'e ka parë prej dy vjetësh, që kurse e përcolli gjer te pragu i portës dhe ë uroi dhe e bekoi. Pret birin e saj, që s'ia ndien më zërin e ëmbël, s'ia përkëdhel më flokët e dredhur, s'ia puth më ballin e gjerë që prej ditës kur e veshi dhe e ngjeshi partizan. Pret dritën e syve të saj...

Por ja, në vend të djalit, nëna mori lajmin e zi: «Shabani u vra». Një rrëqethje e fortë përshkoi trupin e saj, një cipë e errët i mbuloi sytë, nuk lëvizi një çast, u nguros. Pastaj para syve i kaluan kohët kur në gjirin e saj të nxehtë thithte qumështin Shabani fëmijë, kur në prehrin e butë përkëdhelej vogëlushi pesëvjeçar, kur te pragu i portës puthi ballin e ndritur të Shabanit të rritur, të Shabanit partizan. Nëna u nguros për disa orë, u drodh, zemra gjak i pikoi, po nuk derdhi lot, nuk nxori asnjë psherëtimë, nuk vuri kujën. Më në fund mblodhi veten, shtrëngoi grushtet e vogla, rrudhi vetullat dhe sytë i ndritën nga hakmarrja. Po, ishte shprehja e hakmarrjes. Ajo u betua se do t'ia mernte vetë hakun, se luftën e tij do ta vazhdonte vetë, se qëllimin e tij do ta arrinte vetë.

– Kështu gëzohet dhe fle i qetë djali im, – tha nëna...

Dhe që prej asaj dite mbante varur në mur maliherin e mbushur, që dikur e hidhte mbi sup Shabani trim...

Dhe rasti erdhi. Ballistët, duke përfituar nga largimi i partizanëve prej Porodine, një mëngjes, u turrën mbi fshatarët si ujku në shqerra.

Por nga dritarja e një shtëpie të vogël i priti krisma e një maliheri.

Luftonte nëna e Shabanit.

Dhe zëri i saj oshëtinte anembanë katundit:

– Ma ka lënë amanet Shabani!

1945

Plumbat e armikut e goditën në krahun. Gjaku i tij
— holl! vlarë në vend, së gjelbëruar të fushës së Vlerthit. Xhatë!
— mirë e partizanëve, grushtet
Vlerthit!

ZEMËR NËNE

Plumbat e armikut e goditën në kraharor. Gjaku i tij skuqti lëndinë e gjelbëruar të fushës së Vjerthit. Xhaferi mbeti i vrarë në vend, së bashku me shokë të tjerë të plagësuar.

Pika loti u rrokullisën nga sytë e partizanëve, grushtet u shtrënguan fort, zemrat gufuan... U vra Xhaferi!

Ky lajm i zi u hap në gjithë brigadën dhe menjëherë mori dhenë. Nga veriu në jug, nga Mirdita në Kolonjë, në Lubonjë, në shtëpinë e vogël të Xhaferit ku, nëna e mirë, afër gllanikut, rronte me kujtimet e bukura të djemve dhe të çupës së saj që luftonin maleve. Lajmi ra si gjëmë në shtëpinë e veçuar të Lubonjës; tingëlloi si këngë e moçme dhe çori zemrën e nënës.

— Djali i madh t'u vra në fushë të Vjerthit, o nëne! — mezi i thanë.

— Por u vra për liri! — tha nëna me zë të drithëruar.

— Ti mbete qyqe!... — tha dikush.

— Jo, unë kam shumë, shumë bij të tjerë, — pëshpëriti nëna te vatra, që lëshonte shkëndija.

— Po pse s'derdh lot? — e pyetën të habitur.

– Trimat nuk qahen..., – u përgjigj thjesht ajo.
...Dhe fshati heshti përpara zemrës së fortë të nënës,
dhe burrat rrudhën ballin, dhe gratë e reja nuk qitën
zë... Dhe fëmijëve u ngriu lodra në duar.

Nëna priste e përcillte shokët e luftës, miqtë e fa-
refisin që vinin për ngushëllime:

– Nuk e qaj, jo! Djali im u vra për liri.

Dhe fshati heshte i habitur e pëshpëriste:

– Ç'nënë!...

Një ditë i ra në dorë një letër e thjeshtë. E ngushëllo-
nin partizanët, shokët e djalit të saj. Nëna u nguros për
një çast, pastaj e puthi, e puthi shumë herë atë copë
letër. E futi në gji, e shtrëngoi fort, e përkëdheli si përkë-
dhelte dikur Xhaferin e vogël...

Po lajmin e priti pa derdhur lot, pa vaje e kuje,
ashtu si priti Xhaferi plumbin e armikut. E priti me të tro-
kitura të forta zemre. Dhe, shpejt e shpejt, shkoi te ni-
përit, gjeti kartë e bojë dhe u shkrojt partizanëve një
letër, ku shprehu ndenjat e saj të dëlira:

BIJTË E MI!

«E mora lajmin e humbjes së të shtrenjtit tim dhe të
shokut tuaj Xhafer. U dëshpërova, por u ngushëllova që
im bir ra dëshmor, ashtu siç i ka hije një atdhetari të
vërtetë. Do të jetë i pavdekur për mua, për ju dhe për
popullin, të cilit nuk i kurseu asgjë.

Të jeni të sigurt, bijtë e mi, se jo vetëm që Xhaferin
nuk do ta vajtoj, por do të ngushëlloj gjithë nënat e
dëshmorëve, gjithë nënat, që i dhanë popullit dritën e
syve.

Unë kam akoma një djalë dhe një çupë në mal,
bashkë me ju. Me këtë rast ju them që t'i këshilloni
ata të dy të mos dëshpërohen, përkundrazi, të jenë
kryelartë dhe vrasja e vëllait të tyre, t'i nxisë edhe më
tepër për të vazhduar luftën.

Ju uroj, bijtë e mi, fitim në luftë dhe së shpejti
Shqipëri të popullit!

Nëna e Xhaferit»

Lubonjë, 7 tetor 1944

...Dhe fshati heshti kur këndoï letrën...
Nëna qëndronte krenare e thoshte:
– Nuk e qaj Xhaferin!...
– Nuk derdh lot!...
– Nuk mbetem qyqe, kam boll bij!...
...Dhe fshatarët pëshpërisnin:
– Ç'nënë!

1945

GJERGJEVICA

Gjergjevica është nga katundet më të mëdha të Oparit. Është vendosur në mes të shkëmbinjve të egër, në majat e të cilëve kanë folenë vetëm shqiponjat. Rrëzë tij gjarpëron një përrua i thellë me ujë të rrëmbyeshëm e të shkumëzuar, që rrjedh shkallë-shkallë në katarakte të vogla; zhurma e tij është aq e madhe në vjeshtë, sa të shurdhohen veshët. Fshati duket si shkretëtirë. Veç kumbullave të egra dhe çaçanikëve, asnjë pemë s'të zë syri.

Mbi gurët e mëdhenj, që duken sikur do të rrokullisen dhe mbi shkëmbinj të egër, ngrihen si kulla të bardha shtëpitë e katundit, me dritare të vogla, shumë të vogla, sa mezi depërtojnë rrezet e diellit.

— Është gjynah të kesh penxhere të mëdha, — më thoshte xha Dauti në shtëpinë e tij. — Kemi gra brenda dhe armiq jashtë.

Isha ulur në këndin e vatrës, në anën e djathtë të oxhakut. Shikoja përreth dhomën e errët, rrogozët e çierër, muret e nxira nga tymi i zjarrit, enët e pakallajisura, shqytkat në qoshet e dhomës që kundërmonin erë zhezhinë. Ndieja erën e ngrohtë e të thartë që më ngacmonte në hundë dhe më digjte në grykë. Shikoja me

habi xha Dautin me hundë të shtypur e me qafë të shtrembër që hynte e dilte nga pragu i portës duke pështyrë gjak; shikoja hallë Esmënë plakë, me fytyrë të rrudhosur dhe plot pllacka të zeza. Vëreja nusen që tundte djepin; ishte me shpatulla jashtë, gjysmë-lakuriqe, me fytyrë të zbehtë si limon me shami copë-copë në kokë, me këmbët jashtë. Shikoja çupën e madhe të shtëpisë me një futë larushkë përpara, që gatuante mbi tymin e zjarrit. E çfarë gatuante? Treste në zjarr gjizën me ujë, që më shtroi përpara hallë Esmaja me një fjalë të ngjirur:

– Këtu ha pula gur, bir. Urdhëro!

Dhe mendoja:

– Ka sehirxhinj që s'kënaqen së pari një botë të tillë...

Xha Dauti doli jashtë, se e thirri kryetari i këshillit. Unë mbeta vetëm.

Një karvan fëmijë lëviznin në dhomën përdhese. Ata u vërsulën si bletët mbi gjellën që m'u vu përpara dhe futën gishtat në të, pastaj i lëpinë me shije të madhe. Halla rrëmbeu një urë të ndezur nga zjarri dhe i trembi:

– Shporruni!

Ata ikën me të katra.

Ishin bythëçjerrë, me mishra të mavijosura, me buzë të murrëtyera, me këmbë të holla si fyej kallami. Gumëzhinte oda nga të gërthiturat e dy binjakëve të djepit. Ulërinin, por plaka e nusja nuk çanin kokën, ato ishin mësuar.

– Plaç ju preftë! – u thirri çupa e madhe.

– Mos m'i mallko, moj damlla! – e qorton hallë Esmaja, pastaj kthehet nga unë:

– Na kanë rënë mësysh fëmija, more bir. I plaçin sytë asaj shturigës së Manes që nuk i pështyu e s'u tha «mashalla».

Kështu ngushëllohet halla, por binjakët ulërijnë. Pastaj ajo u bën si gogol, u thërret bu-baaaaa, go-goooooo, mu-muuu! Dhe fëmijët pushojnë.

– Kështu i pushoj gjithnjë, – më thotë halla. – Na plasën xhanë, more bir, pastaj nusja nuk ka dhe pak, nëntë i ka dhënë zoti – dhe fshiu hundët me mëngën e këmishës.

– T'ju rrojnë! I paçi me ymër!...

– Eh!... Thuaj «mashalla»! Po t'i kishin rrojtur të gjithë, do të kishte pesëmbëdhjetë, por i kanë vdekur gjashtë. Të ishte djali i parë, do të qe bërë burrë, do t'i kishte vajtur koka në tavan; por s'qe kësmet.

Halla trazoi zjarrin me çelikran dhe vazhdoi:

– Po gjene zoti është i madh, do t'i falë të tjerë!

Ne po fjaloseshim me hallë Esmanë, kur një e shkretë mace e paskësh gjysmuar gjellën. Pashë me bishtin e syrit nusen që po çmorrte një vocërrak te pragu i portës.

Bilbili na lajmëroi se duhet të dilnim. Përshëndeta hallë Esmanë dhe nusen, që më mbushën një xhep me kaçka, dhe dola.

Pa kur m'u kacavirrën fëmijët nëpër këmbë e m'u varën në cepin e palltos e të çantës. Luanin me kuku dhe gjenin trupin tim për t'u fshehur! I rrëmbenin njëri-tjetrit copën e misërnikes së mykur që shtrëngonin në duart e tyre dhe e hanin me shije të madhe.

Nusja i shau një herë, pastaj, kur s'u bindën, ua hoqi me nallane. Ata kërcyen përpjetë si kecërit dhe u fshehën prapa gardhit.

Kur arrita te lëmi, dëgjova Selmanin të thoshte:

– Mos më sjellte zoti edhe një herë – dhe hidhte gurë prapa krahëve.

– Ç'bën kështu? – e pyeta.

– Magji, – m'u përgjigj me zërin e tij të ngadalshëm.

– Po të hedhësh gurë prapa, s'ta bën perëndia kësmet të kthehesh kësaj rruge.

Ishte fanatik i madh Selmani. Por lufta nuk ia dëgjoi magjinë. Gjergjevica u bë shtëpia e tij, streha e tij. Fshatarët u bënë shokët e tij të luftës.

* • *

Një ditë, Selmani, për të mbrojtur njerëzit e mjeruar e barkthatë të Gjergjevicës, luftoi në shkrepat dhe thepat e saj...

...Dhe ra dëshmor.

Nga vëllimi
«GRURI
NUK U DOGJ»

1949

1900
1901
1902

1903

GRURI NUK U DOGJ

E nxori atë dimër xha Hasani me një këmbë në varr. Kaq herë mbeti pa bukë e pa kripë. Diku gjente te fqinjët ndonjë grusht elb a krunde. I përziante me thekër dhe e shoqja piqte në hi një dreq buke, që as qeni s'e hante. Sa për të mbushur barkun. Bëhej njëfarë koromaneje, që, për zotin e vërtetë, t'i rëzonte dhëmbët një e nga një. Jo vetëm kaq, po as plumbi s'e shponte. Për gjellë, mos e zër në gojë atë fjalë. Tre muaj hëngri vetëm arme e dhallë, dhe, nga një herë në javë, një droçkë fasule në një poçe të madhe me ujë. Sa për të mbajtur veten gjallë.

Çështë e vërteta, vuajti shumë atë mot.

Kaq herë i tha e shoqja, Rukia:

– Po nxirë more burrë, farën, se po vdesim si peshku pa ujë!

Xha Hasanit s'i mbushej koka. E dëgjonte dhe s'i përgjigjej. Dha e dha, dhe një herë ia plasi:

– E si ta hamë farën! A je në vetë! Ç'do të mbjellim?!

Ishte i vuajtur për ato gjëra xha Hasani. Jeta e kishte plakur me halle. Shtatëdhjetë vjet me radhë e kishte

parë diellin të lindte nga Ivani e të perëndonte thellë, nga malet e Gorës. Kush hante farën, e merrte lumi. Mor po, edhe zorrët sikur të bëhen petë, farën mos e luaj nga shiniku, – këshillonte xha Hasani. – Se, kur të tjerët do të mbjellin, ti do t'i bësh sehir, dhe, kur të korrin, ti do t'i biesh këmbës!

Këto mendonte xha Hasani, prandaj e ruajti farën, si sytë e ballit.

Në vjeshtë, pas shirave, e mbolli grurin në arën e vogël, aty në Muzgët, afër mullirit. I kulluan djersët gjersa e lëroi dhe e branoviti me atë pelën plakë, së cilës i kishin mbetur vetëm kockat e lëkura. Iu këput beli atij dhe Çeços, të birit, gjersa i mbollën kokrra-kokrra ata gjashtë a shtatë dynmë tokë.

– Zoti e shtoftë! – uroi më në fund plaku.

Kur shkriu dëbora dhe dielli filloi të ngrohte, gruri çatisi nga dheu e gjelbëroi arën. Xha Hasanit iu fry zemra sa një kacek.

Vinte ditë për ditë në arë, e tëharte dhe qëronte krisjet e dredhjet, ferrat e gjambat. Kur e tëharr arën, ajo e bën thërrimen e grurit si flori, mendonte plaku.

Dhe gruri rritej i shëndetshëm...

Kur kalliri filloi të verdhej e të varte kokën, xha Hasanit s'i qeshi më buza. Ulej pranë jazit të mullirit e mendojë me orë të tëra.

«Eh, ishallah e hamë gëzuar!» – rënkonte thellë. «Gruri është i mbarë këtë vit. Ia bëmë hyzmetin mirë.» Dhe vërtet, i mbarë ishte gruri atë mot. «Dhjetë killë killa i jep si vdekja», – mendonte bujku plak. «Ç'Ilafos! Gruri e ka shpënë kallinë një hosten larg. – Vazhdonte xha Hasani. Dhe çfarë kalliri! Të mbushur, të ngjeshur me thërrime të mëdha. Prandaj dhe kalliri e mban kokën poshtë...»

Dhe psherëtinte bujku:
«Eh, ishallah e hamë gëzuar!»

Një ditë e pyeti Lytoja, lopçari i fshatit:

– Po pse thua ishallah, more xha Hasan? Nuk gëzohesh që më ke atë birko grurë?

– E si të mos them, more Lyto, – iu përgjigj plaku duke ulur vetullat e trasha gjer në sy. – Si të mos them

«ishallah!» A e di se jemi të zaptuar, me hasmë në vater? E di, apo jo?

– E di...

– Ashtu de! Po mos harro, se gjermani përvëlonte të gjallë njerëz, e jo pastaj të mos përvëlojë një arë me grurë. Ja, vjen nesër e t'i vë zjarrin. Ec e ha shkrumbin pastaj! Se gruri shkrumb do bëhet...

– Ashtu?

– Po ç'kujtove ti. A, po i huaji është i egër, more Lyto, s'është njeri ai qafir. Është viranot.

Xha Hasanit i rëndonte si gur në zemër fjala «i huaj», «gjerman», «fashist». Ai i kishte parë si rrëmbenin pulat e rosat e fshatit. I kishte parë... si e vranë, te mullari me bar, djalkën e Hyskës, që s'donte t'u jepte rosën me bufka. I kishte parë mirë se ç'biçimë ishin, prandaj ia kishte frikën edhe grurit dhe thoshte shpesh:

«Eh, ishallah e hamë gëzuar!»

Dhe vërtet i doli fjala xha Hasanit.

Një ditë u ngrit që pa gdhirë e shkoi në arë me gjithë Çeçon. E korrën grurin gjer ndajnatëherë, e lidhën duaj dhe e bënë gati për ta ngarkuar në qerre. Ditën e dytë u ngritën me këndesat dhe u nisën. Po, sapo kapërcyen plehun e shtëpisë, panë në xhade një karvan të gjatë me ushtarë gjermanë. Ishin ngarkuar me armë sikur do të sulmonin ndonjë kala. Aty te mulliri u hapën. Ca morën përpjetë shkozës dhe ca, vijën e ujit. Mushkat e kuajt, i lëshuan azat, arave. Nja njëzet hynë në arën me grurë të xha Hasanit dhe filluan të hanin duajt. Xha Hasani i shikonte duke shtrënguar nofullat. Vrer i pikonte buza.

– More Çeço, po i lëshuan arave mushkat e kuajt, more, – i tha të birrit. Pastaj thirri: – Ah, sikur të isha i ri! – dhe fytyra iu vrenjt si qielli me re.

Të huajt po i hanin grurin, jetën.

– Po halli, more Çeço!...

S'e mbaroi fjalën, kur pushkët u zbrazën mbi fshat. Pastaj mitralozi dhe bombat e dorës. Pa krisi dhe mortaja e të filloi një luftë që shumë rrallë e kishte parë xha Hasani.

- More Çeço, po më duket janë ata të maleve, more biri! - tha me gjysmë zëri. Ata sytë e thellë i ndritën dhe fytyra i qeshi.

Ishin me të vërtetë ata të malit, partizanët.

Lufta vazhdoi ndonjë orë. Pastaj s'u ndie më asnjë dyfek. Të huajt morën bishtin në shalë e ua mbathën këmbëve. U zinin thembrat mu në gropë të qafës. O, të kur që bënin, të pathyeshmit!

Xha Hasani doli në prag të portës e i pa kur po vraponin xhadesë e hendeqeve.

- Hë-hël - u thirri duke tundur stapin e trashë që mbante në dorë. - Këmbët e lehta e faqja e bardhë. Ku vini, ku? - dhe ia plasi një të qeshure që edhe Rukia, e shoqja, u çudit.

Partizanët i ndoqën nazistët gjer afër qytetit, pastaj u kthyen në fshat. Bujku plak u hodhi duart në qafë dhe i puthi.

Të nesërmen, me gjithë Çeçon, mblodhën duajt, i shtruan në lëmë dhe shinë grurin. Natën bënë një kërcmë të vogël me partizanët. Kur u shtruan në sofër trimat, u tha me gjithë zemër:

- Hani, more djema, se është gruri juaj. E keni hallall, se ju ma shpëtuat!

Pas ca ditësh xha Hasani dërgoi në mal me partizanët edhe të birin, Çeçon.

LESKOVIK, O GUR...

...Ecim, gjithnjë ecim. Natë. Shi.

Qentë filluan të lehin. Po ne i kemi zënë pozicionet. Skuadrat e sulmit janë vendosur përpara kazermave. Ne jemi lart, në disa brigje të lëruara, afër armikut. Përgatitim pozicionet për t'u mbajtur krahët shokëve që sulmojnë. Për llogoret nuk humbëm kohë, sepse arat janë rrethuar me çakëlle. Rregulluam sidokudo gurët dhe ploçat dhe u shtrimë në tokën e lagur. Afër kam xha Limin. Ai ka zgjatur kokën dhe shikon përpara skuadrat e sulmit.

– Gjer tani jemi mirë. Shokët janë afruar mjaft...

S'e kishte mbaruar mirë fjalën xha Limi, kur një krismë pushke çau ajrin; mbas saj edhe një tjetër, edhe një e tretë. Shokët shtinë mbi rojat. Një fishekzjarr me dritë të kuqe u ngjit ngadalë shumë lart në qiell, qëndroi aty për një çast pa lëvizur, pastaj filloi të rrëshqiste me shpejtësi, si yll i këputur. Shenja e sulmit.

Mijëra pushkë krisën nga të katër anët. Leskoviku shkëlqeu, i kuq gjak. Edhe Melesini u bë i kuq. Qielli dukej sikur po merrte flakë e po lëshonte shkëndija, që sillëshin vërdallë në drejtime të ndryshme. Plumbat me

zjarr suleshin e mbërtheheshin në muret e kazermave të ushtarëve italianë, qindra të tjerë xixëllonin përsëri. Tri predha mortaje vërshëlyen njëra pas tjetrës dhe u përplasën mbi çatitë e kazermave. Flaka e tymi u ngritën përpjetë dhe u përhapën në qiell. Edhe tri predha të tjera goditën përsëri kazermat. Grykat e maleve oshëtinë njëra pas tjetrës.

Dielli porsa kishte nxjerrë syrin nga maja e malit, kur në qiell lart, shumë lart, u duk një «kaçiator» italian. U vërtit e u vërtit mbi ne, lart, gjithnjë lart – kujtonte se mos kemi edhe kundërajrorë. Pastaj, si u siguria, u ul mbi çatitë e Leskovikut dhe filloi t'i hidhte si breshër plumbat e bombat. Zjarri i pushkëve u pre nga të dyja anët. U shtrimë përdhe dhe ngjeshëm kokën në rrëzën e çakëllit.

– Na e hëngri kokën! Ky qerrata sikur i ka bombat me thasë, – tha Rexhepi duke u sjellë vërdallë nga një vend në tjetrin.

– Shko, mor derr, se s'ka vend këtu. Do na hedhë ndo një bumje e do na bëjë fërtele të gjithëve. Ikl – i shfryu xha Limi.

– Ku të vete?

– Dil aty në mes të sheshit e qëndro në këmbë drejt. Ti je i gjatë. Do të të marrin për pemë dhe s'do ta harxhojnë bumjen.

– Jaaa! Ngrehu e dil vetë të shohim!

– Hë, more frikaman! – i shfryu përsëri xha Limi dhe doli aty në mes të sheshit e qëndroi në këmbë pa lëvizur, si një hu gardhi. Rexhepi u ngjesh pas çakëllit dhe filloi të dridhej.

Rrahu e rrahu aeroplani me bomba e me mitraloz, sa e bëri duman! U dogjën ca shtëpi aty mbanë Leskovikut dhe tymi u ngjit në qiellin sterrë. U dërrmuan plloçat e llogoreve tona dhe të shokëve andej matanë. Po të gjithë ne gjallë. Asnjë i vrarë, asnjë i plagosur. Çudi, gjithë ai plumb e barut të mos vrasë njeri! Ja, edhe aeroplani s'qenka gjë! Në fillim na u mblodh. Pastaj, një herë, dy, tri dhe, sikur u mësuam, sikur s'na bënte tërr veshi. Vetëm Rexhepi s'gjente vrimë ku të futej.

Mbas gjysmë ore aeroplani u zhduk prapa maleve.

– E, more, gjallë jeni?

– Gjallë të gjithë!

Skuadrat e sulmit ishin shumë afër kazermave. Komandanti, me atë këmbën e majtë pak të shkurtër, hidhej nga një ledh në tjetrin dhe shtinte në frëngjitë e italianëve. Pranë tij Zefi, me ato duar të holla dhe me atë lëkurë të ndritur e të verdhë si limon, shkrepse patickën italiane. Shtie rrallë, me vend, s'e prish plumbin kot, si një luftëtar i vjetër, megjithëse ka vetëm katër muaj në çetë. Po Zefi është me të vërtetë luftëtar i vjetër; ai është rritur me pushkë krahut ndër ato malet e Mirditës dhe ia di të gjitha yçklat pushkës e luftës. Prandaj edhe komandanti e mban afër. Komandantët mbajnë gjithnjë dy ose tre partizanë nga më trimat. Këta i përdorin si ndërlihdhës për të shpënë e për të marrë lajme e në shumë raste edhe për të sulmuar ndonjë llogore të fortë të armikut. Zefi është një nga këta.

Në krahun e majtë të komandantit është komisari dhe më tej Mefaili. Ata shënojnë dhe shtien vetëm në frëngjitë. Është dhënë urdhër sot që plumbi të zërë në mish; ndryshe italianët nuk shkulen nga kazermat. Po, që të mos shkojë plumbi kot, duhet të jesh shënues i mbaruar! Duhet ta futësh plumbin në një vrimë të vogël, të vogël sa mezi duket! Po është lehtë thua? Mirë Zefi, Mefaili, komandanti e nja njëzet partizanë që u kanë dalë thinjat këtyre maleve së luftuari, po të tjerët që kanë ardhur këto ditë në çetë?! Pa pyete Dhorin? Pa pyete Kadriun që s'ka as dhjetë ditë në çetë! Dhori bën ç'bën e të thotë:

– More, po plumbi a bën përkulje? A të vret kur je prapa shkëmbit?

Më vonë erdhën aeroplanë të tjerë, nga një e nga një, nga dy e nga dy, jo më «kaçiatorë», po bombardues të mëdhenj që nxinë qiellin. Na hodhën e na hodhën plumba e bomba, ja, kështu, si shi. Po ne përsëri gjallë; as vrarë e as plagosur.

– I kni, more, mbushuni! – u thirri xha Limi siç rrinte në këmbë aty në mes të arës dhe u shtiu me pushkë. Pa filluam të gjithë t'u shtiem aeroplanëve.

– Ah! Sikur t'i rrëzojmë!

– Sikur t'i rrëzojmë! – Dhe plumbat tanë si breshër u drejtoheshin aeroplanëve. Mbas pak dikush na thirri me inat:

– Kurseni fishekët!

Nuk shtimë më.

– He! Kur s'kemi një top, – tha xha Limi i zemëruar. – T'ua lëshoja një gjyle e t'i bëja fërtele që në hava. Ç'e do, kur s'kemi një top!

Ne s'kemi kundërajrorë, as kundërtanke, as mitraloza të rëndë, bile edhe të lehtë nja katër a pesë janë a s'janë. Vetëm një mortajë, edhe kjo harxhoi nja tridhjetë gjyle e tani ngrohet në diell! Ne e bëjmë luftën vetëm me pushkë e me ndonjë bombë dore që ua kemi marrë italianëve në Snosm e në Voskopojë...

Një lagje e tërë e Leskovikut po vjell tym e flakë. Bombat djegëse të aeroplanëve janë hedhur brenda në qytet. Shtëpitë digjen njëra pas tjetrës. Në rrugë lëvizin njerëz. Hyjnë e dalin portë më portë si të marrë. Burra, gra, fëmijë rendin zhveshur e zbathur nën strehët e shtëpive dhe humbin në tymin e zi që ngrihet lart shtëllunga-shtëllunga. Aeroplani lëshon bomba djegëse nga barku i mur-erë. Klithmat e fëmijëve dëgjohen gjer këtu, te ne. Dhe bombat djegëse përlajnë Leskovikun. Po barku i aeroplanit vjell, gjithnjë vjell zjarr.

Në pozicionet tona erdhi një plakë me një kusi të vogël në dorë. Gulçonte. Mezi kishte shpëtuar nga zjarri:

– Ju solla qumësht, more bij, pini – dhe na dha kusinë. U ul pranë nesh, psherëtiu një herë thellë dhe, duke parë në qiell aeroplanin që ulej e ngrihej me vërshtëllima të mprehta, na tha me zë të këputur:

– Kini mendjen nga aeroplanët, se na përvëluan qafirët. Ja, shikoni Leskovikun. E bënë gërmadhë, më keq se andartët e grekut qëmoti.

Psherëtiu edhe një herë dhe, duke shtrënguar sytë për të mos parë atë zjarr të madh që i kishte përzhitur shaminë e kokës, vazhdoi:

– Bjeruni qafirëve! Të ngordhin ndër istikamel

Një bombë plasi në lagjen e përtejme të Leskovikut. Plaka u hodh përpjetë e llahtaritur.

– M'i dogjën fëmijët! Atje ra bomba, në shtëpinë e sime bije.

Dhe zbriti përsëri duke thirrur:

– Bjeruni qafirëve!...

Më vonë erdhi edhe një fëmijë, që s'i kalonte të tetë vjetët. Zbathur, me një stap në dorë dhe një torbë në krah. Mezi mernte frymë. Na u afrua e na ngjiti sytë e vegjël, të ndritur si qelq.

– Merrini, shokë! – Kishte nxjerrë nga torba krehra me fishkë. – Ua kam marrë italianëve në dyqan. Po tani dyqani u dogj. Ja, atje, e shikoni? Po nxjerr akoma tymb! Ndoshta edhe babai po digjet atje. Merrini dhe vrajini italianët, se po na vrasin! – Fëmija fliste si i madh. – Na dogjën, more shokë! Ah, sikur të kishim një aeroplan! – U ngrit menjëherë në këmbë dhe na tha: – Do të shkoj Kam edhe ca fishekë në shtëpi!

– Qëndro me ne, se do të të vrasin, – i tha Rakoja.

– Jo! Do të shkoj. I kam fshehur në hatullat...

– Qëndro!

– Po janë dhjetë fishekë, more shokë! Sa italianë vriten me ta? – Na shpëtoi nga duart e ua mbathi këmbëve anës një hendeku të vogël. Mbas një ore u kthye përsëri, po me fytyrë të nxirë. Prej dorës së djathtë i pikonte gjak. Ishte plagosur lehtë nga një copë predhë aeroplani. – I solla, shokë, merrini dhe vrajini italianët...

Nuk foli më. Trupi i tij i vogël u rrëzua përdhe si pemëz e këputur nga rrënjët. Ata sytë e ndritur iu venitën e iu mbyllën. E ngritëm shpejt e shpejt, i lidhëm plagën me një copë këmishë dhe ia lagëm buzët me qumështin që na solli nëna plakë. Pastaj ua dhamë disa leskoviçarëve të mbetur pa shtëpi që shkonin në një pyll aty afër.

Na mbeti merak të gjithëve që s'ia mësuam dot emrin. Rakoja e quajti «Partizani i vogël trim». Kështu po e quaj edhe unë në kujtimet e mia...

TREGIM I NËNËS

Ka qenë e shtunë, koha kur mblidhej misri. Motin s'e mbaj mend. Po unë atëherë isha çupërlinë, gjashtëmbëdhjetë vjetët s'i kisha mbushur. Babai ka qenë në Korçë për pazar. Edhe nëna me Ferdanenë, time motër, ishin mysafire në Korçë.

Babai erdhi në Zvezdë rreth orës dhjetë. Shkarkoi pelën e u fut në ashef, ku po laja vedrën.

– Nëm, moj çupë, ca bukë, se do të shkoj në fushë, – më tha.

I dhashë një copë lakror, ca qepka taze dhe një sahan me dhallë. Hëngri dhe u nis.

Dielli s'kishte kapërcyer ende mbi Pirg, kur në majë të bregut doli tellalli e thirri që burrat të linin punën ndër ara e të mblidheshin te xhamia.

Tërë burrat e lanë punën. Ikën nga fusha dhe u mblodhën te sheshi i xhamisë.

– Vjen junani! – u tha burrave xha Nazifi.

– Junani?! – pyetën të habitur.

– Si, ore, junani?! Nga vjen ky haber?!

– Bobo! Po të ikim sa më parë!

– Dale, more, ku të vemi? Në kënetë të mbytemi?

Ca thoshin të ikim, ca të luftojmë, ca të rrimë. Pleqhtë ec e jakë nëpër oborr të xhamisë. Hej, dreq, hej! Ata më të rinjtë s'i mbante vendi.

T'u ngrit xha Nazifi, që atëherë ishte i ri, e t'u thirri një herë:

– Ta presim junanin me dyfek!

– Me dyfek?! – thanë burrat.

– Me dyfek! – tha prapë xha Nazifi. – Të zëmë Shkozën dhe Dherin e Kuq. Të luftojmë sa të luftojmë; në i thefshim, mirë se mirë; jo po, në qofshin shumë e në s'i mbajçim dot, e lëmë fshatin.

Dhe kështu e lidhën fjalën...

Babai erdhi në shtëpi me një frymë, mori dyfekun, mori edhe fishekët që i mbante në sëndyq me kyç, e më tha:

– Dëgjo, moj bijë, vëru veshin mirë fjalëve. Gjer nesër mund të vijë junani. Ne po shkojmë të ruajmë fshatin. Ti, po të dëgjosh dyfek, të ngresh djemtë e motrat e të mblidhni bagëtitë. Qamili t'i hipë mushkës, se është i vogël, Orhani të marrë bagëtitë, dhe ti me tët ungj të ikni. Mos shikoni shtëpinë, po veten, xhanin!

Për atë të keqe të atyre fjalëve! M'u ngulën si gozhdë në zemër. Babai mori ca bukë në torbë e u ngjit përpjetë, te Dheri i Kuq.

Atë natë lehnin qentë, sikur të kishte rënë ujku në fshat. Hënëza ndrinte. Tërë natën dëgjohej zhurmë. Ec e jakë këta njerëz, me guna siva e me dyfekë. Unë dritare më dritare, shikoja e vija veshin. Burrat shkonin duke rendur përpjetë malit ta prisnin junanin me plumb.

Për atë të keqe të asaj nate! Më bëhen duart pushkuriza, kur e kujtoj.

Ndaj të gdhirë krisi pushka.

– Pau, pau, pau!

«Filloi, – thashë dhe m'u mbushën sytë. Më vinte keq për babanë, për fëmijët, për njerëzit, për fshatin.

I vajta xhaxhait e i trokita në derë: «Dang-dang-dang», po mezi më ndjeu; ishte edhe shurdh e ulok. U ngrit e shkoi të ngarkonte qerren me plaçkat e shtëpisë. Jo të gjitha, po vetëm sëndyqet.

U vajta vëllezërve. Ata flinin si shqerrkëza.

– Orhan! O Orhan! Nisi lufta, more vëllai i motrës.
Ngrehu!

– Héé! – ia bëri Orhani i llahtaritur. – Po si do të bëjmë?

– Ngrehu të ikim! Shpejt!

– Ku?

– Në Shëngjergj. Ti mblidh bagëtinë e ik përpara.

Ai ishte i vogël, nëntë vjeç, e mezi i doli gjumi.

Dolëm të gjithë në oborr. Orhani e Qamili ikën përpara, hxaxhai ngarkoi qerren përgjysmë dhe e la, se grekët po dilnin në majë të Gurit. Nxori pelën çile nga ahuri, hodhi mbi samar qilimin e odës së mysafirëve e u nisëm me të shpejtë.

Dilnin graria e fëmijët nga shtëpitë e rendnin si të marrë. Ishte mbushur xhadeja e Shëngjergjit, mizëri njerëz: pleq, gra, fëmijë, bagëti, plaçka, qerre, aman! Pushka kërciste. Plumbat i binin misrit dhe e ronin thërrime-thërrime. Junani shtinte mbi ne.

Sa dolëm gjer te varret e Pojanakëve, na u godit e reja e Hoxhovicës, Mehmeti i xha Zakes, djali i Qerimit. Kjo e reja e Hoxhovicës, një trashamane, m'u plas përpara këmbëve, sa gjatë gjerë.

– Ç'pate, moj? – i thashë dhe vajta ta ngrija.

– Ik, se ajo u vra, – më thirrën ca gra që rendnin nëpër hendek.

Hodha sytë përpjetë Shkozës, nuk dukej gjë. Vetëm pushka kërciste dhe plumbat që ia bënin fësht-fësht nëpër këmbë. Pa kur dëgjoji një herë xha Nazifin që thirri aty në majë të Shkozës:

– Më të majtë! Më të majtë! Bëni këtej që të shpëtoj më fëmijën, se na i vranë!

Te mulliri gjeta qilimin që i kishte rënë hxaxhait nga kali. Më erdhi keq ta lija. Ishte i bukur, i bukur, sa më përvëlton zemra, kur e kujtoj. E hodha në krahë.

Në mes të kallaballëkut gjeta hallë Hysnien me gjithë djemtë, me ditëzi Kajon e me Nuren.

– Moj çupël Moj Hasbi, ti je, moj?

– Unë, moj hallë, unë.

– Po ku i ke djemtë?

– Shkuan përpara...

Nxitonim nëpër xhade, pa mend në kokë. Dyfeku s'le-
rente. Junani na shtinte, po burrat ia prenë udhën.

Si kaluam mullirin, gjej në hendek pelën çile me gjithë
plaçkat. Vajta ta merrja. Më erdhi keq. Po kur thirri hallë
Hysnia.

– As ik, moj e zezë, se doli junani e të zuri të gjallë
Lëri hajvanët me gjithë plaçka!

Dhe i lashë aty në hendek. Më erdhi keq, sa desh
plasa, po ç'të bëja? S'kisha ç'të bëja. Të më zinte junani
të gjallë mua?

Kur i shtimë sytë nga Dheri i Kuq, si ato sërët me dru
ishte radhitur greku që donte të na priste rrugën e të na
zinte të gjallë. Kaq kish e kaq kish saa, sa të të them,
mizëri.

Po e kaluam rrezikun. Burrat i mbajtën grekët, gjersa
ne iu afruam Shëngjergjit. Na mblodhën aty të gjithëve.
Nxinte sheshi. Po ku ishte gjithë ai popull, xhanëm? Kurrë
s'ma kishte prerë mendja se fshati ynë do kishte aq shumë
njerëz. Në xhade nuk i shihje gurët. Vetëm plaçka, torba,
dengje, jorganë, bagëti, kuaj. Ishte bërë rruga si pazari i
Korçës të shtunave. Se në hodhëm edhe plaçkat e trupit.
Ja, unë, hodha jelekun që ma kishte sjellë peshqesh yt atë
– ndjesë pastë – kur u zura për të martuar. Dhe duhej
t'i hidhje që të ishe e lehtë, se, po të dilte junani në
Shëngjergj më parë se ne, do të na shkonte në satër
të gjithëve.

Gratë zunë të kërkonin fëmijët. Kush i gjente e kush
s'i gjente. Ca fëmijë mbetën të vvarë, ca u plagosën, ca
humbën nëpër misrat. Dhe ata që ishin aty në shesh të
Shëngjergjit, s'ishin më fëmijë, por të rritur, me sy të
trembur e me rrudha në ballë.

Kur i hodhëm sytë Zvezdës, u doli flaka shtëpive të
Nures në majë të bregut. Na u ndrydh zemra, kur pamë
zjarrin. Po digjeshim.

Shkuam në Podgorie. Te Bedullahu i Podgories ndenjëm
atë natë. Aty morëm vesh se ishin vvarë djemtë e Vuka-
llarëve, tre vëllezër: Emini, Banushi, Rexhepi. Pastaj, edhe

Qazoja i Zëmlakut, edhe të tjerë, që s'i mbaj mend. Të plagosur kishte sa mos pyet.

Në Podgorie ndenjëm vetëm njëzë natë, se thanë që do vinte junani edhe aty. Dhe vërtet erdhi. Po ne, që pa gdhirë, e lamë fshatin dhe zumë vend në luadhet e Pîrgut. Aty kishin dalë njerëzit që pyesnin ç'kishte ngjarë, kush kishte bërë dyfek, gjer ku ishte junani, sa të vrarë kishte. Unë rrija mbi një kërcu aty mënjanë e dridhesha për babanë që e lashë në dyfek, për nënën në Korçë, për fshatin që u dogj. Kur dëgjoj zërin e dajës, që po thërriste në mes të njerëzve:

– Oree! Po fëmija e Maliq Ibrahimit ku janë?

– Ja, ja ku janë atje, në hijen e atij plepi.

Ne ishim mbledhur si shuqkë.

– Ju jeni, moj bija?

– Ne jemi, o dajë.

– Hajdeni, mos kini frikë, s'ka gjë. Po Maliqi ku është?

– S'e di, e lashë në dyfek me junanin.

Këto fjalët e fundit ia thashë dajës duke fshirë lotët me shami. Kaq kisha qarë fshehurazi, sa më ishin bërë sytë sikur m'i hiqte njeri me dorë.

– Mos qaj! Do ta thyejë kokën junani. Hajdeni të ikim!

Dhe shkuan në Starovë, në shtëpi të dajallarëve.

Pas dy ditësh erdhi edhe babai, me një pallto copë-copë e vrima-vrime nga plumbat, i nxirë, i hequr, me një turizkë na, të vogël.

– Zbrita prej malit, u hodha në një gropë gëlqereje, – na tregoi atë ditë. – Ngrita kokën, një grek aty në një ledh. E vrava. Pashë andej, pashë këtej, bir njeri. «Ej, thashë, këtu do të më zënë të gjallë.» Një të dalë nga gropa e t'u futa tatëpjetë në një misër të gjatë. Grekët më shtinin. Te gryka e mullirit pashë që më skuqi dheu përpara. «Bobo thashë, do të jetë ndonjë nga çupat.» Iu afrova, e ktheva mbarë. Nuk e njoha. Ishte një çupë e vogël. S'kishte vdekur, po jepte shpirt... «Nëma dorën, moj bijë,» – i thashë. S'm'u përgjigj. S'fliste dot. As dorën s'ma dha. Nuk lëvizte. Plumbi e kishte marrë në kokë. E hodha në kurriz dhe, zvarrë-zvarrë, e futa në

mulli. Aty dha shpirt. Bëra edhe një copë herë dyfek dhe, kur m'u mbaruan fishekët, mora tatëpjetë Ormanin e Pojanit e dola në kënetë. Atëherë pashë flakën në shtëpitë e Nures... Po ishin shumë djajtë, s'i mbajtëm dot.

Kemi ndenjor në Starovë gjer në vjeshtën e tretë. Burrat ikën më parë, ca në fshat e ca në mal me dyfekë. Ne na lanë aty. Pas tre muajsh u kthyem në shtëpi. Rugës, në Shëngjergj, na doli junani e s'na la gjë pa rrëmuar.

Atje i pashë turinjtë e tyre. Se si ishin ashtu, të shpëlarë, si derrat që zhgërryen.

Shtëpinë e gjetëm të djegur, zhur, me koshare, me plevicë, me mullar, me plaçka, me tërë ç'të zë syri, shesh. Tërë Zvezda ishte djegur. Vetëm nja dhjetë shtëpi kishin shpëtuar. Shkuam te Mehmeti i xha Zakes. Atje e ngritëm bicën.

Pastaj hoqëm ç'hoqëm! Pastaj erdhi e madhja! Vinin këta grekë, me forcë, e na kërkonin turli gjërash. Po të mos ua jepje, të ndërseheshin:

«E shikon këtë kamë? Mu në mëlçi ta ngull!»

Kështu i ngjau një ditë gjyshe. Të zezën gjyshe e kishim uloke në kënd. Atje rrinte gjithnjë. Në qoshe të odës, ndën policën e enëve, kishin hedhur misrin. Në të kishim fshehur kaden me gjalpë e me piperka turshi. Kur të erdhën ca grekë aty ndajnatëherë:

– Plakë, ku e ke gjalpën?

– S'kemi ne!

– Si s'keni? Po po ta gjejmë?

Dhe filluan të kobisnin e të rrëmonin si në shtëpi të tyre. Kur njëri e gjeti kaden të fshehur në misër.

I shfryu së zezës gjyshe:

– Pse gënjeve ti? E shikon këtë kamë? Mu në mëlçi ta ngull!

– Epo, unë jam plakë. S'di ç'kanë bërë.

– S'di, na! – dhe ia nguli kamën mu në shpatull.

E zeza gjyshe një mot të tërë hoqi me atë plagë...

Ne gratë e çupat s'dilnim dot gjer aty te pragu. Portën e mbanim mbyllur. Kur kërcisnin pushkët nga mali dhe vritej ndonjë grek, atëherë hiqnim ç'hiqnim! Dhjetë shtëpi në një shtëpi mblidheshim. Një ditë ishin futur tërë gratë e

çupat e mëhallës në një odë dhe qëndisnim flamurin tonë. Burrat rrinin rojë me radhë në shkallët jashtë. Babai na mbante me gajret. Hynte nganjëherë në dorë e na thoshte ndonjë shaka. Popo njëherë ia plasi:

– E ç’jeni mbledhur kështu, moj, si dhentë kur mërzejnë. Po ju s’jeni të shkretën as dhen që t’ju mjelim, dobaren!
Këto gratë e mëhallës zunë të qeshnin nën buzë. Plakat ia dhanë gazit. Ne çupat dhe nusërlinat kafshuam buzët të turpëruara.

Kur trokiti dera. Hynë grekët në oborr. Dëshën të hynin në odën tonë. Babai ua preu rrugën.

– S’është vend për ju këtu. A keni në shtëpitë tuaja nëna, gra e motra? I kni! – Ata s’dëgjonin. Dëshën të hynin me zor. – Vetëm kur të vdes unë, – thërriste babai.

Ata e shtruan në rrip. Babai i shante devolliçe:

– A... nënën! More edepsëzël! More mutër!

Më në fund ikën. Që atë minutë babai rrëmbeu dyfekun e shkoi në mal, me të tjerët...

1949

NUSJA

Tafil agai i Pepellashëve po rrinte menduar në majë të bregut. Sytë, ca sy të buhavitur me kokërdhokë të kërcyer, ia kishte ngulur malit të Tomorit. Mendohej Tafil agai, sikur t'i ishin mbytur gjemitë.

Ndezi me eshkë cigaren që i varej në buzët e bumyera dhe e thithi tymin gjer thellë në mushkëritë. Dhe përsëri ia nguli sytë majës së Tomorit e ra në mendime.

Ishte djalë i vetëm i një oxhaku të madh. I ati, Demir agai, i kishte lënë tërë të mirat. Një shtëpi me tetë konakë. Një karvan me hajvanë e me bagëti: kuaj, lopë, mëshqerra, dhi, dema për damas. Pastaj shpeshëri: tre qymezë të mëdhenj sa oda ku flinte hyzmeqari.

Kur lindi Tafili, u përmbys shtëpia e Demir agait nga këngët e nga vallet. Një javë të tërë luajti qeni i kallajxhiut. T'u skuqën furrat e saçet e t'u poqën bakllavatë me njëqind petë. Pale shqerrat e kulaçet. Pale rakia. Atë mot, për herë të parë, e piu rakinë Demir agai me opingë. Katër zamzane me raki dhe një but me verë gjetën fundin.

Edhe zahiretë e dimrit: kadushkat me turshi dhe kadet me arme u gjysmuan. Mysafirët u shkulën nga tërë anët edhe erdhën e hëngrën gostinë e Demir agait.

– Të rrojë sa Baba Tomori, o Demir aga, e paç me ymër djalin!

Ato ditë, edhe Zakes së Nures, pojakut të fshatit, i kishte lindur djalë. Mirëpo, në shtëpinë e tij s'u ndie as dauille. Lehona ishte plasur në kënd e rënkonte nga të therurat e barkut; fëmija lebetitej; Zakja vinte vërdallë.

Ia kishte ënda Zakes për një çikë aheng e për një gllënjë raki. Po s'e bënte dot. Në hambarët e shtëpisë binte miu e thyente kokën. Rrobat e trupit s'kishte ku t'ia zinte qeni. Jo pastaj të shtronte gosti.

Me këmbë të mbarë e pati djalin ky oxhak i Pepe-llashëve. Që kur lindi Tafili e gjersa u bë për të martuar, Demir agai e shtoi pasurinë edhe dy herë më tepër. Bleu një luadh me tërfil, një korije dhe ca selishta. Pastaj ndërtoi dy plevica për zahirenë e bagëtive dhe një tjetër për dhentë.

E rriti të birin, si mund të rritet një djalë pashai, me qumësht dallëndysheje. Dy babo i qëndronin natë e ditë mbi kokë. E lanin dhe e ndërronin si pëllumb të bardhë. Dhe bejçja rritej përditë e hazdisej si hazdiset pema në tokë të plehëruar. Pa t'u bë një ters i madh, sa dy gurë bashkë nuk linte.

Zunë t'ia kishin frikën si brenda në shtëpi, ashtu edhe jashtë. Fëmijët, kur e shikonin, iknin me të katra.

– Bobo, Tafili! Të vret me gurë.

Dhe sa kishte qejf të shtinte me gurë Tafili! S'ia penxhere në këmbë.

Një ditë po lozte në lëmin e shtëpisë me djalin e Zakes, Myrton. Ishin të dy vërsnikë. Në një ditë kishin lindur.

– Merrmë kalakiç dhe shpjermë në shtëpi, – i tha Tafili Myrtos.

– Unë s'jam gomar, – ia preu Myrtoja menjëherë.

– Po unë jam djali i Demir agait. Hajde ulu të të hip.

Myrtoja nuk u ul. E pa një herë me inat dhe u largua.

– Dale, ku vete?

Myrtoja nuk qëndroi e as që i ktheu përgjigje. «Të marrit bëji udhë», i kishte thënë i ati dhe ai ashtu bëri. Tafili u ul shpejt e shpejt, rrëmbeu një fiçor të madh e ia hoqi mu në kokë. Myrtoja u hodh përpjetë si kec i vogël, pastaj u shtri përdhe. Prapa veshit të djathtë i kërcëu një xhungë dhe filloi t'i dilte gjak. Tafili ua mbathi këmbëve dhe hyri në shtëpi.

Atë natë, kur tregonte ç'i kishte ndodhur me Myrton, Demir agait iu bë qejfi:

– Mirë ia paske bërë, qafirit!

Kështu u rrit Tafili. Asnjeri s'e shau asnjeri s'e ngau. Dhe, kur i vajti koka në tavan, t'u bë i egër, tamam si ata qentë e staneve.

Njëqind temena i bënin fshatarët, kur e takonin në udhë. Gratë dhe çupat i zinte data, kur e shikonin hipur në pelë.

Po këto vitet e fundit erdhën kohë shumë të këqija. Shqipëria u prish. Zunë djemtë të dilnin maleve e të luftonin. Pa morën malet edhe fshatarët, edhe burrat, edhe gratë. Edhe nga fshati i Tafil agait shkuan nja pesë a gjashtë veta. Latifi, Çeçoja, Zeneli edhe Myrtoja, i biri i pojakut. Të gjithë të këputurit.

– Si u bë kjo punë, xhanëm, – thoshte Tafil agai. – U çmendën të gjithë. Dale, pa u tregoj unë!

Dhe shkoi një ditë në Berat. U fjalos atje me ca këmishëzinj, mori ca pushkë e ca para dhe t'u kthye në fshat me nja pesëdhjetë ushtarë.

Këta ushtarët e Tafil agait nuk ishin sidokudo, por të veshur me rroba e me pallaska që të vrisnin sytë. Kishin në kokë nga një takije të bardhë; kishin edhe nga një shqiponjë të madhe, kush në gjoks e kush në majë të takijes.

– Të më shohin tashti! – tha Tafil agai dhe mori malet përpjetë për të ndjekur «të këputurit» që po e bënin vatanë shesh.

Shkoi mal më mal e fshat më fshat. Pa filloi të shkante edhe Gora e Opari. Edhe në Rrëzën e Korçës shkeli njëherë.

Po andej kishte qenë feja vetë. Këto pula të skuqura e këto petulla me mjalte i hëngri për një javë rresht: drekë e darkë e mëngjes. Pastaj mblodhi edhe ca florinj me pesë e ca vathë si inxhi. Zbërthente sëndyqet e nuseve, që kishin burrat partizanë, dhe ç'të gjente brenda ishin të tijat.

Dhe u bë kapedan mbi kapedanë.

Mirëpo dardha e paska bishtin prapa.

Atë mot ka bërë një dimër i madh. Qafa e Martës nuk kapërcehej. Në Çukën e Frëngut kishte rënë shumë borë. Thuhej se në Qafën e Beçit kishte mbetur një karvan çobanësh që vinte nga malet e Vithkuqit për të kaluar në Mallakastër.

Po partizanët sikur të kishin krahë. S'pyesnin as borë e as tufan. T'i vunë gjermanët përpara, pa t'i vunë edhe ballistët si lopët, edhe Tafil aganë me gjithë trimat e tij. Dhe këmba-këmbës në Lavdar, në Çemerice, në Qafë të Beçit gjer në Potom.

— Dale, Tafil aga, dale.

Dhe kapedani s'gjente vrimë ku të futej.

Një ditë e një natë e bëri rrugën nga Rrëza e Korçës gjer në Potom. As hëngri, as piu, as gjumë nuk vuri në sy. Iu bënë farmak bakllavatë me njëqind petë dhe pengjiret që kullonin. Nga hundët i dolën të gjitha. Pa erdhi e t'u plas në këto bregoret e fshatit të tij pa mend në kokë.

Në mëngjes, pa dalë dielli, i mblodhi ushtarët aty mbi fshat.

Po ushtarët e Tafil agait nuk ishin më të parët. As nam e as nishan s'u kishte mbetur nga rrobat e pallaskat që të vrisnin sytë. Takijet s'u zbardhnin më, as sytë s'u shkëlqenin, as shqiponjat e mëdha s'i kishin. Pastaj s'ishin as të tërë, as gjysma, as çereku. Vetëm tetë dhe Tafil nëntë.

— Si bëhet kjo punë xhanëm, ku janë të tjerët? — pyeti me inat.

Gëk s'bëri njeri. E ç't'i përgjigjeshin? Të tjerët kishin zënë ferrat dhe shtëpitë.

Tafil agai kësaj radhe e pa veten ngushtë. I ndau të tërë në llogore dhe vetë u ul përpara Tomorit, që zbardhte si çarçaf.

«Po halli, nga t'ia mbaj? Ku të fshihem?!»

Këto mendonte Tafil agai i Pepellashëve aty, në majë të bregut.

Drodhi edhe një cigare tjetër, e ndezi me eshkë dhe iu afrua një ballisti:

– Mbaruam! Na kanë rrethuar keq. Gjermanët s'po duken të vijnë!

– Mbaruam, o Tafil aga!

Dhe që të dy ia ngulën sytë Tomorit.

Vetëm ca pushkë u zbrazën aty në breg dhe ballistët ua mbathën këmbëve. Partizanët hynë në fshat. Nja pesë a gjashtë u rrasën në shtëpinë e Pepellashëve. Po, me të vënë këmbën te pragu i portës, u dëgjuan ca gra që këndonin dhe një dajre që u vinte nga pas.

*Hipurë mbi ca haïllarë
po vjen beu të të marrë,
nuse moj...*

Bëhej dasmë në shtëpinë e Pepellashëve. Po jo dasmë si qëmoti. As saze e as gosti nuk kishte. Po s'kishte as burra e as fëmijë, vetëm dhjetë gra dhe nusja njëmbëdhjetë, ishin në gjithë ato sarafe.

Një grua e shëndoshë u doli partizanëve te porta:

– Ç'kërkoni?

– Mos është këtu Tafil agai?

– Ai ka një mot që s'e ka parë shtëpinë.

– Do të hyjmë të shohim njëherë.

– Urdhëroni! – i ftoi gruaja duke folur me një zë herë të trashë e herë të hollë.

Partizanët hynë brenda. Me ta ishte edhe Myrtoja i Zakes. Prapa veshit të djathtë kishte akoma shenjën e fiçorit.

– Po kë martoni kështu, moj hanko Gjyzo? – i tha Myrtoja gruas së shëndoshë.

– Mbesën, mbesën, more Myrto. Nesër vijnë e e marrin.

Myrtoja hapi sytë dhe mblodhi buzët si për të sjellë ndër mend këtë mbesën e Pepellashëve. Po s'i kujtohej. Kishte apo s'kishte mbesë oxhaku i madh i Tafil agait?

Gruaja e vuri re. U tund një herë dhe i tha:

— Po urdhëroni të pini një raki! Të na uroni mbesën. E kemi veshur nuse.

Më parë partizanët i erdhën rreth e qark shtëpisë, panë nëpër odat, pastaj, hynë në dhomën e mysafirëve dhe pinë nga një raki.

Tafil aganë nuk e gjetën.

Gratë, matanë, këndonin e zienin si zhuzhakë:

*Nëpër bahçe me limoj
erdhi nëneja e më zgjoj...*

Dhe dajrja binte duke nxjerrë një zë të çjerrë.

— Çfarë drej dasme? — tha Myrtoja. — Pa burra e pa fëmijë, pa një çikë gosti, po vetëm me dhjetë gra të shastisura? Hane, shtëpia e Pepellashëve përmysej kur kishte lindje, e jo kur ka dasma. Pastaj, ç'është kjo dasmë në mes të luftës?

Gjyzoja u ndau nga dy copa sheqer të kuq, një për nusen e një për dhëndrin. Pastaj u nxori edhe nga një filxhan me sherbet. Dukej sikur i ishte bërë zemra mal që kishte partizanë në shtëpi. Myrtoja e shikonte shtrembër. Papo, njëherë, seç i tha një shoku në vesh e u ngrit më këmbë.

— Ku vete, Myrto? — i foli gruaja e trembur.

— Të shoh nusen.

— Uu! Si ta shohësh nusen?! Është turp. Burrat s'hyjnë në odën e grave!

— Epo unë do ta shoh një herë, moj Gjyzo.

— Është turp, ago Myrto — dhe Gjyzoja i doli përpara dhe ia vuri duart në gjoks.

— S'jam ago unë. Mos më thuaj ago, — i shfryu ai. Ç'të bënte? Ndezi një cigare dhe doli jashtë duke përplasur derën. Pas pak u kthye përsëri me dy partizanë.

— Po këto a mund të hyjnë? — i tha gruas që i kishte rënë një çehre e verdhë si limoni.

– Epo, si të them – ia pati Gjyza dhe iu zu fryma në fyt.

– Po këto femra janë, si hanë ato tuajat del

Dy partizanet hynë në dhomën e nuses. Gratë u ngritën në këmbë e u bënë vend. Edhe nusja u ngrit e u puthi dorën. Pastaj i përshëndoshën me gjysmë zemre. Kjo nuse rrinte e nusëronte në këmbë, aty në cep të odës. E kishin veshur me të bardha. Një duvak i trashë kat e kat ia mbulonte fytyrën. Në kokë kishte një sërë me inxhi e me rruaza që vetëtinin. Edhe në qafë i varej një pandatif me një flori të madh. Duart i kishte të mbuluara me një palë dorashka të bardha e të gjata gjer në bërrylat. Pranë, nga e djathta, i rrinte një grua plakë me ca buzë të varura. Nga e majta, evgjitka me dajre, që i lëvizte duart me përtim.

– Bjeri, moj, t'u thafshin duart! – i thirri Gjyzoja.

Dajrja krisi e petët e holla prej teneqeje rreth saj u drodhën. Gjyzoja ia mori këngës:

*Ngrehu, çupë, të të martoj,
me një djalë të të gëzoj...*

Gratë filluan të pëshpërisnin vesh më vesh. Herë shikonin njëra-tjetrën e herë mysafiret. Pastaj, ca nga ca, filloi t'u binte një çehre e gjelbër dhe t'u zgurdulloheshin sytë, sikur të kishin përpara ndonjë të vdekur. As që dëgjonin ç'këngë kishte marrë hanko Gjyzoja, kjo motra e madhe e Tafil agait, po mblidhnin supet dhe kafshonin buzët. Edhe nusja kishte ngrirë në vend.

E ngrinte zërin përpjetë Gjyzoja, sa dridhej oda dhe evgjitka i sëllonte dajres me pëllëmbë. Po gratë as zienin e as shkretëtonin. Kur Gjyzoja mbaroi këngën, vetëm njëra qeshi nën buzë, të tjerat s'bënin gëk. S'i thanë as «Si goja zemra», as «T'u trashëgoftë!»

Partizanet ndenjën gjysmë ore. Pastaj u ngritën.

– Do të dilni, moj bija? – i pyeti plaka që rrinte më të djathtë të nuses.

- Do të dalim, - iu përgjigjën të dyja me një gojë.
- Falemnderit! Jua paçim borxh edhe më kokën tuaj.
- Po do të shohim një çikë nusen.
- Nusen! - thirrën gratë si të llahtarisura.
- E, nusen, - ua preu njëra nga partizanet.

Grave u ra pika. Dy prej tyre dolën jashtë si të marra. Një tjetër mbuloi sytë e u kthye nga muri. Të tjerët çakëritën sytë e hapën gojën përgjysmë. Gjyzoja thirri:

- Boboo!

Dajrja pushoi.

Partizania iu afrua nuses. E pa një herë që nga koka gjer në fund të këmbëve. Pastaj kapi duvakun.

Dy grave të tjera u ra të fikët. Gjyzoja u lebetit dhe u plas përdhe.

Partizania hoqi duvakun dhe nusja u zbulua.

Një palë mustaqe të dendura nxinë në fytyrën e asaj nuseje veshur në të bardha. Pastaj dy buzë të bymbyera, një hundë krëckë dhe dy sy të buhavitur me kokërdhokë të kërcyer.

Tafil agai i Pepellashëve, që s'gjente vrimë ku të futej, ishte veshur nuse.

Nga vëllimi
«ZEMËR
SHQIPTARE»

1954

1950

1951

1952

ZEMËR SHQIPTARE

Ishte vjeshtë, vjeshtë e verdhë, me shi e me baltë. Im shoq, Kasëmi, kishte shkuar në Opar e që andej ishte hedhur në Mokër për të përcjellë ca kafshë me armë për partizanët. Kur u nis, më tha se do të kthehej të shtunën, por iku edhe e diela e s'u duk në shtëpi. U bëra merak, se ishte luftë e dyfeku kërciste kudo.

«Si u bë kjo punë? S'u kthye që s'u kthye», – pyesja veten me dorë në zemër.

Por një fshatar, që kishte qenë në Mokër dhe e kishte takuar Kasëmin, erdhi aty ndajnatëherë e më thirri që nga pragu i derës:

– Moj grua! Mirë e ke atë, moj, mirë. Do të vijë pasnesër. Mos u bëj merak.

Kur dola në oborr për t'u fjalosur më shtruar, se m'u duk sikur më gënjeu, fshatari kishte ikur. Po, gënjeu apo s'gënjeu, mua sikur m'u lehtësua zemra.

Në oborr im bir (e kisha të vogël dhjetëvjeç) kishte hyrë në një pellg me ujë e lahej si rosat. Ishte bërë qull fund e krye.

– Do të ftohesh, mor bir, – i thashë. – Hajde brenda.

Po më dëgjoji? Krisi e doli jashtë. E ndoqa dhe mezi e arrita te gardhi. E futa brenda me zor dhe e ndërrova.

– Ti, Petrit, nuk bën mirë kështu, – e këshilloja duke e ndërruar. – Pa shiko si je bërë, qull. Do të ftohesh. Kur bie shi, njerëzit rrinë brenda.

– Po partizanët, – m'u përgjigj – pse nuk ftohen? Edhe ata jashtë rrinë. Nuk janë njerëz ata?

– Njerëz janë, por janë të rritur.

– Pse, unë i vogël jam?

– Edhe ti i madh je. Të ka nëna burrë. Po, kur bie shi, më mirë është të rrish brenda.

Atë natë erdhi në fshat një batalion. Mua më sollën tre partizanë. U ndeza një zjarr që të thaheshin, se ishin bërë qull e u dhashë të hanin ç'm'u ndodh në shtëpi. Isha mësuar me ta dhe i doja si Petritin tim. Vinin tek unë nga Mokra, nga Opari, nga Devolli për të marrë një hop frymë e për të pirë ndonjë lagjin me dhallë a me ujë. Dy vjet të kaluar, kur i pashë për të parën herë, m'u dukën fare të vegjël dhe u habita me tim shoq që merrej me ta. Një ditë i thashë:

– Ç'të duhet ty të ngatërrohesh me këta fëmijë!

Po ai ma preu shkurt:

– Mbylle gojën ti, grua. Ata kanë dalë maleve që të na çlirojnë.

Dhe vërtet, ç'ta mësoja unë Kasëmin? Ai ishte i mençur vetë. Dhe kishte pasur të drejtë. Pas një jave u bë një luftë këtu në fshat. Vetë, me këta sy, i pashë italianët si u thyen. Që prej asaj dite partizanët më janë dukur burra të pjekur që s'u trembet syri kurrë dhe më janë futur në zemër si Petriti im.

Të tre partizanët që më erdhën atë natë, kishin qenë të muhabetit, por sidomos njëri, një Sotir nga Mokra, një djalë nja njëzetvjeç, me ca sy si të shqiponjës. Ai kishte një mot e ca që bridhte maleve. Kishte luftuar në Voskopojë, në Pojskë e në Leskovik, në Gramsh e në Përmet. Kishte një zë si bilbil. Ku e kishin gjetur njëri-tjetrin? Kaq mirë i ujdin zërat e kaq mirë i kurdisnin fjalët, sa unë u mahnita! Sotiri ia merre, të tjerët ia mbanin. Petriti im ziente.

Ranë të flinin të veshur, siç ishin. Petriri im nuk donte të flinte atë natë me mua. U bë shok i ngushtë me Sotirin. Pashë, ç'pashë e i vura të dy në një dyshek. Sa ranë, gjumi ua mbylli sytë menjëherë.

Unë mbulova zjarrin me hi, shova kandilin e rashë. Po gjumi nuk më mori menjëherë. Që kur kishte filluar lufta, e kisha humbur gjumin. Kasëmi më shante gjithnjë:

– Po fli, moj grua, – më thosh, – se gjermani s'ka atë nge që të vijë natën këtej. Edhe atij i dhemb koka.

Unë s'kisha frikë nga gjermani. Po kisha merak për djemtë e për vatanin që po përvëlohej. Prandaj edhe gjumin e bëja me hope.

Mirë thonë: «Ç'sjell mëngjesi, nuk sjell nata.» Për atë të zezë të atij mëngjesil U zgjova nga të trokiturat e forta në derë. M'u duk sikur shtinte njeri me top te pragu i shtëpisë. Dola në oborr pa u veshur e pyeta:

– Kush është?

Dëgjova hapat e njerëzve që rendnin para shtëpisë. Dikush trokiti përsëri në derë me kondak e thirri:

– Shpejt, Sotir, shpejt, gjermanët!

U derdha e mezi hapa derën. Po ai që trokiti s'ishte më. Sa u mata të hyja brenda, një batare pushkësh plasi mu në mes të fshatit. Pas pak m'u duk sikur po bëhej luftë jo vetëm poshtë, te mulliri, por edhe lart, mbi fshat, tek Uji i Ftohtë. Mos kanë dalë gjermanët edhe sipër? Mos kanë rrethuar fshatin?! Dhe vërtet ashtu kishte ngjarë. Më vonë mora vesh se katërqind gjermanë e ballistë e kishin rrethuar fshatin si në një çark. Komandanti i partizanëve kishte dhënë urdhër që shtegu të çahej lart tek Uji i Ftohtë, gjallë a vdekur, po duhej çarë. Ishte punë e zorshme, po tjetër rrugë s'kishte. Një pjesë të partizanëve e kishte dërguar te mulliri dhe i kishte urdhëruar që të qëndronin gjersa të çahej rrethimi e pastaj të tërhiqeshin duke luftuar.

Sotiri doli i pari në rrugë. Pas tij dolën edhe dy shokët e tjerë. U çudita se si ishin bërë gati aq shpejt. Ata s'patën kohë as të më përshëndesnin. Vetëm Sotiri, pasi u dha urdhër shokëve që të ngjiteshin sipër, më tha:

– Shko brenda, nënë! Mos u bëj merak, se shtegun do ta çajmë – dhe vetë zbriti tatëpjetë, te mulliri, ku bëhej luftë.

Dy plumba fishkëlyen mbi kokën time dhe u përplasën në murin e shtëpisë. Rrëmbeva tim bir në krahë e hyra brenda. Derën e lashë hapur, se s'pata kohë t'i vija llozin. Nga dritarja e vogël shikoja Sotirin që luf-tonte prapa një çakëlli. Zemra më rrihte. Nuk dija ç'të bëja. Të kisha dyfek, do të shtija edhe unë. Po dyfekun e kishte marrë me vete Kasëmi.

Kaloi një orë a dy, ndoshta edhe tri, nuk e mbaj mend, dhe partizanët e çanë shtegun tek Uji i Ftohtë. Vetëm Sotiri mbeti afër mullirit, në mes të zjarrit. Gjer në një kohë ai përdori dyfekun, pastaj e la atë mënjanë, dhe duke u tërhequr zvarrë, luftoi me nagant. Njëherë u ngrit më këmbë dhe hodhi dy bomba, që plasën pas pak me zhurmë të madhe. E pashë kur kapërceu një gardh dhe u ndodh para shtëpisë sime. I thirra nga dritarja që të kishte mendjen. Po ai, siç duket, nuk më dëgjoi. Ç'më panë sytë aty? Një alamet gjermani, i gjatë si hosten, i doli përpara papritur dhe i shtiri me automatik. Sotiri u mblodh shuk e ra përdhe. Duke rënë, ai zbrazti katër herë nagantin dhe gjermani u rrokullis në hendek. Dola shpejt në oborr dhe e gjeta Sotirin te pragu i derës, mbytur në gjak. Ishte plagosur në këmbë e në shpatull. E futa brenda dhe i vura llozin derës. Po tani?! Gjermanët me siguri e kanë parë që hyri këtu. Me një copë çarçafi i lidha shpejt plagët.

– A ke fishekë, nënë? – më pyeti.

E ku i gjeta unë fishekët. Të kisha, do t'i kisha zbrazur vetë.

– Po bombë?

– Jo, as bombë.

Ai hapi nagantin dhe unë pashë në të vetëm një fishek. E vështrova Sotirin në sy dhe e kuptova ç'kishte ndër mend të bënte.

– Sidoqoftë, të gjallë nuk do të më zënë, – tha duke u munduar të ngrihej.

U mundova t'ia merrja nagantin, por ai nuk më la.

Në rrugë dëgjova këmbë njerëzish dhe fjalë që unë nuk i kuptova. Gjermanët kalonin para shtëpisë.

– Nënë, – më tha Sotiri, – shko brenda. Ata zemrën nuk do të ma marrin dot! – dhe u ngrit në këmbë duke u mbështetur pas murit me gishtin në këmbëzën e nantangit.

Nuk i fola më. E rrëmbeva në krahë dhe e fsheha në një qoshe të plevicës duke e mbuluar me kashtë. Kur dola në oborr, pashë tim bir që përgjonte prapa derës.

– Këtu janë, – më tha ai me gjysmë zëri e m'u derdh në prehër.

– S'ka gjë, xhan! S'ka gjë, Petrit i nënës! – i thashë duke i përkëdhelur flokët. – Ty të ka nëna trim! Ti vetëm mos u trego atyre asnjë fjalë...

Nuk mbaj mend ç'i thashë më, vetëm e lëshova nga duart dhe e ndjeva si m'u ngjesh pas këmbëve duke më shtrënguar fort.

Gjermanët e shkallmuan derën, se unë llozin s'e hoqa që s'e hoqa. Ca shtinë me dyfek nëpër penxhere, ca e bënë derën shoshë me automatik. Për të parën herë shikoja gjermanë me sy. Oh! Të kisha një bombë e t'i hidhja në erë!

Fjaloseshin me zë të lartë, por unë nuk i kuptoja. Vetëm njëri prej tyre më foli shqip. Ishte një ballist, që mos iu dëgjoftë nami kurrë.

E bënë shtëpinë rrëmujë, por nuk gjetën gjë. Kërkuan nëpër oborr e nëpër bahçe, po nuk gjetën gjë. Një gjerman, me një kaskë të madhe në kokë, zbuloi pusin dhe shikoi në të. Asgjë nuk dukej në atë errësirë. Ai pështyu në pus dhe shtiri me automatik. Një tjetër hyri në plevicë. E pashë me bishtin e syrit kur qëndroi te pragu i derës me këmbët të hapura. Më rrahu zemra, më rrahu si e marrë, sikur donte të shpërthente jashtë kraharorit. Prisja të dëgjoja krismën e thatë të nantangit. U mata të bëja një hop, po ndjeva se këmbët e mia i shtrëngonte fort Petriti im. Një krismë automatiku u dëgjua në plevicë. Klithma më mbeti në grykë. Mbulova fytyrën me duar dhe nëpërmjet gishtërinjve pashë gjer-

manin që doli nga plevica duke mbledhur supet. Nuk e kishte gjetur Sotirin.

Më rrethuan në mes. Njëri më mbështeti dyfekun në gjoks dhe unë ndjeva nxehtësinë e armës. Ballisti më pyeti me zë të lartë:

— Fol, ku e fshehe?

Nuk mbaj mend si u përgjigja, vetëm më kujtohet se dikush më goditi në kokë. Im bir m'u hodh në qafë për të më mbrojtur. Ata ma shkëputën nga krahët dhe e mbështetën pas murit. Unë kujtova se po ma pushkatonin. U derdha mbi të dhe e mbulova me trupin tim. Atëherë zbrërtheva gjoksin e u thirra:

— Bjermëni mua!

Dikush u bë gati të shtinte. Po një tjetër e ndaloi dhe bëri një shenjë me dorë.

U derdhën përsëri mbi mua e ma rrëmbyen djalin nga duart, e shtynë dhe e nxorën jashtë. Nuk kuptova ç'po ngjiste. Vetëm ndjeva sikur dikush më shkuli zemrën nga kraharoni e ma shkeli me çizme. Ngriva në vend, e mbështetur pas murit. Mezi dëgjova fjalët e tim biri që thërriste në rrugë:

— Në-nëë!...

M'u morën mendtë dhe për pak rashë, po e mbajta veten. U turra jashtë dhe iu derdha në grykë gjermanit që deshi të më ndalonte dhe e rrëzova përdhe. Ku u gjend tek unë ajo forcë, nuk e di.

— Ku ma shpini fëmijën, ku?

Dikush më goditi në shpatulla dhe më rrëzoi. Ndjeva faqen që m'u lag në një gropë me ujë.

— Trego!

M'u kujtua Sotiri. Ai ishte në plevicë, gjallë a vdekur, nuk e di, se i shtinë me automatik. Po ishte në plevicë. Ja këtur afër, fare afër. Gjermanët atë kërkonin. Mjaf-tonte një fjalë, vetëm një fjalë, dhe im bir do të kthehej përsëri në shtëpi e unë do ta puthja e do ta përkëdhelja si më parë e do t'i thosha: «Të ka nëna trim, të ka nëna burrë të rritur!»

Por jo! Ajo s'kishte për të ndodhur kurrë!

Gjermanët u larguan, por unë akoma e kësaj dite
dëgjoj zërin e tim biri që më thërret:

– Në-nëë!

Sotirin e gjeta të gjallë, po të tretur, se kishte humbur
shumë gjak. Ai shtriu duart me mundim e më përqafoi
e unë ndjeva sikur ato duar ishin duart e tim biri.

1953

KATANAJA ME YLL TË KUQ

Kjo ngjarje ka ndodhur në një qytet të Shqipërisë në vitin 1942, atëherë kur atdheu ynë ishte robëruar nga fashistët.

– Kështu, shokë, – u tha më në fund Petroja katër fëmijëve që banonin afër shtëpisë së tij. – Nesër Një Majin duhet edhe ju ta festoni. Përgjegjës për këtë punë keni Agimin. Vdekje fashizmit!

– Liri popullit! – u përgjigjën të katër fëmijët duke nderuar me grusht.

Petroja u shtrëngoi fort dorën e u largua me hap të shpejtë.

Fëmijët këmben nja dy fjalë në rrugë, pastaj hynë në shtëpinë e Agimit dhe filluan nga puna.

Do ta festonin Një Majin me aksion kundër fashistëve, me një aksion shumë të rëndësishëm, që donte mend e zgjuarsi. Dhe për këtë punë, Petroja, që e donin shumë fëmijët e mëhallës, kishte caktuar përgjegjës Agimin. Dhe shumë mirë kishte bërë se si Agimi nuk mund ta kryente asnjëri.

Agimi ishte djali i vetëm i xha Rapolit, që punonte në një fabrikë të vogël të qytetit. E ëma robëtohej në punë

duke larë këmishët e afendikonjve¹⁾. Mezi jetonin e me shumë halle e dërgonin Agimin në shkollë. Ai ishte në klasën e pestë dhe nuk ishte nxënës i keq, por edhe shumë i mirë nuk ishte. Kishte në shkollë edhe më të mirë se ai. Sa për punë dore, nuk kishte nxënës që t'ia kalonte. Katanatë e tij (ose si i thonë tiranasit, balonat tabake) ishin aq të mira, sa ngriheshin në qiell si aeroplanë, e nuk bënin tumba, e nuk bënin bark! Pale oastaj për varkat, aeroplanët e kapelat prej karte, aq të bukura i bënte, sa ia kishin zili të gjithë! Agimi kishte sy të mprehtë e duar të shpejta. Me një të parë, fët e fët, merrte një copë karton e bënte prej tij fenerë, karrae, shtpi me dy e me tre kate, shpata, breza, e lloj-lloj shpezësh. Nxënësit i rrinin mbi kokë e, duke parë gëreshërët e vogla që lëviznin aq shpejt në duart e tij, thoshin:

— Si Agimi s'ka tjetër në botë! — dhe të gjithë mudoheshin ta bënin shok të ngushtë.

Një ditë, për një orë i bëri të aihtë shokët e klasës me kapela të bukura prej kartoni. U preu edhe naa një shpatë të madhe prej dërrase e ua vari në brez. Pastaj zbukuroi me shirita letre një teneae të vjetër e ia vari në qafë Cenit, atij kokëqethurit që rrinte në bankën e parë.

— Kjo është daulle, — i tha. — T'i biesh sa të të dojë qejfi!

Për vete bëri një kapelë me yie e me pendë, të bukur, shumë më të bukur se të shokëve dhe një shpatë të madhe, dy herë më të madhe se të shokëve. Si ngjeshi brezin prej letre, i radhiti shokët njërin prapa tjetrit e dha urdhër:

— Paraa... marsh!

Nga përplasjet e këmbëve u ngrit një re pluhuri. Ecnin me fytyra të vrenjtura e me hap të rregullt. Ceni daullexhiu, që ishte në krye të rreshtit, i binte sa mundte me një kopaçe teneqesë, që i varej në qafë:

1) afendiko — pasanik

– Bum-bububu! Bum-bububu! Bum!

E Agimi me kapelën e zbukuruar mbi sy, thërriste pa pushim duke tundur shpatën:

– Një-dy! Një-dy! Ko-kën lart! Gjok-sin para! Një-dy!

E atyre që takonte në rrugë u thosh:

– Largohuni! A nuk shikoni se po kalon ushtria?

E ushtarët e tij mendonin me vete: «Ama, oficer kemi!»

Por, siç thamë më parë, më bukur se çdo gjë Agimi bënte katanatë. I zbukuronte me bishta e me xhufka lloj-lloj ngjyrash. I bënte të vogla, të mëdha, fare të vogla, shumë të mëdha, si t'i donte qejfi. E kudo që të ishin shokët e shkollës, kur shikonin në qiell katananë e tij, thoshin: «Kjo është katanaja e Agimit». Dhe secili dëshironte të kishte një katana të tillë.

Shokët e tij për një katana të tillë nuk kursenin as ashikët, as detkat, as xhamat shumëngjyrësh e as kopsat e xhaketave, të palltove e të pantallonave, veç të kishin një katana si ajo.

Thamë se fëmijët, pasi u largua Petroja, këmbyen nja dy fjalë në rrugë, hynë në shtëpinë e Agimit e filluan nga puna.

Çfarë pune filluan? Kini durim, do t'jua tregoj.

Në mbledhjen, që kishin pasur pak përpara me Petron, Agimi kishte thënë:

– Kështu, shokë, ta bëjmë e t'i vëmë një yll të madh e të kuq si zjarri.

– Të lumtë, Agim! – i kishte thënë Petroja. – Shumë mirë të ra ndër mend. Fashistët do të tërbohen kur ta shohin. Fillona, pra!

E kur iku Petroja, ata filluan.

Së bashku bënë një katana të madhe sa mezi ua mori dera kur e nxorën jashtë, një katana me yll pesë-cepësh, në mes, të kuq si zjarri.

E bënë shtëpinë rrëmujë. Njërën nga shokët Agimi e dërgoi aty afër shtëpisë të zgjidhte shavarë nga ata që mbulonin kashtoret. Një tjetër e dërgoi të blinte spango, se ajo që kishte nuk i dilte. Të tretin, Genin, e vuri

të trazonte miellin e ujin që i kishte dhënë e ëma në një pjatë. Vetë, gjersa u kthyen shokët, preu kollët e përgatiti yllin.

S'kishte bërë Agimi në jetë të tij katana më të bukur se atë të Një Majit të vitit 1942. Ai përdori gjithë mjeshtërinë e tij. I preu letrat me kujdes të madh, i lidhi shavarët fort e mirë, i ngjiti kollët me brumë aq bukur, sa dukej sikur kishin dalë nga fabrika. Pastaj ngjiti yllin e kuq me pesë cepa. Më letrat që i mbetën bëri një bisht e ca xhufka me tetë ngjyra. Më në fund rregulloi gojëzën dhe e lidhi në turrën e madhe të spangos.

Në drekë, kur u kthye nga puna i ati dhe pa katananë, u mahnit.

– E xha Rapi? – e pyeti Ceni. – A të pëlqen?

– Më ju lumtë, djema! – u përgjigj ai i kënaqur. – Lëshojeni tashti e le të tmerrohen fashistët!

Kur do ta nxirrnin në rrugë, erdhi Petroja. Edhe ai u mahnit.

– Më ju lumtë, djema! – i uroi. – Lëshojeni!

Dhe e lëshuan.

– Ju e dini se fashistët nuk e donin yllin e kuq. Dhe jo vetëm që nuk e donin, po ia kishin edhe frikën, se ylli i kuq ishte shenja e punëtorëve, e bashkimit të tyre, e forcës dhe e trimërisë së tyre. Prandaj atë ditë të Një Majit, kur panë në qiell një katana me yll që flakërinte, u tërbuan e u lëshuan si qen për të gjetur fajtorin.

Po nuk ishte kollaj ta gjenin Agimin. Ai qe fshehur bashkë me të tre shokët në ca mullarë me kashtë aty afër qytetit. E mbajti katananë në dorë gjersa ia lëshoi gjithë spangon, pastaj u ngjit si mace në një shtyllë dhe në majë të saj lidhi fort fillin e katanasë.

Frynte një erë pranvere, e cila, duke lëkundur lehtë bishtin e xhufkat tetëngjyreshe të katanasë, e çoi atë mbi qytet.

Njerëzit, që kalonin rrugëve, qëndronin dhe shikonin qiellin të zbukuruar me yll të kuq, me yllin e lirisë, me yllin e partizanëve.

– Më ju lumtë! – uronin. – E sytë u mbetën në qiell.

Fashistët, të tërbuar e të frikësuar, kërkonin ngado dhe vetëm në mbrëmje e gjetën vendin ku qe lidhur katanaja.

Ata e dogjën katananë, po Agimin dhe shokët e tij nuk i gjetën.

Pas dy vjetësh Agimi doli partizan, luftoi gjersa u çlirua Shqipëria e sot është oficer i ushtrisë popullore.

Po akoma edhe sot katananë me yll të kuq nuk e ka harruar.

...E, djema, a ju pëlqeu ngjarja? Tani, natën e mirë e gjumin e ëmbël!

Z J A R R I

– Ilir! Ilir more! – thërriste gjysh i Rrapo, që rrinte me cigare në gojë në hijen e një mani. – More Ilir!

– Urdhëro! – u përgjigj më në fund një djalë i vogël me ca sy të shndritshëm si xixa, që lexonte një libër duke ndenjtur mbi qerre.

– Më sill një zjarr të ndez cigaren.

– Ama edhe ti gjysh nuk më ke lënë hiç rehat sot! – i tha djali duke kërcyer nga qerrja përdhe e duke e vënë librin nën sjetull. – Unë mësoj e ti më dërgon një herë për ujë, një herë për duhan, një herë për zjarr. Po kështu nuk mësohet de, se i thonë aritmetikë kësaj.

– Hajde, se je i vogël ti! Edhe mëson, edhe punën e bën. Shko më sill një zjarr! – e urdhëroi gjysh i Rrapo.

– Kollaj të duket ty. Po e di ç'domethënë aritmetikë?

– E di, e di! Aritmetikë do të thotë sa bëjnë dy e dy, sa bëjnë katër e katër, sa bëjnë tetë e tetë. Po shko e më sill një zjarr!

– Po sa bëjnë tetë e tetë o gjysh? – e pyeti Iliri duke e vështruar plakun drejt në sy.

– Gjashtëmbëdhjetë! – u përgjigj plaku ngadalë, duke u ngritur e duke rregulluar rrotën e qerres.

– E ditka! – tha djali duke qeshur. – Sa shumë di ti, gjysh. Të gjitha gjërat i di, – tha lliri e shkoi duke rendur për të marrë zjarr në shtëpi.

lliri e donte shumë gjyshin Rapo, plakun me flokë të bardhë e me mustaqe të gjata gjer te veshi. Dy muajt e beharit, kur shkolla e fshatit rrinte mbyllur, tërë ditën e kalonte me të. Gjyshi e hipte në vithe të kalit dhe e merrte në mal për të prerë dru ose në fushë për të prashitur panxharin, për të korrur bereqetin apo për të korrur bar. Nganjëherë e shpinte edhe në Maliq, te daja i tij, që punonte në fabrikën e sheqerit. Rugës gjyshi i tregonte përralla të bukura e të çuditshme. I tregonte se si, qëmoti, një djalë trim kishte vlarë gjarprin me njëajnd kokë, që kishte zënë gjithë burimet e fshatit e s'linte njeri të pinte ujë; se si mizat e dheut ishin bashkuar e kishin mbytur një ari të madh, se si dy partizanë kishin vënë përpara një kope me ballistë. Sa gjëra të çuditshme dinte gjyshi Rrapo! Sa i mençëm ishte ai! lliri, kudo që të ishte, e pyeste për çdo gjë:

– Po kjo, o gjysh, nga ka ardhur? Po këtë, o gjysh, kush e ka dërruar? Po kësaj, o gjysh, si i thonë? Po kjo ç'është, o gjysh?

Plaku përgjigjej aty për aty, pa u mërzhitur e lliri krenohesh që kishte një gjysh të tillë, një gjysh që di çdo gjë në botë.

Po këto kohët e fundit, që kur kishte hvrë në klasën e katërt të shkollës, pyetjet i kishte rralluar, bile ca herë edhe i kishte kundërshtuar plakat, duke i thënë:

– Ti, o gjysh, s'ma the drejt këtë. Mësuesi na e ka shpieguar ndryshe.

Plaku, në këto raste, zemërohej dhe i përgjigjej me inat:

– Atëherë mos më pyet mua, kur ta ka thënë mësuesi...

Sa i vuri gjyshi qerres rrotën e re, lliri u kthye duke i fryrë thëngjillit që mbante me mashë.

– Sa shpejt ia vure rrotën? – e pyeti lliri i habitur.

– Qerrja u rregullua, – tha plaku e ndezi cigaren.
– Nesër e ngarkojmë me panxhar dhe e shpiem në Maliq.

Iliri hodhi thëngjillin në vijën e ujit dhe, kur thëngjilli u shua me një zhurmë të vogël, pyeti:

– Po zjarrin, o gjysh, kush e ka dërguar?

– Plaku thithi cigaren, fërkoj mustaqet me pëllëmbë dhe, pasi u mendua pak, u përgjigj:

– Zoti e ka dërguar!

– Zoti! – u çudit Iliri. – Zjarri ka ardhur nga rrufeja ose...

– Edhe rrufenë zoti e ka dërguar, – ia preu fjalën gjyshi duke u kollitur.

– Zoti? – vazhdoi Iliri. – Zjarri ka ardhur nga fërkimi i dy drurëve, gjysh...

Atij iu kujtua mësimi që u kishte shpjeguar mësuesi në mëngjes. Ai u kishte thënë se në kohët e moçme njerëzit ishin të paditur, por nevoja, ashtu si gjithnjë, i kishte bërë të shpiknin edhe zjarrin. «Ja, ti fërkojmë këta dy drurë» u kishte thënë mësuesi dhe i kishte fërkuar një copë herë.

«Drutë u nxenë. Ejani t'i provoni». Iliri vetë kishte shkuar e i kishte prekur me dorë. Me të vërtetë pas fërkimit drutë ishin të ngrohta. Po të vazhdonin t'i fërkonin me orë të tëra, ato do të ndizeshin. Kështu kanë bërë edhe qëmoti, kur kishin nevojë për zjarr.

«Pse? Nuk e ka dërguar zoti zjarrin?»

«Jo!» i qe përgjigjur mësuesi duke qeshur e kishte vazhduar shpjegimin një orë të tërë, gjersa nxënësit ishin bindur në fjalën e tij të drejtë e të vërtetë.

«Po ja, tashti gjyshi i thotë të kundërtën.

– E ke gabim, o gjysh. Zjarrin s'e ka dërguar zoti.

– Po kush e ka dërguar? – pyeti plaku me inat.

– Njerëzit vetë e kanë shpikur nga nevoja, – u përgjigj i bindur Iliri.

– Fjalë boshe! – i tha plaku duke thithur cigaren.

– Po kështu është, o gjysh.

– Kush ta tha? – pyeti plaku përsëri me inat.

– Mësuesi!

– Të kam thënë, mos më pyet mua kur ta ka shpjeguar më parë mësuesi. Po zjarrin e ka dërguar zoti, – nguli këmbë gjyshi Rrapo i zemëruar dhe, duke hyrë në anur për t'u sntënë bar qeve, foli me vete: «E mirë është shkolla, po u mëson fëmijëve edhe gjëra të paqena.»

«Nuk ka të drejtë gjyshi! Nuk ka të drejtë gjyshi!» – përsëriti me vete lliri duke hapur librin e aritmetikës.

Të nesërmen gjyshi Rrapo u ngrit herët. Kur u ngrit lliri, kishte bërë gati çdo gjë.

– Ty do të të pres unë? – i tha llirit duke qeshur. – Gjumash!

– Epo sot e diel është, o gjysh. Shkollë s'kemi. Mund të flemë pak më shumë.

– Hip! – i tha plaku duke mbrehur qetë.

Me një të kërcyer, lliri u gjend në majë të qerres.

– Mbahu, se mos biesh! – e këshilloi gjyshi nipin, që rrinte i gëzuar mbi panxharin duke u mbajtur pas bigave.

Qetë u nisën dhe qerrja lëvizi nga vendi duke kërcitur: Kiliviu! Kiliviu!

Një tufë thëllënzash fushe fluturoi mbi kokën e llirit. Ai shtriu duart që t'i kapte, po ato ikën shpejt në drejtim të lumit.

Tërë rrugës rrota e re e qerres, të cilën gjyshi nuk e kishte lyer me katran, se s'kishte gjetur, megjithëse kishte kërkuar në fshat, ua çau veshët të dyle duke bërë: Kili-viu! Kiliviu!

Në fabrikën e Maliqit arritën me kohë. Sa shumë panxhar kishin sjellë fshatarët! llirit iu dukën si bregore panxharët të hedhur kukumale, njëri mbi tjetrin, aty afër fabrikës që nxirrte tym të zi nga oxhaku i madh.

Qëndruan vetëm dy orë në Maliq: sa shkarkuan qerren, sa këmbyen ca fjalë me dajën, sa blenë disa sende në dyqan. Gjyshi edhe kësaj radhe nuk e harroi llirin. I bleu atij dy pasta e një gurabie. Hipi në qerre e i vuri qetë përpara. Ajs! Ajs!

Megjithëse vjeshtë, dita ishte shumë e bukur. Një diell i ngrohtë të kënaqte. Turtujt, tufa-tufa, fluturonin të

gëzuar pemë më pemë. Ca re të holla si perde mëndafshi pasqyroheshin në ujërat e kanalit të madh të Devollit. Një lejlek këmbëgjatë gjuante bretkosa atje përtej.

Pastat e gurabia qenë të mira e të ëmbla. Iliri i hëngri me qejf e u shtri mbi barin që kishte marrë gjyshi si tagji për qetë. Plaku i hodhi krahëve setrën e tij dhe Ilirin e zuri gjumi. Vetëm herë pas here ai dëgjonte nëpër gjumë zhurmën e mërzitshme të rrotës:

– Kiliviu! Kiliviu! Kiliviu!

Sa kishte fjetur e sa kishin ecur, ai s'e dinte. U zgjua vetëm nga një tronditje e madhe. Ia nxori gjumin qerrja që kishte hyrë në një gropë e duke dalë kishte kërcitur fort e ishte hedhur përpjete si ndonjë top.

– Fjete? – e pyeti gjyshi. – Ja, arritëm në shtëpi.

– Pashë ëndërr sikur po haja mollë, – i tha Iliri duke fërkuar sytë.

– Gëzim do të dalë.

Gjyshi i bëri vend afër tij.

– Nesër kemi aritmetikë. Unë e kam një dhjetë, por do ta marr edhe një tjetër, – filloi të tregonte Iliri. Po e preu fjalën menjëherë dhe pyeti i habitur:

– O gjysh! Nga del ky tym?

Plaku u ngrit e shkundi bollkat e setrën:

– Me të vërtetë tym! – tha duke parë përreth.

– Gjysh! Gjysh! Mbaje qerren! Tymi del nga rrota! Ja ku po digjet edhe bari! – tha i frikësuar Iliri.

– Ohaa! Ohaa! – ia bëri gjyshi.

Qetë u ndalën. Të dy kërcyen përdhe. Me të vërtetë po digjej rrota.

– Zjarr, gjysh, zjarr! Shpejt, ujë!

Plaku lagu shaminë në një pellg dhe e shtrydhi mbi rrotë te boshti. Zjarri u shua. Tym nuk dilte më. Barin që ishte në qerre e hodhën.

– E pe? – i tha Iliri kur hipën në qerre. – U fërkua rrota me boshtin dhe mori zjarr!

– Pusho! – ia preu gjyshi.

– Dhe tamam rrota e re, që s'e leve me katran.

– Pusho! – përsëriti gjyshi.

– U fërkuan dhe u ndezën. Mësuesi kishte të drejtë. Zjarrin s'e ka dërguar zoti.

Plaku s'iu përgjigj.

Duke hyrë në fshat, Iliri rinte krenar mbi qerre. Dukej sikur i thoshte gjithë fshatit:

– A dëgjoni? Unë e di se si ka ardhur zjarri në tokë. Dhe gjyshi Rrapo tundte kokën i habitur e thoshte me vete:

«Ke hak, Ilir, ke hak!»

ARTANI DO TË BËHET AGRONOM

Shumë herë u zgjua një natë Artani, po nuk u ngrit asnjëherë.

— Si s'po gdhihet, — pëshpëriste me vete sa herë që hapte sytë.

Një herë u ngrit mbi shtrat e vuri veshin të dëgjonte se iu duk sikur po e thërrisnin. Dëgjoji vetëm një qen të vogël që lehte pa pushim në rrugë. Një herë tjetër vështroi nga dritarja që kishte mbi krye. Nëpërmes pemëve të kopshtit pa yjet që xixëllonin dhe hënën që llapste. Fletët e mëdha të një fiku, që arrinin gjer te dritarja, lëkundeshin lehtë nga era. Dy xixëllonja, që këtu ndizeshin e atje shuheshin, kaluan përmes pemëve e Artani zgjati duart për t'i kapur, po në vend të tyre, preku xhamin e dritares. Ndërkaq xixëllonjat u zhdukën.

U shtri përsëri në shtrat e, duke mbuluar kokën me jorgan, tha i çuditur:

— Sa e gjatë qenka nata!

Në mëngjes e zgjoi e ëma duke e përkëdhelur. Ai hapi sytë e, kur pa rrezet e dritës, u hodh nga shtrati drejt e në këmbë, duke thirrur i dëshpëruar:

– Bobo, u vonova! Po ku më zuri ky gjumë tashti në mëngjes? Unë tërë natën s'kam fjetur!

U vesh shpejt e, pa larë sytë, deshi të dilte. Po e ëma e ndali:

– Ku do të vesh kështu, Artan? – i tha ajo. – Është turp! E pe veten në pasqyrë? Pa shih si je? Duhet të lahesh, duhet të krihesh...

– Po u vonova, moj nënë, – tha ai duke iu bindur.

– Nuk u vonove, jo, shpejt është, – i tha e ëma dhe hyri në kuzhinë për t'i përgatitur mëngjesin.

Artani u hodhi syve pak ujë të ftohtë, lau dhëmbët, u kreh e doli jashtë me të shpejtë. E ëma e pa nga dritarja tek vraponte në rrugë me të katra e thirri:

– Artan! Artan! Po ti harrove bukën, more bir!

U kthye i dëshpëruar, se po i shkonte koha. E ëma i dha një qese të vogël, në të cilën i kishte vënë vezë të ziera, qofte të fërguara, gurabije, qepka e hudhra të njoma, bukë e ca kripë të mbështjellë në letër.

– Ku do vije pa bukë? – e pyeti e ëma.

– Po u vonova, moj nënë!

– Si u vonove? Ora s'ka vajtur gjashtë.

– Ashtu të duket ty, po shokët me siguri kanë shkuar tashti.

– Kur nisen për rrugë, njerëzit përgatiten mirë, – i tha e ëma, – e jo kështu si ti, pa mend në kokë. Shiko, se mos ke harruar gjë tjetër.

– Tashti të gjitha i kam, – u përgjigj Artani. – Rri me shëndet!

– Udhë mbarë dhe hap sytë mos ftohesh, – e këshilloi e ëma.

Kur doli në oborr, u kujtua se me të vërtetë kishte harruar diçka. Kishte harruar proshajkën¹⁾ dhe lopatën e vogël, që do t'i merrte me vete. Hyri në kopsht e aty dëgjoj fë atin që e përsëndeti:

– Mirëmëngjes, Artan!

– Mirëmëngjes, babi!

1) çapën

– A po vjen të më ndihmosh? Do të mbjell ca lule që s'i kemi në kopsht, – tha i ati duke i treguar një saksì të re, që kishte blerë në pazar të enjten e kaluar.

Artani i donte shumë lulet e pemët, ashtu si i ati, ndoshta edhe më shumë. Çdo mëngjes ai i dhuronte mësuesit një tufë me lule të bukura dhe çdo mbrëmje, kur mbaronte së mësuari, punonte në kopshtin e shtëpisë. Së bashku me babin hiqnin barërat e këqija mbillnin ndonjë lule të re e rregullonin udhët e vogla të kopshtit. Nganjëherë i ati krasiste e shartonte ndonjë pemë e pastaj ulej për të ndezur një cigare. Artani u hidhte ujë luleve e pemëve e, si mbaronte, ulej edhe ai afër t'et e bisedonte me të, gjersa e ëma i thërriste për të ngrënë darkë.

– E shikon këtë lule? – i tha i ati. – Tani është e vogël, si ti por, kur të rritet, do të hapet në mur e do të kundërmojë erë. Ma dhuroi drejtori i fabrikës. I thonë dorëzonje, se ashtu është, e shikon? Si dorë.

– Me të vërtetë si dorë qenka. Ja dhe gishtat ku i ka, – tha Artani i çuditur, duke soditur bukurinë e lules.

– Hajde tani, merr lopatën e hap një gropëz, ja këtu, që ta mbjellim.

– Po... mirë... o babi... e hap... Po mua më presin shokët. Sot do të vemi shëtitje me shkallën.

– E di, e di, – i tha i ati, – më the mbrëmë. Po shpejt është. Ke kohë.

– Jo babi, se vonohem, – kundërshtoi ai.

– Nuk vonohesh, – i tha i ati. – Unë e hapja edhe vetë, po do të krasit atë gorrícën që mbollëm vjet, se i janë rritur shumë degët.

Artani e la qeşen me bukë mbi një fron që kishte vënë i ati në mes të kopshtit dhe mori lopatën. E kishte mendjen te pikniku. Kishte frikë se mos vonohej, prandaj sa skërfiti një çikë dhe, i tha:

– E hapa, babi!

– Pa ta shohim, – tha i ati dhe iu afrua. Po, me ta parë, mblodhi buzët i pakënaqur: – Kjo s'është gropë, o Artan. Këtu s'ka vend as për një mizë e jo për dorëzonjën.

– Si s'ka? – tha i habitur Artani.
– S'ka, – përsëriti i ati.
– Jo, babi, mjaft është.
– Mos më mëso mua. Gropa do hapur edhe një pëllëmbë.

– Epo u vonova, o babi? Kur të vij në mbrëmje, e hap.

– Gjer në mbrëmje më thahet lulja, – i tha i ati. – Pastaj pse nxiton kështu? Është shpejt akoma.

Artani filloi të punonte përsëri me të shpejtë, duke menduar se shokët me siguri ishin mbledhur te shkolla e ishin nisur. Mësuesi do të qe çuditur për mungesën e tij. Edhe shokët do të qenë zemëruar.

– Eh! – mendonte me vete Artani duke hedhur dhé me lopatë, – shokët bëjnë qejf e unë rri këtu! Kushedi si këndojnë tashti fushave. Kushedi sa lule të bukura mbledhin! Kushedi ç'zogj ka andej! Ah, or babi, më le pa vajtur! Po si të mos vete unë në piknik? A durohet kjo? Nuk durohet, jo.

Ai mori prashajkën dhe qesen me bukë, që ishin mbi fron afër njëra-tjetrës dhe, me lopatë në dorë, u mundua të ikte fshehurazi. Po i ati e pa dhe e pyeti:

– Ku do të shkosh, Artan?

– Të pi... pak ujë, babi, – u përgjigj Artani pa u menduar dhe doli nga kopshti.

I ati ndezi një cigare e priti. Po e piu edhe cigaren e Artani s'u kthye. Babai doli nga kopshti e filloi ta kërkonte nëpër shtëpi duke thirrur:

– Artan! Artan!... A pive ujë, more?... Ku je futur kështu? Hajde, Artan. Ku je fshehur? Në qilar? Apo në hatullat? Apo je futur në sëndyq. Hajde dil, se s'kan nge. Mos u tall me babin. O Artan!

Në kuzhinë ai takoi të shoqen, që lante enët.

– Ç'u bë djali? – pyeti. – Vajti të pijë ujë e s'u kthye!

– Artani iku, – iu përgjigj ajo. – E pashë nga dritarja që po nxitonte në rrugë me të katra.

– Ah, ç'ma punoi, – tha i ati. – Mirë ma punoi.

Dhe burrë e grua ia plasën gazit.

Shkolla ku mësonte Artani ishte aty afër. Sa të kapërceje dy rrugë e nja dhjetë shtëpi dilje në një shesh e në mes të sheshit ishte shkolla, një ndërtesë e bardhë, me dy kate, me dritare të mëdha e me një oborr të gjerë.

Artani e bëri me vrap gjithë rrugën. Kur arriti te shkolla, mezi merrte frymë. Nga larg ai e pa oborrit bosh e u dëshpërua shumë, duke kujtuar se shokët do të kishin ikur. Por përsëri mori zemër kur i shkoi ndër mend se nxënësit mund të ishin brenda nëpër klasa.

Kur u ndodh te dera e shkollës, ngriu në vend: «Boboo, paskan ikur! Po tani?!»

Ç'të bënte? I ra rreth e rreth oborrit, vuri këmbët në një gur e vështroi nga dritarja klasën e vet. Atje s'kishte njeri. Pa dërrasën e zezë, tryezën e mësuesit, copra shkumësi të hedhura mbi dysheme dhe bankën e tij në radhën e dytë.

– Më lanë!... Më lanë! – tha Artani duke ngritur zërin. – E të tëra babai m'i bëri. «Është shpejt, është shpejt» më thosh! Edhe nëna kështu më thosh. Mbeta pa vajtur. E unë me sa gëzim e kam pritur këtë ditë! Me sa gëzim! Tërë natën s'kam fjetur...

Dy pika lot iu rrokullisën Artanit mbi faqe dhe buza iu drodh nga ngashërimi.

U ul një copë herë te pragu i portës së shkollës duke mbajtur në duar qesen me bukë, prashajkën e lopatën e vogël. Ta shikoje do të thoshe: «Kushedi ç'i ka ngjarë këtij vogëlushi që mban kokën varur! Kushedi sa e ka qortuar mësuesi këtë djalë që ngashëren kështu! Kushedi sa dysha ka marrë që qan kështu!» Por, jo! Artani me mësime vinte shumë mirë. I kishte të gjitha dhjeta, veç një nëntë kishte në bukurshkrim.

Po ta pyesni sa ndenji ulur te pragu i portës së shkollës, as ai vetë nuk e di. U mendua e u mendua sa u lodh. Pastaj u ngrit. Vendosi të shkonte vetëm për shëtitje, andej nga Selita e Vogël. Po t'i gjente shokët, mirë, po të mos i gjente, do të mblidhte ca lule me gjithë rrënjë, do të gjente ndonjë pemë të egër të vogël, të

cilën do ta nxirrte me lopatë e me prashajkë e pastaj, si të hante bukën që i kishte dhënë e ëma, do të kthehej në shtëpi.

U bë gati të nisej kur menjëherë i doli përpara Çeçoja me një trastë me bukë në kurriz.

— E, more gjumash, tani vjen? — e pyeti Artani i dëshpëruar.

Çeçoja me duar në xhep, vërshëlleu një herë e i tha i çuditur:

— Moore! Sa shpejt qenke ngritur!

— Shpejt? Çfarë shpejt more! Jemi të fundit, — i tha Artani.

— Të fundit?! — u habit Çeçoja dhe nxori duart nga xhepi për të rregulluar trastën që i kishte shkuar shtrembër.

— Të fundit! — i tha Artani me lot në sy. — Shokët kanë ikur. Ata bëjnë qejf, e ne të dy rrimë këtu.

— Si ore paskan ikur? Po kjo pikë e zezë! E di, Artan? Unë tërë natën s'kam fjetur rehat. Hap e mbyll sytë, ja kështu, si lepuri.

Çeçoja përplasi kapakët e syve disa herë me radhë për të treguar se gjithë natën ashtu kishte fjetur.

— Edhe mua ashtu më ngjau, — u ankua Artani, — po në mëngjes më zuri një dreq gjumi. Kur më zgjoi nëna, ishte gdhirë.

Artani psherëtiu një herë thellë e pyeti:

— Po tashti, ç'të bëjmë?

— Vemi e vrasim zogj, — iu përgjigj Çeçoja. — Unë di një vend, Artan. Është plot me çerdhe. Ka mëllenja, pëllumba ka, edhe bilbila ka. E di? Nga ata verdhashët që këndojnë: Ciriciu! Cërr-cërr-cërr! Ciriciu-cërr!

Aq bukur fliste Çeçoja e aq bukur këndonte si bilbil, sa për pak ia mbushi mendjen shokut. Po Artanit iu kujtua mësuesi dhe udhëheqësi i pionierëve që u kishin thënë kaq herë të mos trazonin zogjtë.

— Jo, Çeço, — iu përgjigj më në fund. — Nuk bën t'i ngasim zogjtë.

— Nuk bën?! E pse nuk bën?! Zogj janë ata, s'janë njerëz që të mos i trazojmë, — ia preu Çeçoja.

– Zogjtë janë të dobishëm. Ata hanë krimbat e mizat që dëmtojnë pemët! – i tha Artani.

– Budalla që je! S'u mbaruan zogjtë se do të vrasim ne dhjetë a pesëmbëdhjetë copë! S'i shikon? Ja, mbi kokë po të fluturojnë me qindra, me mijëra. Çfarë me mijëra! Me miliona. Hajde shkojmë. Ti paske prashajkë edhe lopatë. Aq më mirë. Vemi që vemi, presim edhe degë pemësh e me to bëjmë kafaze, fyej e shigjeta. A dëgjon?

Çeçoja kujtoi se ia mbushi mendjen. Vuri duart në xhep e u nis i pari. Po Artani nuk luajti nga vendi.

– Nuk vij me ty, – i tha, – se je i keq.

– Si the? – u hodh Çeçoja i zemëruar e bëri një hap para duke mbledhur grushtat. – Jam i keq?!

– Po, – i tha Artani.

Çeços iu kuq hunda nga inati.

– E pse?! – pyeti ai.

– Se trazon zogjtë e pemët.

– Pse, mos janë të tutë zogjtë e pemët, a? – pyeti Çeçoja duke zgjatur qafën e tij të hollë.

– Janë të kujt janë, ai që i trazon është i keq, – tha Artani.

Çeços iu bë e tërë fytyra e kuqe, si hunda. Hoqi trastën nga kurrizi, e lëshoi përdhe dhe iu drejtua shokut me zë të lartë:

– Po e the edhe një herë atë fjalë, do të shemb me grushte.

– Je i keq! – tha Artani e u mat të ikte.

– Jam i keq?! Qëndro de, ku vete? Frikacak!

U nxeh edhe Artani. Ai nuk mund të duronte që ta quanin frikacak.

– Unë s'jam frikacak, – thirri ai e u mat t'i hidhej. Po mbeti i ngrirë në vend me grushtet gati. Në rrugë po ecte drejt shkollës një burrë i gjatë, me syze.

– Mësuesi! – u habit Artani.

– Vërtet mësuesi! – tha Çeçoja e hodhi trastën mbi kurriz.

Ndërkaq mësuesi u afrua e i përshëndeti:

— Mirëmëngjes, djema. Kemi kohë të mirë sot, — u tha duke vështruar qiellin e duke qeshur. — Do të gëzojmë me të vërtetë. Po ju sa shpejt paskeni ardhur!

— Shpejt?! — u përgjigjën të dy me një gojë duke parë mësuesin e tyre.

— Shpejt, posi. Po ne a e kemi lënë fjalën që të mblihdemi në orën shtatë? — u tha mësuesi. — Tashti ora është gjashtë e gjysmë.

— Domethënë shokët akoma nuk janë mbledhur? — pyeti Artani që po i rrihte zemra me forcë.

— S'janë mbledhur, — tha mësuesi.

— Dhe ne jemi të parët që kemi ardhur? — pyeti Çeçoja duke fërkuar hundën e kuqe.

— Si duket, të parët.

Mësuesi hyri në shkollë e atëherë Artani thirri i gëzuar:

— Paskam ardhur i pari! Paskam ardhur i pari! — dhe iu kujtuan prindët që kishin pasur të drejtë kur i thoshin se ishte ende shpejt.

Çeçoja u hodh përpjetë nga gëzimi disa herë me radhë, si ndonjë top që përplasët përdhe. Të dy shokët e harruan sherrin që kishin filluar për hiçgjë, ashtu si të gjitha sherret e fëmijëve e hynë në oborr të shkollës të përqaftuar me njëri-tjetrin.

* * *

Pas gjysmë ore u mblodhën me dhjetëra nxënës, kush me qese në duar e kush me trastë në kurriz. Vajzat kishin lidhur flokët e gërshetat me fjongo lloj-lloj ngjyrash. Zërat e tyre, si tingëllimi i këngës së rabeckave, përhapeshin në oborr. Djemtë fjaloseshin me zë të lartë e ndiqnin njëri-tjetrin të qeshur e të gëzuar. Të gjithë tregonin se si s'kishin bërë rehat natën, se si ishin zgjuar kushedi sa herë, se si i kishin përcjellë prindërit duke i këshilluar që të mos djersijnë shumë, që të mos ftohen e që të mos rrëzohen.

U radhitën katër nga katër, dolën në rrugë të drejtuar nga mësuesit e u nisën. Rruga gumëzhiu nga zërat e

tyre tingëllues. Dolën në fushë e fusha gumëzhiu nga këngët e tyre. Hynë në pyll, mblodhën lulëshqerra, manushaqe, lulëkuqe, e lloj lloj lulësh të tjera shumëngjyrëshe. Djem e vajza luajtën valle, devolliçen, dropulliten, tirançen, të Kukësit e të Peshkopisë. Luajtën kikithi, kaladibrançe, mi e mace, pulë e gjel e u shtrinë lëndinave e hijeve të gëzuar e të qeshur, si vetë pranvera.

* * *

Në hijen e një gorrice të egër, të lartë një bojë njeriu, u ulën të hanin bukë Artani, Çeçoja e Gëzimi. Ishin të tre në një klasë. Hëngrën së bashku e u kënaqën. Në fillim shkuan mirë me muhabet, po pastaj u zunë me fjalë e më në fund u përleshën si gjelat.

Ja si ndodhi sherri:

Në një degë të gorrices qëndroi një zog, një zog fare i vogël, sa gishti i madh i dorës e filloi të këndonte duke tundur bishtin, duke kërcyer gjeth më gjeth sikur gorrica t'ia shponte këmbët e duke rrahur sqepin pas fletëve.

— Ciu-ciuciuciu! — këndonte zogu e hidhte valle degë më degë.

— Eh! Ç'gushëkuq i bukur! — tha Gëzimi, që nuk i njihte shpezët.

— Ç'farë gushëkuqi, more, — ia preu Çeçoja. — Ai është trumcak, trumcak i vogël që s'ka pikën e mishit. Vetëm pendë ka.

Dhe vërtet trumcak ishte. Nuk mund të gabonte Çeçoja, që i njihte mirë gjithë zogjtë e rrethit.

— Pa rrini njëherë e mos bëni shamatë se mos e zëmë të gjallë. Këta trumcakët, kur janë të vegjël, janë budallenj, nuk kuptojnë hiç se ç'është rreziku, — tha Çeçoja. Pastaj qiti xhaketën e, gjysmë i përkulur, vjedhurazi, si mace, iu afrua gorrices e u mat të hidhte mbi të xhaketën. Po tamam në këtë kohë Artani u ngrit dhe me një të vërshëllyer e trembi zogun. Trumcaku fluturoi dhe Çeçoja mbeti me xhaketën në dorë, ashtu si macja kur ka

miun përpara. U inatos shumë dhe, nga inati, u mat të këpuste një degë nga gorrica.

— Mos e këput! — i thirri Artani dhe e kapi Çeço për krahu.

— Mirë të thotë, mos e këput, Çeço! — i tha Gëzimi, që po hante akoma.

— Moore! Po juve do të më ndaloni mua? — thirri Çeçoja e, me një të shtyrë të bërrylit, e liroi krahun që po ia mbante Artani. — Pse s'e di unë sa para bëjnë gorricat? Një para s'bëjnë. Kjo është ferrë. Dhe kur unë dua ta këpus, e këpus, dhe jo vetëm një degë, por të tërën ja, kështu, kështu! E përfshiu me duar trungun e gorrices dhe e shkundi me tërë forcën e tij. Iu duk sikur e shkuli, po në të vërtetë gorrica qëndronte në vendin e saj të parë e, si për inat të tij, lëkundej nga era.

— Po të shartohet e po të ujitet, ajo bën dardha, — tha Artani, — kurse ti kërkon ta thyesh.

— Bën gorrica që të zënë grykën e jo dardha, — u tall Çeçoja.

— Po të shartohet bëhet pemë, — tha Artani me bindje.

— Nga na i paske mësuar këto, more djalë? — u tall Çeçoja përsëri.

— Në shtëpi të pionierit i kam mësuar. Edhe babai m'i ka mësuar. Unë edhe vetë di të shartoj.

— Punë e madhe fort të shartosh! Merr një thikë, çaj lëkurën e mbaroil Ah! Kur s'kam një thikë, pa le të mos e provoja këtu, — u mburr Çeçoja megjithëse s'kishte shartuar ndonjëherë e as kishte parë, po vetëm kishte dëgjuar. — Le që gorrica nuk shartohet. Ku ke parë ndonjëherë të shartohet gorrica? Mendje po na shet edhe ti, o Artani!

— Ti, Çeço, kur s'di, më mirë mos fol. Edhe unë s'di e s'flas, — e këshilloi Gëzimi.

— Ti s'di, po jo unë, — u mburr përsëri Çeçoja. — As Artani s'di.

— Artani ka mbjellë gjithë ato lule në oborrin e shkollës, — tha Gëzimi.

— Lule po, por jo gorrica.

— Edhe gorricen e mbjell unë, — tha Artani.

- S'e mbjell dot, - ia preu Çeçoja.
- E mbjell dhe e shartoj.
- As e mbjell e as e sharton.
- E vëmë me bast? - e pyeti Artani.
- E vëmë.
- Me se?
- Me se të duash.

Gëzimi pati një mendim të mirë. Pa e zgjatur shumë, ai tha:

- Vëreni me bast me nga një të hipur kalikiç, prej shtëpisë e gjer në shkollë.

Të dy pranuan, Artani e Çeçoja i dhanë dorën njëri-tjetrit e Gëzimi, duke hyrë në mes të tyre për të prerë bastin, tha:

- Pse s'e bëmë kështu: kush të mundet, të më marrë edhe mua kalikiç?

- Mirë, - thanë të dy me një gojë dhe Gëzimi e preu bastin, duke i ndarë duart e shokëve me krahun e tij si shpatë.

Basti filloi. Artani me ndihmën e ca shokëve, duke punuar me prashajkën e me lopatën që kishte marrë në shtëpi, e nxori gorricën me gjithë rrënjë.

Pasdite, kur do të ktheheshin nga shëtitja, Artani nuk harroi të merrte me vete dhe gorricën.

Rrugës mësuesi e pa Artanin me gorricën në dorë, iu afrua dhe e pyeti:

- Ku do ta mbjellësh këtë gorrice?
- Në oborrin e shkollës.
- Ti do të bëhesh agronom, Artan, - i tha mësuesi dhe e uroi.

Çeçoja uli kokën i heshtur.

Që atë ditë Artani me disa shokë hapën një gropë të madhe në mes të oborrit të shkollës. Të nesërmen i ati i Artanit u solli pleh dhe i mësoi si ta mbillnin, si ta krasitnin e si ta shartnin dardhë gorricën e egër kur të zihej. Kur Artani i mbaroi këto punë, erdhi në oborr mësuesi e u tha:

– Tashti varet nga ju. Po ta keni kujdes gorrïcën, po ta ujitni për tre vjet do të keni dardha.

Dhe vërtet gorrïca u zu, lëshoi degë e u rrit. Pas tre vjetësh ajo bëri dardha. Atë mot Artani mbaroi shkollën tetëvjeçare e mori dëftesën me të gjitha dhjeta. Një ditë, tek rrinin në hijen e dardhës, Çeçoja u kujtua:

– Të kam një borxh, Artan, – i tha duke qeshur. Hipmë të të shpie kalikëç në shtëpi se e ke fituar bastin!

Po Artani nuk pranoi. Ai tashti kishte mbaruar tetëvjeçaren e do të hynte në shkollën e mesme. Nuk i kishte hije një nxënësi të shkollës së mesme t'i hipte kalikëç një shoku të tij.

* * *

Tashti Artani është rritur. Ai mëson në Institutin e Lartë Bujqësor për agronom.

Sa herë kalon nga shkolla fillore, midis pemëve të shumta të oborrit, të cilat i mbollën më vonë nxënësit e tjerë, shikon edhe gorrïcën e tij, të rritur, më të rritur se të tjerat, që i bën dardhat të mëdha sa koka e Çeços.

Nga vëllimi
«NË PRAGUN
E JETËS»

1960

1940
MUDANISI NIN
1940

NË PRAGUN E JETËS

Në fshatin tonë vajzat i martonin të vogla. Po të kishte mbushur vajza gjashtëmbëdhjetë vjet, duhej të vinte pa-tjetër te burri. Atje, pastaj, brenda vitit, bëhej nënë dhe i kalonte jeta pa rini.

Kështu do ta martonte të bijën edhe Risto Opari. Po Lena e tij ishte kërthinjë. S'i kishte mbushur të katërmbëdhjetat. Ajo ende lozte me kukulla dhe ëndërronte si një fëmijë. Kishte një trup të hollë, të hollë si bisk i ri qershie. Sytë e saj të zinj e të mëdhenj, në fytyrën pak të hequr, vështronin gjithnjë me habi. Aty derdhnin lot, aty shkëlqenin nga gëzimi. Edhe buzët, flakë të kuqe e pakëz të fryra, tregonin miturinë e saj.

Po Risto Opari thoshte:

— Po t'i dalë kësmeti, edhe katërmbëdhjetëvjeçe e martoj!

Për fat të Lenës asnjëri nuk kishte trokitur në derë gjërat atëherë. Dhe vajza rritej me hallet e veta.

Lena kishte plot halle. Ngrihej në mëngjes herët, si plakati, pa u ngopur me gjumë, lidhte një shami në flokët e pakrehur dhe u vihej punëve të shtëpisë. Ndishte zjarrin

në vatër, lante enët, spërndriste kasollen dhe shkonte në mal për të kullotur katër dhi.

I ati dhe e ëma ishin bujq të beut dhe gjithë ditën e kalonin në fushë. Mbrëmjeve, kur ktheheshin nga puna të lodhur e të mërzitur, hanin një kafshatë bukë dhe binin e flinin.

Në mal Lena e ndiente veten shumë të lirë. Atje asnjëri nuk e trazonte. Lëshonte dhinë nëpër dushqeret dhe vetë ulej mbi bar. Vendi më i dashur i saj ishte maja e një shkëmbi të lartë. Ajo vente çdo ditë atje dhe ulej në majë të atij shkëmbi. Ditët e para i qenë marrë mendtë dhe kishte pasur frikë të vështronte që andej. Po pastaj u mësua dhe i pëlqente fort të rrinte atje me orë të tëra. Përpara saj shtrihej një botë e tërë, fusha e përshkuar nga lumenjtë dhe e mbytur nga kënetat. Mali i Thatë dhe mali Ivan të mbuluar me re, fshatrat me shtëpitë si kuti dhe, atje tej, larg shumë, qyteti i mbuluar me tym e mjegull. Lena hapte krahët e thërriste me tërë zërin e saj:

– E-e-e-eeee! O-o-o-oooo!

Era i binte në krahë, ia merrte flokët dhe ia ngrinte fustanin prej basme gjer mbi gju. Dukej sikur do të hidhej nga shkëmbi e do të fluturonte si ajo shqiponja atje lart.

Tek ai shkëmb duhej ta kishte folenë një shqiponjë e madhe që Lena e vështronte çdo ditë. Shqiponja rrihte krahët e fuqishëm e vërtitej me orë të tëra atje lart. Një ditë ajo e pa shqiponjën që kishte qëndruar në majën e shkëmbit. Shpesi i madh po i binte me sqep një lepuri që kishte përfshirë me kthetra. Lena u afrua për ta parë më mirë. Po shqiponja fluturoi me gjithë lepuri. «Sa e fortë!» – u habit ajo dhe i hyri frika se mos një ditë, ai shpesh do ta rrëmbente edhe atë.

Mbrëmjeve Lena zbriste në fshat gjithnjë e ngarkuar. Me një litar gjithë nyja lidhte një vandak dushqeresh, i hidhte mbi kurriz dhe, si i vinte dhinë përpara, shkonte në shtëpi. Ato dushqere ua hidhte dhive natën. Nganjëherë ajo sillte dhe karthje e dru në kurriz. Atëherë e ndiente veten shumë të lodhur. I milte dhinë shpejt e shpejt dhe, shpesh, pa ngrënë, shtrihej për të fjetur,

Risto Opai, duke parë vajzën që flinte, i thoshte së shoqes:

– U rrit kjo. Duhet martuar. Shiko mos ia hedhësh fjalën Kiços. E ka djalin punëtor ai.

E shoqja, një grua thatime, vështronte me përmallim Lenën e psherëtinte:

– Është e vogël, more burrë! Në vjeshtë i mbush të katërbëdhjetat!

– E vogël, e vogël! Një fjalë di ti. Po në ta rrëmbetë i paudhi!...

Lena sytë i kishte mbyllur, po gjumi nuk e kishte zënë. Asaj i drodh zemra. Kush do ta rrëmbente atë? Ku e kishte fjalën i ati? – U bë fare si e fjetur, bile filloi edhe të gërhiste nga pakëz, po veshët i hapi mirë. Donte të merrte vesh se kush ishte ai që do ta rrëmbente e kush do të ishte ky burrë që do ta merrte.

– E ç'do ta dojë ai Lenën. Kjo është kërthinjë, – tha e ëma dhe Lena ndjeu mbi kokë dorën përkëdhelëse të s'ëmës.

– Kërthinjë! Kërthinjë ishte edhe e bija e xha Naumit. Po e la me barrë.

– Mos thirr, se do ta zgjosh?

U bë heshtje dhe në atë heshtje Lena dëgjoi përpëlitjen e fluturave, të lehurat e një qeni dhe kollën e të atit. Heshtjen e prishi përsëri zëri i mekur i nënës:

– E bija e xha Naumit ishte e rritur. Po afronte të tetëmbëdhjetat. Kurse kjo s'ka asnjë shenjë gruaje. Të mbushë moshën, pa ta martojmë.

– Le të rritet te burri, njësoj është!

– Po është e vogël, more!

– Dy pare mend keni ju gratë, – tha me inat i ati duke pështyrë në vatër. – Po ja i doli nesër, ai, në mal, e ta çnderoi. Ç'do të bësh zotrote? Në gjyq do ta hedhësh? S'të dëgjon gjyqi. Do ta hash turpin me bukë. Asnjë fjalë s'do të thuash dot, se të merr për veshi e të nxjerr nga kasollja e nga tokat. Ec e jeto pastaj.

Lena ndjeu mbi kokë dorën e s'ëmës. Dora dridhej dhe nga kjo e dredhur Lena e kuptoi se e ëma po ngashërente. Një pikë lot i ra mbi faqe dhe iu fut në gushë.

Për pak Lena desh u ngrit, po e mbajti veten. U mallëngjye edhe ajo dhe sytë i dogjën nga lotët. Kafshoi buzën fort për të mos qarë.

— Të presim gjer në vjeshtë, — tha e ëma me ngashërim. — Na lirohet djali nga ushtria, marrim edhe mendimin e tij, pastaj shohim e bëjmë.

— E ç'qan kështu, si fëmijë?

— Ç'të mos qaj.

— Bjer e fli. I thuaj çupës që t'i bëjë sytë katër atje në mal.

Pas pak e shuan dritën, e mbuluan prushin me hi dhe ranë e fjetën.

Lenën e zuri gjumi me zor. Nga të gjitha ato që dëgjoji kuptoi një gjë, që sot e tutje duhej të jetonte me frikë. Një njeri si gogol do ta ndiqte këmba-këmbës dhe do ta çnderonte edhe atë si të bijën e xha Naumit. Një ndjenjë e madhe dëshpërimi dhe frike ia pushtoi zemrën. U struk pas trupit të s'ëmës dhe ngashëroi me zë. E ëma u tremb dhe e pyeti:

— Ç'ke Lenë?

Lena nuk iu përgjigj.

— Kushedi ç'ëndrra shikon! — pëshpëriti e ëma dhe e përqafoi.

Që prej asaj dite Lena e humbi gëzimin. Sytë e saj të mëdhenj e të zinj u mbuluan nga një hije frike dhe gjithnjë vështronin të trembur. Fytyra pak e hequr iu pikëllua. Edhe të ecurit sikur e ndryshoi. Më parë ajo ecte e qetë, drejt rrugës, pa kokëçarje. Kurse tani gjithnjë rrotullon kokën sa andej-këtej. Hapat i hedh të shpejtë e me frikë se mos rrëzohet. Supet i mban të ngritura dhe qafa i duket më e shkurtër. Gjithnjë i duket sikur e ndjek njeri nga prapa. Kur është vetëm, një fletë e thatë të lëvizë, një qen të lehë, një derë të kërcasë ajo trembet dhe zemra e saj i shton të rrahurat.

Në mal nuk e tërheq më bari me qeniet e tij të vogla; as shkëmbi i lartë e as fluturimi i bukur i shqiponjës. Ajo rri shpesh majë shkëmbit e punon me shtiza një shami të hollë. Ka filluar të bëjë pajën. Shamia është gjëja e parë që do të shpjerë te burri. Pastaj, pas shamisë, do

të qëndisë një jastëk dhe këmishën e natës të nusërisë. I vëllai shkruante në një letër se do t'i sillte, kur të vinte, ca metra basmë dhe një shami me ojna ngjyra-ngjyra. Lena ka vetëm një fustan. E ka bërë dy vjet më parë. Po gjatë këtyre dy vjetëve fustani i kuq me lule të bardha është bërë gjithë arna. Pastaj edhe është ngushtuar, se ka hyrë në ujë dhe se Lena ka hedhur shtat. Ajo s'ka me se të vishet tani, kurse e ëma i kujton gjithnjë pajën. Ç'i duhet paja asaj?

Edhe e ëma e ka vënë re ndryshimin e së bijës. Asaj i duket Lena jo vetëm e trembur, por edhe e menduar. Shpesh Lena nuk flet fare. I bën të gjitha punët pa zë dhe bindet shpejt. Çdo gjë që i thotë e ëma, ajo nuk e kundërshton, si ndodhte shpesh më parë.

— Mirë, nënë! — thotë dhe shpejt e shpejt bën ç'ka për të bërë.

Një ditë e ëma, kur u kthye nga puna, e gjeti Lenën duke qarë me ngashërim. Sytë e mëdhenj i qenë skuqur e zvogëluar nga lotët.

— Ç'ke? — e pyeti ajo e shqetësuar.

— Kam frikë! — u përgjigj Lena.

— Frikë! Ç'është kjo frikë?! — u habit e ëma. — Ti s'je e vogël.

— Më duket sikur më ndjek njeri.

E ëma nuk e besoi dhe, duke dyshuar se mos e bija kishte thyer ndonjë enë, filloi të shihte nëpër kasolle. Po të tëra gjërat i gjeti në vend.

— Nga kush ke frikë? — e pyeti ajo.

Vajza heshti një grimë dhe, duke vështruar t'ëmën në sy, u përgjigj:

— Nga beu!

— Ç'flet kështu, Lenë! — ia bëri e ëma dhe iu ul së bijës përpara duke u munduar të mbante veten. — Pse, ç'të ka bërë beu?

— Asgjë.

— Po atëherë pse ke frikë?

— Ti ma fute frikën, ti me babanë. Atë natë kur

fjaloseshit. Unë nuk flija, ju dëgjova – dhe Lena me lot në sy i tregoi ç'kishte dëgjuar.

– Budallaqe, pusho, se është turp të qash kështu!

– Edhe ti kështu qaje atë natë. Edhe unë kam frikë, jo vetëm ti. Tani më duket sikur ai më ndjek prapa – dhe vajza u shkri në vaj.

Gruaja nuk dinte si ta pushonte. Ia mori kokën në pëllëmbë dhe ia fshiu lotët me shami. Pastaj e afroi pas gjirit dhe e shtrëngoi fort, fort, duke belbëzuar:

– Pusho, Lenë! Ti je goxha vajzë! Ti s'je më e vogël. Ti të kesh frikë? Pastaj ti duart përse i ke? S'të janë tharë. Po të ngjasë gjë, bjeri me gur dhe ik, ik sa të të hanë këmbët, vrapo, fluturo. Ai s'të ndjek dot. Ti shpëtoji nga krahët dhe ik me vrap, me vrap. Po të jesh në mal vetëm, fshihu në pyll, po të jesh në fshat, eja në shtëpi. Dëgjon, Lenë? A më kupton? Ti s'je e vogël tani. Ti duhet ta ruash vetë nderin. Ti shpejt do të bëhesh nuse...

Ky bisedim me nënën ia lehtësoi zemrën shumë Lenës. Budallaqe që ishte! Ishte trembur kot së koti. Po ajo duart përse i kishte?

Kaluan disa muaj dhe me ta kaloi edhe hidhërimi e trishtimi i vajzës së vogël. Frika nuk i qe zhdukur krejt. Diku thellë në zemër ajo e ruante atë frikë, po shumë të zbehtë. Tani nuk trembej më nga zhurma e një flete të thatë apo nga fluturimi i papritur i një zogui. Trembej vetëm nga njerëzit e panjohur dhe nga ata që shembëllenin me beun.

Po, përsëri, në zemër të saj ishte kthyer gëzimi i mëparshëm, gëzimi i miturisë.

Në mal ajo filloi përsëri të dëfrehej. Filluan t'i pëlqenin përsëri fluturimi i guximshëm i shqiponjës, era përkëdhelëse në majë të shkëmbit, fluturat e luletaçet. Qëndronte majë shkëmbit të lartë dhe vështronte herë fushën e malet pa mbarim dhe herë pëllumbin e vogël krahëkuq që qëndiste në shami...

Një pasdite të bukur vere, tek ishte ulur mbi bar e qëndiste, dëgjoji shkrofëtimën dhe potkonjtë e rëndë të

një kali që godisnin si kopanë tokën e ngurtë. Lena ktheu kokën e trembur, po nuk pa njeri. Në një dushk të djegur nga rrufeja, aty pranë saj, çirrej e përdridhte bishtin një laraskë. Matanë dushkut dukej Mali i Thatë i mbuluar me re. Mbi mal fluturonin tufa shpendësh në drejtim të Koritës së shën Gjergjit.

– Më bënë veshët! – përshpëriti vajza dhe humbi pas qëndisjes.

Por potkonjtë e kalit i dëgjoi përsëri, më afër. Atëherë u ngrit dhe vështroi nga vinte zhurma. Vërtet, aty në pyll, ishte një kalë. Kalin Lena nuk e shikonte dot, se nuk e linin drurët, po shikonte vetëm bishtin e zi që tundej sa andej-këtej, si një fshesë.

Fryu era dhe ia ngriti fustanin gjer mbi gjunjë. Pastaj era u pre menjëherë dhe vajza ndjeu prapa kurrizit këmbët e një njeriu që shkelnin si mace mbi bar. Nuk i bëri zemra të kthente kokën për të parë. Vuri duart kryq në kraharor sikur do të falej, mblodhi supet dhe priti në heshtje. Pas pak dëgjoi zërin përkëdhelës, por të frikshëm të një burri:

– Ç'bën këtu, moj Lenë e vogël?

Lena u kthye e trembur.

– Beu! – klithi ajo dhe mu përpara fytyrës së saj pa sytë e vegjël, të fishkur anëve dhe hundën me majë të kuqe të beut. – E zeza unë! – tha ajo dhe u mat të vraponte. Po beu me trupin e tij të madh ia preu rrugën duke hapur krahët.

– Mos ki frikë, moj pëllumbeshë!

Duart e tij e përfshinë vajzën nga beli.

– Largohu! – thërriste Lena, duke u dredhur e tëra, ndërsa beu e shtrëngonte fort në shpatullat e nxehta.

– Mos thirr!

Fytyra e beut, flakë e kuqe, llapste nga epshi, kurse Lenës i pikonin lot dhe i dridhej buza.

– Më lësho! Më vrave! Më copëtove, beej! Aman, të keqen, më lësho!

Lenës iu kujtuan fjalët e s'ëmës. Ajo e kishte këshilluar që ta ruante nderin, se nuk ishte më e vogël.

Po si t'ia bënte. A mundej ajo, vajzë kërthinjë, t'i bënte ballë fuqisë së një burri?

«Ti s'je e vogël... Ti duhet ta ruash nderin vetë!...» – i kumbonin në vesh fjalët e s'ëmës, ndërsa mbrohej me të gjitha fuqitë e saj. Ajo i shtrëngoi duart njëren pas tjetrës dhe i ngjeshi në kraharorin e beut, ku dukej një zinxhir floriri, që lidhej në një kopsë e mbaronte në një xhep të vogël të jelekut, ia largoi fytyrën me pëllëmbë dhe e çorri me thonj në qafë.

Por forca e saj ishte një forcë fëmije. Ajo e ndjeu se si iu dobësuan krahët, grushtet, aqshat. U lodh dhe filloi të aulçonte. Tamam si ai qielli kur vishet me re, iu veshën edhe asaj sytë e zinj e nuk pa më as dushkun e djegur nga rrufeja, as Malin e Thatë të mbuluar me re e as fytyrën e beut. E shtrirë mbi bar ajo vështronte vetëm qiellin dhe një re të madhe, të zezë që po i afrohej diellit.

Mblodhi edhe një herë tërë fuqitë e fundit dhe, duke parë gojën e çapëlyer të beut dhe vrimat e hundës të hapura si flearat e një kali të lodhur, i dha një të shtvrë me këmbë e me duar. Papritur u gjend në këmbë, ndërsa beu shtrinte duart për ta kapur përsëri, duke i thënë fjalë përkëdhelëse e lutëse.

Lena shtrënaoi në dorë shaminë që qëndiste pak më parë dhe vrapoi. Nuk dinte ku shkonte, vetëm vraponte përpara, gjithnjë përpara. I dukej sikur nuk ecte ajo, po sikur ecte udhishta nën këmbët e saj, sikur fluturonin drurët e oyllit në të dy anët, sikur vraponin gurët, lëndina, retë.

– Nënë! Nënë! Nënë! – thërriste, ndërsa era ia rrëmbente flokët dhe fustanin e grisur copë-copë. – Më shpëto, moj nënë!

Kur ktheu kokën, pa beun që fshiu gjunjët e pantallonave dhe që iu vu prapa duke vrapuar edhe ai.

Lena nuk aëndroi asnjë cast. Duke vrapuar, ajo u nqjit në maië të shkëmbit të lartë, atje ku kishte folenë shqiponia, te vendi i saj i dashur. S'kishte ku të vinte më. Mbylli sytë dhe, duke marrë frymë thellë-thellë, u

hodh nga shkëmbi në rrëpirë. Fluturoi si shqiponja, po shqiponja gjithnjë ngjitej lart në qiell, kurse Lena ra poshtë dhe trupi i saj u dërrmua mbi shkëmbinjtë. Ajo nuk pa e nuk ndjeu më asgjë. Nuk e pa as beun që vështronte i tmerruar nga maja e shkëmbit, as shqiponjën që fluturonte lart mbi trupin e saj, as shaminë e qëndisur, shtrënguar në grushtin e saj.

1956

HAMITI I VOGËL

Filmi kishte kohë që kishte mbaruar dhe fshatarët, pothuaj të gjithë, ishin shpërndarë. Vetëm Hamiti kishte mbetur në mes të sheshit, i menduar, me vështrimin në perden e bardhë që po e mblidhte kinooperatori, një beratas i ri,

– Eh, Çapajev, Çapajev! – pëshpëriste me keqardhje Hamiti. – Si nuk e kapërceve dot lumin? Ti arrite gjer afër bregut! Edhe dy-tri pashë dhe do të kishe dalë matanë! Jo, nuk është e mundur të mos e kesh kapërcyer!

– Hamit! Ti je aty? – ia preu mendimet kinooperatori.

– Unë, – u përgjigj djali.

– Hajde, se do të shkojmë.

Djaloshi bëri ca hapa dhe iu afrua një qerreje me dy rrota, ku qenë vendosur aparati, motori dhe kutitë e filmit. Aty ishin edhe tre vërsnikë të Hamitit, kurse një i katërt mbante për kapistalli kalin, të mbrehur në qerre.

– A të pëlqeu filmi, o Hamit?

– S'ka si Çapajevi! – u përgjigj pas pak djaloshi. – Vetëm se si mbaroi ashtu, menjëherë, – dhe i hëdhi një

vështrim të dyshimtë, po kinooperatori nuk e vuri re, se ishte natë.

– Shkojmë, djema! Ngani kalin me kujdes!

Qerrja kërciti dhe mori udhë.

Ishte pothuaj mesi i natës, mbasi beratasin fshatarët e kishin detyruar që ta shfaqte filmin dy herë me radhë. Disa kishin qejf ta shikonin edhe një herë, po kinooperatori kishte thënë me këmbëngulje: «Jo dhe jo.»

– Si mund ta shfaq tri herë me radhë? Edhe unë shpirt kam. Jam lodhur. Dhe nesër që pa gdhirë kam rrugë për të bërë.

Duke u premtuar se do të vinte përsëri pas dhjetë-pesëmbëdhjetë ditësh, mezi i bindi fshatarët që të shpërndaheshin.

Nata ishte e qetë dhe plot ajër të pastër, natë vere. Lidheve fluturonin xixëllonjat si shkëndija zjarri. Një kombajnë korrte në fushë, kurse në kënetë fshatarët, për të hapur toka të reja, kishin ndezur zjarre me flakët gjer në qiell.

Kur dolën në xhade, të gjithë hipën në qerre. Atëherë Hamiti, duke mbajtur në duar frenat e kalit, tha:

– U bë tamam si karroca e Çapajevit! Yaa! – ia bëri ai kalit.

– Vetëm mitralozi më mungon! – tha një nga djemtë.

– Ja dhe mitralozin ku e kemi, – tha një tjetër duke treguar motorin. – Jepi, oburra, që t'i dërrmojmë ballistët!

– Kujdes, Hamit! Mos e nga kalin me vrap, se na prishet aparati, – i hoqi vërejtjen beratasi.

– Prrrrruuu! – ia bëri përsëri Hamiti duke tërhequr frerin dhe kali e ndaloi vrapin. – Ja edhe shtëpia ime, – shtoi ai si ecëm edhe pak.

Djemtë e tjerë kërcyen nga qerrja dhe, si uruan natën e mirë, u larguan.

Shtëpia e Hamitit ishte buzë xhadesë. Nëpër portën e saj të hapur futën qerren, çmbrehën kalin, e futën në ahur dhe hynë brenda.

Dhoma ndriçohet nga një llambë e vendosur mbi oxhak. Hamiti ia ngriti llambës fitilin dhe e ftoi mysafirin

të ulej në këndin, ku ishte një tepsi e mbuluar me një peshqir të murmë.

– Ja, edhe darkën gati e paskemi. Urdhëro e ha! – tha Hamiti duke hequr mbulesën nga tepsia.

– Jam i urtuar si ndonjë ujk! – tha kinooperatori dhe filloi të hante si në shtëpi të vet.

Një copë herë e prenë bisedën duke rrëkëlyer, pa përtypur mirë, kafshatat e bukës. Ndërkaq erdhi edhe i ati i Hamitit që ishte bërë gati për të fjetur.

– Hani e ju bëftë mirë! Ama film na ke treguar sot! Po nesër për ku e ke rrugën?

– Për në Brashesh.

– Në Brashesh? Atje kam dajallarët unë. A më merr edhe mua? – pyeti Hamiti duke vështruar të atin, për t'u bindur nëse do ta lejonte apo jo.

– Të marr, – u përgjigj kinooperatori.

– Ec, bir, ec, po mos rri shumë!

Hamiti u bë me krahë dhe nga gëzimi iu pre oreksi. Rrezet e llambës i ranë në fytyrën e ndritur bojë gruri. Një kaçurrel i flokëve të verdhë i kishte rënë mbi ballë dhe e tregonte më të mitur se ç'ishte. Po shtat kishte hedhur më shumë sesa duhej për moshën e tij. Ishte i gjatë si lastar e i thatë si kërçelkë, po, kur mundej me vërsnikët, i hidhte të gjithë poshtë. Në vjeshtë do të hynte në klasën e fundit të shkollës fillore, pastaj... do të shihte e do bënte.

Kur ranë për të fjetur, kishte kaluar mesi i natës, dhe, kur u zgjuan, ende nuk kishte dalë dielli. Hipën mbi qerre dhe udhëtuan nja katër orë, gjersa arritën në Brashesh.

Edhe në Brashesh kinooperatori e shfaqti dy herë «Çapajevin» me gjithë kundërshtimet që bëri. Hamiti, ulur në radhën e parë, e pa filmin të dy herët dhe me ankth priti fundin e tij.

– Përsëri nuk e kapërceu dot lumin! Ah, Çapajev! – pëshpëriste me keqardhje. – Edhe dy-tre pashë do të kishe dalë matanë! Jo, nuk është e mundur që të mos e kapërcesh!

Në Brashesh kinooperatori hëngri e fjeti në shtëpinë e dajës së Hamitit. Kur ranë për të fjetur, Hamiti e pyeti mikun e tij:

- Po nesër, për ku e ke rrugën?
- Në stanet, lart në mal!
- A më merr edhe mua?
- Ti si e ke hallin? Kërkon të bëhesh kinooperator?
- Më pëlqen shumë ky zanati yt. A do të më marrësh?
- Mirë. Por vetëm merri leje dajës.

Në stanet nuk e morën qerren me vete. Motorin dhe aparatit i shpunë të ngarkuar në mushka. Në mbrëmje gjithë çobanët e çobankat u mblodhën përpara perdës së bardhë. Në rreshtin e parë rrinte Hamiti i vogël. Tani ai e dinte filmin përmendsh. I dinte të gjithë kuadrot e të gjitha episodet. Sa dilte Çapajevi në një vend, Hamiti e dinte se ç'do të bënte. *Po gjithnjë mendjen e kishte te fundi i filmit, prandaj edhe fundin e priste me të rrahura zemre.*

- Kësaj radhe do ta kapërcejë! Patjetër do ta kapërcejë! - thoshte me vete dhe përsëri dëshpërohej kur Çapajevi mbytej në lumë.

Atë natë, pas shfaqjes së filmit, e pyeti kinooperatorin:

- More, pse këputet filmi në fund?
- Si këputet!
- Po ja... sikur nuk mbaron. Mos të është prishur ndonjë copë?
- Filmi është i ri...
- Më duket sikur ti më gënjen. Pse nuk më thua të vërtetën? Ty, fundi i filmit ose të është prishur, ose të është djegur, ose e ke humbur!

- Më mërzite me këto fjalë, o Hamit!

Edhe djaloshi e pa që e teproi, prandaj e mbylli gojën dhe nuk e shqetësoi më. Vetëm kur u ngritën në mëngjes, e pyeti:

- Po sot, ku do të vesh?
- Në fshatin Lajthatë.
- Po nesër?
- Në ndërmarrjen bujqësore.
- Po pasnesër?

- Në fshatin Gurëz.
- Po pastaj?
- Pastaj nga Gurëzi në rreth. Do të lë «Çapajevin» e do të marr një film tjetër. Do të pushoj një ditë dhe do të derdhem përsëri fshatrave.

«Sa keq që do ta lërë Çapajevin!» - tha me vete Hamiti, pastaj e ngriti zërin. - A më merr edhe mua këto ditë gjer në Gurëz? ...Për babanë e për dajën mos ki merak, kam marrë leje. Ja që më pëlqen të bëhem kinooperator!

- Po mirë, more djalë, hajde!...

Dhe Hamiti e pa Çapajevin dy herë në Lajthatë, një herë në ndërmarrjen bujqësore dhe një herë në Gurëz; gjithsej nëntë herë. Dhe gjithnjë vinte me shpresë se Çapajevi do ta kapërcente lumin, megjithëse filmi tregonte të kundërtën.

Në Gurëz, kur u nda prej kinooperatorit, i tha:

- A e di pse të përcolla gjer këtu? Jo për t'u bërë kinooperator, po vetëm për të parë Çapajevin kur të kapërcente matanë lumit. Filmi nuk e tregon këtë. Por unë e di që Çapajevi do ta kapërcjë shëndoshë e mirë. Kur do të vish herë tjetër me Çapajevin?... Pas një viti the?... Ja këtu do të jemi po s'u bë kështu si them unë. Çapajevi nuk vritet e nuk mbytet në lumë. Nuk është nga ata ai. Çapajevi do të dalë matanë dhe do të luftojë përsëri.

Dhe Hamiti i vogël u kthye në fshatin e vet me shpresë se një ditë Çapajevi do ta kapërcente lumin, patjetër, si një e një që bëjnë dyl!

1959

FRYMË E VJETËR

Gjin Jonuzi ishte shtatëdhjetë e pesë vjeç, po, si gjithë pleqtë, edhe ai nuk i tregonte vjetët tamam. Kur e pyesnin, thoshte se duhej të ishte aty rrotull gjashtëdhjetë e ca vjetëve. Si plak që ishte, e nderonin shumë në fshat. Fëmijët e të rinjtë e thërrisnin gjysh, burrat e gratë dajë Gjini, dhe rrallë, ndonjë vërsnik i tij, e thërriste në emër, Gjin!

Vitet i kishin rënduar shumë mbi shpatullat dhe e kishin thyer në mes, ashtu si përkulen degët e ngarkuara të një peme. Degëve, për të mos u thyer, u vënë nga një furkë. Edhe Gjin Jonuzi, për të qenë më i sigurt e për të mos rënë, mbante një shkop të fortë thane, tërë gunga. Me atë shkop në dorë vinte në fushë e grindej me ata që i punonin tokat keq, hynte në dyaqan e i hidhte romuze shitësit që s'dinte ta mbante mallin siç duhet, shkonte në zyrat e kooperativës dhe e bënte rezil kryetarin për një derrkuc që kishte ngordhur, për dashin e racës që ishte sëmurë apo për ndonjë bletë që rroiste.

Ç'është e vërteta Gjin Jonuzi ishte bërë grindavec i madh, si në shtëpi, ashtu edhe jashtë. Po megjithëkëtë, si

plak që ishte, e nderonin të gjithë. Fëmijët nuk ia bënin fjalën dys. Burrat e gratë i qëndronin në këmbë, kurse vërsnikët i jepnin gjithnjë të drejtë.

Mirëpo një ditë kryetari i kooperativës ia mori nderin nëpër këmbë. Bëhej atë ditë një mbledhje e gjithë fshatit. Në këtë mbledhje u shtrua plani i mbjelljeve të vjeshtës. Kryetari, një burrë i ri, rreth të dyzetave, me agorregulloren në dorë, u tha fshatarëve se pas dy ditësh duhet të fillonin nga mbjelljet. Po Gjin Jonuzi nuk ishte i një mendjeje me të. Duke u mbajtur pas shkopit, u ngrit e tha:

— Për së prapi e ke filluar punën ti, o kryetar. Përse na thua që ta fillojmë mbjelljen pas dy ditësh? Po në zëntë përsëri ndonjë shi, ç'do të bëjmë atëherë? Të rrimë duarkryq, hë? Që ta ngas fjalën, ne duhet të kishim filluar nga mbjelljet që pardje, apo edhe që një javë më parë.

Kryetari qeshi me zë dhe ia bëri një herë me dorë, fap! si t'i thoshte plakut: «Ulu, o dajë Gjini, se të janë thartuar trutë!» Po Gjin Jonuzi nuk u ul. Atëherë kryetari u ngrit dhe e pyeti:

— E si do t'i fillonim këto mbjellje, o dajë Gjini, kur tokat ishin me ujë?

— Tashti ma mbylle gojën. Tokat në ujë ishin, — tha plaku me të tallur dhe si u kollit një herë, vazhdoi me zë të lartë. — Po atje në Muzgët janë nja dy ara që s'kanë ujë. Edhe te Guri i Prerë toka mund të lërohej. Që ta ngas fjalën, edhe te Varri i Turkut sot mund të kishin hyrë qetë për bukuri. Pa shikoje një çikë atë libër që ma mban në duar, a t'i thotë këto gjëra? Nuk ma ha mendja që t'i thotë. Ai kaq fletë ka, sa të dredhësh njëqind cigare. Kurse për t'i shkruar në kartë tërë punët e bujqësisë, duhet për çdo fshat një libër, naa, kaq, sa ungjilli...

— Ç'thua, o dajë Gjini! Po përse në Rroboshtë do të fillojnë pasnesër nga mbjelljet? A s'i kemi fqinjë? A s'i kanë edhe ata tokat si tonat?

— Që ta ngas fjalën, fshat e zanat, shtëpi e ndërti! — tha plaku dhe u ul.

Po kryetari përsëri në të tijën:

– Ti, dajë Gjini, llafos si qëmoti! Ka ikur ajo kohë. Tashti bëjmë si na mësojnë librat. Ti, o dajë Gjini, je... je... frymë e vjetër!

A se frymë e vjetër! Plaku u ngrit e, tëk-tëk, me hap të shpejtë doli nga salla tërë inat; ndërsa gjindja shkulej së qeshuri duke pëshpëritur:

– Frymë e vjetër!... Frymë e vjetër!...

Ja, kështu ia morën nderin nëpër këmbë plakut...

Një javë më vonë ai u grind përsëri me kryetarin. Kishin mbetur pa u vjelë nja tridhjetë dynymë misër që i kishte mbuluar uji i lumit. Plakut i zuri goja lesh së thëni herë njërit dhe herë tjetrit që ta vilnin sa më parë atë misër.

– Do të shkojë dëm, gjynah! Është buka e fëmijëve! Vileni!

– Do ta vjelim, dajë Gjini, do ta vjelim! – iu përgjigj urtë e butë kryetari, i zënë me mendime të tjera.

– E kur do ta vilni?! Po ndenji edhe ca ditë në ujë, u thartua dhe as derrat s’e hanë!

– Ja, sa të bjerë uji...

– Po në u shtoftë uji! E po gjynah, bre, kryetar!

– Mos u nxeh, dajë Gjini! Kemi kërkuar të na sjellin një lundër nga rrethi. Me të do ta vjelim.

– Po ja s’të erdhi lundra?! Që ta ngas fjalën, duhet t’u thuash njerëzve që të hyjnë vetë në ujë e ta nxjerrin një sahat e më parë.

– Ç’thua, more dajë Gjini? Si qëmoti llafos ti. Sëmuren njerëzit, po të futen në ujë. Mirë them unë, ti je... frymë e vjetër!

Përsëri Gjini Jonuzit i dokëndisi keq kjo fjalë. U bë vrer dhe iku pa e zgjatur, duke trokëllitur në truall me shkopin e tij tërë gunga.

Të nesërmen u çakërrit, kur njëri nga pleqtë e fshatit i dha vaktin.

– Si u gdhive..., frymë e vjetër! –i tha vërsniku dhe qeshi duke mbajtur ijet me duar.

– Oj! Ç’është ky llagap që më keni ngjitur? – u zemërua plakut.

– Po kështu thotë tërë fshati, o frymë e vjetër!...
Më tej Gjini Jonuzi ta koi edhe fshatarë të tjerë. Edhe ata nuk ia përmendën emrin:

- Mirëmëngjes, frymë e vjetër!
- Ndize njëherë, o frymë e vjetër!
- Nga vete kështu, o frymë e vjetër!

Dhe që atëherë plakut nuk i tha më njeri as gjysh, as dajë Gjini e as Gjini, por frymë e vjetër.

Ja, kështu ia morën nderin nëpër këmbë plakut...

Një ditë rrinte mbi një ledh në të hyrë të fshatit dhe mendonte për emrin e tij të ri. Nuk e gjente me vend që ia kishin vënë atë emër. Ja, të themi, se ishte pakëz zevzek e grindavec, po për këto s'kishte pse ta quanin frymë e vjetër. Megjithëse plak, ai ishte ende i zoti i punës dhe i vetes. Sytë e veshët nuk e kishin lënë. Edhe mendjen në vend e kishte. Është e vërtetë se me atë kryetarin e kooperativës nuk i kishte punët aq mirë. Po në s'i kishte mirë, nuk ishte fajtor Gjini Jonuzi. Në grindej nganjëherë, grindej se i kishte fajet vetë kryetari.

«Që ta ngas fjalën, – mendonte plaku duke pirë duhan ulur aty mbi ledh, – që ta ngas fjalën, unë nuk jam frymë e vjetër, sepse, po të isha i tillë, do ta mësoja për keq kryetarin. Po, që thua ti, unë për keq nuk e kam mësuar. Ja, mbjelljet akoma s'i kanë mbaruar, sepse nuk më dëgjuan. Edhe misri po kalbet atje në ujë. Po të më kishin dëgjuar, tashti do të bënim kërcmë. Po, që thua ti, unë vajta për lesh e dola i qethur. Më varën teneqenë prapa dhe ma harruan emrin! Jo, po kjo nuk është e drejtë! Dale ta marrim shtruar-shtruar e ta zgjidhim punën më pe e më gjilpërë! Që ta ngas fjalën...»

Ndërkaq një gaz gjashtëdhjetenëntësh, që kërcente si top në rrugën tërë gropa e baltë, ia preu mendimet Gjini Jonuzit. Makina qëndroi para tij, po nuk u shua. Zbriti që andej një djalë i ri, i gjatë, leshverdhë dhe duke qeshur ia shtrëngoi dorën plakut.

- Si je, o dajë?
- Mirë, besa...
- Si vini këtej? – pyëti djali dhe, pa marrë përgjigjen,

vazhdoi: S'i keni mirë punët me mbjelljet, o dajë, i filluat vonë.

– Hë-hë! – i dha të drejtë plaku duke tundur kokën.

– Edhe atë misrin atje afër lumit e latë të kalbet. Pse s'u mblodhët e ta nxirrnit, apo prisnit vaporët. Gjynah!

– Hë-hë! Gjynah, vërtet! – ia bëri plaku përsëri duke fërkuar me pëllëmbë mjekrën e ashpër. E vështroi djalin me vëmendje dhe e pyeti: Që ta ngas fjalën, kush je ti, o shok? Je i deleguar apo përgjegjës?

– Sekretari i partisë të rrethit jam, o dajë.

– Ah! Ti qenke? Emrin ta kam dëgjuar, po ftyrën s'ta kisha parë, – tha plaku dhe ia shtrëngoi dorën edhe një herë.

– Po ty, si ta thonë emrin, o dajë? – e pyeti sekretari.

– Mua?... – Frymë e vjetër!

– Sii?! – u habit dhe qeshi sekretari. – Ç'është ky emër!

– Emri im.

– Frymë e vjetër?!

– E, ore, frymë e vjetër! Që ta ngas fjalën, këtë emër ma ka vënë kryetari ynë – dhe plaku ia tregoi tërë historinë, si kishte ndodhur, më pe e më gjilpërë.

– Hip në makinë, o dajë Gjini! – e ftoi sekretari duke e ndihmuar që të hipte. – Hajt të shkojmë në fshat e ta zgjidhim në vend këtë punë. Me sa kuptoj unë, ti paske pasur shumë të drejtë.

Plaku zuri vend prapa në makinë, kurse sekretari u ul përpara, më krah të shoferit që qeshte me lot. Sa u nis makina, plaku i ra në sup sekretarit dhe i tha me gjysmë zëri, i gëzuar:

– Me këtë emrin e ri sikur u mësova dhe më pëlqen të më thonë frymë e vjetër, se plak jam. Po, që ta ngas fjalën, bëre mirë që erdhe. Jo për gjë, po që ta marr vesh edhe unë se kush është me të vërtetë frymë e vjetër në fshatin tonë!

11. Két feladatból válaszolj! (Összesen 12 pont)

1. A függvény $f(x) = \sin(x) + \cos(x)$ deriváltját keressd meg!

2. A húr egy 100 cm hosszú szálból készült. A húr egyik végénél a másik végéig 100 szeresére nő a feszültség. Mennyi a húr megnyúlása?

3. Egy 2000 g tömegű testet 10 m/s sebességgel dobunk fel. Mekkora a test maximális magassága?

4. Egy 100 g tömegű testet 100 cm magasról engedjük le. Mekkora a test sebessége a föld felé esés közben?

5. Egy 1000 cm^3 térfogatú gázt 100 kPa nyomásra összenyomunk. Mekkora a gáz térfogata?

6. Egy 100 g tömegű testet 100 cm magasról engedjük le. Mekkora a test sebessége a föld felé esés közben?

7. Egy 1000 cm^3 térfogatú gázt 100 kPa nyomásra összenyomunk. Mekkora a gáz térfogata?

8. Egy 100 g tömegű testet 100 cm magasról engedjük le. Mekkora a test sebessége a föld felé esés közben?

9. Egy 1000 cm^3 térfogatú gázt 100 kPa nyomásra összenyomunk. Mekkora a gáz térfogata?

10. Egy 100 g tömegű testet 100 cm magasról engedjük le. Mekkora a test sebessége a föld felé esés közben?

11. Két feladatból válaszolj! (Összesen 12 pont)

1. A függvény $f(x) = \sin(x) + \cos(x)$ deriváltját keressd meg!

2. A húr egy 100 cm hosszú szálból készült. A húr egyik végénél a másik végéig 100 szeresére nő a feszültség. Mennyi a húr megnyúlása?

3. Egy 2000 g tömegű testet 10 m/s sebességgel dobunk fel. Mekkora a test maximális magassága?

Nga vëllimi
«TREGIME
TË ZGJEDHURA»

1973

CONFIDENTIAL

SECRET

PLAGËT

– Kam urdhër të të tërheq e të të shpie në spital! Ke marrë tri plagë dhe ke humbur një kovë me gjak! E ç'pret më? Shoshë kërkon të bëhesh! Ngrehu! – jepte e mernte infermieri që ta bindte, herë duke iu lutur, herë duke e sharë, herë duke u munduar me zor ta hidhte mbi kurriz e ta tërhiqte.

Selmani mernte nishan gjermanët që ngjiteshin për-pjetë grykës tërë shkurre e gurë, zbrazte belgjikun dhe i përgjigjej infermierit me nervozizëm.

– S'është tretur akoma ai plumb që do të më vrasë!
Gjersa kam shpirt ndër dhëmbë, s'luaj që këtej!

– More Selman, more shok! A kupton...

– Më lër, të them...

– Kam urdhër nga komandanti! Ngrehu!

Për herë të parë Selmani u nxeh:

– More, a shikon ç'bëhet? Na hipi gjermani dhe ti më thua të ngrihem! E ku të vete?! Mbytu me gjithë spital! Nuk ndahem nga shokët!

Infermieri ia lidhi plagën në pulpën e këmbës dhe filloi t'i fshinte me pambuk gjakun e mpiksuar midis gishtave. I thoshte i zemëruar:

— Ke një derro kokë ti, more djalë, që mos e pastë njeri! Na! Më sa merr vesh ky, aq merr vesh edhe koka jote, — dhe i ra me noçkë një guri.

Gryka gjëmonte nga krismat e armëve. Plumbat fish-këllenin, skërmisnin shkëmbinjtë, nguleshin në trungjet e pishave dhe në mish të njerëzve. Një mjegull e lehtë si tyl ngjitej përpjetë dhe shkrihej në hapësirën e kaltër.

Selmani kafshonte buzët, shtrëngonte nofullat dhe qëndronte me shpirt ndër dhëmbë. Ishte a s' ishte njëzetvjeç djalë, i shkurtër, i shëndoshë, korrozi, me një palë mustaqe të rralla nën një hundë me kurriz. Brenda një ore ishte plagosur tri herë. Dy plagë kishte marrë në bark, shkarazi, dhe një në pulpën e këmbës së djathtë. I zhytur i tëri në një pellg gjaku, ai merre nishan me belgjikun e tij dhe qëllonte gjermanët që përparonin vazhdimisht.

— Ja kështu, shtrirë mbi dyfek të mbetem, nuk luaj që këtej pa thyer qafën këta djaj! — i thoshte infermierit që mbledhte në çantë ilaçet dhe bëhej gati të shkonte.

— Do t'i them komandantit të vijë vetë...

— Atë nge ka komandanti! Atij i del tym nga koka. Pa shiko, shiko sa u afruan!

Në çast shpërtheu një batare pushkësh e mitralozash. Majat e shkurreve binin përdhe, sikur i kosiste njeri. Selmani hoqi me dhëmbë rezkën e bombës dhe hapi krahun. I theri barku dhe për pak bomba desh i shpëtoi nga dora. Mblodhi veten dhe e flaku. Strukur prapa gurit ai dëgjoi shpërthimin e bombës dhe në çast zërat e shokëve:

— Përpara!

— U hodhën në sulm! — pëshpëriti dhe, duke ngritur kokën, bëri gati bombën tjetër. Tatëpjetë grykës vraponin disa ushtarë. Kafshoi buzën fort dhe hapi krahun përsëri. Bomba fluturoi dhe plasi mu në mes të gjermanëve. Selmani nuk pa gjë. Në çast iu mor fryma, pushka i ra nga duart dhe vetë u përku nga prapa. Infermieri e priti ndër duar duke klithur:

— Ah!

Selmani u drodh kur infermieri i vuri fashën në ballë, aty ku filloi të buronte një vazhdë tjetër gjaku.

– Ç'bëre, more Selman! – belbëzoi infermieri dhe buza iu drodh.

Partizani hapi sytë e turbullt dhe pyeti mbytur:

– U thyen?

– E këputën qafën! – u përgjigj infermieri.

– Pa më... mbaj... t'i shoh... pak!

Infermieri ia ngriti kokën me kujdes.

– Nuk shoh gjë! – belbëzoi Selmani me sytë gjysmë të mbyllur. U dha një të shtyrë bërrylave të mbështetur në tokë dhe u ngrit edhe më.

– I shoh, djajtë! U thyen!.. Tani, o shok,... po deshe... shpjemë ku të duash, – i tha dhe i ra të fikët.

* * *

E ndiente veten sikur e kishin shtrirë mbi gjemba. Këta gjemba prej hekuri i shponin kurrizin dhe i dilnin mbi bark, në këmbë dhe në lule të ballit. I therte tërë trupi dhe nuk mund të lëvizte as edhe një qime të kokës. E megjithëkëtë ai lëkundej sa majtas-djathtas, sa lart-poshtë dhe i merreshin mendtë e i vinte për të vjellë. Iu morën mendtë edhe kur u mundua të hapte sytë e të vështronte se ku ishte. Nuk pa gjë tjetër, veç perdes prej mjegulle dhe ca njolla të shkëlqyeshme që shkonin e vinin para syve të tij të lodhur. Ishte si në një kllapi ëndrre, kur njeriu kërkon të lëvizë e s'lëviz dot, kërkon të ecë e s'ecën dot, kërkon të flasë e s'thotë dot asnjë fjalë.

Papritur, dëgjoi një zhurmë shurdhuese dhe hapi sytë. Po i mbylli përnjëherësh. Zhurma u pre dhe vendin e saj e zuri një shpërthim i pafund bombash e predhash. Një flakë e madhe mbuloi çdo gjë. Midis asaj flake pa veten e tij. Ai s'duroi më, hapi krahët dhe vrapoi përpara duke thirrur si ndonjë i çmendur.

– Selman! Selman! Selman! – dëgjonte nëpër kllapi një zë njeriu që i kujtonte zërin e infermierit.

Me ngadalë, sikur t'i ishin ngjitur me zamkë, ai ngriti kapakët plumb të rëndë të syve. Pa qiellin, një qiell të

mahnitshëm vjeshte, të kaltër dhe me shtëllunga resh të buta e të bardha. Ah, sikur të shtrihesh mbi ato re të buta dhe era të të sjellë vërdallë në hapësirën pa fund! Po sa re të çuditshme e të bardha që janë. Pambuk e kaluar pambukut! Me siguri ato janë të buta, të buta si push! Sikur të ishte atje dhe jo në këtë vend tërë gjemba që lëkundet poshtë e lart, majtas e djathtas! Po vërtet, ku gjendet kështu Selmani! Ku është shtrirë? Ku ka fjetur këtë natë?

Ai i hapi sytë krejt, megjithëse dielli, sado që i fshehur prapa reve të bardha, ia vrau. Përveç qiellit me ato re të bukura, pa edhe një copë leckë që i varej mbi syrin e djathtë. Lecka lëkundej si ndonjë tra, tamam mbi syrin e tij të djathtë. Ngriti dorën për ta larguar atë fije pëlhure që i rëndonte mbi sy. Por dora i mbeti përsëri e varur diku, mbi një copë dërrasë. Diçka tha me vete, u shëmtua në fytyrë dhe, si ngriti krahun, lecka fluturoi në hava. Atëherë dalloi mirë qiellin e mahnitshëm me re të bardha dhe poshtë tij ca maja malesh të gjelbra e të verdha, plot shkëlqim. Dhe nën këto maja malesh, fare afër, një pëllëmbë përtej hundës, dalloi një copë dërrasë që vinte e ngushtohej te këmbët. I erdhi inat sa gati plasi. Tani ai, duke kujtuar ç'kishte ndodhur, kuptoi mirë se ku ishte dhe ku po e shpinin. Nga inati lëvizi vetëm kokën, por iu duk sikur lëvizi gjithë qiellin. I dhembti koka, përsëri u shtrembërua në fytyrë nga dhembja dhe mbylli sytë që të mos i merreshin mendtë. Kur i hapi, dalloi mu te maja e hundës fytyrën e njohur të infermierit.

— Ore i poshtër, ku më paske vënë kështu? — e shau duke e mbledhur mendjen top.

Infermieri rrudhi sytë, tregoi dhëmbët e tij të bardhë qumësht dhe, duke fshirë sytë e përlotur që vetë-tinin nga gëzimi i brendshëm i papritur, tha:

— Ama u përmende?! Tani copë le të bëhet! Je gjallë, Selman!

— Ore i poshtër! Po kush tha se kam vdekur!

— Je gjallë, vërtet gjallë!

Selmani ndjeu një peshë të rëndë e të qullur mbi gojën e tij, dhe, kur kjo peshë u largua, tha:

— More i poshtër, në tabut më ke vënë? Po ç'kujtove ti, se unë kam shpirtin tënd? Nuk vdes unë! More, ç'njerëz të ndyrë ka kjo botë! Kushedi sa kohë ke që pret vdekjen time! Mblidh mendjen, vdekja do të vijë kur të mbush njëqind e një dhe, bile, një çikë më shumë se njëqind e një.

— Je gjallë, Selman! Je gjallë! Veç mos lëviz shumë! Dale të të puth edhe një herë — dhe përsëri Selmani ndjeu mbi buzët e tij buzët e ashpra, të kripura e të qullura të infermierit!

— More tutkun, mos më puth, po më trego ku më ke vënë, — e pyeste Selmani i përdëllyer nga dashuria e shokut.

Infermieri fshiu sytë me grusht dhe iu përgjigj me zë të lartë, sikur mbante fjalim, por edhe sikur shante njeri:

— Do të dish ku të kam vënë?... Në tabut të kam vënë. Po ç'kujtove ti, se do të të mbanim në krahë një natë të tërë? E gjetëm tabutin të gatshëm mu te dera e xhamisë. «Merreni! — na tha hoxha, — s'është tabut, po govata ku lajmë të vdekurit!...»

— Ore! — ia preu fjalën Selmani që vështronte me sy të venitur sa majtas-djathtas. — I poshtër paske qenë, bre!...

— Më shaj sa të duash, veç mos luaj kaq shumë, se do të të hapen plagët!

Selmani, i gëzuar që ishte ende gjallë dhe i përdëllyer nga fjalët e shokut të tij, u shkri fare dhe për një çast i harroi krejt dhembjet e plagëve. Mbylli sytë dhe humbi në ëndërrime. Iu kujtua fshati i tij i humbur midis maleve, kopeja me dhi që ai kulloste, shkopi i agait që ai hante mbi kurriz dhe ylli i kuq që mbanin në kapelë ca njerëz të armatosur. Dhe përsëri erdhi në vete. Për herë të parë pas aq orëve fytyra e tij shndriti nga një e qeshur e padukshme dhe tha:

— O infermier! O lugat! Përse nuk më thua të vërte-

tën?... Ti kujtove se unë mbarova, prandaj edhe më vure në govatën ku lajnë merhumët!

Infermieri ia fshiu djersët nga balli dhe iu përgjigj duke qeshur:

— Sa për mua, ti kishe mbaruar me kohë! Mirëpo paske shtatë shpirtra! Tani që u përmende, shpëtove! Hallall e paç këtë jetë, se ke luftuar gjer në pikën e fundit të gjakut!... Si e ndien veten tani?

Selmani e vështroi me dashuri:

— Sikur më ke shkuar në hell e po më pjek!

Pushuan pak në një lëndinë pylli rrethuar me dushk. Ishin mbi njëzet veta, shoqërues e të plagosur. Por në tabut kishin vënë vetëm Selmanin. Të tjerët ecnin vetë. Jo! Ishte edhe një tjetër që e mbanin në krahë! E kishin vënë në kapotë. Ja ku e lëshuan me kujdes mbi lëndinë, pranë Selmanit.

— Kush është ky këtu? — pyeti Selmani duke bërë me dorë nga i plagosuri.

— Një shoqe, — iu përgjigj infermieri me zë të ulët.

— Shoqe?! Cila?!

— S'është nga batalioni ynë. Nuk e njoh!

— Është plagosur rëndë?

Infermieri i pëshpëriti në vesh:

— Predha ia ka prerë të dyja buzët, si me thikë.

Ka edhe nja dy plagë të vockla nëpër trup... U enjt së qari. «U shëmtova», — thotë!

Selmani e vështroi të plagosurën me bisht të syrit. Dalloi një tufë flokësh korb të zinj, ca fasha të përgjakura, supet e saj që lëkundeshin prej ngashërimit dhe i erdhi keq për të.

— E po, si i bëhet kur mbetesh pa buzë? A ka ndonjë ilaç? — pyeti Selmani me zë të ulët që të mos e dëgjonte e plagosura.

— Ka, posi! Të ngjisin një palë të reja...

— Bre! Po ku i gjejnë? Të vdekurve ua këpusin?

— Jo, joo! Të presin një copë mish këtej, nga tulet, e ta ngjisin aty ku duhet...

- Gënjen ti, lugat.
- Për perëndi, jo!
- Çudi! - ia bëri Selmani, vështroi partizanen e plagosur dhe ra në mendime.

* * *

Në spitalin partizan koha shkonte shumë ngadalë dhe shpesh dukej sikur mbetej në vend. Errësira nuk largohej kurrë nga qoshet e dhomave përdhese të ndriçuara nga ca dritare të vockla si frëngji, ashtu si nuk largohej era e rëndë e ilaçeve dhe e gjakut. Të plagosurit, të vendosur njëri pas tjetrit si gjethet e duhanit në varg, ngulnin sytë në tavanin e zi, psherëtinin e rënkonin dhe rrallë e tek këmbenin ndonjë fjalë e bënin ndonjë shaka. Kur ishte kohë me diell, ata që ishin më mirë, dilnin në lëmë e kënaqin sytë duke parë natyrën. Po, kur binte shi, ata grumbulloheshin nëpër dhomat dhe pëlcnin nga mërzia! Po çfarë nuk duron njeriu në këtë jetë?!

Selmanin e vendosën pranë një frëngjie nga vështrointe një copë qiell dhe majën e zhveshur të Tomoricës. Mjeku, një djalë i ri që i kishte lënë mësimet përgysmë dhe që nuk qeshte kurrë, ia mjekoi plagët menjëherë.

- Paskë qenë kasap e jo doktor! - i tha Selmani që shtrëngonte dhëmbët për të mos thirrur.

- Duro një çikë, duro!

- Nuk thashë se s'duroj, po thashë se qenke kasap! Infermieri i batalionit tonë është më i mirë se ti.

- Ashtuu?

- E ka dorën të lehtë. Kurse ti s'ditke gjë tjetër veç të presësh mishin me gërshërë e të thuash: «Duro, duro!...»

Pas mjekimit Selmani ra në një gjumë të thellë e të rëndë, sikur t'i kishin dhënë opium dhe u zgjua të nesërmen pasdite. Kur hapi sytë dhe pa qiellin e kaltër përmes frëngjisë, e ndjeu veten aq të lehtë, sa ishte gati të ngrihej e të merrte malet. Mirëpo në çast i therën plagët dhe nxori një psherëtimë të lehtë.

– E, a u zgjove? Ama gjumë ke bërë! – tha doktori dhe u ul më bisht pranë tij për t'i mjekuar plagët.

– Ti, shoku kasap, qenke?... Bëj punën, bëj! – tha i pakënaqur Selmani dhe, si vuri mbi sy llërën e dorës për të mos parë, pyeti: – Si duken bathët, shoku doktor, do të më nxjerrësh shpejt që këtej?

– Nuk thua shyqyr që shpëtove! Një qime të ka ndarë nga vdekja!

– Do të bëhej dëm i madh fort! – tha me tallje Selmani. – Po, këtu m'u përgjigj, a do të më shërosh shpejt?

– Pas një muaji...

– E po, çka, nuk qenka shumë. Një javë për një plagë!... Aty nga fundi i javës Selmani pyeti papritur:

– Shoku doktor, si është ajo partizanka që është plagosur në buzë?

– E ke gjë ti që interesohesh?

– Ç'përgjigje që më dhe! Gjersa është partizane, shoqe lufte e kam.

– Ka mbetur pa buzë.

– Këtë e di.

– Plasi së qari. S'di edhe unë si ta pushoj. I kishte thënë infermieres: «E si të mos qaj! Pa shih si më kanë mbetur dhëmbët jashtë. E zeza unë, do të mbetem pa martuar!»

Selmanit i vinte keq shumë për atë vajzë të panjohur dhe kishte dëshirë ta takonte, të njihej e të bisedonte me të. Duke vështruar nga frëngjia majën e zhveshur të Tomoricës dhe mbi të qiellin që herë kaltërohej dhe herë vrenjtej, ai gjithnjë e më tepër sillte ndër mend partizananen e plagosur. Dhe s'kishte ditë që të mos pyeste doktorin dhe infermieren plakë:

– Si është sot Fatmira?

Dalëngadalë ai krijoi në mendjen e tij edhe pamjen e saj. Duke u nisur nga ajo tufë flokësh të zinj që i kishte parë te lëndina në pyll, Selmani mendonte se ajo do të ishte zeshkane me sy të zinj, me vetulla të zeza. Dhe nuk u gënjeje. Fatmira ishte me të vërtetë e tillë.

Një ditë ai u ngrit ndenjor. Ishte e para ditë që mundi të lëvizte. Nga frëngjia nuk pa vetëm copën e qiellit dhe majën e Tomoricës, por edhe grykat që zbrisnin tatëpjetë malit, brigjet e gjelbëruara, fshatrat e vogla dhe oborrin e spitalit. Iu duk sikur nga ajo frëngji pa tërë botën. Në oborr ishte një dushk, pas të cilit ishte kacavarur një pjergull plot rrush ende të papjekur. Nga fletët e pjergullës e të dushkut rridhnin pika vese të shndritshme. Këto pika vese i kujtuan Selmanit lotët e vajzës së plagosur dhe shpirti iu mallëngjye.

Atëherë me zor të madh, duke u mbajtur pas murit, u ngrit me një këmbë dhe kërceu një gjysmë hapi përpara. I çau tërë trupi, po nuk ra. Shtrëngoi nofullat dhe e mbajti veten. Bëri edhe një kërcim tjetër.

– Ku shkon, Selman! – i thirri mjeku i zemëruar duke e mbajtur për krahu.

Partizanit i erdhi rëndë t'i tregonte se për ku ishte nisur. Prandaj e gënjeu:

– Provova fuqinë, shoku doktor!

– Ky budallallëk mund të të kushtojë shtrenjtë! – e shau mjeku dhe e shtriu në dyshekun e fortë prej kashte.

Dhe vërtet i kushtoi. Plagët iu lënduan dhe iu keqësuan. Vetëm në fund të muajit doktori mbështeti në mur patericat dhe e lejoi të ngrihej.

– Tani mund të shkosh gjer në oborr!

Po Selmani nuk shkoi në oborr. U drejtua për në dhomën tjetër dhe, menjëherë, që nga pragu i derës, pa në qoshe tufën e flokëve të zinj. Vajza ishte kthyer me fytyrë nga muri. I dukeshin vetëm shpatullat. Tamam ashtu e kishte parë edhe atë ditë te lëndina e pyllit. Zemra e Selmanit rrahu me të shpejtë dhe ai nuk guxoi të kapërcente prapun.

– Fatmirë! – thirri që nga dera.

Vajza ktheu kokën dhe pyeti, duke i shqiptuar me zor dhe keq fjalët.

– Kush je ti?

– Një i plagosur, si ti.

– Pa si ma paske mësuar emrin?

– Me të pyetur, – u përgjigj Selmani dhe hyri në dhomë duke u mbajtur me zor mbi patericat.

Vajza kishte dy sy të mëdhenj, të zinj, të fryrë e të shndritshëm. Ajo i fshiu me grusht, vuri pëllëmbën mbi buzën e lidhur me fasha dhe e pyeti.

– Ke kohë që je plagosur?

– Atë ditë që je plagosur edhe ti. Na kanë sjellë të dy së bashku në spital.

– Unë s'mbaj mend!...

– Kurse unë të mbaj mend mirë. Të kishin shtrirë mbi një pallto. Ti kishe rënë më krah dhe qaje...

Vajza psherëtiu:

– E ç'të mos qaj...

– Budallaqe! Unë mora katër plagë e s'derdha asnjë lot, – i dha zemër Selmani, po partizania iu përgjigj:

– Ti je djalë! Kurse unë... unë... – dhe nuk vazhdoi dot më, se e mbyti ngashërimi.

Selmani mbeti në këmbë me patericat nën sqetull dhe s'dinte si ta vazhdonte bisedën. Vështronte flokët e pakrehur të vajzës, ballin e saj të lartë, sytë e saj të përlotur, kraharorin rinor që i hidhej përpjetë prej pshëretimave dhe nuk dinte si të bënte: të ikte apo të qëndronte. Nië ndjenjë e fortë dhembshurie ia pushtoi shpirtin dhe në të njëjtën kohë u zemërua me veten e vet që s'qe i zoti ta bënte partizanen të pushonte.

– E, more shoku Selman, si e ndien veten? A mbahesh dot mbi këta hunj? – e pyeti doktori që zgjati kokën te dera e dhomës.

Selmani bëri një rrotullim të shpejtë dhe, duke dalë çalë-çalë, u përgjigj i zemëruar:

– Unë u shërova! Të falem nderit! Po atë kur do ta shërosh? Atë shëroje, në je me tërë mend doktor!

Mjeku ngrysi vetullat:

– Asaj ç'kam ç't'i bëj më shumë!

– Atëherë s'je doktor. Njëqind herë më i mirë është infermieri i batalionit tonë! – përfundoi Selmani tërë inat dhe shkoi fill e në shtratën e vet të fortë gur.

Selmani ngrihej në mëngjes më herët se gjithë të mlagosurit e tjerë. Sa hapte sytë, ndiente një boshllëk të madh në zemër, po edhe një gëzim të madh se do të takohej përsëri me Fatmirën. Një forcë e çuditshme e shtynte gjithnjë drejt dhomës së saj. Dhe ai filloi të hynte në atë dhomë pa druajtje. Ulej pranë vajzës, lëshonte patericat midis këmbëve, mbështeste kurrizin në mur dhe fillonte bisedën me vajzën e re. Brenda pak ditësh ata u njohën aq shumë, sa i zbuluan njëri-tjetrit të tëra të fshehtat e shpirtit. Ishin të dy fshatarë, të dy nga një krahinë, po jo nga një fshat. Të varfër e të etur për liri, rrëmbyen pushkët e dolën malit. Dhe ja ku rrinë të dy në një dhomë përdhese, duke pritur që t'u shërohen plagët e të kthehen nëpër repartet e tyre. Po, ndërsa Selmani e priste këtë ditë me gëzim, vajza rrinte gjithnjë e mjeruar dhe, sa herë i kujtohej plaga që kishte marrë, oante. Duke parë lotët e saj, zemra e Selmanit ndrydhej dhe pikonte vrer. Po ai s'qe i zoti t'i kthente asaj qëzimin e lumturinë, gjersa këto nuk ia kthente dot as mjeku. Vetëm e ngushëllonte me fjalë:

— Mos qai, se nuk nxjerr qjë nga lotët! Fundia ajo është plagë që ke marrë në luftë. Njerëzit, kur të të shohin, do të thonë: «Ja një partizane trime që ka luftuar me armë në dorë!»

Nganjëherë ai ia kthente me shaka. Mirëpo as nau-shëllimet dhe as shakatë nuk e qetësonin vajzën. Dhe ajo kishte të drejtë. Për këtë u bind më në fund edhe vetë Selmani, kur rastësisht ia pa plagën. Po hynte në dhomë të saj; por, me të parë mjekun që po ia zgjidhte fashat qëndroi te dera. Kureshtia e shtyri të shihte dhe zajati kokën. Iu mbajt fryma. Mbi gojën e vajzës, në vend të buzëve dalloi ca copëra mish si ajak dhe prapa tyre dhëmbët e vegjël e të bardhë qumësht. Iu drodh shpirti dhe nuk mundi të shihte më se si mjeku po e operonte dhe po i ngjiste një palë buzë false...

Të nesërmen ai u ngrit përsëri më parë nga të gjithë dhe shkoi fill e te Fatmira. E zgjoi nga gjumi dhe i tha i gëzuar:

– Kësaj radhe shpëtove! Doktor i më tha se ta rregulloi buzën tamam siç e kishe!

Sytë e saj sikur shkëlqyen nga një gëzim i brendshëm. Po, për të folur, nuk fliste dot. Vetëm, i luajt i kokën në shenjë mohimi.

– Për ideal, të them! Dhe a e di se ç'doktor është ai! Kokën të prerë ta kesh, ta ngjit e të ngjall! Veç mos qaj.

Vajza rënkoi dhe iu mbushën sytë. Ai e zuri për dore dhe pa dashje ia shtrëngoi. Kishte një dorë të ngrohtë punëtoreje.

– Mos qaj, dëgjon?

Një pikë lot rrodhi nga syri i saj i zi. Ai ia fshiu me gisht duke ndier një të ngjethur të lehtë nëpër trup dhe në çast faqet iu bënë flakë.

– Do të shërohesh, Fatmirë, dhe përsëri do të jesh midis shoqeve, – i thoshte duke ia fshirë lotët me gisht.

Erdhi dita që të ndahen dhe ndoshta për të mos u takuar kurrë. Rrugët e luftës nuk janë të drejta. Ato janë rrugë malesh e pyjesh, rrugë përrenjsh e lumenjsh, rrugë fshatrash e qytetesh. Nëpër këto rrugë të luftës, të çara nga plumbat e të gërryera nga gjylet, njeriu mund të humbë përgjithnjë dhe mund të mos takohet kurrë më me njerëzit e afërm e me shokët e tij... E ku dihej ç'e priste Selmanin që ishte ngjeshur me rrip e me armë e qe bërë gati për të shkuar te batalioni i tij!

– Rri me shëndet, Fatmirë! Vdekje fashizmit! – i tha ai dhe i shtriu dorën e tij të madhe e të fuqishme.

– Liri popullit! – u përgjigj ajo me zor duke ia shtrënguar dorën.

– Dhe mos qaj!

Vajza psherëtiu!

– Unë jam një shëmti! – tha ajo në kulm të dëshpërimit dhe i ktheu krahët.

Me hap të rëndë e të ngadalshëm Selmani doli në oborr. Aty vështroi qiellin e mbushur me re të bardha e të zeza, ngjeshi mirë rripin dhe hodhi hapin e parë. Po qëndroi menjëherë. Në kurrizin e dorës i ra një pikë

vesë. Nga fletët e dushkut e të pjergullës rridhnin pikat e kulluara të vesës dhe këto i kujtuan edhe një herë Fatmirën. U kthye përnjëherësh dhe shkoi drejt e në dhomë të partizanes. U përkul mbi të, ia ktheu kokën dhe e pyeti:

– Pa ma thuaj edhe një herë atë fjalën e fundit? – Fatmira mezi e kuptoi se ç'kërkonte ai. Selmani e uli zërin dhe ia mori dorën në pëllëmbë: – Fatmirë! A ma jep fjalën që kur të mbarojë lufta...

Ajo u step dhe tundi kokën:

– Po ti nuk më ke parë sa e shëmtuar jam.

– M'u përgjigj, a ma jep fjalën që kur të mbarojë lufta... të bëhesh gruaja ime?

1960

I FUNDIT

Dilaveri shtyu me pëllëmbë kanatin e dritares së vogël dhe vuri veshin. Matanë gardhit që rrethonte kopshtin, përmes gjelbërimit të pemëve, shndrisnin rrasat e çative të lagura nga vesa dhe dukej fshati që shtrihej nga maja e pllajës e gjer buzë xhadesë së automobilave. Një krismë pushke çau ajrin.

— Ndrekkollarët, — pëshpëriti Dilaveri duke ngulur vështrimin te një shtëpi, mbi të cilën bënte hije një arrë e moçme. Pas pak ai mundi të dallonte në oborrin e asaj shtëpie vetë plakun, Ndrekon, me të bijtë që vunë përpara qetë dhe bënë nga xhadeja.

Një krismë tjetër shpërtheu prapa gardhit të kopshtit. Dilaverit iu duk sikur plumbi u ngul në qoshen e shtëpisë.

— E zbrazi edhe Çaloja! — pëshpëriti me qesendi dhe pa të dilte që prapa një mullari me bar komshiun e tij me një dogra në sup e me një ka të zgjebosur përpara. Komshiu i ra kafshës me një purtekë dhe çalë-çalë bëri edhe ai tatëpjetë për nga xhadeja, i ndjekur nga e shoqja, që seç jepte e merrte me duar e me këmbë. Po Çaloja as që e ktheu kokën dhe as që ia vuri veshin

dhe gruaja mbeti pranë një lesniku me kokën midis pëllëmbëve.

Krismat e pushkëve u dendësuan. Ato binin nga lindja, te kalibet e çobanëve, nga perëndimi, te djemtë e Hysenit, buzë xhadesë, te Bankallarët dhe buzë përroit ku ishin ndërtuar varg njëra pas tjetrës shtëpitë e Shehlerëve, të Muçollarëve e të Sykajve. Njerëzit dilnin nëpër lëmenjtë me dyfeqe nëpër duar, merrnin nishan qiellin e kaltër dhe qëllonin. Dikush e zbrazte nga dera e ahurit e dikush nga dritaret. Osmani e zbrazti majë çatisë ku kishte hipur për të zënë pikat. Dhe pas këtyre krismave fshatarët nxirrnin nga ahuret qetë, rrëmbenin parmendat dhe zbrisnin tatëpjetë për nga xhadeja, te sheshi i shkollës.

Dilaveri rrinte i zymtë te dritarja dhe dëgjonte me ëndje krismat e pushkëve. Ato i kujtonin vitet e kaluara, luftimet nëpër malet kundër armiqve, djemtë e rinj që luftonin për liri. Në ato kohë, kur punët ishin keq, Dilaveri rrëmbente i pari në fshat maliherin e vet dhe shkante me djemtë, çante borën, futej përrrenjve, ngjitej majë maleve, rrinte pa bukë e gjumë dhe luftonte...

Kurse atë ditë ai nuk luajti fare nga shtëpia. Edhe atë ditë binin pushkët, po Dilaveri hapi vetëm kanatin e dritares e vuri veshin. Dhe, duke dëgjuar, menjëherë e gjente me mend se çfarë pushkë ishin ato dhe të kujt ishin...

Ndërkaq u përplas dera e dhomës dhe hyri si ndonjë tufan një djalë i ri, kuqalash, kokëqethur, me pushkë në dorë.

— Baba! A e dëgjon ç'po bëhet? E formuan kooperativën. Na mbeti radha neve! — tha i gëzuar, i ra llozit me pëllëmbë dhe qiti tytën nga dritarja.

Dilaveri nuk i foli, e pa vëngër dhe djalit i mbeti gishti te këmbëza e maliherit.

— Nuk do të jetojmë si qyaja, baba! Edhe në varr mos qofsh vetëm! Ja, për hair qoftë! E zbraza.

Djali mori nishan qiellin, po nuk shikonte shënjestrën e pushkës. Bebëza e bardhë e tij u ngjesh në cep të syrit

dhe vështronte pa lëvizur fytyrën e zyrtë të plakut. Dilaveri thithi duhanin, kroi gurmazin duke u kollitur dhe heshti. Dhe nga kjo heshtje djali e kuptoi mendimin e të atit dhe nuk guxoi të tërhiqte këmbëzën.

— Baba, po ndahemi nga fshati për së gjalli. Po ti më ke thënë se shqerrën që ndahet nga kopeja e çan ujkul! Për të mirën tonë na thonë që të bashkohemi! Një për të gjithë, të gjithë për një!

Plaku preku me dorë veshët e shënjestrës së maliherit dhe i fërkoj me gishtat tërë plasa, sikur donte t'u hiqte pluhurin. Pastaj ia mori të birit pushkën, hapi llozin, i fryu kot tytës dhe vuri fishekun në gushë. Ndërkaq i biri e mernte me të mirë dhe i lutej:

— Zbraze vetë, baba! Ja, e sheh këndeskën prej llamarine majë çatisë së Çalos? Bjeri asaj. Të shohim, do ta qëllosh dot, apo jo. Më kanë thënë se ke nishan. Po unë s'të kam parë. Pa hël!

Plaku mori nishan. Pushka nuk lëvizte në duart e tij leshtore. Dukej sikur ishte mbërthyer edhe ajo, edhe ai vetë.

— Jo andej, baba! Këndeskës bjeri! Fundi zbraze nga të duash! Njësoj është. Mjafton të japim edhe ne lajmin, si të tjerët. Hiqel — tha djali dhe priti me ankth krismën e pushkës. Por plaku hoqi faqen nga tyta dhe iu përgjigj shkurt, me zë të prerë:

— E kam zbrazur kur duhej. Tani vare në mur.

I biri u nxeh përnjëherësh dhe fytyra iu skuq më shumë, se ç'e kishte në të vërtetë.

— Mirë thonë se pleqtë kanë mbeturina në ndërgjegje. Dhe kanë, bile, edhe ata që kanë luftuar, si ti. Po unë e kam për detyrë të t'i shkul nga shpirti këto mbeturina, s'më kanë pranuar kot në radhët e Partisë! A e di se ti po shkël me këmbë gjakun e dëshmorëve? A e di se ti po bëhesh pengesë për ndërtimin e socializmit në fshatin tonë? Vëri gishtin kokës, baba! Pa mendo një çikë? Ti kërkon të jetosh me të vjetrën, po me të vjetrën nuk ecet përpara. E vjetra ta gërryen shpirtin si krimb, më keq se ç'ta ka gërryer. Ja ku të them, flaki mbeturinat dhe hyrë

në kooperativë. Të bashkohemi, se bashkimi bën fuqinë. Nië për të gjithë, të gjithë për një. Mjaft jetuam veç e veç, si avaet! Hyr që të bëhemi një familje e madhe, të jetojmë të lumtur e të na ketë zili bota...

Plaku e vështronte dhe tundte kokën, i zymtë. Dukej se fjalët e të birit këtej i hynin e këtej i dilnin. Më në fund ia preu:

— More Tosun, more djalë. Ne dy veta jemi, një lloj qajaku kemi, në një strehë jemi e s'merremi vesh. Kurse ti kërkon të na bashkosh me të tjerët, që të mos e marrë vesh qeni të zonë. Lëri llafet se janë fukarallëk dhe vare dyfekun në mur!

— Nuk e var! Nuk të dëgjoj më! Ka gjashtë muaj që po të shpieqoj me durim gomari të mirat e kooperativës, që po të lutem e po të bie në gjunië që të hysh. Po ti je qorruar nga mbeturinat, të ka zënë truri myk e nuk qijkon. Po unë kam për detyrë të t'i shkul me gjithë rrënjë këto mbeturina. Nuk është turp për ty, kur ta kalon edhe Osmani? Ja, edhe Osmani qenka më i mençëm se ti. E dha fjalën, dha edhe lajmin me dyfek dhe shkoi të hidhte edhe firmën.

Plaku, si duket, e humbi durimin dhe iu kthye të birit:

— E ç'humb Osmani që hyn në kooperativë, more halvan! Osmani tokë s'të ka, veç një skërke majë malit, haqëti s'të ka. qinë prej qinë s'ka. Osmani morra ka. Por edhe ata s'kanë për t'i shkuar dëm, peshqesh të tjerëve do t'ua çoië. Dhe nastaj do të vijë e të punoië tokën time me atë e mi. Dëajo, mor fyell, që m'i ke buzët me aumësht, dëajo se ma solle në majë të hundës. Var pushkën e aërohu ku ke për t'u qëruar.

— Domethënë nërsëri nuk bindesh! Mirë, pra! Ta punoj unë ty, — tha Tosuni, ia rrëmbeu pushkën, nxori tytën e saj naa dritaria dhe e zhrazi, jo një herë si kishin bërë të tierët, po një krehër të tërë. — Turoërohu tani në sy të botës! — shtoi djali i kuq flakë dhe doli rrëmbimthi.

Dilaveri tundi nërsëri kokën, mori pushkën që i biri e la në dritare dhe, duke e varur në mur, tha nëpër dhëmbë:

– A ç'më çukullite kokën, ore i biri i Dilaverit!
Dhe kështu familja e tij nuk hyri atë mot në kooperative...

* * *

Doli vjeshta, hyri dimri, ikën ditët dhe muajt, ra drapri nëpër ara, u fut misri nëpër kosheret dhe erdhi vjeshta tjetër. Kooperativa, si e re aë ishte, nuk vuri dot dhjamë. Dilaveri, si i zoti i punës aë ishte, e siguroi bukën. Atëherë iu kthye të birit e ta bëri për dy para:

– Ama për këtë jetë më flisje ti, ore tutkun? Naa nië grusht bereqet morën bota! E ku është parë aë të bëhet stan me lepui! Pa më kanë vënë coban të këtij stani Osmanin aë s'di naa lidhet qomari!...

– Do të vdesësh e s'ka kush të t'i mbvllë shtë, po hyr në kooperative, baba! – nuk hiqte dorë Tosuni nga këshillat e tij.

– Mos ki merak, nuk do të të mendoj, do të vdes me sy mbvllur.

Në fshat sikur ia harruan emrin Dilaverit. E thërrisnin individ. Kur e mori vesh kuptimin e kësaj fjale, nuk para i erdhi mirë, po s'kishte c'të bënte dhe duroi.

Nië ditë vere no voziste duajt naa fusha. E kishte naarkuar qerren dhe ecte para aeve me llullë në aoië, i zymtë, si aithnië. Nuk arriti të dilte në xhade se ia preu udhën karvani i qerreve të kooperativës.

– Pa mbaii aetë aty, o individ, sa të kaloimë ne aazë!
– e urdhëroi Osmani duke e vështruar me diallëzi me shtë e tij të veckël e të ziartë.

Dilaveri vuri hostenin nërpara zjedhës dhe aëndroi. Qëndruan edhe aetë, kurse qerret e kooperativës canë përpara varq niëra pas tjetrës, duke bërë zhurmë me rrotat aë fërkoheshin pas boshteve dhe duke naritur lart pluhurin e verdhë, aë binte si polen mhi manaferrat e përzhitura naa dielli. Fshatarët, aë atje tej kruanin aurmazin dhe i hidhnin rumuze e thumba. Dilaveri thithte

llullën, i përshëndeste dhe bënte sikur nuk i vinte re fjalët e tyre. Përpara tij kaluan fytyrat e njohura të njerëzve, së bashku me të cilët kishte ngrënë në një çanak. Ato ishin fytyra të rreshkura nga dielli, me flokë e vetulla të verdha nga pluhuri e byku, ashtu siç ishte edhe fytyra e tij. Po tani këta njerëz, me të cilët kishte pirë ujë në një burim, nuk iu dukën më si bashkëfshatarët e tij. Vërtet fytyra të njohura ishin, por ato sikur buzëqeshnin me dinakëri e me tallje dhe sikur i thoshin: «Vetë i ke fajet, o individ! Ti u ndave nga ne dhe jo ne nga ti!»

Karvani i qerreve të kooperativës ishte shumë i gjatë. Qetë, të lodhur, ecnin ngadalë dhe e bënë më të gjatë këtë karvan. Dilaverit i vinte inat sa s'pëlciste, po s'kishte ç'të bënte dhe priste kokulur duke vështruar me bisht të syrit në i dukej fundi karvanit.

– Mbeta në bisht! – murmuriti i zemëruar me veten e vet dhe, për herë të parë, e kuptoi se ishte ndarë me të vërtetë nga fshati.

Atë mot kooperativa vuri pak dhjamë dhe jeta e njerëzve sikur ndryshoi: Fshatarët dilnin nga klubi më të gëzuar, me ndonjë setër të re, me ndonjë palë bollka të mira, me ndonjë qylaf të bardhë si bora. Kur ktheheshin nga pazari, sillnin basmë të kombinatit për gratë e për fëmijët, një grusht kafe që e pinin në shtëpi të përzier me qiqër, ndonjë jastëk a jorgan. Dilaveri e vuri re këtë ndryshim, po përpara të birit, nuk e bëri veten. Vetëm i tha me qesendi:

– E ç'morën më shumë se unë?! Një grusht bereqet!

– Sot një grusht, nesër një thes! Kështu është kooperativa... Kurse ti, baba, ti u bërë më i keq se ujku, se edhe ujku që është ujku, nuk jeton vetëm në pyll!

Prapë nuk e dha veten Dilaveri, po thellë në shpirt e ndjeu se nuk kishte bërë mirë që u nda nga fshati. Filloi të lëkundej, të thyhej e të anonte nga kooperativa dhe, në mos atë mot, motin tjetër do të kishte hyrë në kooperativë, po të mos kishte ndodhur ajo që ndodhi. Uji u turbullua përsëri dhe mendja iu kthye Dilaverit dhe iu bë top.

Një pasdite të vrenjtur vjeshte po shkonte në mullin për të bluar një shinin misër. Kishte vënë përpara gjeshën plakë dhe ecte naadalë mbi tokën e butë të rrugës së rrahur nga potkonjtë, nga thundrat e nga rrotat e qerreve. E kishte humbur mendjen duke vështruar matanë shelgjeve që vesonin, parcelat e mërdha të kooperativës dhe nuk e vuri re se po ecte mbi një urë që nuk kishte qenë më parë. Atë urë e kishin ndërtuar kooperativistët mbi një hendek të thellë e të gjerë, mbushur me tinë e ujë, rrethuar me shelgjishta e manaferra. Dilaveri, kur u përmend dhe vuri re se ku po ecte, u qëzua shumë. se. po të mos ishte ura, do t'i duhej të futei në ujë e tinë qier mbi gju a më tepër. Po në cep të urës shtanau në vend. Mbi majat e ca qjembave dukej një copëz dërrasë ku ishin shkruar ca fjalë me shkronja të zeza. të mëdha e të shtrembra. Dilaveri i foli qomarit të qëndronte, e zuri për kapiçallin dhe lexoi me zë për të dritën herë fjalët që ishin shkruar në atë copë dërrasë: «Kalimi në u...rë është i nda...luar për indiv...idët!»

— Për mua e kanë vënë këtë, rrufjanët! — tha nënër dhëmbë i zemëruar dhe i orekur dhe vështroi një dvinde metra përtej ku dukej, midis pemëve, korita tërë myshk e mullirit, një mur i tij dhe përfund këtij muri dy dritare të mëdha në gjysmërrethi nga dilte uji i jazit tërë shkumë e zurmë.

U kthye nga kishte ardhur, bëri disa hapa anës hendekut dhe u mundua të aiente ndonjë vah për t'u hedhur. Po hendeku e trembi me ujin e tij të zi e të fjetur, me kallamat e me shoatoret e egra që kishin mbirë në mes të tij. Atëherë hodhi vështrimin nga fshati e nga fusha. Vetëm larg, në ca lëndina, disa fshatarë kishin ndezur një zjarr e po nroheshin rreth tij. Si u bind që s'e shihte nieri, i ngjeshi qomarit në vithe një pëllëmbë të mirë dhe kapërceu mbi urë pothuaj duke vrapuar, si ndonjë hajdut që porsa ka rrëmbyer ndonjë qese me para.

Millonai, një plak i djallëzuar, i vockël nga trupi e i shkathët si ndonjë hardhuckë, me një fytyrë të parruar

tërë pah mielli, sa e pa myshteriu, la gurin që po gdhendte dhe filloi ta pyeste e t'i këpuste thumba. E pyeste dhe e vështronte nga këmbët:

– A të pëlqeu ura, o Dilaver?... Mos u bëj si tersi i Pojanit. Traktoristi kaloi aty dhe e mbajti... Po ti shpëtove mirë! S'të pa ai, pa ta tregonte!

– Kush të më shihte? – e pyeti Dilaveri duke shkar-kuar thesin me misër.

– Kryetari ore, Osmani. S'lë ai të preket, as kaq, pasuria e kooperativës.

– Unë s'kalova mbi urë...

– Të shoh nga këmbët. Pa shih si je llangosur.

– Isha hipur.

– Babait arat i tregon? Po mos u bëj merak, o Dilaver, se nuk i tregoj njeriu unë. Ti andej-kalo përsëri, veç hap sytë se, po të pa Osmani të piu e zezat!

Po millonai ishte edhe zemërmirë. Vërtet e rëndoi me fjalë «individin» vërtet e talli dhe e mori nëpër këmbë, po edhe misrin ia bloi pa radhë. Dhe, kur u nda, e këshilloi edhe një herë që të kalonte mbi urë, pa ai, nuk do t'i tregonte njeriu. Mirëpo, sa ktheu krahët Dilaveri, plaku kapërceu jazin dhe ia dha nga lëndinat, ku kullosnin kuajt e ku ngroheshin fshatarët rreth zjarrit. Takoi djalin e madh të Ndrekos, një kapadai mbi kapadainjtë. Pa mbaruar fjalën mirë millonai, djali kërceu mbi njërin nga kuajt pa shalë, u kap fort pas perçes së tij, u bë erë dhe e arriti Dilaverin te bishti i urës. Fshatari e dëgjoji trokun e kalit, ndali gomarin dhe, si ktheu kokën, njohu djalin e Ndrekos, i cili i thërriste që atje tej:

– Heej, individ! S'e kemi ndërtuar për ty atë urë!

– S'jua kam nevojën! – u përgjigj Dilaveri me inat, tërhoqi gomarin për kapistalli dhe, pa menduar thellë, e futi në hendek, nja njëzet metra tej urës.

– Po një herë e kapërceve ama! Kështu jeni mësuar ju, të kullosni Stambollë! – i shfryu djali i Ndrekos, duke qëndruar majë kalit, te bishti i urës, si ndonjë rojë e tmerrshme. Futi dorën në xhep, mori nga kutia një cigare dhe e ndezi duke vështruar Dilaverin që llapashiste ujin

me këmbë e me duar me gomarin e tij që ishte fundosur në tinë gjer afër barkut. Pas pak djalit i kaloi inati dhe filloi të bënte shaka e të tallej me plakun:

– Për bishti, për bishti ngrije, o individ!... Ndonjë pëllëmbë më poshtë shpoje!.. A u shofsh, oree!

Dilaveri bënte sikur nuk e dëgjonte a ndoshta vërtet nuk e dëgjonte, se kishte hall mos ia hidhte kafsha barrën në hendek. E shtynte gomarin me pëllëmbë, i binte me gju në vithet, e hiqte nga veshët, i ngjeshte shkelmin në bark, po gomari s'levizi nga vendi. Pa, ç'pa, shkarkoi thesin me miell dhe e nduku gomarin nga bishti, si ndukin një hu gardhi që duan të shkulin.

– Ashtu dee! Tani i re mendjes prapa! – e talli djali i Ndrekos duke u munduar të nxirrte tymin e duhanit rathë-rrathë. – Po, me ngadalë, se ia këpute, o individ! – u gajas së qeshuri majë kalit dhe, kushedi sa do të vazhdonte kjo tallje, sikur të mos vinte aty Osmani, hipur edhe ai majë kalit.

– Përse s'kalove në urë, more i uruar? – e thirri kryetari, po Dilaveri as që pranoi ta vështronte e jo t'i përgjigjej.

– E përse të kalojë? Mos ka derdhur ndonjë pikë djersë për këtë urë? – i kundërshtoi djali i Ndrekos. Hodhi cigaren në hendek, pështyu dhe vazhdoi: – Individ është. Le të vuajë si individ. S'i ka faj njeri!

– Pusho, more ti, aty majë kalit! Horr! Shko e i ndihmo!

– S'i kam ndonjë borxh!

Dilaveri i dëgjoi fjalët e kryetarit, po, si duket, kujtoi se edhe ai po tallej, prandaj u përgjigj me zemërim:

– S'kam nevojë për kotheren tuaj! Gomarin e nxjerr vetë i zoti nga balta!

Osmanit i shkuan sytë te dërrasa midis kulprave dhe, duke lexuar, ç'ishte shkruar aty, e kuptoi më në fund përse Dilaveri nuk donte të kalonte mbi urë.

– Kush e ka vënë këtë? – u nxeh Osmani dhe sytë e tij të veckël shkrepinë nga inati.

– Unë, – u përgjigj djali i Ndrekos dhe, si ngriti kokën, filloi të dridhte mustaqet.

– Kush të paska mësuar kështu?

– Mendja më tha...

– Ama mendje që më paske! Lum Ndrekoja që të ka! Po, a je në vete, more tutkun?! Po a e di se kështu ne i ndajmë njerëzit përgjithnjë nga fshati?! – Osmani u për-kul mbi qafën e kalit, zgjati dorën dhe e shkuli dërrasën, huri i së cilës nuk ishte ngulur thellë në dhe.

– Turinjtë do të t'i thyej me këtë! Kështu bëhet lufta për të bindur individët, more derr! – shfryu edhe një herë Osmani dhe e flaku tabelën në hendek.

Ndërkaq Dilaveri e kishte nxjerrë gomarin nga balta, e kishte ngarkuar dhe po shkonte në shtëpi me këmbët llangosur në baltë që nga opingat e gjer sipër gjunjëve.

– U tallët paq, ore djema, – pëshpëriste me vete tërë inat, i vrenjtur. – Po mbajeni mend mirë, nëpër hundë ka për t'ju dalë! Një urë ka ndërtuar Osman efendia e s'të lë të kalosh, e jo të të ndihmojë kur të të zërë e keqja! Lipsur qoftë! Shëndoshë krahët!

Dhe që atë ditë e bëri mendjen top: «Sikur edhe me flori të ma shtrojnë, nuk do të hyj në kooperativë.»

Vinin njerëz të ndryshëm në shtëpi të tij që ishte majë bregut, vinin të deleguar nga rrethi e nga qarku, instruktorë partie, oficerë, agronomë, bile edhe ndonjë shok nga qendra. Rinin disa orë, një ditë, dy, i flisnin, ia kthenin mbarë e prapë, e merrnin me të mirë, po Dilaveri, në fund të fundit, i përcillte me duar bosh.

Një ditë erdhi edhe Naska, një ish-oficer, sekretar i dytë i Komitetit të Partisë të Rrethit. Ai e kishte njohur Dilaverin që në kohë të Luftës dhe plaku e priti si mik të vjetër. U takuan në oborr të shtëpisë, u përqaftuan, u puthën. Naska, i thatë e i gjatë, e vështronte plakun që lart poshtë, sikur të ishte majë çatisë:

– Sa vjet u bënë që s'të kam parë! Eeh! Qenke plakur, shoku Dilaver!

– Domosdo u plaka, kush jeton shumë, do të plaket.

– Dilaveri, ngaqë ishte i shkurtër, e vështronte që poshtë lart, si vështronte qiellin.

– Urdhëro brenda! – e ftoi mysafirin.

– Prit! – tha Naska dhe mori në dorë aparatën që mbante varur në sup. – Pa mblidh ç'ke e ç'nuk ke në shtëpi, se dua të të nxjerr fotografi, të të lë një kujtim. A ke dalë ndonjëherë fotografi?

– Jo.

– Qenke prapa nga dynjaja, shoku Dilaver. Ja, re e vdiqe, Ç'do t'i lësh tët biri, po s'i le një fotografi? – e pyeti me shaka Naska dhe i shkeli syrin Tosunit që dëgjonte këtë bisedë e vetë s'fliste.

Plaku e pa vëngër të birin e u përgjigj:

– Emrin e mirë do t'i lë. Po diti ta mbajë le ta mbajë. Po s'diti, më qafë pastë veten...

Tosuni u bëri zë njerëzve të shtëpisë dhe pas pak dolën tre vëllezërit e tij të vegjël, motra e madhe, e ëma dhe gjyshja plakë.

Naska, duke rregulluar aparatën, përkuli qafën e tij të gjatë si të stërgut dhe i pëshpëriti Dilaverit duke qeshur mu te vrima e veshit leshtor:

– Fotografinë do ta bëj, poo... të më japësh fjalën ama që sot të hysh në kooperativë, se mbete i fundit!

Dilaveri tundi kokën siç e kishte zakon.

– Dëgjo, more shoku Naskë, unë s'jam i vogël që të më gënjesh me një copë letër, si gënjehet fëmija me një copë sheqer të kuq. Ti ke ardhur mysafir, shtëpia është jotja, bujrrëm! Urdhëro të hamë e të pimë, të bëjmë muhabet, të më tregosh se ç'bëhet në botë, po për kooperativën, mos më fol!

– Si kështu. o Dilaver?! Në luftë ti ke qenë i pari.

– Edhe sot, po të bëhet luftë, në ballë më ke.

– Edhe sot luftë është.

– Nuk dëgjoj të kërcasë dyfeku. Çfarë lufte është kjo?!

– Një gjë s'e kuptoj. Atëherë, sa të thamë, rrëmbeve dyfekun, kurse sot...

– Po dyfekun e kam në gjak unë, more i uruar. Me dyfek ka qenë babagyshi dhe babaj i babagyshit... Pa

këtë luftën tënde pa dyfek unë nuk e kuptoj. Jam cazë i trashë, o shoku Naskë... po urdhëro, urdhëro brenda.

Dhe kështu Dilaveri e përcolli duarthatë edhe sekretarin e dytë të Komitetit të Partisë të Rrethit...

Në shtëpi plasi grindja midis Dilaverit dhe djalit të madh. Si duket, Tosunit ia kishte mbledhur organizata e partisë, pa e ndizte sherrin kohë e pa kohë. Djali s'la gjë pa bërë, po ku i mbushej koka plakut.

– Aman, baba! Të hyjmë, se më more më qafë. Do të më nxjerrin nga Partia.

Dilaveri i përgjigjej si pa të keq:

– Në të nxjerrçin, domethënë se s'je për të.

– Baba! Do të më bësh antiparti, antipushtet...

– Fol shqip, se s'të marr vesh!

Tosuni nxehej, dridhej nga inati:

– Po nuk hymë, do të ma marrin taserën e Partisë, baba!

– E ç'është tesera? Një copë defter i vogël. Gjersa e mban në xhep, edhe mund të ta marrin. Partinë njeriu duhet ta ketë në shpirt e jo në xhep. Atje s'ta shkul dot njeri. Ja, le të vijmë e të ma shkulin mua, po qenë të zotët...

Tosunit ia kishin shtruar disa herë në organizatën-bazë: Ose në kooperativë e me Parti, ose jashtë kooperativës e jashtë Partisë! I kishin dhënë afate të ndryshme: Në fillim dy muaj, pastaj pesë, pastaj gjer në vjeshtën tjetër. Dhe ja vjeshta erdhi e ai s'bëri dot gjë. Ky ishte afati i fundit që i kishte dhënë organizata-bazë. E thirrën në byronë e rrethit. Tosuni u mbrojt duke thënë se i ati i kishte mbeturinat thellë në shpirt, siç janë rrënjët e një rrapi të moçëm, dhe se këto mbeturina mund të zhdukeshin vetëm kur ai të mbyllte sytë. Tosuni nuk kishte ç'të bënte më, nuk mund ta bindte dot, ashtu si nuk e bindi dot edhe shoku Naskë. Dhe përfundoi duke u thënë shokëve të byrosë se ai ishte vënë midis dy zjarresh dhe s'dinte nga t'ia mbante. I kishte mbetur vetëm një rrugë, t'ia hiqte vetes!

Duke pritur në korridor vendimin që do të merrej për

të, Tosuni vështronte nga dritarja luadhet me barin e lagur nga shiu, mëzat që kullosnin dhe rosat e bardha që laheshin në një pollg me ujë. Lotët i vinin rrëke nga sytë dhe ai i fshinte shpejt e shpejt me mëngën e setrës që, po ta shikonte njeri, të mos e kuptonte se qante.

I dhanë përsëri afat gjer më të dalë të dimrit. Me t'u kthyer në shtëpi, tërë vrerin dhe zemërimin e tij ia zbrazti të atit. Mirëpo plaku kësaj radhe ia mblodhi keq, nuk i foli urtë e butë si zakonisht, por e shau ndyrë dhe iu kanos:

– Kujt i flet kështu, more qen bir qeni? A e di se ta përdredh kokën si të zogut?!

– Baba! – ulëriu Tosuni dhe zbërtheu mintanin. – Më vri, po deshe, hiqma me dyfek, ja ku e ke, po në kooperativë hyr! Se është për të mirën tonë në radhë të parë.

– Nuk hyj me ata që më futën në kanal e më bënë për pesë para...

– Djali i Ndrekos ta bëri atë, e jo kooperativa!

– Ai një dhe Osmani dy! A s'është Osmani në krye të kooperativës? Po hiqmu nga sytë e mos të ta shoh më bojën!

– Kështu! Domethënë s'do. Mirë pra, – tha Tosuni dhe, si uli zërin, shtoi me vendosmëri: – Atëherë më jep pjesën e mallit. Do të ndahem.

Plaku hapi sytë, i habitur. Pastaj përnjëherësh ngriti pëllëmbën, ktheu kurrizin nga i biri dhe u ra tuleve të prapanikes, duke thirrur:

– Pjesën dooo! Na, merre hisen tënde, meqë e dashke, merre! – u kthye nga Tosuni dhe i shfryu. – Po ç'hise do ti, more qen bir qeni? E ku e gjete mallin ti, more farë sinapi që rritesh buzë haleve? Mallin e kanë vënë këto duar, këto, dhe jo ti! Morra ke ti e jo mall! Ik mbytu, se rrëmbeva një hu e të lashë në vend!

– Baba!.. Babaa! – ulëriu më kot Tosuni. – Në gjyq do të të hedh. Me gjyq do ta bëj ndarjen...

Po nuk u bë as gjyqi e as ndarja. Dy ditë pas kësaj grindjeje, në familjen e Dilaverit, pllakosi një fatkeqësi e

madhe e papritur që u dha fund një herë e përgjithmonë grindjeve të përditshme.

Atër mesnatës Dilaverit gati iu zu fryma nga tymi i dendur që kishte mbushur ashefin ku ai flinte. U kollit dy-tri herë dhe brofi në këmbë. Ishte ende nëpër gjumë dhe nuk e kuptoi menjëherë se ç'kishte ndodhur. Gjeti me hamendje dritaren dhe shtyu kanatin e saj. Një flakë e verdhë iu përplas në fytyrë dhe ia përzhiti vetullat e mjekrën e parruar.

– Zjarr!... Zjaaarr! – thirri ai dhe eci kuturum nëpër dhomë.

– Dil, se u përvëluam, baba! – dëgjoji zërin e lemërisur të vajzës që e thërriste të dera.

Kur doli në oborr, flakët vërshuan mbi çatinë e shtëpisë, në hatullat, ku mbanin verës bagëtinë, dhe mbi plevicën me kashtë.

– Ujë! Ujë! – thërriste plaku duke ardhur vërdallë nëpër oborr.

– Mjerë ne! Mjerë ne! – lebetitej pa mend në kokë gjyshja. Pas fustanit të gjerë të saj, ishin kacavarur si rrodhe djemtë e vegjël të Dilaverit; veshur vetëm me këmishë, vështronin të tmerruar zjarrin dhe qanin.

Tosuni rrëmbeu një kusi që ishte te dera e ashefit, mendoj një grimëz se ku ta derdhte dhe pastaj e hodhi brenda. Po uji, sikur të kishte qenë benzinë, e ndezi më shumë zjarrin. Nga dera e errët doli një flakë e madhe dhe bëri përpjetë çatisë. Trarët e moçëm e të thatë, sikur të ishin prej pishë, kërcitën, bënë bark e pas pak ranë të thyer më dysh. Ra edhe çatia. Atëherë filluan të pëlçisnin fishekët, të fshehur prej kushedi sa kohësh nëpër hatulla e nëpër mure. Dhe pas këtyre krismave, oborri u mbush me fshatarë e fshatare.

I pari erdhi komshiu i Dilaverit me një enë me ujë, e hodhi ujin sipër çatisë e pastaj filloi të sodiste shtëllungat e zeza të tymit dhe flakët që kishin përpirë shtëpinë. Pas tij erdhi Osmani, edhe ai me dy kova me ujë.

– A dolët të gjithë? – pyeti ai Tosunin.

– Dolëm, po gjë prej gjëje s' shpëtuam! Na mbuloj flakal

Osmani mbështeti në mur një palë shkallë, hipi në to dhe e derdhi kovën mbi çatinë e rrëzuar.

– Ujë! Ujë! Më jepni ujë! – thirri ai majë shkallëve dhe gjymat, kovat, kusitë, gjithë enët që kishin sjellë fshatarët kalonin dorë më dorë e derdheshin mbi zjarr. Po flakët s'kishin të mbaruar.

Dilaveri ishte bërë si i çmendur. Dy herë u përpoq të hynte në ashef, po s'qe e mundur.

– Do të përvëllohesh, baba, ç'bën kështu! – e mbajti me zor Tosuni:

– Kam lënë pesëmbëdhjetë mijë lekë mbi oxhak. Edhe malisherin e kam varur atje. T'i shpëtoj ato të paktën! – thoshte Dilaveri dhe fshinte me mëngë djersët e fytyrës që i dukeshin nga flakët si pika gjaku.

– Mbahu, o Dilaveri! S'ke ç'i bën! Të rrosh vetë! – e ngushëlloi plaku Ndreko që erdhi i fundit së bashku me të bijtë, edhe ata me enë nëpër duar.

Po munda shkoi kot. Filluan të binin strehët e çatisë e pastaj muret. Zjarri u hap si një rrufe e përfshiu çdo skaj të shtëpisë. Njerëzit mbetën të heshtur, të pikëlluar, me kova bosh nëpër duar. Vetëm Dilaveri e Tosuni vazhdonin të hidhnin ujë, me shpresë se mos shpëtonin ndonjë plaçkë dhe vetëm zëri i gjyshes dëgjohej si zëri i ndonjë kukuvajke:

– Mjerë ne! Mjerë ne!

Kur filloi të gdhinte, flakët u platitën. Në vend të shtëpisë mbeti vetëm një kopicë e madhe me shkrumb e hi. Tek-tuk ende tymosnin mbeturinat e padjegura. Dilaveri hyri midis asaj kapice përvëluese dhe gërmoi me bel, me shpresë se mos gjente lekët, pushkën a ndonjë send tjetër. Më në fund i humbi tërë shpresat, u lodh, flaku belin dhe doli në oborr ku kishin mbetur vetëm katër-pesë fshatarë të këshillit e të kooperativës. Binte erë tym që atje tej. Duart i qenë përzhitur, fytyra i qe nxirë dhe vetëm sytë e pikëlluar i zbardhnin e vështronin me tmerr rreth e rrotull.

– U dogj shtëpia! U dogjën plaçkat, bereqeti, bagëtia! E ku të mbytem unë tashti? – tha ai dhe u ul mbi një

gur pranë plakës e fëmijëve, si i goditur në zemër me një gjë të rëndë.

– Së bashku i kemi hequr gjithnjë hidhërimet, o Dilaver. Së bashku do ta heqim edhe këtë. Tashti ngrehu. Merr fëmijët, se u plevitosën, dhe hajdeni andej nga unë.

Dilaveri ngriti kokën dhe vështroi atë që i foli. Ishte Osmani.

– Ngrehu të them, se mardhën fëmijët. Hë, ore Tosun, ç'pret! Nisuni!

Plakut iu mbushën sytë me lot e pëshpëriti:

– Të falem nderit e ta paça borxh! Po jemi kallaballëk!

– S'ka gjë, lugët do të shtohen!

Tosuni i vuri përpara fëmijët, kurse plaku nuk luajti nga vendi.

– Shkoni ju, shkoni! Unë do të qëndroj këtu edhe ca – dhe, si mbeti vetëm, i erdhi rrotull shtëpisë duke vështruar tymin e murmë që vazhdonte të dilte nga shkumbi.

Ishte bërë pikë e vrer! Ku do ta përplaste kokën ai dhe familja e tij? Ja, mirë, sot i mori Osmani. Po Osmani s'mund t'i mbajë tërë vjeshtën e tërë dimrin! Ku do të gjente para për të blerë bereqet, për të blerë plaçka për fëmijët që mbetën më ditë të hallit? Po shtëpinë, me se do ta ndërtonte? Asaj shtëpie themelet ia kishte hedhur gjyshi dhe e kishte ndërtuar i ati i Dilaverit. Njëzet vjet ishin robëtuar prindërit e tij për të ngritur atë shtëpi, plot njëzet vjet! Njëzet vjet do t'i duheshin edhe Dilaverit. Se nuk është gjë e lehtë të ndërtosh shtëpi! Qëmoti njerëzit vinin në kurbet, linin kockat për një dollar e kasollet s'i bënin dot! Duhet trarë, duhet dërrasa, gëlqere, gozhdë, menteshe, ustallarë. Pa duhet dyshekë, enë, hambarë, koshere, plevicë. Pa duhet... E ç'nuk duhet! E ku bëhen gjithë këto? Sa vjet duhet që të bëhen gjithë këto?

Plaku mendonte kështu me vështrimin e humbur në pllajën rripa-rripa, ku dukeshin shtëpitë midis gjelbërimit. «Në ato shtëpi njerëzit jetojnë të gëzuar, s'i rreh era e shiu. Edhe nga dimri që po afrohet s'kanë frikë. «Urdhëro», – i thonë edhe dimrit. Dru kanë vënë, turshi kanë vënë, pastërma do të venë, bereqet kanë, raki kanë... Kurse

unë! Unë mbeta lakuriq në mes të udhës! Pa kam edhe çupën për të martuar... Po kjo është për të luajtur mendsh! Ku të vete?! Ku të mbytem?!

Nga sytë e tij të shuar u këput një lot dhe i ra në kurrizin e dorës tërë damarë mavi. Plaku shkundi dorën dhe loti, që shndriti në rrezet e para të diellit, ra mbi kapiçën e shkrumbit.

— Kë të mbytem, o perëndi?? — belbëzoi ai dhe vështroi i hutuar qiellin pa anë e fund, mbushur me re e me ajër të freskët malesh. U ul më bisht, koka iu var në supin e majtë, iu varën edhe duart midis gjunjëve. Dhe me orë të tëra qëndroi përpara shtëpisë së djegur si ndonjë trug i moçëm i përvëlur nga rrufeja.

Në këtë gjendje e gjeti Osmani që shkoi tek ai pasdite vonë së bashku me dialin e madh të Ndrekos dhe me komshiun e Dilaverit, Çalon.

— A e di si më dukesh, apo jo? — i foli që atje tej Çaloja. — Si ndonjë gur varri. Hiqe atë mendim. Ne kemi pasur halle më të mëdha e s'jemi bërë kaq merak.

Dilaveri as që e mori me mend përse kishin ardhur këta tre burra, psherëtiu e nuk u përgjigj.

Djali i Ndrekos nxori paketën «Partizan» dhe ia zgjati.

— Ndize!

Dilaveri i hodh një vështrim të dyshimtë:

— Ja ku e kam. — i tha dhe vuri në gojë llullën.

Osmani u ul shesh, shkrepri çakmakun, ia ndezi llullën dhe tha:

— Këtë hallin tënd, o Dilaver, e pleqësua në Parti e në kryesi të kooperativës. Megjithëse jemi grindur me ty për ca qëra që s'është vendi për t'u thënë, vendosëm të të ndihmojmë. Ja, drejt e nga mbledhja po viimë. Tërë fshati na përkrahu. — Plaku thithi llullën, lëshoi një shtëllungë të madhe tymi dhe vuri veshin. Vështronte nga shtëpia e djequr, po mendjen e kishte te fjalët e Osmanit: — Paratë i mblodhëm, ja tek i ke, këtu — dhe Osmani i lëshoi përpara një tufë me kartëmonedha. — Plaku hapi sytë dhe mbërtheu vështrimin midis opingave ku ishin lekët. — Një pjesë i ke nga kooperativa, të tjerat nga

anëtarët. Këtu ke emrat e atyre që t'i dhanë e këtu sasinë e lekëve që dhanë. Nuk t'i japim borxh, po t'i falim. Sa për bereqetin, do ta mbledhim nesër. Kush të fal disa kile e kush një shinik, sipas takatit. I ke të shënuara këtu. Po ne i ramë kalemit e na doli se gjer në korrjet e reja të dalin. — Plaku filloi të dridhej dhe e kuptoi edhe vetë që dridhej. Prandaj shtrëngoi muskujt e kokallat dhe u ul shesh. Shtrëngoi llullën me ata dhëmbë që i kishin mbetur, po ajo i dridhej me gjithë buzë. E kapi fort me dorë dhe i vuri sipër gishtin e madh, por edhe dora i dridhej, edhe gishti i dridhej. I fërgëllonin edhe qepallat e vetullat e përzhitura, edhe faqet e vyshkura, edhe mjekra e parruar. Dhe i dukej vetja sikur ishte në ëndërr. — Do të të japim pesë qerre dhe kamionin e kooperativës për të sjellë qerestenë, gurët e tjegullat. Do të vijë brigada e rinisë, ja me këtë djalin e Ndrekos në krye, për pastrimin e vendit e për hapjen e themeleve. Puna është që ti ta ndërtosh shtëpinë para se të fillojnë ngricat dhe para se të bierë bora. Që nesër shko ku duhet, bli ç'ke për të blerë dhe fillo nga ndërtimi... Kështu, o shokëni?

— Kështu, — u përçajigj Çaloja.

— Kështu e vendosëm, — iu përçajigj edhe djali i madh i Ndrekos.

— Tani ngrehu të shkojmë, se po erret!

— Dielli kishte perënduar. Nga lindja frynte një fllad i lehtë, rrëmbente hirin dhe e përhapte mbi lëndinën e zhuritur, mbi barin e thatë, mbi lëmushkun e gjelbër të shkëmbinjve.

«Ku jam kështu? Në ëndërr?!» — mendoi Dilaveri duke parë me sy të turbullt tufën e kartëmonedhave dhe fytirat e njohura të atyre njerëzve, për të cilët ai, kohët e fundit, kishte menduar vetëm keq. Po e kuptoi që nuk ishte në ëndërr dhe bëri cmos për të mbajtur veten. Dhe për të mbajtur veten thithi llullën, hoqi tymin thellë në mushkëri dhe e nxori nga hundët e nga goja. Jo sikur nxirrte tymin e duhanit, po tymin e një zjarri të madh që i digjej në shpirt.

— Ngrehu, Dilaver! — i tha përsëri kryetari i koope-

rativës duke e vështruar me sytë e tij të veckël, të zjarrtë e të gëzuar. Burrat e tjerë ishin ngritur. Panë njëri-tjetrin në sy, vështruan edhe plakun që rrinte si i shastisur dhe mblodhën supet.

Dilaveri zgjati dorën tërë damarë mavi, preku tufën e kartëmonedhave, e mblodhi shuk dhe u ngrit. Psherëtiu shumë thellë dhe hapi gojën. Zëri iu drodh:

– Shumë kam jetuar, o vëllezër. Po shumë pak paskam parë e paskam mësuar në këtë jetë! Do të di vetë si t'jua shpërblej këtë të mirë! Ju falem nderit!

Dhe të katër zbritën ngadalë tatëpjetë pllajës që gu-mëzhinte nga thirrjet e njerëzve, nga zilkat e varura në qafë të bagëtive, nga blegërimat e kopesë me dhen dhe nga këngët që përhapte radioja me vajguri e kooperativës...

1960

KRYETARI

Unë po krihja demin e racës, kur Jashari hyri në stallë tërë hundë e buzë dhe më zgjati një copë pusullë të zhubravitur.

– Ç'e ke këtë? – e pyeta.

– Më transferoi përsëri. Do të punoj në stallë, rojë nate, – m'u përgjigj ai i zemëruar duke thithur vazhdimisht bishtin e cigares që e mbante me dy gishta.

U afrova te dritarja dhe mezi e lexova pusullën. Kryetari më shkruante se Jashari, me vendim të kryesisë, ishte hequr nga punët e fushës dhe caktohej rojë nate në depot e stallat tona. Të them të drejtën, më erdhi keq për Jasharin. E vështrova tinëz. Duart i dridheshin, fytyra i qe zverdhur, sytë i qenë mbushur me lot. Mua, si grua që jam, m'u këput shpirti.

– E po mirë, o Jashar, – i thashë, – këtu të caktuan, këtu do të punosh.

Ai hodhi bishtin e cigares e shkeli me majën e opingës dhe tha:

– Domosdo do të punoj, se kam një karvan me njerëz

në shtëpi. Po nuk është e drejtë të më poshtërojë kë-shtu e të më sjellë të punoj nën çitjanet e grave.

Mua më prekën këto fjalë. Po nuk jam mësuar t'u kundërshtoj njerëzve, e sidomos burrave. Më vjen shumë turp. Më duket sikur do të thonë: «Ja, doli edhe Resnija, e bija e Dautit, të na shesë menaje.» Mirëpo fjalët e Jasharit më ranë si plumb në zemër dhe s'u përmbajta.

— Mos fol ashtu, Jashar, se tani burra e gra jemi njësoj, — i thashë me të mirë e me të urtë.

Prita të dëgjoja përsëri ndonjë fjalë të rëndë, kur ai, sikur të mos më kishte dëgjuar, tna:

— Nuk e kam me ty, Resmije. Ti je e zonja. Të punon edhe mendja edhe dora, prandaj të kanë vënë brigadiere, unë e kam me Xheladinin, me kryetarin, që s'di të silltet me njerëzit, që më ka marrë nëpër këmbë e më përdor si leckë. Brenda një viti tri herë më hoqi nga puna. Isha mirë e bukur përgjegjës i sallës së leximit. Punova sa munda. Nuk them se kam ndonjë shkollë të madhe, por edhe pa shkollë s'jam. Shtatëvjeçaren e kam mbaruar. Por ai as tre muaj s'më la të punoja. Më hoqi dhe vuri Sulejmanin, të nipin. Më caktuan në fushë, përgjegjës skuadre. «E po, mirë thashë, do t'i vë zemrës një gur e do të duroj.» Kur ja pa mbushur dy muaj, vuri përgjegjëse Saidenë, të kushërirën, dhe mua më dërgoi këtu rojë nate. Po pse, e drejtë është kjo?! Dhe a e di pse ma punon kështu? Se e kritikova në mbledhjen e asamblesë. Dhe që atëherë më ka marrë inat.

Jashari drodhi një cigare tjetër, e ndezi dhe, ngaqë e hoqi pa pushim, u mbyt me tym.

— I shkreti til — thashë duke mbaruar së krehuri demin.

I pashë edhe një herë lopët, kontrollova grazhdet, viçat, bidonat e qumështit dhe, si i porosita çupat që të vinin në mëngjes në orën katër dola nga stalla. Kishte filluar të errej. Në enën me ujë, ku pinin viçat, kishte rënë hëna e prerë më dysh nga një fije kashtë që kishte mbetur në enën prej druri. Në dritën e hënës fytyra e Jasharit m'u duk fare e zbehtë.

– E po, natën e mirë e punë të mbarë! – i thashë duke psherëtitur. – Mos lër njeri të hyjë në stallë natën, se tremben lopët dhe e pakësojnë qumështin. U hidh të hanë në orën dymbëdhjetë. Në katër të mëngjesit më ke këtu.

– Mirë, mirë, mos ki merak, – m'u përgjigj ai me vështrimin në ujin e enës. U largova dhe, para se të kapërceja matanë gropave të silazhit, ktheva kokën. Në mugëtirën e mbrëmjes, te porta e stallës, pashë një xixëllonjë që fikej e ndizej me shpejtësi. Ishte cigarja që thithte Jashari pa pushim.

Duke shkuar për në shtëpi, mendoja se kryetari ynë i dashur, Xheladini, nuk kishte vepruar mirë. Me ç'të drejtë e heq tjetrin nga puna tri herë brenda një viti? Pa shiko, Jashari i gjorë, si është bërë, gjysmë njeriu, i ka ardhur shpirti në majë të hundës, pi farmak pa pushim dhe kushedi se ç'bluan me vete! Dhe ka të drejtë të dëshpërohet e të zemërohet. Të ta punojë tjetri, për një fjalë që i ke thënë?

Me këto mendime hyra në shtëpi. Megjithëse s'kisha mbushur motin që isha martuar, burrin nuk e kisha, mësonte në një kurs dymujor. Ndeza zjarrin, hëngra bukë dhe rashë të flija. Dhe ja, në dyshek m'u kujtua se si kryetari ynë, një javë më parë, kishte lejuar shoferin me gjithë kamion të shpinte gurë e qereste te dhëndri i vet që po ndërtonte shtëpi të re. Dy ditë mungoi makina jonë. Dy ditë u prish edhe qumështi! Po kryetari s'mori ndonjë masë për shoferin. Domethënë se e mbante me hatër. Jasharit ia këput me sëpatë kokës pa të drejtë, se nuk e ka në soj, kurse të tjerët... Jo, këto s'janë punë të mira!

I blova mirë e mirë këto mendime dhe vendosa më në fund të zbrazesha edhe unë kundër Xheladinit.

Dhe ja, u bë mbledhja e asamblesë. U ndanë të ardhurat. Dolëm mirë, më mirë sesa kujtonim dhe kjo na gëzoi të gjithëve. U thanë shumë fjalë të mira e të këqija, për njërin e për tjetrin. Po për kryetarin s'e hapi gojën njeri. Atëherë u ngrita unë të flisja.

– Me lejel

S'kisha folur ndonjëherë nëpër mbledhje, se më vinte rëndë. Isha nuse e re, e ardhur nga një kooperativë tjetër dhe nuk i njihja ende njerëzit. Dhe, kur u ngrita të flisja, m'u duk sikur më ra tavani. «Ç'm'u desh mua!» – thashë me vetë, kur pashë qindra sy që m'u mbërthyen.

Po më keq e pata, kur dëgjova fjalët e Xheladinit. Ai rrinte në tryezë i qetë, i gëzuar. Më vështroi në gojë e më tha:

– Hë, moj Resmije, se s'ta kemi dëgjuar zërin ndonjëherë! – Mua sikur më ra pika nga këto fjalë. E si t'i thosha në sy ato që kisha menduar? Të them të drejtën, s'ma mbajti dhe desha të ulesha, kur Xheladini më tha përsëri me fytyrë të qeshur e me zë të ëmbël: – Hë, moj Resmije, na thuaj ç'ke për të thënë!

Atëherë s'di edhe unë se si po gjuha m'u zgjidh.

– Me ty e kam, o Xheladin! – Jo sikur thashë fjalë, po sikur hodha ndonjë bombë. Përnjëherësh s'pipëtiu më njeri. I madh e i vogël më ngulën sytë. «Të dalë ku të dalë», – mendova, dhe e ngrita zërin: – Me Xheladinin e kam. Ç'kam në zemër, do ta them hapur, për të mirën tonë. Kryetari ynë bën si i thotë koka e jo si është e drejta. 500 e ca litra qumësht na u prishën për dy ditë. 500 e ca litra bëjnë... sa lekë bëjnë? Nuk e di, bëjini hesap vetë. Dhe u prishën për faj të Xheladinit. E drejtë është kjo? Në piskun e punës e lejoi shoferin të shkonte e të ndihmonte të tjerët.

– Si kështu?!

– Kur ka ndodhur?!

– Të japë llogari Xheladini!

– Daleni, more, se kryetari di se ç'bën.

Qetësia u prish. Pyetjet më vinin si breshër. Njerëzit lëviznin nga vendet, thërrisnin. Dhe mbi të gjithë dëgjova zërin e Jasharit:

– S'na duhet Xheladini. Të zgjedhim një kryetar tjetër!

– Po të jetë nevoja, le të zgjedhim një tjetër! – thashë dhe u ula e turbulluar.

U thanë **fjalë të rënda** e të mira, po më në fund kryetar mbeti përsëri Xheladini.

U ktheva në shtëpi me shpirt të vvarë. Më shkrepri një mendim: «Po sikur ta pësoj edhe unë si Jashari? Po sikur të më marrë inat edhe mua?» Atëherë u pendova për ato që thashë në mbledhje. Dhe ja, inatin e kryetarit e vura re që të nesërmen. U takova rrugës, kur po vija në stallë shumë herët.

– Mirëmëngjesi, shoku Xheladin!

– Mirëmëngjesi! – m'u përgjigj pa më vështruar dhe u hodh mbi një kapërcyell.

«Ndërroi rrugë që të mos bisedojë me mua, mendova me inat. U pa kjo punë. Prite kur të më punojë qindin!»

Mirëpo ky qëndrim i tij i padrejtë sikur më dha zemër.

«S'jam si Jashari unë, – mendova. – Në më bëfsh gjë, do të di ku të drejtohem. S'të lë të heqësh valle mbi kurrizin tim!»

Dy ditë më vonë më erdhi në stallë aty nga dreka, i vrenjtur e i zyrtë. Kontrollloi vetë çdo gjë, në heshtje. I pa lopët një për një, pa grazhdet, pa ushqimin, bidonët me qumësht, planet e prodhimit. E vura re që u vështronte mjelëseve duart, thonjtë, rrobat, shamitë në kokë, jo sikur të ishte në stallë, po në ndonjë spital.

«Kontrollo, kontrollo! – thosha me vete. – Kërkoje qimen në qull. Do ta gjesh ndonjë gjë që s'vete dhe me të do të ma hash kokën.»

Këto mendime m'i preu ai vetë.

– Shoqja Resmije, nesër në mëngjes eja në zyrë, se kam punë me ty, – më tha dhe rëndë-rëndë doli nga stalla.

– Të erdhi radha, Resmije! Prite! – dëgjova prapa krahëve zërin e Jasharit.

«Gjersa më thërret «shoqe», që s'më ka thirrur kurrë, e gjersa më kërkon në zyrë, u pa kjo punë, – mendova. – Sa keq kur njeriu të merr inat, pse ti e kritikon!»

Gjithë pasditen kisha një boshllëk në shpirt, po nuk iu hapa njeriu, as Jasharit, i cili bënte, ç'bënte e më hidhte ndonjë fjalë. Dhe ky boshllëk m'u shtua më shumë, kur në mbrëmje e takova përsëri në rrugë.

— Mos harro për nesër, shoqja Resmije, — më thirri që atje tej pa qëndruar.

«Ah, ore Xheladin! — gati murmurita duke shtrënguar dhëmbët. — Më shikon shtrembër, më thërret me romuz «shoqe» dhe mundohesh të gjesh qimen në qull! Po nuk është i drejtë ky qëndrim! Nuk të kanë mësuar të sillësh kështu me njerëzit!»

Për fatin tim, atë natë ishte kthyer nga kursi im shoq. Të paktën tani kisha kujt t'ia hapja zemrën. I tregova gjerë e gjatë për ato që kisha bërë. Ai më dëgjoji me vëmendje, tundi kokën e në fillim s'më tha asnjë fjalë. Qëndrimi i tij më bëri merak më shumë.

«Obobo! — mendova me zemër të plasur. — E paskam shkelur keq!»

Mirëpo përsëri nuk isha e bindur se kisha bërë ndonjë gabim.

— Po thuajmë, more burrë, ç'faj kam bërë unë? — e pyeta.

Ai tundi përsëri kokën dhe kësaj radhe foli:

— Jashari tërë jetën dembel ka qenë, prandaj e kanë sorollatur andej-këtej. Mos ia dëgjo fjalët atij. Sa për Xheladinin, ku di unë si të të them? Gjersa të kërkon në zyrë, shko!

Vetëm kaq më tha im shoq. Po këto fjalë nuk më ngrohën fare.

Të nesërmen shkova në zyrat e kooperativës. Te shkalla e fundit, para derës së kryesisë, m'u prenë këmbët fare, po përsëri e mbajta veten dhe bëra përpara. Kryetari ishte atje, ulur te tryeza e tij dhe po shqyrtonte një tufë me shkresa që ia kishte vënë përpara llogaritari ynë. Bëri sikur nuk më vuri re dhe unë mbeta si qiri në këmbë në mes të zyrës. Pas pak më pa, kroji veshin me laps dhe, si më dha dorën, më ftoi të ulesha.

— Të erdhi burri? — më pyeti pa hequr sytë nga shkresat.

— Erdhi mbrëmë.

— Si është me shëndet.

— Mirë.

– Po me mësimë si ka dalë?
– Turp të të gënjej, nuk e pyeta.
– Si kështu?! – bëri sikur u habit duke më vështruar në sy.

Ai më vështronte, kurse unë thosha me vete: «Mos e zgjat me këto pyetje, Xheladin! Bjeri shkurt! E di përse më ke thirrur!»

Dhe tamam në këtë kohë ai mblodhi shkresat, ia dha llogaritarit dhe, për habinë time, m'u drejtua me këto fjalë:

– E zonja je ti, moj Resmije! Të lumçin krahët edhe mendja! Stallën e mban s'ka ku të vejë më mirë, jo si stallë, po si spital! Lopët i ushqen mirë, viçat i rrit si fëmijë, vajzat i ke të pastra, si mamitë. Ah, sikur t'i kishim gjithë njerëzit punëtorë si ti! Nuk do të vuanim më! Po ja që kemi edhe dembelë, si Jashari... Ai u ngrit nga tryeza dhe m'u afrua: – Edhe një gjë do të të them. Në mbledhje më dhe një dajak të mirë. E meritoja. Do të më bëhet mësim. Të falem nderit, shoqja Resmije! Ja, për këtë të thirra – dhe, si më shtrëngoi dorën, tha përsëri duke qeshur: – Të falem nderit!

Mua më rrahu zemra nga gëzimi, por më erdhi edhe turp nga vetja. I zbrita shkallët e lehtësuar nga një barrë e rëndë.

«Ja ç'njeri qenka Xheladini ynë i dashur! Kurse unë... budallaqja...»

S'gjeta fjalën që më duhej për të sharë veten, po shpejtova hapin për nga stalla, ku më prisnin shoqet edhe lopët. Po edhe Jashari. Ai më priti te pragu i derës dhe, me një fytyrë të pikëlluar, më tha:

– E moj Resmije, a të thashë unë që të erdhi radha? Po, pa më thuaj, cilën caktoi brigadiere? Mos vallë të shogën?

E pashë me inat dhe s'munda t'i thosha më shumë se kaq:

– Hiq, more Jasharziu! Mblidh mendjen, lëri llafet dhe shtroju punës. Kryetarin tonë s'e ka njeri!

NDERI I PLAKUT

Në qytetin tonë të vogël është një kopsht plot pemë e lule. Ai quhet «Kopshti i rinisë». Po, meqë është në qendër të qytetit e në sy të botës, të rinjtë tanë nuk para shkojnë aty. Ata duan më shumë anën e lumit, kodrat e gjelbëruara dhe bulevardin plot zhurmë. Kopshtin ua kanë lënë pleqve. Dhe vërtet, që kur çel gjethi në pranverë e gjersa ai fillon e zverdhet, në këtë kopsht mbliidhen kokë më kokë pleqtë e qytetit tonë.

Të jesh e të dëgjosh bisedat e tyre. E për çfarë nuk bisedojnë pleqtë! Qyteti ynë është një qytet i ri dhe pleqtë janë të gjithë të ardhur nga të katër anët e Shqipërisë. Ata dinë çdo gjë që ka ndodhur në këtë shekull në vendin tonë e përtej vendit tonë. Bisedojnë për komitetë e qëmoçëm e për dobinë e mjaltit, për lugetërit e për sputnikët, për kurbetin e mallkuar e për hidrocentralin «Karl Marks». Për çdo gjë bisedojnë pleqtë e qytetit tonë. Po më shumë bisedojnë për politikë, se si pleq që janë e si shqiptarë që janë, nuk mund të rrinë pa politikë!

Njëri tregon, të tjerët dëgjojnë. Ai që tregon, flet ngadalë-ngadalë. Pleqve u pëlqen ngadalësia. U pëlqen të folurit ngadalë. U pëlqen që pranvera të ecë ngadalë, ashtu si edhe vera. U pëlqen që minuta, ora e dita të ecin ngadalë.

Ngadalë hap derën në mëngjes dhe del nga shtëpia edhe plaku Sabri Tafa. Sa del në rrugë, vë dorën si strehë mbi ballë dhe vështron qiellin: «Pale, si do të jetë moti sot?» Rrezet e diellit ia ngacmojnë hundën dhe ai fillon të teshtijë, i kënaqur pesë-gjashtë herë me radhë. Një çunak e vështron nga dritarja e thotë: «Filloi gjyshi gjimnastikën e mëngjesit.» Sabriu fshin hundët me një shami të bardhë si bora, që ia ndërron plaka përditë, drejton trupin me një rënkim të lehtë dhe, duke mbajtur shkopin nën sjetull, nisët për udhë ngadalë-ngadalë.

Sabri Tafa është më plaku ndër pleqtë e tjerë. Këtë e tregojnë bebëzat e shuara të syve të tij që ndizen rrallë e tek, vetëm atëherë kur plaku tregon për të birin. Ai ka një fytyrë tërë rrudha dhe të zezë, sikur t'ia kenë lyer me qymyr, ka dy duar të mëdha, të zeza edhe ato, ka edhe një shkop që mban nën sjetull, të zi edhe atë. Është i pastër Sabri Tafa, rri gjithnjë i rruar, i heku-rosur, me shami e me këmishë të bardhë si qumësht e me këpucë të lustruara. Duket se e ka plakën për kokë të plakës!

Ai shkon drejt e në kopsht në qendër të qytetit. Mbërrin aty gjithnjë i fëndit. Porsa mbërrin, të tjerët e përshëndesin dhe i bëjnë vend.

— E po, si u gdhive, shoku Sabri? — e pyesin.

— Mirë, falemnderit! Vetëm kolla më ka ngacmuar, — përgjigjet ai duke vështruar me bebëzat e shuara të syve.

— Lëre këtë të flamosur duhan, — e këshillojnë.

— Duhej lënë me kohë. Tashti s'bën fajde.

— E po ç'na dëgjove ndonjë të re?

Dhe fillon politika. Të rejat Sabriu i ka mësuar nga radioja dhe ua thotë fill e për pe të tjerëve. Pleqtë dëgjojnë me vëmendje si nxënësit e mirë në shkollë dhe

kënaqen. Sabriu u tregon si venë punët në Bistricë e në Kongo, gjer ku kanë shkuar punimet në Thumanë, kush do të zgjidhet presidenti i ri në Amerikë dhe si vete rikonstruksioni i fabrikës së sheqerit. Dhe çdo ditë, pa-tjetër, do t'u tregojë ato që dëgjon për minierat. Shpirti i këtij plaku të drobitur nga motet është te minierat, sepse ka aenë vetë minator i qymyrgurit dhe sepse minator e ka dhe të birin, Zenelin. Pesëdhjetë e pesë vjet ka punuar ai nënër minierat e Amerikës e të Shqipërisë, dhe ndoshta prandaj i ka duart e fytyrën të zeza sterrë, si qymyri.

— Në minierën e Zenelit punët shkojnë mirë. Edhe mbremë pata një laim, — thotë plaku dhe bebëzat fillojnë e marrin zjarr, kur ai përmend emrin e djalit të vet.

E ka djalë të vetëm, e ka minator të fortë. Po e ka edhe djalë shtëpie. Zeneli cdo muaj do t'i dërgojë plakut ndonjë duhan, ndonjë shishe me raki, ndonjë plackë nër kostum, ndonjë palë këpucë të mira apo ndonjë lek. Ja, këto që ka veshur Sabri Tafa, i biri ia ka dërruar. Pensionin ai e prish për të mbajtur shtëpinë dhe plakën. Të tierat ia dërron Zeneli, minatori Zenel Tafa.

Plaku është krenar për të birin dhe mburret me të. Pleatë e tierë nuk e kanë parë Zenelin ndonjëherë, por, po ta shohin, do ta njohin menjëherë, kaq bukur ua ka vizatuar i ati. Zeneli është i gjatë, si dikur i ati (Sabriu tani duket i shkurtër për arsye se nuk e mban trupin drejtë, por e kërrus). Ka duar të mëdha si të Sabriut, ka vullnet të fortë, si guri i qymyrit. Po gjithë më e bukur që ka Zeneli është puna e tij. Prandaj mburret e krenohet me të drejtë plaku Sabri Tafa. Kushedi sa herë e kanë dëgjuar pleatë e tierë aty në kopsht të treqojë të niëjtën që nër të birin. Dhe asnjëherë nuk janë mërztur, po gjithëni e kanë uruar me gjithë shpirt.

— Të të rrojë, o Sabri! E paç me ymër! Ke me të vërtetë një çiflia në shtëpi.

Dhe naa këto urime Sabri Tafës i bëhet zemra mal.

— Është punëtor, pa jam krenar, — thotë Sabri Tafa, dhe bebëzat, zakonisht të shuara, i vetëtijnë. — C'i mbetet njeriut pasi të vdesë! Ja, ç'do të të mbetet, kur

të vdesësh? Emri. Jo. Emri do të të harrohet. A e di se çdo të të mbetet? Hiri që do të bëhet baltë dhe puna që ke bërë për nierëzit...

Shpeshherë Sabri Tafa merr gazetën, vë syzet dhe u lexon lajmin që shkruhet për minierën, ku punon i biri.

Herë tjetër plaku ua ndërpret bisedën vend e pa vend shokëve e u thotë:

– Pa ndizeni nga ky duhan, se ma ka dërquar Zeneli!

– Pa hiqeni nga një herë, o shokë, këtë raki të Zenelit.

S'ka ditë që plaku të mos e zërë në aqojë të birin. Po edhe pleqtë e tierë mërzhiten, po të mos dëqojnë emrin e Zenelit. Zeneli ishte krenaria e plakut, votë qëllimi i jetës së Sabriut, gjithë qenia e tij, nderi i tij, prandaj edhe bebëzat e shuara marrin zjarr kur përmendet emri Zenel.

...Një ditë Sabri Tafa nuk u duk në kopsht as në orën e zakonshme dhe as më vonë. Në fillim pleqtë vështronin tërë shpresë rruaën nga vinte ai përditë.

– C'na u bë ky Sabri, xhanëm?! S'është vonuar ndo-njëherë! – pyesnin ata njëri-tjetrin.

– Hë, se vjen tashti!

Po Sabriu nuk u duk as të nesërmen. Atëherë pleqtë u bënë me të vërtetë merak.

– Mos i ka ndodhur që, more burra? – pyeti një lab turivogël me aylaf të lartë mbi sv.

– Mos është sëmurë? – dyshoi një plak me republikë me flatra të qjera e me kravatë të zezë.

– A e dini ç'të bëjmë, shokë? I vemi në shtëpi, – tha një plak i hollë e i thatë, tërë kokalla e damarë mavi.

U ngritën dhe i shkuan.

E qietën Sabri Tafën në mes të oborrit, të thyer më dysh mbi shkopin e tij të zi. Ishte tretur e ishte hequr sa mezi mbahej në këmbë. Ishte plakur në dy ditë sa për dy viet.

Me të parë shokët që hynë me radhë në oborr, u gëlltit dy-tri herë dhe bebëzat e vogla iu qullën nga lotët.

– E ç'na u bëre, a i vrarë?! Thamë se kaq e pate!
– bëri shaka plaku nga Labëria, por kjo shaka nuk ia luajti fare terezinë Sabri Tafës.

Ai u zgjati dorën si ndonjë conë dru dhe i bëri zë plakës që të nxirrte në oborr karriqet për miqtë.

– E po na trego njëherë, ç'pate? – e pyetën pleqtë qatë me një zë.

Sabri Tafa i vështroi me radhë me bebëzat e shuara. pastai nauli shtë në një qoshe të oborrit dhe heshti, si një memec. Nuk ishte më ai Sabriu i parë, jo. Këtë e kuptuan menjëherë gjithë shokët e tij. Prandaj, për të marrë vesh të vërtetën, e mbytën me pyetie. Po plakë vështronte si i hutuar qoshen e oborrit. Pleqtë, të pëlluar, vështruan njëri-tjetrin pa ditur se si të venonin. E kuptuan se një hidhërim i madh i kishte rënë në shtëpi Sabri Tafës dhe në heshtie mundoheshin të gjenin mënyrën se si ta naushëllonin.

Më në fund plaku me aylaf të bardhë mori zemër dhe e nveti:

– Allahu na ruajtë, o Sabri! Po mos i ka ndodhur që Zenelit?

Pleqtë, që ia dinin zakonin Sabriut, e vështruan me vëmendje në sv. duke shpresuar të shihnin aty shkëndijat e zakonshme. Por jo. Bebëzat mbetën të shuara, si gjithnjë:

– Po fol de, si e ke Zenelin?

Përcëri bebëzat e plakut mbetën të shuara. Për herë të parë emri i djalit nuk ndizte shtë dhe shpirtin e tij. Për herë të parë ky emër nuk naqallte krenarinë e zakonshme të plakut. Sabriu psherëtiu thellë e me dhimbje të

– Mos pyesni... në Zenelin!

Pleqtë zaurdulluan shtë.

– Mos u cuditni... Na... Këndojeni!

Plaku nxori nga xheni i bizhameve një conë letër të zhumbrosur dhe ia lëshoi në dorë atij me republikë. Ky e hani dhe, ndërsa pleqtë u mblodhën kokë më kokë e vunë veshin, lexoi:

I dashur shoku Sabri Tafa!

Ne ju njohim mirë si minator e si njeri dhe kemi një dashuri të veçantë për ju, se keni qenë punëtor i palodhur e njeri i ndershëm. Po me keqardhje ju lajmërojmë se djali juaj, Zeneli, kohët e fundit, nuk punon mirë e nuk sillet mirë në punë. Kolektivi ynë ju drejtohet juve si baba dhe ju lutet që ta këshilloni...

Sabriu, në kulm të hidhërimit, ia rrëmbeu letrën nga dora: — Mjaft e lexove, — tha, dhe fshiu me kurrizin e dorës sytë. — Ja ç'më ka punuar im bir! Më turpëroi në pleqëri... — U mat të thoshte edhe diçka tjetër, por e mbyti hidhërimi. Më në fund u ngrit dhe, duke u mbajtur pas shkopit, mezi shqiptoi:

— Do të shkoj vetë në minierë!

Pastaj, papritur, thirri me zë të mbytur:

— Plakëë! Më bëj gati plaçkat!

1961

NATA E PARË

Rrezet e fundit të diellit ndriçonin malet e larta, majat e çaçanikëve buzë lumit dhe kulmet e shtëpive të Perasit. Doriu i bardhë ecte me revan duke ngritur pluhurin e imët e të verdhë. Kalorësit i shkëlqenin armët e lara dhe i tundej xhufka e zezë në festen e kuqe.

— Po vjen! — thirri Zylyftari që nga pragu i derës dhe menjëherë oborri u mbush me fshatarë.

Doriu hyri nëpër derën e hapur dhe gurët e kall-drëmit lëshuan xixa nën potkonjtë e tij. Kalorësi vuri dorën në brez, nxori koburen prej sërimi dhe e zbrazi tri herë.

— Të trashëgohesh, o trim! — tha ai duke vështruar Zylyftarin që kishte pleksur duart dhe priste që mysafiri të zbriste nga kali.

— Qofsh me ymër, bej! — e falënderoi djali duke mbajtur kokën poshtë, sikur kishte mbi zverk ndonjë peshë të rëndë. Ndërkaq beu lëshoi këmbën në pëllëmbët e tij të pleksura mirë. Djaloshi shtrëngoi fort gishtat, muskujt, dhëmbët dhe vështroi me zemërim opingën me

xhufkë të zezë, zbukuruar me pafka të verdha, si copëza të vogla floriri.

– I fortë jo, o Zylyftar! – tha mysafiri i lartë duke i rënë me kamxhik fustanellës së tij të gjatë gjer në gju.

– Urdhëro brenda, bej! – e ftoi Zylyftari vetullngrysur, duke i treguar me dorë portën. – Sofra është shtruar dhe nusja të pret!

Beu qeshi me zë, pakëz me zor, shkoi pëllëmbën në mustaqet e mëdha dhe eci me hap të rëndë pas Zylyftarit.

Në një dhomë përdhese ishin shtruar qilima me thekë, poste e shilte të buta dhe në mes të saj një sofër e madhe. Nën tavanin e nxirë varej një perde e dendur tymi që nxirrnin kandilat dhe cigaret. Në një qoshe ishin ulur sazexhinjtë që këndonin e u binin veglave pa pushim.

Sa u ul mysafiri në krye të vendit, Zylyftari iu afrua me legen e me ibrik. Beu, sa për adet, lagu vetëm majat e gishtave të zbukuruar me unaza, i fshiu me një shami të kuqe që nxori nga brezi dhe mori nga sofra një lagjin të madh me verë.

– Të trashëgohesh, o trim!

Zylyftari vetullvrenjtur vështroi gushën e mysafirit, të majme e të qullur me verë. Vuri dorën në zemër dhe pëshpëriti midis dhëmbëve:

– Të paçim me ymër, bej!

Sazet buçitën, ca djem të rinj luajtën një valle me shpata dhe beu u bë shumë shpejt më qejf. Fuste në qese dorën e lyrosur nga dhjamët e miskave, nxirrte një grusht me mexhite dhe ua hidhte sazexhinjve. Këta i rrëmbenin me të shpejtë, i lagnin me pështymë dhe i ngjisnin në ballë. Zylyftari, gjithnjë i vrenjtur, i shtinte verë në lagjin dhe i vështronte me zemërim gushën e majme e të qullur. Vetëm një herë u largua. E thirri i ati në dhomën tjetër, ku ishte nusja me duvak:

– Dëgjo, ore bir. Ç'ke për të bërë, bëje shpejt e mirë, – i tha i ati duke e shtrënguar nga krahët. Zylyftari nuk iu përgjigj menjëherë. – Zylyftar! Ty të them! Më vështro në syl!

I biri ngriti sytë e zinj e të zjarrtë të errësuar nga zemërimi.

– Baba! Edhe mua më ka hyrë shpata gjer në kockë!
Edhe i vdekur të isha, s'do ta duroja këtë turp!

Plaku e shtrëngoi fort nga supet, rënkoj e tha:

– Ky është një kanun i ri që na poshtëron sa s'ka ku të vejë më. Vdekja është më e ëmbël, ore bir!

Zylyftari, si mbeti vetëm, i ngriti duvakun nuses së re.

– Mos ki frikë, moj sorkadhja ime. Në duart e tij nuk të lë... – Nusja u drodh, po sytë nuk i ngriti. Vështronte përdhe, e zbardhur si kartë nga frika. – Veç duro gjer në mesnatë, moj sorkadhja ime! – i tha Zylyftari dhe e la nusen vetëm. Në hajat dikush iu afrua dhe i pëshpëriti në vesh:

– Jemi gati, Zylyftar!

– Skuqeni mirë dhe mprihini fort hanxharët! – e porositi ky me zë të heshtur dhe hyri në dhomë.

Mysafirrit sumbulla djerse i shkëlqenin në ballë, nën festen me xhufkë. Ngriti edhe një lagjin me verë dhe iu drejtua djaloshit duke lëvizur nga vendi:

– Zylyftar, o trim! Mos po ma zë gjumi thëllëzën?

– E shpumë në sarajet e zotërisë sate! – u përgjigj Zylyftari dhe nga zori zbërtheu kopsën në grykën e min-tanit.

– Zylyftar! S'kam ndër mend ta gdhij këtu natën e parë!

– Si të japësh urdhër, bej!

– Shkojmë, o Zylyftar. Ta kesh për nder të madh që po e filloj me ty kanunin e ri... Për nder të madh, ti edhe ajo... A është vërtet thëllëzë?

Djaloshit i kulluan djersë të ftohta dhe mezi tha:

– Si ylli i sabahut është, o bej!

Mysafiri u ngrit, po këmbët nuk e mbajtën mirë. Zylyftari e zuri për krahu dhe e shtrëngoi.

– I fortë je, o trim...

– Këtej, bej, këtej, – i tregonte udhën Zylyftari duke e shtrënguar gjithnjë më shumë.

U hap një derë dhe beu i dehur pa një flakë që ia përcëlloi fytyrën.

– Ku më shpie kështu? – u përmend ai dhe bëri

përpjekje për t'u çliruar nga duart si darë të djaloshit.

— Te kanuni i ri, o zullumçar! Te nata e parë!

Nja shtatë a tetë djem të fuqishëm e rrëmbyen beun në krahë dhe e afruan tek ajo dera e zjarrtë. Aty beu u bë esëll menjëherë dhe pa, para hundës së tij, një furrë të skuqur që lëshonte sillë e flakë, si ndonjë vullkan. U tmerrua dhe thirri:

— Zy...ly...ftaaa!

Djemtë e futën në furrë dhe zëri përnjëherësh u mek!

U bë një rrëmuje e shkurtër në fillim. Sazet pushuan. Dikush shoi kandilat dhe ra një errësirë që të shponte sytë.

— Vëllezër! — thirri Zylyftari duke mbajtur me një dorë koburen me sedef të beut. — Ç'ishte për t'u bërë, u bë! Edhe gjarpri nën gur nuk do ta duronte këtë turp! Tani ai po bëhet shkrymb!

— Të lumtë, o Zylyftar! — thirri një zë i tronditur dhe, pas pak, një plak i shkurtër, që kishte hedhur krahëve një gunë të dhirtë, iu derdh djaloshit në qafë. Plaku nariti dorën. Një rreze e hënës vetëtiu në tehun e prehtë të hanxharit që ai kishte ngritur lart:

— Merrni frymë lirisht, o vëllezër! E pat qafiri! — thërriste plaku dhe tundte hanxharin sikur priste koka njerëzish.

— Tani te sarajet! — thirri Zylyftari. — Le t'u vejë edhe atyre flaka gjer në qiell!

Turma e fshatarëve doli në rrugë tërë zhurmë. Hanxharët e shpatat vringëllonin në ajër. Përplaseshin këpucët mbi truall, përplaseshin dyer e kanate dritaresh. Qanin fëmijët nëpër djepe. Turma, e ndezur nga urrejtja shekullore, hyri në sarajet e beut. Fshatarët hynë nga porta kryesore, nga dritaret, nga kopshti e nga çdo vrimë që të fuste brenda. Hanxharët vringëllonin dhe u çanë kacakët me gjalpë e butet me verë. Një qilar i madh ishte plot me bute të vjetra. Vozat e vogla i nxorën nga dritaret, i bënë vrima-vrima, pinë sa u ngopën dhe pastaj i rrokullisën tatëpjetë në lumë. Zylyftari kishte hyrë te hambarët e bereqetit me një krahë bar. Te një qoshe pa

atë plakun me lianxhar e me gunë të dhirtë. Plaku ishte ulur në bisht e s'levizte.

– Ç'bën aty? – e pyeti Zylyftari duke u vënë zjarrin hambarëve.

Plaku u ngrit, duke u munduar të gjente në errësi të ushkurët dhe brezat.

– As po i ndyva një herë këto saraje, tashti dynjaja le të përmbyses, – tha plaku dhe doli jashtë, se e mbyti tymi...

Flakët i mbuluan sarajet dhe u përhapën nëpër ahurët dhe çdo gjë dukej si në pëllëmbë të dorës. Djemtë e rinj nxirrnin nga ahurët herגיעletë, u vinin gojëza prej litari dhe i shalonin me një të kërcver. Pleqtë tërhiqnin për kapistalli demat e parmendës dhe lopët. Burrat vinin përpara tufat e dhenve e të dhive.

Mbi një gardh kishte hipur Zylyftari dhe, duke u mbajtur pas trungut të një çaçaniku të ri, fliste me zë të lartë:

– Merrni e'koni për të marrë dhe ngjituni përpjetë malit! Suvarinjtë turq nuk do të na lënë rehat. Ata do të vijnë e do ta djegin Perasin!

Aty buzë gardhit ishte nusja e re, pa duvak. Kishte kryeëzuar duart në kraharor dhe vështronte koburen e Zylyftarit që vetëtinte nga flakët, sikur të ishte lyer me gjak.

– Shpejtoni, o vëllezër! Mëngjesi të na zërë në majë të malit! – thirri Zylyftari, dhe mori të përpjetën, në krye të vargut të gjatë të muhaxhirëve.

Hëna lëshonte dritën e saj të zbehtë mbi majat e dheve, mbi zabelet e errëta, mbi kryet e njerëzve që ecnin të heshtur sikur përcillnin ndonjë të vdekur. Fëmijët, të përkundur nga të ecurit, flinin të qetë nëpër djene, në krahët e prindërve, në koshat ngarkuar mbi mushka e kuaj.

– Ku vemi kështu? – e pyeti e shoqja Zylyftarin me zë të heshtur.

– Do të shkojmë lart, në male, – u përgjigj Zylyftari dhe psherëtiu thellë.

Pa arritur në majë të malit, agoi. Atëherë kthyen kryet prapa dhe panë fshatin e tyre. Perasi po digjej i tëri!

— Ia vunë flakën suvarinjtë! — psherëtiu një burrë mbuluar mirë me gunë.

— Qani, o motra! Përse nuk qani? U dogj Perasi ynë e s'kemi për ta parë kurrë më! — tha me lot në sy një plakë gjysmë e kërrusur. — Burrat zunë shtigjet, gratë e fëmijët vazhduan të përpjetën dhe pas pak mali jehoi nga krismat: — Qani, o motra! Përse nuk qani?! Po na i vrasin djemtë! — tha me lot në sy plaka gjysmë e kërrusur, po zëri i saj u mbulua me krismat e armëve, nga hingëllimat e kuajve, nga vringëllimat e shpatave dhe nga lebetitjet e fëmijëve. Kur arritën në majë të malit, shtigjet ranë në qetësi. Suvarinjtë turq u vranë e u grinë. Burrat u kthyen të sakatuar e me hanxharë të përgjakur. Dëgjohej ligjërimi i plakës: — Qani, o motra!..

— Trimat nuk qajnë, — e ndërpreu Zylyftari dhe diç i theri në zemër. Fërkoj kraharorin e përgjakur dhe thirri me zemërim:

— S'është e mundur që të mos gjejmë një vend në këtë botë të madhe! Nisemi!...

U nisën në drejtim të diellit dhe asnjë prej tyre nuk u kthye më në Peras...

1962

PAS MARTESËS

Ishte një nga ditët e fundit të muajit janar, a ndoshta dita e fundit. Dritaret e dhomës zbardhëllonin nga drita mëngjesore me një vezullim të përhimtë. Zarja kishte kohë që ishte zgjuar dhe, pa bërë asnjë lëvizje, kundronte me dashuri fytyrën e Ademit që flinte ende. S'i gëzohej dot të shoqit. E kishte pritur me ankth çastin kur do të zgjohej një mëngjes së bashku me të. Përkëdhelte me sy kaçurrelat e tij, qepallat e puthitura, buzët pakëz të hapura dhe përsëriste me vete:

– Jam e lumtur!

Pikërisht në këtë çast dëgjoji prapa derës kollën e thellë të vjehrrit dhe zërin e tij të ngjirur e qortues:

– S'qenka ngritur nusja jonë?!

Zarja, duke ndier rreptësinë e zërit, u ngrit nga shtrati me kujdes që të mos ia prishte gjumin Ademit, u vesh shpejt e shpejt dhe në majë të gishtave doli nga dhoma.

Plaku që priste te dera, pa e vështruar, i bëri me kokë nga oborri dhe tha:

– Lësho pulat dhe hidhi lopës të hajë.

Zarja e kuptoi se ky ishte një urdhër i prerë, një zakon i vjetër, me anën e të cilit provonin nusët. Plaku

mund t'i bënte vetë këto punë, siç i kishte bërë çdo mëngjes, po, me sa duket, donte të provonte se sa e bindur e punëtore ishte nusja e të birit.

Zarja u sul te koteci. Pastaj rrëmbeu nga mullari një krah me jonxhë të thatë dhe hyri në ahur. Plaku që nga çardhaku tundi kokën i kënaqur. Po, kur Zarja doli në oborr, u ngrys menjëherë.

– Kafënë! – urdhëroi ai.

Dhe, duke pirë kafen, i tha së resë pa e vështruar në sy.

– Shko, shko çlodhu edhe ca.

Zarja, e bindur si një shqerrkëz, u kthye në dhomën e gjumit. Dhe menjëherë ndjeu një boshllëk në zemër. I fluturoi ndjenja flatraartë që kishte ndier pak më parë. Ulur në fund të shtratit, ku flinte i shoqi, priste mos dëgjonte përsëri urdhrat e rrepta të vjehrrit.

Pas një jave ndodhi një gjë e papritur. Zarja, tërë gëzim, hodhi kazmën në sup. Te dera e shtëpisë i doli përpara plaku dhe e pyeti:

– Ku shkon?

– Në rrah, në brigadë.

– Kthehu! – e urdhëroi ai dhe, si e pa vëngër, shtoi:

– Nuset qëndrojnë një vit në shtëpi.

– Baba... – ajo deshi t'i thoshte se ishte marrë vesh me Ademin, po plaku e ndërpreu:

– Zakonet nuk do t'i prish unë. Pas një viti, shohim e bëjmë.

Zarja iu bind urdhrat me zemër të thyer. Nuk donte të fuste grindje në atë shtëpi midis vjehrrit e burrit. Po e ndjeu veten sikur kishte hyrë në një botë të huaj, që e ndante me mur nga jeta e madhe.

Dhe kështu filloi për të jeta brenda katër mureve, brenda gardhit që rrethonte oborrin. Asaj i zinte dora çdo gjë, punonte kopshtin me bel, kujdesej për ushqimin e lopës, pastronte shtëpinë e priste me gëzim mbrëmjen, kur kthehej Ademi nga puna. Po dalngadalë, me kalimin e kohës, muret e shtëpisë u ngushtuan aq tepër, sa ajo filloi të venitej si bima në serat e mbyllura.

Një pasdite po vinte duhan. Ishte fillka vetëm dhe vesa e shiut i lagte shaminë e kokës. Në ugari a në shtëpi kishte pllakosur heshtja. Gjer afër mbrëmjes mezi mbolli dy brazda dhe me asnjeri nuk këmbëu një fjalë. Dhe iu kujtua skuadra e saj kur mbillte duhan. E fillonin punën pa dalë dielli dhe gjer në mbrëmje mbillnin tërë dynmë. Puna kishte duk dhe koha kalonte pa u ndier. Vajzat, të nxehura nga puna, zukanin nëpër ara si bletët dhe përpqeshin kush e kush t'ia kalonte njëra-tjetrës. Në pushimin e drekës kërcisnin shakatë dhe bisedat, lexonin gazetën, thurnin çorape e triko, gjithë duke qeshur, gjithë duke vetëtitë nga gëzimi, sikur s'kishte vajza më të lumtura se ato. Dhe kur perëndonte dielli, s'u bënte zemra të ktheheshin në shtëpi. Duhani mbillet mirë mbrëmjeve, gjer vonë. Prandaj ato nuk largoheshin nga ara, pa i mbjellë tre dynmët. Vetëm kur ngrysej, ato ktheheshin dhe udhët e fshatit zienin nga bisedat e zjarra, nga shakatë, sikur ishte ndonjë ditë e shënuar.

Zares iu kujtuan këto dhe iu drodh zemra nga vetmia. Ugari i shtëpisë, rrethuar me gardh, iu duk si një kafaz dhe e ndjeu veten të dërrmuar. Ndjeu edhe një brengë tjetër të madhe. Ademi, që gjer atëherë këshillohej me të për punët e brigadës, filloi të mos e pyeste më. Zares i dukej sikur ai ishte larguar prej saj, megjithëse sillej si më parë, i dashur e fjalëmbël. Po këto fjalë me kohë u rralluan. Ai s'kishte ç't'i thoshte më. Ajo s'dinte ç't'i thoshte. Po i përsëriste gjithnjë për kopshtin, për lopën, për enët. Ai, i mërziur ndoshta nga këto biseda, kriste e ikte në klub, në kryesi, në mbledhje.

Zarja i jepte të drejtë. I shoqi kishte punët e kooperativës, kurse punët e saj nuk e kapërcenin pragun e shtëpisë. Ademi s'kishte përse të kërkonte ndihmën e saj. Këtë ndihmë ai e merrte nga tjetërkush, ndoshta edhe nga ndonjë grua që punonte a drejtonte në brigadë.

Një mbrëmje, asaj s'iu durua e i tha:

– Adem! S'qëndroj më në shtëpi. Do të dal në brigadë.

Ai e vështroi i habitur:

– Po babai thotë...

– Lëre ç'thotë babai! Këtu po më pëlçet shpirti. Çdo gjë më mbyl, më ndrydh, më poshtëron. M'u neverit vetja, jam ndarë nga puna, nga jeta.

– Punë ke boll edhe këtu...

– Kam, po s'ndiej asnjë gëzim. Kjo punë më dërrmon. Jam katandisur si mos më keq. Më mbulon të qarët, kur kujtoj skuadrën që drejtoja, spartakiadën ku 'dilja e para në vrapim, ansamblin ku këndoja si soliste. S'duroj dot më, Adem. Më ndihmo!

– S'kemi ç't'i bëjmë babait!

Ai mblodhi supet dhe doli si pa gjë të keq. Ky qëndrim i rëndoi Zares si gur në zemër. E ndjeu veten të fyer e të përbuzur dhe furka i ngriu në dorë. Po ajo ndjeu atë çast se në shpirtin dhe mendjen e saj ishte piekur më në fund një vendim i prerë, nuk duhej t'u nënshtrohej zakoneve të mykura të së kaluarës! Nuk duhej! Në asnjë mënyrë nuk duhej!

Ishte ulur mbi shtrat me furkën në dorë. Mbi dyshe-menë që porsa e kishte fërkuar me leckë të lagur, shkëlqenin njolla drite elektriku. Një tufë manushaqesh, që kishte mbledhur rrzëzë gardhit, kishin ulur kryet në kavanozin me ujë. Muret ndrisnin nga bardhësia. Në çdo qoshe të dhomës ndihej dora e padukshme dhe e kujdesshme e amvisës së re. Po amvisa s'e kishte mendjen aty. Ajo mendonte Ademin. E donte. Ai ishte njeri i mirë, punëtor, zemërbardhë. Mendonte Ademin dhe pika lot i binin mbi furkën që i kishte ngrirë në dorë.

Të nesërmen u ngrit pa gdhirë, hodhi kazmën në sup e doli në oborr. Vjehri, ky babaxhan që u ngjallte respekt të tjerëve me heshtjen e tij, vetëm u kollit. Po nusja e re, që e kuptonte domethënien e egër të kësaj kolle, eci përmes oborrit. Kur arriti te pragu, dëgjoi prapa krahëve zërin e tij të ngjirur:

– Ku vete?

Zarja u trondit në fillim. Pastaj mblodhi veten e u përgjigj:

– Në briqadë, baba!

– Kthehu! – e urdhëroi plaku.

– Nuk kthehem, baba! – tha Zarja e vendosur.

– Atëherë... mos u duk më këtu. Këput qafën! – thirri plaku.

Zarja e pa tek vinte drejt saj, me hap të shpejtuar e me shkopin ngritur lart.

– Baba! – tha ajo duke buzëqeshur hidhur. – Po s'më deshi yt bir, nuk vij më në këtë shtëpi. Prandaj mos m'u kërcëno, se nuk më tremb me kërcënime. – Plaku bëri edhe një hap drejt saj duke u dridhur prej zemërimit. – Ti ke hall të mos të dalë nami i keq, – vazhdoi Zarja e qetë e si e vrarë. – Ke hall thashethemet. Po e ke gabim, baba. Ti nuk e kupton dëmin që po më sjell mua, Ademit, vetes... E di që një ditë do t'i braktisëh këto zakone, por atëherë ndoshta do të jetë vonë... Mos harro fjalën që dhe në kuvendin e pleqve...

Vjehrrit iu errësuan sytë. Shkopi i ngriu lart. Zarja doli në rrugë dhe mori drejtimin e brigadës.

Në perëndim shkëlqente një drapër hëne. Në lindje vezullonte Ylli i Mëngjesit. Zarja ecte me hap të shpejtë, me shpirt të tronditur e të turbulluar, po me një mendim të qartë si ai agimi i ditës së re. Nuk dëgjoi që po e thërrisnin. Qëndroi vetëm kur i shoqi e zuri për krahu.

– Zare! – belbëzoi ai me ankth. Kishte vrapuar shumë dhe mezi merrte frymë. Ademi priste që ajo të derdhte lot. Sytë e saj tregonin se ajo ishte aq e pikëlluar dhe e pafajshme, ndiente aq dhimbje në shpirt, sa atij i pikoi në zemër. Kurse buzët e shtrënguara fort shprehnin revoltë e vendosmëri që ai s'i kishte vënë re ndonjëherë. – Zare... S'kam çarë kokën shumë për këto punë, për ty, për babanë. Po tani... babanë do ta bindim, do ta mundim...

Ndërkaq lindi dielli. Sytë e Zares shkëlqyen. Dikush i pa nga larg tek ecnin me hap të shpejtë e të zënë dorë për dorë. Në qendër të brigadës, një zë i gëzuar vajze çau ajrin:

– Po vjen Zarja! Po na vjen Zarja!

ERA

– O i zoti i shtëpisë! – thirri te pragu i derës së çelur i deleguari i rrethit, një djalë i ri, bullafiq, me flokë të dendur e pakëz të dredhur.

– Urdhëroni! – u dëgjua prapa mureve një zë i gëzuar, që u shoqërua nga lehjet e një qeni. Dhe, me njëherë, u dha në oborr një burrë rreth të pesëdhjetave, me këmbë të gjata futur në bollka të gjera e të zeza, me një xhaketë të vjetër ushtarake, veshur me një krah e me një qylaf të bardhë e të gjatë në kokë. Që atje tej ai vuri buzën në gaz dhe zgjati krahët, duke dashur të shprehte me këtë, si duket, gëzimin e tij të papërmbajtur ndaj mysafirit.

– Të prita tërë ditën e ditës, o shoku Teki. Hë se po vjen tani, hë se po vjen pastaj! Po më mirë që erdhe në mbrëmje. Nata është e gjatë dhe kemi kohë të këmbejmë një fjalë... Po, urdhëro! – e ftoi i zoti i shtëpisë, duke ia shtrënguar fort dorën mysafirit, që ngurronte të hidhte hapin matanë pragut.

– E di ç'mendoj unë, o Bajram? Sikur ta masim edhe këtë kopshtin tënd personal, e pastaj hyjmë në

konak, — tha i deleguari duke mbajtur me dorë flokët që ia merre era.

— Si të duash, e masim, — tha pa qejf fshatari dhe shtoi jo pa qëllim: — Veçse unë them se mëngjesi është më i mençur se nata.

Mysafiri, sikur nuk ia vuri veshin, nxori nga çanta që mbante nën sqetull skajin e një metri dhe, duke vështruar nga kopshti që fillonte rrëzë shtëpisë, tha:

— Nesër më presin punë të tjera. Hajt ta masim sa nuk është errur. Apo ke më shumë se tre dynymë?

— Unë? Bah! E ku të lë kryetari ynë tokë të tepërt!

— Domethënë s'ke më shumë se tre dynymë?

— Asnjë pëllëmbë!

— Mirë pra. Tërhiqe metrin!

Fshatari zuri cepin e shiritit me dy gishta të trashë të shkurtër dhe, si hyri në kopsht, e shtriu mbi bar. Nuk shkoi shumë kohë dhe i bënë llogaritë. Për çudi të mysafirit e të vetë Bajramit, u doli më shumë se tre dynymë. Fshatari shtrëngoi buzët, ngriti vetullat, mënjanoi kokën pakëz më të djathtë dhe pyeti i habitur:

— Mos bëmë ndonjë gabim, o shoku Teki? Se kalem është ky i shkretë, ikën e s'e merr vesh ku vete.

— S'ma merr mendja...

— Po edhe mua s'ma merr mendja që të ketë më shumë.

— Atëherë e masim edhe një herë. Tërhiqe! — përfundoi i deleguari duke i lëshuar në pëllëmbë skajin e metrit.

E matën përsëri dhe përsëri u doli më shumë se tre dynymë.

— Çudi! Kurrë s'ma merr mendja! — tha si me vete Bajrami duke kruar zverkun me një kleçkë të thatë. — Po fundi, një pëllëmbë tokë është më tepër! S'ka gajle!

— Jo një pëllëmbë, po dy dynymë, — qeshi mysafiri pa të keq, futi metrin në çantë dhe e vështroi fshatarin me dinakëri. — Pa më thuaj, o Bajram, si e ke zhvatur këtë tokë?

Fshatari kroi përsëri zverkun me kleçkë dhe u përgjigj.

– Me ç'më thotë mendja mua, gabimi i parë është bërë që në fillim fare, kur krijuam kooperativën. Atëherë s'do ta kenë matur drejt. Po ndoshta edhe gruaja ime mund të ketë faj në këtë mes, se ajo e punon kopshtin. Gërmo vjet një brazdë, gërmo sivjet një brazdë tjetër, fute shatën një çikë këtu e një çikë atje tej, dhe ja, e fitove një dynym. Po kjo është punë që rregullohet. Gjer ku më takon mua, the?

– Ja, gjer këtu! – tregoi mysafiri vendin me majën e këmbës.

Fshatari rrëmbeu një gur sa një bukë furre dhe e lëshoi te këmbët e mysafirit:

– Ja edhe sinorin e ri e caktuam, – tha ai, fshiu pëllëmbët në të qepurat e bollkave, veshi mëngën tjetër të setrës dhe shtoi duke qeshur. – Tani urdhëro brenda, se edhe u err!

E shoqja e Bajramit, një grua nikoqire dhe e shka-thët, ndërsa burrat bisedonin në kopsht, shtroi sofrën, lëshoi mezetë e rakinë dhe u turr në ashef për të përgatitur darkën Kishte therur një pulë, kishte skuqur amur dhe kishte vënë saçin. Nën një saç tjetër piquej në çerep kulaçi një pëllëmbë.

Mysafiri dhe i zoti i shtëpisë pinë, hëngrën dhe biseduan gjer në mesnatë. Biseduan doemos për punët e fshatit, për kooperativën, për planet e saj, për njerëzit e saj. Po më shumë biseduan për ndërgjegjen. I deleguari i shpjegoi se kishte tre muaj që bridhte nëpër kooperativat dhe se në çdo fshat kishte gjetur të meta që kishin të bënin me ndërgjegjen e ulët të njerëzve. Në një fshat, i biri i botës kishte dy vjet në kooperativë dhe kaun e mbante fshehur në mal. Në një fshat tjetër, njëzet alamet burra kishin bërë tërë vitin njëzet ditë pune, kurse shumë kopshte personale kishin tokë më shumë se tre dynymë.

Bajrami e dëgjonte me vëmendje dhe e kuptonte se ku donte të dilte mysafiri, po bënte sikur nuk e merrte vesh.

– Ke të drejtë, shoku Teki. Tamahqarllëku e prish njeriun. Edhe në fshatin tonë ka të tillë.

— Po ja, ta fillojmë nga ti, — tha më në fund mysafiri. — Ai dydynmëshi yt i tepërt tregon se edhe ti nuk je në rregull me ndërgjegjen...

— Oo, tani ma prishe qejfin, mos e thuaj atë fjalë, — e ndërpreu menjëherë fshatari, i pakënaqur. — Unë ta dija se e kisha të tepërt, kisha hequr dorë me kohë.

— Mos m'i merr për keq fjalët e mia, o Bajram, — i tha urtë e butë mysafiri dhe e vështroi me vëmendje për të kuptuar në i kishte thënë Bajrami me tërë mend ato fjalë, apo e kishte gënjyer.

— Për keq nuk t'i marr, po sikur më dokëndise një çikë.

— Se të thashë s'je në rregull me ndërgjegjen?

— Po.

— Fundja ne tanët jemi e s'prishemi për një fjalë. Hajt, gëzuar! Mirë se të gjeta! Ky është shëndeti i... — dhe Tekiu ngriti një doli. Dhe, duke pirë gotat, vështronte me bisht të syrit fytyrën e vrarë të Bajramit dhe bindej gjithnjë më tepër se fshatarit i kishte ardhur shumë keq jo nga fjalët, po nga toka që kishte humbur.

— Unë ta them edhe një herë, o Bajram, se ti s'je në rregull me ndërgjegjen. Të shoh në fytyrë. Të ka ardhur keq për atë copë tokë.

— Jo. E ke gabim. Nuk më vjen keq për tokën, po për fjalët që më thua. Si s'qenkam unë në rregull me ndërgjegjen, kur jam në rregull me tërë punët e Partisë e të shtetit?!

— Po ja, me tokën këtu s'ke qenë në rregull, — nguli këmbë Tekiu duke përplasur në sofër gishtin tregues të dorës së djathtë. — Domethënë, në këtë rast, ti ke vënë interesin tënd mbi interesin e kooperativës. Dashje pa dashje, po e ke vënë. Është kështu apo jo?

— Dale, prit...

— Jo, jo! M'u përgjigj.

— Dale një herë... Të shpjgohem...

— More, po m'u përgjigj këtu. Është kështu apo jo? Mos më thuaj dale, dale!

Bajrami hoqi qylafin e bardhë dhe kroi kokën e qethur e të thinjur.

– Po ta shohësh aq thellë, domosdo që ashtu është.

– Këtu të kam! – thirri i gëzuar mysafiri. – A e sheh se si e pranove më në fund.

– Vetëm se unë një gjë të tillë s'e kam bërë me dashje.

– Ajo s'ka rëndësi. Rëndësi ka që ti më në fund e pranove. Dhe kjo tregon se ti i kuptove drejt gjithë ato që thashë unë për ndërgjegjen.

Mysafiri duket se ishte lodhur shumë, mbasi, me të vënë kokën në jastëk, fjeti menjëherë. Kurse Bajrami nuk vuri gjumë në sy. Sa dëgjoi gërhitjet e para të Tekiut, u ngrit ndenjtur, u shtrua këmbëkryq mbi dyshek dhe ndezi cigaren te flakëza e verdhë e kandilit. E vërteta është se kishte pirë një çikë si tepër, po rakia s'e zuri, sikur të kishte qenë ujë e jo raki. Mendjen e kishte fare të kthjellët, si e ka zakonisht njeriu në mëngjes, pas një gjumi të thellë. Prandaj u bind menjëherë se tërë ato që kishin ndodhur atë mbrëmje, nuk ishin ëndrra po të vërteta. Ndryshe i kishte bërë planet Bajrami, dhe ndryshe i doli. Ai kishte menduar që ta merrte me të mirë të deleguarin, t'i jepte të pinte e të hante mirë dhe, kur të vinte puna për të matur kopshtin personal, ta masnin këtë me sy dhe ta shënonin në dokument jo më shumë se tre dynymë. Mirëpo s'ia hodhi dot. Kopshti u mat dhe dydynmëshi iku! Dhe kjo gjë e bëri esëll. Rakia s'e zuri dhe gjumi s'e zuri! Shtatë vjet me radhë, që kur u krijua kooperativa, ai e punoi atë copë tokë si e punon një bujk i mirë dhe toka e shpërbleu me tërë të mirat. Kurse tani, tjetërkush do ta gëzonte! Dhe ja ku është shtrirë e po gërhet ai që e mati kopshtin e tij. Ja ku e ka edhe çantën pranë jastëkut. Në atë çantë është metri i gjatë. Me atë metër i dolën në shesh hiletë.

Bajrami rënkoi dhe padashur u ngrit e hodhi bishtin e cigares në vatër. Siç ishte, me brekë e me këmishë, hodhi dy-tre hapa nëpër dhomë dhe qëndroi përpara dritares që binte në kopsht. Matanë saj nuk dukej

gjë prej gjëje, se nata ishte e errët pus. Po me sytë e mendjes pa sinorin e ri që e kishte shënuar vetëm një gur sa një bukë furre. Nesër, që në mëngjes, do t'i vinte kryetari i kooperativës, do të ngulte hunjtë te sinori i ri dhe pjesën tjetër do ta fuste në blloqet e kooperativës.

«Iku dydynmëshi, vate!» — psherëtiu Bajrami me vështrimin ngulur në errësirën e natës. I vinte keq sa s'bëhej për atë copë tokë. I dukej sikur ajo tokë ishte edhe shpirti i tij, edhe jeta e tij, edhe lumturia e tij. Dhe e ndante atë tokë vetëm një gur, vetëm një copëz që ai e kishte vënë me duart e veta. Po, po, me duart e veta e kishte vënë aty ku i kishte thënë i deleguari... E përse nuk e vuri një çikë më tej?... Po, vërtet, përse nuk e vuri një çikë më tej gurin, një pëllëmbë dy pëllëmbë më tej. S'do të bëhej ndonjë kiamet i madh! Dhe kështu do të kishte përfituar edhe dy pëllëmbë tokë!

Bajrami mendoj këto dhe ndjeu të ftohtë në shpirt, sikur e trembi njeri. Në të vërtetë ai nuk u tremb nga njeri, se s'kishte kush ta trembte. I deleguari kishte zënë vend mirë dhe nuk gërhiste më. Në dhomë dëgjohej vetëm frymëmarrja e tij e rregullt. Po Bajrami u tremb. Dhe u tremb nga mendimi i tij që i shkrepri papritur aty për aty: «E ç'bëhet sikur të vete tani e ta shtyj atë drejt gur dy tre hapa më tej? Kush do ta marrë vesh? Se mos do të rrijë Tekiu e ta masë përsëri? Ai do të ngrihet në mëngjes e do të zhduket nga sytë këmbët!

Këto mendoj dhe u tremb, po i erdhi edhe mirë, kur mendoj kështu. Dhe ndjenja e frikës u përzie edhe me ndjenjën e gëzimit. Po menjëherë frika iu zhduk dhe në shpirt filloi t'i gurgullonte si një burim i fshehur gëzimi për mallin, për tokën, për pasurinë e tij.

Pa menduar më gjatë eci në majë të gishtave dhe doli në kopsht. E kishte humbur fare mendjen, prandaj doli zhveshur. Që atje tej dukej si vinte vërdallë gjysmë e përkulur një hije e murme. Ecte me këmbë e me duar duke kërkuar diçka.

E gjeti më në fund gurin e sinorit dhe e rrëmbeu në

krahë. Zemra i rrahu atë çast dhe, sikur të ishte ditë, në fytyrën e tij do të dallohej një buzëqeshje e këndshme e ngadhënjimtare. Bëri një hap, dy, tre, duke numëruar me vete sa herë hidhte këmbën dhe qëndroi. U përkul për të lëshuar gurin. Po për çudi, guri sikur i qe ngjitur në duar e në kraharor dhe nuk i shqitej. Ai bile e lëshoi gurin me forcë, e ngjeshi në dhe, po kur u ngrit, u ngrit së bashku me gurin.

– Çudi, – pëshpëriti me vete Bajrami, – më është ngjitur guri në duar! Bëri edhe një hap më tej. U përkul dhe lëshoi gurin. Po ai përsëri nuk u shqit. – Çudi! – qeshi Bajrami dhe sepse e shtrëngoi atë copë gur pas kraharorit, tamam ashtu si shtrëngonte një herë e një kohë gruan e tij. – Sa i dhembshëm qenka sinori! – pëshpëriti ai me zë, i gëzuar, sikur zbuloi ndonjë thesar fshehur diku në një vend të paditur.

Bëri edhe tre hapa të tjerë. U mendua pak, duke u vënë veshin zhurmave të heshtura të natës, dhe e lëshoi gurin midis këmbëve të tij.

– Mjaft! S'dua më shumë! – mendoi dhe bëri për nga shtëpia, me hapin e tij të gjatë një pash. Por te qoshja e shtëpisë qëndroi. Një mendim tjetër i shkrepiti aty për aty dhe e bëri të trembej. Po, duke e bluar në tru këtë mendim, më në fund, u qetësua dhe vendin e frikës e zuri përsëri gëzimi. U kthye menjëherë te sinori i tij dhe, duke ngritur gurin me të dy duart, tha me vete:

«Me siguri, Tekiu as që ka për ta parë më kopshtin tim! Kur të vijë kryetari, do të pyesë dhe Tekiu do t'i thotë se kemi vënë një sinor të ri. Kryetari do të shohë gurin dhe do të ngulë hunjtë. Dhe toka mbetet përsëri imja! Si nuk ma preu që në fillim, po kam një orë që vras mendjen e po plevitosem në këtë të ftohtë?!»

E kështu, pasi vendosi gurin te sinori i vjetër, u kthye shpejt e shpejt në shtëpi, vuri veshin prapa derës dhe, si u sigurua se i deleguari flinte, shkoi e hyri drejt e në dyshekun e tij të ftohtë akull. Po gjumi nuk e mori, me gjithë përpjekjet që bëri për të fjetur. I rëndonte një

diçka në zemër. E kuptonte se nuk kishte vepruar mirë e drejt. Kishte edhe një boshllëk të madh në shpirt.

«Eh! S'bëra mirë! – rënkonte dhe kthehej në krahun tjetër. Por me t'u kthyer pyeste veten: – E përse s'bëra mirë? Hajt fili, more Bajram vëllai. I thonë dy dynymë, jo shaka! Aq mirë bëre, sa s'ka ku të vejë më!»

Vetëm ndaj të gdhirë, kur filluan të këndonin gjelat, e zuri gjumi. Po tamam atëherë erdhi e shoqja dhe e zgjoi:

– Ngrehu, se ka ardhur kryetari! – i tha ajo duke e shkundur nga krahët.

U ngrit me zemër të plasur dhe u habit, kur pa bosh dyshekun, ku kishte fjetur mysafiri. Menjëherë iu kujtua ajo që kishte bërë gjatë natës dhe gjumi i doli aty për aty, sikur ia hoqi njeri me dorë.

– E, si m'u gdhive, o shoku Teki? A bëre ndonjë çikë rehat, se... çoku kemi ndonjë plesht të mallkuar! – e pyeti Bajrami mysafirin, duke ia shtrënguar dorën me dashamirësi e duke qeshur me tërë shpirt. Në të vërtetë ai qeshte me shumë zor dhe donte që të ikte sa më shpejt ky i deleguar.

– Mirë, të falem nderit! – u përgjigj Tekiu dhe iu drejtua kryetarit të kooperativës, që kishte ardhur me dy anëtarë të tjerë të kryesisë. – Kemi bërë një bisedë shumë interesante me Bajramin për çështjen e ndërgjegjes. Apo jo, Bajram?

– Vërtet! Unë, njëherë, mbeta shumë i kënaqur! Tani kushdo që të më pyesë ia jap xhevapin aty për aty se ç'është ndërgjegjja! – u përgjigj i zoti i shtëpisë, duke parë nga dera e ashefit, nga frika se mos i dukej në ballë ajo që kishte në zemër. – Moj grua, a na i poqë kafetë? – thirri ai dhe, sa mbaroi fjalën, te dera e ashefit u dha e shoqja me tepsi në dorë.

Burrat thanë nga një «për gëzime» dhe filluan t'u frynin filxhanëve e të pinin kafën.

– Kështu, o shoku kryetar. Sinorin e ri të Bajramit e shënuam me një qur. E vuri vetë Bajrami, – tha duke dalë në rrugë mysafiri, i ndjekur nga të tjerët.

Bajramit ia bëri zemra «tak» po nuk e dha veten. Hyri në mes të kryetarit e të mysafirit e tha me plot gojën:

– Është një gur shtufi goxha i madh.

– Ou! – klithi i habitur i deleguari duke vështruar nga kopshti.

– Ç'pate? – e pyeti kryetari.

Bajrami u mbërthye në vend dhe mezi kapërceu pështymën.

– Shiko, shiko! More Bajram! – e thirri i deleguari duke e vështruar me dinakëri.

– Urdhë...ro! – iu mbajt goja fshatarit.

– Kush e ka luajtur nga vendi këtë gur? Kush e ka shpënë përtej sinorit të vjetër?

Kaq ngushtë u zu Bajrami, sa s'mundi të gjente një gënjeshtë. Hapi gojën e foli atë që i erdhi aty për aty:

– Ndoshta era e ka shpënë, shoku Teki! Se natën ka fryrë një erë e marrë fort...

– Ah! Këto gjynahet e erës! – tha me të tallur i deleguari, u shkeli syrin fshatarëve dhe e shpuri gurin te sinori i ri.

1962

KUR JE E VOGËL

Prej kohësh kisha vendosur ta bëja atë që bëra atë natë shtatori. Kur u err mirë, mora armët, ia hipa Arapit dhe u nisa. Motra më pyeti se ku do të shkoja, por unë, si gjithnjë, nuk i tregova. Ajo ishte e vogël, dymbëdhjetëvjeçe, dhe unë asnjëherë nuk i kisha treguar se ku vija e çfarë bëja. As që më shkonte ndër mend ta ngatërroja atë me punët e rrezikshme të luftës. Ajo ishte e vogël, trupin e kishte të imët, të thatë, të shkurtër. Mezi mbante fshesën. Tamam kalama. E ç'ndihmë mund të të japë në kohë lufte një motër e vogël si Nora ime?

Me të dalë nga kasollja, kali mori revan nga luadhet e kënetës. Ishte mësuar ta bënte atë udhë pothuaj çdo natë. Gjithë netët e verës i kaloja në luadhet. Pengoja kalin dhe e lëshoja të kulloste. Vetë shtrihesha në tokën e ngrohtë dhe vështroja yjet.

— Këtej, Arap! — i fola duke i rënë me pëllëmbë në qafë. — Sonte nuk do të kullosësh. Sonte kemi punë tjetër, Arap.

Mezi m'u bind, po më në fund mori xhadenë. Pas një ore iu afrova urës dhe aty bëra atë që kisha menduar prej kohësh të bëja. Në ndërtesën njëkatëshe ishin

ata, armiqtë. Në një dritare të hapur kishte dritë. I pashë. Po këndonin e po pinin. Siç isha mbi kalë, përplasa granadën në gurin që mbaju në torbë, dhe e hodha drejt e në dritare. Sa numërova gjer më pesë, ajo shpërtheu. Ndërkaq hodha edhe granadën e dytë. Kali u ngrit një herë kas dhe mori vrapin drejt kënetës. Atje brenda u bë panik. Dëgjova lebetitje. Kur ktheva kokën, pashë te pragu i derës një ushtar, a ndoshta oficer, me brekë të bardha. Në një dorë mbante revolverin e në tjetrën një shishe. Atëherë krisi mitralozi nga një vend i fshehtë që unë nuk e kisha zbuluar më parë. Më theri gjuri dhe shpatulla e djathtë. I them kalit:

— Arap, jepi sa të të hanë këmbët, po kujdes, se jam plagosur.

U bëra njësh me qafën e tij të zezë duke u mbajtur me një dorë, se tjetrën e kisha të këputur. Dredhuam rrugë e pa rrugë nëpër llucën e kënetës, kapërcyem mbi kallamishte e mbi hendeqe dhe ndjeva si më troshiste vrapimi i çmendur i kalit. Arapi u bë qull. Shkuma e verdhë u përzie me gjakun tim. Kjo erë e rëndë më ra në kokë dhe mezi u mbajta me dorën që e kisha mbërthyer si darë në jelen e tij. Buzët m'u thanë, ajri që i skuqur, me gojën hapur thithja prush, dikush më godiste me grusht në mushkëri, m'u duk sikur kisha hipur mbi zemrën time. Papritur fluturova nga kali dhe rashë në dhe të butë, në baltovinë. Kur erdha në vete, dëgjova lehjen e qenve të tyre. Po më ndiqnin. Dëshën të më zinin, të më varnin të gjallë e të kënaqeshin duke parë gjuhën time të zgjatur. Ç'të bëja? S'kisha më fuqi, plagët më çanin dhe prita... S'ka gjë më të ndyrë se të presësh në të tilla raste, të presësh qentë të vijnë e të të zhvasin. Më erdhi turp nga vetja dhe m'u duk sikur kapërdiva një mi të ngordhur. Ngrita kokën për të parë kalin dhe m'u duk sikur kisha rënë mbi një sfurk. Tri bigat e sfurkut kishin hyrë në kurriz e më kishin dalë në kraharor. Ç'gjë e fëlliqur, mendova dhe pyeta me zë: — Kush më solli në këtë varr? Arapi, vetja ime apo ata, armiqtë? Tri rrugë kam, pëshpërita, zgjidh e merr: O mbytu në kanal,

o hiqja vetes, o lëre veten të të shqyejnë qentë! – Po s'bëra asnjërin prej tyre. Ngula buzët në dno, thitha lëngun e trasnë dhe i bëra zë Arapit që nuk e shiqa ku ishte! Pas pak pashe kokën e tij mias kallamishteve.

– Ç'më bëre, Arap, – e qortova. – Më hodhe në llucë.

Ai shkrofëtiu dhe tundi jepen. M'u duk sikur më tha: «I desne vetë të bije. Pse më hiqe pa samar?»

Aty e kuptova gabimin që kisha bërë. Duket t'i kisha vënë patjetër samarin! Në samar mund të mbahet më lehtë i plagosuri. Po ishte kalë i mrekullueshem Arap. Kuptonte si njeri. I rrasnë lentë te gjunjet e këmbeve të para dhe ai u shtri pranë meje. Une i hipa me mundim të madh. Kur e ndjeu se isha qepur mire, u ngrit dhe mori vrapin. Atëherë aty pranë lehën qentë dhe krisen pushkët. Unë, si në një ëndërr të turbullt, dëgjova mbytur trokun e tij dhe rështërimën e kallamishteve...

Kur hapa sytë, pasnë tytyrën e hequr e të menduar të motrës sime të vogël. Pashë nga dritarja e hapur Arapin që hante bar pranë mullarit! U binda që isha në kasollen time.

– Ku i kam armët? – pyeta se m'u duk sikur dëgjova lehtjen e qenve të tyre.

– I kam fshehur, – m'u përgjigj një zë i njohur.

Ishte ngula sytë motrës dhe m'u duk kaq e pikëlluar dhe kaq e vogël, sa s'mund ta them dot. Dhe dëgjova përsëri lehtjen e qenve të tyre. M'u duk sikur vaekja vinte rrotull kasolles dhe priste me durim të madh gjersa të vinte çasti për të më zhvatur. Tani e kisha kuptuar se vdekja ishte një kafshë e tmerrshme, e përbindshme, si armiq të. Dhe fillova të gjykoja si një plak i moçëm para vdekjes, megjithëse isha njëzetvjeç djalë.

– Kaloi koha ime, u plaka, motër, – i thashë, – dhe ti je kaq e vogël.

Papritur mbylla sytë dhe më zuri gjumi, një gjumë

i thellë pa ëndrra, pa dhembje, pa shqetësime. Po u zgjova, kur ndjeva se dikush më tërhiqte nga shpatullat dhe më thoshte me ngulm:

– Po vijnë! Po vijnë!

Isha si i ngrirë dhe mezi e kuptova rrezikun. Nora më kishte nxjerrë te pragu i derës dhe më tërhiqte me duart e saj që mezi mbanin fshesën. Dielli që porsa kishte dalë më vrau sytë, po ata i pashë, njëri i ri, e tjetri plak, të armatosur. të djersirë, të zemëruar. Munda të thosha:

– Më lër, o Norë, është e kotë.

Po ajo s'më la. Më tërhoqi prapa kasolles duke qulçuar. Më futi midis shpendrave e luleve të gjarprit si në një rrjetë merimangash.

Ata mbërritën, i ranë Arapit me kondak në barkun ku ishte mpiksur gjaku im dhe kontrolluan kasollen. Shnendrat po më merrnin frymën me erën e tyre të rëndë. Dhe më hipi dëshira t'i shoh afër, sy në sy.

Mbaia frymën, ruheshia mos kollitesha, megjithëse shpendrat e lules së gjarprit më ndillnin një teshtimë të padurueshme. Dëqjova zërin e më të riut:

– Kjo është fëmijë, s'di të gënjejë. Ai me siguri u mbyt i plagosur.

– Fol, moj qurravece! – shau më plaku.

Kurse mua më zuri gazi i heshtur, i sëmurë, i shurdhër. Dhe mendova:

«Ah! Sikur ta kisha Norën më të madhe!»

Ata dolën te pragu i kasolles dhe po hanin diçka. Pashë Norën që ua mbushi gotat edhe një herë me qumësht.

«Farmak jepu, moj Norë!» – pëshpërita me vete.

I riu e piu gotën, kurse ai tjetri e flaku me arihtë qumësht dhe u drejtua nga unë. Pashë çizmen e tij tërë baltë dhe dëqjova zërin e tij.

– Këtu është, këtu...

Atëherë unë ndjeva erën e rëndë të çizmes, laçështirën e këndshme të dheut dhe pashë gjurin tim të plagosur...

Kur u përmenda, e pashë veten të varur kokëtatëpjetë në manin e zi të oborrit. Ai më i kaluari në moshë pyeti Norën:

– Ti je vajzë e mirë. Pa na sill pushkën e tij.

E pashë budallaqen, si vrapoi te mullari dhe nxori pushkën time e tha:

– Urdhëroni!

– Po fishekët?

– Po revolverin?

– Urdhëroni!

– Po granadat?

– Ato mund t'i ketë këtu, – tha dhe u tregoi torbën e rëndë që mezi e mbante në dorën e saj të hollë.

– Je vërtet vajzë e mirë, – tha më i riu. – Ne ty s'të bëjmë kurrajë.

Atë çast unë e urreva motrën time të vogël. Ajo u dha çdo gjë. Ajo u dha shpirtin tim, armët. Pa armë në kohë lufte s'je kurrgjë. Unë tani s'isha asgjë. Unë isha një njeri i varur kokëtatëpjetë në një degë mani. M'u mbushën sytë me lot dhe mallkova dreqin e zotin që nuk kisha një motër të madhe, e cila, të paktën, të më jepte zemër në çastet e fundit të jetës, dhe të mos më tradhtonte. E urreva motrën, e përbuza shumë më tepër sesa e kisha përbuzur gjer atëherë. E vështrova me neveri tek rrinte te pragu i derës si një zog pa krahë dhe se pse më erdhi keq. Mendova: «S'ke faj ti, o Norë, ka moshë. Ç'ndihmë mund të të japë në kohë lufte një fëmijë si ti?!»

I riu vërviti rripin si prazhdë dhe ma ngjeshi në trup. Rripi u ngjiti një çast në krahërorin tim dhe, kur u shkëput, mori me vete një copë të vogël lëkure. Tjetri më nguli majën e thikës në gjurin e plagosur dhe tha me habi:

– Çudi! Si kërcet kocka!

Unë u përpoqa më kot të mblidhesha nga dhembja, se nuk mund të mblidhet njeriu, kur është i varur kokëtatëpjetë. Po arrita të shihja motrën që mbuloi fytyrën me të dy duart. Ndjeva se si m'u zbërthyen gjithë nyjat. Pastaj m'u duk sikur m'u hoq kapaku i kokës dhe trutë

m'u derdhën përdhe. U mundova të ngrihesha, por trupi me zgjatej si llastikë. Një peshë e hidhur dhe e rëndë më holloi si pe. Ata më binin, unë hollohesha si ai krimbi. Do të kisha ulëritur, po më vinte keq për Norën, e cila, për një çast, m'u zhduk nga sytë. Për t'i dhënë zemër asaj, i thirra:

– Mbahu, Norëë!

Ata më goditën përsëri, kurse mua më zuri ngërçi. Ndjeva dhembje vetëm në gju, kurse trupi m'u duk sikur ra kokëtatëpjetë në një hon të zi. U përpoqa të mbahesha pas pushkës, po u kujtova se atë ma kishin marrë armiqtë. S'ma kishin marrë. Ua kishte dhënë motra.

– Ç'më bëre, moj Norë! – belbëzova.

Më goditën përsëri dhe m'u duk sikur më vunë në një presë gjigante. Më shtrydhën nga koka gjer te këmbët. M'u bë vetja si një dhembje e mbledhur kutullaç. Mishi m'u shpërnda copa-copa, vetëm një pjesë e trurit më mbeti, e bardhë e e përgjakur. Atëherë thirra për të fundit herë me dhembje: Lamtumirë, motër!

Njëzet vjet isha mësuar të rrija me këmbë mbi tokë. Papritur, rri kokëtatëpjetë. Dhe një këmbë e një shpatull s'e ndiej fare. Dhe një erë e ftohtë më fryn në shpirt. Këmbë e duar më ngatërrohen sa nuk marr vesh ku janë duart e ku këmbët dhe kjo është një gjendje poshtë-ruese. Po përsëri mendoj për motrën time të vogël dhe mezi shoh trupin e saj të imët që del përsëri te pragu i derës. Ajo mban në duar një pushkë më të madhe se veten. Nuk është pushka ime. Është një belgjik. Merr shenjë. Pastaj nuk shoh gjë, se ata ma veshën sye me rrip. M'u duk sikur u ktheva vetëm në një pellg të mavijosur, në një thes, ku ishte futur një trup i prerë copa-copa. Po me një kënd të paprishur të syve pashë atë, motrën e vogël, që merrte shenjë drejt meje.

– Tërhiqe këmbëzën, pëshpërita, – i ëmbël do të jetë plumbi yt.

Mbylla sytë krejt dhe mendova se është më mirë të vdesësh nga plumbi i një motre të vogël sesa nga torturat e armiqve. Po ajo u vonua. Me mundim hapa një-

rin sy dhe e pashë Norën të mbuluar nga djersët. Mendova se çdo njeri që lufton me vdekjen, mbulohet me djersë të ftohta. Pastaj humba, se ata filluan përsëri nga e para. Humba kohën, ndërgjegjen, çdo gjë. M'u përzier ditët, orët, minutat, sekondat. Gjithë bota m'u përzie dhe mendova shumë turbullt: «Koha, njeriu, bota. Çdo botë ka boshtin e vet, çdo njeri ka kockën e vet. Rreth tyre vërviten. Po unë ku vërvitem? Rreth manit të zi. Dhe motrën, e kam të vogël. Ajo s'di ç'është njeriu e bota! Ajo është e vogël fare!»

Më përmendi një krismë pushke. Me siguri ishte ajo, Nora. Prita plumbin i qetë, po nuk ndjeva gjë. Dhe atëherë pashë se si, ai që më ngulte thikën te kupa e gjurit, ra përfund manit. Flokët e mi prekën fytyrën e tij. Thë fjalën e tij të fundit, të ndyrë:

— Kodosh!

Unë s'flisja dot. E pështyva në gojën që i mbeti hapur.

Ajo qëlloi përsëri. Tjetri, më i riu, u plagos në gju, ulëriu dhe u tërhoq zvarrë gjer te mullari, ku hante bar Arapi. Atje vuri në sy automatikun, po një plumb tjetër e mori nën sisën e majtë dhe s'tha asnjë fjalë...

...U përmenda natën vonë, te stanet, i mbështjellë me poste delesh. Midis partizanëve e barinjve, dallova atë, motrën time të vogël. Flinte e mbështjellë edhe ajo me poste delesh, anës zjarrit.

E pyeta i habitur:

— Kur u rrite ti, Norë?

Ajo s'më dëgjo. Flinte.

1970

PORTRETI

Piktori F. S. u ul përpara telajos dhe, për një copë herë, vështroi me vëmendje gruan që do të pikturonte. Ajo ishte një grua e re vietnameze, nja tridhjetëvjeçe, veshur me uniformë ushtarake, me gradën major. Ishte ulur në karrige, me kurrizin pas murit dhe, meqë ishte shumë e vogël nga trupi, majat e këmbëve mezi i çiknin dyshe-menë. Kishte një ballë të gjerë, të vrenjtur, mbi të cilin kishin rënë një tufë flokësh të zinj e të drejtë; dy sy të mëdhenj, të lodhur e të menduar; dy mollëza faqesh të mëdha e të rrumbullta dhe një palë buzë të trasha, pakëz të përthara, në ngjyrën e manushaqes.

— Nuk ka tipare shumë të theksuara, — tha piktori duke hequr vijëzat e para mbi kartonin e bardhë. — Po, megjithëkëtë, mund të dalë një portret interesant.

— Shoku piktor, — e ndërpreu përkthyesi, — Ngyien Ti Çjena ka dhembje në kokë, prandaj do t'ju lutem të mos e mundoni shumë.

Piktori hodhi lapsin mbi togun e ngjyrave dhe tha:

— Po të jetë e sëmurë, mund ta pikturoj një ditë tjetër.

– Ajo ka dhembje të vazhdueshme në kokë. Ka hequr shumë. Ka parë vdekjen me sy. Nuk mund të qëndrojë dot me orë të tëra, siç dëshironi ju. Ka nevojë për pushim.

Ne heshtëm një grimë dhe në atë heshtje, që ra pezull në dhomën e madhe të hotelit, vështruam të dy Ngyien Ti Çjenën. Kishim folur frëngjisht dhe ajo nuk na kishte kuptuar. Buzëqeshte pakëz e hutuar dhe priste urdhrat e piktorit.

– Po të lodheni, më thoni.

– S'ka gjë. Mund të aëndroj. Vazhdoni punën, – u përgjigj ajo me zë të ëmbël e të butë, si të një fëmije.

– Shoqëruesi më tha se keni parë vdekjen me sy.

– Pse ta fsheh. Është e vërtetë. Thonë se e kaluara duhet harruar, sidomos kur ajo ka qenë e hidhur. Unë nuk mund ta bëj një gjë të tillë.

– A mund të më tregoni diçka nga jeta juaj? – e pyeta.

– Me gjithë qeif, në qoftë se nuk i prishim punë shokut piktor, – u përçajigj ajo.

– Përkundrazi, më ndihmoni, – tha piktori, duke mos ia hequr sytë gruas, sikur të donte të hynte thellë në shpirtin e saj ende të panjohur për ne.

Dhe ajo filloi:

– Kam qenë pesëmbëdhjetëvjeçe kur u çlirua tërë Vietnami dhe kur francezët filluan sulmin në Saigon nga Tajlanda e nga deti. Ishte viti i tmerrshëm 1945. Them i tmerrshëm, se ai ishte viti i zisë. A e dini ju se ç'do të thotë zi buke? Ndoshta e keni lexuar në gazetatat që atë vit vdiqën nga uria dy milionë bashkatdhetarë të mitë. Dy milionë! Ndokush e dëajon këtë shifër dhe e kalon si pa rrië të keq. Por pa ndalu një grimë e mendo. Janë dy milionë njerëz të shtrirë pa frymë nëpër rrugët e qyteteve, nëpër orizoret e fshatrave, nëpër xhunalat e egra. Me kokallat e tyre mund të bëhet një mal i lartë, që të shihet nga çdo skaj i botës. Me dy milionë njerëz mund të nrihet një shtet më vete, mund të thahet një ocean, mund të rrëzohen nga fronti perënditë. Japonezët arabitën atë mot tërë orizin tonë dhe njerëzit u uritur bridhnin

për një kokërr oriz nga Sajgoni në Hanoi, e nga Hanoi në Sajgon. Edhe unë lashë fshatin atë vit dhe u nisa me prindërit e mi për të gjetur një kokërr oriz. Isha në atë moshë, kur njeriu mban mend çdo gjë. Edhe tani i kam parasysh rrugët me muhaxhirë. Në çdo rrugë të gjatë kishte dy zinxhirë njerëzish që udhëtonin në drejtim të kundërt me njëri-tjetrin, për të njëjtën gjë, për të gjetur oriz e për të mundur urinë. Edhe unë bëja pjesë në një zinxhir të tillë me nënën e me babanë. Nuk jam në gjendje të tregoj ato që kam parë. Dhe s'ka njeri që të mund t'i tregojë ato tmerre. Unë kam parë pleq të tërhiqeshin zvarrë ditë e natë, gjersa jepnin shpirt buzë orizoreve. Kam parë nëna të vdekura me sy hapur, me fytyrën nga qielli, me gjinj të jashtë. Dhe mbi këta gjinj të tharë si eshkë buzët e mitura të fëmijëve, që thithnin pa pushim, gjersa u zihej fryma. Kam parë trupa të gjallë vetëm me kockë e lëkurë, kam parë skelete njerëzish të zbardhur nga dielli. Dhe, më në fund, pashë me sy edhe vdekjen e prindërve të mi. Një javë ata nuk futën gjë prej gjëje në gojë. Rrënjët që gjenin i gatuanin vetëm për mua.

«Më erdhi radha, moj bijë, më tha babai me gjysmë zëri, siç ishte shtrirë në mes të rrugës. Mallkuar qoftë kjo jetë! Mallkuar qoftë japonezi, francezi, amerikani e çdo i huaj që shkel tokën tonë! Në shpëtofs, merre këtë dong¹ e jepe për flamurin e revolucionit», – dhe dha shpirt.

Nënën e humba të nesërmen. Më la mbi një ledh e shkoi të kërkonte ndonjë barishte, duke u tërhequr zvarrë, se nuk mund të ecte. Dhe s'u kthye më. Me siguri do të ketë vdekur duke këputur ndonjë rrënjë bari. Unë e kërkova tërë ditën. Ecja mbi trupat e të vdekurve, i ktheja për t'u parë fytyrën, por nënën nuk e gjeta. As varrin nuk e di ku e ka. Dhe mbeta fillikat vetëm midis aiitë atyre njerëzve, që i grinte vdekja pa mëshirë. Kisha një vëlla partizan, por edhe atë nuk e

1) monedhë vietnameze

pashë më. Më thanë se e kishin shpënë për ta pushkuar. Kishte pasur tri bomba me vete. Dy ua hodhi francezëve, një e plasi në këmbët e veta. Dhe mbeta vetëm. Po, shok i dashur, nga familja e minorit mbeta vetëm unë, pesëmbëdhjetëvjeçarja Ngyien. Dhe, si mbeta vetëm, u ktheva kockë e lëkurë në krahinën time revolucionare, në Taj Binj, dhashë dongun e babait për flamurin e revolucionit dhe u lidha me lëvizjen. Në vitin 1947 u bëra komandante e njësitit guerril të fshatit, më dyzetëtetën hyra në parti, më dyzetenëntën armiku na erdhi te porta dhe atëherë fillova luftën e vërtetë.

Francezët erdhën në befasi, bombarduan nga ajri e nga lumi, ngritën pesë poste ushtarake përreth fshatit tonë dhe u bënë zot të vendit. E shoh se ju e dini mirë frëngjishten. Ndoshta keni bërë ndonjë shkollë franceze, ndoshta keni ndonjë admirim të veçantë, për Francën, ndoshta keni menduar se Franca, aq e kulturuar, nuk ka se si të jetë aq e egër nëpër kolonitë e saj. Do t'ju deziluzionoj. Dua t'ju them se tërë derrat një turi kanë. Tërë kolonialistët janë të egër, çnjerëzorë. Që ditën e parë, që në fillim, unë pashë me këta sy egërsinë e tyre. Ato që do t'ju tregoj do t'ju duken të pabesueshme, por janë të vërteta.

* * *

Ishte dita e parë e pushtimit. Unë u ngrita herët dhe dola nga kasollja për të parë se ç'bëhej në fshatin tim. Nuk eca nëpër rrugët, por nëpër kopshtet me banane, duke kapërcyer gardhet. Dhe te një gardh mbeta. Ishte një palmë atje. Dhe te palma kishin varur lakuriq një njeri. Një njeri pa kokë. S'ka gjë më të tmerrshme se të shohësh njeriun tënd të varur në pemë nga shpatullat, ndërsa koka e tij e çarë më dysh është hedhur në këmbët e tij! E njohta. Ishte pojaku ynë i mirë, që kishte dalë herët për të ruajtur orizoret tona. M'u mblodh një lëmsh në fyt dhe sytë më dogiën. Kisha parë mijëra të vdekur më dyzetepesën dhe kujtoja se isha mësuar.

Por jo. Një dhembje e mprehtë më shpoi kraharorin. Shtrëngova dhëmbët, këputa litarët, hapa një gropë dhe e mbulova të vrrarin rrëzë gardhit, nën hijen e palmës. Dhe bëra më tej. Dola buzë një orizoreje dhe që nga kaçubat pashë një fshatar që peshkonte kërmij në llomet me ujë. Pashë edhe pesë ushtarë francezë të armatosur që iu afruan fshatarit. Ishin djem të rinj, të ushqyer mirë, me bustinat mbi sy. Dhe ishin francezë të qeshur e të gëzuar. Ata qeshnin, bisedonin me zë të lartë; fshatari peshkonte kërmij, kurse mua më digjej shpirti nga urrajtja. Me siguri ata të pesë do ta kishin vrarë pojakun tonë.

– Hej, ti! – thirri njëri prej tyre. Kujtova se më thirri mua dhe u fsheha më mirë në kaçubat.

– Dil këtej! – tha një tjetër.

I treti shkoi drejt fshatarit dhe e zuri për flokësh.

– Ç'bën këtu? – e pyeti.

Fshatari u tregoi kërmijtë në kosh.

Ushtari ia nduku flokët më tepër dhe ngriti dorën, në të cilën shtrëngonte një thikë të madhe e të mprehtë. Qafa e fshatarit u zgjat, siç zgjatet qafa e pulës, kur i vë thikën. Unë mbylla sytë nga tmerri. Kur i hapa, pashë me lemeri kokën e bashkatdhetarit tim që kullonte gjak në dorën e ushtarit francez. Seç thanë midis tyre dhe qeshën me zë. Njëri prej tyre bëri gati aparatit dhe e nxori në fotografi me kokën e përgjakur dhe ende të ngruhtë në dorë. Këtu, në Hanoi, në muze, është një fotografi e tillë. Ku ta dish, mund të jetë pikërisht ajo që bëri atëherë francezi në fshatin tim... Unë ika fshehurazi, shkova në birucën time ku jetoja vetëm, dhe qava me ngashërim, duke menduar si të hakmerresha. Por këta nuk ishin lotët e mi të fundit. Të nesërmen qava përsëri. E si mund të durojë zemra e një vajze të re, kur sheh me sy tmerre të tilla?! Dola përsëri herët në mëngjes, duke ecur vjedhurazi, si hajdutët. Dhe ç'më panë sytë! Nuk më bën zemra ta tregoj. Tek oborri i shtëpisë një grua shkoqte oriz në havanin prej druri, ndërsa dy ushtarë po e sodisnin te pragu i derës së jashtme.

– Pa ngrehu, – i tha njëri prej tyre.

Gruaja u ngrit. Ata e vështruan me vëmendje nga koka gjer te këmbët e zbathura.

– A ke gjë këtu? – e pyeti njëri prej tyre duke e prekur me kosoren në barkun e fryrë. Gruaja nuk kuptoi ç'i thanë, uli kokën e turpëruar dhe lidhi duart mbi bark. – Zhvishu! – e urdhëroi ai që kishte kosoren, ndërsa tjetri ia grisi këmbishën e bardhë dhe ia uli pantallonat e zeza prej mëndafshi.

Gruaja u drodh. U drodha edhe unë prapa gardhit, pa kuptuar ende mirë se ç'deshën t'i bënëin asaj. Kur e zhveshën lakuriq dhe e shtrinë me kurriz mbi barin e njomë, e mora me mend se ç'kërkonin prej saj.

– Mos më turpëroni! Mos! – klithi gruaja duke u munduar të mbulohej me pëllëmbët e saj.

– Mos! Katilë! – thirra edhe unë, por jo me zë të lartë.

– Jam me barrë. Jam në të shtatin. Kini mëshirë, zotërinj! – klithi përsëri ajo me zë të përvajshëm.

Ushtarët panë njëri-tjerin, seç pëshpëritën dhe u hodhën mbi gruan, që mudohej të ngrihej. Njëri ia zuri duart. Tjetri i rëndoi me gjunjë mbi kërcinjtë e këmbëve. Mua m'u drodh shpirti, sikur po më thernin dhe gati sa nuk u turra mbi ta. Por s'kisha me vete veçse një thikë të vogël. E ç'mund të bëja me një thikë kundër dy vetave të fuqishëm e të armatosur me automatikë?

Papritur më solli në vete gruaja që nxori një nga-shërim të çjerrë, të zgjatur, të dhimshme, sikur po e çanin. Dhe, o tmerr, vërtet po e çanin. Po e çanin me kosore, që nga kërthiza e poshtë. Po ia nxirrnin fëmijën të gjallë nga mitra! Edhe në ëndërr ta shohë njeriu këtë vrasje, do të çmendet, dhe jo unë që e pashë me sytë e mi. Çdo gjë m'u turbullua, mendja, sytë, shpirti. Erdhi e m'u mblodh një lëmsh në gjoks, një lëmsh shumë i madh, të cilin e kam ende këtu brenda. Ky lëmsh nuk ka për të m'u zhdukur kurrë. Është urrejtja ime që vlon këtu, një urrejtje që do të shuhet vetëm kur të hyj në varr.

Ushtarët ikën. Unë iu afrova gruas së re që nuk mundi të bëhej nënë. Ishte mbuluar me gjak dhe po jepte shpirt. Mendohej të ngrinte kokën për të parë fëmijën e saj që dergjej midis këmbëve të çakërritura, në një cipëz lëkure e në një pellg gjaku.

— A është gjallë? — pyeti ajo dhe më vështroi me ata sy të perënduar, ku ndriçonte vetëm një rreze drite.

— Më thuaj, motër... a është... gjallë? — mezi pyeti përsëri dhe më vdiq në krahë...

* * *

Ngjien Ti Çjena mbështeti kokën pas murit, mbylli sytë dhe heshti. Piktorit iu drodh peneli dhe i shënoi një vijëzë të panevojshme në portret. Unë futa ngadalë bllokun në xhep, kafshova buzën, shkova te dritarja duke ecur shumë lehtë mbi rrogzin prej bambuje, dhe rashë në mendime. Edhe shoqëruesit nuk bënë zë. Heshtja u var përsëri pezull në dhomën e madhe të hotelit. Asnjeri nuk luante nga vendi. Asnjeri nuk fliste. Më dukej sikur kishim ndalur edhe frymëmarrjen dhe po mbanim zi për milionat vietnamezë që u vyshkën nën thundrën e kolonizatorëve.

— U lodhët? Ju dhemb koka? Mund të pushoni, — e prishi heshtjen e gjallë piktori ynë.

Ngjien Ti Çjena hapi sytë, psherëtiu, buzëqeshi e tha:

— Vazhdoni, shok. Edhe unë po vazhdoj me kujtimet e mia të hidhura.

Pastaj u drejtua nga unë:

— Kisha dëgjuar se shkrimtarët janë shumë të ndjeshëm. Tani u binda për këtë. Ju u prekët në shpirt nga tregimet e mia. Por duhet të duroni. Ky ishte vetëm fillimi.

Dhe ajo vazhdoi, po me atë zë të ëmbël fëmije, të tregonte ngjarje që të ngjethin mishtë e që ta mbushnin zemrën me urrejtje.

— Francezët mbushën javën në fshatin tonë. Ka qenë e diel, dita e parë e vjeshtës. Dymbëdhjetë fëmijë, vocërrakë, tetë-nëntëvjeçarë, luanin në një shesh tërë hije me

detka prej qelqi. Unë po nisesha për në xhungël, ku do të bënim mbledhjen e njësitit tone guerriil. I pashe femijët tek luanin të gëzuar dhe për nerë të parë, pas kaq vitesh, ndjeva në shpirt një riad të ëmbël pranvere. Më dukej sikur femijët, me ato doçkat e tyre tërë baltë, më bënin fresk mu në thelb të zemrës. Njëmbëdhjetë luanin. I dymbëdhjeti kishte hipur këmbëkryq mbi një buall dhe sodiste nga lart. Kur i kalova pranë, hoqi nonin¹ nga koka dhe më përshëndeti me të.

— «Mirëmëngjes, Ngyien li!

— Mirëmëngjes, vogëlush! Hap sytë mos biesh nga bualli.

— Është i urtë ky, Ngyien Ti. S'më ka rrëzuar ndonjëherë, — tha çuni duke përkëdhelur me duar qafën e ashpër të kafshës.

Me një ngazëllim të pashpjegueshëm i vështrova femijët një copë herë dhe u nisa për në xhungël. S'kisha dalë mirë nga fshati, kur dëgjoj të lebetitura. Në fillim m'u dukën si zëra të gëzuar.

«Femijët!» — thashë me vete.

Ishin vërtet zëra femijësh. Vura veshin, ndala frymën dhe dëgjoja. Por nuk ishin zëra të gëzuar. Ishin lebetitje.

— «Mos u ka dalë ndonjë nepërkë? — mendova dhe aty për aty ndërrova mendim. — Nepërkës ia shtypin kokën ata.»

Thirrjet e lemeritura vinin nga sheshi me hije, të mam nga ai vend ku luanin pak më parë femijët. Vetëm tigrin mund t'i trembte ashtu femijët. Po nga doli ky tigër? Xhungla ishte larg dhe s'kishte ndodhur ndonjëherë që të hynte tigrin në fshat në mes të ditës.

— «Francezët!» — më shkrepin në mendje menjëherë dhe zemra më ndolli për keq.

Atëherë u ktheva. U rashë orizoreve mes për mes për të dalë më shpejt; kapërceva përmes kopshteve me banane, kapërceva fluturimthi trapet me ujë. Dhe sa më

1) kapelë prej bambuje në formë konike

shumë i afrohesha sheshit, aq më tepër pakësoheshin ato thirrje që të shponin mu në shpirt. Nganjëherë këputej një zë i përvajshëm e fluturonte dhimbshëm në qiell. Pastaj ky zë ngjirej e shuhej, sikur e priste njeri me shpatë. Unë vrapoja sa më hanin këmbët dhe, me të dëgjuar lebetitjet e fëmijëve, qëndroja menjëherë dhe vija veshin. Më dukej sikur nga lebetitjet do të merrja vesh të vërtetën.

«Nëëëë!» – thirrën tre-katër zëra përnjëherësh dhe m'u duk sikur kumboi tërë qielli.

«Nëëëë!» – thirrën pak më vonë vetëm dy zëra.

Kur dola nga një pellg me ujë dhe po u afrohesha bananeve që rrethonin sheshin, dëgjova vetëm një zë që thërriste vazhdimisht:

«Nëëëë! Nëëëë! Nëëëë!»

E njoha këtë zë. Ishte i atij vogëlushit që kishte hipur mbi buall. Duke vrapuar, nuk e pashë një grua që u shkëput nga gardhi prej bananeje dhe hyri në kasolle. Dëgjova vetëm klithmën e saj:

«Na i vranë çunat!»

Unë qëndrova në vend. M'u duk sikur më qëlloi njeri me plumb në zemër. Pastaj, pa e ditur se si, vura re se kisha hyrë në mes të sheshit, ku ishte bërë kërdia. E kisha humbur mendjen dhe mbaj mend se kisha qëndruar dy hapa larg një ushtari francez. Llërët e tij të përveshura ishin llaqosur me gjak. Gjak kishte në fytyrë, në ballë, në kapelën prej tape, në vetullat, në qepallat. Gjak kishte në gjoks, në aqunjë, në këpucë. Kishte ngrirë në vend, me këmbët hapur, me giuniët pakëz thyer, me majën e thikës drejtuar nga unë. Më shikonte me një vështrim të ngrirë nën vetullat e vrenjtura që ia mbulonin sytë.

– C'ke bërë kështuuu! Kriminel! – thirra unë. – Ai nuk lëvizi nga vendi. Qëndroi si një statujë. – Krimineeeel! – thirra përsëri përmes lotëve dhe iu derdha. Vetëm tiari kërcen në atë mënyrë si kërcëva unë. Vetëm tiari kafshon në atë mënyrë siç e kafshova unë. Ia ngula dhëmbët në byzlykun e dorës. Ndjeva kockën që i kërciti. Dëgjova

klithmën e tij. Ndjeva edhe grushtin e tij të rëndë mbi kurrizin tim. Por thika i ra nga dora. U mundua ta shkelte me këmbë, por unë e rrëmbeva, si tigrin gjahun e vet, e shtrëngova në të dy duart dhe ia ngjasha lart, në kraharor, me tërë fuqinë time. Ai rënkoj. Nxori një gulçimë dhe u var mbi kurrizin tim. Peshja e tij bëri që thika të hynte më thellë, gjer në myll. Vetëm atëherë i hoqa dhëmbët nga dora e tij. Ai u rrëzua përmbys. Unë i rëndova sipër, me tërë peshën e duarve e të trupit, dhe grushti më hyri në gropëzën e kraharorit me gjithë myllin e thikës. E kisha qëlluar tamam aty ku duhej, një gisht nën shtë, mu në zemër. Kur ia hoqa thikën, gjaku i vërshoi, si nga një but vere, kur i hecin tapën. Atë thikë e mbaja qiersa mbaroi lufta. Tani është në muze. Me të kolonizatori vrau dy mbledhjetë vietnamezë të veçiel në luanin me detka! I theri sic therin shaerikat në kasanhanë. U kishte prerë aumazin. U kishte çarë trutë. U kishte shuar zemrën. Vetëm njërin e kishte aëlluar nga orapa, në peshkun e kurrizit, atë voaëlushin që rrinte hiour mbi buall. Hiour e aietja edhe unë. Kishte varur këmbë e duar dhe dukej sikur flinte. Kafsha e urtë e trembur nga era e aiaikut, doli nga sheshi dhe, me hanin e saj të rëndë, shkoi në shtëni të vet. Ecte naadalë. me kuides, sikur kishte frikë mos i binte voaëlushi që mhante mbi kurriz. Të tierët ishin aty, mbi lëndinën e aetë, të nëraiakur. Edhe detkat ishin përhapur aty mbi lëndinën e blertë. Edhe ato ishin të përjakura dhe dukeshin si sy të kuq...

Atë ditë nuk e bëmë dot mbledhjen e niëstitit. Na mblodhën francezët po tek ai shesh i rrethuar me hanane. Më morën edhe mua, më vunë midis dy rraëve dhe më shounë te sheshi. Ishte mbledhur tërë fshati, i madh e i voaël, i kishin vënë në rresht njërin pas tjetrit. Më vunë edhe mua.

— Përse na mblodhën? — pyeta shoën që kisha përpara.

— Nuk e sheh? — më tha ajo me lot në sy dhe më tregoi qoshen e sheshit. Unë u tmerrova. Një për banane

ishin varur trupat e njomë të fëmijëve. Përdhe kishin vënë një kërcu. Dy ushtarë i merrnin trupat e njomë, i hidhnin mbi kërcu. Njëri prej tyre thërriste:

– Mish taze! Katër dong copa! Pesë dong koka!

Fshatarët i shtynin drejt «thertores», u merrnin të hollat dhe u lëshonin në pëllëmbët e ngrira copat e mishit të kuq.

Më erdhi radha edhe mua. Kisha mbyllur sytë dhe nuk shikoja. Kraharori më çante, buzët më dridheshin, gjunjët nuk më mbanin. Më morën pesë dong dhe më lëshuan në duar një gjë të rëndë. Eca symbyllur me duart e shtrira dhe dola në rrugë. E merrja me mend ç'po mba-ja, prandaj nuk më bënte zemra të shihja. Me të dalë në rrugë, fillova të vrapoja, të gulçoja, të rënkoja me kokën lart, duke vështruar qiellin e kaltër.

– Ngyien Ti, – më thirrën prapa krahëve, – qëndro, Ngyien Ti!

Ishte një zë gruaje tërë ankth që më thërriste. Dhe unë qëndrova.

– Ngyien Ti, motër! Kjo është koka e tim biri! Ma jep, motër! – u lebetit ajo si e çmendur. Ma rrëmbeu nga duart, e shtrëngoi në gji, ngjeshi buzët në flokët e tij dhe ashtu vrapoi. E arrita në shtëpi dhe të dyja së bashku e varrosëm atë kokë vogëlushi në mes të kop-shtit të mbjellë me maniok¹).

Në mbrëmje bëmë më në fund mbledhjen e celulës e të njësitit guerriil. Nuk mungoi asnjëri. Erdhën të gjithë. U thashë:

– Shokë! Vëllezër! Armiku po ia pret kokën Vietnamit tonë! Por ne nuk do të zvogëlohem, nuk do të gjunjë-zohemi. Nuk është koha për fjalime. Hidhni këtu të gjithë nga një pikë gjak dhe le të shkruajmë me të parullën e parë.

Të gjithë prenë pakëz mollëzat e gishtave dhe shkruam me gjak në një beze të madhe:

«Gjaku ynë për liri!»

1) një lloj zarzavateje si patatja

Që atë natë e vendosëm parullën te sheshi ku na therën fëmijët. I lidhëm edhe një bombë. Dhe, kur ushtarët francezë shkuan ta hiqnin, bomba shpërtheu dhe i bëri copë-copë.

Filluam të armatoseshim. Kishim ca pushkë e revolverë të vjetër. Një ditë shkova në pazar të qytetit me gjithë niësitin. Çarmatosëm dymbëdhjetë ushtarë dhe i tërhoqëm në xhungël së bashku me armët. Minat e bombat i bënim vetë. Qëronim dodutë¹ dhe i mbushnim me barut. I vendosnim bombat nëpër shishet dhe nëpër katruvet e ujit. Bëmë harqe e shigjeta. Bëmë topuzë prej bambuje. Bëmë një top prej drurëve të fortë të xhunalës. Premë copa të vogla dërrasash, ngulëm në to gozhdë të mëdha e të ndryshkura dhe i vendosëm nëpër rrugët e orizoreve, pranë postave armike. I arimë ushtarët me këto gozhdë. Komanda franceze bëri bile dhe protestë.

«Luftoni siç është për të luftuar! Ç'janë këto gozhdë që vendosni nëpër rrugë! Hiqni këto mjete barbare!»

Mjete barbare! Sa qesharake! Ata prisnin kokat tona e shisnin nëpër pazare mish njeriu, ne u copëtonim këmbët me gozhdë dhe ne qenkeshim barbarë!

U armatosëm me mjete moderne e primitive. Çdo gjë që shërbente për të vvarë u fut në armatimet tona: thika, shata, hunjtë prej bambuje. Dhe atëherë filluam sulmin. Ditën fshiheshim në xhungël, bënim prita, natën shkatërronim rrugët automobilistike, prisnim hekurudhat me trupat e palmave, bënim barrikada. Unë vetë bëra tri mina të fuqishme me gypat e ujit dhe me to hodha në erë tri posta ushtarake. Postën e katërt e sulmuam natën në befasi dhe i zumë rob të gjithë ushtarët me gjithë një nëntoqer. Të nesërmen vendosa një minë në lumë, në një gji ku armiqtë vinin shpesh për të zënë peshk. Ishin dymbëdhjetë ushtarë. Mina plasi. Pesë u vranë, shtatë u plagosën. I zura të gjallë, i vura përpara dhe i dëraova në xhungël, në bazat tona të fshehta.

Një dtë morëm urdhër të rrëmbenim kripën e orizin

1) Frutë tropikale që rritet në pemë, e madhe sa një pjepër.

nga depot e fshatit dhe t'ia dërgonim ushtrisë që vep-
ronte në thellësi të pyjeve. Përsëri me minat tona ho-
dhëm në erë postat e rojave, ngarkuam kripën e orizin
në kurriz e u nisëm. Ishim njëqind e pesëdhjetë veta.
Duhet të arrinim sa më shpejt, pasi tanët kishin mbetur
pa ushqime. Duhet të udhëtonim pesë ditë e pesë net
pa pushuar asnjë minutë. Por kjo nuk mund të bëhej.
Edhe kafshë të ishim, do të kishim mbetur të gjithë në-
për xhungla. Atëherë u ndamë në skuadra prej tre vetash.
Çdo skuadër bëri një vig të shëndoshë e të lehtë. Në këtë
vig flinte njëri nga ne. Dy të tjerët e mbanin. Me një
fjalë, pesëdhjetë pushonin e flinin në vig, njëqind ecnin.
Pas disa orësh ndërroheshim. Dhe kështu ne ecëm pa u
ndalur as edhe një minutë. Dhe mbërritëm te tanët, jo
për pesë ditë, por për tri.

Ky ishte aksioni i fundit. Kur u ktheva në fshat, rashë
në duart e tyre. Më arrestuan në mëngjes, kur isha duke
ruajtur sekretarin e partisë të rrethit. Sekretarin e laj-
mërova që të ikte. Vetë, për të shpëtuar atë, rashë në
grackën e armikut. Atëherë pashë me të vërtetë vdekjen
me sy. Pas pyetjeve të zakonshme, filluan torturat. Tre
muaj e gjysmë me radhë vdekja më erdhi rrotull, më
preku me dorën e saj të ftohtë. Kushedi sa herë e ndjeva
atë në shpirt dhe e pashë të largohej për t'u kthyer
përsëri, më e egër, më gjakësore.

Më torturonte një nëntoger me emrin Zhozho, një
burrë i ri, nja tridhjetepesë a dyzetvjeç. Kishte një mjekër
të zezë të dredhur, dhëmbë të bardhë, sy të fryrë dhe
binte erë verë. Ditët e para më futi në një kafaz të
rrethuar me tela me gjemba. Kafazi ishte i lartë nja dy
metra dhe aq i ngushtë, sa mund të qëndroje vetëm në
këmbë. E kishin ndërtuar përpara postës, në mes të një
pellgu me ujë, pa hije. Më futën aty si ndonjë egërsirë
dhe më lanë tri ditë. Tri ditë as hëngra, as piva, as u
ula. Nuk mund të lëvizja në atë kafaz, se më nguleshin
telat e ndryshkur në mishrat e zbuluara. Dielli, dielli
ynë tropikal më përvëlonte tërë ditën e ditës. Koka më
çante dhe më vinte për të vjellë. Aty më filloi kjo dhembje

koke që nuk më është ndarë gjer sot e kësaj dite. Zhozhoi dilte përpara portës, ulej në karrigen prej kashte, hante pëllumba të skuqur e pinte verë. Nganjëherë shëtiste përpara kafazit tim, duke vështruar palmat që dukeshin si tenda të blerta. Kruante mjekrën, thithte puron dhe kthehej te vera pa më parë e pa më thënë një fjalë. Unë dergjesha në këmbë duke u tretur si qiriri në zjarrin e diellit dhe në shkëlqimin verbues të ujërave. Ditën e tretë ma hapi kafazin e më tha:

– Vietnameze, dil të pushosh!

Unë hodha një hap e, më të dalë, rashë në pellg me gjysmë shpirti dhe piva ujë. Ai më ngriti.

– Do të pish verë? – më tha.

Dhe vërtet më dha verë. Më dha edhe pëllumba të pjekur, edhe oriz. Piva dhe hëngra shtrirë në një krevat të postës. Nga mbrëmja erdhi një infermier. Kujtova se do të më shihte mos isha sëmurë e do të më jepte ndonjë ilaç për kokën. Kurse ai më mori gjak. Mbushi dhjetë tuba. Zhozhoi ishte aty, shikonte nga dritarja tendat e blerta dhe kruante mjekrën. Pastaj ndezi puron, mori një tub, e vështroi me vëmendje e tha.

– E paske gjakun të kulluar, vietnamezel! Me siguri me këtë ke shkruar parullën «Gjaku ynë për liri!».

– Po, – iu përgjigja, unë vura një pikë në atë parullë.

– Po gjakun tjetër kush e dha? – më pyeti ai pa më vështruar.

– Vietnamezët, – iu përgjigja.

– Vit-na-me-zët, – theksoi. – Të njëjtën përgjigje më jep gjithnjë. – Tundi tubin që mbante në dorë dhe shtoi: – Ky gjak nuk do të jepet për lirinë tënde, po për shpëtimin e ushtarëve që ke plagosur. – Duke dalë e urdhëroi infermierin: – Thithja gjer në pikën e fundit!

Mua më ra të fikët dhe kur u përmenda e pashë veten të varur nga shpatullat në një degë të palmës. Më kishin varur tamam si atë pojakun tonë të mirë. Por kokën s'ma kishin prerë ende. Përreth ishin mbledhur ushtarë të gëzuar francezë dhe midis tyre pashë mjekrën

e dredhur dhe puron e Zhozhoit. A keni parë si stërviten boksierët? Unë kam parë në një film. Varin një thes të mbushur me rërë dhe i bien me grushtet të veshura me doreza. Unë isha thesi me rërë i varur në palmë. Dhe ushtarët francezë boksierët. Zhozhoi hoqi puron nga goja dhe bëri një shenjë me dorë. Atëherë filluan të më qëllonin me grushte ku mundnin. Më kishin vënë në mes e më qëllonin. Unë lëkundesha, vërtitesha, qaja, rënkoja, ulërija. Nuk isha vërtet thes me rërë. Ata më qëllonin në kokë, në kurriz, në gjoks, në ije, në bark, ku mundnin. Po më shumë në bark e në ije, se atje ishte mishi i butë e nuk u vriteshin noçkat. Trupi m'u bë pleh, tërë fulltaka mavi, pastaj m'u mpi e nuk ndjeva më dhembje. Sytë më qenë errësuar e nuk shihja mirë. Dalloja vetëm grushte të rënda që fluturonin në ajër, qindra grushte, mijëra grushte, që nguleshin si perona në trupin tim të tharë e më vërvisnin si fugë, më ngrinin lart, më kolovisnin. E së bashku me mua vërviteshin palmat, kokat e ushtarëve, muret e postës, orizoret, tërë toka jonë e blertë, gjithë qielli ynë i kthjellët.

— Vietnameze! — dëgjova zërin e Zhozhoit si në një furtunë. Atë nuk e pashë, as nuk munda t'i përgjigjesha. Më kishte rënë të fikët. Po më hodhën një kovë me ujë dhe u përmenda shpejt.

— Të pushkatohet! — thirri Zhozhoi. — Prenë litarët, më tërhoqën zvarrë gjer në njëfarë vendi, pastaj më ngritën dhe unë eca vetë në një rrugë të rrahur nga këmbët e z bathura të vietnamezëve. Më futën në një pyll me pemë kauçuku. Më mbështetën te një trung i moçëm, nga rridhte lëngu i bardhë i kauçukut dhe morën nishan. Zhozhoi hoqi puron nga goja dhe ngriti dorën lart. «Tani vetëm një fjalë duhet: «Zjarr!» Plumbat do të shpojnë trupin tim pa gjak dhe unë do të shtrihem rrëzë këtij trungu të moçëm, mbi këtë bar përjetësisht të blertë», — mendova e qetë. Ngrita kokën më lart dhe nxora kraharorin përpara.

— Vietnameze! — tha Zhozhoi duke mbajtur dorën gjithnjë lart, gati për të dhënë urdhrin e ekzekutimit.

– Të erdhi fundi! Kush tjetër dha gjak për parullën? Kush i hodhi në erë postat tona? Kush i vrau ushtarët tanë që peshkonin? Kush e prishi hekurudhën? Kush e rrëmbeu kripën dhe orizin tonë? Kush?

Pushtova fort nga prapa trungun e kauçukut dhe iu përgjajia:

– Vietnamezët!

Dora e Zhozhoit atie lart lëshonte tym. Ai e uli atë dorë naadalë, vuri nuron në gojë dhe tha:

– Vietnameze! Ti nuk meriton një vdekje kaq të ëmbël.

Dhe më shpunë përsëri në postë, për ta parë përsëri me sy vdekjen që më vinte rrotull.

Një ditë më shtrinë përmbys mbi lëndinë dhe katër ushtarë më shkelën duart e këmbët. Zhozhoi mbaroi pëllumbat e pjekur, i dha fund shishes me verë dhe u çapit drejt meje. Më grisi këmishën dhe filloi të ma rripte kurrizin me pinca e gërshërë. Unë gulçoja e kafshoja dhe. Ai më rripte, siç rrjepin qengjin dhe copëzat e lëkurës m'i hidhte përpara fytyrës, që t'i shikoja e të tmerrohesha. E mblodha veten e përmes lotëve e ngashërimeve, i thashë:

– Zhozho! Ti je armik i egër i Vietnamit, por më shumë se kaq s'ke ç'më bën!

– Të pushkatohet! – thirri ai.

Dhe më shpunë po tek ai vend, te pylli me pemë kauçuku. Ushtarët më vunë në shenjë. Zhozhoi ngriti dorën me gjithë puron e ndezur. Por nuk më vrau. Vetëm më tha:

– Ti nuk meriton një vdekje kaq të ëmbël, vietnameze – dhe vazhdoi me tortura.

Nuk ma kishte marrë mendja kurrë se hekuri që hekurosia teshat, do të më hekuroste edhe mua. Zhozhoi e nxehu mirë e mirë në shtë e mi dhe ma vuri në kraharor. Unë klitha. Mishi m'u dogj dhe ndjeva erën e tij.

– Kush, pra? – thirri ai duke m'u afruar aq shumë, sa më mbuloi qafën me mjekrën e tij të dredhur.

Iu përgjigja përmes klithmave e lotëve:

– Vietnamezët!

Ai u tërbua. Hoqi hekurin, ku ishte ngjitur lëkura ime dhe ma ngjeshi nën anën e zemrës, pastaj në bark, në ije, mbi kërthizë...

– Të pushkatohet! – e dëgjova këtë fjalë për të tretën herë.

Po përsëri nuk më pushkatuan, megjithëse më shpunë në pyll. I dukej e ëmbël Zhozhoi vdekja nga plumbi!

Më bëri edhe torturën e fundit që kishte shpikur mendja e francezit, korrentin elektrik. Kishte një makinë të vogël sa një shkrepëse, ma mbështeti atë në trup dhe unë u shtrembërova nga dhembja. Çakërrita sytë, çapëllova gojën, u dogja e tëra përbrenda dhe humba ndjenjat. Kur hapa sytë, pashë përpara një prift, Zhozhonë dhe gjashtë shokë vietnamezë të katandisur si unë. Prifti ishte katolik. Mund të ishte edhe Le Huji, prifti tradhtar që mbante mbi tryezën e punës kafkën e një patrioti, të cilin e kishte vrarë vetë, me dorën e tij. Na lidhën e na vunë përpara.

– Do t’ju mbulojmë të gjallë, duke ju lënë vetëm kokën jashtë. Kjo është vdekja që meriton ti, vietnameze! – tha Zhozhoi me puron midis leshit të dredhur të mjekrës.

Unë isha tharë si një karthje e isha mbledhur e zvogëluar sa një grusht. Trupi më përvëlonte nga plagët. Ato plagë i kam akoma, por më vjen rëndë t’jua tregoj. Çdo gjë më dukej pa ngjyrë, e shpëlarë, e turbullt. Dhe çdo gjë më dhembte. Edhe ajrin kur e thithja, më çanin mushkëritë. S’më kishte mbetur pikë fuqie. E ndieja veten të pushtuar fort nga krahët e ftohtë të vdekjes. Dhe, duke dhënë shpirt, më vinte keq vetëm për një gjë, që nuk mund të luftoja më.

Mbaj mend që eca së bashku me të gjashtë shokët vetëm disa hapa. Pastaj u hoqa zvarrë ndonjë metër a dy. Ushtarët më ngritën në këmbë disa herë. Por nuk qëndroja dot. Bija përdhe si e vdekur. Më tërhoqën për flokësh gjer buzë një përroi. Unë nuk u përmenda. S’më punonte as pulsi, as zemra. Kisha vdekur! Më goditën me shkelma, me kondakët e pushkëve, dikush më shpoi me

bajonetë. Por unë kisha vdekur e nuk ndieja gjë. Infermieri më kontrolloi mirë e mirë dhe tha:

– Zhozho, kjo ka mbaruar me kohë!

– S'arritëm ta varrosnim të gjallë, – tha Zhozhoi dhe urdhëroi: – Hidheni në përrua t'ia nxjerrin sytë serrat!

Më dhanë një të shtyrë me këmbë dhe unë u rrokullisa në fund të përroit, mbi një kumishte, nën një pishë që vllte terentinë...

Shokët i shpunë në pyll. I detyruan të hapnin vetë gropa të thejlla. Pastaj i mbuluan në këto gropa, duke u lënë vetëm kokat jashtë. Tamam siç bënin në mesjetë. Rojat qëndruan atje gjer ndaj të gdhirë, gjersa dha shpirt edhe vietnamezi i fundit. Kur doli dielli, ata ikën dhe vendin e tyre e zunë serrat.

Por dielli i atij mëngjesi feksi për mua. Më gjetën katundarët dhe më shpunë në birucat e tyre. Më mjekuan me ilaçet e popullit, me barërat e xhunglës sonë, me baltën e orizoreve tona. Pas një muaji më erdhi shpirti, e gremisa vdekjen përgjithnjë dhe u ngrita.

– Ngyien Ti, – më tha sekretari i partisë, ai sekretar, për jetën e të cilit unë hoqa aq shumë, – ti nuk duhet të luftosh më. Ti duhet të pushosh, Ngyien Ti.

– Jo, – iu luta, – mos më largo nga lufta. Gjersa ka kolonizatorë, vendi im është në zjarrin e luftës.

– Ti je një heroinë e vërtetë vietnameze, Ngyien Ti! – më tha ai dhe më dha përsëri komandën e njësitit guerril.

Dhe a e dini ç'bëra që atë ditë? Sulmova postën me tërë njësitin. Ushtarët, ca u vranë e ca u dorëzuan. Prapa palmës, ku më varën e më rrahën me grushte, dallova një mjekër të zezë e të dredhur. I shkova befaz dhe i thirra:

– Hidhi armët, nëntoger Zhozho!

Ai ngriti duart lart e pyeti:

– Kush jeni ju që ma dini emrin?

– Afrohu! – e urdhërova unë.

Ai bëri disa hapa dhe ngriu në vend. Mjekra e zezë i shkoi mënjanë, fytyra iu çapëlua, sytë iu shtrembëruan, sikur kishte përpara djallin.

– Vietnamezja! – belbëzoi. – Po ju... po ju sikur vdiqët...

– Dola nga varri që të marr shpirtin tënd të fëlliqur, – i thashë me zemërim.

Ai u shtri përpara këmbëve të mia dhe ngjeshi mjekrën në bark duke ngashëryer:

– Mos më vrisni... mos më vrisni... mos më vrisni!

– As me gisht nuk të prek, barbar! Të tjerët do të ta bëjnë gjyqin! – i thashë dhe e dërgova në shtab...

Luftova gjersa i shpartalluam francezët në Dien Bien Fu dhe i detyruam të bënë armëpushimin. Por, siç e shihni, armët nuk i kam hedhur...

Ngyien Ti Çjena mbaroi tregimin duke na prekur thellë me vuajtjet e saj, me heroizmin e saj. Mbaroi portretin edhe piktori ynë. U ngritëm dhe u mblodhëm rreth tablosë. Nga kartoni i ngjyrosur na vështronin dy sy të zinj, të qetë, të menduar, mbushur plot dashuri, besim e urrejtje. Heroina mbeti shumë e kënaqur. Edhe neve na pëlqeu. Kurse piktorit, jo.

– Për të realizuar këtë portret duhej një forcë e jashtëzakonshme artistike; duhej ngjyer peneli në gjakun e zemrës, – tha ai.

E falënderuam Ngyien Ti Çjenën nga thelbi i zemrës dhe e përcollëm. Kur u ndamë, na tha:

– Unë e di mirë gjendjen e Shqipërisë. Jeni në gojë të tigrit. Po të mos ishit të fortë, do t'ju kishte ngrënë me kohë. I falem Shqipërisë! Çojini asaj dhe sidomos grave heroike, përshëndetjet e zemrës sime.

Ajo iku. Por ne morëm me vete përshëndetjet e saj, kujtimet e jetës së saj, sytë e saj të zinj, të qetë, të menduar, mbushur plot dashuri, besim e urrejtje, që na vështronjë me miratim nga portreti i piktorit tonë.

NGA SHTYPI

ESTABLISHED 1880

FOLEJA E SHQIPONJAVE

Shefqet Argjiri tërë natën e natës nuk vuri gjumë në sy. Shtrirë në kurriz mbi truallin e thatë, pinte duhan pa pushim dhe numëronte yjet. Nga qielli i errët i shtatorit hëna lëshonte rrezet gushpëllumbi mbi shpatet e maleve të larta, mbi bredhat e rrallë, mbi barin e gjatë tërë lule të padukshme vjeshte. Nga grëminat e thella, nga grykat e nga rrëpirat e errëta, të mbuluara me shkurre, ngjitej lart një gumëzhimë e pandërprerë: ishin ujërat e maleve që rridhnin tatëpjetë me rrëmbim dhe e ndalnin vrapin në fushë. Mbi një bredh të vetmuar këndonte pa pushim një kukuvajkë. Shefqet Argjiri, shtrirë nën këtë bredh, me të dëgjuar zogun, që, sipas tij, ndillte fatkeqësi, u ngrit i shqetësuar. Rrëmbeu një ashkël dhe e hodhi përpjetë. Zogu u tremb e fluturoi. Ashkla ra mbi trupin e një njeriu që flinte rrëzë trungut të bredhit. Ky brofi menjëherë në këmbë, rrëmbeu pushkën që kishte mbështetur te trugu i pemës dhe pyeti ende nëpër gjumë:

— Tashti të nisem.

Shefqeti pa siluetën e shokut, e kuptoi që ishte ende nëpër gjumë.

- U ngrite, o Sulejman?...

- Mos ki merak, vete e vij shpejt, si era!

- Na more, këtu! Sulejman! Ku do të vesh... Ti je akoma në ëndërr, more djalë. Shko e hidh ca ujë syve që të dalë gjumi!

Djali erdhi në vete e filloi të qeshte me zë. Pastaj u ul këmbëkryq pranë Shefaetit dhe drodhi një ciqare.

- Si duken bathët? A do të qërohen? - pyeti diali dhe bëri me kokë poshtë qrykës së errët, përfund së cilës dalloheshin muret e bardha të një shtëpie.

- Shenjë e keaq! Erdhi një kukuvaikë e më këndoi mbi kokë. - u përgjigj Shefqet Argjiri duke vështruar lart degët e bredhit.

- E po, si do t'ia bëimë, po nuk ikën?

- Do të zbrazim ca pushkë e do të ikim ne.

- Te partizanët?

Shefqeti, duke lagur fletën e cigares me majën e ajuhës, tundi kokën në shenjë pohimi...

Ata të dy, dajë e nip, pasi menduan hollë-hollë, shkruan një letër dhe në mbrëmje vajtën të armatosur drejt e në postëkomandë. Marshalli i postës çakërriti sytë kur lexoi letrën. Dhe në letër thuhej:

«Ju lajmërojmë se jeni të rrethuar nga partizanët. Po nuk u larquat qier ndaj të gdhirë, do t'ju godasim. Të lini armët, kalin e kuq dhe hartën!...»

Me të dorëzuar letrën, u ngjitën në mal, ndezën zjarre rreth e rreth dhe pritën agimin e ditës së re...

Ndërkaq nga lindja kishte filluar të zbardhëllonte. Një dritë e padukshme dilte që prapa maleve dhe dalëngadalë shkrinte errësirën e natës. Po çdo gjë ishte ende pa shkëlqim. Vetëm krahët e një shqipeje që fluturonte shumë lart, vetëtinin nganjëherë. Shqiponja prandaj është shqiponjë, dhe mbret i shpendëve, sepse ajo e vështron e para diellin jetëdhënës dhe e para merr shkëlqimin e tij...

- Ore, Sulejman, je më i ri e sheh më mirë se unë. C'hëhet atv poshtë? Ah, unë i shkreti, kur s'kam një palë dylbi! Më duket se kanë dalë në oborr të tërë! Mo-

rrën tatëpjetën! – tha Shefqeti dhe shtrëngoi fort rripat e armëve.

– Po ua mbathin, o dajë, po ua mbathin! – thirri djali duke ngritur pushkën lart prej gëzimit.

– Oburra, priua rrugën! – urdhëroi Shefqeti dhe the-ri tatëpjetë, si ndonjë kaproll. Me një frymë, i arriti e u doli përpara, fshehur midis ca busheve. Ndo njëzet xhandarë ecnin me hap të shpejtë rrugës së malit dhe vështro-nin sa majtas djathtas majat e shkëmbinjve, gurët e më-dhenj nëpër rrëpirat, trungjet e pemëve. Kur kolona u afrua shumë, Shefqeti doli në një vend që ta shikonin mirë dhe thirri sa kishte në kokë, në mënyrë që ta dë-gjonin xhandarët.

– Të mos qëllojë njeri, se ia marr shpirtin!

Me të thënë këto fjalë, u zhduk prapa busheve dhe vranoi përsëri tatëpjetë duke gërvishur fytyrën nëpër ferrat e degët. Zgjati kokën prapa një shkëmbi dhe tregoi pushkën. Këtë marifet bëri edhe Sulejmani. Dilte herë në një vend e herë në një vend tjetër, bënte sikur u jepte urdhra të tjerëve, bisedonte me zë të lartë sikur të kishte me të vërtetë njeri përpara. Herë pas here, prapa ndonjë trangu, majë ndonjë bregoreje a nga ndo-një vend tjetër dëgjoheshin të thirrurat e Shefqet Argjirit e të Sulejmanit me zë të ndryshuar:

– Po ikin!

– Mos qëlloni, shokë partizanë!

– Jemi marrë vesh urtë e butë!

Marshallët ecnin në mes të vargut, vështroinin me frikë zjarret përreth dhe, kur dëgjonin të thirrurat e parti-zanëve, i hidhnin sytë njëri-tjetrit, sikur thoshin: «Sa mirë bëmë që ikëm!» Kur zbritën fare në fund të grykës, ku nuk dukej më as postëkomanda e tyre dhe as shtëpitë e fshatit, dëgjuan këto fjalë:

– Dhe mos e sillni më kokën këtej, se do t'ju mbetet ferrave!»

Pas këtij kërcënimi, nuk pipëtiu më njeri. Xhandarët shpejtuan hapat tatëpjetë, kurse Shefqet Argjiri me ni-pin e tij hynë në postëkomandë dhe filluan nga kontrolli.

Gjetën njëzet pushkë, kalin dhe, mbi një tryezë, hartën që kishin kërkuar.

— I paskan lënë të tëra, o dajë! Edhe pushkët, edhe hartën, edhe...

— Është kokë, more djalë, e dhimbset, nuk është lakër!

Shefqeti luante llozet e dyfeqeve, mbliidhte buzët i pakënaqur (ishin paticka të shkurtra, të cilat, sipas tij, nuk vlenin asnjë pare).

— Po këtë hartë, ç'e do, o dajë? Ti s'di as këndim, as shkrim, — e pyeti djali duke parë hartën që Shefqeti e mbështolli me kujdes dhe e vuri në çantë.

— Si, ç'e dua? A e di se do të bëhet luftë e madhe. Do të bredhim në tërë Shqipërinë. Me këtë unë do të gjej udhët!

Djali e pa me krenari.

— Ja ku po ta them, o dajë! Je trim dhe i zoti! Unë vij pas teje edhe në fund të botës. Me ty nuk humbet kurrë njeriu.

Shefqetit iu bë qejfi, shtrëngoi rripat e armëve, po nuk i ra në sy të nipit.

Në oborr të postkomandës ia hipi kalit të madh, qimekuq. Ishte një nga ata kuajt e ushtrisë, me këmbë të rënda, me kokë e vithe të mëdha, me një perçe të gjatë.

— Ama kalë, hë! — ia bëri i kënaqur Sulejmani, duke i shtrënguar qenglën.

— Është i rëndë, s'bën një para! — tha Shefqeti duke zënë vend mirë mbi shalë.

— Përse? u habit djali.

— Për ta ngarkuar është i mirë ky. Pesë barrë i mban me siguri! Po për t'ia hipur, nuk bën...

Ngarkuan armët dhe morën të përpjetën e malit, ai hipur dhe Sulejmani në këmbë. Një fllad i lehtë, që kundërmonite erë rrëshirë, frynte majave të bredhave.

— A u lodhe, o çun? — e pyeti Shefqeti kur dolën te bredhi ku kishin kaluar natën. Dhe, pa pritur përgjigjen, e urdhëroi të hipte. Sulejmani nuk e bëri të gjatë. Vuri këmbën mbi një gur dhe kërcëu prapa tij, mbi vithet e kalit. Zuri vend mirë e tha me të qeshur:

– Si i paska ky këto! Dyst! Si shilte! Mund të rrish këmbëkryq e të pish duhan.

Ecën kreshtës së një mali mbuluar me bredha. Rrezet e diellit rrallë e tek mezi përshkonin degët e dendura dhe binin vjedhurazi mbi myshkun e mbi tëndinën e lagur, duke formuar njolla drite. Kur dolën nga ky pyll i errët dhe ranë në një pllajë, ku ishin ngritur stanet, Sulejmani pyeti papritur:

– Si do t'i bëhet tashti, o dajë, që kemi mbetur pa mbret?

– Ç'ma more nga goja fjalën! Çudi! Për këtë po mendoja edhe unë! – u përgjigj Shefqet Argjiri dhe, si ia hipi kalit mënjane, vazhdoi: – Njëri: mbret theu qafën më tridhjet e nëntën. Ky i Italisë e ka thyer përgjysmë. Sa për fshatin tonë, mund të themi me siguri se, tashti që ikën xhandarët, ai është pa mbret. Bile gjithë kjo krahinë tashti është pa mbret. Ti pyet, se si do t'i bëhet halli? Unë them se duhet të zgjedhim një mbret tjetër, një mbret të popullit.

– Kështu mendoj edhe unë. Duhet të zgjedhim një mbret të ri, – ia preu fjalën Sulejmani. – Unë, për veten time, kam qejf të të zgjedh ty mbret. Hë? Si thua? Hajt të të zgjedhim ty, o dajë! – shtoi djali me zemër të hapur.

– Shiko, ç'menduaka, çuni i dajës! – tha Shefqeti, picërroi sytë, se ia vrau dielli dhe kroi zverkun me gishtin tregues.

– E përse të mos të zgjedhim ty?

– S'e bëj dot unë...

– E përse?

– Sepse s'di shkrim e këndim.

– I mëson ato, s'është ndonjë zahmet i madh. Për nder, hajt të të zgjedhim ty mbret!

– Jo, more, Sulejman, jo! Do të çalojë mbretëria, si ky gërdalli... Po vërtet, ç'ka kali që çalon? – pyeti ai dhe zbriti. – Pa shiko, i paskan rënë patkojtë nga këmbët e prapme...

Te stanet pushuan një copë herë të mirë dhe pinë nga një lagjin të madh me dhallë. Çobanët, me të parë njerëz të armatosur, i mbështollën në mes, i mbytën me

pyetje dhe u habitën fort, kur morën vesh se xhandarët kishin ikur nga postëkomanda. U habitën për këtë, kur panë kalin e madh dhe pushkët që kishin ngarkuar mbi të. Shefqeti i porositi çobanët që të mos kishin frikë nga xhandarët, të mos i paguanin asnjë grosh afendikoit që kishte tapitë e atyre kullotave dhe të mos e afronin çelikun e tyre te stanet.

— Tashti më tregoni, — i pyeti ai, — a kanë ardhur këtej partizanët?

I thanë se një muaj e ca më parë, njerëz të armatosur kishin kaluar një natë në stanet. Po, që atëherë nuk ishin dukur më dhe asnjëri nuk dinte se ku mund të gjëndeshin.

Tri ditë e tri net brodhën mal më mal e shteg më shteg, çanë pyje e përrenj, pyetën fshat më fshat dhe, më në fund, i gjetën partizanët në oborrin e një teqeje. Shefqeti, duke tërhequr për freri kalin e madh që ishte bërë telef nga këmbët dhe ishte tretur, sa i qenë bërë brinjët govatë, shkoi drejt e te komandanti.

— Jam Shefqet Argjiri nga Ferrkuqi. Më regjistroni në çetën tënde, mua, tim nip, Sulejmanin, kalin dhe njëzet pushkë që ua mora xhandarëve.

Komandanti i çetës i dha vaktin dhe ia pat:

— Ne s'kemi regjistra, o shoku Shefqet! Ku të të regjistrojmë! Sa për postëkomandën e Ferrkuqit, i dimë të gjitha. Po, pa ulu e më trego vetë njëherë, si ua punove atyre marshallëve.

— Po ja, ashtu, si ç'e keni marrë vesh edhe ju. I thirra, ua mbloodha rripat. Ata u trembën dhe ikën nga sytë këmbët.

— Të lumtë! Kjo që ke bërë, është një punë e mirë dhe me mend. Ty edhe nipin e pranojmë me gjithë qejf në çetë. Sa për kalin, ai s'na duhet. Qenka më të dhënë shpirt.

Dhe vërtet, sa mbaroi këto fjalë komandanti, kali shkrofëtiu si i tërbuar, ngriti qafën dhe u këput përdhe. Përpëlitit këmbët si kopanë, tundi bishtin, hapi gojën duke treguar dhëmbët e mëdhenj e të verdhë dhe nuk lëvizi më.

Shefaeti e nduku nga bishti dhe tha me pikëllim:

— Eh! I shkreti, kaq e patil! Kisha menduar të bridhja tërë malet me të!... Po shëndoshë këmbët!... E' po mbli-dhuni, ore djem, rripeni! Ta bëjmë të paktën opinga lë-kurën e tij...

* * *

Në tetor zunë shirat. Koha u ftoh menjëherë në male dhe dielli shumë rrallë çante perden e dendur të reve të zeza dhe lëshonte mbi pyjet e zverdhura rrezet e tij me dhëmbë. Në mëngjes herët, porsa agonte, mbi fletët e lajthive, mbi fierin e kuaërremtë, mbi barin e thatë dhe mbi dëllinjat e gjelbra endej një shtresë e bardhë bryme. Nga dreka kjo brymë shkrihej e bëhej pika-pika, si një vesë shi. Mbrëmieve ato narinte si një copëz akull. Fletët dridheshin me zhurmë dhe bari, nën këmbët e partizanëve, kërciste sikur thyheshin deaëza të thata. Më një fjalë, këto ishin ngricat fillestare që paralajmëronin dimrin. Dhe, me të filluar ngricat, partizanët netët i kalonin nëpër shtëpitë e fshatarëve, nëpër plevicat me kashtë, ose nëpër guvat e errëta e të ftohta.

Shefaqet Argjirin, si i kaluar në moshë që ishte, e vinin gjithnjë në këndin e djathtë të vatrës. Çeta ishte e vogël dhe brenda një jave ai i njohu të gjithë dhe u miqësua me të gjithë. Atë e donin dhe e nderonin i madh e i vogël, meqjithëse bënin edhe shaka me të. Në çetë pëlciste gazi, kur binte fjala për hartën e tij, për kalin e tij që naordhi në mes të oborrit të teqesë, për atë fialën e tij lidhur me mbretin. Po Shefaqet Argjiri nuk e prishte qejfin dhe nuk zemërohej kurrë. Ulej në këndin e vatrës, i porosiste të zotët e shtëpisë që t'u jepnin vetëm bukë e qepë dhe i linte të rinjtë të bënin qyfyre.

Një ditë Suleimani e pyeti:

— Përse, ti dajë, kudo që vemi, kërkon vetëm bukë e qepë? Pse nuk i lë të na gatujnë ç'të duan?

— Sepse s'kanë dhe, sepse, s'kemi dalë për të ngrënë, po për të luftuar. Unë kur hyj në një shtëpi, shoh

plehun. Po pati pleh pak ose aspak para shtëpisë, domethënë se ai konak është i këputur. Gjer tashti në shtëpi të tilla kam hyrë, prandaj edhe u kam kërkuar vetëm bukë e qepë.

Edhe kjo pyetje që bëri pa të keq Sulejmani, u kthye që atë ditë në shaka. Sa hynin partizanët në ndonjë konak, vështronin Shefqetin me bishtin e syrit dhe, kur ky porosiste bukë e qepë, ia plasnin gazit...

Pas dy javësh, çeta vendosi të godiste një përqendrim të vogël të trupave italiane që ndërtonin një kazermë buzë xhadesë automobilistike. Partizanët udhëtuan pothuaj gjithë natën, gjersa mbërritën te vendi dhe gjersa bënë rrethimin. Duke shkelur me kujdes mbi tokën e ngjirë, Shefqeti i thoshte Sulejmanit me zë të ulët:

— Aty te kazermat duhet të rrëmbejmë hekur e çimento që të ndërtojmë shtëpitë në fshat.

— E me se t'i ngarkojmë?

— I fshehim në ndonjë shpellë, pastaj lajmërojmë fshatarët të venë t'i marrim...

Porsa filloi të gdhiehej, krisi pushka. Shefqeti ishte shtrirë në një llogore, që zoti e di se kush e kishte ndërtuar dhjetëra vjet më parë dhe mundahej të shikonte armikun mirë, pastaj të qëllonte. Prapa krahëve të tij zbraste mortajën e lehtë një partizan i vogël.

— More, Petrit! — i thirri Shefqeti. — A sheh ku bien predhat? Në majë të malit dhe jo në kazermë.

— Hajt, se e rregulloj unë tashti, — tha djaloshi. Dhe vërtet e rregulloi. Predha shpërtheu mu mbi çatinë e kuqe të kazermës.

— Të lumtë, ore djalë! — thirri Shefqeti dhe bëri tatëpjetë.

Gjysmë ore më vonë, çeta dogji kazermën dhe u detyrua të tërhiqej menjëherë, mbasi te vendi i betejës mbërriti një autokolonë armike që ishte në udhëtim e sipër. Italianët zunë vend nëpër hendeqet më të dy anët e xhadesë, hapën zjarr të dendur, po nuk sulmuan. Partizanët u mblodhën prapa malit, në një luqinë midis dy pyjeve të dendura me qështenja. Atëherë vunë re se u mungonte Shefqet Argjiri.

— Kush ishte me të? — pyeti komandanti ulur pranë zjarrit, ku kishin vënë gështenja për të pjekur.

— Rrugës ishim së bashku, — shpjegoi Sulejmani shumë i tronditur. — Bile, mbaj mend që më tha të merrnim hekur e çimento...

— Hekur e çimento?! — u habit komandanti.

— Po. Hekur e çimento.

— Ku ta merrnit?

— Ja, atje, te kazermat e italianëve.

— E përse?

— Daja më tha, për të ndërtuar shtëpi në fshat.

Komandanti tundi kokën dhe padashur vuri buzën në gaz. Nxori nga zjarri një gështenjë, i fryu dhe filloi ta qëronte.

— Shkoi si qeni në vresht! — tha ai si me vete i pezmatuar dhe u përtyp.

Kjo ngjarje i dëshpëroi të gjithë. Çeta e vogël, mbledhur rreth zjarreve, i preu fjalët e shakatë. Partizanët hanin gështenja të pjekura dhe muhabeti nuk u shkonte. Po më shumë u dëshpërua Sulejmani. Ai kishte radhën e rojës. Rrinte prapa një guri në majë të pyllit me gështenja dhe vështronte rrugën e malit. Nga lindja afroheshin gjithnjë e më shumë re të zeza. Këto re i shtynte era varg njëren pas tjetrës dhe i grumbullonte në atë copë qiell që dukej përmes degëve të gështenjave. Nga dreka qielli u bë pus dhe filloi të vesonte. Sulejmani vështronte i pikëlluar rrugën dredha-dredha të malit dhe mallkonte veten që nuk i kishte vajtur pas dajës, ashtu si ç'që be-tuar njëherë...

Me të filluar shiu, komandanti dha urdhër që çeta të mblidhej e të nisej për udhë. Dhe tamam në këtë kohë Sulejmani erdhi me një frymë e lajmëroi se tre italianë, njëri hipur në kalë e dy në këmbë, po vinin lart rrugës së malit. Pylli me gështenja zhurmoi sikur ra breshër nga hapat e shpejtë të partizanëve. Kur dolën majë bregut, italianët ishin afruar mjaft.

— Ndaall — u thirri Sulejmani duke marrë nishan atë që ishte hipur.

Kalorësi që ecte përpara të tjerëve, tërhoqi frerin dhe qëndroi. Partizanët u habitën, kur dëgjuan që ai fliste një shqipe të kulluar:

— E more, ç'doni?! Me ngadalë, se mos na vrisnil

— O dajë! — thirri Sulejmani dhe doli në rrugë.

— Unë jam! — u përgjigj Shefqeti dhe zbriti nga kali.

— Të dinim të vrarë, o dajë! Edhe unë tashti desh ta mbajta në lule të ballit.

— Hyner të madh do të bëjel...

Komandanti, duke qeshur, doli në rrugë, e përqafoi dhe i hodhi një vështrim të gjatë që nga këmbët gjer te koka. Dhe që nga këmbët e gjer te koka Shefqet Argjiri ishte veshur si italian, me një palë rroba të reja prej oficeri, me çizme të lustruara, me një bustinë që kishte ende shenjat e ushtrisë italiane. Në qafë i varreshin një automatik dhe një palë dylibi të mëdha.

— Po këta, ç'i ke? — e pyeti komandanti duke vështruar italianët që qëndronin në këmbë tërë sy e veshë nga frika.

— Robër, — u përgjigj Shefqeti dhe iu kërcënuua italianit që kishte një monokël në syrin e djathtë.

— Pa na trego, si e qysh i zure?

— I zura në depon e çimentos. Ishin tre. Njëri mbeti atje. Ky maskarai, me xham në sy, është oficer, ky tjetri është ushtar, ushtar i mirë. Më ndihmoi për të dalë shëndoshë nga depoja. Desh e lashë lëkurën!... Po nga doli gjithë ajo ushtri, xhanëm? Të mos isha veshur kështu si jam veshur, e hëngra kullotën. Ia hipa kalit, i vura këta përpara dhe dola përmes xhadesë. Siç e sheh, mbërrita shëndoshë e mirë te vendi: pyjet me gështenja. Apo nuk e kishim lënë këtu takimin?

Si ajo bomba që shpërthen, ashtu shpërtheu gazi në çetë. Partizanët e përqaftuan me radhë Shefqet Argjirin, duke e mburrur për trimërinë që kishte treguar. Filluan bisedat e zjarra rreth betejës së mëngjesit. Sulejmani iu betua përsëri se nuk do t'i ndahej më, po do ta ndiqte dajën këmba-këmbës. Gëzimi, që kishte humbur për disa orë, iu kthye çetës përsëri. Dhe përsëri filluam shakatë e qyfyret.

Duke ecur, Shefqet Argjiri e pyeti oficerin italian me të tallur:

— Po këtë xham, përse e mban në sy?

— Ky është monokël. Jam kont.

— Ç'domethënë, kont?

— Fisnik.

— Qofsh shëndoshë!... Po, pa na thuaj, zoti kont, a do të luftosh me ne kundër fashizmit si ai ushtari yt? A e sheh ushtarin? Atij ia dhamë pushkën. Ai tashti është shoku ynë. Është partizan... Hë, pra, përgjigju, do të luftosh edhe ti?

Konti ngriti fytyrën e bardhë e të lëmuar, hoqi monokëlin dhe u përgjigj duke u gëlltitur:

— Do të luftoj... por... në intendencë... Unë jam specialist për furnizimin e ushtrisë.

Shefqeti u shkeli synë shokëve dhe qeshi majë kalit:

— Mirë, mirë, more kont! Po, pa na thuaj, si intendent i dëgjuar që qenke, a di të rruash e të qethësh?

— Posi. Di fort mirë.

— Po këpucë, a di të qepësh?

— E kam zanatin tim, — u përgjigj konti menjëherë.

— Po hallvë a di të bësh, or kont?

Plasi gazi përreth. Atëherë oficeri e kuptoi se po talleshin dhe uli kokën, i turpëruar...

Pas dhjetë ditëve, çeta goditi përsëri përqëndrimin e trupave italiane te kazerma e djegur. Armiqtë u shpartalluan. Po në luftim e sipër u vra edhe ushtari italian. E mori plumbi mu në lule të ballit dhe vdiq pa thënë një fjalë. Kurse «konti» humbi pa lënë nam e nishan. Më kot e kërkuan pyjeve me gështenja, luginave e shpëllave përreth.

— Ah! Veç mos më rëntë në dorë edhe një herë! — tha Shefqeti me zemërim. — Do t'ia ngul atë copëz xham mu aty ku s'rëfeket!...

* * *

Si për inat të tyre, shiu nuk lëreu tërë natën. Kapotat u ishin qullur e rënduar. Vetëtinte e bubullonte në qiellin

sterrë dhe era ua përplaste turinjve me forcë pikat e shiut. Në dritën e vetëtimave, Shefqet Argjiri, që ecte në krye të skuadrës së tij, kthente kokën dhe vështronte partizanët. Ishin dymbëdhjetë veta që ecnin të mbledhur shuk, me kryet futur thellë midis shpatullave. Nuk dëgjohej asnjë fjalë a psherëtimë, nuk dëgjoheshin as hapat e as kolla e atyre që ishin ftohur. Dëgjohej vetëm rrapëllima shurdhuese e ujërave të një përroi të rrëmbyer, që rridhte disa hapa në krah të djathtë të tyre. Kur bashkohej kjo zhurmë me krismën e gjëmimeve, dukej sikur shembeshin malet që s'kishin të sosur.

– Bëni gajret, djema! Për një sahat arrijmë te vahu. Sa ta kapërcejmë atë, do të feksë edhe dita.

Partizanët i dëgjuan përgjysmë fjalët e skuadërkomandantit të tyre.

– Si the, o shoku Shefqet? – e pyeti Petriti, që mbante mbi kurriz mortajën e lehtë dhe që dukej sikur i kishin vënë ndonjë samar.

– Them se arritëm. Ja këtu ka qenë ura e vjetër që dogjën fashistët. Më poshtë është vahu. Bëni gajret!

Llamburiti një vetëtimë dhe në dritën e saj Shefqet Argjiri pa disa fytyra të qullura me faqe të paruara dhe, midis tyre, dalloi fytyrën e re të Sulejmanit.

– Unë do të kapërcej këtu. Kush bën edhe një orë rrugë, – dëgjoi në errësirë zërin e nipit.

– Ku do të kapërcesh këtu? Mbi tel?!
– Kam kapërcyer edhe një herë tjetër!

– Hap sytë, more djalë, se po re, të rrëmbyen valët e të shpunë në det, – e këshilloi Shefqeti.

Megjithëse ishin mbështjellë të dymbëdhjetë kokë më kokë, flisnin me zë të ulët e mezi dëgjonin. Poshtë gumëzhinte i tërbuar përroi i turbullt dhe i fryrë nga ujërat e shirave. Në dritën e një vetëtime tjetër Shefqeti dalloi mbi përrua, pakëz më sipër urës së djegur, një tel të trashë. Nga një anë telin e kishin lidhur në një shtyllë telefoni, kurse këtej, nga ishin partizanët, e kishin shtrënguar, fort pas tringut të një shelgu.

– Hap sytë, Sulejman! Ty të them!

– Mirë, o dajë, mirë! – iu përgjigj nipi duke u varur me duar në telin e trashë. Pas pak ai u shkëput nga ledhi dhe mbeti i varur.

– O Sulejman! – i thirri skuadërkomandanti dhe, si nuk pa gjë e nuk mori përgjigje, vuri duart në gojë si pizgë dhe thirri sa kishte në kokë: – O Sulejman!

Partizanit i rrëshqisnin duart se i kishte të lagura. Hidhte njëren dorë, pastaj i jepte me të shtyrë supit dhe hidhte krahun tjetër. Shkrepi një vetëtimë tjetër. Shefqeti e pa djalin që kishte arrirë në mes të telit duke zgjatur krahun dhe iu duk sikur ai po rrëzohej tamam te vendi ku vala fryhej më shumë dhe binte pastaj me rrapëllimë, si nga një katarakt.

– Sulejmaaan!

– Mos ki merak, o shoku Shefqet! Ai kapërceu. Tashti e kam radhën unë, – u përgjigj Petriti dhe, pa e bërë të gjatë, shtrëngoi mirë rripin e mortajës dhe u var në tel. Pas tij kapërcyen me radhë edhe gjashtë partizanë të tjerë.

«Jeni të rinj, more djema», – tha me vete Shefqeti, kur u sigurua se ata mbërritën shëndoshë e mirë matanë lumit...

Tamam pas një ore ai, së bashku me shokët e tjerë, kapërcyen vahun në një vend, ku përroi e ngadalësonte vrapin dhe zgjerohej nja dyqind metra më të dy anët. Zakonisht vahu nuk kishte ujë më shumë se aër në gjü dhe kapërcehej shumë lehtë. Por atë natë Shefqetit iu desh të çante ujërat me gjoks, duke u mbaltur fort pas duarve të partizanëve të tjerë. Valët e padukshme dhe të frikshme ia rrihnin gjoksin dhe e shtynin poshtë. Rryma e fuqishme mudohej t'ia shqiste këmbët e ta rrëmbente me vete. Shefqeti ndiente se si rrëshqiste rëra nën tabanët e çizmeve ushtarake që tashti nuk ishin më të reja.

– Shtrengohuni, or djem, se shkuam në det! – u tha shokëve dhe, ngaqë uji ishte i ftohtë, iu duk sikur e prenë me brisk rreth e rreth belit dhe te majat e gishtave.

– Bëni gajret, or djem, se dollëm! – u dha zemër shokëve, kur uji i zbriti nën gjü.

Mirë e kishte parashikuar kohën Shefqeti. Me të dalë në xhade, filloi të gdhinte. Nëpër mugëtirën e mëngjesit dallohej xhadeja e bardhë që nuk i ndahej përroit, sikur të ishte hija e tij. Mbi përrua endej mjequlla e hirtë që mbulonte si me napë ujërat e turbullta. Shiu pushoi dhe re'ë, për çudi, u bënë të bardha qumësht dhe me shpejtësi kaluan më të kaptë të maleve hijerënda.

Shefqeti shtrëdhë sa mundi çipat e setrës dhe shajakët, pështyu pëllëmbët dhe, duke u dredhur nga të ftohtit, filloi të priste një shtyllë telefoni. Sëpata e mprehtë u ngul si një dhëmb i çeliktë në trungun e thatë e të fortë. Pastaj shtylla ra me një frushullimë të lehtë. Shefqeti i bëri copë telat, theu me mykën e sëpatës izolatorët dhe, me një shkelm, e dërgoi shtyllën në fund të përroit.

Më tej ai dëraoi në përrua një shtyllë tjetër. Këtë punë bënë në xhade gjithë shokët e skuadrës së tij. Pre-në shtyllat, kanë izolatorët, këputën telat, dhe i flakën në përrua. Kur doli dielli, Shefqeti dha urdhër që t'i jepnin fund me kaq aksionit. I pari u ngjiti nja pesëdhjetë metra mbi një shullë, gjeti një vend si gropë ku nuk e hante era, caktoi rojat dhe, si ndezën një zjarr të madh, filluan të thaheshin. Teshat e tyre të bëra aull avullonin ca naa zjarri dhe ca nga rrezet e diellit që ishin të naroh-ta, si në pranverë. Të lodhur nga rruga e gjatë dhe e vështirë, duke ndier në trup ngrohtësinë e diellit, të nanuritur naa zhurma e përroit dhe nga kënga e zogive, ata kaosallitën shtë dhe ranë në krahun e ëmbël e të butë të gjumit. Flinte edhe Sulejmani që ishte lënë rojë. Gjer në njëfarë kohe, ai luftoi me gjumin që i kishte ardhur në kapakët e syve. Pastaj u mblodh shuk, futi mjekrën dhe majën e hundës në jakën e palltos së qullur dhe e zuri gjumi. Një aukapik që kishte ngulur thonjtë në trungun e një gorricë të eqër, thau mirë e mirë pen-dët e kurrizit në rrezet e diellit dhe, si u bë trokë, filloi të rrihte sqepin e ajatë pas lëkurës. Sulejmani, që ishte struktur në një gropë shumë pranë gorricës, dëgjonte në-për gjumë të trokiturat e sqepit të aukapikut dhe i dukej sikur e shponin në tëmth me shtizë. U zajua përnjëherësh dhe, duke u dridhur, vuri re se ballin e kishte mbështetur

mbi një kërcu. Duke fërkuar me gisht vendin, ku i dhimbte, ai vështroi poshtë dhe ngriu sikur preku një tel elektrik. Njëzet metra nën të po kalonin pesë makina të hapura, të mbushura plot me ushtarë.

— Italianët! — pëshpëriti Sulejmani, u tërhoq zvarrë një copë herë dhe pastaj vrapoi gjysmë i përkulur.

— O dajë! Zgjohu, o dajë, italianët! — tha me një frymë duke ndukur për jake Shefqetin që gërhiste në shullë.

— Ç'ke, more nipçe, që më prish gjumin! Bre, ç'gjumë që po bëja...!

— Italianët, o dajë! Hipën sipër...

— Kuush?! Je në vetel... Ngrehuni, shokë! — urdhëroi dhe rrëmbeu dyfekun.

— Mos u ngri në këmbë, se do të të diktojnë. Janë pesë kamionë plot e përplot.

— Mos, more!

— Për zotin e vërtetë!

— Po ç'na bëre kështu?

Djemtë rrëmbyen dyfekët dhe, ashtu siç ishin, kush mbathur e kush zbathur, zunë nga një vend. Po ndërkaq kamionët u zhdukën në grykën e ngushtë e të dredhuar.

— Eh, ç'na shpëtuan, more shokë, — tha i dëshpëruar Shefqet Argjiri dhe drodhi një cigare. Duhanin dhe fletët që i qenë lagur, i kishte nderë në një copë pllaçë dhe i qenë tharë për bukuri. Ndezi cigaren me një thëngjill që e mori nga zjarri me dy gishta dhe e thithi me ëndje të madhe.

— Fajet i kemi vetë. Premë telat dhe harruam që do të vijmë për t'i ndrequr. Tashti unë mendoj kështu: Të zëmë pritë më poshtë, se këtu s'është vend i mirë, të minojmë rrugën dhe t'i presim. Gjumë bëme, bukë hëngrëm, u ngrohëm mirë e mirë, thamë edhe duhanin. Tashti, oburra, pas meje! Do të zëmë majën e atij shkëmbit të bardhë mbuluar me lajthi...

Pas tri orësh gryka gumëzhiu nga makinat ushtarake. Një triçikël dhe një autobлиндë që ecnin në krye të kolonës së vogël shkelën në minë dhe u hodhën në erë. Kaskat e ushtarëve shkëlqyen majë makinave, po kur shpërthy-

en minat, këto kaska u hodhën në xhade dhe vrapuan tutje e tëhu, duke u përplasur me njëra-tjetrën, duke u rrokullisur mbi xhade, duke kërcyer drejt e në përruan e thellë e të rrezikshëm. Batareja e pushkëve ishte e pandërprerë. Plumbat përcëllonin ajrin dhe nguleshin në mish. Njëra nga makinat bëri një rrotullim të shpejtë nga e majta, qëndroi një grimë me rrotat buzë përroit pastaj, sikur e shtyu njeri me forcë, shkau në greminë me gjithë ushtarë. Duke rënë, ajo kërcente si top nga një shkëmb në tjetrin, gjersa zuri vend në ujërat e thella e të turbullta. Ushtarët fluturonin si cingla, duke u lebetitur, kaskat vringëllinin në ajër dhe dyfekët zinin ndonjë ferrë pa ia bërë bam farë. Po bëhej me të vërtetë kërdia! Gati njëqind ushtarë italianë ishin vënë nën breshërinë e plumbave dhe i . . . priste me siguri ose vdekja, ose përroi i llah-tarshëm. Duke e kuptuar mirë këtë rrezik, ushtarët që mbetën ende gjallë, filluan të vraponin njëri pas tjetrit, anës xhadesë. Shkonin me shpresë të arrinin kthesën dhe andej të mblidhnin veten e, po të qe nevoja, të qëllonin. Mirëpo, që nga maja e shkëmbit, çdo gjë dukej si në pëllëmbë të dorës. Ushtari i parë që mori guximin e çau përpara, ra përmbys, pasi bëri pesëmbëdhjetë-njëzet hapa. Po vdekja e tij nuk i trembi të tjerët. Duke kaluar mbi kufomat e të vrrarëve, mundën, më në fund, të kapërcenin kthesën e të shpëtonin nga tridhjetë ushtarë. Të tjerët mbetën aty, nën shkëmb, të vrrarë e të plagosur, ose u mbytën në valët e turbullta.

Shefqet Argjiri i futi kërrin me fishekë maliherit, kroi zverkun me gisht dhe vështroi shokët që kishin rënë përmbys mbi shkëmbinjtë me dyfekët në sy. Diçka tha me vete i kënaqur dhe u ngrit. I qe tharë goja për një pikë ujë. Aty poshtë shkëmbit, pothuaj buzë xhadesë, ishte një burim i ftohtë. Mendoi të dërgonte ndonjë nga shokët për të mbushur mataranë. Po ndërroi mendim.

— Do të thonë i hyri frika komandantit, — pëshpëriti dhe, si mori mataranë, zbriti tatëpjetë duke u munduar të fshihej përmes lajthive. Në një gur të bardhë, përmes ca guriçkave të shndritshme, gurgullonte një ujë i kulluar qehlibar. Shefqeti u ul më gjunjë, largoi një fletë lajthie

që lëkundej si ndonjë maune mbi burim dhe piu me etje e me kënaqësi të madhe ujin e lehtë e të ftohtë të maleve. Duke fshirë buzët me mëngën e palltos, mendoj se ishte koha që të largoheshin për t'u takuar me çetën. Po më parë, nuk do të ishte keq që ta minonin edhe një herë rrugën, të merrnin ndonjë material luftarak që kishin hedhur italianët dhe pastaj të niseshin.

— O Sulejman! — i bëri zë që nga burimi të nipit.

— Urdhëro! — dëgjoj menjëherë përgjigjen.

— Silli ato minat që kanë mbetur...

— Cilat?

— Minat.

— Mirë!

Dhe ia solli. Po nuk ia solli të saktë. Në një nga arkat e mortajës së lehtë kishte harruar pa marrë kap-sollat.

— Tutkun, përse nuk i kontrollove? — e shau Shef-
qeti duke nxjerrë minat nga thesi.

— Shkoj e i marr tashti.

— Në djall të vesh... Ku do të shkosh? A nuk i sheh
makinat e tjera që po u vijnë në ndihmë?

— Jo nuk i shoh. Ku janë?

— Vër veshin e dëgjo!

— Është zhurma e përroit...

— Janë makina dhe të mëdha bile, — tha i zemëruar
Shefqeti dhe, ndërsa Sulejmani mori të përpjetën, ky
vendosi të shkonte e të shihte se ç'u bënë ata ushtarët
që mundën të shpëtonin dhe ç'ishte ajo zhurmë e madhe.

Eci rrzëzë shkëmbit dhe, kur u afrua në fund të tij, u
ngjit pakëz lart, mbi një gëmushë, mbuluar me bar. Majë
asaj bregoreje të vogël ai pa një mitralier dhe dy ushta-
rë që kishin ngritur mitrolozin gati për luftim. U ul qetë-
-qetë aty ku ishte, dhe mori nishan mitralierin, i cili po u
jepte urdhra ndihmësve të tij, që mbanin kasat e fishe-
këve mbi kurriz. Shënjestra u fut përmes fijeve të barit
dhe u drodh. Plumbi çau ajrin me fishkëllimë dhe, si
duket, e goditi mitralierin në ballë, pasi ky klithi dhe
shtrengoi kokën me pëllëmbë. Pastaj ra më gjunjë dhe

u shtri barkas. Njëri nga ndihmësit ia shtriu krahët për ta ngritur, po mbeti i vrarë mbi të. Tjetri theri përmes barit. Po, pas pesë hapash, shtriu krahët përpara dhe ra përmbyës me faqen mbi barin e lagur.

Shefqeti u ngrit më gjunjë dhe, duke kruar zverkun me gisht, vështrroi xhadenë përtej. Një mizëri ushtarësh i zuri syri. Kishin ardhur ndihma të mëdha, domethënë kishte pasur të drejtë, kur kishte menduar kështu.

«Po përpiqen të na rrethojnë!» — tha me vete dhe u kthye përsëri te burimi. Piu përsëri me etje të madhe dhe duke pirë, dëgjonte Sulejmanin që e thërriste i shqetësuar:

— O Shefqeet! Ikë se na rrethuan italianët!

«Ama lajm po më jep, sikur nuk e di unë!» — mendoi dhe, duke ngritur kokën nga burimi, pa, nja tridhjetë hapa përtej, në hendekun e ngushtë të xhadesë, dy ushtarë me arka në kurriz, që vinin drejt tij. Siç ishte më gjunjë, mori shenjë, i futi të dy në veshët e maliherit dhe shkeli këmbëzën.. Dhe, me një plumb, i vrau të dy. Ushtarëve u fluturuan kaskat nga koka dhe mbetën në vend, shtrirë sa gjatë gjerë. Dhe, tamam në këtë kohë, italianët hapën një breshëri të dendur zjarri me pushkë e me mitralozë. Dhe gjithë ky breshër drejtohej mbi të. Shefqeti u trondit për një çast, duke u struktur pas gurit të burimit. Pastaj, e mblodhi veten dhe vuri veshin. Dëgjoi shokët që e thërrisnin të tërhiqej dhe u gëzua. Nuk u gëzua nga fjalët e shokëve, po nga fakti se u bind që italianët shtinin në tym. Atëherë, më gjunjë siç ishte, mori nishan përsëri ushtarët italianë që vinin barkazi buzë xhadesë me arka në kurriz.

Gryka gjëmonte nga krismat. Plumbat çanin qiellin, që kishte filluar të vrenjtej, skërfisnin gurin prej shtufi, fëshfërinin përmes fletëfe të lajthive dhe shuheshin në ndonjë trung peme a në ndonjë kaçubë me bar. Kurse Shefqeti qëllonte më nge, në mish. Italianët që futeshin në shënjestrën e tij, klithnin «māma mia», flaknin dyfakun, shtrinin duart përpara dhe binin, si ata notarët.

Më në fund, u tërhoq, se iu mbaruan fishekët. I kishin mbetur plumba vetëm në koburen që e mbante në

dorë, se dyshonte mos i dilte përpara papritur ndonjë ushtar. Shokët i arriti përtej shkëmbit, ku kishin zënë pritë, në faqen e malit mbuluar me shkozë. I gjeti të lodhur e të kapitur. Mezi merrnin frymë.

— Ç'e bëre, mortajën, Petrit? — pyeti ai me gjysmë zëri, se edhe ishte lodhur sa s'bëhet.

— Shtatëdhjetë bomba që kisha, i mbarova... E fsheha.

— Po ti, ç'e bëre mitralozin? — pyeti një tjetër, ashpër.

— Ti e di, o shoku Shefqet, se ai mitraloz i hidhte fishekët vetëm një nga një. Si hodhi edhe të fundit, e fsheha në një ferrë...

— Mirë, besa. U bëmë si ushtria e Osman Gazepit!

— tha Shefqeti dhe, si u hodhi një vështrim shokëve, u bë pishman që i rëndoi. Edhe ata kishin luftuar si ai, edhe ata ishin lodhur e kapitur si ai. Pa shiko si merr frymë Petriti, Sulejmani, të gjithë! Janë bërë telef djemtë! — M'ju lumtë, bre, çuna! Keni bërë luftë, si burrat! Kërmë u bë dynjaja! Dhe ne të gjithë jemi shëndoshë e mirë. Oburrani! Jepuni këmbëve sa të arrijmë më të kaptë të malit! — u dha zemër dhe u vunë në rrugë.

E përpjeta ishte si thikë dhe s'kishte të mbaruar. Gjer në një farë vendi, ecën pa merak, por pastaj italinët i diktuan dhe iu vunë pas duke qëlluar vazhdimisht. Shpeshherë plumbat u vërshëllenin mbi krye dhe ata detyroheshin të mbroheshin duke ecur të përkulur e, nganjëherë, bile edhe duke u tërhequr zvarrë. Kjo ua mori shpirtin fare. Dhe s'kishin asnjë fishek për t'u mbrojtur, përveç fishekëve të nagantëve. Shefqeti, duke e ndier rrezikun që u kanosej, u jepte zemër shokëve dhe i nxiste që të ecnin pa pushim. Kjo ishte e vetmja rrugë shpëtimi. Të ecnin sa u hanin këmbët, duke dredhuar, të arrinin majën sa më parë, andej, pastaj, fillonte tatëpjeta dhe pylli i dendur e pa fund me bredha e me ahe.

— Oburrani, shokë! Gajret, gjer te maja! Andej pastaj rreshqasin këmbët vetë!... Ja edhe pak e mbërritëm! — u jepte zemër Shefqeti duke marrë frymë me gojën hapur. Një afsh i nxehtë i dilte nga kraharori, nga fytyra, nga veshët dhe s'qe në gjendje ta shuante. Hapte gojën, thithte ajrin dhe ecte gjysmë i përkulur, duke dëgjuar

mbi kokë vërshëllimën e mprehtë të plumbave. Njëherë, një plumb gođiti dy pëllëmbë përpara tij, mbi një pllloçë. Guri u bë cifla-cifla dhe një nga këto cifla e goditi lehtë në këmbë. Më tej, një plumb tjetër u përplas mu te gjurma e furçit që ai la pas. Plumbi i tretë shpoi kindin e kapotës.

— Më ka vënë në shenjë e s'më ndahet, qen i biri qenit! Më ndjek si ai ujku delen dhe do të ma hajë kokën! — pëshpëriti Shefqeti, ra barkas, u tërhoq pakëz zvarrë dhe, pastaj, filloi të kërcente bush më bush, si ai beguni i vogël e i pamësuar...

Dhe ja, ajo që priste, u bë! Një plumb e shpoi tejpartëj në bel. U lëkund në vend, si ai rrapi, kur fryn era e marrë, u mbajt pas pushkës për të mos rënë dhe mbuloi me mëngën e kapotës sytë që iu errësuan. Po, megjithatë, këmbët nuk e mbajtën. Mbështeti njërin gju përdhe dhe atëherë dëgjoi njërin nga djemtë që e pyeti.

— Mos u plagose, shoku Shefqet?!

U ngrit përnjëherësh, u lëkund përsëri dhe filloi të ecte duke shtrënguar nofullat nga dhembja.

— Më janë nkuar shalët nga djersa! S'kam gjël...

Batareja e pushkëve dhe e mitralozëve bëhej gjithnjë e më dendur. Italianët po i ngjiteshin malit në tre krahë, në formë rrethi. Këtë partizanët e kuptonin nga zjarri që u vinte gjithandej. Po të mos arrinin të dilnin në majë, do të mbaronin me siguri të gjithë, duke dhënë shpirt në ndonjë nga bushet e shumta që lëshonin një erë të rëndë e të hidhur.

— Oburrani, djem, edhe pak! — u jepte zemër Shefqet Argjiri, duke ndier gjakun që i kullonte gjer në fund të këmbës së majtë dhe i mbushte çizmen. Ishte zverdhur dhe qimet e faqeve i qenë ashpërsuar. Këmbët i qenë rënduar si kopanë dhe mezi i hidhte. Goja i qe tharë për një pikë ujë dhe përreth buzëve i qe formuar një shirit i bardhë. Në ecje e sipër, ai ndjeu edhe një dhembje tjetër në shpatullën e djathtë. Një klithmë e mbytur i shpëtoi nga goja. Qielli, mali, bushi iu rrotulluan dhe iu përzien. Vetë u përkul prapa dhe formoi pothuaj një gjysmë harku. Po për të rënë, nuk ra.

— Ah, Ç'më ka vënë në shenjë, biri i bushtërë! Do të më bëjë shoshë! — pëshpëriti dhe kafshoi gishtin sa e bëri gjak.

— O dajë, ç'ke kështu? Mos more ndonjë plagë?... Epo ec de, se na arritën! — i tha Sulejmani që u ndodh pranë tij.

— Gajret, djema, edhe pak! — pëshpëriti Shefqeti, shtrëngoi tytën e dyfeket që e kishte hedhur mbi supin e majtë dhe bëri përpara, me mundim të madh. Nuk donte t'u tregonte se ishte plagosur. Ky lajm do t'i dëshpëronte djemtë. Partizanët ishin lodhur aq shumë, sa nuk mbanin dot as edhe një shkrepëse dhe jo pastaj të merrnin në krahë një njeri. Dhe kush i linte ta merrnin? Nga prapa gjëmonte vazhdimisht vdekja e mallkuar. Ajo nuk u nda- hej në çdo hap, sa herë hapnin gojën për të marrë frymë, sa herë binin për t'u tërhequr zvarrë. Prandaj Shefqeti nuk u tregoi. Me shpirt në dhëmbë, ai ecte duke u lë- kundur sa majtas djathtas, sa para prapa, duke pritur me ankth plumbin tjetër. Ecte me trupin drejt se nuk mund të përkulej, vetëm lëkundej si ai lastari në erë dhe, me givsmë zëri, vazhdonte t'u jepte zemër shokëve të kapitur. Po nuk eci dot aiatë. Te një bush i kuqërremtë nariu për një çast në vend. I ngeci edhe fryma, i ngriu edhe pushka në dorë, edhe syri me vështrimin e tretur.

— E treta e vërteta! — pëshpëriti me zor. Tre plumba mora... në kurriz!... Jazëk! — Hodhi një hap të pasigurt dhe u kthye me fytyrë nga armiku. Vuri duart në kraharor dhe tha me zë të mbytur oë e dëajonte vetëm ai: — Këtu më bini, aen bir qenash!... Këtu! — Sytë iu veshën, naa goja i plasi gjaku dhe iu duk sikur u rrokullis përposh, mbi një gjë të butë, si dyshek me pupla. Po e mbloodhi veten menjëherë. Kishte rënë mbi bushin e kuqërremtë. U ngrit duke rënkuar dhe pa Suleimanin dy hapa më tej:

— O dajë! C'është ky gjak që po të del nga goja? — pyeti djali me shqetësim.

— Theva dhëmbët, kur rashë! Ec, ec... Suleiman! Obu- rrani, edhe pak! Ja tek mbërritëm! — u përqaiaj Shefaeti dhe, si mbloodhi forcat e fundit që i kishin mbetur, mori frymë thellë dhe hodhi hapin e rëndë.

Nënër bush s'dëajoihej atë tietër vec frymëmarrjes së njerëzve. Ajo i përnatante frymëmarrjes së stuhisë. Cdo atë rëndonte si plumb në trupin e tyre, pushka, aierdanët bosh, kapotat, këpuçët, cdo qië, hile edhe airi, në thithnin me rrëmbim, u dukej i rëndë plumb. Balli u nërvelonte nga diersët atë u kullonin curk, aiuniët u thyeshin nga pesha e trupit, qoja u qe nërtharë e meqithatë. ecnin na pushim e pa u ndalur, kërcenin nga një bush te tietri, tërhineshin zvarrë duke rëvizitur faqet pas dheut të ashnër. I ndiate nga pas vdekia, kurse përnara. majë malit, i priste jeta. Dhe prandaj ecnin me shpirt në dhëmbë...

Dhe më në fund arritën në majë.

I pari arriti Petriti i vonël. Me të kapërcyer më të kapëtë, u përplas përtokë, më kurriz, na vënë re se ku ra. miftonte atë atv nuk e hante plumbi. I fundit mbriti Shefaet Arajiri, duke u mbaitur pas dyfekut dhe duke u kolovitur mbi këmbët e tij të rënda.

— Tashti, o shokë, shpëtuam!... Dhe unë mbarova! Kam marrë tri plagë dhe s'hej dot më tei... Më shtrini atv, në atë folenë e shajponjës!... Më mbuloni me bush e me gjethe dhe ikni!

Këto tha Shefaet Arajiri dhe ra si një kurm i prerë nga rrëniët. Shokët u përkulën mbi të dhe e vështruan me pikëllim.

— Bëni siç u porosita, djem! — i urdhëroi.

— Nuk të lëmë në duart e tyre! — e kundërshtuan.

— S'u thashë të më lini në duart e tyre, po të më vini aty, në atë folenë e shajponjës...

— Nuk të lëmë! Nuk të lëmë! Të kemi komandant!

— Në më keni komandant, atëherë dëajomëni: Bëni ç'iu thashë dhe ikni sa më parë njëve! Atë s'kanë për t'ju ajetur. Le atë as atë s'kanë për t'iu ndjekur...

Suleimani ndolli hundët dhe fshiu cepin e syrit atë iu lag nga një lot.

— O dajë! — belbëzoi ai, po nuk tha fjalë të tiera, se Shefaeti ia preu me vështrimin e tij të perënduar, po ende të rrentë.

— Do të shihemi përsëri, o shokë! Nuk vdes unë!

Pa edhe në vdeksha, një copë emër do ta lë prapa. Kur ta kujtoni këtë emër, thuajuni të tjerëve se unë nuk iu tremba kurrë as armikut dhe as vdekjes!

E ngritën në krahë dhe e shpunë disa metra më tej te një vend i rrethuar me shkëmb të bardhë e që dukej tamam si një fole shqiponje. A ndoshta ishte me të vërtetë ndonjë fole e braktisur shqiponje!

– Më vini ca gurë anës!... Hiqjani siguresën kobures e ma vini në dorë!... Këtu në xhep kam një komunikatë, merreni! Merrni edhe dylbinë, dyfekun dhe çantën me gjithë hartën!... Po i ruani mirë, se do të më duhen përsëri... Hajt!... Ikni tashti! – pëshpëriti Shefqeti me zë të këputur dhe dëgjoi hapat e shokëve që largoheshin gjithnjë më shumë. Pas pak, me mundim të madh, ai ngriti pakëz kokën dhe, përmes gjetheve që i kishin hedhur përsipër pa Sulejmanin që kishte qëndruar me dhembje të madhe në zemër. Dhe djali, sikur ta kishte dëgjuar, u kthye e, me kokën varur në gjoks hyri në pyll dhe, pas pak, u fsheh midis drurëve të dendur.

– Tashti... eja, moj shtrigë... e më merr! – tha me vete Shefqeti, dëgjoi krisma armësh që zbrazeshin aty afër dhe pastaj nuk mori vesh ç'u bë, se i ra të fikët...

...Nga mesnata, shokët erdhën dhe e ngritën. Kishte rënë në një gjumë të thellë, po ishte gjallë...

«PËR MBROJTJEN E ATDHEUT»
Prill-Maj 1961

BUKA

Ai nuk dinte të çlodhej si tërë njerëzit. Ai nuk dinte ç'ishte lodhja. Tërë ditën, që pa gdhirë mirë e gjersa errej, ishte në lëvizje të vazhdueshme, duke tërhequr kalin për kapistre ose hipur në arabanë e tij dyrrotëshe. Askush nuk e pa ndonjëherë pa kalë e pa araba dhe gjithmonë, dimër e verë, vetëm nxitonte, qull në djersë, duke transportuar gurë, qereste, plitharë, zhavorr. Ishte njeri i heshtur dhe, kur takonte ndonjë të njohur, këmbente vetëm disa fjalë, edhe ato në ecje e sipër.

Ai më shumë bisedonte me kalin, sesa me njerëzit dhe më shumë kujdesej për të, sesa për pesë kalamajtë e të shoqen. Kur errej krejt, e çmbrehte, e fuste në ahur, i hidhte në kurriz një rrobë për t'i pirë djersën dhe, duke ia mbushur grazhdin me bar, i thoshte:

— U lodhe shumë sot, Kiçoooo! Dymbëdhjetë rrugë bëmë! Po mos kujto se unë nuk u lodha. — Kali kthente kokën duke përtypur fijet e barit të thatë. — Sigurisht, o bukurosh, ti je lodhur më shumë. Prandaj ha, të bëftë mirë! Por, po nuk punuam, me se do t'i ushqejmë ata pesë kalamajtë dhe atë të shkretë grua që është thyer

më dysh nga reumatizmi?! Ti e ke mirë, se ha bar, po njeriu nuk ha bar, do bukë! Ku ta gjejmë bukën, po nuk punuam?! Tani ngopu, o xhan i Malkës, këputi edhe një gjumë në këmbë, siç bën raca jote e bekuar, kurse mua këtu më ke!

Po të ishte dimër, ai flinte atje, në grazhd, mbi bar, mbuluar me një jorgan të vjetër e të leckosur. Në verë flinte përjashta, mbi araba. Rrallë i kalonte netët në kasolle, me gruan e fëmijët. Më keq se aq, zor se rronte njeriu.

Shtrirë në grazhd dëgjonte një copë herë përtypjet e kalit dhe, kur ky shkrofëtinte, i thoshte me zë:

– Këtu jam, Kiçoo! Ç'ke? Mos Je ftohur gjë?!

Zgjaste dorën dhe i prekte gjoksën e vithet:

– Të qenka tharë djersa. Tani çlodhu se kemi punë nesër, jo llafe! Do të ngarkojmë qereste te Shtyllajt dhe do t'ia shpiem zotit Doko në çiflig, në Zëmlak. Njëmbëdhjetë kilometra të vemi e njëmbëdhjetë të kthehemi, bëjnë njëzet e dy kilometra. Dëgjon, bukurosh? Do ta bëjmë dy herë këtë rrugë. Domethënë, dyzet e katër kilometra... Shumë janë për ty, o i gjorë, po s'kemi ç'të bëjmë!... Nesër është e diel dhe, si e diel, mirë ishte ta bënim pushim.

Kali shkrofëtiu. Malkës i erdhi për të qeshur.

– M'i kuptove fjalët, qerrata! Po harrove që je hajvan dhe për hajvanët s'ka të diela.

Kali nuk u përtyp më dhe nuk shkrofëtiu. Ai kishte ngrirë si mumje dhe nuk lëvizte asnjë qime të trupit. E kishte zënë gjumi. Ndërsa Malka, me mendje të turbullt nga lodhja e nga gjumi mendonte:

«Dy rrugë nga tre lekë, bëjnë gjashtë lekë. Një lek e do Kiçoja tagji. Mbeten pesë. Katër lekë i do Safeti për vajgurin, për fishekun me sheqer dhe për kaushin me oriz që i kam marrë veresie. Ç'më mbetet mua?! Mua më mbetet një lek. S'e mbyll dot ditën me një lek. Jemi shtatë shpirt. Duam dy koromane me bukë... Eh, sikur të arrija të bëja edhe një rrugë! Po s'ka zot që bën gjashtëdhjetë e gjashtë kilometra në ditë! Dëq'ion, Kiço? – shtoi me zë të lartë. – Edhe nesër keq e kam për bukë!

Kali s'dha asnjë shenjë jete. Flinte.

Atë të diel ai u zgjua, si zakonisht, pa gdhirë. Mbase ishte edhe më shpejt se herët e tjera. Kishte për të bërë një rrugë shumë të gjatë. E hante merakun i saj, prandaj çdo gjë e bënte shpejt e shpejt, gati duke vrapuar. E shpuri, kalin për ujë, i vari torbën me tërshërë dhe e mbrehu. Çirakët e zotit Shtylla, që ia qanin hallin, e ndihmuan për të ngarkuar qerestenë. Dielli e zuri jashtë qytetit, në debojë, ku ishin kazermat e reparteve ushtarake «Lupi». Frynte një erë e lehtë nga Morava, qielli ishte i kthjellët dhe në debojë dukeshin mirë topat e mëdhenj, avionët «kaçiatorë», kamionët e rëndë. Përtej telave me gjemba, buzë rrugës, shtrihej fusha e futbollit. Te hyrjet e kazermave e të depove shkonin e vinin rojat e armatosura. Atë çast ra boria e zgjimit. Kali i dëgjoi tingujt e mprehtë, ngriti veshët dhe shpejtoi hapin.

– Ashtu, Kiçooo, ashtu! Jepu një çikë këmbëve që ta vëmë kohën përpara sa është mëngjes akoma, – tha Malka pa kthyer kokën nga kazermat. Ai nuk kishte hipur në araba për të mos rënduar kalin, po ecte prapa saj me atë hapin e tij të shpejtë, me kokën përkulur përpara dhe me mendimin në Zëmbllak, te çifligu i zotit Doko.

«Edhe ai qeni shtëpi të reja po ndërtonte dhe kërkonte qereste. Qerestenë e kishte gjetur, po s'kishte karrocë dhe kërkoi karrocën time, ku kisha ngarkuar fuçitë e gjezapit», – mendoi Malka, duke kujtuar një ngjarje të hidhur, që i kishte ndodhur gati pesëmbëdhjetë vjet më parë.

Ai ishte në Amerikë atëherë. Kishte shkuar, si qindra të tjerë, për të siguruar kafshatën e gojës. Punonte në periferitë e Detroitit, në një fabrikë acidi, gjezapi, siç i thoshte Malka. Dhe punonte me një araba, pothuaj si ajo që ka tani, veçse arabanë e tërhiqte vetë. Transportonte gjezap. Kur, një ditë, ia pret rrugën një i huaj dhe i thotë:

– Ngarkoju këto dërrasa e m'i sill gjer aty, buzë lumit!

– S'kam nge! Më pushon nga puna padroni, – kundërshtoi Malka.

I huaji që i sertë, inatçi dhe gojëndyrë.

– Do të vish, se s'bën! – i tha.

– Nuk vij...

– Do të vish! – dhe frap ia bëri e nxori thikën. Ishte me dy. I tene dhe shkeqeu para syve të karrocierit.

– Fute thikën në brez dhe ik në punën tende! – i tha qete Malka.

Por i huaji nguli këmbë dhe e shau keq:

– Hajt! Mor qen shqiptar i zgjebosur!

Malka u zverdh në tytyrë dhe iu droanën duart. Kishin snarë keq atë dhe vendin e tij.

– Ik! – i tha i permbajtur. – Mos më fut në gjynah dhe, atë që the, mbaje për vetel!

Ajo që ngjau pastaj, u bë për disa sekonda. I huaji ngriti dorën, ku mbante thikën, po nuk arriti ta qëllonte. As Malka nuk e mban mend mirë se si u gjend i huaji kokëposhtë, brenda në tuçinë e acidit. E keqja u bë menjëherë!

– Hëngre kokën tënde, o i babëzitur! Vetë i pate fajet! Unë s'të kam ndonjë faj! – tha i pikëlluar Malka. E shpuri në një pyll, buzë lumit, dhe atje e varrosi, duke pëshpëritur i helmuar:

– Ishte e thënë që ti të vdisje e unë të vuaj për bukë!

I vëllai dhe farefisi e pritën me këmbët e para:

– Hajvan! S'arrite të lash as navllon! Me se do ta lash navllon?! Vdis për bukë!...

Arabaja kishte hyrë në Zëmlak. Kali dhe i zoti ishin bërë qull në djersë.

«Dreq! – tha me vete Malka. – Si është mendja e njeriut. Kërcen sa në një anë, në anën tjetër! Ç'm'u kujtua Amerika këtë të diel që kam për të bërë dyzet e katër a më shumë kilometra udhë?!» – dhe i foli kalit! – Hajt, Kiço, se mbërritëm!

Në rrugën e fshatit po zbrisnin katër ushtarë të huaj dhe një milic shqiptar, me shporta nëpër duar. Ata, duke qeshur kapërcyen një çakëll dhe morën poshtë nga plepat, midis të cilëve dalloheshin bateritë e topave të rëndë. Lart, në pyllin me lajthi kulloste kopeja e lopëve dhe e dhive. Në vijën e ujit, përpara kafenesë, laheshin

tufat me rosa. Malka i bëri shenjë kalit të qëndronte dhe zgjati kokën në kafene. Tryezat ishin plot me njerëz. Në njërën ishin ulur ata të parisë dhe luanin kumar. Karrocieri e njohu myshterinë e vet dhe iu drejtua me zërin e tij të qetë:

– Ta solla qerestënë, zoti Doko!

Ky ishte një burrë fytyrërrumbullakët, i rruar taze, me flokë pakëz të rënë. Lëvizi ngadalë kokën dhe e pa karrocierin me bisht të syrit. Siç duket, kumari i kishte shkuar mbarë, se i tha me zë të butë:

– Qenke ngritur shpejt, o Malkë! Ulu, ulu të të jap një kafel

– Të falem nderit, po s'kam kohë! – u mundua të buzëqeshte Malka.

Zoti Doko i hoqi fjalët zvarrë:

– S'kam kohë, thotë! Po ç'punë tjetër ke ti, veç kamxhikut? – e pyeti me njëfarë qortimi dhe me një buzëqeshje të shtirur. Pastaj papritur ngriti zërin, zbuloi lettrat dhe shtiu dorën mbi tufën e parave: – Lëreni se u bë!

Malka nuk mernte vesh nga kumari, po u habit, kur zoti Doko i futi tërë ato para në xhepin e brendshëm të xhaketës.

– Malkë! – i tha zoti Doko. – E di ç'të bësh ti? Shkar-koji dërrasat tek unë. E di ku po e ndërtoj shtëpinë? Atje në krye të fshatit, do të na bësh një të mirë. Do të vesh në Cangonj për të marr te kryeplaku ca thasë me miell e t'i sjellësh këtu, për ushtrinë.

– S'kam nge, – kundërshtoi Ismaili.

Zoti Doko qe i sertë, inatçi dhe gojëndyrë.

– Do të vesh, se s'bën! – i tha.

– Nuk vete...

– Do të vesh! – dhe zoti Doko futi dorën në xhep, tamam siç kishte bërë ai i huaji në Amerikë. Malka u turbullua, po erdhi në vete menjëherë, kur pa zotin Doko që nxori nga xhepi disa monedha dhe i hodhi mbi tryezë për të vazhduar lojën e kumarit. – Do të vesh, Malkë, do të vesh! Se e bën për ata, për miqtë. Apo nuk i do ti ata?!... Ashtu de, i do, se të kanë sjellë tërë

këto të mira, të kanë sjellë punën mbi të gjitha, edhe bukën...

– Ashtu, zotrote, ashtu, – pëshpëriste Malka, – Fuqi e madhe... Qeveri e madhe... Ushtri e madhe...

– Dhe luftën që kanë nisur do ta fitojnë. Dhe bota do të jetë e tyrja dhe jona... Tani, meqë nuk të pihet kafe, mbaroje këtë punë. Me mua i lajmë hesapet kur të sjellësh qerestënë, se më ikën zari.

– Si të dëshirosh, – tha Malka dhe u bë erë.

Sa vajti në Cangonj, sa ngarkoi thasët me miell, sa i dorëzoi në repartin e baterisë së topave, që ishte ngritur aty përfund fshatit, iku mesi i ditës. Malka i mirë, i fortë e i shpejtë, ishte bërë i sertë dhe grindej me vetveten:

«S'po më vete mbarë! Do të më zërë nata udhës. Gjynah për Kiçon! Gjynah për Kiçon! Do t'i përcëllojnë thundrat nga potkojntë e nxehur! Pale që mbeta edhe pa bukë!

Me të thënë fjalën bukë, ndjeu uri. S'kishte ngrënë që në mbrëmje. Ai e kishte zakon të mos hante mëngjes. «Të punoj, pa të ha», – thoshte dhe këtë zakon nuk e prishte. I dëgjoi zorrët si filluan t'i gërhisnin. Qëndroi te çezma e Plasës dhe u dend me ujë. Sa herë e grinte uria e s'kishte bukë për të ngrënë, frynte barkun me ujë. Më keq se aq, zor se rronte njeriu. Kali hante tagji në torbë. Ai shuante urinë me ujë. I hodhi një vështrim përbuzës kafshës dhe mermëriti:

– Ha, Kiçooo, ha! Të bëftë mirë! Ke akoma edhe gjysmën e rrugës për të bërë.

Ia hoqi torbën, hipi në araba dhe u nis përsëri. Gruri nëpër ara ende s'ishte zverdhur, po bënte nxehtë dhe cinxrat çirreshin fshehur nëpër gjethet e pemëve. Toka, e tharë nga dielli, vende-vende ishte çarë e diku ishte bërë si shkëmb. Ai e ngriti kokën lart për të parë diellin e për të përcaktuar orën. Një tufë patash fluturuan drejt kënetës rëndë-rëndë, në formë trekëndëshi. Hodhi sytë në rrugën tërë gropa dhe pa veshët e kalit. I kishte varur gati gjer mbi krifën e zezë e të djersirë.

– U lodhe, Kiçool – i tha.

Kali e dëgjoi, ngriti veshët si për të hetuar më mirë dhe shpejtoi hapin.

«Si njeri kupton, qerratai, si njeri! Po është lodhur, ama. Hallall e ka sonte torbën me tërshërë!

Përsëri e mori uria, po aty pranë s'kishte ujë. Zbriti nga arabaja dhe, si, kërceu hendekun, hyri në një arë me grurë. Këputi dy-tre kallinj dhe u mundua t'i shkërmoqte. Gruri ishte ende me qumësht.

– Do edhe ndonjë muaj që t'i bjerë lejleku, – tha me zë të lartë dhe futi në gojë thërrimet e buta e të shijshme. Iu morën mendtë nga era e mirë e lëngut. E arriti arabanë dhe, me një të kërcyer, hipi mbi të. Kali ecte me revan, me sytë gati të mbuluar nga takëmet. Malka nuk e nxiti. Ra në mendime, me kokën futur në gjoks dhe murmuriti:

– Si nuk mora me vete ndonjë kore bukë!

Kësaj radhe fjala «bukë» doli si një psherëtimë nga thellësitë e shpirtit dhe iu kujtua gjyshja, ndjesë pastë! Ajo i mblidhte thërrimet me majën e gishtit, një e nga një, si pula me sqep, i hidhte në gojën pa dhëmbë dhe i përtypte një copë herë të mirë, e kënaqur. Dhe ashtu, sybyllur, i thoshte të nipit:

– Ta nderosh bukën, o Malkë! Ta nderosh, o bir, edhe kur është e fortë, edhe kur nuk është e pjekur mirë, edhe kur është e mykur, se nderon veten dhe punën e dhimbshme. Kur gjen përdhe ndonjë copë bukë, mos e shkel, o bir i nënosë, po merre, puthe tri herë, mbështete në ballë me dashuri dhe vëre më ndonjë vend, ku nuk shkel këmbë njeriu, ose fute në xhep të setrës, se do të të duhet ndonjë ditë...

I zënë me kujtimet e fëmijërisë, Malka u përmend nga një zhurmë e mbytur. Vuri re se kishte mbërritur përpara debojës. Rruga ishte e zënë dhe kali qëndroi. Që nga Lëndina e Lotëve e gjer te deboja ishte një varg i gjatë me makina ushtarake, me topa të kalibrave të ndryshëm, me karroca. Shumë ushtarë kishin zbritur nga makinat dhe ishin grumbulluar buzë rrugës, këtej telave me gjemba. Të tjerë kishin rrethuar fushën e sportit dhe

brohorisnin në kupë të qiellit: «Lupi! «Lupi! «Lupi!». Luanin futboll. Nga fusha e tharë ishte ngritur një cipë pluhuri të verdhë dhe topi mezi dukej. Mbi këtëtë cipë ngrinej oshëtima e ushtarëve, që zgjatej në bregoret e Barçit si një bubullimë gazmore.

— Edhe kjo na duhej, — mendoj Malka i dëshpëruar. — Zoti e di kur mbaron kjo lojë dhe kur hapet rruga. Dhe dielli është më të perënduar.

Pa diellin. Duhej të kishte edhe nja tri orë ditë. Rrezet binin pjerrtazi dhe nga këmbët e ushtarëve që luanin, ngrihej gjithnjë pluhur i verdhë. Meqë s'dinte ç'të bënte, filloi të shikonte lojën pa qejf. Malka nuk e kuptonte përse ushtarët e oficerët qeshnin aq shumë. Lojtarët ishin nxehur dhe vraponin si të çmendur pas topit. Po ishte një top i çuditshëm. Nuk kërcente. I binin fort me majën e këpucëve, e ngrinin lart dhe, kur binte, ngelej në vend. Ishte vërtet një top i çuditshëm!

Malka ndjeu përsëri uri dhe i erdhi si të fikët. Atë çast, njëri nga lojtarët gjuajti fort. Topi kaloi bri shtyllës, mbi telat me gjemba dhe ra brenda në araba.

— Gooool! — gjëmoi deboja si nga një bubullimë e tmerrshme. Malka u përmend nga ky shpërthim gazmor dhe zgjati dorën nga topi që kishte rënë në arabanë e tij. Po ngriu në vend, sikur i ra pika.

— *Ma dai, dai presto, dai!*! — thërrisnin ushtarët, po ai as i dëgjonte dhe as e kuptonte gjuhën e huaj. Bebëzat e zmadhuara të syve të tij të errët kishin ngrirë përpara topit.

— Bukë!... Bukë! — belbëzoi ai si i çmendur dhe e mori topin në duar. S'ishte top. Ishte bukë korçe, e rrumbullakët, e mirë. E vërtiti nëpër duar si një gjë të shenjtë, ia fshiu pluhurin me pëllëmbë e me kujdes, siç mund të fshihet gjaku nga plaga e një fëmije dhe i mori erë me ëndje.

— Bukë! — murmuriti me ngashërim. — Bukë! — dhe një pikë lot i ra në koren e tharë trokë. Harroi se ku ishte. As nuk shihte, as nuk dëgjonte. E kishte përpirë

1) Jepe, jepe shpejt!

të tërin ajo bukë, që ushtarët e huaj e kishin përdorur si top. Dhe në ndërgjegjen e tij të turbulluar iu zgjuan kujtimet, gjyshja, ndjesë pastë, që i mblidhte thërrimet një e nga një, nëna, babai, xhaxhallarët, dajallarët, tezet, hallat, të tërë ata që kishin ikur nga kjo jetë me nderimin e madh për bukën.

– *Ma dai, mato!*¹⁾ – i thirri një lojtar, që doli këtej telave me gjemba dhe u turr drejt arabasë me zemërim. Iu kujtuan pesë fëmijët, që e prisnin si zogjtë, me sqepin hapur, kur ai kthehej në shtëpi me bukë nën sqetull.

– *Ma dai, maskalcone. Ke koza fai, mato!*²⁾ – i thirri ushtari me një këmbë në rrotën e arabasë dhe i zgjati duart për t'ia rrëmbyer. Po vështrimi i karrocierit ishte aq i egër, sa ushtari u zbraps menjëherë. Atëherë të gjithë të huajt panë se si u ngrit në këmbë majë arabasë një njeri i shkurtër, i heshtur e i zymtë, me nofullat të mbërthyer. E puthi bukën ky njeri tri herë dhe tri herë e vuri në ballë, në heshtje të plotë, sikur kryente ndonjë rit të shenjtë. Pastaj, pa u shpejtuar, zbriti nga arabaja dhe të huajt panë se si ai e vendosi bukën midis degëve të një akacieje të vogël dhe tha me zë të tmerrshëm një frazë të pakuptueshme për ta:

– Jeni njerëz pa shpirt e pa qëllim dhe luftën do ta humbni!

Hipi në araba krejtësisht i zbehtë dhe i heshtur. Me të dyja duart nduku aq fort frerin, sa kali u mbraps. E pa lojtarin që e mori bukën nga akacia dhe e hodhi në fushë, matanë telave me gjemba. Loja rifilloi midis brohoritjeve. Dëgjoi një ushtar me pupla në kaskë që pyeti oficerin e vet, i habitur:

– *Ma che e successo?*³⁾

Oficeri u përgjigj shkurt:

– *Un mato!*⁴⁾

1) Jepe, o i çmendur!

2) Jepe, o i poshtër! Ç'bën, hajvan!

3) Po ç'ka ngjarë?

4) Një i çmendur!

Malka nuk e kuptoi gjuhën e tyre. Ngriti kamxhikun dhe, për herë të parë, e fshiku kalin keq:

– Ec, Kiçooo! – i thirri. – Këta e humbën luftën!

Kali çau me të katra, duke bërë zigzage të rrezikshme përmes makinave ushtarake e topave të kalibrave të ndryshëm. Malka qëndronte në këmbë, me frerin në dorë dhe mbushte ajrin me fshikëllima kamxhiku.

«Drita» 24 gusht 1975

NË BEHAR KUR KORRET GRURI

Gjer aty nga ora tetë punova pa pushuar asnjë çast. E mbushja dorën plot se kisha vënë pallamar dhe kallinj-të binin me një fëshfërimë të lehtë e të shkurtër. Lejleku, i mprehur mirë, i priste kallinj-të sa çikte në ta.

Me lejlek e me pallamar korret mirë, mendova. Përfshiji kallinj-të me pallamar, hape krahun sa të mundësh dhe tërhiqe lejlekun fort, rrafsh me tokën. Me një të rënë, një dorake bën. Ja kështu!

Frynte juga dhe bënte vapë. Afshi i nxehtë dridhej. Cinxrat pëlcisnin. Porpollokët e majmë strukeshin nën duajt me gurë dhe mund t'i zije me dorë. Vetëm dallëndyshet turreshin herë-herë mbi bregun e lumit dhe çiknin me krah ujërat e fjetura e të kthjellëta. Qielli pa asnjë re, pa asnjë qenie të gjallë, i mbushur me zagu-shi, dukej si shkretëtirë e përvëlur.

Përtej lumit korre plaku Haxhi. Ishte një burrë i shkurtër, thatanik, flokëbardhë e mustaqezi. Edhe ai punonte pa pushuar, po s'kishte bërë as sa gjysma e asaj që kisha bërë unë, jo vetëm sepse korre me drapër, por edhe sepse ishte plak njeri.

«Megjithatë, ai është i gëzuar, — mendova. — Korr grurin e tij, ka shtëpinë e tij dhe është i lirë. Kurse unë... Unë punoj për të tjerët, për Elmaz aganë...»

Dhe m'u kujtua përsëri agai. Ku shkoi ai natën me aq axhele? Këtë pyetje e kisha bërë kushedi sa herë gjatë atyre orëve. Ku shkoi? Unë isha duke fjetur në grazhd kur ai shtyu derën dhe më zgjoi:

— Hydri! Më bëj gati pelën!

Brofa në këmbë dhe e pyeta nëpër gjumë:

— Ku do të vesh, Elmaz aga?

— Pelën, shpejt! — thirri.

— Mos është keq aneja? — pyeta.

Ane thërrisja të shoqen. Ajo ishte një grua grinda-vece, e shëmtuar dhe e verdhë, që kollitej vazhdimisht. Ballin e mbante gjithnjë të lidhur me shami të lagur dhe ankohej e lëngonte nga sëmundja.

Ai nuk më tregoi se ku do të vente. Shaloi pelën duke mbështetur këmbën në pëllëmbët e mia dhe, me të dalë në rrugë, e ngau me të katra, i përcjellë nga të lehurat e qenve dhe nga xixat që lëshonin potkonjtë nëpër strall.

Unë jam shumë i ndjeshëm. Pikëllohem nga fatkeqësitë dhe nga mjerimet e të tjerëve. Ndoshta pse jam jetim. Ndoshta pse më ka vrarë puna që të vogël e s'di ç'është gëzimi. Po këtë e ndrydh në vetvete dhe nuk ia shfaq askujt. Prandaj jam edhe i heshtur, flas pak dhe më pëlqen të rri i vetmuar. Dhe kur jam vetëm më sulmojnë lloj-lloj mendimesh, që më rraskapitin e më dërrmojnë tërë shpirtin se nuk u jap dot udhë.

Ku shkoi ai me aq axhele? Ku shkoi duke e ngarë pelën me kupë nën qiellin mbushur me yje? Me siguri aneja është sëmurë. Me siguri është duke vdekur, mendova.

Hodha setrën krahëve, i erdha rrotull shtëpisë dhe pastaj u ngjita lart, në odën ku flinin ata? Elmaz agai e kishte lënë derën hapur. Llamba, me fitil të ulur, lëshonte një dritë shumë të zbehtë. Aneja flinte, me kokën lidhur, si gjithnjë. Dëgjohej vetëm frymëmarria e saj e përzier me skërfitjen e mërzitshme të krimbave që bre-

nin trarët e vjetër. Zbrita shkallët që kërcisnin lehtë në këmbët e mia, u hodha jonxhë të thatë lopëve e buallin-cave dhe u shtriva mbi dyshekun tim si gur.

Kisha fjetur a s'kisha fjetur nja dy-tri orë, kur dëgjoja në oborr trokëllimën e potkonjve.

— Hydri! — thirri Elmaz agai kur unë isha në këmbë të dera. — Pelës hidhi batanijen dhe mos i jep të pijël — Mirë, aga...

— Nesër... Ç'nesër! Iku nata. Sot do të korrësh arën në breg të lumit! Ngrehu herët që të korrësh me vesë e të mos ronitet gruri.

— Po nisem që tashti.

— Mirë do të bësh. Nisu! — më tha me një frymë dhe ngjiti shkallët dy e nga dy.

Unë thirra pelën dhe ia shkova pëllëmbën vitheve. Dora m'u bë qull me djersë. Duke i hequr frerin nga goja, pashë si i kullonte shkumë e verdhë prej flegrave. Me shkumë i qenë mbuluar ijet dhe gjoksi.

— Bobo, moj arapke e mjerë, — thashë me keqardhje, — qënke bërë qull në djersë.

Pela shkrofëtiu dhe m'i hodhi cërkat e shkumës në fytyrë.

— Ku ke qenë kështu, moj e gjorë? E shkreta ti! Kushedi ç'rrugë ke bërë! Po ku ishte kështu, hë?

I hoqa shalën dhe i hodha batanijen mbi kurrizin që i digjte si furrë. Kafsha më fërkohej pas dorës. Unë e kuptova ç'kërkonte.

— E jo. Ujë nuk do të pish, se ftohesh e ngordh. Ja ku ke torbën me tërshërë! Ha!

Mora lejlekun, grijën e pallamarin; mora edhe sillën time të përditshme (bukë misri, qepë dhe një shishe me dhallë), ia hoqa torbën pelës dhe u nisa për tek ara në breg të lumit. Kur fillova të korrja, ishte ende natë dhe lejleku dukej nga rrezet e hënës si i lyer me ar. Bëja ç'bëja dhe përsërisja, duke e munduar veten kot:

«Ku shkoi ai me aq axhele?... Ku shkoi?...»

Plaku Haxhi e la punën, u ul buzë lumit në hijen e kumbullave të egra dhe filloi të hante mëngjesin. I lodhur më shumë nga vapa se nga puna, e lashë edhe unë, kapërceva mbi duajt me grurë dhe qëndrova përkundrejt plakut. Na ndante lumi që rridhte pa asnjë zhubër. Ishte një lumë i ngushtë, me ujë të ftohtë, që rridhte dimër e verë pa zhurmë. Isha qull në djersë, prandaj hodha setrën kraheve. Para se të nxirrja bukën nga torba, leva lejlekun me pakëz vaj dhe fillova ta mprihja me grijë. Plaku më vështronte me gojën plot, tundte kokën dhe largonte me pëllëmbë mizat e mërzitshme që pickonin shumë në atë zagushi.

— Vapë e madhel — i thashë.

— Më mirë ngrohtë se ftohtë, o Hydri! — tha plaku dhe, duke vënë buzën në gaz, shtoi: — Kur sëmuresh, nuk thua «jam ngrohur», thua «jam ftohur».

— Zotrote e fillove vonë korren sot, dajë Haxhi.

Plaku e përtypi mirë kafshatën e misrit dhe, si e kapërdui duke bërë qafën kosore, tha:

— Kisha mysafirë mbrëmë, o bir i daiut. Ju s'kishit?...
A, po. Harrova. Tek Elmazi nuk venë ata.

— Cilët? — e pyeta.

— Partizanët. Ç'djem që janë! Ikën herët, ndaj të gdhirë. I përcolla gjer te Dheri i Kuq, prandaj u vonova cazë.

— Po përse nuk vijnë tek Elmazi? — e pyeta, megjithëse unë e dija arsyen.

— Epo, punë e tyre, o xhan i daiut. Ku ta dish? Dyshojnë, se ai aga është vërtet, po është edepsëz!

Plaku fliste me dashuri për partizanët, sikur t'i kishte djemtë e vet, të mirë, trima e të mbarë. Elmaz aganë e shante dhe mirë bënte, kurse unë përsërisja me vete: «Ku shkoi ai me aq axhele?... Ku shkoi?...»

— Kështu punët, o Hydri! Ja, më shikon mua? Unë s'kam qarë ndonjëherë. Kurrë s'duhet qarë! Ç'nxjerr nga lotët e nga psherëtimat! Asgjë! Si thonë ata djemtë e Partisë? Ka ardhur koha për luftë se ndryshe na mori

lumi. Kaq e patëm! Të qërohen fashistët nga vatani, se na batërdisë! Djem trima, katërqind dërhem!

Unë i kisha takuar partizanët atë vit dy herë, në pyll, kur isha për dru. Shumica ishin djem të rinj, të dashur, të sjellshëm. Kishte edhe ndonjë plak të urtë e të mençur, si dajë Haxhiu. Më flisnin edhe ata për robërinë, për mjerimin e Shqipërisë, për gërmadhat e saj, për kufomat e saj, që fashistët i mbillinin gjithandej, në rrugët e qyteteve, nëpër burgjet, nëpër fshatrat, në tokë e në ujëra. Më flisnin për luftën dhe unë i dëgjoja gojëhapur. Dhe bëhesha gjithnjë e më i ndjeshëm, më i heshtur dhe më zemërak. Herën e parë i tregova si pa gjë të keq Elmaz agait. Ai mori zjarr menjëherë, si ajo dëllinja e thatë:

— Ku i takove? Në ç'vend i pe? Sa ishin? Ç'të thanë? A, na e sollën kokën edhe në këto anë! Të mallkuarit! Bëjnë luftë kalamajsh e rrjepacakësh! Për këtë luftë janë të zotët. Do të na djejin! Do të na përvëlojnë! Ku ishin? Sa ishin? Mos i dëgjo e mos i tako, se të lë pa bukë! Të shporri! Të lë top në vend me një plumb!

Herën e dytë s'i tregova. Po nuk e kuptoja zemërimin e tij të madh. Pyesja veten: «Përse xhindoset ky? Përse zemërohet? Ç'i kanë bërë partizanët këtij, që hidhet kaq përpjetë, sikur e ka lyer prapanicën me piper të kuq djegës? Asgjë s'i kanë bërë. Bile asnjë kafshatë bukë s'i kanë ngrënë në shtëpi. Përse të xhindoset? Përse të më shporrë? Përse të më lërë top në vend me një plumb?...»

Plaku Haxhi më fliste që përtej lumit:

— Njeriu duhet ta dojë vatanin më shumë se shpirtin e tij dhe duhet të jetë i fortë në këtë jetë. Kurse ti, ç'të të them, o bir? Ti vetëm durimin e ke më të fortë se guri. Po gjer ku e gjer kur ky durim? Ti, ti, o Hydri...

Plaku nuk e mbaroi fjalën se, në çast, të dy ngritëm kryet lart, drejt qiellit, nga vinte një uturimë shurdhuese. Një bombardues i madh e i rëndë porsa kishte dalë nga maja e malit dhe po lëshohej pakëz pjerrtazi mbi fshat. Papritur, si bubullimë a si rrufe në qiellin e larë e në tokën e përvëlur shkrepën shpërthime të fuqishme, flakë verbuese, tymra të bardha dhe batare mitralozi të rëndë...

... Pikërisht kështu u kishte ndodhur një vit e gjysmë më parë në Korçën e pushtuar nga ushtria greke. E mbaj mend mirë. Ishte 6 janari i vitit 1941, ditë e hënë. Bëhej Lufta Italo-Greke dhe fashistët italianë kishin marrë vrapin drejt perëndimit. Unë kisha vajtur në qytet me gjithë Elmaz aganë për të bërë harxhet e bajramit të vogël. Harxhet i blemë dhe po i ngarkoja në pelë, aty pranë xhamisë së Goxhamirahorit. Sahati i madh shënoi me tingull të çjerrë kambane orën një e gjysmë. Pikërisht në atë orë, kur ende s'ishte shuar tingulli i kambanës, jo një, si tashti, po pesë aeroplanë bombardues, të mëdhenj e të rëndë si ky, me shenjat e Liktorit në krahë, u shkarkuan pothuaj njëherësh mbi qytet. Jo mbi tërë qytetin, po vetëm në një lagje të tij, duke filluar nën Kodrën e Shën Thanasit e gjer në perëndim të kishës së Mitropolisë. Shpërthime të fuqishme e të njëpasnjëshme tronditën tokën. Gjithçka, ajri i ngrirë, muret, kalldrëmet, xhamat, pemët pa gjethë, gjithçka ushtoi me një zhurmë shurdhuese, shoqëruar nga krrakëritjet e mprehta të tufave të korbave. Buçitja që aq e madhe dhe e befasishme, sa njerëzit, me fytyra të prishura, që vraponin sa u hanin këmbët, në çastin e parë thërrisnin tërë ankth: «Tërmet! Tërmet!» Po, pakëz më vonë, kur panë barkun e zi të aeroplanëve, atë bark të zi që pillte copëra vdekjeje dhe i hidhte këlyshët binjakë dy e nga dy ku të mundte mbi lagjen e mjerë, e kuptuan që s'ishte tërmet, po një bombardim çnjerëzor. Dhe vetëm kur jehona e përbindëshave fashistë, monotone e gërryese, filloi të dëgjohej pak e më pak, gjersa u përpi nga qielli, njerëzit dolën nga të gjitha shtëpitë e qytetit, nga të gjitha dyqanet e kafenetë, nga të gjitha qoshet e strehët ku ishin fshehur, sikur mbinë nga dheu, mbushën rrugët dhe, duke vrapuar, shkuan të shihnin se ç'kishte ndodhur në atë lagjen fatkeqe të Mitropolisë.

Shkova edhe unë me Elmaz aganë.

O, po ç'të shihje?! Një katastrofë e vërtetë, mbuluar ende me tym, që binte erë barut dhe gjak të freskët. Një

varrezë e vërtetë, e stërmadhe, që nga Kodra e Shën Thanasit e gjer poshtë Mitropolisë, me shtëpi të rrafshuara apo gjysmëgërmadha, me rrugë të shkallmuara, të zëna nga dherat, nga gurët, tjegullat, trarët dhe nga orenditë shtëpiake. Dhe nën to, njerëz ende të gjallë, që lebetiteshin e kërkonin ndihmë. Dhe të tjerë që lebetiteshin të plagosur. Dhe të tjerë që kishin mbyllur sytë një herë e përgjithmonë atë ditë të ftohtë janari.

- Këtej! Këtej! Këtej!

- Ndihamoni, vëllezër! Të shpëtojme njerëzit!

- Më mbetën fëmijët të gjallë, nën gurët e trarët!

- Fashistët! Mizorët! Kriminelët! Përse i hodhën bombat këtu?

- Përse?... Përse?

Një mjerim i vërtetë, i mbështjellë me një dhembje të madhe! Lot të nxehtë, të papërmbajtshëm, lagnin mollëzat e faqeve mbuluar me pluhur të hidhur, si me helm!

Vinin të tjerë nga pazari, me vrap si të çmendur, kërkonin shtëpinë e vogël njëkatëshe e s'e gjenin. Kërkonin fëmijët, mëmën plakë, gruan dhe s'i gjenin! Kishin mbetur atje, nën gërmadhat!

Nxorën një fëmijë bërë copë e çikë. Unë e preka dhe u trondita aq shumë, sa fillova të qaja. Qaja në heshtje, aë! të mos më kuptonte. Elmas agai, me fytyrë të prishur dhe nuk pashë më gjë, se m'i mbuloi sytë perdjë e turbullt e lotëve. Vetëm pyesja veten: «Përse u bë ky bombardim këtu? Këtu s'ka as depo armësh, as kazerma ushtarësh. Këtu është një laqie e varfër, me njerëz të mirë, shumica zanatcinj, këpucarë, rrobaqepës, furrtarë, teneaëxhinj, sheqertë. Përse u bë ky bombardim këtu. Këtu pranë është lumi i vogël aë shteron fare gjatë verës. Këtu pranë është një urë prej dërrase. Urën donin të bombardonin? Përse u bë ky bombardim këtu? Kazermat janë matanë varrezave të myslimanëve, nga rruga e Drenovës. Ka kazerma edhe nga deboja, nga fusha e aeroportëve, pranë varrezave të francezëve. Atje ka ushtarë grekë, ka bateri topash, ka depo armësh, ka materiale dhe ushqime për ushtrinë. Po andej s'u hodhë asnjë bombë

e vetme. As edhe një! Përse u bë ky bombardim këtu? Përse? Përse? Përse? Përse?...»

Pyesja veten pa arritur të kuptoja gjë dhe dëgjoja bisedat e shkëputura tërë ankth e urrejtje të qytetarëve:

– Ka shumë të vrarë!... Ka shumë të vrarë!...

– Dyzet e ca shtëpi janë rrënuar krejt!

«Sa ka fshati ynë, – mendova. – Dyzet e dy shtëpi ka fshati ynë.» Dhe, duke i përfytyruar si gërmadha, m'u ngjeth mishtë. Me sa mundim, me sa vuajtje e me sa borxhe janë ngritur ato shtëpi prej guri e plithari. Me sa halle, brez pas brezi! M'u ngjeth mishtë, edhe pse unë s'kisha shtëpi e flija në grazhd, mbi dyshekun e fortë si gur.

– Ka shumë të vrarë! Gjashtëdhjetë u gjetën gjer tash-til! Ka edhe të tjerë! Ka edhe më shumë të plagosur. Një familje ka marrë fund e tëra. Ca fëmijë mbetën jetimë për tërë jetën!

«Jetimë», – belbëzova dhe fshiva sytë me grusht.

– Hajde! Ndihamoni, shokë! Merrini këta fëmijë nëpër shtëpitë tuaja!

– Xha Miti, do të vish tek unë, familjarisht!

– Nuk do të lëmë asnjeri përjashta! Hidhërimin do ta ndajmë së bashku, siç kanë bërë gjyshërit e stërgjyshërit!

– Hajdeni me mua! Hajdeni me mua!

– U bë ç'u bë tashti! Po do të vijë edhe dita jone. Do të hakmerremi për të gjitha mizoritë, barbarizmat dhe padrejtësitë!

– Do të hakmerremi!

– Do të hakmerremi, shokë!

Një burrë me kasketë, me vurrata të zeza në fytyrë, mori hopa dy fëmijë jetimë dhe i shtrëngoi në gji:

– Ju ka xhaxhai ju, ju ka xhaxhai! Hajdeni të shkojmë e të luani me fëmijët e mi!

Unë pashë jetimët që iu qepën pas qafe, m'u drodh zemra dhe fshiva sytë me grusht për të dytën herë.

– Ç'ke? – më pyeti Elmaz agai duke më parë me habi.

– Gjynahl – belbëzova.

– Epo, luftë është, – tha ai me zë të qetë, sikur të mos kishte ndodhur asgjë. – Dasmë pa mish s'ka!

– Po përse u bë ky bombardim këtu?... Përse?

– Atë e dinë ata, italianët, miqtë tanë. Se miq e shpëtimtarë i kemi. Kur të vijnë përsëri, do t'i ndërtojnë më të bukura, me hekur e çimento...

– Po njerëzit e pafajshëm që u vranë?! – u shkreha me zemërim e me lot faqeve.

– Hajt! Se s'merr vesh nga këto punë ti! Je i vogël akoma. Dhe mos më dërdëllis shumë! S'thua shyqyr që shpëtuam vetë?! Tërhiqe pelën dhe kujdes hejbet, se kemi harxhet e bajramit atje!

* * *

...Të gjitha këto m'u kujtuan kur aeroplani, nga barku i tij i sterrosur, hodhi dy e nga dy mbi fshat e mbi arat me grurë ata binjakët e vdekjes. I thirra plakut Haxhi vetëtimthi:

– Po bombardojnë si Korçën në janarin e dyzetënjtëshit! Po përse ky bombardim? Sa të poshtër që qenkan!

Plaku u ngrit në këmbë si ndonjë i ri dhe, si bëri dy hapa, doli nga hi ja e kumbullave të egra dhe hyri në arën me grurë. Në një rën dorë shtrëngonte bukën e misrit, në tjetrën takijen, që të mos i binte nga koka, të cilën e mbante lart, duke vështruar bombarduesin e rëndë.

– Ah! – ia bëri. – Si nuk e kam maliherin me vetel Ah, o breshkaxhinj të fëlliqur! Nuk jua mban të luftoni si burrat në tokë. dhe po na hidhni glasa nga qielli!

– Pse, dajë Haxhi! E ha maliheri aeroplanin? – e pyeta.

– Oj, të ngrënë që i bën! Oj, të ngrënë, sidomos këtë që fluturon kaq ulët! Bëri edhe dy hapa përpara, me këmbë të ngjeshura në kallingjtë e korrur dhe me vështrim nga fshati, ku dukeshin shtëllungat e bardha të shpërthimeve. – E shikon ç'bëhet, o Hydri? Populli ynë është jetim, si ti. Po kush do t'i mbrojë jetimët, po s'rrembyen

vetë armët?! – dhe i shau përsëri fashistët me atë gjuhën e tij prej devollu. – Mender, pordhët e gomarit mund të ndyjnë ajrin një çikë, po s'trembin njeri, o breshkaxhinj faqezinj! – Unë hipa mbi bregun e lumit për të parë më mirë. Aeroplani vinte rrotull mbi fshat dhe hidhte rrallë nga dy bomba, që binin mbi kulmet e shtëpive, mbi plevicat dhe mbi oborret. – Ç'po i punojnë fshatit! – tha plaku me zemërim, duke përplasur këmbën mbi duajt me grurë të porsakorrur. – E dallon? U bë rrafsh shtëpia e të ziut Hajrulla!

– Edhe e Halitit! – thashë unë me dhembje, se djalin e tij të vogël e kisha shok fëmijërie.

Bombarduesi u ul edhe më shumë, gati sa çikte me rrotat majat e plepave.

– U hodh në erë shtëpia e të ziut Hajredin! Ka një karvan me fëmijë derëziu! Shiko! Shiko ç'bëhet dhe mos e harro! E sheh si të lëron i huaji? – Plaku e ngriti zërin. – Po i vjen radha kasolles sime! Eh! Ç'kam validenë atje! Do të ma vrasin, të mjerën!

U bë edhe një shpërthim tjetër dhe plasi tymi.

– E pati edhe shtëpia e agait tim! – thashë unë pa ndier asnjë keqardhje.

– Jol – thirri plaku duke tundur dorën, ku shtrëngonte copën e verdhë të bukës. – S'ra mbi shtëpinë e tij. E ruajnë melajqetë aganë.

– Po, ai zjarr ç'është? – e pyeta.

– Po digjet mullari me bar i Elmazit dhe jo shtëpia.

Unë pushë me vërejtje. Plaku kishte sy të fortë. Vërtet po digjej mullari me bar, buzë gardhit të kopshtit.

Që nga brigjet e lumit ku ishim ne, bombat, që dilnin nga ai bark i zi i kurvës metalike, dukeshin të vogla fare, si miza. Mirëpo ato miza ishin aq të fuqishme, sa po rrafshonin shtëpi e katandi.

– Ai na e solli këtë pusht këtu, ail – thirri plaku duke drejtuar nga fshati grushtin ku shtrëngonte bukën e misrit. -- Ai! S'ka tjetër, veç atij! Ua ka dhënë një për një shtëpitë ku ishin mbrëmë partizanët, të Hajrullahut, të Halitit, të Hajredinit dhe timen. Ai, tradhtari! Spiuni! I pangopuril Zuzari!...

Plaku Haxhi nuk foli më, se atë çast aeroplani bëri nga ne, drejt fushës, duke qëlluar me mitraloz bujqit nëpër ara dhe duke hedhur herë pas here ca bomba të vogla që nuk dukeshin në qiell kur dilnin nga barku, po që lëshonin flakë me të cikur në tokë. Një bombë e tillë i dha zjarr grurit në arën e plakut Haxhi. Kashta, e tharë nga dielli përvëlues, mori flakë menjëherë, duke kërcitur si dëllinjë. Plaku zgurdulloi sytë, u drodh nga zemërimi i madh dhe bëri vetëm katër hapa, duke iu ngatërruar këmbët nëpër duaj. Në hapin e pestë e pa shë si hapi krahët, bëri dy rrotullime rreth vetes, si njeri që i merren mendtë dhe është gati t'i bjerë të fikët. Meqë s'kishte ku të mbahej, nxori një klithmë mallkimi dhe ra mbi kallinjte, ndërsa përreth tij plumbat skërmitnin e shqyenin tokën e tharë dhe grurin nga kallinjte.

– Dajë Haxhi! – thirra i tronditur, duke më shkuar mendja për keq.

Ai nuk u ngrit më dhe unë vrapova drejt tij me zemër të ngrirë. Kisha frikë se mos pëрпиhej nga flakët. Kapërceva lumin me lehtësi, se uji më arrinte gjer te gjunjët. Po, me të dalë në bregun matanë, aeroplani hodhi, me sa duket, bombën e fundit dhe vazhdoi rrugën nga kishte ardhur, duke lënë prapa gërmadha, gurë, presje e qerpiçë bërë lëmsh, zjarre, mjerim dhe vdekje! Po edhe një gjë të madhe: urretjen! E ndjeva si më vlonte ajo në shpirtin tim të butë e shumë të ndjeshëm. E ndjeva për herë të parë, të fortë, të rreptë, përvëluese, si ato flakët që kishin mbuluar fshatin dhe arën me grurë.

Nuk arrita dot menjëherë te plaku i mirë Haxhi. Bomba e fundit që lëshoi aeroplani, m'u duk sikur më kishte marrë në shenjë dhe po më binte mbi krye. Vetëtimthi, matanë bregut, u shtriva përtokë dhe ngjesha fytyrën në një demet. Gruri mbante erë të mirë. Një porpollok, që ishte strukur aty për t'i shpëtuar vapës, fluturoi i trembur, duke nxjerrë klithmë e duke rrahur fort krahët e shkurtër ngjyrë kafe të çelët, si ngjyra e grurit. Bomba shpërtheu me një buçimë të tillë, sa m'u duk sikur më plasën timpanët e veshëve. Ndjeva të më binin mbi trup si shi e si breshër copat e skërmitura të plisave të thatë

trokë dhe kokrrat e pjekura të grurit. Pastaj u ngrita qull në djersë dhe vrapova pa ditur se ku shkelja. E gjeta plakun Haxhi midis kallinjve të thërrmuar. Në dorë shtrëngonte ende bukën e misrit. Në mjekrën e vogël e të parruar dhe anës buzëve i qenë pleksur, së bashku me grimcat e tokës, me kallëzat, me bykun, me kokrrat e grurit dhe thërrimet e bukës së misrit, edhe sumbulla të ndritshme gjaku të kulluar, shumë të kulluar, si qelibar dhe të ngrohtë valë. Ishin bërë njësh toka, bereqeti, bujku dhe gjaku i tij, jeta e tij.

— Dajë Haxhi! Dajë Haxhi! Ngrehu, dajë Haxhi! Aeroplani e theu qafën! Përmendu, dajë Haxhi!

Më digjnin sytë nga tymi e flaka që po afroheshin, a mbase nga lotët. Ai nuk u përmend. Atëherë e ngrita në krahët e mi. Në vendin ku kishte rënë, toka, me buzët e saj të shkrumbuara e tërë plasa, kishte thithur si e etur gjakun e tij. M'u duk i lehtë pendë plaku i dashur. Kishte harxhuar pothuaj tërë gjakun që mban trupi. Flaka na arriti dhe ndjeva si më përcëlloi faqet me push të lehtë, se ende nuk u kisha hequr brisk. E shpura më tej dhe e ula aty, te bregu i lumit, nën hijen e kumbullave të egra, ku pak më parë çlodhej duke ngrënë atë copë bukë që nuk e lëshonte nga grushti. Aty, si ia laga ballin e qafën me ujin e lumit, rënkoj një herë dhe u përmend. Më vështroi me ata sytë e tij të fortë, si të shqiponjës, mori frymë thellë, u mundua të buzëqeshte. Unë u gëzova si fëmijë dhe e putha në faqe, duke e qullur me lot të kripur e të vakët. Një kokërr gruri e përgjakur më mbeti ndër dhëmbë dhe unë e përtypa.

— A, jo kështu! Jo kështu, o bir! — më tha me vështirësi, duke më vështuar në bebëzën e syrit. — Njeriu duhet të jetë i fortë në këtë jetë. Nga lotët s'nxjerr asgjë... Populli është jetim, si ti! Po kush do t'i mbrojë jetimët, po s'rrëmbyen vetë armët?!... Dëgjo dajën ti. Përpara vatanit mos vër asgjë! S'ka si ky dhé, që e kemi ushqyer me djersë e me gjak! S'ka! S'gjen dot të dytë, kudo që të vesh, në tërë botën!... Dëgjo dajkon ti. Lidhu me Partinë dhe me ata djemtë e malit!... Unë s'jam pajtuar kurrë me këtë jetë dhe nuk i jam nënshtruar kurrë!... Kam

qenë si furtunë!... Edhe asaj nuk i jam nënshtruar kurrë... asaj viranes... vdekjes!... Po kësaj radhe më gjeti keq... shumë keq!... Të çarmatosur!... Të çarmatosur, o Hydri, o bir!... – Heshti pak, fryu kraharorin, po nuk ngopej dot me frymë. Ajri i shfrynte si gjyryk, diku lart, në brinjën e majtë, ku, me sa dukej, do të kishte plagën më të rëndë. – Kaq e pata unë, o bir! – vazhdoi të fliste më me vësh-tirësi, duke më lënë amanetet e fundit. – Në hatullat e kasolles, andej nga lind dielli, ... kam fshehur... maliherin... me gjithë gjerdanin... plot me fshikë... Qëllon mirë, i uruari!.. Merre ti... dhe mos u lër kusur fashistëve... aeroplanëve... tradhtarëve! U mbush për të fundit herë me frymë. – Dhe tashti më ndihmo, o bir!... Ma ngri pak kokën... të shoh fshatin! – Unë e ngrita me shumë kujdes. Ai vështroi një copë herë të mirë malin e lartë, fshatin në rrëzë të tij mbuluar nga retë e bardha të pluhurit e të_tymit dhe grurin e tij që po shkrunbohej.

– Jo mirë! – pëshpëriti. Më vështroi për të fundit herë gjatë-gjatë. Më tha: – Mos e harro këtë!... O bir!
Dhe mbaroi në duart e mia...

U ngrita me një dhembje dhe me një urrejtje të madhe në shpirt, po mendjen nuk e humba. Veshët ende më shungullonin nga shpërthimet shurdhuese. Afshin e flakëve që ishin afruar te bregu i lumit, nuk e ndieja më. Ato flakë, aty do të mbaronin, te bregu. S'kishin ku të venin më! Do të përpiqeshin për herë të fundit, do të fërgëllonin, dhe gjuhët e tyre të kuqe do të binin në ujërat e kthjellëta, do të qulleshin, do të ofshanin dhe do të shuheshin. Dhe vitin tjetër, a mbase disa vjetësh, kur të mos kishte më të huaj në vendin tonë, tek ajo tokë e djegur dhe e zezë, tek ajo arë e ujitur me gjak do të rritej përsëri gruri, i shëndetshëm, më i bollshëm, dhe porpollokët krahartë do të gjenin aty një strehëz të sigurt për të kaluar vapën e beharit...

I hodha dajë Haxhiut përsipër fytyrës setrën time prej shajaku. Vura në sup lejlekun dhe torbën e varfër me vështrimin andej nga fluturoi aeroplani. Pallamarin e ngjeshja në gishta. E pashë edhe një herë bombarduesin dhe m'u kujtuan fjalët e plakut Haxhi, kur e pyeta

nëse e hante maliheri aeroplanin. «Oj të ngrënë që i bën! Oj të ngrënë!...» Përbindëshi, që më kishte trembur aq shumë dy herë ato vite, m'u duk çuditërisht i vogël, tamam si një pikë e zezë në një letër të kaltër. Një pikë e zezë që përpiqej të përdhoste qiellin tonë të pafund. Një pikë e zezë pa asnjë kuptim dhe pa asnjë vlerë. Andej drejtova instinktivisht dorën, kërcënueshëm. Dora e veshur me pallamar nuk dukej si dorë. Në atë zagushi përvëluese, në atë qiell të tymosur, ajo m'u duk si një gjë krejt tjetër. Më shëmbëlleu si një topuz me maja të lëmuara e të mprehta...

* * *

Kur arrita në fshat, pluhurin dhe tymin e zjarreve e të barutit i kishin përpirë majat e maleve dhe qielli. Korbat, duke çarë ajrin e përzhitur me krahët e tyre të zinj, uleshin në lisat e përcëlluar rreth shtëpive të rrënuara dhe krrakëllinin me tërbim. Në tërë fshatin endej si një pëlhurë e zezë lebetitja e heshtur, që herë-herë ngrihej si kujë e vajtim dhe herë-herë si mallkim e hakmarrje. Dhe midis tyre ndjeva të ecte me vrull e hap të rëndë, siç ecja edhe vetë, nëpër rrugët e shtrembëra nëpër kalldrëm et e lëpira, qosheve e portave të hapura kat e kat, atë që quhet urrejtje, urrejtjen shekullore të popullit të vuajtur, kundër atyre që mbillnin, jo vetëm në anët tona, po në gjithë botën, shkatërrim e vdekje.

Me këtë ndjenjë urrejtjeje, hyra në derën e madhe e të hapur dhe në oborrin e gjerë ndesha ballë për ballë me atë, Elmazin, aganë tim zemërgjerë, që më kishte mbajtur shtatë vjet me bukë e dhallë e strehë, që kurrë isha dhjetëvjeç fëmijë jetim.

— Hë, Hydri, ç'kemi nga fusha? Ç'që ai zjarr andej? Mos pësoi gjë ara ime? — më pyeti me ankth të shtrirë, i çelur në fytyrë, disi i gëzuar.

— Jo, — i thashë, — u dogj gruri i plakut Haxhi...

— Shyqyr zotit, që paskemi shpëtuar! — tha me vështrimin nga qielli, që ishte ende bojë hiri dhe i veshur me

tym e pluhur. – Hël A të shkoi puna mbarë? – më pyeti aty për aty po me atë ankth, më i çelur në fytyrë.

– Ç'ka! Do ta kisha korrur gjithë arën, po të mos ndodhte mynxyra, – thashë i mërzhitur dhe i vrenjtur.

Ai, papritur, lehu tamam si një qen i tërbuar, që këputet nga zinxhirët:

– Çfarë mynxyre! Çfarë mynxyre! E ç'ndodhi, në fund të fundit?! Ç'u bë?! Kiameti s'u bë. Ja, edhe ne e pësuan! Na u dogj mullari me bar. Po, punë e madhe fort! Behar është, s'është dimër. Toka është e begatshme. Do të na japë edhe bereqet, edhe bar. Mynxyrë, thotë. Çfarë mynxyre? Ku është mynxyra jote këtu?!

Unë gati bërtita:

– Po njerëzit, kush do të na i japë?! U vranë njerëzit, aga! U vra e vdiq në duart e mia dajë Haxhiu! Ti nuk e di, po frymën e fundit e dha në prehrin tim, në pëllëmbët e mia, që i mbanin kokën! Kush do të na i japë njerëzit?!

Ai m'u afrua e më pa me vërejtje një copë herë të mirë. Kushedi si iu duka! Kushedi se si isha bërë në fytyrë!

– Je trembur, o qyqar! Je trembur! Të ka ikur fytyra fare! – qeshi si me zor.

– Jo! Nuk jam trembur! Nuk jam trembur hiç fare! – bërtita.

Më mori me të mirë, më hodhi dorën në qafën e djersirë, ku më rrihte fort një damar dhe më foli me zë të butë. Më tha pak a shumë po ato gjëra që më dërdëlliti në bombardimin e qytetit të Korçës. Po atëherë më foli rreptë, më qortoi, më shau, më talli. Atëherë e kishte të shkruar në ballë kënaqësinë që ndiente për krimet e atij gjashtë janari të vitit 1941. Kurse kësaj radhe sikur u mallëngjye. Po ato gjëra më tha, po m'i tha me keqardhje, bile edhe me mbytkë në fyt.

– I ziu Haxhi! Ishte burrë i heshtur, punëtor dhe i ndershëm. Si, more, na la ai plak aq i mirë? Janë bërë ca dëme, janë bërë! Po përse na ka bërë perëndia me dy duar? Që të ndihmojmë njëri-tjetrin.

Më shtiu gishtat e butë nëpër flokët e qullur nga djer-
sa dhe më tha, gati me ngashërim:

—Epo, luftë është, o bir!

Për herë të parë më quajti «bir». E kisha dëgjuar këtë fjalë nga shumë bashkëfshatarë, sidomos nga burrat, gratë e pleqtë. Të gjithë ata më quanin «bir». Kurse plakot kockëdala e të dhimbsura më thërrisnin e më përkëdhel-
nin me fjalën «birkë i hallos», «birkë i tezes», megjithëse nuk i kisha as halla, as teze dhe as farefis. Po mua më vinte mirë kur më përkëdhelnin me atë fjalë të mirë «bir». Edhe ai ma tha më në fund atë fjalë. Ma tha për herë të parë pas shtatë vjetësh. Kurrë nuk e kisha dëgjuar nga goja e tij atë fjalë aq të ëmbël dhe që ka aq shumë nevojë të dëgjojë veçanërisht fëmija pa nënë e pa baba siç isha unë. Gjatë shtatë vjetëve nga goja e tij kishin dalë vetëm porosi, urdhra, sharje, mallkime dhe fjalë të ndyra «derr, sojsëz, gomar, hajvan, qen,...» Dhe pa papritur fjala e ëmbël «bir». Më bëri përshtypje të madhe, shumë më të madhe sesa të dy bombardimet së bashku.

Ngrita kokën për t'ia parë fytyrën e për t'u bindur në e kishte thënë atë fjalë me gjithë shpirt, po nuk dallova gjë, se në atë çast ai qe mbuluar nga tymi i duhanit që e pinte me llulë.

— Luftë është, o bir! Dasmë pa mish s'ka! Sa për ato kasollet që u rrënuan, do t'i ndërtojnë ata, me hekur e çimento, të forta të mira e të bukura. Po, sa të mbarojë kjo luftë e mallkuar! Për njerëzit bëhesh merak ti? Epo, na kanë lajmëruar, o bir, që të rrimë urtë. Na kanë urdhëruar kaq herë që të mos shkelë këmbë partizani në fshatin tonë. Ndryshe, na kanë thënë, do të na bëjnë pluhur, siç po na bëjnë. Kush u tha partizanëve të vinin? S'i ftoi njeri. Po ata erdhën mbrëmë dhe na e lanë doçin te pragu i shtëpisë. Na lanë doçin dhe krisën e ikën që pa gdhirë. Kush ka faj për këtë. Vetë i kanë fajet, ata që erdhën dhe ata që i pritën. Po Italia është e mençme, e mori vesh dhe që me sabah na i dërgoi llokumet. Dhe mirë na e bëri. Të vënë mend, gjeçin belanë! Përse t'i qasin në shtëpi? Qafën thefshin,

të mallkuarit, pa din e pa iman! S'e hamë dot ne me lta-
linë. Është fuqi e madhe. Na bën zap me pështymë!

Atij iu tha pështyma, qeshi dhe shkundi hirin e çibukut.
— Tashti, oburra, ta shuajmë atë çikë zjarr që ka mbe-
tur nga mullari, se, helbete, vjen nata, fryn ndonjë erë e
na përvëlton shtëpinë! Ta shuajmë dhe pastaj shko e shtri-
hu se je trembur e të ka ikur shpirti fare. Po dhe të drejtë
ke, o Hydri. S'i thonë shaka të të vdesë njeriu në duar.

Unë nuk fola më as edhe një fjalë. Ai dërdëlliste
vazhdimisht, edhe kur e shuam krejt zjarrin me kova uji.
Isha bërë shurdh e memec nga zemërimi dhe nga urrej-
tja. Nuk hëngra as darkë. Kisha harruar çdo gjë për të
cilën ka nevojë njeriu.

U hodha jonxhë të thatë lopëve e buallicave, i mola,
i vura torbën me elb pelës dhe u shtriva në dyshekun tim
të fortë gur. Atëherë, i lodhur e i dërrmuar, pyeta veten:
«Kush na e bëri këtë hata?»

Një dritë, si shkrepimë, më feksi brenda syve, brenda
ballit të rënduar. Pyeta veten përsëri, duke e përfytyruar
të gjallë Elmaz aganë mbi pelën që gulçonte nga vrapimi,
mbuluar në shkumë djerse dhe që shkërmoqte gurët me
potkonj.

Ku kishte vajtur natën e shkuar me aq axhele?!

Duke sjellë nëpër mend ngjarjet e ditës, dajë Ha-
xhiun, që nuk arriti të m'i thoshte gjërat shkoqur gjer
në fund e duke i bashkuar të gjitha në një të vetme, më
shkrepri përsëri ajo dritë brenda vetes. Atëherë thashë me zë:

— Ai!

Me këtë mendim në kokë u ngjita në lagjen e si-
përme të fshatit për të parë ç'kishte ndodhur, për t'u
ardhur në ndihmë të mjeruarve dhe për të shpënë në
vend amanetin e plakut Haxhi!

Mua më pëlqente nata, heshtja, vetmia, se vetëm atë-
herë kisha mundësi të këmbeja mendime me vetveten, të
arsyetoja për gjithë ato që ndodhnin e që shihja gjatë di-

tës. Tërë kohën tjetër isha i zënë me punë të rëndë, me kafshët, me arat, me barin, me drutë, me tokat e tij e të anesë, me plehun.

Dola nëpër rrugët e zhurmshme, të ndriçuara nga hëna dhe nga vitë. Nuk bënte vapë, po zagushia nuk ishte zhdukur. Dëgjioja ende vajtime e britma të rralla dhe, midis tyre, më dukej sikur dalloja zërin e nrohtë të daië Haxhiut: «Këtë mos e harro! Këtë mos e harro kurrë! Mos e harro!»

Fshati rrëzë malit viaan, i zhveshur nga pjesa jugore dhe i shndritshëm orei hënës, sikur ishte në lëvizje, merre frymë, nuk u nënshtrohej kthetrave të natës. Ishte e para natë që s'e araste ajumin: lëviznin njerëzit, qerret, kafshët, sharroheshin dërrasat, mbërtheheshin qivuret, përqaqiteshin viktimat për varrim. Ishin lënë mënjanë, meritë e vjetra, grindjet e voala për një gardh, për një vijë uji a për një fjalë të pamenduar, thënë në inat e sipër. Fatkeqësia e napolitur çnjerëzore, fyeria e rëndë mizore që u ishte hedhur nga i huaji si një pështymë në fytyrë, dhembia e madhe për të dashurit e të afërmit që gjetën vdekjen nga bombat në një ditë behari kur korret aruri, e kishin bërë fshatin e shpërndarë rrëzës së malit, si një grusht të vetëm, të rëndë, të pathyeshëm, aati për t'u vërsulur mbi çakenitë këmishëzini e arabitaarë.

Në natën e nrohtë, të ndriçuar nga yjet, e nga hëna, nga kandilat e nga bishtukët e pishave, pashë hallë Dilen që kishte mbledhur karvanin e fëmijëve në aoshen e shtëpisë së rrënuar. Fëmijët flinin nërtokë, zbuluar, dhe kushedi ç'ëndrra shihnin! Ajo, devollite e shkathtë dhe e fortë, më doli përnara me duart në ije, më njohu e më tha me gojë në plot dhembie:

— Ma vranë të ziun Hairedin! M'i lanë fëmijët pa baba! Po do t'i rrit, o Hydri, do t'i rrit e do t'i dërgoi partizanë. Në nga një do t'i rrit dhe do t'i nis të gjithë maleve, që të marrin hak për babanë e tyre Hairedinin, nër të ziun Myrto, nër këtë të zezën Hatixhe, që ia preu bomba të dyja këmbët!

Drejtoi kokën e vogël nga flinin fëmijët dhe atëherë pashë, më krahu të tyre, hallë Hatixhenë, atë plakën ho-

katere të lagjes së sipërme që na bënte gjithnjë të qeshnim me shakatë e saj. Ishte shkurtuar, dukej gjysmë njeriu ashtu, pa këmbë, lidhur e shtrënguar me copa çarçafi. Më sëmboi zemra kur e pashë. Po hallë Hatixheja vuri gishtin mbi buzët e na tha:

– Mos flisni me zë të lartë, se na zgjoni fëmijët! – Pastaj shtoi me shaka: – Do të më dojë më shumë im shoq kështu, pa këmbë. Do t'i dukem e vogël, si një çupërlinë! Apo jo, o Hydri? – Më bëri me shenjë që t'i veja pranë. E putha në flokët e thinjur. Ajo më vuri buzët e përthara në ballë, më vështroi drejt në sy për një kohë të gjatë dhe, duke bërë çmos që të mos e zinte ngërçi nga dhembja, më pëshpëriti: – Po ti, o jetimkë i hallos, përse je bërë kështu, si limua? Të kam ushqyer me sisën time, kur jot ëmë, Ferdaneja, vdiq sa të lindi. Ndjesë pastë! Eh, ç'nënë kishe ti! Trime, devollite si ajo! Po jeta është jetë, o birkë e hallos! Të gjitha i ka, gëzime e hidhërime bashkë. Je lodhur, je mërziur, dridhesh nga dhembja e nga inati. Po hiç mos e humb toruan! Merr kosoren e dil malit!

Unë u preka shumë. E si të mos prekesha nga ato fjalë që tha për nënën, të cilën nuk e kisha parë, për qumështin që kisha pirë nga gjiri i hallës, për porositë që më dha?!

– Do të marr maliherin, – i thashë i prekur, sa mend qava, – dhe do të bëj si më thua ti.

– T'u bëftë halloja ty, o bir! Trimi i hallos! – Dhe për herë të parë e pashë që u ligështua dhe ashtu, në ligështim e sipër, pëshpëriti e përmbajtur, që të mos vinte kujën: – Boll pamë jetimë! Të mos na shohin më sytë jetimë! Bjeru qafirëve, vraji ku t'i qjesh, në tokë, në qiell, në lumë! Vraji, o bir, që të mbrosh të gjallët, po edhe të vdekurit. Të mbrosh të zezën Ferdane, hallon sakate Hatixhe, këta fëmijë, dhe fshatin, dhe veten, dhe tërë vatanin!

Erdhi një qerre rrotat e së cilës gërvinin me një zhurmë çjerrëse.

– Fëmijët! – tha ai që drejtonte qerren duke mbajtur në dorë hostenin e gjatë.

Ishte xha Myrtoja, më trupmadhi dhe më i heshturi i fshatit. Vetëm me darë mund t'ia nxirrje fjalët. Po atë natë ishte bërë llafazan.

— Do të vini tek unë, të gjithë. Behar është. Mund të flerë njeriu edhe përjashta. Po robëria qenka thikë në zemër! Hydri, ti je? Oburra!

Unë mora hopa dy fëmijë dhe i shpura te qerrja, ashtu të përgjumur. Në qerre ishin edhe dy familje të tjera. Njoha vetëm gruan e plakut Haxhi. Të tjerët ishin fëmijë, ca zgjuar, ca në gjumë.

— E ngritëm të ziun tim shoq, — tha plaka e dajë Haxhiut, duke fshirë sytë me kindin e shamisë së zezë që mbante në kokë. — E ormisëm atje, te shtëpia e Myrtos. Po ti, o bir, si je?

— Mirë, teze.

— Të la ndonjë amanet i ndjeri?

— Më la.

Rrëmbeva edhe dy fëmijë të tjerë, më të mëdhenjtë dhe i shpura në qerre. Ata u zgjuan dhe filluan të pyesnin:

— Ku do të vemi? Po babai?

— Vjen edhe babai, — u thashë.

Më në fund ngrita hallë Hatixhenë. E mora në krahë me shumë kujdes, që të mos i lëndoja plagët. Gjithë pjesa e poshtme e dollomasë së zezë iu varr krejt bosh, si një leckë e nderë në tel.

— E sheh sa mirë? E sheh sa e lehtë që jam? Kur të dalë im shoq nga burqu, do të habitet. Ku ta gjeië burri një grua kaq të lehtë! — bëri shaka ajo, duke shrënuar me buzë një shtëllungë flokësh të thiniur, që i kishin dalë nga shamia. Mua m'u duk sikur hallë Hatixheja i kishte kapur vetë ata flokë, për të mos shpërthyer në dënosa e liqjërime.

— Jo! — kundërshtoi hallë Dilja, kur i thashë që të hipte në aerre. — Nuk mund ta lë vetëm Hajredinin. Xhe-nazeja s'lihet vetëm.

— Shko ti! — iu luta. — Rri unë me të.

— Jo! — nguli këmbë ajo.

— Ç'të keqe ka këtu? — e pyeta.

– Ka! – m'u përgjigj prerë dhe e vendosur.

– Mirë, – ndërhyri xha Myrtoja dhe u doli qeve përpara me hosten. – Vij e ju marr, sa t'i shpie fëmijët.

Po atë çast erdhi një qerre tjetër, rrotat e së cilës gërrvinin më shumë se e para.

– Kiliviu! Kiliviu! Kiliviu! – dëgjohej në tërë fshatin kjo gërvishtje monotone. Dhe ishte e hidhur, tamam si një gërvishtje plagësh.

Si u rregulluan të gjithë, unë mbeta vetëm. Zhurmat u mekën ajithandej, po dritat jo. Ndrinin yjet, hëna, kandilat, flakët e pishave. Tek-tuk gërvima aerresh të vetmuara që shkonin në fushë. Tek-tuk përplasje dyersh e hapa të shpejtuara njerëzish. Por edhe ata u shuan. Dëgjoheshin vetëm lehjet e qenve, që atë natë ishin tërbuar pas hënës së plotë, a ndoshta pas erës që lë prapa këmisha e zezë e pushtuesit.

Ecja i rënduar nga mendimet. Ecja kuturu nëpër rrugë, pa vënë re se ku shkelja. Isha i dërrmuar, gjumë s'kisha fare, megjithëse shpeshherë sytë i mbaja mbyllur. Dhe kur mbyllja sytë, më shfaqeshin masa të turbullta, të përgjakura, të përzhitura, aë i mernte lumi i Devollit me vete, i shtynte tej me brirë të ujshëm, gjersa i degdiste në det, më shfaqeshin këmbë të prera mbuluar me zhele të zeza, fytyra njerëzish të dashur që më përqaфонin, më puthnin e më thoshin të mos harroja asgjë nga ato që kisha parë dhe të merrja hak për të gjitha.

Papritur, u gjenda përpara shtëpisë së Dajë Haxhiut. Ishte një qetësi e madhe dhe vura re se pas pak do të agonte. Megjithëse kasollja ishte në majë të bregut, m'u duk vetja si në një gropë të thellë. Dhe që nga ajo gropë, në ngrohtësinë e beharit, kur korret qriuri, ndjeva duhmën e pluhurit që lëshojnë çatitë e mbuluar me presje. Sikur më shtyu nieri me dorë, eca drejt murit me plitharë dhe hyra në të vetmen dhomë aë kishte kasollia. Nga dritarja vërshonte drita e hënës së plotë. Kandili që ende i ndezur buzë vatrës. Ia ngrita fitilin dhe atëherë pashë një gjë të çuditshme: tavani ishte i carë mu në kulm. Nga ajo e carë dukej një copëz qiell me yje të verdha qehlibar. Dhe pingul me të,

pranë vatrës, një predhë e madhe ngulur në dyshtemenë përdhese. Në fillim m'u duk si një fron i shkurtër, po pastaj, kur e preka me dorë, e kuptova që ishte bombë aeroplani. Ajo predhë kishte shpuar çatinë dhe ishte ngulur përgjysmë në tokën e butë, pa shpërthyer dhe rrinte atje, e heshtur, si një kokallë e stërmadhe gjysmë e varrosur

Dola përjashta, shkela mbi hithrat dhe mbi sinapin e verdhë anës mureve dhe, duke e marrë me mend nga binte lindja, thashë:

– Këtu!

S'qe nevoja të përdorja shkallët. Muri andej qe shumë i ulët. Fillova të kërkova nëpër hatulla dhe, pas pak, pa vështirësi, midis presjeve preka maliherin, mbështjellë me lecka mbytur në vaj. Gjeta edhe gjerdanin plot me fiske. I mora në duar dhe m'u duk sikur preka lirinë.

«I gjeta, dajë Haxhi! I gjeta!» – thashë i gëzuar.

* * *

Pa dalë dielli, erdhën ata me pupla në helmetë, me xhufka të gjata në qylafët e zinj, me paticka, me automatikë dhe me topa. Në oborrin e Elmaz agait qe koka, trupi u zgjatej nëpër fshat dhe bishti u mbaronte në brigjet e lumit, ku kishin ngritur kampin me çadra, me kamionë, me kuaj, me topa malorë dhe me karrot e kuzhinës.

U zgjova nga krismat e armëve që u zbrazën në fushë dhe nga hingëllimat e shqetësuarra të pelës, që ishte trembur dhe kishte shkukur hurin e litarit. Dëgjova vetëm një batore të zgjatur pushkësh e automatikësh dhe uturimën e makinave. Një fshatar thëriste duke vrapuar:

– Fashistët! Dilni shpejt! Fashistët!

Që nga pragu i ahurit pashë mizëri njerëzish, pa mbrojtje e të zënë në befasi, burra, gra, fëmijë, bagëti, që ngjiteshin drejt malit për t'u shpëtuar plumbave të të huajit. Herë-herë, që nga rrëza e malit çanin hapësirën mëgjësore britma shqetësuese, urdhra, porosi, sharje.

Gratë dilnin me fëmijë në gji, me futë përpara, me duar tërë miell dhe harronin të shuanin zjarrin në vatër e të mbyllnin dyert e lesave.

— Ku venë këta të marrë kështu? — pyeti Elmaz agai duke hedhur vështrimin herë nga udha e pazarit, herë nga mali.

— Shkojnë të fshihen në korijet e thella që të shpëtojnë nga pushkatimi, — iu përgjigja.

— Më qafë paçin veten! Po italianët s'kanë gjë me popullin. E kanë me ata të malit, që u zunë pritë te Gryka e Cangonjit dhe i gjakosën e i vranë. E kanë edhe me ata që i strehojnë.

— U përvëluan nga bombardimi, aga. E panë llah-tarin me sy. S'kanë faj.

Ai vështroi i heshtur nga mali, kafshoi cepin e mustaqeve dhe më porositi të shikoja punën, të shkoja në fushë për të korrur atë «copëz» arë që kishte mbetur dhe, kur të binte vapa, të hapja trapin e lumit dhe të ujisja misrin. Pastaj mori xhadenë për t'u dalë italianëve përpara, kurse unë hipa pelën dhe shkova në fushë, rrugë e pa rrugë, i turbulluar nga hidhërimi dhe nga topitja. Pela ecte me revan, megjithëse nuk e cytja. Atëherë u kujtova që s'i kisha dhënë ujë prej kohësh.

— Ngopu tashti! — i thashë me zë, kur mbërrita te lumi. Ajo pinte me etje duke zhytur buzët si kadife gjer në flegra dhe duke tundur bishtin për të larguar mizat. Unë shihja rreth e rrotull qull në djersë, me një kombth të madh në fyt që s'më linte të merrja frymë lirisht. Shumica e fshatarëve kishin hyrë tanimë thellë në pyll. Edhe pleqtë, ulokët dhe të sëmuret nga ethet. Po edhe ata, që nuk kishin hyrë ende, pas pak, do të arrinin pyllin dhe do të shpëtonin.

Pela pinte me nge duke lëshuar nga buzët cërka që binin mbi ujë dhe formonin rrrathë. Ajo pinte, unë ndieja një lak rreth qafës, që, sa vinte e më shtrëngonte më shumë, duke parë atë pamje të llahtarshme aty, përtej bregut, gati te dera e mullirit. Shtatë fshatarë kishin rënë njëri pranë tjetrit, sikur flinin, kush më kurriz, kush përmbys e kush brinjazi. Me një të parë, i njoha të gjithë.

Ai, me pah mielli në supe e në flokë, ishte Petroja, mullixhiu ynë çalaman dhe i papërtuar. Ata që e kishin marrë në mes, sikur do ta mbronin nga stuhitë, qenë vllazërit Demiraj, që bënë një jetë të qetë, të veçuar dhe nuk përziheshin kurrë në punët e të tjerëve. Katër më të rinjtë, dy me opinga dhe dy zbathur, ishin Damjani, Rizai, Guri e Driti. Për të shtatë më erdhi keq. Po më shumë më çërriti zemra për moshatarët e mi, për Gurkën e Dritin këmbëzbathur, me të cilët vrapoja pas qeve, kur na i zinte zekthi dhe ziheshim me hosten e me kërrabë, kur kacafyteshin buajt inatçinj të agallarë ve tanë.

Përse i kishin pushkatuar? Ç'u kishin bërë ata? Me siguri atë mëngjes kishin shkuar në mulli për të bluar grurin e parë, për të bërë me shëndet bukën e re. I kishin pushkatuar për hakmarrje për kompaninë fashiste që u asgjësua te Gryka e Cangonjit. Dhe ai më dërdëllis: «Italianët s'kanë gjë me popullin!»

Nga gjysmëharku i jazit vërshonte shkumë e bardhë Disa pëllëmbë më tej, uji, i ngritur lart, merrte të shtatë ngjyrat e ylberit dhe këto ngjyra, copëzuar në mijëra e mijëra grimca shumë të imëta, lagnin fytyrat e verdha e të përgjakura të njerëzve të dashur. Ylberët e ujshëm binin vazhdimisht mbi sytë e tyre të hapur e të ngrirë.

Nja pesëdhjetë metra më tutje, në lëndinën e blertë, që dimrit mbulohej nga vërshimi i ujërave dhe nga rosat e egra, ishte kampi i armiqve. Pranë kamionëve, një bateri topash malorë, i kishte drejtuar tytat nga fshati. Po aty, mbi një karrocë, lëshonin avuj kazanët e mëdhenj ushtarakë. Gjatë tërë bregut të lumit laheshin ushtarët e huaj. Luanin me stërkalat ngjyra-ngjyra, fërkonin lëkurën e nxehtë pas cipës së kristaltë të ujit, u hidhnin ujë me grusht kuajve që hingëllinin nga kënaqësia, qeshnin e këndonin. Aty ku unë kisha vrapuar për t'i ardhur në ndihmë plakut të mirë, dy ushtarë lakuria bënë valë me ujërat dhe i tundnin njëri-tjetrit vithet e bardha.

Mua m'u duk sikur m'u zbërtheje diçka përbrenda. Ia ngula pelës thembrat si mamuz dhe ajo, e trembur, u ngrit kas në këmbët e prapme, kurse me të parat rrahu

ajrin. Nuk më bënëin duart për punë dhe brodha kot më kot monopateve e udhishtave, nën diellin përvëlues. Fusha e verdhë ishte krejt e shkretë, pa asnjë njeri, pa asnjë qerre a kafshë. Edhe fshati, po ashtu, veç rojave italiane. Duajt ishin shtrirë nëpër lëmënjtë dhe prisnin njerëzit e kuajt për t'u shirë.

U ktheva në shtëpi i turbulluar dhe i egërsuar. Në oborr, një ushtar dhe një civil italian kishin nderur zjarr nën hatullat dhe piqnin misra qumështorë.

– Të rroftë aparati ty, Antonio! Lufta bëhet me pushkë, – thoshte ushtari, duke rrahur me pëllëmbë karikatorin e automatikut.

– Në kohë lufte aparati fotografik vlen nganjëherë më shumë se pushka jote, – e kundërshtonte civili.

– *Ma che!*¹⁾ Mos ma shaj armën, Antonio! E di ç'të bëj? Ta mbush barkun me barut.

– Barkun jo. Këtë po deshe, – tha civili me të qeshur dhe i tregoi prapanicën. – *Ma che diavolo fa!*²⁾ Hiqi, se u dogjën!

I nxorën misrat e përzhitur dhe filluan t'i skërmitnin me dhëmbët e bardhë. Ushtari më pa, mbushi gavetën nga kazani që lëshonte avull aty nën hatulla dhe ma zgjati duke buzëqeshur.

– Merri! *Sono buoni!*³⁾ – më tha.

– Të dhjeva mu në makarona! – iu përgjigja i zemëruar. Ai u habit:

– *Ma che diçi?! Mangi!*⁴⁾

Hyra në korridor. Dera e odës së miqve qe pakëz e hapur. Aty ishin tre-katër veta, midis të cilëve edhe Elmaz agai. Në krye të minderit rrinte një kapiten, tërë shenja të shkëlqyeshme, si prej argjendi. Fytyrën e kishte të shëndetshme, të rruar taze. Me ato nofulla katrore dhe me atë mjekër të madhe e të kërcyer përpara, ai

1) Ç'thua!

2) Djall, ç'bën!

3) Janë të mira

4) Çfarë thua?! Ha!

i gjante shumë Duçes. Që prapa derës rrëmbeva copa bisedash:

– Këto ishin të domosdoshme, edhe bombardimi, edhe pushkatimi. Nuk shlyhet lehtë gjaku i nëntëmbëdhjetë ushtarëve që na vranë te Gryka e Cangonjit. Mirë-po një gjë nuk e kam të qartë. Unë kisha të dhëna që në atë lagje ishin strehuar partizanët...

– Ishin vërtet. Te Hajrullahu, te Haxhiu, te Haliti, te Hajredini...

Ky ishte zëri i Elmaz agait. Nuk e shihja, po zërin ia kisha dëgjuar shtatë vjet dhe ia njihja mirë.

– Me ushtri nuk arrija dot, prandaj dërguam bombarduesin. Na erdhi me vonesë informata. Kush informoi? – pyeti kapiteni me nervozizëm.

– Zoti Elmaz, – tha një tjetër

– Ju? – pyeti kapiteni.

– Si urdhëron! – u përgjigj Elmaz agai.

Unë u drodha prapa derës. Përsërita me vete pyetjen që më ishte ngulur si turjelë në tru «ku shkoi ai me aq axhele?» dhe më vërshuan mendimet. Unë dyshoja që ishte ai, po s'isha i sigurt. Dyshova që kur pashë pelën mbuluar me shkumë djerse. Dyshova kur më tha fjalët e fundit plaku Haxhi. Dhe tashti, që e dëgjova nga goja e tij, m'u duk sikur kisha dyshuar tërë jetën time, që kur isha bërë i ndërgjegjshëm. Tashti isha i sigurt. «Ti je tradhtar! Tradhtar! Tradhtar!», thashë me vete dhe mendja më shkoi te ahuri, ku kisha fshehur maliherin.

Ata brenda filluan të acaroheshin.

– Ndër viktimat s'ka asnjë partizan. Ju keni gënjyer, – tha oficeri tërë zemërim dhe u ngrit nga minderi. – Ju keni gënjyer dhe kjo... është e rëndë!

– Ata ikën para se të vinit ju, zoti kapiten. Ikën! – e ngriti zërin Elmaz agai duke u munduar ta bindte që ai s'kishte ndonjë faj.

– Atëherë edhe ata kanë informatorët e tyre! Kush i lajmëroi të na zinin pritë te Gryka e Cangonjit? Nga e dinin partizanët që ne do të kalonim andej? – E pa aganë drejt në sy dhe thirri: – Ju, zoti Elmaz, mos bëni punë të dyfishtë?!

Elmaz agai kërceu nga vendi dhe iu afrua ushtarakut që kishte marrë një pozë kapadaiu e mendjemadhi, si Duçja vetë. Atëherë ia pashë profilin, me atë ballin e ngushtë, me vetull shumë të trashë, të zezë sterrë, me hundë të fortë, pikaloshë, nga flegrat e së cilës zgjateshin ca qime të zeza, si tel.

— Jo! — ia bëri ai me gishta të çakërritur si rrënjë dhe kafshoi buzën aq fort, sa e zbardhi. — Më rripni të gjallë, në ju gënjej!

Me sa dukej ai ishte një ushtarak me përvojë, një kunadhe dinake, se po atë çast e qetësoi Elmaz aganë. Ngriti gotën dhe e piu me fund.

— *Grappa*¹⁾ e mirë. Rrushi e keni? — pyeti duke buzëqeshur lehtë.

— Safi! Pikë e parë!

— Sigurisht rrush. Ju falëm nderit! — dhe derdhi në gojë të dytën, pa e prekur gotën me buzë. Kur i mbushën edhe një, tha: — Hedhja e eksplozivit dhe mitralimi janë bërë mirë, me ndonjë defekt që është krejtësisht i justifikueshëm. Por, populli, përse largohet nga ne? Përse merr veten më qafë duke braktisur shtëpitë dhe duke vuajtur kot? Mos duhet të dërgoj ndonjë aeroplan tjetër, atje në pyllin ku është strukur?!

— Ah! — psherëtiu Elmaz agai me duf, i lehtësuar tanimë, — të kishit ardhur me kohë, do t'i zinit si peshqit në rrjetë! Edhe dëme s'do të kishit fare. Edhe ne do të flinim rehat. Sa për popullin, mos kini merak! Populli është si bagëtia.

— Do ta ndreqim këtë punë, — tha oficeri buzagaz. — Edhe shtëpitë e rrënuara do t'i ndërtojmë ne, me hekur e çimento.

Mua më shkoi mendja, përsëri te maliheri që kisha fshehur në ahur. «Sa mirë që kam një pushkë», mendova dhe e ndjeva veten të fortë.

1) Raki

Pasdreke ata bënë një gjë që s'më kishte shkuar ndër mend kurrë. U ngjitën në lagjen e sipërme, ku ishte bërë bombardimi dhe filluan të fotografonin shtëpitë e rrënuara. Kapiteni qëndroi përpara 'kasolles së hallë Diles, u mendua një copë herë dhe u dha urdhër xhenierëve që të hipnin mbi gërmadhat.

– Kjo është një ide e shkëlqyer, zoti kapiten! – tha fotografi duke i vendosur ushtarët ashtu siç dëshironte ai, ca hipur mbi mure me trarë në supe, ca të tjerë me tezgja; duke bërë sikur mbanin gurë dhe të tjerët me mистри.

Dy shkrehje aparati nga dy pika të ndryshme. Sa herë e shkrehte, fotografi thërriste i kënaqur:

– *Meraviglioso!*¹⁾

Kapiteni, mori atë pozën e zakonshme të mendjemadhut, dhe e këshilloi:

– Antonio! Do ta botosh me një titull të madh: «Ndihma bujare fashiste!»

– Signor, si!

– Dhe poshtë me dy nëntituj: «Ushtarët e xhenios të Divizionit *Lupi di Toscana* në ndërtimin e një shtëpie të shkatërruar nga barbarët grekë... Jo nga grekët. Të shkatërruar nga komunistët!» Dhe «Fshatarët falënderojnë përzemërsisht kapitenin Bruno Ferrara për gjestin e madh humanitar të ushtrisë glorioze të Duçes!»

Pasi tha këto me njëfarë madhështie, i shtriu dorën Elmaz agait dhe, ashtu, zënë dorë për dore, Antonioja, i shkathët dhe i papërtuar, shkrehu dy herë aparatit duke thënë pas çdo shkrehjeje atë fjalën «*meraviglioso*».

Pastaj sajuan edhe një gjë të kobshme, që nuk mund t'i vejë ndër mend askujt, përveç fashistëve. Edhe këtë s'ma kishin parë sytë gjer atëherë. Po aty, ushtarët bënë një si qivur, i hodhën përsipër gjethe e lule behari, i vunë një fjongo të gjatë edhe dy flamurët, tonin me

1) E mahnitshme!

sëpatat e Fashios dhe tringjyrëshin italian. Dy ushtarë qëndruan për nder-armë.

— Antonio! — porositi kapiteni duke fryrë gjoksin si të Duçes. — Do t'i gjesh një titull të tillë: «Venerim për viktimat që gjetën vdekjen nga banditët komunistë!» Ose një perifrazim të mendimit të Duçes, p.sh. «Shqiptarët i kemi në zemrat tonat!» Ky të jetë titulli i madh, dhe atë që thashë në fillim, «venerimi», të jetë nëntitull, duke shtuar dhe këtë nëntitull tjetër: «Kapiteni Bruno Ferrara, merr pjesë vetë në ceremoninë e përmortshme!»... Duhet të bëjmë një fotografi edhe atje te mulliri, me ata të shtatë.

— *Signor, si!* — tha fotografi.

Atëherë kapiteni i caktoi vendin Elmaz agait, hoqi kapelën dhe mori në fytyrë një pamje të dhimbshme. Kokën e kishte kreujt të rruar dhe kushdo që do ta shihte, do të thoshte pa ngurrim: «Duçja!».

— Jepi, Antonio! — urdhëroi.

Në atë heshtje të stisur, midis asaj gënjeshtre të paturpshme, midis asaj fyerje të rëndë që i bëhej fshatit e popullit tim, u dëgjuan tri shkrehje të aparatit fotografik, si tri trokitje të korbis mbi një kërmë.

Mua më shkoi mendja përsëri te maliheri. «Sa mirë që kam një pushkë, — mendova. — Njeriu është i fortë kur ka një pushkë!»

* * *

Ata ikën kur filloi të binte vapa. Ngritën çadrat e kazanët, hoqën rojat, lidhën topat pas makinave dhe u nisën nga kishin ardhur, mbuluar me një napë të hollë pluhuri të verdhë që i ndiqte nga pas. Ikën dhe lanë prapa hirin e zjarreve, heshtjen e rëndë e të përzishme dhe ata të shtatë të pambuluar atje te mulliri, buzë jazit. Tërë fshati binte erë mish të pjekur, erë makarona, erë baruti e gjaku. Ata therën tërë kopenë me dhen që vëllezërit Demiraj e kullosnin në lëndinat rreth mullirit. Therën edhe tri pendë që dhe vranë një kalë e një

mushkë, veç pulave. Lëkurët e bagëtive, të brendshmet e tyre dhe të shpendëve të përhapura gjithandej, ishin mbushur me miza jeshile dhe lëshonin një kutërbim që të mbyste. Aty ku kishin shkelur këmbët e ushtarëve dhe ku kishin kaluar makinat, karrot e topat, arat ishin bërë lëmsh. Tufat e harabelëve turreshin mbi grurin e shkoqur.

Unë u ktheva në shtëpi me mlllef të papërmbajtur dhe me mendjen të mbledhur top. Kisha tanimë një pushkë dhe, kur ke një pushkë, je i fortë. Në oborr s'kishte gjë, veç zjarrit të shuar nën hatullat, ku ata të dy, fotografi e ushtari kishin pjekur misra qumështorë. Brenda ishte vetëm aneja, shtrirë në dyshekun e saj të butë, me kokën lidhur me shami të lagur.

– Ku është agai? – e pyeta.

– Shkoi me ta, t'i përcjellë. Më tha se nuk vonohet, – u përgjigj ajo, e këputur fare.

Dola nga dhoma duke përplasur derën. Ajo më thirri:

– Hydri! Ma sill atë legenin prej cingoje! Më sill edhe një bardhak me ujë të ftohtë.

Unë bëra sikur s'e dëgjova. Isha bërë tym. «Ta sjell unë legenin prej cingoje. Bëju hazër të përmiresh zotrote,» – pëshpërisja me vete, duke marrë maliherin dhe gjerdanin që i kisha fshehur në hatulla. Gjer aty vinte zëri i saj i hequr, si ankim. Pastaj filloi të më kërcënonte, të më mallkonte, të më fyente.

I futa një krehër fishekë pushkës dhe ngjasha gjerdanin në bel. Unë kisha një pushkë tanimë dhe isha i fortë. Pela hingëlliu, se e ndjeu që do ta nxirrja nga ahuri. Pashë me mall dyshekun tim si gur, ku s'kisha për të fjetur më, i rashë me grusht dhe e shalova pelën që aty.

– Hydri, o derr! Sa të vijë ai, pa ta ndreq samarin!
– vazhdonte aneja ankimet e mallkimet e saj të zakonshme. Ishte hera e parë që nuk i bindesha. Kushedi ç'mendonte ajo! Kushedi ç'maraz kishte përbrenda që nuk po ia dëgjoja fjalën! Mbase dhe nuk i besohej që të ishte e vërtetë. Mbase i dukej vetja në kllapi nga ethet ose në ëndërr dhe bënte çmos që të përmendej.

I foia pelës dhe ajo, si të ishte njeri, shkrofëtiu aty mbi dyshekun tim si përpara një varri dhe doli nga stalla, ndërsa unë isha bërë rrafsh me qafën e saj.

— Ec tashti, moj e dashur! — i foli dhe e cyta me thembrat e plasura, që i kisha si mamuze. Ajo u lëshua si furtunë drejt malit. — Bëhu qull në djersë, moj arapkël! — i thashë me zë, sikur i flisja një njeriu dhe jo një kafshe. — Ashtu, si atë natë. Mbulohu me shkumë të verdhë, që të arrijmë sa më shpejt e t'u them vëllezërve e motrave të kthehen në fshat se ata e thyen qafën prapa diellit! T'u themi të kthehen, të varrosin të dashurit, të ndreqin shtëpitë, të ndezin vatrat, të marrin hak për mizoritë dhe të korrin grurin...

Unë flisja me dashuri dhe ajo, sikur të më kuptonte, fluturonte e mbytur në djersë, gulçonte me ije, me fleg-rat të zgjatura përpara...

I gjeta fshatarët e mi kur po bëheshin gati për të dalë nga pylli. Dielli po perëndonte, i kuq, i zjarrtë. Ishte ende zagushi dhe cinxrat s'kishin të pushuar. Fshatarët ecnin grupe-grupe, me bagëtitë përpara, të ngarkuara me plaçka, kosore, sfurqe, spata. Fëmijët u vinin rrotull nëpër këmbë.

— Ç'bëhet andej? — më pyeti xha Myrtoja, ai fshatari trupmadh, që ma preu rrugën i pari.

U tregova me një frymë të gjitha ç'më kishin parë sytë.

— Ikën! E këputën qafën! — u thashë dhe pikat e djersës më ranë nga balli drejt e në grifën e pelës.

— Po si kështu?! Njërën apo të dy vëllezërit i vranë?!... Të dy?!... Të dy te mulliri i vranë?!... Nuk shpëtoi asnjëri?!

Ajo që fliste ishte nëna e vëllezërve Demiraj. Nuk pyeti më gjatë, diçka iu shkreh në shpirt dhe gëlltiti lotët. Gratë iu derdhën dhe e rrethuan në mes tyre, për ta ndarë hidhërimin në pjesëza të vogla.

— Oburrani ju, ore djem! Ecnit përpara! — u bëri zë Myrtoja dhe pesë moshatarë të mitë filluan të zbrisnin tatëpjetë me hap të shpejtë.

– Po këtë armë ku e gjete? – më pyeti.

– E kam amanet nga dajë Haxhiu.

– Po. Maliheri i tij është. Mirë thotë Partia: ka ardhur koha t'i nxjerrim nga hatullat. Po ata rrufjanë vijnë papritur, sikur i lajmëron njeri me tel.

– I lajmëron Elmaz agai. Ai na i sjell, xha Myrto. O, ç'bën ai, ç'bën ai! Edhe i vdekuri, po të marrë vesh poshtërsitë e tij, hap kapakun e varrit!

Myrtoja u mendua një copë herë dhe më pa drejt në sy:

– Ai duhet varrë, Hydri! E dimë që është i keq, po nuk e dinim që paska shkuar aq larg. E ka prishur pasuria atë njeri. Ai duhet varrë!

– Duhet varrë! – thanë me një gojë burrat e tjerë.

Unë shtrëngova maliherin. Isha i gëzuar që kisha një armë. Njeriu me pushkë është i fortë, mendova dhe mund të plotësojë shumë mirë vullnetin e popullit.

Nga larg u dëgjua një gumëzhimë e mbytur. Fshatari i gjatë vuri pëllëmbën mbi ballë, si strehë dhe vështroi qiellin. Nga qielli ngritën kryet edhe burrat e tjerë.

– Po partizanët a i lajmëruat? – pyeta.

– Janë larg, në Dumbravë të Moravës, – u përgjigj Myrtoja pa ia hequr vështrimin qiellit. – Dërguam njerëz. Mbase arrijnë me kohë t'u zënë ndonjë pritë atje te Qafa e Buallit...

Fshatari do të fliste edhe më, po atë çast hapësira e purpurt gumëzhiu dhe të gjithë ne pamë në qiell një kaçiator italian me dy krahë.

– Aeroplani! – thirri Myrtoja i pari. – Shpërndahuni, nëpër shkurre! Kujdes fëmijët! Ashtu javash, javash, nëpër bushe e dëllinja. E ç'do të na bëjë kjo sorrë?!

Aeroplani u lëshua pjerrtazi mbi ne. Unë, siç'isha, hipur në pelë, hoqa maliherin nga supi. Arapka, sikur ta dinte ç'do të bëja, ngriti veshët përpjetë dhe nuk luajti fare nga vendi. Mbi kokat tona fluturuan fletushka të bardha. U desh një copë kohë gjersa më i shkathëti i fëmijëve e kapi njërën në ajër e na e solli. Po asnjë nga ne nuk dinte të lexonte. Në një anë të letrës diçka

ishte shkruar. Në anën tjetër ishte fotografia e Duçes, me nofulla katrore e me mjekër të kërcyer përpara, tamam si fytyra e atij kapitenit, Bruno Ferrarës.

Myrtoja ua hodhi fëmijëve duke qeshur:

– Fshini prapanicën, o kolopuçët e xhaxhait, me kokën e madhe të Duçes! Mblidhini dhe fshini prapanicën!

Kaçiatori bëri një rrotullim dhe erdhi përsëri drejt nesh me rrapëllimë, ngadalë-ngadalë dhe shumë ulët. Unë e mora në shenjë te helika që larg dhe, kur më erdhi mbi kokë, e qëllova. U ktheva më krah dhe e qëllova përsëri. Qëlloi edhe ai po plumbat iu shpërndanë kuturu!

– Bjeri edhe një herë! – thirri Myrtoja i gëzuar.

Po nuk qe më nevoja, se atë çast të gjithë pamë se si nga bishti i aeroplanit doli një tym i zi që erdhi e u zgjat dhe u trash si shtëllungë. Qielli u mbush me vërshëllimën e tij të mprehtë, që i ngjante ankimit të një përbindëshi të goditur për vdekje. Fëmijët, që e dinë mirë se ku mbaron katanaja që i këputet filli, ngritën duart lart, të gëzuar, duke vrapuar në drejtim të aeroplanit.

– Oj, të ngrënë që i bëri! Oj të ngrënë! – thirra unë majë pelës, duke kujtuar këto fjalë të plakut Haxhi. Zemra më gufoi. «Njeriu është i fortë kur ka një armë», – mendova i gëzuar. Unë e kisha tanimë pushkën, e provova me sukses dhe isha i lumtur.

Sa të hapësh e të mbyllësh sytë, aeroplani iu turr malit si një dem i tërbuar, nuk pyeti ç'kishte përpara, ia nguli brirët e hekurt, shpërtheu në flakë me një buçimë shurdhuese dhe u bë copë-copë.

Një oshëtimë e gëzuar njerëzore mbushi pyllin. Fshatarët i harruan për një çast vuajtjet e mundimet. Gratë fshinë sytë e përlotur, mallkuan të huajin dhe me shpirt të lehtësuar filluan të thërrisnin fëmijët që u çakërdisën pas aeroplanit. Kishte midis tyre djem të vegjël, të shka-thët e të zgjuar, që donin të merrnin ndonjë mbeturinë të kaçiatorit, për ta kthyer në një gjë të dobishme, në një karrocë të vogël, në një stelë qeni, në një kafaz thëllëzash, apo thjesht në një lodër.

– Të lumtë pushka, Hydri! – tha Myrtoja, hapi krahët e gjatë, unë u përkula dhe ai më përqafoi fort. Pastaj pa edhe një herë shkëmbin e bardhë ku u përplas aeroplani. Në mes të tij kishte mbetur një njollë e zezë, e madhe dhe asgjë tjetër.

– Nxihu, Itali, nxihu! Nxihu, Itali mavria, nxihu! – thirri ai dhe dy lot që i rrodhën nga sytë e gëzuar nuk i la t'i përthaheshin dhe as t'i binin, po i lëpiu me majën e gjuhës...

* * *

Kur hyra në fshat, kishte rënë nata. Qielli ishte tërë yje, të mëdha, të vogla dhe ca si pluhur i përshkënditur, të gjithë të dridhshëm, si qenie të gjalla. Lehnin qentë dhe këndonin bulkthit si të dashuruar pas hënës së plotë. Qëndrova përpara shtëpisë dhe, pa zbritur nga pela, i futa malisherit fishekun në gojë. Unë kisha një pushkë tanimë dhe isha i fortë... dhe isha i lumtur. Njeriu duhet të ketë një pushkë për të mbrojtur vendin, për të vrarë pushtuesit dhe tradhtarët.

Shtyva derën, po ishte mbyllur nga brenda me llozin e madh sa një tra. Atëherë trokita fort. Pela hingëlliu nga kënaqësia që do të pushonte më në fund dhe do të hante torbën me tërshërë.

– Kush është? – pyeti ai, agai, me zë të tronditur.

– Hapeni! Jam unë, – thashë me pushkën ngrehur.

– Kush je ti?

– Po unë jam, Hydriu?

Pela hingëlliu përsëri. Unë e përkëdhela në qafë. «Mirë bën që hingëllin, moj arapkë,» – mendova. Llozi gërrviu.

– A, ti je, o derr?! Po ç'është kjo mynxyrë që kris e ikën pa na lajmëruar?! Ku e gjete ti këtë të drejtë, o derr i derrit? Ku e gjete ti, një copë hyzmeqar, të lësh grurin pa korrur e misrin pa ujitur? Ku u syrgjynose? Në ç'hale ishe futur? Ç'qenë ato krisma? Ç'që ai shpërthim? Ç'që ai aeroplan që u përplas në shkëmb?

Hajt, pa ta tregoj unë ty, sa para të bën lëkura! Ja, me këtë lloz do të t'i thyej brinjët dhe hundët, derr!!

Ai ishte shumë i zemëruar, shumë i egërsuar, prandaj nuk e hiqte dot llozin. Unë, me pushkën ngrhur, me gishtin te këmbëza, thosha me vete, shumë i qetë:

«Për nënën time Ferdane! Për vëllezërit që u vranë e u pushkatuan! Për jetën time të mjerë! Për shtëpitë e rrënuara! Për grurin e djegur në ara! Për jetimët! Për lirinë e Shqipërisë që ti tradhtove!...»

Më në fund e ndjeva që e hoqi llozin duke rënuar. Pashë dritën e kandilit që i ndriçonte gjysmën e fytyrës. Nuk arriti ta hapte derën kat e kat. Fjala i mbeti përgjysmë. Ia shkrehu maliherin drejt e në gojën e çapëlyer dhe e lashë top në vend, me një plumb.

— Qen! — brita.

Pela hingëlliu dhe u ngrit kas. Donte të hynte brenda. Ia nduka fort gozën prej litari dhe ajo, si rrahu ajrin me këmbët e përparme, u turr në rrugë duke nxjerrë xixa nga potkonjtë.

* * *

Unë kisha tanimë një pushkë dhe e ndieja veten të fortë. Dhe kisha vetëm një rrugë: rrugën e maleve të mia!

Që atë natë, pesë djem të rinj, pothuaj moshatarë, u nisëm për te partizanët. Kur mbërritëm në Qafën e Buallit, beteja kishte marrë fund. Luftëtarët, midis makinave që vazhdonin të digjeshin, po grumbullonin armët e municionet e armikut, që ishte shpartalluar krejt. Dëgjova një partizan që thrriste:

— Shoku komisar! Qenka një oficer i plagosur këtu! Tamam si Duçja!

— Të ngjarë që i bëka! Sikur e ka nxjerrë nga hundët, — tha një student me automatik në dorë.

— Tërë derrat një turi kanë! — shtoi një devolli i sertë.

— More! Po, mos është Duçja vërtet?! — pyeti një burrë mesatar, me katër pushkë mbi supe.

Unë u afrova dhe në dritën e flakëve pashë oficerin, që kishte rënë në një pozë shumë qesharake. Ishte ende i gjallë dhe vështronte me tmerr e me mëshirë. Tjetri, një civil, që ishte bërë shoshë pranë tij, kishte në qafë një aparat fotografik të shpuar tejprtej nga plumbat.

Mua m'u kujtuan mizoritë e tyre dhe mjerimet e fshatit. M'u kujtuan krimet e tyre dhe më hipi gjaku në kokë, dhe s'e përmbajta veten.

– Ky është ai... kapiteni... Bruno Ferrara, – thashë me qetësi.

– Mos e qëllo! – thirri komisari me inat.

Unë heshta.

– Është një nga ata djemtë që erdhën sonte. – shpjegoi një partizan, me ballin lidhur me fasha.

Komisari më erdhi pranë me hap të shpejtë, më pa me vërejtje nga këmbët me opinga të shqyera e gjer në sy dhe më pyeti me qortim:

– Po përse ta vrasësh, more trim? Përse?

Unë nxora gëzhjën, i vura maliherit siguresën dhe nuk fola...

«NËNTORI» Nr. 10. 1978

FURKA

Fshati Gjonbardhaj shtrihej midis dy maleve të larta dhe ndahej në dy lagje të mëdha, njëra në lindje e tjetra në perëndim. I ndante një përrua i cekët. Lagjes nga lindja i thoshin Hijas, se rrinte në hije dhe rrezet e diellit binin mbi të shumë vonë, pas mesditës, dhe vetëm për pak kohë, sa edhe në behar mezi i ngrohnin kasollet. Tjetrës i thoshin Djellas, se atë përshëndesnin të parën rrezet e diellit. Edhe në dimër, në mesditë, gurët e latuar të shtëpive ishin të vakët, si sqellat e një zogu.

Asnjeri nuk e dinte se që kur ishin vënë e kush i kishte vënë ata emra, po të gjithë e dinin, në Gjonbardhaj e në tërë krahinën malore, se në Hijas ishin struktur të varfrit, kurse në Djellas, dimër e verë, nga mëngjesi e gjer natën vonë zbardhnin shtëpitë e mëdha dykatëshe të Milo Çelnikut dhe të farefisit të tij.

Në Hijas, në një kasolle që s'kishte asnjë ndryshim nga të tjerat, jetonte e vetmuar plaka Furkë. Ajo quhej Kostandinë, po ia kishin harruar emrin. Sikur e kishte harruar edhe ajo vetë dhe ishte mësuar me emrin e ri.

Dilte herët në mëngjes, ulej te pragu i kasolles dhe tërë ditën lëvizte me shkathtësi duart mbi furkë, tirtë lesh, e kthente në fill të hollë dhe e mblidhte turrë në lëmsh. Me atë lesh bënte shajak të fortë dhe vishte familjen e saj të madhe, të shoqin, dy djemtë, nusen e të madhit, dy nipërit dhe veten. Pastaj, kur filloi lufta, bënte shajak për partizanët Shumë pak lumturi kishte ndierë ajo në jetë. diçka kur u martua e lindi djemtë. kur martoi të madhin, kur u bë gjyshe dhe në atë kohë të viteve të luftës, kur si nënë e mirë që ishte, vishte luftëtarët e Shqipërisë.

Por erdhi një kohë kur Kostandina e ndjeu veten krejt të vetmuar: Në kasollen e saj s'dëgjohej më asnjë zë fëmije a luftëtar. E pllakosën vrasjet e vdekjet, gati njëkohësisht, brenda dy vjetësh, njëra më e helmuar se tjetra. Në fillim Milo Çelniku i vrau të shoqin sypatrembur e kryengritës, vetëm se pse ai u lidh me partizanët. Pastaj, papritur, i vdiq djali i madh nga një sëmundje e rëndë, i la nusen të re me dy binjakë, të vegjël fare. Dhe, më në fund, ikën edhe ata të tre brenda një pranvere, kur mbi Hijas rëndonte qielli i mbuluar me re të zeza sterrë.

I mbeti vetëm i vogli, 17-vjeçari. I thoshin Vani i Vogël, se ishte i vogël dhe i paktë nga trupi. Ishte sypatrembur dhe kryengritës, si i ati. Nuk arriti ta martonte e ta gëzonte, se djalit iu ngrit mendja. I zjarrtë e hakmarrës siç qe, në verë të vitit 1943, rrëmbeu maliherin e babait.

– Nënë, po shkoj te partizanët!

– Po ti ma more armën, o Vani i Vogël. Unë me se të luftoj?

– Me furkë! – qeshi i biri, e përqafoi dhe, duke u ndarë, i tha: «Do të lë një amanet, po të vritem, maliherin të ta japin ty.»

Dhe ai u vra... Erdhi një natë në Hijas komisari i tij, ia gjeti kasollen e ftohtë, e përqafoi e i tha:

– Mirë se të gjej, nënë Kostandinë!...

Nga zëri e kuptoi mandatën. Furka i ngriu në duar. Tha si përçart:

– Asgjë s'më ka trembur, o bir, dhe asgjë s'më tremb më në jetë...

– Nënë Kostandinë, – vazhdoi komisari me mundim e me dhembje. – Yt bir kthehej nga beteja për të dhënë lajmin e gëzuar, se qyteti i parë i Shqipërisë u çli-rua. Po e zunë në befasi dhe na e vranë.

– Kush? – e ndërpreu Kostandina.

– Milo Çelniku.

– U bënë dy vdekje nga një dorë. S'i mban dheu!

– Ia rrëmbyen edhe maliherin, nënë Kostandinë, – mezi tha komisari.

– Kush? – e ndërpreu ajo përsëri.

– Milo Çelniku.

– Ai është maliheri im! Amanetin s'e tret dheu!

– Më kishte thënë që maliherin të ta jepja ty, me dorën time. Po s'e mbajta dot amanetin! Më fal, nënë Kostandinë!...

Që atë çast Kostandina nuk foli më. Edhe më parë ajo i kishte fjalët me këtë. Kurse që atë çast goja iu mbyll. Fliste vetëm me vete, në heshtje të plotë.

Kishte pasur një familje të pandarë dhe as që kishte menduar ndonjëherë se do ta humbte aq shpejt e në mënyrë të pamëshirshme. Mbeti fillikat e dukej edhe vetë sikur ishte kthyer në një furkë që mbështjell shtëllungat e shtrëngatat e fundit të jetës.

Për të vetmuarit kishte në Gjonbardhaj një kishë të vjetër, po ajo nuk shkoi asnjëherë, se nuk besonte më zot e perëndi. Më shumë i besonte pragut të ftohtë të kasolles, furkës e shtrëngatës në male, se zotit.

Kur i binin pika shiu a llohe mbi furkë, mendonte: «Janë lotët e të dashurve të mi, që s'po ua marr dot hakun».

Kur e kërcënonte a e mallkonte ndonjë nga ata të Milo Çelnikut, ajo s'ia vinte veshin, po mendonte:

«Çdo ditë kam humbur diçka nga vetja, humba rininë, pastaj humba shumë. Por jo kot. I humba që t'i fitoj të gjitha një ditë».

Fshatarët e çmonin shumë, e nderonin dhe e ndihmonin. Ndonjë nuse e re e dhimbsur e puthte fort në faqet e fishkura e i thoshte:

– Edhe këtë lot të ri, ta dua shumë, moj nënë Kostandinë, e bukura nënë!

Plakat e përshëndesnin e mërmërisnin:

– E zeza Furkë!

– E bardha Furkë!

Vërtet, mendonte Kostandina, jam bërë si kjo furkë, që ma dha për pajë gjyshja ime, ndjesë pastë. Sa vjet ka punuar kjo furkë? E ku ta dish. Me të ka punuar stërgjyshja, gjyshja, nëna, tashti punoj unë. Nesër do të punojnë të tjera gra, të tjera vajza, të tjerë breza. Se është furkë e fortë dhe s'ka vdekje kurrë! Pa shiko si është lëmuar, si thikë, si maja shtize hekuri, i ka dhëmbët të mprehtë, mund të të shpojë tejpertej. Kështu jam edhe unë. Një furkë e bosht që vërtitem e që tjerr jo lesh, po ëndrra.

Kur mbetej vetëm te pragu e Gjonbardhaj flinte, ajo anonte pakëz kokën e thinjur e mendonte:

«Ëndërroj të gjej maliherin e të eci në rrugën e fëmijëve».

Një mëngjes të vrenjtur e përshëndeti një djalë i ri. Ai i ngjante shumë Vanit të vogël. Kostandinës i ngriu furka në duar. Po ai s'ishte Vani. Ai ishte një luftëtar, që, duke ecur me hap të gjatë e të shpejtuar, këndonte një këngë për një nënë të fortë partizani. Kostandina mbajti mend vetëm këto vargje:

*Në shtëllungë leshi
Fshehur zjarr i madh...
Dhe djemtë kur ranë,
Vetëm një fjalë thanë:
– Nëëëëëë!*

Kënga ishte e fuqishme dhe e zgjatur, e zgjatur, sikur këndonin e mbanin iso tërë malet njëherësh:

– O nënë! Nëëëëëë!

Kostandinës i rrodhën lotët. «I rrita fëmijët dhe i bëra të bukur si lule, mendoj, dhe si të gjitha gratë e Gjonbardhajt, mendoja të qaja më pak e të gëzohesha më shumë. Po kurrë nuk mendoja se do të këndohej për mua një këngë e tillë. Tani jetoj vetëm me kujtimet e tyre... I përkëdhel me sy dhe i shoh të gjallë në ëndërr...»

«Po qaj?» – u çudit me vete, kur lotët e ngrohtë i ranë mbi duart që s'kishin pushuar kurrë së punuari.

«Tani mjaft! – tha me vete. – Mjaft! Me sa duket, qava shumë, se lotët m'i bënë duart qull. Sa ishin gjallë edhe qaja nga pak. Tani që këndohet kjo këngë zemre për mua që s'i kam fëmijët s'është të qaj. Duhet të më shteren lotët.» – Dhe që nga ai çast i thau edhe lotët. Dhe s'qau më.

Një mbrëmje u ul te pragu një moshatare, e përvëluar edhe ajo nga jeta, por jo aq sa Kostandina. Edhe ajo tirrte me furkë lesh të zi. Boshtet gati preknin njeritjetrën, i bardhi të ziun, i ziu të bardhin dhe sikur i çuçurisnin shoqi-shoqit.

– Kostandinë, moj e zezë. Ai i mallkuari i Djellasit ka thënë se ti more fund e po vdes. Thotë se ti je motër e djallit. Thotë se edhe djallin e ke mbyllur në shishe. Thotë...

Kostandina e ndërpreu. Foli për herë të parë që nga vrasja e Vanit të vogël.

– Mos e thuaj atë fjalë, moj e uruar! Gënjeshtria i ka këmbët të shkurtra. Ne shyqyr që kemi furkën. Atë kemi armë. Atë kemi gjykatëse të të gjitha të këqijave. Po ditë të bardha do të shohim në mos ne, që jemi plaka, të tjerët, populli.

Që nga ajo mbrëmje Kostandina filloi ta mblidhte veten. Boshti dridhej e dridhej në duart e shkathëta e ajo ulur te pragu i kasolles, plakej çdo ditë e më shumë nga shkëlqimi i shtëpisë me dy kate të Milo Çelnikut. Thellë në shpirt ndiente se gjithë hidhërimi i grumbulluar gjatë jetës, gjithë hallet e dertet e luftës i ishin kthyer në helm, farmak për armiqtë e huaj italianë e gjermanë dhe për tradhtarët si Milo Çelniku, dhe në

një dashuri të madhe, që nuk dinte ta shprehte kurrësesi, për familjen e vet, për lagjen e vet të varfër, për djemtë e Shqipërisë që luftonin maleve. Këto dy ndjenja të fuqishme, dashuria dhe urrejtja, kishin pushtuar, push-tonin gjithë qenien e saj, mëngjeseve të gjata të pranverës, netëve pa fund të dimrit me dëborë e tufan të vitit 1944, mbrëmjeve të ndera e të palëvizshme të verës. Dashuria i ndizej në shpirt, kur mendonte për familjen e vet e për luftëtarët e lirisë dhe po nga shpirti i dilte një si vullkan urrejtjeje, kur sytë e fishkur i zinin të huajt e ballistët. Shpesh, fshatarët e Hijasit, kur kalonin para kasolles së saj, shihnin te pragu pak thërrime kripë e një bucelë të vjetër, të përmbysur. Shpejtonin hapin të tronditur për t'i shpënë diçka nga ushqimet e veta të pakta, se e kuptonin që Kostandina jetonte vetëm me ujë e me pak kripë.

Dhe me urrejtje.

Një mbrëmje u harrua dhe e zuri gjumi me furkë në duar, ulur te pragu i kasolles. U zgjua papritur, jo nga të ftohtët, se ajo nuk ndiente më as të ftohtët e as të nxehtit, por nga zhurma e llahtarshme në tërë Gjonbardhajn, në Hijas e Djellas. Ende pa u përmendur, iu duke sikur vraponte nën shiun e yjeve, ikte e ikte dhe, sa më shumë largohej, aq më fort këndonte një këngë të re, me zërin e yjeve, të qiellit e të maleve, pa e dëgjuar as vetë zërin e saj. Këndonte për gjirin e saj të tharë, për luftëtarët, për dashurinë e vërtetë njerëzore, për furkën me dhëmbë të lëmuar e majëmprehtë të mbushur tërë lesh. Dhe, për çudi, e shihte Hijasin e Djellasin zënë dorë për dorë që vallëzonin rreth një zjarri të madh, ku digjeshin armiqtë e huaj dhe Milo Çelniku.

Kur u përmend e pa veten të veshur me xibunin e leshtë. Nën të pa një copëz nga këmisha e bardhë, prej leshi edhe ajo, që i rrinte ngjitur pas lëkurës. Mbështeti furkën në anën e majtë të kraharorit të tharë, dhe ndjeu t'i rrihte zemra e madhe e nënës. Atëherë dëgjoji krismat e pushkëve që këmbeshin shkëmb më shkëmb dhe zëra grash që thërrisnin para kasolles së saj.

– Furkë, moj e zezë, ngrehu të ikim, se po vjen Milo Çelniku me gjermanët!

– Nënë Kostandinë! Ata po vijnë!

– Furkë, moj nënë! Na ndihmo!

– O, nënë e dashur, kemi një letër për në shtab!
Ajo që i foli e fundit ishte një nuse e re, shtatzënë, me barkun gjer te goja:

– Rrugët janë zënë e asnjë s'del dot nga Gjonbardhaj.

– Ku janë burrat e djemtë e Hijasit e të Djellasit? – pyeti më në fund Kostandina, me një zë tamam prej burri të moshuar.

– Maleve, në stane, për të ndihmuar trimat tanë, – iu përgjigjën.

Kostandina mori urdhrin për shtabin dhe e vuri në furkë. Pastaj furkën e mbuloi me lëshin e bardhë të deleve rudë dhe u nis menjëherë për rrugë, malit përpjetë, siç ishte nisur sa e sa herë të tjera, me furkën mbushur me trakte, e ngulur në brez.

Eci orë të tëra shtigjive të dhive duke dredhur boshtin e lashtë e duke bërë fill.

– Ndal! – Kush je ti? – e pyetën rojat te qafa e kodrës, duke iu afruar me armët ngrehur.

– Nië çobankë! – murmuriti ajo.

– Cila çobankë?

– Furka.

– Ku vete?

– Në malet e mia...

Njëri nga rojat shkrapiti siguresën e armës. Tjetri, një nga ata të Djellasit, të Milo Çelnikut, e ndaloi.

– Lëre të vejë në diall, – tha. – Është ajo e laithitura, Furka e lagjes Hije. S'ka dhëmbë që të kafshojë.

Ata bënë edhe një shaka të rëndë për punë grash dhe Kostandina u zhduk nëpër errësirë e heshtur, e përzhitur nga urrejtja dhe e sigurt në çdo hap që hidhte.

I ajeti partizanët pas mesnate dhe ua dha letrën. Këshilli nacionalçlirimtar i Gjonbardhajt lajmëronte se një repart gjermanësh prej rreth 50 vetash dhe çeta e

Milo Çelnikut ndodheshin në lagjen Djellas dhe, sipas të dhënave të sigurta, do të hynin në Hijas. Si ta digjnin atë, do të hidheshin në fshatrat fqinje për të shkatërruar bazat e luftës dhe sidomos spitalin partizan. Në letër jepeshin të dhëna të sakta se në ç'vende ishin rojat, prej sa vetash përbëheshin ato dhe ç'armatime kishin armiqatë.

— Na ke sjellë një lajm shumë të rëndësishëm, nënë Kostandinë! — i tha komisari duke falënderuar dhe menjëherë batalioni i ndarë në kompani u nis për të rrethuar Gjonbardhajn.

Qëmtonte dëborë e imët dhe gjersa iu afruan fshatit, malet u zbardhën. Kostandina ecte së bashku me komisararin e me disa partizanë të rinj, si djemtë e saj. Për të shkurtuar udhë, i futi nëpër rrëpira, monopate e shtiaje dhish. Kur dolën te qafa e një kodre mbushur me dëllinja, tha:

— Ja ku i keni rojat.

Komisari kishte bërë një plan të mirë dhe nisi dy djem të shkathët. Ballistët kishin ftohtë, pushkët i kishin në sup dhe përplasin këmbë e duar për t'u ngrohur sado-pak. Kur djemtë u afruan, ata thirrën me një zë:

— Ndal, kush je!

— Vijmë t'ju ndërrojmë! — tha njëri nga partizanët.

— Po ç'u vonuat kaq shumë, more hajvanë! Ne ngordhëm këtu nga të ftohtët, — u ankua njëri kurse tjetrit pyeti:

— Ç'kemi andej?

— Qetësi.

Po ato krisma, ç'qenë andej matanë?

— Çobanët trembin ujqit.

Ndërkaq një skuadër partizane u doli nga prapa dhe atëherë komisari thirri:

— Hidhni armët dhe dorëzohuni!

— Daleni, ore, se mos na vrisni me të vërtetë, — tha njëri i habitur dhe i trembur duke hedhur pushkën mbi dëborë. Tjetrit ia hoqën nga supi.

Si u hap rruga partizanët hynë në Gjonbardhaj dhe ndaj të gdhirë krisi pushka brenda në lagjen Djellas. Që me krismat e para Milo Çelniku doli nga shtëpia e tij hipur mbi kalë dhe mori rrugën për nga qafa e bregores, ku kishte rojat e veta rrugën për nga qafa e tërbuar përmes plumbave. I zoti, me maliherin krahqafë, kapur fort pas jeleve, ia kishte ngulur mamuzet thellë në ijët e djersira dhe nuk shihte kërdinë që bëhej në Djellës. Te qafa e kodrës kali u tremb nga të shtënat dhe kryeballisti u gremis përtokë. Ende i shtrirë, pa, një hap para vetes, një grua veshur me xibun të zi e me një shkop në dorë. Jo, nuk ishte shkop, po një furkë e zakonshme. Bëri të ngrihej por ndjeu një dhimbje të madhe në fikhthin e fytit. Nuk arriti të thoshte asnjë fjalë dhe më kot u mundua ta hiqte me të dy duart atë armë të tmerrshme që po i hynte në gurmaz: Dhëmbët e furkës, të lëmuar dhe të mprehur nga puna e gjatë, iu ngulën si krehër shigjetash në grykë: Para se të humbte krejt ndjenjat, shtrëngoi fythin me duart e gjakosura dhe tha me habi e përçarë vetëm një fjalë, që i doli me zhurmë nga gurqullimat e gjakut:

— Furka?!

— Unë jam, — u përgjigj qetë-qetë Kostandina.

Komisari i zgjati maliherin, që kryeballistit i kishte rënë mbi dëborë, kur u gremis nga kali.

— Është maliheri i Vanit tim të vogël. Ma ka lënë amanet! — tha Kostandina me një shkëndijë drite në sy.

...Atë ditë partizanët, si e pastruan Gjonbardhajin nga armiqtë, panë te pragu i një kasolleje, në lagjen Hijas një plakë që shtrëngonte me duar një furkë e një pushkë. Me xibun të zi, me kryet e thinjur rënduar mbi njërin sup, mbështetur pak brinjazi mbi prapun e kasolles, ajo u dukej si një shqiponjë e plagosur.

Ishte ajo, Kostandina, Furka, siç i thërrisnin fshatarët.

«10 KORRIKU» nr. 11, 1979

DËSHIRA E FUNDIT

Kandili me vajguri mbi oxhak lëshonte mbi flakën e zbehtë një vijë të hollë e të gjatë tymi, si gjuhë nëpërke. Refleksat e dritës përplaseshin mbi fytyrën e plakut, që dergjej në qoshen e vatrës dhe dukej sikur i dridhej mjekra e bardhë e parruar prej ditësh. E shoqja me kryet mbi gjunjë dremiste e kapitur, por, po t'i fliste ai ose po të rënkonte sadopak, ngrihej menjëherë, i afrohej te shtrati dhe e pyeste me ankth:

– Ç'ke, Xhezar?!

Ai mezi ia shkoqiste fjalët:

– Sikur... ta kishin djemtë këtë zjarr... atje në pritë!

E shoqja e ngacmonte zjarrin dhe hidhte karthje të thata. Flaka merrte përpjetë në grykën e zezë të oxhakut dhe ajo e kuptonte se kjo ishte sëmundja e fundit e tij, e kuptonte se kjo ishte sëmundja e pleqërisë, po nuk e jepte veten.

– Si të mbaroj tashti, kur nuk mbarova atëherë? –

– thoshte Xhezari me zë të mekur dhe i kujtohej fare qartë dita kur mori plagët e para...

Edhe atëherë dimër i egër qe. Ai dhe shokët e tij luftonin me dyfekë të vjetër me gjalmë, me çifte gjahu, me sfulqe, me kërraba. Barinjtë e fshatit, edhe ai vetë, në torbat e tyre, së bashku me gjizën e bukën e misrit, kishin edhe bomba, edhe thika e plumba, luftonin trup me trup me armiqtë, u digjin kamionët dhe me urrejtje i shtrinin fashistët të përgjakur mbi hekurat e tyre, mbi tanket e shtrëmbëruara, edhe pse përbindësia të tillë metalikë s'kishin parë ndonjëherë me sy.

Xhezari lëvizi nën velenxën e leshtë dhe e shoqja i shkoi sakaq te koka. Ai pëshpëriti midis buzëve të thara:

– Më duket se më erdhi vilania, – tha duke shtuar me dëshpërim: – U vonuan djemtë!

Dhe përsëri iu kujtua ajo koha e largët partizane, kur ishte i armatosur me një nagant e me një maliher.

E gjetën befasisht në një mulli, në një natë të errët, kur kishte dyzet e tetë orë pa gjumë e pa bukë.

– Ku i ke djemtë, o Xhezar?! O gërxho matuf? – e pyetën ballistët. Xhezari mezi e mblodhi veten. E ndjeu që ishte para vdekjes. E ndjeu që u plak më shumë brenda një çasti. Po zëri i tij bëri që të mos ndihej trokashka:

– Po ja, ore, – tha me zë të lartë, – këtyre maleve i keni! Me shokët janë. Në jua mban, shkoni, vritini! Po, dhe në i vrafshi, mos kujtoni se erdhi fundi i botës. Fundi i botës është gjetiu.

I doli përpara një nga ata kapedanët e Ballit që ia kishte dëgjuar trimërinë dhe e hiqte për mik:

– E ku është fundi i botës, o çoban?

– Në shpirtin e tyre! – u përgjigj Xhezari i menduar, pa hequr vështrimin nga maliheri, mbështetur te thasët me miell.

Puna majisi menjëherë, si një plagë nga ndryshku. Ata u derdhën ta qëllonin me kondakët e dyfekëve. Xhezarit iu errësua bota. Rrëmbeu maliherin, e zbrazi sakaq e doli nëpër derë. Po, me të hyrë në jaz, një plumb i theri në krahun e majtë. Ballistët e qëllonin nga dera dhe nga dritarja e vogël e mullirit. Aty e ndjeu vdekjen fare pranë, po ai qe i fortë me trup e me shpirt.

– Qena! Mos më shponi kurrizin! Se do të më vijë turp nga djemtë! – thirri dhe zbrazi përsëri maliherin duke ndier sëmbim në zemër dhe, siç ishte, e rrëmbu jazi me shkumë të bardhë dhe e nxori në kënetë.

Të nesërmen, duke nxjerrë kokën nga guna, e pa veten midis maleve të veshura me pisha, midis partizanëve të armatosur. Brenda muajit plaga iu ëmbëlsua. iu mbyll përfundimisht. Dhe ai hyri në radhët e batalionit. Pastaj lufta u bë më e ashpër. Ditë e natë dëgjohej gjëmimi i topave. U fshinë nga faqja e dheut njerëz, kafshë, shtëpi. E mbuluan gjuhët e flakëve edhe shtëpinë e Xhezarit dhe për disa orë, në Operacionin e Dimrit, ajo u rrënuar e u bë gërmadhë dhe, për çudi, i mbeti përpjetë, mbi pìrgun e mbeturinave të shkrumburara, vetëm një copë muri dhe, mbi të, oxhaku i lartë e krejt i zi. Xhezari shpërndau atë ditë më bërryla turmën e fshatarëve e të partizanëve, i dha dorën gruas së tij që shtrëngonte në krahë birin më të vogël e që rrinte në lëmë të shtëpisë e drobitur, dhe vuri re se gjithë fshati ishte shkatërruar.

– Epo mirë, – tha. – Pastroni gërmadhat dhe ngrini kasolle! Vrasësit nuk kanë për të shkelur më këtej!

Dhe vërtet, gërmadhat u pastruan, shtëpitë u ngritën dhe që nga ai dimër i 1944-ës asnjë armik nuk shkeli më aty. Që nga ai vit, në fshat ra për herë të parë dielli, ra agimi i ditës së re, i skuqur me gjak, agimi i lirisë...

* * *

Ato ditë dhjetori të vitit 1953, Xhezari lëngonte dhe e ndiente se ky ishte lëngimi i fundit. Po ato ditë, në ato malësi kishte ardhur një grup diversantësh. Tërë fshati ishte ngritur më këmbë, i madh e i vogël. dhe djemtë e tij, i madhi tridhjetë e pesë vjeç, i mesmi njëzet e pesë dhe ai më i vogli, që e ëma e shtrëngonte në gji më 1944 e që tashti ishte mbi të gjashtëmbëdhjetat. Të gjithë kishin rrëmbyer armët e ishin derdhur pas gjurmëve të kriminelëve.

Kurse ai, Xhezari, partizan i paepur, dergjej në shtrat, i drobitur nga sëmundja, i zbardhur nga pleqëria, me një ankth në shpirt që nuk mund të vinte atje, në pritë, me të tjerët, për të vrarë armiqtë, të cilët, meqë s'e morën dot fshatin e tij e Shqipërinë e tij drejtpërdrejt, kishin vendosur ta merrnin me thika prapa shpine, me diversion, duke prerë në besë njerëzit e ndershëm në rrugët e maleve e të jetës.

Ai bëri përpjekje të ngrihej e të mbështetej në mur. E shoqja, e hollë, e gjatë, pakëz e verdhë në fytyrë nga pagjumësia, me sy të mëdhenj e të butë, e pyeti përsëri.

– Ç'ke, Xhezar?!

– Një boshllëk në zemër, – u përgjigj ai duke i shtrëguar së shoqes dorën e thatë ende të fortë. Kam frikë se do të mbaroj para se të vij në djemtë. S'kam frikë nga vdekja, jo. Atë e kam parë shumë herë. S'është gjë. Një hiçgjë është. Një gjë si buka që hamë. Kemi ardhur në jetë edhe unë, edhe ti, edhe djemtë, edhe të gjithë ata që shkuan për të asgjësuar armiqtë, që të japim jetën për liri e për vatan dhe s'ka përse të na trembë vdekja. Po dua të marr vesh si dolën, para se... para se...

Ajo e pa me sytë e saj të mëdhenj e të druajtur dhe s'diti ç't'i thoshte. E kuptoi dëlirësinë dhe trimërinë e të shoqit edhe para vdekjes së tij.

– Do të vij në! – tha duke kthyer qafën e saj të hollë herë nga një dritare, herë nga dera e herë nga hajati.

– Do të vij në!

– Hape pak atë... dritare! – përsëriti ai. – Të dëgjojmë ç'bëhet nga malet!

Asaj iu dhimbs Xhezari dhe e hapi me keqardhje se andej, nga binte dritarja, ishte veri dhe frynte erë e ftohtë dhjetori.

Dhe që nga dritarja erdhi gjëmimi i armëve. Përtej dritares ishte natë. Dukeshin malet e palëvizshme me reflekse të hirta më të bardhë nga dëborat. Xhezarit iu dëgjua një zë i largët, si jehonë që përsëritej e mbërthehej tek ajo dritare.

– Hidh bombën! Hidh bombën, gjersa nuk dorëzohen!

Iu duk se dëgjoi shpërthimin e bombës, po, meqë sytë i kishte të përgjumur e të turbullt nga një cipë e hirtë xhelatinoze, nuk dalloj asnjë dritë. Pastaj dëgjoi qartë zëra njerëzish dhe plaku shëndetlig, me shpirt në dhëmbë e aq i ndjeshëm, e dërgoi gruan në oborr për t'i sjellë dru e karthje për djemtë.

– Shko! Shko! – e urdhëroi të shoqen butë. – Shko e na sill dru dhe shih ç'bëhet andej nga malet! – Dhe me shumë mundime u ngrit nga shtrati i ngrohtë, bëri disa hapa duke u mbajtur pas murit dhe mbështeti kokën te parvazi i dritares.

Jashtë ishte një bardhësi e çuditshme. Hëna, që ai s'e shihte, se ishte mbi pullazin e shtëpisë, ndriçonte me ngjyrë të hollë, të tejdukshme e të pakapshme qiellin e kristaltë, yjet dhe dëborën rreth e rreth. Xhezari vuri veshin. Nuk shihte qartë, po për të dëgjuar, dëgjonte mirë. Kirsmat e armëve vinin nga mulliri, nga ai mulli ku ai pa për herë të parë vdekjen dhe trimërinë. Mirëpo aty, nën dritare, flisnin ca çunakë. Fëmijët ai i donte shumë, fliste me ta me dashuri dhe kishte dëshirë të madhe t'i dëgjonte.

– Tani janë te mulliri, – thoshte njeri duke kërcitur dhëmbët nga të ftohtët.

– Shko në shtëpi! – e urdhëroi më i madhi, duke folur tamam si burrë.

– S'kam njeri në shtëpi.

– Pse ku janë?

– Atje! – i kërcitën dhëmbët të voglit sikur të ishte rritur midis erës së barutit. – Luftojnë!

I madhi shau si të mëdhenjtë.

– Unë kam një revole, – tha, – do të shkoj atje! – Dhe, me sa dukej, e tërhoqi shokun e vogël dhe në çast u bë qetësi. Atëherë Xhezari dëgjoi qartë kirsmat e armëve. Atje, te mulliri, te jazi a përmbi të, në kreshtë, po zhvillohej një betejë e vërtetë, mbase si ajo e tij, vite më parë. Po tani ishte e kundërta. Tani janë një, dy, pesë

të këqinj e me qindra të mirë, me mijëra mbase. Ku do të venë të ligjtë? S'kanë ju venë! Ja, edhe sikur ndonjëri të hyjë në jaz, si Xhezari më 44-ën, ku do të vejë? Në kënetë? Po kënetë s'ka më. E ku më tej? Në male? Po atje është më pisk. Atje s'i vjen më njeri në ndihmë... Tek unë? E ku do të vijë tek unë!...

Xhezari u kujtua se ishte me këmishë të gjatë e me brekë të qjata dhe i paarmatosur. U tërhoq nga dritarja dhe, meqë s'kishte fuqi të qëndronte në këmbë, eci këmbadorasi gjer te qoshja e dhomës. Hapi kapakun e sëndukut, ku kishte reliket e tij të shenjta: maliherin, ajerdanin me fishekë, rrobat partizane, kapelën me yll dhe shallin e kuq. E hapi, i preku me duar dhe ndjeu t'i digjnin sytë nga një lëng i hidhur. Ashtu, në atë gjysmerrësirë, u vesh me mundim të madh. Mbërtheu ajerdanin, lidhi dosido shaminë e kuqe në qafë. shtrënaqi aq sa mundi maliherin dhe iu afrua përsëri dritares. Përtej saj ndihej një zhurmë e gëzueshme, sikur jeta të ishte hijeshuar me ngjyrat e zhurmat e saj të zakonshme. Në fshat, nëpër lëmeni, para shtërive, nëpër oborre, si dhe në oborrin e tij, ku, për çudi, atë mesnatë blegërinin delet e angjat, vetëtinin zjarre. Ai nuk i shihte mirë, po nga reflekset që i binin në sytë qati të verbuar, e kuptoi se ishin llambat me vajguri, të ndezura në çdo shtëpi, ishin petromakset dhe pishtarët që krijonin një dritë të tillë.

Ai s'e dinte ku ishin të afërmit e tij, djemtë e tij. S'e dinte në kishte apo jo ndonjë humbie, po u bind se ata, të huajt, të ligjtë kishin marrë fund edhe një herë, dhe iu bë zemra mal që ajatë jetës së tij nuk pati as edhe një çast të vetëm trishtimi e dëshpërimi nga ngjarie të tilla. Nuk e pati as në ato çaste të fundit të jetës së tij. Dhe, për çudi, në ato çaste nuk mendoj për fatin e tre djemve të tij, që ndiqnin armiqtë e egër...

Kur hyri e shoaja, e gjeti shtrirë në shtratin e vet, me velenxën leshtë ajer në bel. Gjoksini ia mbulonin gjerdanët. Në qafë i skuqte shamia pakëz e zbardhur nga dielli, era e shiu. Mbi flokët e bardhë, pakëz mënjanë, i binte kapela partizane me yll. Nën kapelë, fytyra e rra-

hur nga shqota. Me dorën e djathtë shtrëngonte maliherin.

– Xhezar! – klithi e shoqja me të kapërcyer pragun e derës. Zëri i saj qe i rreptë. Flokët e shpupuritur i kishin mbuluar gati të gjithë fytyrën e zbehtë, kurse sytë i qenë prerë.

– Ç'ke?! – mezi pyeti ai pa lëvizur fare.

– Të voglin na e kanë plagosur, – u përgjigj e shoqja me fytyrë të mjeruar.

– Po ata? – pyeti ai për diversantët.

– Ca u vranë!... Të tjerët u dorëzuan!...

– Ai psherëtiu me një kënaqësi, që, me gjithë gjendjen e rëndë, nuk mundi ta fshihte. Pastaj, me gjithë moshën e madhe që kishte dhe me gjithë atë djall vdekje që e kishte mbërthyer prej ditësh, ngriti pakëz kokën dhe pyeti:

– Ku e ka marrë plumbi?

– Ndën sisë, në anën e djathtë!

Plaku fryu gjoksin e gjerë kockë e lëkurë dhe, si ngriti maliherin, tha:

– Hallall i qoftë!

Fytyra e gruas mori një çehre tjetër, të butë, dhe gjithë qenia e saj i gufoi përbrenda.

Ai shtrëngoi maliherin me grushtin e tij noçkëdalë e lëkurëbardhë. Vuri gishtin në këmbëz, një gisht që dukej si çark, e drejtoi armën nga dritarja e hapur dhe e zbrazi. Së bashku me krismën, nga buzët e thara dolën dhe fjalët e tij:

– Hallall i qoftë!

E shoqja i shkoi te shtrati. E kuptoi se ai po merrte fund. Donte t'i vishte rrobat e vdekjes. Ia ngriti pak trupin, ia mbështeti kokën te jastëku i murit. Ndërkaq në dhomë hynë të bijtë, ata të dy, dhe ai i treti, i vogli, që qe i plagosur. Hynë dhe fshatarë ushtarakë dhe djem e vajza të panjohura nga fshatrat e tjera. Xhezari, duke ndierë se ç'po bënin me të, hapi pak sytë e turbullt e tha fjalët e fundit:

– Më varrosni kështu, partizan!

Dhe ashtu e varrosën, në atë dimër, nën atë dëborë të bardhë, kur mjekët ia lehtësonin plagën të birit, kur malet jehonin nga breshëritë e armëve dhe nga ortekët e dumantë, që gumëzhinin anembanë, kur armiqtë bëheshni copë-copë dhe ktheheshin në hiç!

«10 KORRIKU» nr. 12, 1977

PARTIZANI I PANJOHUR

U zgjova menjëherë prej një gjëmimi të fuqishëm e tronditës, sa m'u duk sikur tërë shtëpinë e përpiu dheu. Sytë m'i vrau drita e agimit dhe veshët m'i mbushën fishkëllimat e mprehta të plumbave dhe sokëllimat e njerëzve. Kisha rënë për të fjetur ndaj të gdhirë, i lodhur dhe i rraskapitur nga një udhëtim i largët, që nga mali i Ostrovicës, ku ne të Partisë e të Këshillit, duhej të pajtonim një gjak. I pajtuam më në fund me një mijë tela-she dhe u kthyem. Po rrugët e Ostrovicës s'janë rrugë. Ato janë rrëpira të rrezikshme, përrenj të vrullshëm dhe hone të thella. U ndava nga të tjerët dhe m'u desh të udhëtoja tetë orë në këmbë, natën, nëpër shiun që binte mbi dëborën e parë, gjersa arrita në shtëpi, kur po këndonin gjelat. Piva vetëm një gotë të vogël me raki, sa për t'u ngrohur, u sigurova se rojat e njësitit të fshatit kishin dalë në përgjim dhe rashë në shtrat i dërrmuar fare. Rakia më dha gjumë, po gjumin e bëra të turbullt. E ndieja përmes qepallave të rënduara si mekej dalngadalë flaka në vatër. Dëgjoja nëpër gjumë herë një ofshamë

fëmije, herë një hingëllimë kali, herë një këngë që më vinte nga shumë larg. Pastaj, nëpër terr m'u bë një trok kuajsh, një urim, një fjalë e mirë për Partinë e për Këshillin. Flisnim njëherësh ne dhe ata që do të pajtohehin. Pastaj biseda u bë më e shkoqitur. «A jeni me luftën, ju, o shokë të Ostrovicës?» «Jemi» «Jo! Nuk jeni! Kështu si bëni ju, duke u vrarë kot vëlla me vëlla, do ta humbni luftën!» «Jo! Nuk humbim!» «Do ta humbni, po nuk hoqët dorë nga hasmëritë dhe gjaqet», «Ja, po pajtohemi, si thotë Partia, po pimë gjakun e njëri-tjetrit dhe po bëhemi vëllezër!» «Kështu, po, jeni në rrugë të drejtë. Të rrojë Partia!» «Parti u bëftë gjithë bota!»... Mora naganatin dhe e zbraza duke thirrur: «Kemi një jetë, një shpirt e një vatan! Jemi vëllezër! Të gjithë të Partisë!» Atëherë të gjithë u përqaftuan, dhe një i ri nga fshati rrëmbeu armën e shtiu në dritare. Të lehtësuar nga ankthi i zakonit të vjetër e barbar që kishte fikur sa e sa shtëpi e jetë njerëzish, me gjithë zinë e madhe që kishte pllakosur vendin, pimë raki, hëngrëm mish të pjekur që na e sollën gratë, të cilat fluturonin nga gëzimi, hodhëm valle të zënë dorë për dorë dhe kënduam kokë më kokë e të përqaftuar me njëri-tjetrin... Le të ishte luftë, le të frynin erërat e Ostrovicës, le të uturin pyjet, le të uturin pyjet, le të ishte e gjatë rruga e mundimeve dhe le të na binin mbi sharqe pluhuri i barutit dhe plumbat e lirisë! Ne kishim lidhur besën e madhe të vëllamërisë, besën e madhe të shqiptarëve!...

Të gjitha këto, pakëz të shpërfytyruara e copa-copa, po të vërteta e të gjalla, po i shihja në gjumin e parëhatshëm, kur më zgjuan gjëmimi i predhave dhe sokëllima e njerëzve.

I veshur siç isha, me setër e me opinga lëkure, ashtu siç flija çdo natë, që kur hyri gjermani, rrëmbeva pushkën e gjatë, lidha gjerdanin në ecje e sipër dhe dola menjëherë në oborr.

Frynte erë dhe binin ca pika shiu të imëta si miell, të cilat përplaseshin ku mundnin, dhe strehët e çative vajtonin pikë-pikë në enë dhe kaskat e ndryshkura italia-

ne që gratë i kishin vënë për të grumbulluar ujin për të larë këmishët dhe leshin e dhive e të deleve, sepse thoshin se uji i shiut i lante mirë.

Ishte më të hyrë të dhjetori, malet qenë mbuluar me mjegull të dendur dhe nuk shquheshin mirë. Çdo gjë, ajri i ftohtë, macja që lëpihej pranë vatrës, drurët e pemëve si dhe mornicat që na kalonin në kurriz, tregonin qartë dimrin.

Me të dalë në oborr, thirra:

– Ç'bëhet?! – Ç'po ngjet?! Kush qëllon?!

– Nuk pashë as njerëz e as kafshë. S'ndihej asgjë, as kokorisja e shpendëve shtëpiakë. Fshati m'u duk i heshtur e memec. Lart qielli i vrenjtur vesonte në qetësi. Poshtë toka e lagur, e mardhur. Dyshova se mos isha në ëndërr, po papritur dëgjova qartë të thirrura burrash, hapa që nxitonin drejt pyllit dhe lehje qensh. Kali që kisha lidhur te gardhi, turfulloi e hingëlliu, me veshët bigë përpjetë, i trembur, gati për të këputur litarët e për të vrapuar nga sytë këmbët.

Dy djem të shëndoshë kaluan përpara shtëpisë, njëri me patickë e tjetri me sëpatë në duar. Rëndnin sa u hartin këmbët, të lehtë e të shpejtë si sorkadhe.

– More djem! Ç'bëhet? – pyeta pa arritur t'u shihja fytyrat.

Ata s'më dëgjuan e s'm'u përgjigjën. Kur dola në rrugicë, kishin firasur. S'pata kohë të pyesja e të mençoja më gjatë. Në pyllin mbi fshat kërcisnin pushkët.

«Gjermanët – thashë i tronditur. – Si na erdhën derrat gjer këtu?! Po rojat tona? Ç'bëjnë shokët e njësitit? Oburra, o Hodo!» – i thashë vetes gati me zë dhe mora përpjetë pyllit për te shokët.

Pylli fillonte buzë shtëpisë sime. Kapërceje selishtën dhe bije menjëherë në pyll. E kisha mbjellë me grurë, po bëri një ngricë e parakohshme atë vit dhe gruri s'ishte rritur. Rrinte me ditë, ashtu, me rrënjët në baltë dhe s'ngrinte krye. Paska shkrirë ngrica, dreqi e mori! – mendova duke zhytur opingat në baltë, se i rashë arës mes për mes.

Pyllin e kisha shkelur cep më cep që kur isha ende i vogël dhe veja atje për të kullotur dhitë. Ia dija të gjitha shtigjet, ku mund të kaloje lehtë, ku mund të mbeteshe midis gjembave të hidhur që të grisnin e të gjakosnin pa mëshirë dhe ku mund të pije ujë në burimet e freskëta.

Hijet e drurëve ishin ende të gjata dhe thellë nëpër pyll krismat e pushkëve reshtën.

Vrapova midis drurëve të dendur, midis dushqeve e murrizave dhe qëndrova te një shkëmb prej shtufi, në këmbët e të cilit, midis fletëve të zverdhura të lajthive, gurgullonte një ujë i kulluar burimi. Pak më poshtë, aty ku fillonte honi që mbaronte përfund përroit, veshur me rrape shumë të moçme, një hon disi i frikshëm dhe tërë fshehtësira, ku s'kishte shkelur asnjë këmbë bariu dhe, domosdo, as unë, pashë dy gjermanë të vrarë. Dergjeshin pranë pellgores me ujë, tërë baltë në fytyrë, në gojë, në vrimëzat e hundës dhe gjaku, që porsa ishte mpiksur, kishte bërë barin, ujin, shtufin dhe baltën si një njollë të madhe të murrëtyer e të pështirë...

Mugëtira e mëngjesit u shpërnda. Vetëm thellë, nëpër skutat e ftohta të përroit, nëpër guvat e honit dhe nëpër gropat e fshehta, të mbuluara me shkurre si mur, regëtinte ende errësira. Shiu, që natyrës i jepte zymtësi dhe shpirtit trishtim, pushoi. Një turmë fshatarësh doli nga pylli në atë copë lëndinë të blertë rrethuar nga drurët. I njihja të gjithë, burrat, gratë, djemtë e vajzat. Dolën nga pylli me fytyra të dhembura dhe, me të më parë, i prenë fjalët. Erdhën drejt meje me një vig që e mbanin në supe. Vigu ishte prej gunash e degësh të forta thane nga pylli ynë. Në krye të vigur ishte Hajdari, përgjegjësi i njësitit të fshatit, me atë fytyrën e tij të përhimë, sikur ia kishte mbuluar tymi i barutit.

— Kush u vra? — pyeta i tronditur, pa e dhënë veten.

Asnjeri nuk m'u përgjigj...

Ë ulën vigun pranë shtufit, ku gurgullonte uji i kulluar i burimit. Hajdari, i ndezur në fytyrë, vështroi gjermanët e vrarë, futi kokën në burim, piu ujë dhe, ashtu shtrirë siç qe, duke i rrjedhur pikat nga goja, tha:

– Gjer te përroi gjetëm shtatë gjermanë të vrarë. Me këta të dy bëhen nëntë. Ka qenë ndonjë skuadër zbulimi që gjeti vdekjen. Katër i asgjësoi njësitë...

– Po ai në vig, kush është? – pyeta, duke e fshehur dhembjen përbrenda.

Në vig rrinte shtrirë një djalosh i gjatë, me leshra e vetulla si kashtë. Sytë i mbante të mbyllur dhe qepallat e përzhitur nga baruti i bënin hije gati gjer te mollëzat e faqeve, që porsa u kishte hequr briskun e parë. Në qafë mbante një shami të kuqe, lidhur nyjë nën gushë. Nuk kishte gjerdanë. Megjithëse dukej përsëri si i mbërthyer me gjerdanë, stofin e xhaketës së zbardhur në ato vende, nuk e kishte zënë dielli. Bile, në xhaketë shquhej edhe hija e dhëmbëzave që kishin lënë ballët e fishekëve. Armët, gjerdanin, belgjikun dhe nagantin, Hajdari ia kishte vënë në krahun e majtë, të cilin ia kishte larë gjaku i freskët nga supi gjer te gishtërinjtë. Një yll i kuq fekste në kapelën që ia kishin vënë mbi gjoks. Dukej sikur flinte i lodhur nga ndonjë rrugë e gjatë. Dukej, sikur po t'i flisje, do të largonte menjëherë gunat, do të ngrihej drejt e në këmbë dhe do të thoshte duke rrëmbyer belgjikun: «Gjallë jam, o shokë! Vetëm se dremita pak!»

– Ku e gjetët? – pyeta duke ia përkëdhelur flokët e rënduar nga shiu.

– Thellë në pyll, mbi një gjerman të vrarë. E gjetëm me revole në dorë, duke hequr shpirt. Na tha diçka, po s'ia morëm vesh. Na mbaroi ndër duar, – u përgjigj Hadjari duke fshirë buzët me mëngën e fanellës prej lesh dhie.

Mua m'u ndez fytyra, sikur e futa midis hithrave. U largova disa hapa dhe u ktheva përsëri nga vigu, duke u penguar në pushkën e gjatë e në mollosët që më ndiqnin pas, duke u zvarritur. Të gjithë fshatarët, burra e djem, shumica të armatosur, u afruan te vigu dhe e rrethuan. Heshtjen e madhe që pillakosi papritur e çau një ligjërim i mbytur gruaje.

– Kush qan? – pyeta duke parë nga maja e shkëmbit gratë, mbledhur mënjanë, pakëz larg vigut.

Ligjërimi u zgjat edhe pak dhe, papritur, u ndërpre, sikur e përpiu pylli i dendur, që na rrethonte nga të katër anët.

Midis hapësirës së qetë dhe boshe filloi të grindej një grifshë.

– Vrijeni atë zog të mallkuar! – thirra.

Pas pak u dëgjua një krismë e pasuar nga një zë:

– E vrava, Hodo!

– Kush qan? – pyeta për të dytën herë dhe në hesh-tjen e madhe ndjeva vetëm fëshfëritjen e erës që m'u ngatërrua midis flokëve të paqethur prej kohësh. Pastaj u ndërpre edhe era dhe pyllin e mbuloi një heshtje e rëndë, e përzishme, sikur të gjithë zogjtë e shumtë të kishin ngrirë në çast.

E pashë përsëri djaloshin në vig dhe iu drejtova Hajdarit:

– Sa gjermanë vratë ju të njësitit?

– Katër, o Hodo...

– Po të tjerët?

– I ka vrarë ai, – u përgjigj Hajdari, duke u munduar të ndizte eshkën me masat.

– Nga e di ti?

– S'kam nevojë ta di. Tregon vetë.

Unë mora belgjikun e djaloshit dhe e vura syrin te tyta. Pushka porsa ishte zbrazur. Në të kishte grimca baruti të porsadjegur. Mbante erë luftë.

Nuk e kisha parë asnjëherë atë djalë të ri. Kisha parë shumë njerëz, po atë jo. Njihja komisarë, komandantë, kryetarë e anëtarë këshillash, përgjegjës të Rinisë Komuniste që punonin në terren, të deleguar nga Veriu e nga Jugu, shokë të Qarkorit tonë, të Komandës së Vendit, bile edhe shokë të shtabit të Përgjithshëm. Po atë s'e kisha parë kurrë, asnjëherë, në asnjë vend. Shëmbëlente pak me atë Dulkën, trimin e Hodos, që na e degdisën fashistët në burgjet e Italisë. Po Dulka ishte i shkurtër, një pëllëmbë mbi dhé, kurse këtij i dilnin këmbët një pëllëmbë jashtë vigut të gjatë... Kush të

ishte ky djalë i ri, nga na vinte ky partizan që kishte
vrrarë pesë gjermanë dhe me ç'porosi ishte ngarkuar?

– E kontrollove, o Hajdar?

– Po, – u përgjigj Hajdari.

– I gjete gjë?

– Belgjikun, fishekët, revolen dhe një copë koromane
misril!

Unë u zgjata mbi sopin prej shtufi dhe thirra:

– A e njuh ndonjëri nga ju këtë djalosh? A e ka
parë ndonjëri nga ju? Zëri im qe i fuqishëm, si sokëllimë.
Jehoi grykë më grykë e mal më mal. S'm'u përgjigj njeri.
– A e njuh kush? – bërtita përsëri dhe, si pushoi je-
hona e zgjatur në kurorën e maleve, dëgjova përsëri
atë ligjërim të dhimbsur, të hidhur dhe heroik të njërës
prej grave tona.

– Po afrohuni dhe shikojeni! Shikojeni me kujdes!
Shikojeni mirë! Se, mbase e njihni! Shikojeni, o vëlle-
zër, një për një! Edhe ju, o motra! Afrohuni dhe shi-
kujeni djalin! Shikojeni mirë trimin!

Më parë u afruan burrat grupe-grupe me hapin e
tyre të rëndë të malësorit. Hoqën qeleshet e bardha
dhe për një kohë të gjatë qëndruan para vigut kryezbu-
luar. Hajdari i zbërtheu kopsat dhe i hapi grykën djalo-
shit se mos shihnin ndonjë shenjë në gjoksin e tij të
bardhë qumësht, që s'ia kishte parë dielli kurrë. Nën
sisën e majtë ai kishte vetëm nishanin e plumbit, dhe
poshtë tij një curril gjaku i freskët, i hollë, i brishtë, që
i kishte rrjedhur pak më parë.

Burrat qëndronin një copëz herë para tij të vrenjtur.
tundnin rëndë kryet, diçka pëshpërisnin me dhembje, da-
shuri e urrejtje përzier dhe ua linin vendin të tjerëve, duke
u larguar në heshtje.

Nuk e njihnin! S'e kishin parë kurrë!

U afrua grupi tjetër. Edhe ata ishin burra të rreptë,
me fytyrë të ruda, si të lëruara, e me plagë. U afruan
edhe djem të rinj, të pashëm, shtatlartë, vetullprerë e
me sy shqiponjë. Nderuan me grusht dhe ua lanë
radhën të tjerëve.

Nuk e njihnin! S'e kishin parë kurrë!

Një fshatar plak, më plaku i të gjithëve, plaku Meçe, qëndroi më gjatë përpara vigut. Ishte burrë i shkurtër e i kërrusur, po mbahej në këmbët e tij, pa shkop. Thuri më nge një cigare të trashë me letër gazete, e ndezi me uror, e thithi dy-tri herë gjersa doli tymi dhe ia vuri djaloshit midis gishtërinjve, në dorën e djathtë, që e kishte të shëndoshë. Nuk tha asnjë fjalë dhe ashtu i heshtur, vetullngrysur dhe i kërrusur, u largua ngadalë-ngadalë, siç kishte ardhur. Nuk e njihte plaku Meçe! S'e kishte parë kurrë!

Pastaj u erdhi radha grave. Ato ngurruan në fillim. Pastaj çau e para turmën një vajzë e re, e brishtë. Ndjeva që pylli murmuriti. Nga ecja e njoha që ishte ime bijë, Hajria, çupa ime e vogël, e pamartuar. Mbeta majë sopit, i trishtuar, me një ndjenjë dhimbjeje të madhe që më sëmboi në lukth, kur e pashë që i vuri djalit midis buzëve pakëz të hapura një lule marajthe, erëmirë dhe çuditërisht të freskët.

Mbi turmën e grave përsëri fluturoi një ligjërim. Fjalët s'i kuptoheshin, se ligjërimi që i heshtur, po ishte i hidhur, shumë i hidhur dhe i përvajshëm, sa edhe mua m'u këput shpirti.

Hajria qëndroi përpara djaloshit duke nderuar me grusht gjersa u ndërpre ligjërimi. Pastaj më vështroi me sytë e përlotur dhe më tha:

— Nuk e njoh! S'e kam parë kurrë, baba!

Për një çast e humba mendjen dhe s'dija si të veproja. Kush ishte ai partizan i ri, që shtrihej në vig para nesh? Ishte varër në nahijen tonë, në pyllin tonë, mbi fshat dhe kishte kopanisur pesë gjermanë. Dhe asnjëri s'e kishte parë ndonjëherë, asnjëri s'e njihte, as unë, as Hajdari, as ime bijë, as Meçe njëqindvjeçari, më i moçmi nga ne të gjithë, që i vuri cigaren e ndezur midis gishtërinjve. S'dija ç'të bëja më. E pashë edhe një herë djaloshin, ia pashë leshrat si kashtë, gjoksin e bardhë, armët dhe thirra:

— Po, si është e mundur, të mos e njohë asnjë nga ne, kur ai u vra për fshatin tonë?!

Mbi turmën e grave u ngrit edhe njëherë ligjërimi i hidhur.

— Kush qan? — pyeta me ngulm.

Hajdari më kuptoi që kisha lajthitur, më nduku nga sharku e më tha me zë të rëndë e të mbytur:

— Hodo! Po partizan është trimi! Ç'pyet kaq shumë? Shoku ynë e djali ynë është! Ta ngremë e ta varrosim me nder!

— Jo! — kundërshtova. Prisni pak! Kemi kohë për ta varrosur me nder! Nisuni, ore djem, në Komandën e Vendit dhe në shtabin e qarkut dhe lajmëroni që të vijnë e ta shohi këtë trim!

Më ishin vrarë edhe shokë të tjerë, të dashur shumë, të njohur nga farefisi, bile edhe im vëlla, i ndjeri Sali. Më ishin vrarë shumë. E kisha parë edhe vdekjen time në sy kushedhi sa herë! Po ai djalosh në vig, ma këputi shpirtin fare.

Pasdite erdhën nga Komanda e Vendit dhe nga shtabi i qarkut shokë që kishin kohë që punonin e luftonin në anët tona.

Nuk e njohën as ata! Nuk e kishin parë kurrë as ata!

Kaloi edhe një batalion i një brigade të Jugut. Partizanët shtinë një breshëri armësh për nder të të rënit, kënduan këngën «Hakmarrje» dhe ikën në luftime.

As ata nuk e njohën! As ata nuk e kishin parë kurrë! Më në fund e vendosëm.

— Epo, meqë është biri ynë dhe meqë u vra për fshatin tonë, le ta varrosim këtu, te ky shtuf, se shtufi e mbron dhe nuk e prish shpejt! — thashë unë i ngrysur e me dhembje të madhe.

U ula mbi shkëmb. Hajdari më zgjati një cigare të ndezur, e thitha gjer thellë në mushkëri dhe atëherë pashë si u vërsulën gratë, ndërsa djemtë hapnin gropën.

E para doli e shoqja e Hajdarit, një devollite nga Progri, veshur me fustan të zi të gjatë, me një shami të bardhë që i mbulonte kokën dhe faqet.

– Bir, o bir! Dulkë, o bir! – filloi ajo të ligjëronte mbi trupin e partizanit. – Dulkë, o trim!

Atëherë e kuptova nga zëri se ishte ajo që kishte ligjëruar disa herë dhe unë, zemërplasuri, nuk e kisha njohur.

Doli devollitja përpara gjithë grave dhe, me ligjërime të dhimbshme e heroike, të lashta sa bota, filloi ta ormiste partizanin e ri flokëkashtë. Nuk i la të tjerat ta ngatërronin. Duke ligjëruar dhe duke e puthur në duar, në ballë, në sy e në plagë, ia vuri kapelën me yll në flokët e rënduar nga shiu, i lidhi gjerdanin, i kopsiti gjoksin dhe e stolisi me lule.

– Dulkë, o Dulkë! Dulkë, o trim! – jehonte pylli.

Re të zeza zunë qiellin. Pylli u nxi, ndërroi ngjyrë dhe u bë i mistershëm. Malet u mbuluan krejt dhe filloi të vesonte përsëri. Po afronte edhe nata, që kishte filluar të endej poshtë përrenjve, e honeve duke u ngjitur lart e më lart.

Koha bënte punën e vet. Derdhte shi. Rrëzonte gjethe. Thërrmonte shtufin dhe bluante grurin...

Hajdari pinte duhan, i ngrysur, pranë meje, ulur mbi shkëmbin e shtuftë. Edhe plaku Meçe pinte duhan, i heshur duke numëruar tespjet prej farash ulliri. Unë mendoja për Dulkën, djalin e Hajdarit e të asaj devollitjeje trime. E kisha korrier që kur formuam Këshillin Nacional-çlirimtar. Po fashistët na e kapën me tradhti, të plagosur. E shpunë në Korçë. Pastaj në Tiranë, pastaj në burgjet e Italisë. Italia kapitulloi në shtator të vitit 1943. Dulka s'u kthye më. Ata që u kthyen treguan se Dulkën e kishin hedhur fashistët në një varr të përbashkët me shumë patriotë të tjerë. Varri ishte buzë detit, në një ishull të shkretë, buzë dallgëve e furtunës!...

U përmenda nga breshëria e armëve të njësitit tonë. Djalin e kishin varrosur me nderimet e luftës. Ajo, devollitja, fërkonte me pëllëmbë gurin prej shtufi që i kishin vënë partizanët te koka dhe ligjëronte me gjysmë zëri:

– Bir, o bir! Do të flesh këtu tashti! Për tërë jetën! Pranë burimit!... Pranë nënës!

Hajdari u ngrit, ngjeshi me
dhe i bëri zë së shoqes. Gruaja
sy ende të përlotur, ku shkëlqen
me mbytka dhe me krenari:

– I ngjan shumë Dulkës,
të mos i ngjante, djali im ësh
ligjëroj tërë jetën për të!

riperëndimit, në-
nta, duke lënë
eri të qytetit.
dhe trupat
eria, tan-
të së-
rsa u
lojet
an

NATA E FUNDIT

Porsa kishte filluar vjeshta e dytë e vitit 1944, vjeshta me horizontet gri me mjegullat e bardha e të qeta, me kalldrëmet përherë të lagura, me erërat e ftohta që paralajmëronin dimrin dhe me krismat e luftës së madhe që ishte në mbarim e sipër.

Qyteti, me të vetmin bulevard, që shtrihej nga jugu në veri, dhe me rrugët e shumta shtruar me kalldrëm, ziente nga lëvizjet, nga zhurmat e vazhdueshme dhe nga krismat e armëve në periferi të tij.

Repartet e brigadës partizane, që me sulmin e parë, çliruan kazermat e xhenjos, spitalin, shkollën qytetëse dhe maternitetin, që ishin rrëzë kodrës, nga ana e lindjes, dhe gjermanët i kishin kthyer në pika të forta mbrojtjeje. Në mëngjes dolën në qendër të qytetit dhe pushtuan ndërtesat kryesore zyrtare: ish-bashkinë, ish-prefekturën, hotelin e madh, postën dhe komandaturën, ku armiqtë rezistuan me shpirt ndër dhëmbë gjer në mbrëmje. Të nesërmen u hap banka dhe, megjithëse, nuk u gjet asnjë monedhë me vlerë dhe asnjë shenjë floriri, u vulosën kassafortat, u mbyllën dyert me çelës dhe u vunë roja të forta.

Gjermanët u tërhoqën natën drejt veriperëndimit, nëpër rrugën që e ruanin me forca të shumta, duke lënë praparojë një repart granatierësh në periferi të qytetit. Ata ikën me shpejtësi dhe me njëfarë paniku dhe trupat e tyre të motorizuara, makinat me ushtarë, artilieria, tanket, autobлиндat, motoçikletat dukeshin si qenie të sëmura që i ka zënë ngërçi. Gjatë tërë rrugës, gjersa u larguan nga qyteti, qëllonin vazhdimisht me të tëra llojet e armëve. Predhat binin kuturu dhe partizanët e kuptuan se kjo ishte vetëm një manovër e vonuar psikologjike, pa asnjë efekt. Sidoqoftë, asnjë nga luftëtarët shqiptarë nuk besonte se kolona do të arrinte gjer në Berlin. Përpara rrugët ishin prerë nga mijëra e mijëra partizanë dhe nga populli i qmatosur, prandaj kolona nuk do të arrinte as në kufijtë veriorë të Shqipërisë. Ishte e qartë që kjo pjesë e trupit të Rajhut do të varrosej këtu.

Që një javë më parë kishte filluar largimi i feudallëve dhe borgjezëve të mëdhenj, të cilët s'kishin ndënjur asnjans në luftë. Të tjerë kishin ikur që në vjeshtën e parë, duke marrë me vete çdo gjë me vlerë që kishin në pallatet e tyre. Disa familje qëndruan duke shpresuar se gjendja do të ndryshonte. Po, me të ndier sulmin partizan mbi qytet, u turrën drejt veriperëndimit. Ca u qepën pas gjermanëve, i paguan mirë me florinj dhe e siguruan largimin. Ca të tjerë vrapuan te agjencia private «Z.A.», po aty ishte vetëm një autobus i vogël, prandaj krisi sherri, kush e kush të hynte më parë. U përfolën, u pështynë, u zunë civilë, ushtarakë, dama të parfumura, ngarkuar me valixhe e me çanta të rënda. Kishte midis tyre tregtarë të mëdhenj, zyrtarë të lartë, ish-gjerrarkë, komandantë Balli, politikanë të regjur, spiunë me damkë, të gjithë tregtarë flamurësh. Po makina ishte e vogël dhe vetëm një pjesë mundi të hipte. Atëherë, ata që ngelën, u kthyen nëpër shtëpitë me shpresa të humbura, duke pritur me ankth se ç'do të bëhej me ta, kur të çlirohej qyteti.

Kurse qyteti, megjithëse në periferi të tij luftohej, ziente. Nëpër rrugët e sheshet ishin përzier popull, partizanë,

anëtarë të këshillave nacionalçlirimtare e të njësiteve guerrile, fshatarë nga katundet e afërme, të rinj antifashistë, anëtarë të Partisë, burra, gra, fëmijë, të mosshuar. Pastronin rrugët nga rënojat, nga bunkerët e shkatërruar, nga triçiklet e karrot e braktisura, nga shtyllat e rrënuara, nga telat e elektrikut. Me tezga e karroca po hiqeshin nga sheshi qendror dhe nga shkallët e komandaturës kufomat e gjermanëve të vrarë dhe kuajt, gjithashtu të vrarë e të fryrë nga asfiksia. Xhenierët e ustallarët po ndreqnin urën që gjermanët e dogjën, kur ikën, po hiqnin minat që armiqtë i kishin vënë për të hedhur në erë ndërtesat qendrore dhe po mbledhnin me kujdes bombat e paplasura.

Komisar Irakliu, duke ecur me hap të shpejtë, veshur me kapotë gjermane tanimë të vjetruar, me automatik në dorë, vinte re gjurmët e zinxhirëve të tankeve dhe fëmijët që hiqnin tabelat e ndërtesave zyrtare dhe të rrugëve që tregonin në gjuhë të huaj drejtimin e qyteteve të Shqipërisë. Fëmijët ishin të gëzuar. I flaknin nga lart me brohorima. Tabelat binin përtokë. Të tjerët i shtypnin me këmbë dhe i deformonin. Ashtu, të thyera, nën shi, dukeshin si gjëra pa vlerë, që kishin mbetur nga një kohë e vjetër, shumë e largët.

Me të hyrë në zyrat e shtabit të brigadës, komisar Irakliut iu kujtua intendentit dhe lajmëroi të vinte menjëherë.

Shtëpia ku ishte vendosur shtabi, ishte plot me partizanë e civilë, në të dy katet. Shtëpia e madhe ishte krejt pa mobilie e orendi. Pronari, një borgjez pasanik, kishte ikur një muaj më parë, duke e lënë shtëpinë krejt bosh. Tashti nëpër dhomat e korridoret kishte stola të thjeshtë prej dërrase, ndonjë tryezë dhe ndonjë raft, të thjeshtë edhe ata. Nëpër mure e nëpër dorezat e dritareve ishin varur pajimet luftarake, gjerdanë, pushkë, çanta e torba dhe qosheve e mbi dysheme kishte batanije, pallto ushtarake dhe ndonjë gunë, me të cilat mbuloheshin partizanët, kur binin për të fjetur.

Intendent Raqi arriti në shtab pikërisht kur komisari

i brigadës, së bashku me kryetarin e këshillit Nacional-çlirimtar të qytetit, Avni Plakun, porsa kishte dalë për të kontrolluar mensën e fëmijëve të dëshmorëve dhe asistencën sociale, që ishte hapur atë mëngjes për jetimët dhe për pleqtë që kishin mbetur mos më keq, pa asnjë përkrahje, pa strehë dhe pa bukë nga mizoritë e armiqve.

Meqë nuk e gjeti komisarin në shtab, u ul në shkallinën përpara hyrjes, nën strehë, për ta pritur, i dërmuar nga lodhja. Dëgjonte shiun që rridhte nëpër ullukët e strehëve, dhe ndiente se, po në atë mënyrë, i vërshonte edhe gjaku nëpër trup. Mbështjellë me kapotën ushtarake dukej sikur dremiste. Kishte që në orën katër të mëngjesit që bridhte në këmbë lagje më lagje, për të gjetur ushqime e veshmbathje për partizanët që luftonin ende, diku afër në periferi të qytetit, për të plagosurit, për jetimët e për pleqtë.

Sahati i madh pranë kishës ra katër herë. Intendenti u përmend nga tingujt e fortë dhe mendoi se kishte plot dymbëdhjetë orë që bridhte, pa pushuar në asnjë vend dhe pa futur gjë në gojë veç duhanit.

Aty, nën strehë, qëndronte roja, një partizan i ri, i zeshkët, me mustaqe të mëdha dhe i paqethur prej muajsh.

— Mos u mërzit, shoku Raqi! Do të vijë shpejt komisari, — tha roja buzagaz, duke mos e shqiptuar mirë fjalën komisar. — Ka shkuar në mensën e fëmijëve dhe në asistencë.

Një karrocë me dy rrota të mëdha, e tërhequr nga një kalë çil kockë e lëkurë, qëndroi përpara kangjellave që rrethonin kopshtin. Karrocieri, një burrë i zyrtë, gjysmë civil e gjysmë partizan, i foli kalit dhe, si hoqi nga supet batanijen e qullur, zbriti me përtim, me pushkë në sup. Përshëndeti me grusht dhe u'ul më krah të intendentit, në shkallinë, nën strehën e gjerë.

— U lodhe, o Malkë? — e pyeti Raqi duke iu marrë goja te shkronja «m».

Karrocieri bëri një lëvizje të dëshpëruar të kokës dhe nuk u përgjigj. Nxori qesen prej lëkure dhe filloi të dridhte një cigare.

Edhe ti komisarin do, o shok? — e pyeti roja gjithnjë buzagaz, sikur e qeshura e tij të ishte një tipar që nga dita që kishte parë jetën me sy.

— Më ka kërkuar urgjent, — tha Malka.

— Vjen komisari, vjen.

Ullukët dhe strehët rridhnin duke kërcitur. Vijat e ujit dredhonin anës gurëve të kalldrëmit, të turbullta. Shiu i imët binte mbi kalimtarët e shumtë që vraponin të zënë me punë, mbi flokët e tyre, mbi vetullat e qepallat. Binte mbi mendimet e Raqit, të Malkës e të rojës partizane.

— Mot i keq! — tha djali i zeshkët duke fshirë me pëllëmbë tytën e pushkës. — Do të laget përsëri komisari.

Ata të dy ulur në shkallinë, pinin duhan, të mërzitur.

— Hë, o Malkë! Bëre gjë? — e prishi heshtjen intendent, duke iu marrë goja keq.

— S'japin me të mirë, — u përgjigj karrocieri, pa hequr cigaren e trashë nga goja. — U ka mbirë në majë të gjuhës: s'kemi, na i mori gjermani, na i prishi lufta, u batërdisë, kështu thonë, nga të tri palët, nga i huaji, nga balli, nga Nacionalçlirimtarja. I marrtë dreqi, i marrtë! Të babëziturit! Plot i kanë hambarët. Po duhet ligji i ri: o miellin e florinjte, o burgun e plumbin! Zgjidh e merr! Të shohësh ti pastaj... Po ne jemi të butë, o shoku Raqi, shumë të butë.

Psherëtiu hidhur. Thithi cigaren fort dhe maja e saj e ndezur lëshoi xixa. Atëherë, nëpër shiun e imët u duk si një njeri me tre sy.

Roja, që e dëgjonte me vëmendje, po që donte edhe muhabet, e pyeti:

— Në ç'batalion të brigadës je ti, o shok?

— Jam në njësitin guerril të qytetit, — u përgjigj karrocieri.

— I thonë Malkë Arabaja këtij, — shpjegoi intendent Raqi, — E ke dëgjuar ndonjëherë emrin e tij?

— A, ti je Malkë Arabaja? Më ka treguar komisari për ty. Ti je ai Malka që i pe lupeditoskanët duke luajtur me top buke, dhe the «e humbën luftën» dhe pastaj i bëre të

dhiteshin në brekë, kur u vure zjarrin kazermave, – qeshi roja me zë, duke e përqafuar me të dyja duart.

Nga kjo sjellje e çiltër dhe e përzemërt e një partizani të panjohur, Malkës i vërsjuan kujtimet e ëmbla e të hidhura njëkohësisht që i flinin në shpirt dhe s'i kishte harruar. Iu kujtuan kohët kur bridhte me araba tërë ditën për të siguruar jetën e familjes së madhe, kur u lidh me komunistët, hyri në njësitin guerril, bëri aksione të guximshme dhe transportoi materiale luftarake me karrocë nga qyteti në mal. Po kjo ishte e kaluara. Atë pasdite me ajër të qullur, kur era rrëzonte nga drurët gjethet e para, Malkën e brente mendimi se nuk po siguronte dot bukë për ata fëmijët jetimë, prindërit e të cilëve ranë maleve për liri, për ata të moshuarit, që u përvëluan e mbetën kërcurë, për partizanët e plagosur, për ata që lindnin në maternitet, për shokët e tij që luftonin e vriteshin ende në periferi të qytetit. Ata biseduan shtruar, duke kujtuar të kaluarën, që ishte e dhimbshme e tërë tronditje, po edhe e madhërishtme dhe heroike, dhe dolën përsëri te halli i madh: te buka, tek ushqimi, te veshmbathja.

– Erdhi komisar! – tha roja buzagaz, duke u bërë gati për të nderuar me grusht.

Intendenti dhe Malka u ngritën dhe i dolën përpara. Ai po vinte me hap të shpejtë, së bashku me kryetarin e Këshillit, Avni Plakun, që mezi e ndiqte, se ishte shumë më i madh në moshë, mbi të pesëdhjetat, me flokë të përgjysmuar, me ballë të lartë e syze mbi hundën pakëz me kurriz. Komisar Irakliu i vështroi me vëmendje, me një vështrim pyetës, prej njeriu politik dhe, nga mënyra se si ata të dy lëvizën supet, e kuptoi që punët nuk po shkonin mirë.

Raqi kishte dy ditë që s'e kishte parë komisar Irakliun. Gjatë atyre dy ditëve komisar i ishte holluar edhe më shumë se ç'qe. Në trupin e gjatë, pa dhjamë, rrobat i dukeshin si të varura në një kremastar, në një skelet. Ishte pa ngrënë, i lodhur e i raskapitur. Vetëm sytë e zinj e të mëdhenj i kishte tërë gjallëri, tërë zjarr. I dëgjoji me vëmendje, shkopsiti pallton dhe u tha në ecje e sipër:

– Ejani brenda, se këtu u bëmë qull!

Zyra e shtabit s'ishte gjë tjetër, veçse një dhomë e madhe, me dy mindere, me një dritare pa perde, me një tryezë, ku ishte telefoni i instaluar ato ditë dhe me ca libra në një dollap të vjetër. Vetëm nga abazhuri i madh, i kristaltë, me dhjetë portallamba, të cilin e kishte harruar pronari, e kuptoje se ç'mrekulli do të kishte pasur në atë dhomë.

– Këtë që më thua, unë e di shoku Raqi, – tha komisari pa u ulur. – Puna është që ne të bëjmë çmos për të përmbysur këtë situatë. Andej, në periferi, puna merr fund sonte. Granatierët gjermanë i kemi futur në jarë. Janë në grahmat e fundit të vdekjes. Ose do të dorëzohen, ose do të vriten të gjithë në një pështjellim klithmash, zjarri e gjaku. Mirëpo ne jemi shumë keq për bukë. Apo jo, shoku Avni? – pyeti ai kryetarin e Këshillit, që lëkundej në këmbët e gjata dhe ia bënte «po» me kokë.

Edhe ai ishte i hollë, kockë e lëkurë, si kallam, me një fytyrë të hequr, ku dalloheshin mirë mollëzat e dala dhe faqet e groposura. Kishte qenë gjashtë muaj i internuar në kampin e Porto-Romanos dhe që nga ajo kohë s'e kishte marrë veten. Megjithatë, edhe atij sytë i lëshonin shkëndija prapa xhamave të trashë të syzeve.

– Atë që grumbulluam nga këshillat e qytetit e të fshatrave e shpërndamë. Por po mbaron. Na kanë mbetur keq edhe materniteti edhe mensa e jetimëve. Ka rrezik të na vdesin ata që linden në këto ditë lufte, dhe jetimët. Unë jam edhe mësues. Njëzet vjet jam marrë me fëmijët e klasës së parë të fillores!

U nxe papritur. Fytyra iu prish. Syzet i shkuan shtrembër dhe shtoi me zemërim: – Shoku komisar! Ligji është ende i pashkruar, po ne nuk mund të presim gjëra të shkruhet e të firmohet, se do të jetë tepër vonë atëherë! Tregtarët e mëdhenj i kanë depot plot e përplot!

– U shkrua edhe ai ligj. Prandaj ju thirra. Qarkori i Partisë e vendosi sot pasdite! – tha komisari dhe filloi të vërshëllente një këngë partizane.

– Atëherë të fillojmë nga më i madhi i tregtarëve, që nuk arriti të ikë, nga Dokoja, – tha Avni Plaku i çelur në fytyrë.

Malkës i ra nga buza cigarja e shuar.

– Nga ai? – pyeti dhe ngriti gishtin si çatall, sikur tregonte njeri.

– Nga ai, Dokoja yt! – tha Avni Plaku duke rregulluar syzet.

– Po mirë! Aq më mirë! – tha Malka dhe tundi kokën i menduar, pa vështruar njeri me sy.

Ra telefoni dhe kaloi një kohë e mirë gjersa u sqaruan punët.

– Si? Si? – pyeste komisar, i përqëndruar në telefon, duke bërë me dorë që ata të mbanin qetësi. – Ma thuaj edhe në herë!... Ashtu... Mirë. Po vij vetë!

La telefonin, pa orën e dorës dhe mori automatikun.

– U ka dalë një punë shokëve që luftojnë. Pa të shohim, ku kërkojnë të dalin granatierët me këtë hile! Ni-semi!

Shiu kishte pushuar dhe në oborrin e madh e plot pemë fëmijët luanin luftash. Dy burra të kaluar në moshë grinin me çark duhan për partizanët dhe për pleqtë e asistencës. Një grua nxirrte me petës këmishët e përvëluara nga kazani i madh që lëshonte avull. Në degën e një akacieje qe varur kokëtatëpjetë një shqerrë e the-rur. Kasapi, një partizan i ri, me llërë përveshur, me thikën midis dhëmbëve, ngaqë qe i shkurtër, ngrihej në majë të opingave dhe fuste llërët brenda për të ndarë me gishtat e fortë lëkurën nga mishi. Në një nga katet ishin edhe zyrat e Këshillit të lagjes e të Frontit Demokra-tik, prandaj nëpër shkallë e nëpër korridore kishte shu-më njerëz që bënë ndonjë punë ose që prisnin dikë.

Ata të katër hipën në karrocë.

– Pak shpejt, shoku Malkë! – e porositi komisar.

Rrotat me rrathët të hekurt rrepëllinë mbi kalldrëm dhe mbytën të gjitha zhurmat e tjera. Ata flisnin me zë të lartë.

– Mirë e the ti, shoku Avni, – iu drejtua komisar

kryetarit të Këshillit, që mbante syzet me gishta se mos i binin nga troshitja e madhe. — Tregtarët e mëdhenj kanë menduar për drithin, sikur ta dinin që ne do të kishim shumë nevojë. E kanë ruajtur nëpër depo tamam për këtë ditë!

— Ai pizeveng Doko ka mbi pesëqind kuintalë miell, miell as! — tha Malka duke cytur kalin që të ecte më shpejt. — Jepi, Kiçooo! Hyrjaaa! Forcaaa!... E ka në magazinat, në pazarin e vjetër, tek ata dyqanet me qepena llamarine të përdredhura, poshtë, në qilar.

— Ai ka florinj shumë dhe ka thënë se do t'i nxjerrë jashtë shtetit e do t'i vërë në bankat e Zvicrës, — tha Avni Plaku.

— E keni të sigurt këtë informatë, shtoi komisari, duke u mbajtur fort pas anëve të karrocës, që fluturonte në vrapin e saj të çmendur.

— Florinj? — pyeti intendentit dhe i shndritën sytë e bardhë, të rënduar nga lodhja.

— Florinj! Florinj tingëllues, o shoku Raqi! Edhe shufra bile! — qeshi komisari duke u rënë me pëllëmbë supeve të dobëta të shokut.

— Epo, ç'presim më? — thirri intendentit dhe gati fluturoi nga karroca prej lajmit që dëgjoi. Ai kishte një defekt të vogël në të folur. I mbahej pakëz goja kur shqiptonte tingujt «s» e «n», sidomos kur zemërohej.

— A, ore gagaçi im i dashur! — qeshi komisari. — Me të dëgjuar fjalën flori, u bëre bilbil nga goja!

Qeshën që të katër me zë dhe nuk e vinin re një çunak që u derdh drejt karrocës duke thirrur në vrap e sipër:

— Xhaxhi komisari! Xhaxhi komisari! Të vish edhe sonte te ne për darkë! Të presim! Eja me gjithë shokët që ke aty, me gjithë kalë!... Xhaxhi komi-sa-riiii!...

Kur mbërritën në periferi, në pozicionet e shokëve, gati po errej.

— Hë! Ç'që ai telefon? — pyeti Irakliu komandantin e kompanisë, nxirë në fytyrë nga tymi i barutit.

— Ja ku po vijnë, shoku komisar! — tha komandanti

me zë të trashë, të ftohur, duke treguar me dylbinë që mbante në dorë, tre njerëz në rrugë.

Njëri mbante pushkën lart dhe, në majë të saj, në bajonetë lëkundej një shami e bardhë. Dy të tjerët ishin pa armë.

— Mos qëlloni! — urdhëroi komisar Irakliu partizanët që u grumbulluan rreth karrocës, duke qeshur me hapin ushtarak të atyre të treve.

Mercenarët qëndruan nja dhjetë hapa larg. Komisari dhe shokët e tij u ngritën në këmbë mbi karrocë.

— Kemi ardhur për marrëveshje, — tha ai që mbante shaminë e bardhë, me zë të tronditur. — Duam të bisedojmë me kryekomandantin tuaj, me atë që drejton luftën këtu.

— Ne kujtuam se keni ardhur për t'u dorëzuar! — u tha komisar Irakliu serioz.

— Jo! Granatierët nuk dorëzohen! — u përgjigj ai i flamurit të bardhë.

— Dhe doni të bisedoni me atë që drejton operacionin? — pyeti përsëri serioz komisar Irakliu.

— Goja-gojës vetëm me të...

— Po mirë, — tha komisari, kësaj radhe me ironi. U hodhi një vështrim shokëve, u shkeli syrin dhe e ngriti zërin duke i bërë Malkës një shenjë me dorë. — Shoku Malkë!

— Urdhëro! — tha Malka, që e kuptoi qëllimin e komisarit.

— Ty të kërkojnë, si kryekomandant që je. Merru vesh me ta!

Malka doli përpara shokëve, shtrëngoi armën fort dhe u thirri mercenarëve:

— Unë jam kryekomandanti! Çfarë doni? Flisni!

— Granatierët kërkojnë armëpushim, — ngriti zërin ai me shami të bardhë. — T'i lini të qetë e të lirë të largohen aë këtej. Komanda ajermane ju siguron se s'ka për të hedhur asnjë pushkë kundër jush. Ndryshe do ta djecin këtë laje!

Malka u kollit në grusht dhe iu përgjigj serioz:

– U thoni aleatëve tuaj se kemi vetëm një kusht: të dorëzohen së bashku me ju!

– Si?! Të dorëzohemi?! – pyetën dy nga ata të tre me një gojë.

– Të dorëzoheni! – thirri Malka me zemërim, siç i fliste kalit kur nxehej. – U thoni se mashtrimet nuk u shkojnë! U thoni se asnjë nga ata dhe nga ju, mercenarë të shitur, s'do të ikë rehat e pa luftë. Më në fund u thoni, se, po nuk u dorëzuat, do t'ju vrasim të gjithë, se s'keni nga t'ia mbani! Po nuk e shihni, more hajvanë, se jeni rrethuar? Qorra jeni? Nuk e shihni se keni rënë në çark, si minjtë? Hajt, tashti, prapa-marsh! Në mos po dhashë urdhër që t'ju bëjnë shoshë! – dhe ngriti armën lart.

Mercenarët u larguan me hap të shpejtë, duke kthyer kokën herë pas here. Pak para se të arrinin te kthesa, ia morën me vrap. Në karrocë dhe përreth saj plasi gazi.

– A, sa mirë ua punoi! Sa mirë! M'i lumtë!

– More, po kush është ky? S'e kam parë ndonjëherë!

– Është anëtar i Komitetit Qendror të Partisë.

– Çne, ore! Ky është Malka, Malkë Arabaxhiu! E njoh unë! Jemi nga një mëhallë! Hë, më të lumtë, o Malkë!... Malkëëëë!

– Mirë ua bëre, shoku Malkë! Shumë mirë! Ashtu siç duhet. Ashtu siç e meritojnë! Të lumtë! – i tha komisar Irakliu sinqerisht, duke fshirë sytë me kurrizin e dorës...

Një orë më vonë partizanët u hodhën në sulmin e fundit, i shkulën granatierët e mercenarët nga pozicionet dhe i vunë përpara, duke i ndjekur këmba-këmbës nëpër fushë e nëpër luadhet e përmytura me ujë. S'kishin ku të venin më. Edhe ata që mund të shpëtonin nga errësira, duke u fshehur hendeqeve, do të mbaronin pa tjetër. Më tej fillonte rrethimi i dytë. Ishte një batalion i tërë i brigadës, që kishte prerë çdo udhë e shteg.

– Pastroni vendin! – urdhëroi komisar Irakliu duke fshirë ballin me tytën e nagantit, zakon i vjetër i tij ky, që e përsëriste sa herë mbaronte beteja ose kur kishte ndonjë hall të madh për të zgjidhur, ose kur i vinte shpir-

ti në majë të hundës. – Grumbulloni armatimet! Robërit dërgojini në Viskë! Dhe pastrohuni, se nesër ju pret qyteti i çliruar plotësisht!

* * *

Filloi përsëri shi, i imët, i ftohtë. Rrugët e sheshi kryesor ishin ende me njerëz, me civilë e partizanë, që vazhdonin pastrimin e gjurmëve të betejës. Po centrali elektrik nuk punonte dhe përjashta ishte errësirë. Vetëm nëpër dritaret e shtëpive vezullonin dritëza të verdha të llambave me gaz. Që andej përhapeshin zhurma të gëzuara dhe melodi këngësh të njohura, që ishin krijuar viteve të luftës dhe ishin bërë aq të dashura e popullore. Ishte përhapur lajmi se reparti i fundit gjerman, reparti i granatierëve besnikë të Rajhut, ishte asgjësuar krejtësisht në periferi. Prandaj festohej çlirimi i qytetit dhe njerëzit nuk kishin gjumë, megjithëse kishte kaluar mesnata. Ngandonjëherë, shumë rrallë, dëgjoheshin krisma pushke e revolveri. Me gjithë urdhrin e rreptë që ishte dhënë për të mos zbratur armë, qytetarët, që i kishin shtëpitë plot me partizanë, nga gëzimi i madh i fitores, hapnin dritaret, ose dilnin në oborrin e shtëpisë, ose në rruqicën e ngushtë e të errët dhe aëllonin qiellin e errët, duke i shoqëruar krismat me brohoritje të forta.

Doli te pragu i shtëpisë edhe Qemali, ftuesi i gjyait, aë shoërndante izaria e aë kishte një karvan me femiie, të vetët e të vëllait. Po vëllai iu vra në luftë. Ngriti pushkën lart dhe tha me zë të ngashëryer:

– Për ty, o Isuf, o vëlla! Për shokët e tu dëshmorë! Për kujtimin tënd! Për Shqipërinë!

Qëlloi dhe dy pika lot i rrëshqitën faqeve të parruara. Pastaj u ul dhe puthi pragu e shtëpisë. Ajo shtëpi ia kishte ngrënë shoirtin dhe e kishte krimbur në borxhe fukaranë një jetë të tërë. Ajo ishte larë dhjetëra herë me para, me lot, me hidhërime, me aivqe e burgje.

– Më në fund!... Shtëpia ime!... Shtëpia jonë! – bel-

bëzoi, ndërsa fëmijët e ngritën për ta futur brenda. Plaku e mbloodhi veten, pështyu në drejtim të pallatit që ishte përkundrejt, matanë rrugës, dhe tha me zemërim:

– More fund, o katil i katilëve! O Doko, rezil, i pangopur! O mut i mutit!...

Pikërisht atë çast, përpara shtëpisë së tregtarit të madh qëndroi një karrocë dhe prej saj zbritën ata të katër, të armatosur. Shtëpia ishte e madhe, me tri kate, e rrethuar me kangjella, me një papafingo konike tërë xhama e lule, në majë të së cilës, kushedi për ç'arsye, kishin yënë një aeroplan të vogël prej llamarine, që drejtonte helikën nga frynte era. Të gjitha dritaret ishin të errëta, të mbuluara me perde të trasha prej kadifeje. Vetëm te njëra, që kishte dhe ballkon, në një cep, fekste një rigë e verdhë drite.

Ata mundoheshin të shihnin njëri-tjetrin, po errësira që e dendur dhe nuk dallonin gjë veç siluetave të zeza sterrë që fëshfërinin si kallamat në erë. Dera e madhe prej kangjellash, në krye të së cilës ishte shënuar viti i ndërtimit të shtëpisë dhe nën të inicialet «D. S.» të pronarit, ishte e hapur. Ata hynë brenda në oborr, ngjiten shkallët prej mermeri të bardhë dhe vunë veshin për të dëgjuar. Lart, në katin e dytë, në dhomë e në sallon shpërtheu një e sharë burri dhe u përplas diçka e rëndë në dysheme. Dikush zbriti nga shkallët dhe hyri në qilar. U dëgjua përsëri një rrokullimë dhe po ajo përplasje e hapave.

Ata trokitën që të katër me armët ngrehur.

– S'do ta hapë, tani! – tha Malka me gishtin te këmbëza e pushkës.

– Bjeri fort! – urdhëroi komisar Irakliu nervoz.

Po ndërkaq dikush tha nga brenda:

– Ja!... Ja!... Kush është?

– Hapeni! Jemi ne të Këshillit Nacionalçlirimtar. Aty është zoti Doko? – pyeti me zë të rëndë Avni Plaku.

Dera u hap dhe në katorin e saj u duk fytyra e gjerë dhe e shëndetshme e tregtarit, e ndriçuar nga shandani me pesë aqirinj që mbante në dorë. Ishte veshur me pizhame me vijëza, si tërë pizhamet, po prej mëndafshi të ndrit-

shëm. Mbi supe mbante një shall të madh e të trashë prej leshi.

– Urdhëroni, zoti kryetar i Këshillit! Partizanë më keni sjellë? Shumë mirë! I pranoj me gjithë shpirt! Urdhëroni! – tha duke ruajtur nga ana e jashtme gjakftohësinë e vetësigurinë dhe i futi në një sallon të madh të katit të dytë.

– Na falni që ju shqetësuam! – i tha Avni Plaku.

– Ç’është ajo e shqetësuar! – e ndërpreu ai. – Këtu bota po vriten, kurse ne nuk mbajtkemi dot me bukë tre partizanë të lirisë?! I thonë luftë! Njeriu për njeriun jeton! – vazhdoi me mirësjellje të shtirur, me mendjemadhësi, duke i parë të katër, një e nga një, me vëmendje. – Pooo! – zgjati fjalën, luftë është dhe do ta shqetësojmë patjetër njëri-tjetrin. Përse jemi vëllezër të një kombi, të një gjuhe e të një gjaku?!

«Dhelpër, o dhelpër!» – mendoi Malka duke shtrënguar buzët. Komisar Irakliu që i qetë, gati përgjumësh. Intendenti e humbi toruan pas antikave. Kryetari i Këshillit ishte tërë sy e veshë.

Tregtari i la një çast vetëm dhe iu drejtua së shoqes që priste në korridor, e trembur, me një fëmijë për dore.

– Këta s’kanë ardhur për të mirë. I shoh nga fytyra. Po ti, mbaje veten.

Ajo e këshilloi duke i pëshpëritur te veshi:

– Aman, Doko! Të keqen! Kujdes! Vepro me mend në kokë!

Ai rrëmbeu shishen dhe takëmin e pijeve nga rafti, takëmin prej kristali dhe i shfryu së shoqes me zë të heshtur:

– Më lër rehat! Dëgjo këtu: Do ta mbyllësh gojën dhe nuk do të thuash asnjë fjalë!

Hyri në sallon me një buzëqeshje të shtirur, të ftohtë, si të gjarprit, nëse mund të buzëqeshë gjarpri. Tamam atëherë, lavjerësi i madh, një orë e vjetër e shekullit të kaluar, varur në mur, ra një pas mesnate. Ishte një nga ato mrekullitë e artizanëve artistë që punonin gati tërë jetën e tyre për të bërë një orë dhe në të njëjtën kohë

një vepër arti të përkryer. U hapën disa kafazë si shpella dhe prej tyre dolën gjashtë elefantë që tërhiqnin një karrocë mbretërore. Mbi karrocë, një djall me brirë i binte trumpetës. Elefantët bënë një rrotullim dhe hynë përsëri në kafazet e tyre. Djalli, para se të zhdukej, u përkul, sikur uroi natën e mirë.

– Nga një raki! – tha zoti Dokò duke bërë lëvizje të shkathëta, që nuk i shkonin moshës së tij pesëdhjetepesëvjeçare.

– Faleminderit! S'është kohë për pije, – e ndali komisar Irakliu, duke vënë pëllëmbën mbi gotën e tij.

– Po ju, uluni! Urdhëroni, uluni! – i ftoi mysafirët që qëndronin ende në këmbë, paksa të habitur, me sa dukej nga elefantët, nga karroca mbretërore dhe nga djalli me brirë.

– Mirë, – tha komisar Irakliu i mërziutur, – po ulemi pak.

Tregtarit i mbeti shishja në dorë. Nuk dinte ç'të bënte e ç'të thoshte. Kur njohu Malkën, u pre në fytyrë. Thirri pa qenë nevoja:

– Grua!

Ajo zgjati kokën te dera e hapur:

– Urdhëroni!

– Një kafe e një çaj mysafirëve!

– S'është nevoja! Kemi ardhur për një punë tjetër, më me rëndësi, – tha kryetari i Këshillit.

Atëherë tregtari ndjeu që rrotull po frynte diçka e keqe. Sikur iu drodhën gjunjët dhe u ul pa zhurmë në kolltukun e butë. Hyri edhe e shoqja me një shall lesh-deveje që i mbulonte tërë shpatullat dhe kurrizin. Me një dorë mbante të birin, që nuk kuptonte ç'po ndodhte, se ishte ende i vogël, dhe me tjetrën një pjatancë mbushur me mollë të kuqe, me arra e bajame. U bë një qetësi e çuditshme në sallonin e madh, dyshemeja e të cilit ishte mbuluar cep më cep me një sixhade të butë tërë ngjyra. Nga tablotë e pikturave nëpër mure vështrojnë tërë dhembshuri sy grash të bukura gjysmëlakuriq. Mbi piano zbardhnin e zverdhnin tërë reflekse, statuetka

e antika të çmueshme. Për një copë herë u dëgjuan pëllëmbët e ashpra, që ata të katër fërkonin për t'u ngrahur, kërcitiet e druve në oxhakun oriental, pikat e shiut që trokisnin nëpër xhama dhe tiktaku i lavjerësit të madh, që mbante fshehur në brendësinë e tij gjashtë elefantë, një karrocë mbretërore dhe një djall me brirë që binte burisë dhe përkulej, sikur uronte natën e mirë.

Tregtarit iu errën sytë, kur pa Malkën për herë të dytë që ishte ulur te dera, i përqëndruar tek arma e tij. Lu bë sikur kishte përpara një masë amorfe, të zymtë dhe pa kuptim. Ai ishte mësuar që të bëhej gjithnjë vullneti i tij. Po të thoshte «e marr», e morrte, po të thoshte «s'e dua», s'e donte dhe s'kishte njeri e forcë që t'i impononte vullnet e mendim tjetër. Kur vendoste, nuk ndalej përpara asgjëje, siç thoshte edhe vetë me shaka, as përpara femrës, as përpara zotit vetël. Ishte një monstrë që me marifetet e tij mund të mbyste cilinda, duke e puthur. «Kjo batë është allishverish, të doli asi, e fitove, s'të doli, e humbel. Duhet të dish ta vërtitësh!» mendonte kur ishte me orë të mira dhe me orë të këqija.

Përsashta u dëgjua një e shtënë pushke dhe ajo e solli në vete. Menjëherë përpara syve të tij doli çdo gjë mori formën e vet të vërtetë, edhe salloni, edhe e shoqja me të birin, që ishin ulur si mbi gjemba, edhe ata të katër që ishin më tej, si ata qirinjtë e verdhë të shandanëve mbi oxhak, edhe ai lavjerësi të madh që nuk pushonte për asnjë çast, po vraponte që të nxirrte edhe një herë, elefantët, karrocën mbretërore dhe djallin me brirë duke i rënë barisë.

— Ç'janë këto armë që shpazën? — pyeti duke ndier dridhma në kurriz, megjithëse kurrizin ia kishte kthyer zjarrit.

— Nga gëzimi, — u përgjigj komisar Irakliu duke mbetur thyer pada shur këllëfin e nagantit.

— Pak më parë se të urdhëronit ju, se kush e zbrazi mu te pragu i shtëpisë sime. Thashë se mos më qëlluan mua!

— bëni një lloj shakaje që s'i shkonte fare!

— Qëlloi Qemali, fqinji, ai borxhliu syt i përjetshëm!

– tha Malka që nga dera, ku rrinte si rojë me armën ngrehur.

– Fukara, i ziul... Po si shkon lufta? – pyeti si pa të keq, duke kruar me gisht majën e kokës me qime të rralla, ca të bardha e ca të zeza.

– Qyteti u çlirua plotësisht, – tha komisar Irakliu, që po humbte durimin.

– Ju jeni të fortë dhe me siguri do ta çlironi tërë Shqipërinë e do të fitoni! – tha tregtari duke bërë çmos që të tregohej i gëzuar, bile dhe entuziast. – Shyqyr! Se u shkatërrua i mjeri popull me mall e me katandi! Unë nuk ju ndoqa dot, se vuaj nga mëlçia. Pastaj, djalin e kam pasur të vogël dhe gruan gjithnjë të sëmurë!... Po ama, me dorë në zemër ju them, se s’kam bërë asgjë të keqe kundër popullit. Ato pak që kam fituar, i kam trashëguar nga babai dhe nga djersa e mundi im. I kam me tapi të rregullta, me firma e vula, edhe pronat në fshat, të regjistruara në kadastër, një për një, që në kohë të stërgjyshit...

Komisari u mërzit shumë dhe e ndërpreu me ironi:

– Edhe unë nga fshati jam. Po im gjysh, ndjesë pastë, më thoshte se ato toka, para se t’i rrëmbente farefisi yt, ishin të fshatarëve. Toka gjithnjë ka qenë e fshatarëve, para se të dilnin gjyshërit e tu... Po, nejsel! Ne kemi ardhur për një punë tjetër...

– Me se mund t’ju ndihmoj, se edhe unë dua të bëj kthesë. Helbete, njerëz jemi dhe ndonjë gjë, mbase, nuk e kemi bërë ashtu siç duhet...

– Jep prova! – i tha komisar Irakliu, duke mos dashur t’i kujtonte të kaluarën e t’i thoshte që fare asnjans zotëria e tij s’kishte qëndruar në atë luftë të madhe.

– Ç’kërkoni nga unë? – pyeti më në fund tregtari me ankth.

– Populli ka mbetur pa bukë... Asistenca, jetimorja, spitali, materniteti! Pale partizanët! Po kush pyet për ne. Ne, në fund të fundit, u rritëm përmes urisë dhe mund të durojmë. Sigurisht, gjendja do të ndryshojë shpejt. Fshatarët do të na dërgojnë bereqet. Por tashti për tashti jemi

shumë ngushtë. Besoj më kuptuat mirë, — tha komisar Irakliu.

Treatari kërceu si mbi gjemba:

— E ku të gjej unë bukë?! Të kisha, po, do t'jua jepja me gjithë shpirt. Se e di ç'do të thotë të të gërhasin zorrët nga uria...

— Mbase ke...

— Një kuital për vete, sa për të nxjerrë dimrin. Ato aë kërkoj dje Këshilli, ia dhashë. Apo jo, zoti Avni?... Ja, pyeteni Avni Plakun. Ai është mësues i ndershëm dhe nuk gënjen. Më ka lëshuar edhe një dokument, me firmën e tij.

— Po, — tha kryetari i menduar. — Na dhe njëqind lugë për asistencën dhe njëqind pjata, alumini edhe ato, për mensën e jetimores...

— E shihni?! — hapi krahët tregtari dhe fytyra iu çel.

— Ke fituar shumë ti, Doko! — tha ngadalë, si me vete, komisar Irakliu, pa fshehur inatin që po pushtonte qenien e tij.

— Epo, punë çmimi! Jepja e merria ku më leverdiste! Punë fitimi! Lloqari kjo botë! — tha duke fërkuar mollzat e aishtit të madh me atë të treguesit.

Komisar Irakliu thirri:

— Jo lloari, po zvatje! Më e ndershme është të thuash zvatie.

E nariti zërin edhe treatari:

— Po ç'doni naa unë, lëkurën?!

— S'kemi ardhur të të marrim lëkurën, Doko! Po të të themi, se boll ke ushayer me grurin e popullit Romën, Berlinin dhe derrat e tyre!

— Unë bëia trati. Na, nëm, është kjo botë. U jepja grurë, ata më paguanin, ... ma paguanin... me...

— Me qiakun e popullit! — thirri komisari dhe, padashur nxori naantën naa këllëfi, e kaloi në ballë, sipas zakonisht, sikur fshiu djersët dhe e la mbi tryezë, pranë vetes.

Atëherë treatari ndjeu jo erën e së keqes, po atë vetë, lakuriq e të prekshme, siç prekte gjunjët, kur i

dhembnin nga reumatizmi. Fytyra iu mbush me rrudha. Bebézat e hirta i mbërtheu mbi të shoqen, që i lutej në heshtje, me vështrime të kishtë kujdes e të vepronte me mend në kokë. Dëgjo! Malkën që tha me tallje:

— Më mirë mbylle atë kamare, se do të të hyjë ndonjë mizë! Ne e dimë ku e ke fshehur miellin.

I përsëriti këto fjalë edhe kryetari i Këshillit, po serioz e pa tallje. Edhe ai tha:

— E dimë mirë.

«Ah! Si erdhën këto kohë! — mendoi tregtari i zbehur krejt. — Vjen i biri i botës, një furrxhi, një arabaxhi, një mësues mizerabël dhe një gagaç dhe të vënë përpara si pa gjë të keq! Po ai është malli im! E kam vënë, me djersë, e kam blerë me para në dorë, për ta shitur me para e për të bërë përsëri para!»

— E dimë!.. E dimë! — i buçitnin veshët dhe njërit prej atyre që thoshte këto fjalë i mbahej goja keq te, «m»-ja.

— Kur e dini, merreni! — thirri me gojë të çapëlyer.

— Celësat e magazinës! — tha komisar Irakliu dhe i fryu tytës së naganit. — Dhe mbaje mend mirë: ne s'jemi hajdutë, por përfaqësues të pushtetit të ri të popullit!

Tregtari u bind, se aë e kotë të kundërshtonte. Ishte hera e parë në jetë që ai vepronte kundër dëshirës e vullnetit të vet. Hera e parë! Dhe iu duk sikur i ra mbi kokë abazhuri i madh që varej në tavan. E ndjeu se po fillonte përmbysja e kohës së Noes, po fillonte përmbysja dhe katastrofa e vërtetë.

Rënkoj si epileptik, po tutkën e kishte në vend. Më mirë miellin, se florinjët, mendoi. Hapi një sirtar, mori celësat, lidhur me zinxhir të shkëlqyeshëm, i hodhi mbi tryezë, sikur hodhi zemrën e vet, dhe tha çuditërisht i zbutur:

— Më kuptoni, o vëllezër! Është mall e dhimbset! Dhimbset i uruari! Jo pse s'dua ta jap, po dhimbset, të pikon mu në thelb të zemrës. Po... në fund të fundit, vëllezër jemi! Dhe koha është e tillë që nuk lejon të zi-

hemi vëlla, me vëlla. Se, edhe të zihemi, s'kemi ç'të fitojmë! — A, po këto janë lajka, more edepsëz, — mendoj Malka duke rrëmbyer çelësät. — Jemi velur me këto lajkat tuaja — gjërmë fyt. — Nuk kapërdihen më.»

«Pasi kështu? Pa faturë? Pa para? — tha tregtari si i goditur, duke buzëqeshur me zor. — Do të të lëshojmë një ndëftesë. S'të lëmë pa dokument, — tha intendent Rraqi. Ishte i zemëruar, prandaj iu mbajt edhe goja.

«Dokja po pëlqiste nga marazi, së e mori me menua që ajo çopë letër, të cilën do t'ia jepte «gagaçi», s'do të kishte asnjë vlerë.

«— E po mirë, — tha më në fund hidhur, lëshuar i tërë në kolltukasi brumë kardhur, po me mendjemadhësi. — Ta hajë popullit!»

«A, aburrë i pashtër dhe edepsëz që je, — mendoj Malka duke tundur zinxhirin e çelësave, — zor se gjen jetër në botë. Rrufjan të kashtur nëna ty.

«Sigurisht në emër të popullit dhe për popullin bëhen të gjitha këto. — tha komisar Irakliu i vrenjtur, duke e vështruar tregtarin drejt në bebzat e hirta. — Do ta marrim miellin që sonte dhe do ta dërhojmë menjëherë në mençën e fëmijëve, në spitalin e të plaqosurve, në maternitet, në asistencën e pleqve dhe në të gjitha furrat e qytetit. Do ta ndajmë me racion nëpër familjet e të varfërve, të atyre që luftuan, që derdhën gjak.

«Lavjërësi ra dy herë, duke lajmëruar se ora kishte vajtur dy pasmesnate. Dolën përsëri gjashtë elefantët dhe karroc mbretërore. Kësaj radhe bënë dy rrötullime, ndërsa djallimë bënë i binte trumpetës.

«Ç'mrekullira bën dora e njeriut!» — mendonte i mahnitur Avni Plaku duke parë lavjërësin. Malka, me gojë pakëz hapur, rrinte si i shastisur dhe krahasonte karrocën mbretërore me karrocën e vet. Komisari numëronte

me vete sekondat. Në çdo sekondë godiste tryezën lehtë me tytën e nagantit. Prej se të jenë bërë ata elefantë, ajo karrocë e bukur dhe ai djall qesharak? Prej floriri? pyeste veten pa zë intendent Raqi.

«Ç'natë e gjatë! — mendonte tregtari, i zyrtë. — S'u gdhi që s'u gdhi! Natë e mërzitshme dhe e frikshme! Dhe këta s'kanë ndër mend të ikin. Përse s'ikin? Përse s'e thyejnë qafën? Ç'presin? Ç'duan akoma? Hajdutët! Rrjepacakët! Evgjitet e Katavaroshit e të Tabakëve!»

Përbrenda i kullonte vrer, po bënte çmos që vreri të mos i pëlciste nga buzët e fryra, prej njeriu të ngopur e të kënaqur nga jeta që, papritur, ndien se është në prag të greminës.

— Do të rrimë edhe ca, — thoshte komisar Irakliu duke luajtur me mullirin e nagantit, si me ndonjë lodër kalamaish. — Kemi edhe problemin tjetër për të zgjidhur. — Tregtari priste, tërë sy e veshë, të dëgjonte ç'që ai problem ende i pazgjidhur. Dhe dridhej në kolltuk nga tmerrri. — Ti ke fshehur këtu, në këtë shtëpi, mijëra florinj dhe shufra ari, — tha komisar Irakliu duke vështruar muret e sallonit.

— E pastaj?! — u zbeh Dokoja dhe pa ndër këmbët e veta kamxhikun e tij, që dukej si ndonjë gjarpër, të cilit ia kanë shtypur kokën. — Në shtëpinë time unë bëj ç'të dua...

— Pastaj, — e ndërpreu qetë komisar, — ke thënë se do t'i nxjerrësh jashtë me mjete të papara, të padëgjura, të rafinuara. Do t'i nxjerrësh jashtë shtetit me anën e kufomave të ushtarëve të huaj, të vrarë nga ne. I mençur shumë po tregohesh, zoti Doko. Do t'u heqësh të vdekurve plëndës, zorrë e mëlçi dhe t'ua mbushësh barkun me florinj! Çfarë s'pjell mendja juaj borgjeze! Çudi e madhe!

Tregtari hapi bebëzat e hirta i tmerruar. U ngrit përnjëherësh dhe thirri:

— Gënjeshtër! Shpifje! Unë s'kam asnjë flori për bel! O, po e ndiej që në këtë shtëpi s'qenkam zot unë, po të tjerët! Unë qenkam i tepërt!... I tepërt!...

– Megjithëse koha s'na pret, nuk do të largohemi gjersa të na i dorëzoni, ose gjersa t'i gjejmë vetë, – e ndërpreu komisar Irakliu duke vështruar edhe një herë muret, sikur floringtë të ishin fshehur vërtet aty.

– Po ju, komunistët, sikur jeni kundër mallit, gjësë, pronës. Ç'i doni floringtë e tjetrit?... Po, ja, ku ju them: S'kam! S'kam! S'kam! S'kam!

Dukej sikur ishte ndonjë qen i tërbuar, me formën e një njeriu trashaluaq, që vinte rrotull e lëshonte jargë nga goja.

Gruaja, strukur në një qoshe divani, me djalin në prehër, i cili vështronte të atin me sy të lemerisur, iu lut me zë të dridhshëm, që dilte nga thellësia e shpirtit, si psherëtimë e përvajshme:

– Doko! Aman, Doko! Mos bëj kështu! Të të vij keq për djalin! Shiko, është bërë meit, sikur e ka zënë ajo punë!

Ai e mblodhi vetën, kur pa të birin dhe urdhëroi:

– Shpjere të flejë!

– Kam frikë nga krismat, Baba! – tha i biri, duke u ngjeshur edhe më pas gjirit të nënës.

Një çast më vonë tregtari s'e kishte më veten në dorë. Ishte përfshirë i tëri nga kthetrat e mëdyshjes, të hutimit, frikës e tmerrit. S'kishte se me cilin të këshillohej, as shokë, as farefis, as ndonjë nga miqtë e huaj. Kishin ikur të gjithë, ishin fshehur, ishin shpërndarë si zogjtë e korbit, duke u qepur pas gjermanëve. Ca kishin ikur me kohë në Tiranë, megjithëse flitej që Regjenca ishte transferuar në Shkodër, ca të tjerë i kishin rregulluar punët me kohë, kush në Shqipëri e kush jashtë, duke dhënë shpërblime të majme.

«Vetëm unë gomari mbeta këtu, – mendoj. – Vetëm unë, gomari, nuk mendova me mend në kokë për të shpëtuar pasurinë time! Mbeta fill vetëm! Ç'të bëj? Nga t'ia mbaj? Ku të mbytem? Me cilin të këshillohem? Me time shoqe, që s'ka dy para mend?! Apo me këtë idiotin?!»
– mendoj për të birin.

– Moreee... Partizanë! Po ju... juve..., – gati klithi pa e mbaruar mendimin se, kur tha fjalën «partizanë», diçka i theri përbrenda, diçka gërryese, sikur ia shkuan zemrën në grijë.

– Mos na detyroni të veprojmë ndryshe, – e këshilloi Avni Plaku, ndërsa komisar Irakliu luante me mullirin e nagantit, që nxirrte ca tinguj të këndshëm metalikë.

Pa mbaruar fjalën mirë Avni Plaku, tregtari, me hapa shumë të shpejtë, shkoi te komoja, ku ishte një pasqyrë e madhe me kornizë të trashë gjithë lajle e lule të stilit arab, që i ati e kishte sjellë nga Misiri, mori një kuti mbuluar me cohë kadifeje ngjyrë vishnje dhe e përmbysi mbi tryezë me inat. Sahatë të vegjël, rruaza grash dhe gurë të çmuar, gjerdanë, byzylykë e zbukurime të tjera që dukeshin prej floriri, me atë shkëlqimin e verdhë e verbues të metalit të rrallë, u përhapën me zhurmë. Gruaja u ngrit në këmbë dhe vështroi e ngurtësuar që nga cepi i divanit. Ata të katër panë në heshtje njëri-tjetrin.

– Ja, këta janë floringjtë e mi, merrini! – tha tregtari dyllë i verdhë.

Komisar Irakliu i shtyu me myllin e nagantit.

– Dokooo! – tha i ngrysur e si përgjumësh. – Mos na hidh hi syve! Po ta përsëris: nuk kemi ardhur si hajdutë, për të të rrëmbyer këto çikërrima, që mund të quhen pronë personale familjare. Kemi ardhur në emër të pushtetit të ri të na dorëzosh floririn, i cili është pronë e popullit dhe ti... e ke fshehur.

Gruaja, e kënaqur, me sa duket, nga ky veprim i partizanëve, i mblodhi shpejt e shpejt zbukurimet e veta dhe i vendosi përsëri në kuti.

Dokoja hapi krahët i pikëlluar:

– Po si është e mundur dhe ku është parë që njeriu të dorëzojë pasurinë e vet, kështu, në këtë mënyrë, pa një çek bankar nga... banka juaj?!

– Banka jonë është bosh, se floringjtë i keni rrëmbyer e fshehur ti me shokët e tu borgjezë, shqiptarë e të huaj! – iu përgjigj komisar qetë, megjithëse e kuptoi ironinë e borgjezit.

Unë s'kam rrëmbyer gjë nga banka... dhe s'ka ligj që të m'i marrë, se ligje të tilla as ka pasur dhe as që do të ketë kurrë.

– E kemi ligjin! – tha Avni Plaku.

– Ku e keni? Pa ta shohim pak...

– Është ligji i revolucionit! Ti ke qenë me fashizmin, Doko! Mos harro se ke qenë kuestor në kohën e tyre! – i tha me rreptësi komisari.

– Jò kuestor, po zëvendës, për një kohë fare të shkur-tër. Dhe dhashë dorëheqjen, pa i lyer duart me gjak.

– Kur kapitulloi Italia, të gjithë kuestorët dhe zë-vendëskuestorët dhanë dorëheqjen, – u tall komisar Irakliu.

– Dhe u lidhën me gjermanin, – i vuri pikën Malka.

– Kam bërë tregti! Vetëm tregti!...

– Dhe ke rrjepur popullin! – e ndërpreu komisar Irakliu me zë të lartë. U nqrit dhe për herë të parë i ra tryezës fort me tytën e nagantit. – Fati i Shqipërisë nuk vendoset as nga mielli, as nga florinjte e tu. Fatin e Shqipërisë e vendosj poulli vetë, me armë... Me armë! – dhe ia tundi nagantin para hundëve. – Po djersja e popullit, e grumbulluar në florinjte e tu e të të tjerëve, nuk duhet të plaçketet, të varroset nën tokë apo të dalë jashtë shtetit. Ka dhietëra, miëra njerëz, ja kështu, si Malka, si Avniu, si Raqi, si unë, që s'marrim asnjë qindarkë, sepse jemi në luftë të përgjakshme prej vitesh. Kurse ti dhe borqezët e tierë... dhe feudalët e mëdhenj... Po, përse ta zajasim? Të këshillojmë të mos e rëndosh veten më shumë se kaq! Po hiç s'do të të lëmë. Do ta nxjerrësh bukën me kazmë!

Dokos iu pre ajuha fare. Rrëmbeu kamxhikun që ishte në dysheme, nën këmbët e tij, si një ajarpër i ngordhur. Malka, i mësuar me kamxhikë, ia rrëmbeu, pa arritur që ai të qëllonte.

– E, e, borgjez! Me këtë armë që ke ti, lufta jote merr fund për një dekimë... O shoku komisar! E mira është ta shpiem edhe këtë me të tjerët, në Viskë! – thirri karrocieri i zemëruar në kulm.

Djali i vogël, që s'ishte ndier gjer në atë çast, me të dëgjuar fjalën «Viskë», filloi të klithte me lot në sy, duke iu lutur të atit:

– Jo në Viskë, baba! Mos shko në Viskë! Më kanë thënë shokët: atje të varin në lis, ta lyejnë kokën me mjaltë, të lëshojnë bletët dhe vdes...

«Sa të poshtër janë edhe në shpifjet e tyre», – mendoi Malka. Borgjezët me këto shpifje llahtarishin edhe fëmijët e vet!

Djali u shqit nga e ëma, hipi mbi një komodinë të lartë dhe i ra murit me grushtet e vogla. I binte me zemërim fort, fort dhe nuk shihte ku godiste, se kokën e mbante poshtë. I zemëruar, i lodhur nga pagjumësia, i lemerisur nga ato që thoshte i ati, padashur goditi sahatin me lavjerës. Ora e vjetër u shkëput nga muri dhe ra mbi komodinë. Nuk u thye dhe nuk ngeli. Vetëm se nga njëri kafaz nxori kokën ai djalli i vogël me brirë dhe i ra trumpetës para kohe.

– Këtu janë florinjët! Këtu! Këtu! Këtu janë! Këtu! Ja ku janë! Ja ku janë! – bërtiste djali i vogël duke vazhduar të godiste me grushtin e njomë.

Dokoja u turr drejt tij, i xhindosur. Po atë e rrëmbeu e ëma dhe e mbuloi me krahë. E pengoi edhe Malka, që i preu rrugën.

– Idiot! O idiot! E kam thënë kushedi sa herë që është idiot! – mallkonte tregtari duke lëshuar shumë nga goja. – Idiot i tëri! Si e ëma! Shiko ç'fëmijë ke pjellë?! Shiko ç'ke nxjerrë nga barku?! Një idiot safil! Se e keni pasur në gjak ju idiotizmin! ... Po ç'na bëre, o idiot? Ç'na bëre? Ç'tu desh të hipësh majë komodinës? Ç'tu desh, o idiot? O i-di-ot!...

Po çdo gjë ishte e kotë tanimë. Metali i çmuar ishte zbuluar. Në vendin ku pak më parë ishte sahati i madh me lavjerës nga ku, në çdo orë, dilnin gjashtë elefantë që tërhiqnin me mundim një karrocë mbretërore me një djall me brirë përsipër, i cili i binte trumpetës dhe uronte në fund «natën e mirë», ata të katër panë një të çarë, një si zgavër të thollë e të zezë. Që andej, si gërryen suvanë

dhe tullat me bajonetë, nxorën qesetë prej lëkure, të mbushura plot me metal tingëllues dhe shufra prej floriri të madhësive të ndryshme.

— Oh! — rënkoi borgjezi sikur lëshoi frymën e fundit. U lëshua në kolltuk si një njeriu që i bie të fikët. — Florinjtë e mi!... Jeta ime!...

Ishin shumë florinj dhe shumë shufra, të madhësive të ndryshme, të imperatorëve, mbretërve e mbretëreshave të ndryshme të botës, të të gjitha kohëve, që kur kishte dalë për herë të parë ari. Ishte një bankë e tërë.

Dokoja nuk ishte në gjendje të ngrihej. Qe plakur brenda një nate sa për njëzet e pesë vjet, a ndoshta më shumë. Mishrat nën mjekër iu qullën dhe iu fishkën. Iu bë nën gushë një lëmsh, rrudha-rrudha e kokrriza-kokrriza, si ajo e kuaja pa vlerë e qafës së misërrokut. Faqet e bëshme iu lëshuan dhe iu zverdhën. Nëpër to dolën ca pikëza të murrëtyera. Sytë i perënduan dhe iu bënë njësh si xhelatinë, ku mezi dalloheshin ca bebëza të shkrira ngjyrë hiri.

Kryetar Avni Plaku, si e pa borgjezin në atë gjendje, i tha gruas që të qëndronte gjersa të numëroheshin florinjtë. Raqi, i gëzuar, mbante llogari të përpikta, siç kishte bërë tërë kohën e luftës me misrin, opingat, duhanin, mishin dhe kokrrat e fasuleve. Kryetari i zbrazte florinjtë nga qesetë e mëdha, hiqte mënjanë shufrat, i ndante sipas shteteve dhe i numëronte në sy të gruas, një e nga një, me kujdes të madh, duke i tërhequr me majën e gishtit tregues. Komisari e kishte futur nagantin në këllëf dhe po shikonte me kujdes pikturat e antikate, pa e pasur mendjen fare se ç'bëhej aty rreth tryezës së zezë prej ebaniti të ndritshëm. Malka me një sy vështronte borgjezin që ishte squllur krejt dhe më tjetrin monedhat e shndritshme, që nuk i bënin asnjë përshtypje. «Ç'qënkan këto pare si mangëre!» — mendonte ai, duke kujtuar kohën e largët të fëmijërisë, kur luante me shokët nëpër lëmenjtë me monedha të vjetra prej bakri me koka të shtypura mbretërisht e sulltanësh, pa asnjë vlerë. Pastaj filloi të pyeste:

— Ç'eshtë kjo, me fytyrë gruaje, o komisar!
Irakliu u shkëput nga pikturat e antikant, e pa monedhën pa asnjë interes dhe tha disi i mërzhitur:

— Unë nuk i njoh këto pare. I shoh për herë të parë. Unë, që ta dish ti, shoku Malkë, njoh mirë furrën. Kam qenë furrxhi. Aty, po, s'ma kalon njeri. E di në majë të gishtave se ç'do të thotë furrxhi, se ç'do të thotë të vejë djersa në fund të peshkut të kurrizit, se ç'do të thotë të nxjerrësh bukët e pjekura mirë dhe tavat me zarzavate të skuqura për merak. E di mirë! Nuk i harroj kurrë fëmijët, kur vinin të uritur e rrëmbenin lakrorët me miell misri e lëpjetë dhe i shpinin në shtëpi të përgjysmuar. Nuk i harroj kurrë fëmijët e varfër që arrinin te dera me orë dhe ngopeshin vetëm me erë e mirë të mishrave të pjekura të borgjezëve! Nuk i harroj! Po këto pare e fëlliqura prej florini nuk i njoh.

— Kjo është lirë angleze! — shpjegoi intendent Raqi, duke treguar me gisht, pa e prekur monedhën fare.

— Po kjo tjetra? — pyeti Malka kurriz.

— Lirë turke, pesëshe.

— Po këto me këndeskë?

— Napolona franceze!

Kryetari i Këshillit ndali gishtin të monedha për të mos ngatërruar llogarinë dhe e ktheu me shaka:

— Ç'pyet kaq shumë, o shoku Malkë? Mos ke ndër mend të bëhesh ministër i financave?

— Pse jo?! — qeshi komisar. — Ku i dihet! Në e lëntë Raqi, edhe mund të bëhet.

— Pyes se nuk kam parë kurrë florinj me sy, as monedha e as shufra. Për mua s'kanë asnjë vlerë. Më të shtrenjta e më të vyera për mua janë pushka, kali e karroca...

Kaloi një kohë e gjatë gjersa i numëruan të gjitha. Ishin shumë qese, shumë shufra. Një bankë e tërë. I futën nëpër ca thasë mielli dhe i lidhën grykat me spango. Raqi bëri shpejt e shpejt dokumentet, një për financën revolucionare, një për ish-pronarin.

— Duhën firmuar këto, shoku-komisar, — tha i preokupuar.

— Ja kur e kel! Jepja! — bëri Irakliu me kokë nga borgezi, i cili, megjithëse kishte ardhur në vetë, rrinte në kolltuk si i goditur.

— Firmonil! Ja këtu! — i tha Raqi me një mirësjellje që s'i shkonte hiç.

— Tregtarit i dridhej dora. Sytë i kishte krejt të bardhë.

Belbëzoi: — Njësoj sikur firmoj vdekjen timel.

— Ke qënë hapangopur për para, Dokoja — i shfryu Malka dhe thithi cigaren, maja e së cilës ndriçoi fort dhe karrocieri u duk si një njeri më tre sy të zjartë.

— Dokoja, krejtë pa fuqi, si një njeri që e rrëmbejnë spazmat gjithandej, shtriu me mundim krahun drejt kamxhikut që Malka e kishte hedhur ambi tryezë dhe që dukej si një gjarpër i ngordhur. Nuk arriti ta prekte as me gishta. Po edhe sikur ta rrëmbente, ç'do të bënte?! Ata të katër ishin larguar...

Nata e fundit e robërisë kishte marrë fund. Duart e saj të zeza nuk kishin më fuqi të pushtanin çdo send të të zhytnin në katran. Qyteti ishte çliruar dhe po agonte. Po agonte jo një ditë e zakonshme, e përhershme dhe monotone. Po agonte një erë e re.

Karroca ecte nëpër kalldrëmet, duke bërë zhurmë me rrrathët e saj të hekurt.

— Si do të jetë kjo ditë që po agon dhe ajo që do të vijë nesër e pasnesër? — pyeti i menduar një nga ata që ishin në karrocë.

— Kur, nesër e pasnesër?

— Kur të çlirohemi krejt, pra!

— Luftë për komunizmin! — u përgjigj komisar Irakliu.

— Luftë! — Megjithëse herët, trotualet dhe rrugët ishin mbushur

me partizanë e me qytetarë. Njëpër dyert e njëpër ballkonet ishin vendosur që gjatë natës flamurë të kuq, të mëdhenj, me shqiponjë dykrenare e me yll të artë. Në pazar ishin hapur berberhanat, ëmbëltoret, rrobaqepësitë, kovaçhanat dhe dyqanet e vogla të çikërrimave. Zejtarët ende bënin guna, rroba shajaku, gjerdanë fishekësh, rripa dhe opinga për partizanët.

Karroca ecte si e çmendur, dhe fajet i kishte Malka, që cyste kalin e dobët me kamxhik e me të thirrura.

— O Malkë! — tha komisar Irakliu i gëzuar, papritur, kur hynë në mes të rrugëve me kalldrëm të pazarit. — A e di se ne të katër jemi partizanët më të pasur në Shqipëri e në botë?!

— Jemi vërtet, shoku Irakli! — u përgjigj Malka duke qeshur. I bëri zë kalit, nduku frerin dhe e ndali karrocën përpara një vitrine me xham të thyer. Prapa saj, mbi skarë, piqeshin kërrnacka me mish dashi të majmë. Që të katër nuhatën erën e mirë.

Malka pyeti:

— Që kur s'ke ngrënë, shoku komisar?

— Që dje më këtë kohë...

— Plot njëzet e katër orë! Për kokën e çunave edhe unë aq kam!... Po ju, o shokë? — iu drejtua të tjerëve.

— Mua po më bie të fikët nga kjo erë e mirë! — tha Raqi, bilbil nga goja.

— Po ne sikur jemi partizanët më të pasur të Shqipërisë dhe të botës! Pa shikoni ç'florinj kemi njëpër thasë! A hymë këtu e hamë nga një kërrnackë, sa për të prerë urinë?!

— Meqë na fton, o Malkë, nuk ta prishim! — tha Avni Plaku dhe zbritën që të katër nga karroca si djem të rinj.

Me të vënë këmbën te pragu i dyqankës, Malka thirri:

— Mirëmëngjes, ustai Katër kërrnacka!

— Mirëmëngjes, o trima, që na sollët lirinë! Urdhëroni! Uluni! Aman, jarebil Shyqyr, o zot, që ia arritëm kësaj dite të shenjtë! — tha burri i hollë, i kaluar në moshë, me përparëse të bardhë qumësht e me llërët përveshur.

– Edhe nga një pilaf, s'do të na bënte keq, shoku Malkë! – tha intendent Raqi duke qeshur me gjithë shpirt, i gëzuar që do të shuante urinë pas kaq vitesh me një gjellë që atij i pëlqente aq shumë.

– Kam edhe kukurec! – tha ustai, i gatshëm për t'ua lëshuar tepsinë përpara.

– Na jep, o vëlla, ç'të kesh! Ne jemi partizanët më të pasur në Shqipëri dhe në botë! E di ç'ka në atë karrocën time të varfër? Miiëra florinj e shufra prej floriri! Ajo duket e varfër, po është karroca më e pasur mbretërore në botë, me gjashtë elefantë e me një djall me brirë që i bie trumpetës.

Dyqanxhiu e mori Malkën për të dehur dhe iu bë qejfi se, me sa dukej, edhe ai pinte.

– Prej meje keni edhe nga një raki! – tha dhe filloi të mbushte pjatat duke thënë si me vete! – S'është kohë për kërnacka, po na dha urdhër. Këshilli që sot në mëngjes ta hapim pazarin. Apo jo, shoku kryetar? Na urdhëruat?

– Po, po, o Delo! – tha Avni Plaku duke rregulluar svzet, për të parë më mirë skarën që lëshonte tym të këndshëm, me të cilin visheshin kërnackat e shijshme.

– Aman, jarebi! Kur po e thyejnë qafën këta katilë nga tërë Shqipëria! Se na u çopëtuan djemtë e çunat! Era nga skara ishte dehëse, e mirë, joshëse. Deloja po i mbushte pjatat plot dhe po u hidhte erëza mali.

– Ah! Kur s'kam piper të zi! Vjen nga jashtë! I miri! – ankohej...

Atë çast komisar Irakliu u kujtua për dicka që ishte shumë e laraët dhe shumë e afërt njëkohësisht. Uli kokën dhe pyeti me zë të ulët si i turpëruar:

– A keni para me vete, o shokë?

Ata u panë sv në sy, si hajdutë.

– Jo! – tha Malka i pari. – Pse, ti s'ke?

– Unë jam krunde fare, o Malkë! – tha komisar Irakliu me zë që mezi dëgjohej, duke rrahur xhepat me pëllëmbët e ashpra..

– Edhe unë s'kam! – tha intendent Raqi duke kërkuar

nëpër xhepat e shumtë, që i kishte plot me copa lëtrash mbushur me shënime e llogari.

— S'më gjenden as mua! — tha i turpëruar Avni Plaku me dorën në zemër.

— Po, me se do të paguajmë, o Raqi? — pyeti Malka.

— Ku di unë!

— Po ti je i financës, o djall?

— Popullore e jo private! — tha serioz intendent.

Komisar Irakliu shtrëngoi dhëmbët, gjë që nuk e kishte zakon dhe tha me ingat:

— E ç'na fute këtu, o shoku Malkë, kur s'ke asnjë lopkë me vete. Ngrihuni, se s'ka lezet të hamë qyl e veresie!

U ngrit i pari, buzëqeshi kot e tha:

— Na fal, usta! Po ikim, se na doli një punë me ngut!...

Deloja ngriti supet me gjithë pjatat që kishte në duar. Nuk kuptoi përse s'hëngrën mëngjes luftëtarët. I pa kur hipën me të shpejtë në karrocën me dy rrota të mëdha. Tundi krvet e tha i menduar:

— E ka thënë Deloja: s'është kohë për kërnacka e pilaf me piper të zil! Është luftë akoma!...

Nata e fundit e robërisë kishte marrë fund. Ajo tashmë ishte shpërndarë. Rrugët ishin mbushur me njerëz, dita e re ishte bërë e prekshme. Shiu kishte pushuar. Vieshta derdate najyrat e saj të larmishme, mbi të ajiu të verdhën e portokallen, e të gjitha të buta, me erë të mirë.

— Si kështu?! Si mbetëm pa ngrënë? — tha Malka duke cvtur kalin me anë të rripave, pa e qaditur. — Po ne, shoku komisar, sikur kemi gjithë ata florinj!

— Janë të popullit ata, Malkë! — tha komisar Irakliu... Pastaj shtoi i qezuar dhe duke aeshur me zë të lartë:

— Në bankë, shoku Malkë! Shpejt! Pastaj në magazinat e miellit! Furrat tashti sa janë ndezur.

Karroca çante me rrëmbim përmes pazarit, mbi kall-drëmin që shkëlqente prej vesës së shiut më shumë se qielli i mugët dhe me re.

«DRITA» 11 e 18.III.1979

ATA ISHIN TRE

Ajo e kishte qëndisur flamurin për merak, siç qëndisnin vajzat e reja ndonjë mbulesë të pajës. Ishte një flamur i vogël, prej atllasi, në formë trekëndëshi. Thekët i kishte ngjyrë ari. Edhe yllin mbi krerët e shqiponjës, po ashtu. Neve të gjithëve na mbetën sytë tek ajo copë e kuqe që lëshonte rreze të ndritshme edhe nga lëkundja më e vogël. Na dukej si një mrekulli.

— Bukur fort! — thashë unë. — Tani flamurin do ta shpiem në mal, me gjithë një letër për shtabin. Si thua, Netë, a do të vish edhe ti? Inqugurohet Brigada.

Ajo nuk foli, po sytë e zinj i shkëlqyen. Unë e kuptova dhe i thashë:

— Atëherë, vishu shpejt! Duhet të nisemi menjëherë! Po vishu trashë, se jashtë bie dëborë dhe rruga është e gjatë.

Në oborrin e shtëpisë përdheja më futi krahun Xhemaliu, anëtari më i gjatë, më trupmadh dhe më i shëndoshë i njësitit tonë.

– Ku do të vesh pa mua! – tha duke vënë beretën në këllëf. – Nuk e sheh ç'kohë është? Shtetrrëhim. Nëpër rrugët, brenda e jashtë qytetit, lëvizin vetëm ushtarë armiq. Nga postbllloqet nuk kalon as miza. Kurse unë i njoh vendet andej nga malet, se kam qenë disa herë. Ku i dihet ç'mund të ndodhë gjatë rrugës? Aq më shumë që është edhe Neta. Ajo është e imët dhe e dobët, si karthje. Mund të mbetet në dëborë kur s'e pret. Të paktën, për çdo rast, më ke edhe mua. Nuk jam ushqyer kot, si i thonë fjalës, me qumësht dallëndysheje.

– S'e ke keq, Xhemali, – i thashë duke i dhënë të drejtë, sidomos për vajzën. Neta ishte vërtet e imët dhe e brishtë, si një lastar i njomë. Ishte dhe fjalëpakë, si me-mece, e ndrydhur dhe e druajtur gjer në dhembje.

Ajo u vonua pak, sa rregulloi flamurin në gji dhe sa veshi çizmet prej Ilastiku. Po edhe ashtu, e veshur trashë, me pallto të shkurtër prej shajaku e me shall leshi në kokë, m'u duk si njeriu më i dobët dhe më i pazot që kisha njohur gjer atëherë. Bile, më erdhi për ta mëshiruar, kur doli në oborr dhe filloi të shkelte dëborën me hapat e shpejtë e të vegjël. Te pragu i shtëpisë desh i thashë. «Kthehu ti, Netë! Po shkojmë ne me Xhemaliun.» Po nuk e bëra këtë, se më erdhi keq, kur shqova gëzimin që shprehnin sytë e saj të zinj.

– Epo, meqë jemi gati, nisemi! – thashë dhe kështu u nisëm për në male që të tre.

Ishte kohë dreke dhe binte dëborë. Kishte filluar që ndaj të gdhirë dhe vazhdonte të binte pa pushim me copa të mëdha. Për të mos rënë në sy, kaluam nëpër rrugica të ngushta e të qeta, të cilat, nga dëborë e madhe, dukeshin edhe më të ngushta e më të qeta. Në fakt ne duhej të ecnim drejt perëndimit, drejt Voskopojës e Lavdarit të Oparit, po, për t'iu shmangur postbllloqeve, morëm nga verilindja, mbi kodrat e qytetit, drejt Burimeve të Çardhakut, ku shkoni për piknik gjatë verës. Me t'iu afruar Barçit, do të zbrisim tatëpjetë, do të kapërcenim xhadenë që lidhte Korçën me Bilishtin dhe, me të rënë në fushë, do të ktheheshim drejt perëndimit,

për në Voskopojë dhe Opar. Rruga na zgjatej nja katër-pesë orë të mira, po kështu ishim krejtësisht të sigëruar, nëse mund të ketë rrugë «krejtësisht të sigëruar» në kohë lufte. Veç kësaj, mendonim se, po të ecnim ashtu siç e kishim filluar, pa u çlodhur në asnjë vend dhe po të mos na dilte rrugës asnjë pengesë, në mbrëmje do të ishim patjetër mbi Pocestë ose në Klos. Andej pastaj e kishim më lehtë, se ishte zonë e lirë. Mund të udhëtonim fare mirë tërë natën, mbasi kishim me vete Xhemaliun, i cili kishte qenë atyre anëve edhe herë të tjera dhe e njihte vendin mirë.

Mirëpo...

Mirëpo, me të mbërritur pranë Barçit, në kohën kur po vështronim me admirim perden e bardhë e të trashë të dëborës, e cila binte butë-butë mbi çdo gjë të tokës, mezi dalluam në xhade një autokolonë gjermane, që zvarrisej me uturimë Jrejt qytetit. Gjersa u zhduk makina e fundit, na u desh të prisnim dy orë të mira. Atëherë zbritëm gati me vrap midis drurëve të zhveshur e të rrallë të pyllit, kapërcyem xhadenë dhe ramë në fushë. Po pikërisht atëherë ra edhe nata. U bë pus brenda disa minutave.

— Ku jeni? — pyeti Xhemaliu, që ecte përpara dhe çante dëborën me hapat e tij të gjatë.

— Ec! Ec! — i thashë unë që isha i fundit, pas Netës, duke ndier një sëmbim të lehtë në ijen e djathtë, po Xhemaliu priti gjersa iu afruam:

— Si thoni? Të vazhdojmë më tej? — pyeti ai duke ndezur cigaren. Në dritën e shkrepësës e pashë të mbuluar krejt me dëborë. Me siguri, ashtu do të ishim mbuluar edhe unë me Netën.

— E përse të mos vazhdojmë?! — e pyeta si me habi.

— Po ja, — tha me mëdyshje, — gjithë ajo ushtri. Nuk erdhi kot këtej...

— Ushtria ka punën e vet. Ne kemi punën tonë; — e ndërpreva dhe ndjeva përsëri pickimin e lehtë, por të hidhur, në ijen e djathtë.

Ai nuk më la që ta çaja unë rrugën.

Ç'eshtë ajo, — tha — gjë që s'bëhet. Ecnj pas meje. Edhe ti, Netë, mos u shkëput. Qepmu këmba-këmbës. Po të lodhesh, më bëj zë!

Vajza nuk mundje fare dhe gjersa arritëm në Luadhet e Vashtëmesë, nuk këmbuem asnjë fjalë. Dëbora binte pa ëpushim, qetë-qetë, nuk dëgjohej gjë e gjane, as zë njeriu; asq cicerinë, as lehiqe qensh. Gjithkund zotëronte një neshitje e mërzitshme dhe e bezdisshme varri, që prishej vetëm nga zhurma monotone e chapave tanë. E Luadhet e dëgjua mënjë uturimë motorësh dhe qëndruam e z vumë vesh. Pak më vonë, në xhade u dukën drita makinash si të veshura me avull nga dëbora dhe nga mjegulla. Nuk tishim më larg se dyqind metra dhe u bindëm se qe auto-kalonë ushtarake.

Eshhtë ajo që pamë nga Barçi, — tha si më ankim Xhemaliu, duke rrafhur pa pushim këmbët mbi dëborë. — Ru na doti tanë që kam dhe këmbët qull-gjer në pupë. E zhyta atje të Luadhet në një lloj mburuar me oë-borë.

Edhe unë i kisha këmbët të lagura, se ndjeja që po më mberdhnin gishtërinjtë.

— Po ti, a je lagur? — e pyeta Netën. — Ke të ftohtë? Je lodhur?

Në vend të saj dëgjova zërin e Xhemaliut:

— Ku vete gjithë kjo ushtri? Në Pogradec? Në Elbasan? Në Tiranë? Apo mos futet Gorës e Oparit, andej nga shkojmë ne?

Unë nuk u përgjigja. As Neta, kurse ai, filloi vërtet të ankohej e të qajë pa pushim për këmbët e qullura.

— Më djegin!... Më shpojnë sikur më kanë futur gjilpëra!... Me siguri do të më mbushen me fluska, do të më ngrijnë. Mos na bëhet ndonjë gangrenë, dregi e mori! — dhe, duke iu marrë fryma, u kollit thatë nën jakën e palltos, ngarkuar me dëborë.

Dyzet e tetë makina! Tetë tërheqin topa! — tha Neta me zë të heshtur, gati të këputur, kur kaloi para nesh makina e fundit.

— Tamam aq numërova edhe unë, — thashë i habitur nga vëmendja e saj.

— Si do të bëjmë, se unë nuk qëndroji dot në një vend! Të ftohtët po më ngjitet në tërë trupin. Edhe duart m'u bënë akull, — tha Xhemaliu po me atë zë ankues duke hukatur duart.

— Nisemil — thashë dhe më të lidhura hapin e parë, ndjeva po atë pickim në ijen e djathtë. Po kësaj radhe pickimi ishte i fortë, si një kafshim qeni. Instiktivisht vura dorën në ije, duke kafshuar buzën fort që të mos nxirra ndonjë psherëtimë apo klithmë. Dorën prakur ite revolverin dhe atëherë mendova se mos, kushëdikujajo copë hekuri do të më kishte vrarë ijen. E shtyva armën më tej brezit dhe ndjeva njëfarë lehtësimi.

— Ç'ke? — më pyeti Xhemaliu dhe dëgjova si kërcisnin lehtë dhëmbët nga të ftohtët.

— Asgjë! — e gënjeva dhe eca i pari për të çarë dëborën. Pas meje ecte Neta, kurse ai na ndiqte pas, me hapat e tij të gjatë.

Nuk mund ta them me përpikmri sa ishte ora, po kur kapërcyem xhadrën të gryka e Pöcestës dhe morëm përpjetë kodrave, drejt perëndimit, mesnata duhej të ishte pranë, mbase një këndes, një këndes i vetëm e i pagjumë, ndoshta i trëmbur nga uturima e motoreve, ia thirri këngës me një tingull të ngjirur e të zgjatur. Ndodhë nganjëherë që këndesat, të gënjer nga koha, këndojnë aty nga mesnata. Si përshëndetsh Rjani-tjetrin, ia merrnin përsëri me gjumë. Po atë natë ai këndes mbeti i vetmuar. Nuk e pash asnjë nga vëllezët e tij dhe përsëri mbi bardhësinë e hirtë e të pafund dhe mbi këngën e ngjirur e të zgjatur të këndesit më heshtja.

Unë eca përpara dhe herë-herë ktheja kokën dhe vëshitoja Neta-n që më ndiqte këmba-këmbës. Xhemaliun, që ecte prapa mezi në dalloja dhe nganjëherë më humbte nga sytë. Ai mbetej pas dhe shpesh në ndalnim për ta pritur. Duke iu afruar majës së kodrës së zhveshur, dëgjova prapa kraheve një gulçimë të mbytur.

«U lodhl – mendova me keqardhje për Netën. – Kot i thashë të vintc. Më mirë të rrinte në shtëpi, pranë sobës. Kjo natë s'është për vajzat e brishta si ajo!»

Qëndrova në majë të kodrës dhe ktheva kokën prapa. U habita. Nuk gulçonte Neta. Ajo gulçimë e mbytur dhe ajo frymëmarrje e shturur dhe plot drithërima vinte që prapa shpatullave të saj. Por, u habita më shumë kur dallova dorën e Xhemaliut mbi supin e Netës. Më hipi gjaku në kokë. Ai, goxha derr, të ecte mbështetur mbi supet e njoma të vajzës! Si e përmbajta veten, nuk e di! Ndoshta më ndali vështrimi i butë i syve të saj të zinj që e kapa kur ndeza çakmakun.

– More! – psherëtiu Xhemaliu si u mbush me frymë. – Ç'e përpjetë! Na dërrmoi fare! Po këmbët, ama, na u ngrohën!

E qortova dhe e shava për atë që bëri. Ai, me fjalët që tha, m'u duk sikur kërkoi të falur.

– Ke të drejtë, o Luli. Po këtu pranë majës thashë se më mbeti zemra.

U ulëm në një vend rrethuar me dëllinja. Nuk këmbuem asnjë fjalë ato dhjetë minuta. Xhemaliu, mbështetur pas dëllinjës, dukej nga frymëmarrja e rregullt se ndihej mirë dhe ngrohtë. Unë mendoja për Netën. «Si nuk u ankua një herë kjo vajzë! Si nuk u qa! Si nuk tha një fjalë!»

E pyeta papritur:

– Nga je ti, Netë?

– Nga malësia e Moravës.

– Kur ke ardhur në qytet?

– Pasi u dogjëm në Luftën Italo-Greke, më dyzetën, kur isha pesëmbëdhjetëvjeç.

Nuk ma merrte mendja që të ishte tetëmbëdhjetë vjeç. E kujtoja më të madhe, rreth të njëzetepesave, ndoshta pse ishte si e vvarë në fytyrë nga vuajtjet e mundimet. «Si nuk u ankua një herë kjo vajzë! Kurse ky tjetri që dremit, turp të ketël Alamet zdapi i shëndoshë, veç të mburret dil

– Ngrehu! – i thirra, – se do të ftohesh, Xhemali!
Ai brofi menjëherë në këmbë, i trembur dhe belbëzoi duke u dridhur lehtë:

– Më kishte zënë gjumi. Gjumë për kokë të gjumit!
Veçse më qenka mbushur trupi me mornica. Epo, nisemi, pra! Ç'presim?!

Megjithatë, priti sa u nisa unë i pari, shtyu lehtë Netën që të ecte pas meje dhe vetë mbeti përsëri i fundit.

Filloi të frynte një erë e lehtë, që shumë shpejt u bë e vullshme dhe e ftohtë. Na e dërgonte peshqesh Morava. Ishte ajo, që ne e quajmë «Cangonjarka», se del si një përbindësh nga gryka e Cangonjit, ngre tufane në fushën e hapur e pa mbrojtje dhe i përplas pastaj grykave, pllajave e maleve në perëndim e veriperëndim, ku shtrihen krahinat e Oparit e të Gorës. Era e ngriti dëborën përpjetë si hi e si mjegull, pastaj e ngriu dhe e ktheu në saçma të vogla. Ngriu edhe shtresa e sipërme e dëborës dhe në fillim rruga sikur na u lehtësua. Po, pas ndonjë ore, si kaluam lajthishtat e dushqeret dhe ramë në një pyll me pisha të rralla, era na doli përpara, na preu udhën dhe na godiste pa pushim, duke na hedhur fytyrës saçmat e bardha që na shponin sytë, ballin, buzët e faqet. Pylli kuiste vazhdimisht. Nga pishat rrëzoheshin dengjet me dëborë. Kërcisnin degët e thata që era i shkulte me dhëmbët e saj të padukshëm. Megjithatë, ne ecnim pa pushim, unë përpara e ata pas meje, në një rresht, shumë pranë njëri-tjetrit. S'kishnim ku të fusnim kokën dhe i vetmi shpëtim ishte që të vazhdonim rrugën pa u ndalur për asnjë çast, në asnjë vend. Ecnim shpejt tatëpjetë një pllaje dhe nga afshi i brendshëm palltot na u bënë të forta si lëkurë e tharë në diell. Fryma na ngrinte dhe përreth jakës u formuan koktriza akulli. Më kokrriza na u mbuluan flokët në ballë, vetullat, qepallat, ndërsa faqet e nofullat na i pickonin erë dhe saçmat e bardha të dëborës. Kur filluam të ngjisnim përsëri një të përpjetë, na u desh të prisnim Xhemaliun, që na mbeti prapa. Unë i hodha dorën në krah Netës dhe e pyeta se si e ndiente veten. Palltoja e saj ishte bërë gur. Ajo kishte

hallin t'ëm e të Xhemaliut, i cilí, me të na arritur, belbëzoi me një zë të ngrirë:

— U thava, o shokë! Nuk mundem më! Të qëndrojmë e të nderim ndonjë zjarr këtu.

E kishte lëshuar veten fare dhe sytë, nga ngricat, i kishte si me sklepa.

— Duro edhe pak, Xhemali, — i thashë. — Për një orë arrijmë te stanet. Është një kasolle atje. Atje nderim edhe zjarrin. Ti eja ngadalë, s'ka gjë!

Nuk ia zajata më dhe vazhdova rrugën krah për krah me Netën. Dëbora pothuajse kishte ngrirë dhe s'qe nevoja që njëri naa ne të ecte përpara për ta çarë. Këpucët tona, të hëra edhe ato kallkan, hynin vetëm një pëllëmbë në ciën e ngrirë. Kjo na ndihmonte në ecje, po era vazhdonte të na binte ballë për ballë, kërcënueshëm, me një furi të tërbuar, sa nuk ngopeshim dot me frymë. Kështu që gjithë atë pllajë e ngjytëm duke ecur brinjazi, si gaforret. Unë bëja ç'bëja dhe përmes qepallave të mbuluara me dëborë i hidhnia naa një vështrim Netës. E mjera vajzë, më dhimbsej! Era ia përrolaste kindat e narira të palltos pas çizmeve prej aome. Me siguri, këmbët nuk i ndiente më. Unë e di mirë që çizmet prej gome të mbajnë shumë ftohtë. Është niësoj si të ecësh zbathur. Ashtu, e vogël dhe e imët, e mbledhur shuk nga të ftohtët, dukei si një boçë e thatë pishe, aë nga çasti në çast era do të rrëmbente e do ta përplaste ku të mundte. Por jo. Unë isha gabuar në mendimet e mia, isha nisur vetëm nga ana e jashtme. Por, ta vlerësosh njeriun nga ana e jashtme, është hiç me hiç. Nëna ime gjithnjë i këshillon djemtë e vajzat që janë bërë për t'u fejuar: «Hapni sytë! Bukuria është një copë herë! Zqjdhni njeriun, të ketë mend në kokë dhe shpirt e zemër në aji!» E tillë ishte Neta. Aio kishte një zemër të madhe që i rrihte fort në gjí, nën atë flamurin e vogël, të cilin e kishte qëndisur vetë. Aio ishte shpirti i vërtetë i quasar!

Më tej, kur ramë në një përrua për të dalë në stanet, te kasollja ku kisha aenë verës që kaloi, rruga na u vështirësua më tepër. Aty era nuk ishte aq e vrullshme,

po dëborë ishte e butë dhe këmbët na futeshin thellë, gati gjer në brez. Veç kësaj aty më theri përsëri ana e djathtë e ijes. Më ngjau sikur m'u ngul gjer në mykët një thikë e mprehtë. Nga dhembja e madhe dhe e vazhdueshme e shtrëngova vendin fort dhe me të dyja duart. Jo. Nuk ishte revolveri që ma shkaktonte atë dhembje therëse. Ishte diçka tjetër, që e kuptova kur më erdhi për të vjellë e më plasi vreri nga goja. Ishin shenjat e para të apendicitit. Unë e njihja mirë këtë sëmundje. E kisha hequr nja shtatë vjet të kaluar dhe akoma i mbaj mend dhembjet e tmerrshme. Atëherë mjeku pat thënë se duhej operuar. Po ne ishim shumë të varfër dhe operacioni kushtonte një djall e gjysmë... Dhe ku e gjeti të më zërë sonte, në një natë dimri të egër, pranë një vajze që vjen në këto anë për herë të parë, pranë një të riu që mezi çan dëborën çalë-çalë dhe është gati të vërë kujën nga dhembja e këmbëve të ngrira, në një kohë kur një auto-kolonë e gjatë armike flet qartë për fillimin e një operacioni të gjerë, e neve na duhet të shpiem patjetër flamurin dhe letrën në shtabin partizan!

Dhembja më preu gjunjët dhe rashë mbi dëborë. Neta m'u afrua dhe më pëshpëriti fare pranë veshit:

– Ç'ke, Luli?

Pëshpërima e saj ishte si e ngrirë dhe e shqetësuar.

Unë e gënjeva:

– S'kam gjë. U pengova dhe u rrëzova. Më duket se kam ndrydhur pak këmbën e djathtë. Po, do të më kalojë. A duket Xhemaliu? – dhe bëra përpjekje të ngrihesha.

– Tani sa doli përfund pishave, në përrua!

Neta e kuptoi që s'i tregova të drejtën. Më futi duart nën sqetulla dhe më ndihmoi të ngrihesha në këmbë. Megjithëse m'u drodhën gjunjët, më erdhi për të vjellë dhe dhembja filloi të më përhapej në gjithë barkun, ecja duke u lëkundur. Ajo ma mori krahun dhe e hodhi rreth qafës së saj. Kështu e bëmë atë copë rrugë gjer te stacionet verore, duke ndier frymën e njëri-tjetrit. Kur arritëm te kasollja e braktisur, e cila ishte hepuar nga pesha e dëborës, diku nga veriu çau qiellin një fishekzjarr blu.

Një tjetër, i kuq, vetëtiu më larg, nga jugu. Menjëherë pas tyre era solli jehonën e një brëshërie armësh:

— Autokolona! — tha Neta, shtyu derën e kasolles dhe unë u gjeta papritur në një errësi të plotë, ndërsa Neta u kthye për të marrë Xhemaliun.

* * *

Gjysëm ore më vonë mbërriti Xhemaliu. Ndërkaq Neta, me një shkathtësi të çuditshme, e kishte ndezur zjarrin në vatrën primitive. Unë u shtriva mbi ca fije bari e hala pishe të ngrira. Ajo doli përjashta dhe u khye me një krah karthje e degë të thata e të holla. Shpejtësia e saj ishte e mahnitshme. Dëgjoja si kërcisnin në duart e saj të ngrira karthjet e degët. Pastaj pushë shkrepësen dhe flakën e dobët që filloi të lëpinte me gjuhën e zjarrtë fijet e barit të thatë e të karthjeve. Kur zjarri mori jetë mirë dhe flaka na ndriçoi fytyrat, pamë tavanin e kasolles, të mbuluar me fier të dendur, mbushur tërë qirinj dhe kristale akulli dhe, ngaqë bënte shumë ftohtë, na u duk sikur ishim më ndonjë guvë të nëndheshme prehistorike, mbushur me rrëkeza uji e stalagmite. Edhe muret kishin zënë një shtresë të hollë dëbore, megjithatë aty ishte më mirë sesa jashtë. Pas pak kasollja u mbush me tym, kristalet filluan të shkrinin dhe qirinjtë prej akulli të pikonin.

Unë përpëltesha vazhdimisht, shtrirë pranë zjarrit. Neta s'dinte ç'të më bënte. Më vuri dorën në ballë dhe tha:

— Ke temperaturë. Do të jesh ftohur.

Unë kësaj radhe i tregova të drejtën.

— Kam apendicit! E kam hequr njëherë këtë dreq sëmundje!

Ajo doli me shpejtësi dhe u kthye me një shuk dëbore, mbështjellë me shami.

— Kam dëgjuar se të bën mirë, — tha duke ma vënë me kujdes në ijen e djathtë.

– Ashtu është. Nëna më vinte lecka me ujë të ftohtë...
Po ti afrohu te zjarri! Ngrohu! Hiqi çizmet!...

– Ja! Sa të shoh Xhemaliun, – dhe doli përsëri me ata hapat e lehtë e të shpejtë.

Mua më vinte të haja veten me dhëmbë, megjithëse e dija që s'kisha faj dhe bëja çudi me forcën fizike e shpirtërore të Netës. Ajo kishte vërtet një zemër të madhe!

Hynë të dy pas pak. Xhemaliu mezi mbahej më këmbë me njërin krah hedhur mbi supin e saj. Sikur Neta t'ia hiqte krahun, ai do të përplasej përtokë. Ajo e uli pranë zjarrit me kujdes të madh, sikur të ishte prej qelqi e do të thyhej. Pastaj, pa humbur kohë, mezi ia zgjidhi lidhëset e nqirra të këpucëve. Xhemaliut i kishin ngrirë vërtet këmbët, i qenë bërë kallkan dhe ajo, si një njeri i sprovuar, ia fërkoj mirë e mirë me dëborë gjersa iu bënë të kuqe flakë.

– Tashti i kam mirë: Ndiej që në to më vërshon ajaku, – tha Xhemaliu duke u strukur fare pranë zjarrit. Sytë e tij iu lënqështuan dhe unë nuk e kuptova arsyen. I kishte nga dhembja, nga tymi apo nga mirënjohja ndaj Netës! Apo ishin ngricat e dëborës që i shkrinin nga vetullat e qepallat e tij! Strukur pranë zjarrit, ai dremiste dhe, në dremitje e sipër, rënkonte e fliste si përçart. Neta kujdesej për zjarrin, sillte nga jashtë ashklla, karthje, thante çorapet tona, më ndërronte shaminë në ije dhe nuk fliste. Vetëm një herë tha me keqardhje:

– Xhemaliu pothuaj se është zbathur. Çorapet i paska fare të holla dhe të grisur përfund. E si të mos i mbërdhijnë këmbët?

Njëherë ktheu kokën nga dera dhe u ngrit papritur. Dikush ishte atje. Mu duk si një gjë e gjallë, si një kokë mbuluar me dëborë. Gjer atëherë ne s'kishim parë asnjë kafshë e asnjë shpend. E pra ato anë janë plot me lepuj, me ketra, me sorkadhe. Thonë se ka edhe ujq, edhe arinj. Verës dëgjohet kënga e thëllëzave të malit dhe e pëllumbave të egër. Kurse atë natë asgjë, veç bardhësisë dhe ulërimës së erës.

...Neta u kthye shpejt dhe mbylli derën mirë. E pyeta:

— Kush ishte?

Ajo vanoi të përgjigjej.

— Një ujk vjen rrotull kasolles, — tha, duke hedhur ashkla mbi zjarr.

— Do të ketë këlyshët këtu pranë. Me siguri ka dhe uri.

Ne folëm një copë herë për ujqit dhe për egërsirat e tjera të pyjeve. Ajo më tregoi historinë e një ujku këlysh që i ati e kishte gjetur në malin e Morayës dhe ua kishte çuar në shtëpi. E kishin ushqyer me qumësht, si një fëmijë. Po ditën e parë që u lëshua, ua mbathi këmbëve drejt Morayës me gjithë rripin që i kishin vënë në qafë dhe nuk u kthye më.

Xhemaliu u zgjua papritur. E kishte mbledhur veten, po i vinte rëndë të na shikte në sy. Duke veshur çorapepet e holla e të thara, murmuriti me dëshpërim.

— Djalli ta marrë! U bëra si kalama! Më vjen turp! Dhe përse? Për një palë çorape! E dija veten të fortë, po baskam qerë një higjë!

— Çdo të bëjmë tani? — pyeti dhe u ngrit në këmbë duke u ngërdheshur në fytyrë. Me sa dukej, i çanin kockat. Muanu dhimbs, po më erdhi edhe mirë që u tregua që i gatshëm. Atij ndoshta i qe mbledhur ndonjë nyjë nga leckat e çorapeve.

Xhemali! — i thashë me të butë. — Mos u dëshpëro kaq shumë, se s'u bë kiameti! S'ke bërë ndonjë faj.

— Jo! Po më vjen inat sa të pëlças, se këtyre anëve kam qerë disa herë, e kështu s'më ka ndodhur.

— Po kjo është një natë e jashtëzakonshme... Dëborë... Tufan...

— Po për këtë s'ka dëborë e tufan?! — u gati thirrri atë duke u drejtuar nga Neta.

— Vajza më mbante sytë poshtë. Unë s'dija ç't'i thoshja. U bë një qetësi e madhe. Dëgjoheshin vetëm ashklatat e thata që kërcisnin në zjarr. Thashë me vete: «Ajo ka zëmër të madhe. Xhemali!» Pastaj e përsërita këtë me zë të lartë.

— Ashtu thuaj: Ka zemër të madhe. Kurse unë, pse s'kam corabë! Pika aë s'më bie në çakë të kokës! — Ai bëri me dorë një shënjë pakëndaësie dhe më pyeti: — Po ti ç'ke? Mos të ngrinë edhe ty këmbët? Mos kapute mish?

— Aty afër, — u përgjigja dhe, duke mbatfur këmbët, vazhdova. — Nuk dimë sa është ora. Nuk dimë as sa orë rrugë duhet të bëjmë për të mbërritur në shtab. Nuk dimë as ç'na pret përpara. Dimë vetëm që kemi një flamur dhe një letër të Qarkorit dhe oë duhet t'i dbrëzojmë patietër, në mëngjes, ose, shumë-shumë, në drekë. Pran-dai do të nisemi dhe nuk do të qëndrojmë më në asnjë vend. Veç në qëlloftë të ndeshemi papritur me armiq.

Unë e ndieja veten më mirë. Shmia më dëborë e Netës më kishte mpirë dhembjen. Thellë ende, diçka më pickonte, po mund të ecja lirshëm, pa u kërrusur.

— Nuk do të bëie keq aë ti të qëndroje, — më pësh-përiti Neta, kur u bëmë gati për të dalë.

— Në asnjë mënyrë! — e kundërshtova. — Ta dj se vdes!

— Më thotë aië? — s'voti Xhemaliu, që po dilte i pari.

— Jo, jo! — u përgjigja.

— I them të qëndroje, se është i sëmurë. Ka apendicit,

— i shpjegoi Neta me një frymë.

— Apendicit?! — u habit Xhemaliu. — Përse ma fshe-hët? Mos, kujtoni se do të më humbiste burrërin dhe do të më hynë tmerri? Po, keni të drejtë. Vetë i kam fajet. Vetë u bëra i tillë, sa të mos keni as besimin më të vo-aël te shoku juaj Neise. Po ja ku po të them, luli më dëgion? Është marrëzi të udhëtosh, kur ke apendicit. Të pëlçet, të bëhet peritonit dhe me kaq mbaroni! Kthehu! Kthehuni të dy! Flamurin dhe letërën i shpie unë. Dhe yu-t'ju marr me shokët.

— Jo! Jo! — kundërshtova. — Do të shkojmë të tre. Nuk do të ndahemi.

— Ah! E di unë përse s'prahoni! S'keni besim! S'keni besim!

Në zërin e Xhemaliut ndihej një pezmatim i thellë.
– S'është punë besimi, Xhemali, – i thashë duke e shtyrë lehtazi nga shpatullat, që të dilte nga kasollja, e cila ishte kthyer në një pus të errët.

– Po ç'është atëherë?!

– Unë e di që ti mund të vesh vetë deri në shtab. Po ajo autokolona që pamë dy herë, është derdhur në këto anë dhe mund të ndodhë çdo gjë. Mund të ndodhë që të biesh në përpjekje. Dhe në raste të tilla më mirë të jesh me shokë se vetëm.

Ja thashë këto me bindje të plotë. Ai e kuptoi këtë, i kuptoi drejt fjalët e mia, megjithatë doli duke pshe-rëtitur.

Dëborë binte vazhdimisht, ajri qe shumë i ftohtë dhe era kuiste përsëri, si më parë. Qëndruam pakëz te dera e kasolles për t'u orientuar e për të vendosur se nga do të shkonim, kur Neta më shtrëngoi për bërryli e më tha:

– Shikoje! Ja ku është!

Buzë një shkurreje, disa hapa larg nesh, një ujë me qimet e ngritura e të mbuluara me ngricë, ishte bërë njësh me dëborën. Mbase kafsha e kishte gërryer dëborën për t'u mbrojtur nga thëllimi, po ne nuk e shihnim mirë. I dallonim sidomos turirin, që e mbante përpjetë. Futa dorën nën pallto, për të nxjerrë revolverin. Ujku, si duket e ndjeu rrezikun, se u ngrit në këmbë, nxori një hungërimë të tërbuar dhe sakaq na humbi nga sytë. Unë, që ecia i fundit, disa herë e ktheva kokën prapa se mos na ndiqte, po s'e pashë më. Mbase aty rreth kasolles kishte këlyshët e vet. Ku ta dish.

Rrugën e çante Xhemaliu dhe nuk pranonte në asnjë mënyrë që të dilnim përpara unë ose Neta. Ecnim pranë e pranë, në gjurmët e njëri-tjetrit, pa pushim. Nuk qëndronim as kur në qiell, me intervale të zgjatura, majtas e djathtas nesh çanin qiellin fishekziarret e kuqe e blu dhe as kur era sillte nga larg jehonën e krismave. Neta na kishte dhënë një mësim të mirë dhe e ndienim veten më të fortë. Herë-herë diçka e pyeste Xhemaliun. Nuk e dëgjoja përgjigjen e tij, po në timbrin e zërit s'dalloja

as ankim, as shqetësim dhe as dëshpërim. Dhe kjo më gëzonte. Nganjëherë ajo kthente kokën dhe më pyeste në kisha dhembje.

— Më thkuaj të drejtën! — ngulte këmbë.

— Të drejtën po të them. Është një dhembje që mund të durohet.

Thëllimi u bë më i egër dhe nuk e kuptonim në vazh-donte të binte dëborë apo ishte tufani që e ngrinte atë si pluhur dhe na e përplaste në fytyrë. Megjithatë, ndjeva njëfarë gëzimi, se nga shtimi i acarit, e kuptova që po afrohej agimi. Pikërisht atëherë dalluam përmes mjegullës një kope ujqish të uritur. Qëndronin në këmbë, në rresht, nja njëzet metra larg, në krahun tonë të majtë. Turinjtë i kishin kthyer nga ne dhe rrinin të ngrirë, si mumje. Vetëm njëri, ai që ishte në krye të kopesë, vinte poshtë e lart dhe nganjëherë ulej e tërhiqej barkazi mbi dëborë. Ne shtrënguam armët dhe i parakaluam gjersa na humbën nga sytë. Po na dolën përsëri pak më tej. Qëndronin si më parë në rresht, me turinjtë nga ne dhe vetëm njëri vinte poshtë e lart. Me sa dukej, kishin frikë të sulmonin. I pamë edhe një herë tjetër, në të njëjtin pozicion. Ata na ndiqnin. Sa largoheshim, vraponin rrugës së tyre dhe zinin shtegun nga do të kalonim ne. Nuk na dilnin ballë për ballë, po anash. Dhe kjo vazhdoi gjersa filloi të gdhinte. Pastaj nuk i pamë më.

Dita zbardhi shumë ngadalë dhe shumë e ftohtë. Për një kohë të gjatë në qiellin e ngrirë u mbërthye një gri e errët, tinëzake e mashtruese. Dëborë pushoi, edhe tufani, po ishte aq ftohtë, sa pështyma kthehej në akull porsâ binte mbi dëborë. Ne ngjitëm një të përpjetë përmes pishave të dendura dhe qëndruam në majë të saj. Horizonti po zgjerohej dhe po mbushej me dritë. Kudo bardhësi e dëborë: në majat e larta, në shkrepat, në rrëpirat dhe honet. Bardhësi dhe bukuri e mrekullueshme që të vriste sytë. Po ne s'e kishim mendjen te bukuria përrallore e natyrës dhe s'na bënte ndonjë përshtypje. I hodhëm një vështrim rrugës që kishim bërë dhe asaj që do të bënim. S'na kishin mbetur edhe shumë. Po të udhëtonim mirë,

shumë-shumë për dy orë arrinim në shtab. Mirëpo pikërisht atëherë, në krahun tonë të djathtë, në rrëpirë, po kacavirreshin drejt nesh nëpër shtegun e ngushtë tri qenie të gjalla. Në fillim nuk e kuptuam ç'ishin. Ata ecnin të tre gati në një rresht. Ç'të ishin? Njerëz, egërsira apo fantazma? Megjithëse ne, që të tre, si të rinj komunistë që ishim, nuk besonim në fantazma. Po nuk i dallonim mirë se aty poshtë, në rrëpirë, megjulla ishte më e dendur. Vumë re se u nxinin vetëm këmbët dhe ca si hunj të shkurtër që mbanin nëpër duar. Pjesën tjetër të trupit e kishin krejtësisht të bardhë, të njëjtë me dëborën. Ne zumë vend prapa një shkëmbi mbi të cilin shtrinte deget e gjata një pishë e re. Pas pak ata u afruan dhe ne i shquam.

— Gjermanë! — thamë hë një gojë unë dhe Meta.

Ishin veshur me pelerina të bardha fund e krye për t'u maskuar. Mua sepse m'u kujtua ajo përralla e ujkut, që i bënte këmbët me miell për të mashtruar kecaj. Sikur gjermanët t'i kishin edhe çizmet, edhe armët të bardha, më siguri ne do të binim patjetër në grackën e vdekjes. Vështruam njëri-tjetrin dhe, pa folur, nxorëm armët. Kishim gjithë-gjithë dy revolverë me nga një karikator dhe dy bomba, një italiane dhe tjetrën angleze, nga ato që janë si kurriz breshke. E mira që të iknim e të mos binim në përpjekje, se nuk i dihej kësaj pune. Mund t'i vrisnim, po mund edhe të na vrisnin. Këtë porosi më kishin dhënë në qytet. Po ishte tepër vonë. Nuk mund të iknim. Ata na dolën papritur. Për të mbërritur gjër te pylli me pishë të mëdha që kishim përpara, duhej të paktën një gjysmë orë e mëte. Veç kësaj, nga vendi ku ishim, e gjër te pylli shtrihëj një pllajë krejtësisht e zhveshur, pa asnjë shkurre e pa asnjë gur e gropë. Gjermanët, me siguri, do të mbërrinin më parë te vendi ynë, do të dallonin gjurmët tona dhe do të na grinin me automatike.

— S'ka rrugë tjetër — u thashë shokëve duke vënë të dyja bombat përfund shkurreve të ngjira që rrethonin pishën. — Ndryshe, e kemi të humbur dëvanë!

Xhemaliu bëri po me kokë, i futi revolverit plumbin në gojë dhe i hoqi siguresën. M'u duk i qetë dhe i vendosur. Dhe qëndrimi i tij më dha zemër. Po ishte aq ftohtë, sa mund të dridhej edhe tërë trupi. Kurse Neta ishte e shqetësuar. Për herë të parë e shihja aq të shqetësuar. Sytë e saj të zinj nuk përqendroheshin. Herë vështronin shtegun nga ngjiteshin gjermanët, herë bombat e revolverin, herë mua. Nuk e kuptoja atë shqetësim. Më në fund ajo vuri dorën në kraharorin e vet dhe më pëshpëriste:

– Sido që të ndodhë, këtu e kam flamurin.

Unë ia mora dorën në dorën time dhe nuk i fola.

– Jam pa armë, – vazhdoi. – Do të marr revolverin tënd, – dhe ma mori.

– Di ta përdorësh? – e pyeta.

Ajo pohoi me kokë dhe pas kësaj nuk folëm më.

Përmes shkurreve që rrethonin pishën vështronim gjermanët. Ata ecnin ngadalë, shumë ngadalë, se e përpjeta ishte thikë. Ecnin me kujdes, vrojtonin përreth me vëmendje të madhe, me automatikët gati për të hapur zjarr. Një herë qëndruan dhe, ai që ishte në mes, nxori dylbitë dhe pa kreshtat anash e përpara një copë herë të mirë dhe përsëri vazhduan shtegun përpjetë, drejt nesh, duke nuhatur edhe ajrin, si ato skilet dinake. Unë u binda që nuk na kishin diktuar. Po të na kishin diktuar, nuk do të vinin kështu, si cjapi te kasapi. Domethënë, ne ishim maskuar mirë aty te shkëmbi, mbi të cilin ngrihej e drejtë dhe lozonjare pisha e re. Na mbronin nga dylbitë ato shkurret e dendura e të thata, përmes të cilave dallojmë mirë çdo lëvizje të tyre. Ata kishin automatikë. Revolverët, bombat dhe karikatorët me plumba u vareshin në bel. Ishin shumë më të armatosur se ne. Po ne kishim një epërsi të madhe: ishim lart, të maskuar e disi të çlodhur, kurse ata poshtë, krejtësisht të zbuluar dhe të lodhur nga ajo e përpjetë si thikë. Në fillim na hëngri meraku se mos ishte pararoja e ndonjë reparti gjerman. Po pastaj u bindëm se nuk qe pararoja. Rrëpira ku ngjiteshin ata, ishte pa fund. Fillonte tutje, poshtë një korijeje me dushk

të rrallë. Nga korija e gjer atje ku ishim ne, meqë shtegu ishte shumë i përpjetë, edhe njeriut më të forte nga këmbët do t'i duheshin jo më pak se dy orë. Po gjithë ajo rrëpirë, ishte e zbrazët dhe e heshtur. Pra, ata ishin zbulues. Edhe sikur reparti i tyre të ishte fshehur diku nëpër përrrenjtë e korijes, ne nuk na arrinte kurrsesi.

Nuk kaloi ndonjë kohë e gjatë gjersa ata u afruan, po neve na u duk sikur kishim një shekull që prisnim aty, shtrirë e ngjeshur pas dëborës, prapa shkurreve të ngrira e trungut të ashpër. Kur ata, për t'u ngjitur, filluan t'i jepnin dorën njëri-tjetrit, unë shtrëngova me gishtërinj granatën angleze. Vështrimi i Netës ndiqte çdo lëvizje timen. Ishim marrë vesh që unë do të hidhja i pari bombat e pastaj ata do të shtinin me revolverë. Sytë e Netës më pyesnin: «Përse nuk e hedh granatën?!» Edhe Xhemaliu pyeste me tërë qenien e tij: «Ç'pret?» Unë masja me sy largësinë duke pëshpëritur me vete: «Edhe një hap! Edhe një hap! Edhe një hap!... Nën shkëmbin tonë, shtegu ishte i parratur dhe aq i ngrirë, sa që rrezik të thyeje kokën. Me sa dukej, aty, nën pishë do të ishte ndonjë burim, uji i të cilit ishte kthyer në akull. Ata e ndien këtë dhe u kapën përsëri dorë për dorë, duke i hedhur hapat të vegjël e të matur si çdo njeri, që ecën mbi akull. Po ata ishin granadierë të mësuar me akullnajat e Svicrës. Gënxhat e këpucëve alpine speciale nguleshin në akull dhe ua mbanin trupin fort edhe kur hepoheshin nga pesha e armëve. Unë ia hoqa rrezin granadës me dhëmbë, pa bërë asnjë zhurmë dhe shtrëngova fort në grusht mekanizmin e shkrepjes.

«Hidhe!» — më thoshin sytë e zinj të Netës.

«Hidhe!» — më thoshte gjithë qenia e Xhemaliut.

Po unë hezitova se më dukeshin ende larg. Kisha caktuar me hamendje një farë vendi dhe mendoja:

«Kur të mbërrijnë atje, do ta hedh!»

Po ata ende nuk po mbërrinin.

E mora me mend se rrezet e para të diellit ranë mbi majën e pishës së re, hija e së cilës ra mbi gjernat, që nuk ishin më shumë se njëzet metra poshtë nesh.

Atëherë unë përmblodha gjithë vetëdijen, të gjitha forcat, i bindur se, po të bënin edhe një hap më lart, jeta jonë do të merrte fund. I hodha të dyja bombat, njëren pas tjetrës. Plasi vetëm njëra. Pastaj ndjeva erën e barutit që doli nga tyta e revolverëve.

Kjo ndodhi brenda pak sekondave dhe, kur u ngritëm, pamë një tablo të çuditshme.

Njëri nga gjermanët kishte mbetur aty, midis copave të akullit, shtrirë në kurriz e me sytë hapur. Një cipë akulli i mbulonte buzët, mjekrën e faqet që i dukeshin si prej kristali. Në pëllëmbën pak të mbyllur i skuqte bomba italiane. Ishte një çudi se si ajo bombë, që nuk kishte shpërthyer, qe ende në dorën e tij. Mua m'u krijua përshtypja sikur ai, edhe ashtu pa shpirt, mbante me vete vdekjen. Një tjetër, nga forca e shpërthimit, kishte kërcyer prapa i tmerruar dhe pranë një kaçube bënte pa vetëdije përpjekjet e fundit për të jetuar. Neta e qëlloi dy herë me revolver. Ai u shemb përtokë dhe me cepin e pelerinës së përgjakur mbuloi fytyrën, sikur të mos donte të shihte vdekjen me sy. Kurse i treti, megjithëse ende nuk na kishte kaluar tronditja, na bëri për të qeshur. Ne nuk e kuptuam në ishte gjallë apo vdekur, megjithatë e qëlluam. Ai arriti të zbrazte një breshëri me automatik, pastaj, shtrirë në kurriz, filloi të rrëshqiste tatëpjetë me një shpejtësi mahnitëse. Dëbora që ngrihej nga rrëshqitja e rrufeshme dukej si pluhur i përshkëndijtur. E tatëpjeta ishte aq e pjerrët dhe dëbora aq e ngjeshur dhe e ngrirë, sa ai nuk mund të ndalej më e nuk mund të kthehej për t'u ardhur në ndihmë shokëve. Gjer në pikën e fundit bënte përpjekje për të shpëtuar, po honi ishte hon dhe ai, edhe në mos ishte vrarë a plagosur, shkonte i sigurt drejt vdekjes.

Ne u përqaftuam të gëzuar dhe morëm pllajën e zhveshur, si të lehtësuar nga një barrë e rëndë. Atë çast buçitën mortajat në korijen poshtë rrëpirës. Një predhë shpërtheu pranë pishës ku ishim pak më parë. Të tjerat ranë thellë në pyllin e dendur, shumë larg nesh. Unë dhe Neta vendosëm të ecnim më shpejt, mirëpo papritur Xhe-

maliu u zbeh dhe shtrëngoi me të dyja duart kupën e gjurit.

– Ç’ke, Xhemali? – e pyetëm në një gojë.

– More, po unë më duket se jam plagosur, – tha nëpër dhëmbë duke parë pëllëmbët me gjak.

– Nga erdhi ky plumb?

Ishte plagosur vërtet, në këmbën e majtë, mbi kupën e gjurit. Mbi pantallonat kishte njolla gjaku. Plumbi e kishte shpuar tej përtej dhe këpuca i qe mbushur me gjak.

– Atje je plagosur, kur qëlloi ai derri me automatik, – thashë unë, ndërsa Neta ia lidhi plagën me shamitë tona dhe me shallin e saj.

– Atje ndjeva një pickim, po thashë se u vrava te shkëmbi. Nuk më dhëmbi aq shumë. Kurse tashti... – ai shtrëngoi nofullat.

– Sigurisht, tashti t’u ftoh plaga dhe të dhëmb. Po gjene mirë që s’të ka prekur kockën.

Më vinte mirë që Xhemaliu nuk ankohej dhe po e mbante veten si burrat.

– Punë e madhe fort se do të prekte kockën! A i kopanisëm ata të tre! Kjo ka rëndësi. Apo jo, moj Netë?

Ai e vështroi vajzën si ndonjë fajtor dhe me sy i kërkonte të falur për dobësinë që kishte treguar gjatë natës. Neta bënte sikur nuk i vinte re dhe i thoshte:

– Rëndo! Rëndo mbi supin tim! Ja kështu! A nuk e ndien veten më mirë?!

E kishim marrë në mes dhe ecnim të tre si një trup i vetëm. Dëbora e ngrirë kërciste nën këmbët tona, kurse larg, në pyllin e dendur që kishim lënë prapa krahëve, shpërthenin vazhdimisht predhat e mortajave e të sharrapnelëve. Qielli shndriste si xham dhe dëbora rrezatonte me një shkëlqim verbues e të ftohtë. Nuk e kishim aq të vështirë për të ecur, ndonëse shtegu qe i parratur, sepse sipërfaqja kishte ngrirë. Në pyllin përfund pllajës pishat ishin të rralla e të mëdha dhe nuk kishte shkurre që të na pengonin. Mund të ecnim edhe më shpejt, se shtegu ishte i sheshtë, pa të përpjeta e rrëpira, po

kishim hallin e Xhemaliut. Ai sa vinte rëndohej e ligësh-tohej më shumë, megjithëse përpiqej ta mbante veten e ta topiste dhimbjen. Nuk ankohej, veç herë-herë shfrynte nëpër dhëmbë inatin e zemërimit, ndonëse duhej të kishte dhembje të forta, sepse fytyra i qe errësuar e hequr dhe gishtërinjtë e tij më shtrëngonin fort në supe. Megjithatë, ecnim dhe do ta kishim vazhduar udhën, sepse edhe pak metra na ndanin nga qafa e malit nga dukej fshati ku ishte qendra e komandës së vendit dhe ku do të bëhej inaugurimi i brigadës, po të mos më rifillonte dhembja e apendicitit. Gjatë gjithë rrugës e kisha pak të rëndë ijen e djathtë, kurse aty, në pyllin e qetë e të përgjumur, më rifilloi dhembja therëse. Në fillim nuk u tregova shokëve. Shtërngoja nofullat dhe nga sytë më dilnin vetvetiu sumbulla lotësh. Mirëpo, në çdo hap që hidhja, dhembja bëhej torturuese e sflitëse, gjersa arriti një çast që mezi mbështesja në tokë këmbën e djathtë. Fillova të ecja çalë-çalë. Më në fund Neta e kuptoi.

— Luli, ti s'je mirë! — tha.

S'kisha si ta fshihja më dhe i tregova të drejtën. U bëmë dy të pafuqishëm. Më hipi inati për këtë fat të keq dhe shava me vete. U shqetësova shumë, kur mendova se ç'mund të na ndodhte, po të binim në ndonjë përpjekje tjetër. Shpërthimet e mortajave e të sharapnelëve ishin rralluar, po jehona e tyre megjithatë ndihej. Ku ta dish, mbase gjermanët, pas rrahjes me këto armë, mund të fillonin mësymjen drejt pyllit tonë. Po kush na siguronte se rrugën përpara e kishim krejtësisht të lirë? Nga larg vinin jehonat e krismave të tjera. Luftohej gjithandej. Po edhe në pyll nuk mund të qëndronim gjatë. Neta u mor me ne. Me ato duart e shkathëta ma mpiksi dhembjen me dëborë, kurse Xhemaliut ia lidhi më mirë plagën.

— Duhet të vazhdojmë rrugën, — tha. — Do t'ju mbaj unë. Në fillim të dy, pastaj, po të lodhem, marr herë njërin e herë tjetrin. Ajo kishte të drejtë. Në duhej të ecnim me çdo kusht, edhe sikur të tërhiqeshim zvarrë.

– Gjer te qafa e malit, – vazhdoi ajo. – Andej zbres vetë me vrap drejt e në fshat.

Ne po mendonim si të vepronim dhe nuk vumë re tre nierëz të armatosur që ecnin shtegut me vrap. Kur i pamë, ata zunë vend prapa ca shkëmbinjve dhe na drejtuan grykat e pushkëve.

– Gjermanët! – tha Neta dhe u shtri pranë nesh.

Me mundim u zvarrisëm gjer te trunçu i një pisha të rrëzuar dhe nxorëm revolverët. Pamë njëri-tjetrin në sy, pa folur. Me se do të luftonim? Kishim qjithë-qjithë pesë fishekë në të dy revolverët. Unë e kuptova gjendjen e pashpresë dhe i thashë Netës:

– Ne do të luftojmë gjer në plumbin e fundit. Kur të fillojmë të qëllojmë, ti tërhiau zvarrë, ja, gjer atje tek ajo pisha e vogël! Andej mbathia me vrap, sa të mundesh, se nuk të ha plumbi. Dëqjon? – Ajo dëgjonte po nuk fliste. – E dëgjove ç'të thashë? E sheh atë pishën e vogël?

– Mirë thotë Luli. Ti duhet të ikësh, Netë! – tha Xhemaliu, i qetë në fytyrë.

– T'iu lë vetëm?! – përsëriti ajo.

– S'jemi vetëm. – e ndërpreva.

– Dhe kështu të plagosur e të sëmurë?!...

– Rrugë tjetër s'ka! – thashë duke i futur plumbin revolverit.

Pas krismës metalike që bëri arma, dëgjova një zë që vinte nga shkëmbinjët. Zëri që i fortë, i ashpër.

– Kush jeni ju, more?

Një shkëndijë shprese vetëtiu në sytë tanë. Neta nxori një si klithmë të mbytur:

– Qenkan shqiptarë!

Unë i pyeta:

– Po ju kush jeni?

Pas pak erdhi përgjigjja, po me atë zë të fortë e të ashpër:

– Jemi ata që jemi. Parullën!

Ne pamë njëri-tjetrin në sy. S'dinim ç'të thoshim.

– Do të thoni të vërtetën, apo si e keni punën? Jeni

strukur prapa pishës së rrëzuar dhe nuk e shihni së trungru
është i kalbur? E ju shpon plumbi tejpertej, atë edhe ju.

Unë preka instiktivisht trungrun. Ata thanë të vërtetën.
Trungru ishte i kalbur dhe i thatë, si eshkë.

Neta zgjati kokën dhe përsëriti pyetjen time:

– Po ju, përse s'tregoni?... Kush jeni?

Ata heshtën një copë herë. Pastaj njëri u ngrit në
këmbë, mbi shkëmb dhe u përgjigj me zë të fortë e të
gëzuar:

– Akoma nuk e morët vesh që jemi partizanë?

– Partizanët, partizanët! – thirri Neta, kapërceu trungrun
dhe u derdh drejt tyre duke vrapuar. Një çast më
vonë e pashë si përqafohej me ta. Unë me Xhemaliun u
ngritëm në këmbë. Ia kishim hedhur krahun njëri-tjetrit dhe
dëgjonim zërat e gëzuar dhe të qeshurat e atyre që vi-
nin drejt nesh me hapa të gjatë e të shpejtë.

– Nga vini kështu? – na pyetën.

– Nga qyteti. Kemi udhëtuar tërë natën.

– Po ato armë ç'qenë?

– Ndeshëm me një patrullë gjermane prej tre vetash...

– I vratë?

– Që të trel

– Po ju qenkeni heronj! Ne thamë ç'është kjo luftë
që bëhet në pyllin e dendur të pishave.

Ne ua treguam të gjitha ngjarjet e asaj nate e të
atij mëngjesi fill e për pe. Ata sajuan shpejt e shpejt
një vig me degë pishë e me palltot e tyre.

Tashti do ta bëjmë kështu: në vig do të marrim të
plagosurin, – tha njëri prej tyre, që dukej më i madh
në moshë. Pastaj u drejtua nga unë. – Ti do të bësh si
do të bësh dhe do të vish me këmbët e tua, i ndihmuar
nga shokët. Nuk kemi shumë për të ecur. Ja, matanë
qafës është fshati. Fundi, zorra qorre është, s'është zemra,
– bëri shaka ai, dhe u foli shokëve që të niseshin pa
humbur kohë.

Dhe kështu u nisëm. Përpara ecnin dy partizanët që
mbanin vigun. Xhemaliu ishte çelur në fytyrë dhe sytë i
mbante mbyllur. Dukej sikur e kishte zënë gjumi, po nuk

flinte. Pas tyre venim ne. Më mbante për krahu. Neta dhe një partizan i imët si vajza, po i fortë si ajo.

— Ne i dëgjuam të shtënat e armëve. — foli partizani i imët si vajza. — Komandanti na thirri e na tha: «Pa shkoni e shihni ç'bëhet atje te pylli i dendur! A thua edhe andej po na dalin gjermanët! Se, që ta dini ju, o shokë të terrenit, luftohet gjithandej. Çetat territoriale luftojnë mbi Lavdar të Korçës. Dy batalione ka dy ditë e dy net që luftojnë matanë lumit të Devollit, që nga Moglica e gjer në Dolan, Grybë e Këmbëthekër. Një tjetër ka zënë pritë aty te Barakat e Zvarishtit. Në komandën e vendit është vetëm një batalion. Brigada do të inaugurohet vetëm me të, se nuk mund të mblidhen të gjitha forcat. Dhe ju bëtë mirë që na sollët flamurin. Bëtë mirë që na e sollët.

Ai fliste dhe më mbante fort për krahu, duke më ngritur gati peshë. E dëgjoja si në një dremitje të ëmbël. Neta ecte në krahun tim të majtë dhe më mbante për dore.

«Ç'do të ndodhte, vallë, po të mos ishte ajo atë natë dhe atë mëngjes me ne?» — mendova ndërsa partizani filloi të këndonte si me vete:

*Ato maja rripa-rripa seç gjëmojnë
Ndizet lufta për liri e derdhet gjak
Janë trimat partizanë që luftojnë
Janë bijtë e Shqipëris' që marrin hak!*

I ndjeva Netës frymëmarrjen e shpejtuar dhe i shtrëngova dorën. Kisha dhembje, po zemrën e kisha të lehtë. Diçka më gurgullonte aty, siç gurgullon një burim nëpër lajthishte. Krah për krah me të, dëborë shkrinte, thellimi s'ndihej dhe dimri mundej...

«NËNTORI» nr. 4. 1978

NË THELLËSI TË MALEVE

Që nga maja e kreshtës së zbuluar Martini dalloi nën shpatin e rreptë, kullën e vet, kullën e Kolajve. Nga çatia e bardhë dilte një fjollë tymi që mezi ngjitej lart në ajrin e ngrirë. I erdhi mirë kur pa tymin.

E paskan ngrohur kullën, mendoi i kënaqur dhe bëri më tej.

Aty ku shkelte ai, s'kishte borë, po akull, mbuluar me grimca të imëta të bardha, gati si hi. Akulli i fortë kishte veshur shkrepat, lëvoren e drurëve dhe vende-vende, ku rridhnin burimet, vareshin hejtë e kristaltë.

Vështroi një copë herë me vëmendje kullën e vet-muar.

Dikë po përcjell baba, mendoi duke dalluar në oborrin e ngushtë të kullës katër-pesë veta.

Ai kishte sy të fortë. Megjithëse larg, i dalloi mirë që njerëzit, veç të atit, ishin ushtarakë të armatosur.

Shkeli nëpër akull si kedh. Kushdo që të ishte, i ngarkuar si ai, me një peshë aq të rëndë, do të pengohej diku nëpër shkropa, do të rrëshqiste mbi akull dhe kushedi se ku do të mbaronte. Në atë vend, ku dimër

e verë frynin erëra, gjatë muajve të dimrit, s'kalonte dot asnjë kafshë, as mushka, që është më e forta, më këmbëngulësja dhe më e zgjuara, as dhia e egër, e zhdërvjellët, e vetmja sunduese e majave të maleve. Po Martin Kola ishte malësor, ishte nga ato anë të rrepta dhe, veç këtyre ishte i ri, me trup të lidhur, të zhdërvjellët dhe të fuqishëm, megjithëse fytyrën e kishte të imët, të hequr, të njomë si të ndonjë çunaku. Tabanet e tij të sheshta dhe shumë elastike sa e ciknin akullin, i ngrinin peshë supet dhe tërë trupin. Opingat vetëm sa fërkoheshin pak pas akullit dhe Martini dukej sikur fluturonte mbi një ajë të ndritshme. Në të vërtetë ai kërcente mbi ato këmbë të gjata e të forta. Kur shihte ndonjë rrezik, ngulte thembrat e opingave si qozhdë të mëdha, ashtu si dhitë dhe mushkat buzë rrëpirave dhe mbërthehej në vend. Kur donte të kapërcente, këmba e tij shkëbutej me lehtësi nga toka dhe ai vazhdonte rruaën krejt i qetë. Atë shteg të ngushtë e të ngarirë Martin Kola mund ta bënte edhe symbyllur, se ishte trualli i tij, toka e tij, shtegu i tij.

Kur ra në livadhe, i doli përpara qeni i kullës dhe filloi t'i aëzohej nëpër këmbë, duke futur feçkën në dëborë. Mbushte gojën me copra akulli, kuiste dhe hidhej përpjetë me të katër këmbët e shtrembra.

Po. Edhe ti aëzohesh. Të harrova fare! – mendoi Martin Kola për qenin e vet, që nuk qante asnjë njeri të huaj te pragu i shtëpisë.

Martini shkundi shpatullat e gjera e të rënduara. Hapi iu bë i madh dhe opingat iu zhytën thellë në dëborë. Kur mbërriti në kullë, malet e larta përreth dhe copëzën e qiellit midis tyre i mbuloi errësira.

Te pragu e priti Lena, gruaja e tij e gjatë, si ai, e bukur, e shëndetshme, me një vetull të harkuar mbi sytë e mëdhenj. Nën rubën e kokës i shkëlqenin flokët krejt të zinj e shumë të dendur. Ai u bë përnjëherësh serioz dhe i rëndë, si malet.

– Si është Sokoli?

– Disi më mirë! – u përgjigj Lena, duke mos e fshe-

hur dot gëzimin që i shoqi i qe kthyer shëndoshë e mirë nga rruga e gjatë. Ishin kohë të zymta, të egra, të pabesa. Asnjë natë nuk gdhiehej në ato anë pa krisma pushke. Vriteshin njerëz nëpër oborret e kullave, nëpër livadhe, mbrëmjeve duke korrur bar, nëpër shkrepë duke bërë dru, buzë humnerave duke kullotur dhinë. Nganjëherë, shumë rrallë, vinin andej alpinët e huaj italianë, me ato kapelat qesharake, mbi të cilat mbanin nga një pupël. Ata, si të huaj që ishin, shpesh bënëin kërdinë mbi gjënë e gjallë dhe mbi njerëzit e pabindur. Ishte gëzim i madh kur burri kthehej shëndoshë e mirë nga mali me kërcunjtë e druve mbi shpinë. Ishte gëzim më i madh kur kthehej nga qyteti i largët me calikun me misër ose me kripë.

Lena, padashur, duke zgjidhur litarët e calikut, preku flokët e tij të ashpër, të rënduar nga dëborë. Ajo, si grua e re dhe shumë e ndjeshme, kishte dëshirë t'ia shtrydhte me të dyja duart e ashpra, ata flokë të bukur, ato shpatulla të ngrohta qull në djersë, atë kraharor të zbuluar, gati të nxirë nga thëllimi, ku dalloheshin mirë muskujt e fortë, brenda të cilit rrihte zemra e lodhur nga rruga e gjatë. Po u drodh nga tronditja kur pa, përmes derës së hapur, vjehrrin te oxhaku.

— Martin, — beibëzoi dhe vetëm me atë fjalë, si psherëtimë e këndshme dhe e thellë, shprehu gjithë gëzimin e saj prej gruaje të përgjëruar e besnike. Pastaj kafshoi buzët sa i zbardhi dhe, me calikun që e hodhi mbi kokë, mbuloi fytyrën e saj të kuqe flakë.

Rreth oxhakut të nxirë rrinin nip e gjysh duke biseduar. Kur hyri Martini, Sokoli i vogël u mat të ngrihej, por kur pa gjyshin që i bëri shenjë me çibuk, nuk luajti nga vendi. Gjyshi kishte huqet e veta dhe vogëlushi ia njihte mirë.

— E prure? — pyeti Gjini pa e vështruar në sy.

— Po, baba, — u përgjigj Martini duke qëndruar në këmbë te dera e kullës.

— Sa kushtoi?

— Një djall e gjysmël! Të tëra paret i dhashë.

– Domethënë, qenka shtrenjtuar përsëri bereqeti.
– Po, baba. E kanë shtrenjtuar tregtarët. Thonë se, meqë po bëhet luftë me Grekun, ka pasur dhe shumë harxhime Italia. Prandaj.

Plaku thithi çibukun, u mbulua si me mjegull dhe u kollit.

– Ma jep bucelën, se m'u tha gryka!

Martini me shpejtësi të çuditshme e me përulësi akoma më të çuditshme rrëmbeu bucelën nga një kënd i errët i kullës.

Plaku piu me nge, gllënjë pas gllënjke. Pinte, e vinte bucelën midis këmbëve, pushonte pak sa për të marrë frymë dhe tundte kokën e bardhë i menduar. Pastaj tymoste me çibuk. Martini, që vinte nga një rrugë e largët prej dymbëdhjetë orësh, qëndronte para tij, tërë nderim, paksa i vrarë nga lodhja.

– Më sill shishen e rakisë!

– Si urdhëron baba! – dhe Martini erdhi një herë rrotull kullës i lehtë si flutur dhe ia lëshoi shishen në dorë.

Me një shenjë të gjyshit, Sokoli u hodh mbi kërcinjtë e hollë dhe doli nga kulla. Prapa derës e priti e ëmā, Lena, dhe e përmbloodhi në gji e gëzuar.

– Hajde më ndihmo, o bir, të bluajmë misrin!...

Zjarri ishte i mirë. Kërçepin e madh e të thatë, që plaku Gjini e kishte marrë në pyll gjatë verës, e kishin përfshirë flakët. Martinit i vinte gjumë nga lodhja. Mezi e kapërdui gotën e rakisë dhe copëzën e mishit të derrit që e kishin therur një muaj më parë.

Plaku Gjini mbulohej me tymin e çibukut dhe i thoshte me zë shumë të qetë, i vrarë shpirtërisht:

– Sokolin nuk e ke mirë. Do të rritet, po s'do të jetë as për vete dhe jo për ty e për mua. Unë po... pres ditën! Edhe ti vetë s'je mirë! Kështu, nga jashtë, të merr më qafë! Po mua, mos ma fshih, Martin! Ke kollë të thatë, si unë. Pështyn fshehurazi dhe nxjerr gjak, si unë! Gjoksin e mban zbuluar, dhe mirë bën se kështu e

mbajmë të gjithë ne malësorët. Po gjoksi yt nuk është më si shkëmb! Imi, jo se jo! Na i griu varfëria!...

Plaku Gjin kollitej gjatë. Përtej murit të kullës, sikur të mbyste kollën e tij, dëgjohej një goditje e rëndë. Ishin Lena e Sokoli që rrihnin misrin.

Plaku Gjin thithi edhe një herë çibukun, e pa Martinin ftohtë dhe e zgjoi nga dremitja. E ngriti zërin me qëllim:

- Pak më parë se të vije ti, këtu ishte kapidani...
- Kapidani? - u përmend i habitur Martini.

Kërkon ushtarë, milicë! Dhjetë napolona në muaj. Veshje dhe ushqim pa pare. Dëgjon, Martin? Veshje dhe ushqim, pa pare! Me dhjetë napolona blejmë një derr, bëjmë një kotec, mbajmë kullën me bukë gjithë dimrin. Ishte me një kapter shumë të mirë, me një zotni, të thash, që e pinte rakinë si burrat. Kishte dhe tre milicë, djem të rinj, si ti, të gëzuar, të harbuar, të ushqyer mirë!... Po si atë kapter s'kam parë gjer më sot! I ndrinin dhembët kur qeshte! I ndrinte zemra! Me të të bëhesh shok e vllam! Ai hapi qesenë e më dha këtë kapar!

Plaku Gjin hodhi mbi poste një tufë kartëmonedhash dhe Martini, me një vështrim, e kuptoi se ato vlenin shumë më tepër se caliku me misër që kishte sjellë në kurriz nga qyteti.

- E sheh çfarë kapteri është, o Martin? - pyeti plaku Gjin duke kthyer shishen e rakisë.

Martinit i doli gjumi krejt. Pyeti me njëfarë ankthi:

- Baba! Po unë vetëm dhjetë ditë bëra ushtri. Sa plasi lufta në kufi me Grekun, krisa e ika me tërë batalionin shqiptar, pa hedhur asnjë pushkë! Unë nuk di akoma edhe sot ç'është ushtria e ç'është milicia!

Plaku Gjin përpfasi në vatër shishen e rakisë.

- Po pushkën, a e di se ç'është?!

- Ma ke mësuar që kur isha i vogël!...

- E pra, pushka duhet. Paratë nuk i japin për njeri, po për pushkë. Dhjetë napolona për një pushkë. Veç rrobave dhe ushqimit. Shpëtojmë Sokolin e vogël. Shpë-

ton veten edhe atë, nusen tënde. Për mua, mos pyet. Sa më shpejt të iki, aq më mirë!

Martini u nxeh dhe pasi u kollit mirë e mirë pyeti:

– E kujt do t'ia kthej atë pushkë?

– Kullës sate! Varfërisë! Gjithë të këqijave të kësaj bote!

– Po mos është gjë e ndyrë kjo, o baba? Milici! E ç'do të thotë milici!

– Unë nuk e di, por kapidani tha: shqiptar! Dhe ai kapteri i mirë e dhëmbëbardhë shtoi: «shqiptar i kulluar!

Martini donte të pyeste përsëri, po e mbyti kolla e thatë. Dhe nëpërmjet kollës tha me mbytkë të ndërprera, pa i shqiptuar fjalët si duhet:

– Mos na japin... ndonjë urdhër për të vrarë... shqiptarë!...

– Jo, Martin! Shqiptarë s'ke për të vrarë kurrë...

– Mos na japin... urdhër... o baba!

– Atë urdhër nuk do ta zbatosh kurrë! Do të vish menjëherë këtu! Kemi pyje shumë, ku mund të fshihesh!

Të dy i zuri kolla e thatë. Ranë në mendime. Prapa murit vinte rrahja e lumtur e misrit në havanin e madh prej guri. Ishte rrahje e fortë dykrahësh. Matanë ishin bërë qull në djersë nënë e bir, Lena e Sokoli i vogël. Nëna e re, e bardhë si bora, lëpinte me majën e gjuhës pikëzat e djersës dhe i jepte zemër Sokolit duke i thënë me zë të lartë:

– Të lumtë, o bir! Jepi fort! Edhe një herë! Edhe një! Edhe pak!

Plaku Gjin tha i menduar:

– E di si është puna, o Martin? Sa të rregullohemi pak. Sa të shëroheni ti edhe Sokoli. Pastaj në djall të venë të gjitha! Edhe paret, edhe ushqimet, edhe rrobat, edhe milici! Në fund të fundit unë s'mund të shitem... Mbi të gjitha është Shqipëria! Se Shqipëri i thonë këtij trualli, këtyre maleve, këtyre kullave, kësaj gjuhe që po të flas. Dëgjon?

Martini nuk iu përgjigj, se po villte gjak në vatër.

Atëherë plaku u ngrit përnjëherësh në këmbë dhe thirri:

– Oj, ti!

Po Lena me Sokolin e vogël po gatuanin bukën. E kishin rrahur misrin mirë e mirë, e kishin kthyer në miell të ashpër dhe e kishin derdhur në çerap për t'u pjekur. E dëgjuan plakun vetëm kur vikati herën e tretë, me gojën gati të shtrembëruar:

– Oj, ti!

Lena hyri e shqetësuar, me duart tërë brumë të verdhë.

– Urdhëro, tatë! – tha ajo.

Plaku Gjini kishte ngrirë në këmbë, me çibukun e shuar në buzë. Lena u derdh te Martini dhe i ngriti kokën e bukur. Vrapoi pas saj edhe Sokoli.

– S'kam gjë! – u përmend Martini. – Ma rregullo pak kërcurin nën kokë dhe më mbulo se ndiej të ftohtë!

– Po si kështu? Nuk do të hash gjë?! Buka u poq!
– tha ajo e dëshpëruar.

Martini ra në gjumë të thellë. Plaku Gjini qëndroi në këmbë si i ngrirë, me çibuk në buzë. Lena mbuloi thëngjinjtë me hi dhe filloi të shkopsiste kopsat e gjirit. Sokoli i vogël u shtri pranë të atit, i habitur. Pas pak pyeti nëpër gjumë:

– Përse tatës iu bënë flokët të verdhë?!

Plaku Gjini shkundi çibukun në pëllëmbë, shoi pishën me një frymë dhe tha me zë gati të shuar:

– Flini, bij! Flini!...

* * *

Pas tri javësh Martin Kola u vesh milic.

Kapteri, për të cilin i kishte folur aq mirë plaku Gjini, e vështroi një copë herë me pëllëmbën mbi sy, sikur ia vriste dielli, megjithëse ishte dimër i vrenjtur. I tha buzagaz:

– Sa i bukur je bërë, o Martin! Ku ke qenë më parë që t'i flakje ata tirq, atë lëkurë mbi shpinë dhe ato opinga. Sa bukur të rrinë! T'i kanë prerë tamam pas trupit!

Martini e ndiente veten tjetër njeri. I dukej sikur nuk kishte hequr vetëm rrobat, po edhe lëkurën. Nën atë lëkurë të re, të hekurosur, që binte erë molë, megjithëse trupit të tij të gjatë e me shpatulla të mëdha i rrinte vërtet bukur, i dukej sikur kishte edhe një lëkurë tjetër, të ftohtë si të gjarprit.

«Çfarë dreqi jam bërë, – mendonte me vete, një hiç-gjë! Ku je Martin, ku je? Ku je, o malësor, me calik mbi shpinë? S'je as kurkund! As në qiell, as në dhe!»

Iu deshën dy javë të mira që të mësohej sadopak. E shtrëngonte kopsa e këmishës pa jakë dhe jaka e xhakës së blertë. E kruanin pantallonat, të blerta edhe ato edhe të gjera. E vrisnin këpucët me qafa, megjithëse i ndërroi disa herë. E vriste edhe kapela në lule të ballit.

«Kukuuu, moj nënë, si jam bërë! – mendonte i dëshpëruar, karabush, një hiç!»

Lena qeshte me të madhe, kur s'ishte plaku Gjini. I dukej Martini si i huaj, krejt i huaj...

– I k, ore fashist! i thoshte e habitur se si njeriu mund të përçudnohej aq shumë edhe nga veshja. I k e vishu me tirq dhe ma lër gjoksin të zbuluar, ku të mbështetem pakëz, vetëm pakëz me faqet e mia!...

Po ajo e dinte mirë se nën atë rrobë të huaj ishte ai, Martini i saj, i fortë, i bukur, malësori. Prandaj, fshehurazi, i hidhej në qafë, ia flakte kapelën dhe ia përkëdhelte flokët e ashpër me dashuri të vërtetë gruaje.

I biri i qëndronte larg. Edhe kur e thërriste, vogëlushi nuk i afrohej.

– Sokol, po eja, o bir, të të përqafoj!

Krahët e gjatë i mbeteshin hapur, siç i mbetën shqiponjës së plagosur. Sokoli ikte nga sytë këmbët, fshihej nëpër shkurre, merrej me dhitë dhe nuk kthehej, gjersa i ati të ikte nga kulla.

Filloi edhe plaku Gjini ta shihte ftohtë. E pa një ditë me mospërfillje te oborri i kullës dhe i tha duke nxjerrë tym nga goja:

– Hap sytë, Martin! S'je mirë!

Në krye të muajit Martini i dërgoi Gjinit nga qyteti rogën, plot dhjetë napolona kartë edhe disa dhurata të thjeshta për të, për Sokolin e vogël dhe për Lenën. Nuk i lejonin të dilnin nga kazerma. I mbanin mbyllur dhe i ushtronin. Një muaj të tërë i stërvitën mirë nga ana ushtarake. Pasditeve u mbanin fjalime. Vinin ushtarakë të lartë italianë dhe shqiptarë dhe u flisnin për të mirat e fashizmit, për Duçen e madh, që e kishte Shqipërinë në zemër, për luftën që duhej të bënin kundër komunistëve pa fe, pa atdhe e pa familje. Vinte shpesh edhe komandanti i tyre, kapidani, i shoqëruar gjithnjë nga ai kapteri dhëmbëbardhë. Me një të dredhur të mustaqeve, që i mbante përpjetë, kazermën e mbulonte heshtja. Ai piceronte sytë e vegjël dhe u thoshte me duar në brez:

— Trima! Ka ardhur koha ta mbrojmë Shqipërinë nga të pafetë!

Fliste shkurt, kërcëllonte dhëmbët dhe, kur ikte fjalët e tij mbeteshin pezull në ajër për një kohë të gjatë. Atëherë kapteri zbardhte dhëmbët e thoshte:

— Mos e pafsh vdekjen me sy, or kapidan! T'u bëftë dita një mijë, or kapidan!

Mbrëmjeve u shfaqnin filma dokumentarë «Luçe». Duçja në një ballkon të vogël duke thirrur entuziast; jemi tetë milionë bajoneta! Përsëri Duçja me Hitlerin duke parakaluar përpara armatave të hekurta. Ushtria glorioze fashiste duke çliruar Abisininë e egër! Ushtria glorioze duke shpartalluar grekët e pabindur! Dhe përsëri Duçja duke thënë Shqipërinë e kam në zemrën time!.. Duçja midis hierarkëve fashistë... Midis puseve të naftës duke parë malet shqiptare me dylbi!..

Një muaj të tërë mbyllur në kazermë. Ditë për ditë «Gatitu! Prapa-ktheu! Para-marsh! Barkas! Për nder-armë!...» Ditë për ditë fjalime të zgjatura, të mërztishme. Ditë për ditë kapidani me mustaqet përpjetë e me duart në brez duke përsëritur: «Trima! Ka ardhur koha të mbrojmë Shqipërinë nga të pafetë!» Dhe çdo mbrëmje «Luçe», «Luçe», «Luçe»!...

Një të diel pasdite i lanë më në fund të lirë për shëtitje. Martini doli së bashku me Mëhill Cungun, me kushëririn e kapterit dhëmbëbardhë, që dukej baba-xhan.

Martini vështronte rrobat e reja e të hekurosura, kopsat e shkëlqyera, që i kishte fërkuar gjer në mesnatë, majat e këpucëve, që i vetëtinin nga xhelatina. Ngrinte këmbën shumë lart, thyente gjurin dhe e hidhte sikur të ishte në shtegun e malit.

— Hajt! — i jepte zemër Mëhill Cungu. Do të mësohemi të ecim edhe në rrugët e Romës! Thuaj: Rroftë kapidani dhe im kushëri që na nxorën në selamet!

Hynë në rrugët e zhurmshme të qytetit, Martini me një siklet të madh në shpirt, Mëhill Cungu duke u fryrë si gjel. Ai kishte jetuar ca kohë aty, kishte bërë nja dy vjet shkollë dhe këmba e tij e njihte kalldremin. Kurse Martini!... O, lëre Martinin! Ecte si në shtigjet e maleve. Ngrinte këmbën sikur do të kapërcente trungje, ferra e copa akujsh dhe e përplaste si një kalë gërxhall. Kalldrëmi sikur shkërmoaj nga hapi i tij i rëndë dhe i çrregullt. Fëmijët talleshin me ta, duke u thirrur që nga qoshet e rrugicave:

— Milicë! Milicë! Të shitur me para!

Pak përpara se të dilnim në bulevardin kryesor Mëhill Cungu me dorën në këllëf të revolverit, tha:

— Kopilët! Janë bij komunistësh dhe duhen vvarë me gjithë baballarët e tyre.

Martinit iu kujtua Sokoli i vogël, ndjeu një ndrydhje në shpirt dhe deshi të kthehej në repart.

— Je në vete! — i tha Mëhill Cungu i habitur. Ne tani do të bëjmë qejf. Do të vemi në Kafenenë e Madhe, do të pimë nga një dopio kumel dhe pastaj drejt e në bordell!... Atje të ulen italiankat në prehër!...

Martini ecte me kokën poshtë po, edhe ashtu, ndiente urrejtjen e kalimtarëve, të burrave, të grave, edhe të fëmijëve. E ndjeu atë urrejtje të heshtur e kërcënuese edhe kur hynë në Kafenenë e Madhe. Meniëherë tri tryeza u boshatisën. Qytetarët dolën të mërzhitur e të heshtur.

duke u hedhur vështrime tërë urrejtje. Njëri prej tyre, një burrë, i moshuar me syze, pështyu gati te këpucët e Martinit dhe murmuriti nëpër dhërrë se shkokuqur:

– Turp të ken! Tradhtarë!

Mëhill Cungu s'e dëgjoi, zbardhi dhëmbët si kapteri dhe me kapadaillëk porositi dy dëpio kumel.

– Unë s'dua asgjë! Do të iki, se më vrasin këpucët, – tha Martini, dyllë i verdhë në fytyrë.

– O trim, po tani fillon qejfi ynë! – thirri Mëhill Cungu duke hequr kapelën.

Martini s'e vrasnin këpucët, por ndërgjegjja e malësorit të ndershëm.

Dhe kështu, çdo të diel, kur ishte i lirë, ai ndiente në qytet fort e më fort urrejtjen e madhe që dilte nga buzët e fëmijëve e të qytetarëve, nga tryezat e Kafenesë së Madhe, nga dritaret e shtëpive, nga qoshet e rrugicave, nga çdo anë ku hidhte hapin e rëndë. Shtrihej në krevat, i mërzitur, në kazermën e madhe, ku flinin pesëdhjetë njerëz.

– Do të shkoj... do të shkoj..., mendonte me kokën futur nën jastëk.

* * *

Ishte 22 shkurt 1942. Boria e zgjoi repartin para kohe. Alarm mësimor, si gjithnjë, mendoi Martini duke u shtritur. Po boria atë ditë nuk shfrynte si gjithnjë. Binte pa pushim dhe kishte një buçitje tjetër, buçitje lufte. Nënoficerët dhe oficerët ishin si të tërbuar, përplasnin dyert e kazermave, shanin me fjalë të ndyra dhe ishin gati të godisnin cilindo me qytat e pushkëve.

– Shpejt, shpejt! – thirri një graduat italian dhe ia ngjeshi me shkelm Martinit, që ende nuk ishte veshur mirë. Ishte e para herë që e goditnin me shkelm. Malësori dëshiron më mirë plumbin se shkëlmin. Plumbi e rrëmben menjëherë. Shkelmi nuk harrohet kurrë. Po graduati italian nuk e dinte këtë dhe Martini s'pati kohë

më të mendohej, se i mbinë para syve kapidani dhe ai kapteri dhëmbëbardhë.

– Trima, ka ardhur koha..., – mezi dëgjoi ato pak fjalë përmes zallahisë së kazermës, urdhrave me zë të lartë, përplasjes së dyerve, sharjeve të ndyra, borisë që klithte pa pushim.

I nxorën shpejt e shpejt duke i drejtuar me vrap nga qyteti. Oficerët jepnin urdhra në vrap e sipër që milicët të mbushnin armët, të ulnin shiritat e kapelave nën gushë, të bënin gati bombat, si në luftë të vërtetë dhe me iniciativë personale të hidheshin mbi cilindo qytetar të pabindur.

Vraponte midis të gjithëve edhe Martin Kola, duke u mbërthyer në ecje e sipër. Pa kuptuar se ç'bëhej, dëgjonte vetëm urdhra të prerë:

– Shpejt, shpejt! Ulini shiritat! Mbushni armët! Trima, ka ardhur koha...! Gjuani me iniciativë! Hidhni bombat! Shpejt! Më shpejt!...

Kur mbërriti në krye të bulevardit dhe pa përpara një mizëri njerëzish që i printe flamuri shqiptar pa shenjat e liktorit, ngriu në vend, mbështetur te qoshja e rrugicës. Një grua e gjatë tamam si Lena e tij, mbante flamurin në krye të turmës së madhe, e rrethuar nga gra, nga vajza e djem të rinj. Prapa palave të flamurit, qindra e qindra njerëz këndonin këngë patriotike, kërcënonin me grusht dhe thërrisnin me fytyra të ndezura:

– Rroftë Shqipëria! Poshtë fashizmi!

Oficerët italianë qëlluan të parët me armë. Qëlloi edhe kapidani drejtpërdrejt në turmë. Edhe kapteri, që nuk i ndahej këmba-këmbës. Edhe shoku i tij e mbushi pushkën dhe vuri në sy shënjestrën.

– Mëhill! Mos qëllo! Janë vëllezërit tanë këta! Janë shqiptarë! – thirri Martini duke ia ngritur pushkën lart. Arma u zbraz dhe plumbi u ngul në murin e shtëpisë.

– O, kopuk! – thirri Mëhill Cungu më shumë se ai. – A nuk e sheh ç'bëhet? Po nuk i shpërndamë, do të na vrasin! – dhe në vrap e sipër e mbushi pushkën përsëri.

Turma u kacafyt me ushtarët fashist. Martini qëndronte te qoshja si i mpirë, me sytë te kondaku i armës midis këpucëve. Një djalë i ri vrapoi përpara tij duke thirrur me të dy grushtet lart:

– Shokëëë! Na u vra punëtori i fabrikës sonë!... Na u vra Vasuaaaa!

– Na u plagos, edhe Toma! – iu përgjigj një tjetër.

Nga turma thërrisnin të tjerë njerëz, me zemërim dhe urrejtje:

– Fashistë të poshtër! Milicë të shitur!

– Poshtë fashizmi!

– Rroftë Shqipëria!...

Në mbrëmje, qyteti aq i poterrshëm e i zhurmshëm u bë krejt i heshtur. S'kishte dritë askund. Vetëm rojat e armatosura gjer në dhëmbë bridhnin tre e nga tre në të gjitha lagjet, nga qendra e gjer në periferi...

* * *

– Unë nuk rri më milic! – i tha Martini plakut, që priste me sëpatë një kërcu të madh përpara kullës.

– E përse? – e pyeti Gjini duke fshirë djersët me mëngën e fanellës prej lesh dhie.

– Është tradhti!

– Përse qenka tradhti?

– Na nxjerrin rrugëve për të vrarë popullin...

– Popullin?!

Martini i tregoi për demonstratën, për urrejtjen e popullit ndaj fashistëve e milicëve, për gjakun e derdhur. I tregoi se ishte njohur me një punëtor të fabrikës së cigareve, i cili i kishte folur për robërinë, për detyrat e shqiptarëve në këto kohë të vështira dhe e kishte këshilluar të mos e mbante më rrobën e milicist.

– Baba – i tha Martini i mërzhitur, – edhe kalamajtë na qepen nga pas dhe na tallin duke na quajtur spiunë, tradhtarë. Unë e di si e kam duruar këtë poshtërsi. Po tani do ta flak këtë rrobë të ndyrë!

Plaku Gjini ra në mendime, duke thithur çibukun:

— Më ka prerë në besë kapidani! — tha. — Nuk e kishim fjalën kështu kur të shkrova milic. Më ka gënjer. Më foli vetëm për disa njerëz që prisnin qetësinë, që janë pa atdhe, pa familje, e të shitur.

— Jo, — e ndërpreu Martini. — I shituri jam unë, — tha me neveri për veten.

Plaku u zu ngushtë, vështroi përdhe opingat që shkelnin barin e porsamugulluar dhe tha i mbuluar me tym:

— Më duket se ti ke të drejtë, Martini! Po duset ta mendojmë më mirë këtë punë. Po u zhveshe, këtu nuk qëndron dot më, se vijnë e të arrestojnë.

— Unë kam një javë leje, — tha Martini, — kemi kohë të mendohemi. Po, ta dish, milic nuk rri më.

U bënë gati të hynin në kullë, kur atë çast u dha Mark Çuni, një matësor i këputur, në mosnë të Gjini Kolës, veshur me tirq e këmbishtë të çjerrë dhe me një lëkurë dashi pa mëngë, që i mbulonte kurrizin pak të kërrusur.

— Erdha për një grusht kripë. Nuk di në do t'ju ndodhet, — tha matësori i lodhur.

— Çkemi, jo ta ndajmë. Po eja brenda, o Mark Çuni! Ata ishin miq të vjetër e të ngushtë, Mark Çuni e kishte një djalë në maj, po nuk i tregonte askujt, se, sipas tij, bota ishte skile. Po me Gjini Kolën punet i kishte mirë dhe nuk druhej prej tij.

— A ke lajm prej djalit? — e pyeti Gjini Kola kur u ulën rreth vatrës.

— Shëndosnë e mirë është, atje, me shokët!

— Po Martinit tim, si do t'ia bejmë? — pyeti Gjini dhe ia tregoi fill e për pe hallin që e kishte zënë.

— Martini është djalë me mend. Bën mirë që nuk do të rrijë milic. Ashtu është, siç thotë ai. Nuk i duset zënë besë as të huajit, as kapidanit. Jemi pa liri, o Gjini Kola. Duhet t'u zëmë besë Partisë dhe atyre trimave të malit.

Ata biseduan shtruar, si miq të besës. Martini, ulur në stol, kollitej herë pas here, me dorën në gjoks dhe

u tregonte për ato që kishte parë e që kishte dëgjuar në qytet. Kur fliste Mark Çuni, atij i kujtohej ai punëtori i fabrikës së cigareve. Edhe ai pak a shumë kështu i kishte thënë: «Jemi pa liri, Martin! Ti je malësor dhe malësia s'e ka duruar kurrë robërinë! Është turp të veshësh këtë rrobë fashiste! E ke bërë nga halli thua, nga fukarallëku, po atdheu nuk shitet kurrë! Nuk u duhet zënë besë as të huajit, as kapidanit, po Partisë dhe atyre vërsnikëve të tu që luftojnë maleve!...»

Gjin Kola vështronte zjarrin dhe thohte i menduar:

— Ne s'jemi shitur kurrë as për para, as për gradë. Denbabaden kemi qenë shqiptarë dhe s'jemi turpëruar. Po kësaj radhe na fryu në vesh i mallkuari dhe na bëri të skuqemi!

— Jo, Gjin Kola, mos e thuaj atë fjalë, — e ndërpreu Mark Cuni duke lidhur kripën në shaminë e madhe. Kolait ianë trima e burra të besës! Ja ku po iua them: unë dialin e kam partizan. Që të ruhem na skilet, se edhe skile ka, them poshtë e përpjetë që është në minierë. Po nuk është në minierë. Lufton maleve për lirinë e Shqipërisë.

— M'i lumtë pushka atij! — tha Gjini duke e përcjellë mikun qjer jashtë kullës së bashku me të birin. — Po Martinin, a po ma shpie te trimat? — e pyeti.

— Si të dojë Martini, — u përallaj Mark Cuni, duke e narë Martinin që shtrënaonte ajoksin për të laruar kollën e thatë. — Le që Martini, po të dojë, i gjen vetë trimat!

— Më rëndojnë në atoks malet: Turpi të kam bërë, dhe io kolla! — tha Martini me sy të ndezur. — Dua të shlyej! Dua të marr hak për krimet që bëjnë fashistët në popull!...

— Lum Martini! — e nërafoi Mark Cuni i prekur. Në krve të lavës të coi unë te partizanët! Veç mbajini të fshehta këto fjalë, se ka skile bota!...

Mirëpo nuk ndodhi ashtu si vendosën ata të tre. Cdo që u përmbys dy ditë më vonë, kur në fshat erdhën kapidani, kapteri dhe një repart i vogël alpinësh italianë,

të cilët kishin për qëllim të zbulonin vendin ku strehohej çeta e vogël partizane. Kapidani, oficeri italian dhe alpinët shkuan për darkë në qelën e Dom Shtjefnit. Në fillim u grumbulluan të gjithë ushtarakët në sheshin përpara qelës shtruar me rrasa të mëdha mali. Don Shtjefni shumë i shqetësuar, pakëz nervoz nga vizita e papritur, me lëvizjet e matura u jepte urdhra shërbëtorit të vet dhe një gruaje të re veshur krejt në të zeza, që të bënin përgatitjet e duhura për darkën. Pastaj të gjithë ata hynë në qelë, dritaret e së cilës si edhe porta e jashtme mbetën të ndriçuara gjer natën vonë.

Në kohën kur Kolajt po bëheshin gati për të fjetur, dikush trokiti në derën e kullës.

— A pret miq, o Gjin Kola! — thërriste prapa derës një zë i gëzuar.

— Prisni! Prisni! Tani po e hap!

Kur e hapi, Martini u ndesh ballë për ballë me kapterin e tij, atë burrin e shkurtër, shakatar e dhëmbëbardhë, që nuk ishte më shumë se dyzet vjeç, por që i bëshëm si calik mbushur me kripë.

— Urdhëroni, zotni! — e ftoi Martini i zbehur dhe në çast e përfytyroi duke qëlluar turmën me pushkën e gjatë. Ai hyri në kullë si në shtëpi të tij, i shkathët e gazmor, me dhëmbët çuditërisht të rregullt e të shndritshëm si zaje lumi.

— Si e kam Gjin Kolën? Po Sokolin e vogël? Po atë trimëshën e bukur?! Eh, Martin, Martin! Nuk ia di vlerën Lenës ti! Ke thasar në kullë e nuk di ta çmosh! Gjin Kola! I them drejt apo jo? — bëri shaka ai, siç bëjnë malësorët midis tyre me njerëzit e dashur të farefisit e të familjeve të tyre.

Plaku Gjin lidhi tirqet se ishte gati për të fjetur, e pa me mëri, se edhe atij iu kujtua ç'i kishte thënë i biri. Po e ftoi sipas zakonit të maleve:

— Urdhëro e ulu njëherë, ore mik!

E pritën ftohtë. I dhanë të pinte sa donte. Bënë edhe shaka të rëndomta. Ai mburrej shumë për të mirat që u kishin sjellë Kolajve ai dhe fashizmi. Martini e Gjini

bënin sikur pinin, po rakinë nuk e vunë në gojë. U dukej farmak e hidhur. Kapteri ia zbardhte shpesh dhëmbët e bukur Lenës. Ajo mblidhte supet duke parë të shoqin, që ishte jashtëzakonisht i zyrtë. Martini bënte sikur nuk e shikonte duke mbushur gotat. Më në fund, kapteri u deh krejt. E shtrinë, të veshur, siç ishte, me xhakatë lëkure dhe me çizme.

— Këtij i duhen thyer dhëmbët! — tha Martini i vrenjtur dhe i qetë. Ky qëlloi në popull!

— Me mend, o bir! Me durim e me mend! — e këshilloi plaku Gjini, duke ngrënë veten nga inati, meqë e ndiente që ende nuk mund t'i bënte dot gjë atij njeriu të ndyrë, atij vrasësi.

E pra, kur e njohu për herë të parë, i bëri përshtypje shumë të mirë. Jo vetëm kaq po e mburri dhe me mend tha se njerëz të tillë mund t'i bësh vëllezër kur të duash dhe pa pikën e dyshimit.

— Po gjarpri nuk bëhet vëlla dhe nuk mbahet në gji, mendoj duke rënë për të fjetur.

— Ai është vrasës dhe i poshtër! — i pëshpëriste Martini së shoqes, mbuluar të dy me një batanije... I mirë? Ai të vret në gjumë për para, për një fjalë që mund të thuash kundër fashizmit. Ai... edhe mund të të kurvërojë! S'ka besë! Hap sytë, Lenë! Se unë këto ditë do të iki! Do të shkoj te partizanët për të luftuar këta horra dhe zotërinjtë e tyre fashistë! Ki mendjen dhe mos e turpëro familjen tënde të nderhme dhe familjen e Kolajve, të nderhme gjithashtu!

Ajo i qe ngjeshur te kraharori dhe i pëshpëriste duke ngashëryer:

— Jo, Martin! Jo! Mos të të shkojë mendja kurrë keq për mua! Edhe unë i urrej këta fashistë! I urrej me gjithë shpirt! Unë të dua vetëm ty! Vetëm ty dhe Sokolin!

— Unë kështu them! Ki kujdes! Se janë të pabesë! Të shiten ndryshe nga ç'janë... Pastaj, ky, i fëlliquri, ta ka vënë syrin se je e bukur ti, Lenë! Ruajul!

— Martin! Mos, të keqen!...

Po Martini kishte pasur të drejtë. Ata dhëmbë të bar-

dhë i shndritën Lenës në mëngjes mu përpara buzëve, kur ishte duke ushqyer derrin. Ajo e kishte mendjen te puna, kur, dy duar e përfshinë për beli, nga prapa. Ajo ktheu kokën e pa dhe u tremb. Dhëmbët e tij iu dukën si plumba. Ai e lëshoi përnjëherë dhe i tha buzagaz, si pa gjë të keq, sikur bënte ndonjë shaka:

– U zgjuam ne, moj gonxhel! Ç'do të na gatuash për mëngjes?

– Me ç'të na ndodhet në shtëpi, – tha Lena e shqetësuar dhe e ndjeu që u skuq në fytyrë se ai e shikonte pa turp, duke lëpirë buzët me majëzën e gjuhës.

Lena ndjeu diçka shumë të keqe në atë qëndrim, në ato lëvizje të duarve të tij, në atë gjuhëz si majë nepërke. Si çdo grua e ndershme, la punën dhe, e turpuar, në heshtje bëri për nga kulla.

– Ç'ke? – e pyeti Martini që po vishte xhaketën ushtarake duke iu dredhur lehtë gishtërinjtë, të cilëve nuk u bindeshin kopsat.

– Asgjë! – tha ajo duke bërë çmos që ta përmbante veten. – S'di ç't'i jap atij për mëngjes!

– Jepi ç't'i japësh...

– Po çfarë t'i jap?

Martini rrëmbeu pushkën dhe thirri egër:

– Trupin!

Atëherë ajo e kuptoi që Martini e kishte parë nga frëngjia e kullës ç'kishte ndodhur pak më parë aty te kotecët.

– Martin! Po unë s'kam asnjë faj, Martin!... – tha Lena me lot në sy...

Pasdite ndodhi gjëma. Ajo kishte zbritur poshtë në livadhe për të kullotur dhitë. Ishte mbarimi i pranverës në male dhe bari kishte një ngjyrë të hapur. Ishte mbushur i tëri me lloj-lloj lulësh të ndezura. Ajo, shtrirë pranë një kaçubeje, mbledhte vjollca të buta dhe u merrte erë me ëndje të madhe. Kishte ardhur pranvera e shkurtër, me atë diell pak të ngrohtë, që fshihej shpejt midis reve të mëdha e të bardha. Ishte e shkurtër pranvera në male, si jetë e grave të reja. Dhe ato, kur ndienin erën

e vjollcave, bridhnin livadheve, këpusnin me kujdes lulet e brishta dhe, duke thithur aromën e tyre të këndshme, harronin mundimet, hallet e ëndërronin diçka të lumtur, diçka të bukur e të bardhë, si ato retë që lundronin vazhdimisht në qiellin e shndritshëm. Këtë ëndërrim të bukur për pranverën shumë të shkurtër, që lidhej me besimin se e ardhmja do të ishte patjetër e lumtur, ia këputi në mes ai, kanteri, që u shtri mbi bar te këmbët e saj. Përreth ishte qetësi e plotë. Atje lara, te sheshi i qelës së dom Shtiefnit, kishte shumë nierz. Po zëri i tyre nuk mbërrinte gjer në livadhet. Aty dëgjohej vetëm puhiza e erës pranverore dhe zukatia e lehtë e bletëve nënër lulet e marajthave. Ai rrotulloi kokën si arusha, që del nga strofka në fillim të pranverës së parë, kur fillon e shkrin dëbora. U bind që s'e shihte nieri dhe e përfshiu Lenën me duart e forta. Ajo u gjend e napërgatitur, u tremb shumë dhe anti i ra të fikët. Megjithatë, bëri nërpjekje të narihej. Po ai ia afroi buzët te ajiri i çierër. Gruaja, e turnëruar që ajiri i kishte dalë jashtë rrobave, pa e kuntuar as ajo sesi, ia shtyu kokën fort. Po kanteri e kishte kokën shumë të rëndë. I fluturoi vetëm kapela ushtarake me strehë të fortë. Përnara syve të saj shndrisnin vetëm dy sërë dhëmbësh të bardhë, midis tyre një ajuhëz si majë nepërke dhe nga ajo i dilnin avui të një frymëmarrjeje të crrcaullt. Vetëm aqyryku mund të shfrvnte ashtu, vetëm nieri që verbohet nga epshi e bëhet kafshë, që s'ka zemër, po një që të keqe, një tumor në vend të saj.

Lena nuk i dëgjonte fjalët e tti përkëdhelëse. I dukeshin si ofshma e kujie të vdekurish prej kobe, që i vinin nga shumë lara, nga shekujt e kaluar, sikur i dilnin nga fundi i dheut nga fundi i botës, nga gojë përhindëshash të pananiur kurrë në jetë të jetëve. Më në fund e aoditi fort në turi dhe u habit se si u gjend në këmbë menjëherë. Mori guxim më tepër, e pështyu dhe e shau rëndë:

— Fashist i fëlliqur! Shko e bëji këto ndyrësira me tët motër a me tët...

Ai u ngrit në gjunjë i ndezur nga epshi, si ndonjë bishë e egër, e plagosur për vdekje dhe gati që të bënte çdo gjë.

Po, pikërisht në atë çast, kur ai shtriu duart drejt saj, Lena dëgjoji një krismë pushke dhe ndjeu vërshëllimën e plumbit gati përmes flokëve që i ishin shprishur nën rubën e zezë. Kapteri u shtri nën këmbët e saj pa nxjerrë asnjë fjalë. Nga balli i shkallmuar i vërshoi gjaku dhe fytyra iu shprish. Një grerëzë iu ngjit menjëherë mbi bulëzat që filluan t'i dilnin nga buzët.

Lena, e turbulluar, dëgjoji një zë që erdhi nga sheshi i qelës:

– Ooo, ç'ka a pushka, moreee?

Jehona brodhi mbi livadhe vetëtimthi dhe kaloi dalngadalë grykave të maleve, majat e të cilëve shkëlqenin ende nga dëbora.

– Martin! – thirri ajo me zë që mezi i doli nga fyti dhe vrapoi pa mend në kokë drejt të shoqit, i cili qëndronte në këmbë si i ngrirë, prapa një trungu të rrëzuar prej kohësh e të kalbur nga motet. Iu afrua me dënësia, e lumtur që shpëtoi nga turpi. Ai nxori gëzhhojën ende të ngrohtë dhe hodhi pushkën në sup. Kapela i kishte shkuar mënjanë dhe i dukej vetëm syri i djathtë, ai me të cilin kishte marrë në shenjë kapterin fashist. I ngrysur, me një dhembje të madhe, që ia shtrembëroi buzën, tha:

– S'të kam grua, Lenë! Më ke gënjyer!

Ajo u llahtarisi:

– Martin! Unë s'kam asnjë faj! Unë jam e ndershme! Unë vetëm ty të dua dhe do të dua gjer sa të vdes!... Martin!

U dëgjua përsëri zëri i fortë nga bregu ku ishte qela e Dom Shtjefnit, por më afër e më qartë:

– O! Ç'ka a pushka, moreee?

Martini ia hoqi duart së shoqes me zor nga qafa e vet dhe mbushi pushkën.

– Më ke gënjyer! – tha i ngrysur, duke parë majën e thepit.

Jehona e thirrjes nuk u dëgjua më mbi livadh. Ajo hyri drejt e në grykën më të afërme dhe kaloi mal më mal, ogurzezë, si lajmtare e një fatkeqësie të madhe.

Martini e mbushi pushkën dhe ia drejtoi. Nuk shikonte mirë. Njërin sy ia kishte mbuluar kapela. Tjetrin e kishte të veshur nga një gjë zhelatinoze.

— Martin! — i tha Lena me krahë të këputur, pa qenë në gjendje të kopsiste kopsat e gjirit. Më i ëmbël plumbi yt, sesa turpi nga një fashist! Më vrit!

Ajo qëndroi gati për pushkatim, e drejtë, e bukur, me flokët që i kishin dalë nga ruba dhe ia lëkundte puhiza e erës. Në sy kishte dashuri për të shoqin dhe urrejtje për atë, mizorin që po e sulmonin kandrat e shumta. Në cepat e tyre i ndritnin vetëm dy pika lot, të ngrirë, që nuk donin t'i shkëputeshin e t'i rridhnin faqeve të zbehta.

Martini e mori shenjë për një kohë të gjatë, po nuk ia dallonte fare anën e majtë të kraharorit. Nuk donte ta prishte bukurinë e saj në fytyrë. Po edhe duart i lëkundeshin, edhe këmbët.

Ata që thirrën të parët nga oborri i qelës së Don Shtjefnit, rrodhën tatëpjetë bregut dhe ranë në livadhe. Tani të gjithë ata, të armatosur, shumica alpinë të huaj me pupla në kapelë, po afroheshin prapa krahëve të tij. Martini nuk i shihte dhe as i dëgjonte, se u kishte kthyer kurrizin. I dallonte mirë Lena, që i kishte përkundrejt. Ata po afroheshin. Ata do ta kapnin ose do ta vrisnin.

— Më qëllo, Martin dhe ik, se do të të vrasin! — i tha ajo duke iu lutur. Më vrit! Po ta dish, që të kam dashur vetëm ty! Më vrit. Bëj ç'të duash me mua! Mos më lër asnjë amanet, po të duash! Po ik, së ata erdhën! Do të të vrasin, Martin! Ruaju, Martin.

Ai qëndronte i ngrirë, me shënjestrën në syrin e për-lotur dhe nuk ia gjente dot anën e majtë, atë vendin nën sisë, ku i rrihte zemra. Më në fund foli me pikëllim të madh:

— E di që je imja, Lenë! E di që s'ke asnjë faj! Po ç't'i bëj kanunit dhe turpit! Ik në kullën tënde, te prin-

dërit e tu dhe jeto si të jetosh! Veç ma bëj Sokolin burrë!

Atij iu var pushka. Lena iu derdh në qafë si era. Dëneste dhe ia lagte gushën me lot të vakët. Ashtu i gjetën alpinët fashitë, të përqtuar, bërë njësh, burri, gruaja dhe pushka.

— Ç'bëre kështu, Martin? — thirrri i tmerruar kapidani, duke parë kapterin e përgjakur nën ijan e kaçubës.

Martini shtrëngoi Lenën fort në bel dhe tha shumë qetë:

— E vrava! Donte të më çnderonte gruan!...

Dom Shtjefni, që arriti atë çast, ngriti gishtin nga qielli dhe tha me përdëllim:

— Edhe një ndëshkim i tmerrshëm nga zoti!

S'e kishte ulur ende gishtin e tij si qiri, kur nga turma e njerëzve doli përpara plaku Gjin dhe tha me zë të lartë:

— Hallall, o bir! Shqiptari rron për një nder!...

Kur pa kapterin me fytyrë krejt të shprishur, zemra iu bë sa një mal.

— Hallall, Martin! Lenën ta mbaj unë dhe Sokolin unë do të ta bëj burrë!...

Oficeri që komandonte alpinët, një ushtarak i sertë, pasi dëgjoi ç'i tha kapidani, Dom Shtjefni dhe dëshmitarët e tjerë, e quajti krimin mizor.

Vrasin njëri-tjerin për hiçgjë, mendonte pas pak i habitur dhe me mllef, duke pirë verë me gota të mëdha në qelën e kishës. Këta vrasin atin edhe birin për një krodhë bukë, dhe jo për një femër. Janë të egër si malet, gjakmarrjen e kanë në gjak, si malet! Racë e prishur.

Piu edhe një gotë me fund dhe u ngrit duke iu drejtuar Dom Shtjefnit me përbuzje.

— Po ju ç'bëni në këta shkrepë, im zot?!

Dom Shtjefni e kuptoi qortimin pa vend të oficerit kapadai dhe pa eksperiencë. «Kafshë, mendoi, ju nuk i njihni këto male!» Dhe iu drejtua me përvujtni. Po zërin e kishte të rreptë.

– Zoti oficer! Ju s'dini ç'flisni! Ju ka zënë vëral! Mund të pini edhe tërë damizhanen, se kemi, shqyrr, boll! Po me këto që thoni, mund të rrezikoni edhe kokën tuaj!

Dhe ia ktheu latinisht me një mendim të vjetër, pakëz të ngatërruar, po që zuri vend menjëherë te ushtaraku:

– Zoti korrigjon zakonet duke qeshur me lehtësi, – dhe qeshi si djall duke ia bërë bromb.

...Që atë natë Martin Kola u arrestua dhe humbi.

Ku e shpunë?! Ku e syrgjynosën?! Në Porto-Romano të Durrësit? Në Ventotenë të Italisë? Në burgjet e panumërta të Shqipërisë. Në ç'vend? Në ç'ferrë?

Gjin Kola zbriti disa herë në qytet dhe shkoi duke pyetur burg më burg edhe për tej qytetit. Dhe kudo që vinte i thoshin:

– S'kemi të burgosur me emrin Martin Kola.

U rropat dhe Lena me gjithë Sokolin e vogël duke u gdhirë përpara dyerve të burgjeve.

– S'ka Martin Kola këtu!

– S'ka Martin!

– S'ka!

Filloi të flitej për të, gjithnjë e më pak në fshat. Gati iu harrua emri. Koha ishte e përgjakshme, tërë stuhi dhe binte erë barut. Bëhej luftë e madhe në tërë Shqipërinë. Vriteshin njerëzit me shumicë, edhe humbnin pa nam e nishan. Humbi edhe Martni. Po njerëzit e shtëpisë me të drejtë pyesnin gjithnjë e më me ngulm.

– Ku është Martini? Mos e keni parë Martin Kolën?! Mos keni dëgjuar ndonjëherë për Martin Kolën?!...

Po Martin Kolën as e njihje njeri, as e kishte parë kush dhe as ia kishin dëgjuar emrin ndonjëherë në burgjet e Veriut!...

Plaku Gjin pinte çibukun pranë vatrës dhe shpeshherë fliste si përçart në kullën pa njeri:

– Po ti, ku je, o Martin?!... Ku je?!

Vështronte përreth kullën e vetmuar, hante veten me dhëmbë e thërriste përsëri përçart, sikur të kishte njeri që e dëgjonte:

– O Martin! Po diku je! Mbi tokë, a nën tokë, po je!
Na lajmëro, o bir!

U përpoq edhe Mark Çuni me ndihmën e partizanëve të malësisë po nuk gjeti asnjë gjurmë. Ai gjeti vetëm varrin e djalit të vet që iu vra një ditë vjeshte në Bjeshkët e Urës, ku disa muaj më parë në fillim të verës, ishte formuar çeta e parë partizane e qarkut, ajo çetë ku do të vinte edhe Martin Kola. E mori të birin Mark Çuni dhe e sollti në fshat. Po dom Shtjefni nuk e lejoi që trupi i partizanit të prehej në varrezat e fshatit si gjithë të tjerët.

– Më fal! – i tha, – o Mark Çuni! Po yt bir është komunist i shkishëruar! S'e ka vendin këtu!

Atëherë Mark Çuni e varrosi në oborrin e vogël të kullës së vet.

– Ti e gjete dhe e varrose trimin! E ke pranë shtëpisë dhe zemrës! Po unë, ku e kam Martinin tim? Ku do ta gjej?!

Mark Çuni, me gjithë dhembjen që kishte, i tha:

– Ai qe trim dhe e ka gjetur vetë rrugën e malit! Do të vijë Martini! Do të vijë, o Gjin Kola! Nuk të turpëron ai!

– Eh, ty të lumtë goja, o Mark Çuni!

Por, po iknin muaj e vite dhe Martini as vinte në fshatin e tij dhe as i dëgjohej emri...

* * *

Martini ishte gjallë. Fashistët nuk i bënë gjyq fare se, duke u mbështetur në të dhënat e mjekut ushtarak, i cili e nxori TBC të kategorisë së fundit, e internuan pa afat në malësitë e Jugut, në burgun e një fshati të madh.

Fshati ishte një vend i rrethuar me pisha, me burime të ftohta në të katër anët, me shumë kisha dhe me njerëz blegtorë, të fortë e patriotë. E ruante atë një komandë fashistësh, me nja njëqind njerëz të armatosur, të cilët

në çdo çast lidheshin me telefon me qytetin. Kishin edhe një xhade të rregullt nga mund të vinte brenda orës ndihma ushtarake.

Mirëpo, një natë janari, kur dëbora arrinte gjer në brez, njësitet partizane, me urdhër të Qarkorit të qytetit, sulmuan dhe e çliruan. Garnizoni i vogël, i gjendur në befasi, u dorëzua i tëri. S'kishin ç'të bënin. Ndërlidhjen telefonike e kishin ndërprerë njësitet guerile të fshatrave fqinjë. Po ato njësite e kishin gërryer xhadenë në mjaft vende. Veç këtyre, edhe dëbora kishte bërë punën e vet. Njerëzve u arrinte gjer në brez, po trashësia e saj ishte më e madhe.

U luftua vetëm te ndërtesa e italianëve. Ata nuk donin të dorëzoheshin dhe nxorën nga dritaret tytat e pushkëve dhe të mitralozëve. Mirëpo komisar, një djalë i ri njëzetvjeçar, që bënte edhe këngë partizane dhe që e njihte vendin mirë, se ishte malësor i atyre anëve, hipi mbi çatinë e ndërtesës, u mundua sa hoqi borën e tjegullat dhe vërtiti brenda dy bomba njëren pas tjetrës. Italianët u lebetitën dhe u dorëzuan.

Po ky djalë i ri, komisar në një nga çetat e vogla, u turr dhe hapi burgun. Kishte atje lloj-lloj njerëzish, të sëmurë e të shëndoshë. Nuk i pyeti përse ishin burgosur, po u tha shkurt:

– Dilni! Jeni të lirë! Shkoni nëpër shtëpitë tuaja dhe, me se të mundni e ku të mundni, luftoni fashizmin!

Të burgosurit dolën në oborr. Komisarit iu afrua një djalë i gjatë, veshur gjysmë milic.

– Me lejel – i tha. A mund të qëndroj me ju, partizanët?

– Kush je ti? – e pyeti komisar i ri.

– Shqiptar!

– More po të dëgjoj që flet shqip, por po të shoh të veshur pak edhe si milic. Të pyes nga je?

– Nga Veriu. Nga Malësia e Thellë.

– Përse të kanë burgosur?

– Kam vrarë një kapter fashist që donte të më çnderonte gruan.

– E vrave tamam?!
– Po.

– Mirë ia ke bëre, qenit... E përse kërkon të bëhesh partizan?

– Për t'u hakmarrur kundër fashistëve italianë dhe tradhtarëve të vendit.

– Po mirë, o shok! Ne trima si ti duam. Si e ke emrin?

– Martin Kola!

– Hiq mënjane dhe ja ku i ke shokët partizanë! Pastaj bisedojmë! Bashkohu me ta!

– Po pushkë?! Unë s'kam pushkë!

– Pushkë?!... Po shko, ore, në depo e merr ç'të duash. Ne prandaj e hapëm, që të armatohet populli! Ik, Martin, ik!

Një orë më vonë çeta ku ishte komisar ai studenti i ri, që bënte dhe këngë partizane, u grumbullua nën pishat e rënduara me dëborë. Komisari, me një vështrim, dalloi tre njerëz të panjohur, dy me pushkë dhe një me mitraloz. E njohu atë që kishte mitralozin.

– Shoku Martin! A di ta përdorësh mitralozin? – pyeti komisar.

Martini, qafëgjatë e gjokszbuluar, po shumë i hequr në fytyrë, bëri një hap përpara si ushtarakët e vërtetë. Sytë i ndritnin. Tha duke iu dredhur zëri:

– Unë jam malësor dhe armët i kam mësuar që j vogël!

– Ta gëzosh, shoku Martin! dhe tani nisuni drejt e te Kodra e Kaprollit. T'u presim rrugën fashistëve, se po vijnë nga qyteti!...

Pasdite një mitraloz kërciste buzë xhadesë, nën pishat e rënduara nga bora. Fashistët kishin ngelur në vend. Makinat që i kishin lënë përfund xhadesë, aty ku njësitet kishin hapur kanalën e parë, kishin marrë flakë.

– Kush është ai që qëllon me mitraloz në xhade. Yni është apo i ndonjë çete tjetër? – pyeti komisar i ri.

– Yni, shoku komisar. Është Hajdari! – tha një partizan pranë tij.

– Kësaj radhe Hajdari ka dalë keq. Është krejt i zbuluar. Vraponi për ta ndihmuar! – thirri komisar.

U turr gjithë çeta te Kodra e Kaprollit. Nga ana tjetër sulmoi një çetë e Ostrovicës. Në mes sulmoi çeta më e vogël e Gurrmajasit. Fashistët u thyen e s'dinin nga të venin. Flaknin pushkët dhe vraponin me duart lart. Mitralozi atje përfund khadesë nuk pushonte. Ai tani i hante mirë fashistët. I bënte të zhyteshin me turi në dëborë. I gjakoste.

– Dreqi! – tha komisar. S'e ka keq Hajdari, që ka dalë në khadë! Po ka vënë jetën në rrezik...

Po nuk ishte Hajdari. Kur zbriti edhe komisar atje, pa një luftëtar veshur gjysmë civil e gjysmë milic. E njohu malësorin dhe i thirri që të mbrohej, se po e gjuanin nga një lartësi, të cilën çetat nuk e kishin zënë ende:

– Martin!

Malësori ktheu kokën dhe komisar pa një fytyrë mbuluar me gjak. Vrapoi tek ai me një frymë dhe ia rrëmbeu mitralozin nga duart.

– U shpartalluan, Martin! – i tha. Edhe kodrën nga të gjuanin e zunë shokët! Martin, dale të të shoh, ku je plagosur?

E kthehu me zor dhe u trondit. Plumbi e kishte marrë malësorin shkarazi në syrin e majtë. Gropëza ishte si një zgavër e vogël nga buronte gjak i freskët. Komisar ia mbuloi me pëllëmbë gjersa shqeu paketën me garzë e lidhëse.

– S'ka gjë, komisar! I majti është! Njeriu mund të luftojë më mirë me një sy. Dy e pengojnë. Dëgjomë mua! Tani mbaj hapur vetëm njërin dhe çdo fashist që futet në shenjën e tij, e ka vdekjen në xhep!

– Qenke i fortë, o trim! – thoshte komisar duke i lidhur syrin edhe ballin. Qenke i fortë! Tamam si malësorët e anëve tona!

– Më ka bërë të fortë urrejtja, komisar! Kam vuajtur shumë! Këtë ditë kam pritur, që të hakmerrem!

– Edhe dashuria të ka bërë kështu, Martin!

Malësori pa partizanët e çetës së tij që po afroheshin të armatosur me tri katër pushkë dhe tha duke kapërdirë dhembjen:

– Po, komisar. Ke të drejtë. Edhe dashuria!

* * *

Komisari ishte nxënës i vitit të fundit të Liceut, njëzet vjeç djalë, i shkathët, i qeshur dhe trim. I thoshin student, se në ato kohë ashtu i quanin gjimnazistët e liceistët, ndoshta për t'u dhënë një peshë më të madhe viteve të tyre të njoma. Mbrëmjeve, kur shokët flinin të lodhur, ai bën dritën e zjarrit e të kandilit, shkruante ditarin e vet. Ishin fletore të vogla dhe ai i mbushte kutitë dhe vijat herë me bojë dhe herë me laps. Nuk shkruante asgjë për vete, veç për shokët, për fshatarët, për betejat, për zakonet e maleve. Filloi të shkruante edhe për Martin Kolën, siç kishite shkruar edhe për të tjerët, për ata që ishin vrarë dhe për ata që ishin gjallë. Midis radhëve mund të lexoje:

«Martin Kola, me të hapur burqun, rrëmbeu mitralozin, luftoi trimërisht dhe nën Kodrën e Kaprollit u plagos rëndë. Humbi syrin e majtë. Ai më tha se për të luftuar, është më mirë të kesh një sy! Çfarë shpirti ka ky njeri?!

Sot Martini më tha për herë të parë se ka në malësitë e Veriut plakun Giin, Sokolin e voaël dhe Lenën. Tërë ditën ka aenë shumë i mērzitur dhe i dëshpëruar dhe në mbrëmje, kur flinte, e zuri një kollë e thatë, sikur donte ta mbyste. Unë i hodha supeve pallton time dhe, pas pak, kolla e la, po frymë mernte me zor!...

Martini më tregoi se ka vrarë një kapter fashist që donte t'i çnderonte qran! Mirë ia ka bërë! Më tha se për këtë arsye e burqosën...

Sot e kuptova përse e kanë siellë në këtë buraj Vuan nga mushkëritë! U thashë pesë komunistëve të çetës që të kenë kujdes të veçantë për të. Në kontrollin që bëmë natën, e gjeta Martinin mbuluar me katër kapota...

Sot më tha: «Nuk dua të vritem pa varrosur kapidanin dhe dom Shtjefnin e fshatit tonë, që janë fashistë e kriminelë!»...

Shokët e çetës, për herë të parë u lanë në lumë, megjithëse është ende freskët, fillim maji! Martini, që ishte shtrirë në shullë e ngrohej në diell, më tha: «Ëh! Komisar! Malet andej nga ne kanë akoma dëborë! A është gjallë plaku?! Ç'bën Sokoli i vogël?! Po ajo, Lena?!»...

E gjeta shumë të trishtuar e të zbehur. Kishte pështyrë gjak. I thashë që do ta dërgonim në spitalin tonë ose në qytet: «Jo, komisar! Jam mirë! Jam mërzitur se nuk po ia bëjmë bam!»...

Sot Martini ishte në qejf. «Kjo është luftë për fukarane, o komisar, — më tha. — Duhet ta zhdukim sa më shpejt dëshmanin që na ka zaptuar vatanin, edhe parinë, edhe bajraktarët, edhe klerin, se të gjithë janë shushurica!»...

Sot, mes muaji, ishte edhe më me qejf dhe, në ecje e sipër vërshtëllente këngë partizane. E pyeta: «Ç'ke, Martin?!» Ai më përqafoi dhe më pëshpëriti në vesh sikur më zbulonte ndonjë sekret: «Sot për herë të parë e hodha firmën të plotë e pa gabim: Martin Kola!»...

Kemi dy ditë që udhëtojmë larg kufijve të krahinës sonë. Kur pushuam në një livadh, midis pyllit të dendur, e gjeta Martinin shumë të dëshpëruar. Më tregoi pa e pyetur: «Më vjen keq për Lenën. Në një livadh si ky e gjeta. Dësh e vrava, për t'i shpëtuar zakonit. Ajo s'kishte asnjë faj! Ishte grua e ndershme, burrneshë e vërtetë! Dhe unë... desh e vrava e shkoi! Më vjen keq për të, komisar! Kam bërë faj! Më lutej që të ikja e të shpëtoja nga fashistët! Kurse unë e merrja në shenjël! E dua, komisar!»...

Sot, 25 maj, gjithë çeta ka dhembje. Na u vra Martin Kola, shoku ynë i dashur. Që mbremë, kur ndamë skuadrat, ai hyri në ato të sulmit. Ndaj të gdhirë u gjend kundrejt kazermave. Luftoi pa u shkukur nga vendi, edhe kur italianët sulmuan me forca të mëdha. Ata i thoshin

«Dorëzohu, more komunist, se s'ke ku shkon!» Martini u thërriste me shaminë e kuqe në ballë, duke u lëshuar breshëritë e mitralozit: «Komunistët nuk dorëzohen, more këlyshët e Duçes!» Kishte hyrë shumë thellë në pararojë. Erdhën e bombarduan edhe aeroplanët. Gjatë bombardimit, ata e rrethuan dhe na e vranë, aty, disa metra larg frëngjive të kazermave. Ikëm shumë të dëshpëruar, se s'patëm as mundësi ta tërhiqim. E lamë shokun tonë në duart e bishave... ..Jo, nuk e lamë. Në mbrëmje na erdhën në ndihmë çeta të tjera nga krahinat e Jugut. I shkulëm italianët nga kazermat. Zumë prita të tjera rrugëve automobilistike dhe i shpartalluam të gjitha kolonat. Njëzet e pesë armiq të vranë i shtrimë në një kthesë. Tetëdhjetë i zumë robër. Të plagosurit klithnin «mam mia!». Ne shkruam te Martini. E gjetëm mbi mitralozin që i ishte shkatërruar nga predhat dhe e mbuluam nën gurët e bardhë. Kënduam «Hakmarrjen», zbrazëm një breshëri armësh, u betuam me grusht se do t'ia marrim hakun dhe shkruam në betejat e tjera...

«Sa beteja! Çfarë luftime! Po në fund ja edhe dita e Çlirimit... Dita e plotë e Çlirimit! Më mbushën sytë me lot se kujtohen gjithë ata shokë që i mbollëm maleve, si pisha. Më kujtohen Çeliku dhe Guri që ranë në malësinë e Oparit, dëshmorët e parë të çetës! Më kujtohen Ylviu dhe Dilka, që na u vranë në Gorë, edhe Skënderi me Masarë. Më kujtohen Mitati e Jonuzi, që na u vranë në Rrëzë! Më kujtohet Martini, që e mbuluam me gurë! Marti malësori, nga malet e ashpra të Veriut...

* * *

Tërë vitin e parë të Çlirimit, që nga nëntori i 1944-ës dhe gjer në dhjetor të 1945-ës, plaku Gjini nuk e ngriti dot shpinën nga halli që e pllakosi. Asnjë lajm për Martinin. Asnjë.

Lufta e madhe kishte mbaruar, të huajt ishin munduar, kapidani ishte arratisur dhe që vendosur pushteti i po-

pullit. Malësorët merrnin frymë lirisht, pasuritë e kapitanit dhe të tradhtarëve të tjerë pasanikë u konfiskuan, në livadhet e tyre të dikurshme kullosnin bagëtia e të varfërve, në kullën përkundrejt qelës së Dom Shtjefnit u hap shkolla e parë dhe nga fëmijët e parë që u regjistruan që edhe Sokoli i vogël.

Po lufta vazhdonte ende, me forma të tjera, të papara, të padëgjua, tinëzare dhe shpeshherë në malësi, nëpër pyjet, në varrezat, përpara kullave, vriteshin partizanë të ushtrisë tanimë të rregullt, komunistë, vajza përparimtare, aktivistë të shquar, patriotë. Shtigjet e ngushta ku kalonin malësorët e lirë, nata e ndriçuar nga hëna, qela e Dom Shtjefnit, pyjet e dendura me pisha, rrinin pezull, gati për të bërë një vrasje, për të ndezur hasmëritë e vjetra, për të përmbysur çka u ngrit me gjakun e mijëra e mijëra shqiptarëve: pushtetin popullor. Armiqtë e këtij pushteti, të nxitur e të ndihmuar nga të huajt, që gdhinin pa gjumë netët e gjata, nuhatnin si frynin erërat, llogarisnin duke arsytuar për bukuri të gjitha rrugët e pyllit të dendur; përgjonin çdo hap të gabuar, edhe gabimin më të vogël të njerëzve të pushtetit, kontrollonin me imtësi pulsën e shmangieve dhe, mbi të gjitha, ndiqnin rrugën e pakënaqësive dhe të komprometimeve. Dhe ëndërronin mbushur me mëri shekullore për çdo gjë që kishin humbur, prisnin rastin me ankth, që një ditë prej ditësh mbushur me diell a mjegull të dendur, të derdhnin mbi Shqipërinë e vogël të porsaçliruar, repartet e motorizuara, anijet luftarake, tanket e avionët ngarkuar me peshë të madhe prej qindra e qindra tonësh çeliku e eksplozivi. Dhe në tërë këtë plan të llogaritur mirë, ishte parashikuar edhe një gjë e kobshme, e përbindshme dhe çnjerëzore: të xhvarrosnin të rënë, të mohonin gjakun e njëzet e tetë mijëve, të hidhnin sa më shumë mjegull, mjegull...

Kjo gjë bëhej në qelën e dom Shtjefnit, në fshehtësi të madhe dhe në errësirën e plotë, kur malësorët shihnin në ëndërr, midis mjegullave të bardha, jetën e re. Armiqtë përmendnin një për një dëshmorët e asaj ane. Niseshin nga stërgjyshi, nga gjyshi, nga farefisi. Hiqnin

mënjatë Tom Kolën, që u plagos në demonstratën e dyzetedyshit dhe u vra më dyzetetreshin. Ndaleshin te Martin Kola. Nuk u interesonte fare Martin Kola. Ai ishte një hiçgjë. Ndienin kënaqësi që nuk ishte më i gjallë. U interesonte Gjini Kola, babai i tij, fisi i tij, miqësia e tij me Mark Çunin. U interesonin të gjallët, për të varrosur edhe një herë të rënë.

— Ka dalë një libër me kujtime, midis dhjetë librave që u botuan këtë vit, — tha dom Shtjefni duke mbajtur në dorë librin me një titull që i dukej qesharak. Libri titullohej: «Dhjetë pika gjaku».

— Shikojeni! Është i hollë sa një fletë cigareje. Dhe botuar në pesëqind kopje. Janë kujtimet e një komisariliceist të vranë. Po e hanë minjtë nëpër depo, se nuk e ble njeri. Vendi ka mbi nëntëdhjetë për qind analfabetë. Këtu te ne qind për qind. Kush ta lexojë? Edhe ata që dinë shkrim e këndim, s'kanë mendjen te librat, po te buka. Por këtu flitet edhe për Martin Kolën. Na qenka dëshmor!

— Si kështu? — e ndërpreu Mëhill Cungu që merrej me punët e pushtetit në lokalitetin malor.

— Po, vazhdoi dom Shtjefni me zë të ulët. — Pas burgimit është bashkuar vullnetarisht me partizanët dhe është vranë, siç shkruhet këtu, disa metra larg frëngjive të kazermave. Pra, është dëshmor i tyre.

— Shumë keq! — belbëzoi nëpër dhëmbë Mëhill Cungu.

— Përkundrazi, — tha kapidani me kënaqësi, me gishtin në këmbëzën e automatikut.

Që kur u çlirua Shqipëria, ai me urdhër të «Komitetit të Maleve»¹⁾, u arratis, rrinte gjithnjë i armatosur dhe gishtin nuk e hiqte nga këmbëza e automatikut gjerman.

— Ti, Mëhill, do ta quash atë milic. Gjini Kolën nuk do ta pranosh për asgjë as në mbledhjen e fshatit. Do t'i thuash që është familje milici e tradhtari. Të tjerat i rregullon dom Shtjefni. Apo jo, imzot?

1) «Komiteti i Maleve» — organizatë tradhtare e drejtuar nga të huajt.

– Me ndihmën e të madhit Jezui! – u përgjigj dom Shtjefni, duke shfletuar me neveri ato faqe të pakta e tërë gabime shtypi të librit «Dhjetë pika gjakul!»

– Unë e kam njohur Martinin. Kemi qenë të dy milicë. Po kur unë qëllova mbi demonstruesit, ai më kapi pushkën. Pastaj bëri krimin. Vrau kushëririn tim dhe u zhduk. Tani na dalka dëshmor. Kurse unë, – Mëhill Cungu u kollit dhe nuk e mbaroi mendimin e vet.

Kapidani e kuptoi se ku donte të dilte besniku i tij dhe e ndërpreu, duke u sjellë urtë e butë, por pa e fshehur zemërimin. I tha prerë:

– Ti, Mëhill Cungu, e ke justifikuar veten tani. Do të vazhdosh të thuash që, në fillim, ka pasur shumë të gënjyer, por ti e kuptove gabimin i pari i të parëve, u lidhe me Nacionalçlirimtaren dhe luftove për këtë pushtet. Tani ty nuk të kanoset asnjë rrezik. Përveç kësaj, ke për-krahjen e plotë të «Komitetit të Maleve».

– Kapidan! Unë jam me ju gjer në varr! Jua them këto që të më ndihmoni si të veprojl

– Ja, kështu të veprosh; Gjini Kola është familje tradhtari e milici!

Gjini Kola nuk e ngrinte dot shpinën nga halli që e pllakosi. U plak shumë gjatë atij viti, gati shkoi në varr, po e mbajti gjallë vullneti për të luftuar, për të gjetur të vërtetën dhe për t'u hakmarrur.

Një gjë nuk arrinte ta kuptonte plaku: si ishte e mundur që Mëhill Cungu të mbulonte të kaluarën e tij dhe tani t'u diktonte si bajraktarët dikur? Diçka nuk shkon, thoshte plaku me vete. Ai kishte një besim të patundur se djali i tij Martin Kola, duhej të kish mbyllur me nder jetën e tij të re.

Një ditë vjeshte ishte në pyll duke prerë dru për dimër. Pylli ua kishte marrë shumë njerëzve jetën, me kurthet e me pusitë e tij të fshehta. Po plaku Gjini priste dru me sëpatë, i bindur se pylli është miku më i mirë i pleqve. I priste me sëpatën e mprehtë, i zhvoshkte aty për aty dhe thithte me ëndje të madhe aromat dehëse e të

panumërta, mbi të gjitha, atë erën e këndshme të pishave e të rrëshirës.

Papritur, si cub, i doli përpara Mëhill Cungu, veshur me një pallto treçerekëshe, me qafore të leshtë dhe me belgjik në sup. Fytyra e tij kishte një pamje të qeshur, ngadhënjimtari. Plaku Gjin nuk diti ç'të bënte. Ngriti sëpatën dhe fshiu me gishtërinjtë e ashpër tehun e saj të mprehtë.

— Po prish pyllin e popullit, o Gjin Kola! Bravo të qoftë. Prishe, prishe dhe merr hak për Martinin! Kjo të ka mbetur. E ç'do t'i bëni më ju këtij pushteti?! Ja, do t'i hiqni ca lëvozhga të kalbura. Dhe kështu, mendoni, se do ta varrosni!

Plakut Gjin iu pre gjuha. Mëhill Cungu vazhdoi rru-gën tatëpjetë me njerëzit e vet të pushtetit, pa kthyer kokën, duke lënë pas gjurmët e freskëta nëpër fshehtësitë e pyllit. Një degë e njomë pishë u lëkund dhe derdhi mbi të pikat e fshehta të shiut. Ai u lag dhe ngriti kryet lart. Retë e dendura shëtisnin mbi majat e pishave, derdhnin shi dhe ai, me sëpatë në dorë, pylli i madh, drurët që kishte prerë dhe toka ku kishte ngulur opingat, ishin kthyer që të gjitha në lagështi, mjegull e në një gjë të qullët, si ajo lëkura e trungjeve të rrëzuara prej motesh.

Plaku i hodhi pyllit një vështrim të lodhur. Iu duk si një gjë krejt pa kuptim. Në atë pyll Gjin Kola ishte rritur së bashku me dhitë që bëheshin, si edhe ai, më të egra, nga viti në vit. Aty e kishte kaluar jetën, midis drurëve të drejtë e të shëndetshëm. Aty kishte kapur egërsira me leqe, kishte kapur zogj të bukur pa vështirësi, kishte vrarë gjela të egër, kaproj dhe arinj të murmë. Aty kishte rritur Martinin e tij të vetëm, duke i mësuar të gjitha fshehtësitë e pyllit e të kafshëve të egra. Aty i kishte mësuar edhe pushkën, që kur ishte fëmijë pesë vjeç...

Po fyerja e Mëhill Cungut qe aq e rëndë, sa iu duk sikur i ranë mbi krye drurët e moçëm e viganë të pyllit dhe sikur i shpërtheu gjaku nga dejtë e holluar prej pleqërisë. Ndjeu sikur i ranë trungjet me gjithfarë kacavjerrësish të blertë. Çdo gjë e rëndë, e shpërndarë në-

për atë pyll, erdhi e u grumbullua mbi kryet e tij. E plaku Gjin u shkund me tërbim, i shpërndau kacavjerrësit majtas e djathtas, dhe thirri:

– Mëhill! Mos e harro pyllin, Mëhill! Ia pret trungun, po ai lëshon filiza e përtërihet!

Iu duk sikur dëgjoji jehonën e zërit të Mëhillit.

– Yt bir qe fashist, dhe ti do të përgjigjesh për tradhtinë e tij.

Gjin Kola nxori një klithmë.

– Jo! Dhe jehona u zgjat: jooo! Pastaj qetësi e plotë.

* * *

Me Sokolin për dore, plaku Gjin u nis një mëngjes herët për në lokalitetin e largët. Nipi tanimë ishte rritur, dhjetë vjeç malësor, i gjatë para kohe dhe me supe gati si të Martinit. Edhe hapin e kishte si të të atit, të lehtë, të pagabueshëm, edhe vështrimin të mprehtë, edhe flokët të dendur, edhe fjalët të pakta, si të Martinit.

Plaku e kishte përfshirë për dore, më shumë për t'u mbështetur tek ai, sesa ta mbante për dore. Lena i përcolli me lot në sy. Ua kishte bërë gati çdo gjë që në mbrëmje. Kishte mbështjellë të gjitha ç'i duheshin për rrugën e largët të kryeqytetit, fanellën e lehtë, të mbathurat, lëkurçen e qengjit me leshin e trashë dhe dy libra këndimi, që Sokoli i kishte mësuar përmendsh. I përcolli gjer te livadhet përfund kullës dhe aty u nda. Plaku Gjin eci disi i turbulluar drejt shtegut që ishte hapur prej vitesh, pa çarë kokën ç'la pas. Po Sokoli, para se të fshihej prapa shkrepit të fundit, ktheu kokën dhe përshëndeti nënën që kishte qëndruar me duart të kryqëzuara në kraharor. Ajo ia ktheu përshëndetjen nga larg me të dyja duart dhe, kur ata u zhdukën, u shkreh në vaj, se vuri re që ishte pranë trungut të rrëzuar, ku u nda për herë të fundit me Martinin dhe ku ndodhi ajo gjëma e kobshme, që ia mbylli gëzimin një herë e përgjithmonë!...

Plaku Gjin ecte me shpinën kërrusur dhe, para se të

mbërrinin në lokalitet, filloi t'i jepte mësim të nipit se ç'duhej të thoshte përpara zyrtarëve të lokalitetit.

— I'i thuash se je i biri i Martin Kolës dhe nipi im i vetëm. Ië mos gënjesh. I'i thuash se në tshat ta dhanë ty të vetmen bursë për të mësuar në qytet. I'i thuash se je malësor i zgjuar, për një vit, more tre vjet shkollë dhe t'i tregosh dokumentin që ke këtu. T'i thuash...

— Mirë, gjysh! — përsëriste i nipi, po Sokolin e kishin rrëmbyer ëndrrat e pragut të rinisë, që nuk pyesnin për asgjë në botë. Ai tanimë ishte rritur, pak para kohe, siç rriten fëmijët në malësi. Ai ëndërronte për hapësira, për qiej më të hapur, për dete ku lundrojnë anije, për rrugë të panjohura që të shpien diku në vise ku mund të gjesh me siguri varrin e një njeriu të dashur, varrin e Martin Kolës, varrin e babait të mirë dhe trim!...

Qendra e lokalitetit shtrihej rrzë një mali që ata e panë nga larg. Rruga gjer atje kalonte si një gjarpër gjigant që fshihej midis kaçubave e kërcunjve të kalbur. Mbërritën atje duke kaluar midis drurëve të prerë, midis manaferrave. E gjetëm Mëhill Cungun, mbi një tryezë mbushur me letra, copa gazetash, shishesh bosh e kavanozash.

— A, ti na paske ardhur, Gjini Kola? Urdhëro e fol, veç sa më shpejt, se mos na shohin dhe e pësoj unë në vendin tënd!

Plaku e ndjeu ftohtësinë më të cilën e priti dhe tha me vështrim të turbullt:

— Dita është e shkurtër tani dhe nuk do të zgjatemi! Erdha për punën e Sokolit! Mësuesi tha se ky është më i dalluari dhe fshati e vendosi që ta dërgojë në qytet për t'u bërë ushtarak me shkollë!

Mëhill Cungu i la letrat dhe pyeti ftohtë:

— I kujt është ky çun?

— Imil!

— Pyes për babanë e tij dhe jo për gjyshin!

— I Martinit! I Martin Kolës! Djalit tim të vetëm!

— Ah! I atij milicistit thuaj! Çunin e paska të mirë, me sa duket. Po ai vetë ishte fashist!

– Jo! – tha plaku Gjini. Im bir nuk ishte fashist!

– Dengla shet Gjini Kola. Milic e fashist njëlloj janë!
Plakut iu errën sytë më shumë dhe iu duk sikur u
aorrua. Sokoli ia lëshoi dorën gjyshit dhe, pa e ndier,
doli në oborr. Atëherë Mëshill Cungu u nqrit nga tryeza
dhe zgjati qafën mbi atë gëzofin e xhakëtës prej musha-
maje që i mbulonte shpatullat. Vuri dorën e djathtë në
brez, qati për të nxjerrë revolverin, dhe tha: – S'flisia
dot në sy të të vogëlilit, mirë bëri që doli. Po, pa më
thuaq, ku e ke Martinin tënd, Gjini Kola?

– Humbi! – tha plaku me zë të dridhur.

– Humbi se u bë fashist e tradhtar, si të gjithë ata...

– Jo, – e ndërpreu plaku, shumë i vranë shpirtërisht.
Mos fol kështu, se edhe ti ke qenë milic...

– Isha në fillim fare, kur ishim të qorruar, po pastaj
u lidha me luftën, kurse ai, yt bir, tradhtari, u bë me
ta për jetë a vdekje!

Plaku Gjini vuri duart në kokë dhe klithi i dëshpëruar:

– Atë e vranë!...

– E vranë paret e fëlliqura, napolonat! Po unë jam
gjallë se e kuptova propagandën e tyre. U lidha me
pushtetin e popullit, hyra në brigadën partizane dhe, siç
më sheh, jam shëndoshë e mirë! Kurse ai, Martini, ia
bëri të zezën vetvetes! Na futi hakmarrjen, kur Partia
hënte luftë të ashpër kundër saj!... Dëgjo, Gjini Kola!
Më vjen keq për ty, se je plak! Ja ku po ta them sy në
sy se jo prapa krahëve: gjersa yt bir ka bërë këtë tradhti
mizore ndaj atdheut e popullit, të lutem, jo vetëm të mos
më kërkosh hatërlleqe për nipin, po të mos më dalësh
as përpara syve! Dhe me një shenjë të kokës i tregoi
derën, që Sokoli e kishte lënë pakëz të hapur.

Gjini Kola doli si i vranë në oborr. Nga hidhërimi
shpina iu përkul edhe më. Në pyllin mbi zyrën e lokalitetit
gjëmonin sëpatat e mprehta mbi pishat e blerta. Dikush,
ndonjë bari mbase, sokëllinte diku shkrepave. Poshtë, në
përruan e thellë, veshur në të dy brigjet me dushqe,
gumëzhinin ujërat e ftohta, që rridhnin rrëmbyeshëm nga
malet. Një thëllëzë cicëriti aty pranë duke ndjellë zogjtë

e parritur. Gjin Kola nuk dëgjonte asgjë nga tingujt e ëmbël të natyrës malore. Befas ndjeu në pëllëmbën e ashpër një dorë të njomë, po të fortë. Mezi dëgjoi zërin e nipit që e pyeste me ankth:

– Gjysh! Nga do t'i mbajmë?

Sokoli priti një copë herë të mirë, i habitur, me bohçen e ndërresave në dorë, gjersa ai u përmend e tha me mundim vetëm dy fjalë:

– Në fshat!

* * *

Gjin Kola u kërrus pothuaj krejt, më shumë nga hidhërimi sesa nga varfëria. Atë e veçuan nga kuvendet, nga mbledhjet, nga çdo gjë që bëhej në të mirën e pushetit të ri. Lena e re tërë ditën e ditës mbledhte giethe për kafshët dhe, kohën që i mbetej, gatuate, lante teshat, spërndiste kullën. Natën, strukur pas të birit, rrinte syhapur për orë të tëra dhe mendonte Martinin. Plaku, në këndin e vatrës, shuante e ndizte çibukun, e ndiente që ajo nuk flinte dhe murmuriste:

– Flini! Flini!

Atë ditë plaku Gjin shkoi në pyll me dhitë, me brençën e përhershme se mos dita e re i sillte ndonjë lajm të mirë për Martinin. Rugës u ndesh ballë për ballë me dy malësorë. Ata e përshëndetën me ngrohtësi, si gjithnjë dhe u turrën pas dhive. I treti ishte Mark Çuni, i drobitur krejt nga pleqëria. Ishte dhjetë vjet më i madh se Gjini dhe mezi mbahej pas shkopit.

– Gjin Kola! – i tha duke iu marrë fryma. Do të vish sot pasdite në mbledhje për votën! Mua s'më kanë pyetur gjë më sot, se ka skile kjo botë. Po ma jep fjalën e burrave se do të vish.

– Të shoh! – u përallai plaku Gjin me gjysmë zëri.

– Të vish për votën! Për Martinin!...

– Të shoh! – u përallai Gjin Kola dhe shkoi pas dhive të uritura, që bridhnin zakonisht buzë humnerave në atë acar dimri.

Të gjitha pemët e pyllit ishin mbuluar me dëborë. Edhe trungjet e tyre, edhe rrënjët e dala, edhe bimët kacavjerrëse. Plaku Gjin hiqte dëborën me duart, e shkundte nga deqët, hapte me thonj bisqet e blertë nën dëborë dhe i ndillte dhitë që të hanin. Kjo ishte punë shumë e lodhshme për çdo njeri, po plaku Gjin e bënte me shpirt ndër dhëmbë duke kujtuar të kaluarën. Dhe përfytyronte Martinin, të ri, të giatë, shumë të shkathët e shumë të durueshëm. Në cikna të tilla Martini e gërryente dëborën me thonj, gërryente dy-tre pashë vend, i rrëmbente dhitë hopa, si kalamaj, i shpinte te vendi ku muallonte bari i blertë dhe, qjersa ato hanin majat tërë lëna, ai hahte me thonj një vend tjetër.

Plaku Gjin kujtoi ato çaste të lumtura, iu mbushën shtëpitë me lot dhe nuk i bënë më duart për të hecur dëborën. Dëshirën e kishte të madhe, po gishtërinjtë nuk i bindeshin më, megjithëse i hukiste vazhdimisht për t'i ngrohur.

— Eh, Martin! — rënkoi thellë dhe u foli dhive duke ecur tatëpjetë pyllit, të cilit i njihte çdo dru, çdo strofkë eqërsirash, çdo lloj zogu, çdo fëshfërimë e qenie të gjallë.

Kur po zbriste në fshat, vuri re se të gjithë oxhakët ishin fashitur. Vetëm nga kulla e tij dilte një fiollë tymi. Vuri re se gjithë fshati ishte mbledhur te sheshi i shkollës, përpara qelës së Dom Shtiefnit.

Duhet të vete për votën e Martinin, mendoi dhe, ndërsa dhitë hynë në kullë, mori rruqën e shkollës. Por, përpara se të mbërrinte atje, i doli nga një çakëll Mëhill Cunqu, si një mi i madh, me qafore leshi.

— Ku vete ti? — e pyeti.

Plaku Gjin e kujtoi pvetien e tij që ishte si një plumb pas shpine. Meqithatë, u përballi atë:

— Për të marrë vesh se ku do të votoj për Martinin...

— Të nderoj vetëm nër pleqërinë, po votat e reaksionarëve nuk na duhen! Bëimë edhe pa to!

Me të ishte edhe Mark Cuni. E mbanin dy diem të vegjël dhjetëvjeçarë. Ishte plakur shumë Marku. Po me-

gjithatë, atë acar e pleqëri ia njohu zërin Gjin Kolës. Pyeti me sytë e kuq veshur disi me sklepa!

– Ti je, o Gjin Kola?

Ai u vonua shumë në përgjigje. Po, më në fund, u përgjigj, si një thëllim i hidhur që kalon papritur para fytyrës:

– Unë jam, o Mark! Mos qofsha!

– Ti do të vish se s'bën...!

– Mos na ngatërro, o baba Mark! Ec përpara! Këto punë janë me zarar. Ti djalin e ke dëshmor, kurse ky fashist!

Plaku nuk iu bind duarve të forta të djemve. Ngriti shkopin prej thane dhe thirri:

– Nuk e ka fashist! E ka djalë të popullit! Më ka thënë sy në sy se do të vinte te partizanët, tek im bir!

Mëhilli zbërtheu qaforen dhe qeshi hidhur.

– Ik, o baba Mark, se nuk i di ti këto punë!

– Jo, – thërriste Mark Çuni. Martini ka qenë me ne! Martini, Martini... Martini! Kurse ti, Mëhill, fsheh këmbët si aiarpri.

Tha edhe diçka tjetër përmes dhëmbëve të rënë dhe nuk iu morën vesh fjalët. Djemtë e rinj e përfshinë nga krahët dhe e morën me të mirë, duke bërë shaka me plakun e zemëruar.

Mëhilli mbërtheu qaforen me gishtërinjtë që i dri-dheshin lehtë.

Gjin Kola e vështroi në bebëza egër dhe tha:

– Martinin e shkrova vetë milic, se i besova kapidanit...

– Shyqyr që e pranon me gojën tënde, Gjin Kola! Hallall të qoftë milici...

Plaku ngriti zërin:

– Po Martini im u bë me luftën e popullit!

Mëhilli aeshi me të madhe:

– Tani të gjithë kështu thonë, o Gjin! Të gjithë. Ik dhe na lër rehat, se kemi halle...

Plaku Gjin, ia dreu rrugën duke ia tundur shkopin përpara fytyrës. I tha, duke iu marrë goja nga urrejtja:

- Ti Mëhill,.. ti, Mëhill... s'je burrë i mirë!
 - Aaa! Po shan edhe pushtetin! Bravo të qoftë!...
 - Nuk shaj pushtetin, po ty, Mëhill Cungu!...
 - Njësoj është! Më shave mua, shave pushtetin!...
 - S'është njësoj! Të shaj ty, se nuk e meriton këtë emër!

Mëhilli e shtyu lehtë. Plakut Gjini u duk sikur diçka iu zbraz përbrenda kraharorit të zbuluar. E pa Mëhillin që ecte me hapa të mëdhenj e të shpejtuar drejt oborrit të shkollës, ku po grumbulloheshin bashkëfshatarët. Pa edhe shkopin e vet që e kishte ngritur lart dhe i kishte mbetur i ftohtë, si një kallam akulli.

Pesë malësorë të armatosur dhe një oficer i ri i kufirit i dolën përpara papritur. Ishin të këshillit popullor të fshatit e të komisionit të votimeve. Sikur ta kishin dëgjuar bashkëbisedimin e acaruar midis tij e Mëhill Cungut, se menjëherë mbajtën anën e plakut.

- Ta kishe rrahur me shkop, Gjini Kola, se ai njeri s'e ka të gjatë, - i tha me zemërim malësori më i moshuar.

- Po. S'e ka të gjatë, skilja! - tha oficeri i ri me urrejtje të përmbajtur. Pastaj shtoi si më vete, nën zë: - As ai e as dom Shtjefni me tradhtarët e tjerë.

Dy prej tyre e vunë në mes dhe e mbajtën për krahu plakun e hutuar.

- Babë Gjini, - i tha njëri me butësi përzier me mllef, që bënte çmos ta fshihte, - armiku është i keq dhe desh na e hodhi edhe neve.

- Mbahu! Mbahu në supin tim!... - e këshilloi tjetri, aë ndjeu drithërimat e plakut. Gjini Kola i larroi pakëz malësorët nga vetja, ngjeshi shkopin në dëborë dhe, duke vënë mbi të duart niëren mbi tjetren, pyeti me ankth:

- Po Martini im?!

Më i moshuari iu përçajti menjëherë:

- Martini yt vrau një fashist dhe mbroiti nderin e maleve tona, nderin e Shqipërisë. Këtë e dimë të gjithë dhe askush s'na e mohon dot. E dinë tërë malësorët.

Dhe të gjithë thonë: M'i lumtë pushka Martinit të Gjin Kolës!...

Plaku s'dëgjoj më ç'i thanë. Gëlltiti lotët dhe u mbajt te supet e bashkëfshatarëve.

* * *

Binte dëborë e madhe. Sokoli me shokë ishte nisur që natën për të marrë kutitë e votimeve që dikush në lokalitet i kishte harruar t'i dërgonte në fshat. Po gdhinte dita që do të bëheshin votimet e para.

Sëpatat atë ditë nuk rrihnin në pyll. Rreth e rreth atë mëngjes të herët, çdo gjë kishte rënë në qetësi. Mbase vetëm drerët qafëgjatë vraponin me të katra e pa nxierrë zë, të ndjekur nga tufa e ujave të uritur. Mbase edhe Sokoli i vogël me shokët e vet vraponin shtigjeve e pyjeve si drerët e rinj. Ashtu vraponin edhe retë mbi kurorat e pishave veshur me copëza të trasha e të buta dëbore. Vetëm rrallë e tek dëqjoheshin klithmat e zogjve. krisia e ndonië deqe të moçme që nuk i bënte dot ballë peshës së rëndë të dëborës, ndonjë fishkëllimë e mprehtë dhe e pakuptueshme, që ngrihej lart nga guvat e humnerave, ku nuk kishte shkelur kurrë këmbë njeriu.

Plaku Gjin i mbushur me mërinë e tërë maleve, kishte dalë në oborrin e kullës dhe priste me ankth Sokolin t'i kthehej nga rruga e larqët e lokalitetit. Të gjitha zhurmat i gllabëronin maia e larta të maleve dhe nata ishte e qetë. E shtonte këtë qetësi edhe dëbora e dendur, që binte pa pushim dhe butë-butë mbi tërë dheun.

Papritur, ulur mbi qurin përpara kullës, Gjin Kola dalloj përmes perdes së trashë të dëborës një njollë të zezë. Siguresa, që i hoqi pushkës, i lëshoi një tinull metalik shumë të voqël. Por kjo, i mjaftoi njeriut që vinte drejt tij, të ndalei në vend.

– A, ti je, Gjin Kola?!

Plaku e njohu nga zëri.

– Urdhëro dom Shtjefën! Unë jam!

– Këtë natë e ka mallkuar zoti! S'do dhe s'do, që të gdhijë! – tha prifti duke qëndruar përpara tij, krejt i zi, në një sfond të bardhë dëbore

– Për pak desh të vrava, dom Shtjefën.

– Do të të uroja: të lumtë pushka! – tha prifti dhe, si iu afrua, u ul në gurin e kullës, krahas tij.

Prifti ngutej. Sa u ul i tha:

– Ti je rob i Krishtit, Gjin Kola! Yt bir Martini diku u vra! Po zoti e ka marrë në prehrin e vet, atje-lart! E kam paqëzuar unë Martinin me ujin e bekuar! Apo e ke harruar? Shumë mirë që e mban mend, o Gjin Kola! Mbage mend edhe këtë: ky pushtet i ka ditët e numëruara! Në mos sot, nesër do të përmbysët. Ka një «Komitet Malesh» që kujdeset për Shqipërinë! Ka një Amerikë të madhe! Një Angli të madhe! Një vend të madh. Një... Dom Shtjefën, një Gjin Kolë, një Martin që u vra për të!... Punojmë, o plak, të gjithë! Ja edhe sonte në qelën time të zotit ka ardhur kapidani me shokë nga brenda e nga jashtë!... Puna është këtu: të mos votojmë për këtë pushtet, ose më qartë: të votojmë kundër tij, që të shprehim vullnetin tonë, të popullit, të Martinit!

Dom Shtjefni u ngrit dhe iu dukë i lënë edhe disa porosi të tiera. Midis tyre iu naul në tru porosia e fundit, që prifti ia tha kur ishte duke ikur, midis dëborës:

– Mos kurse as nipin aë po sjell kutitë e votimit!

Plaku u përpoq të mbante veten seose e dinte mirë që edhe këtij qiarpri do t'i treqohej vendi.

Binte dëborë e dendur. Plaku Gjin u zbardh krejt edhe ai. Disa herë ndezi eshkën me uror dhe e vuri mbi cibuk. Po zjarri i duhanit i shuhej si e thithte dy-tri herë...

Po nuk i shuhej urrejtja. Ajo i lëshonte filiza të rinj brenda trungut të tij të rrahur nga shqotat.

Djemtë e rinj i sollën kutitë e votimit, edhe kokrrat, aë armiatë bënë sikur i harruan në lokalitet. I doli përnara Gjin Kolës edhe plaku më i moçëm: i fshatit, Mark Çuni. E mbanin nga krahët po ata cunakët e fortë. Thirri, ndërsa flokët e borës i shkrinin mbi sklepa:

- A jam te kulla e Gjin Kolës?
- Po, i thanë djemtë.
- A jam te kulla e Martininit?
- Po, këtu je.
- A janë aty Lena dhe Sokoli?
- Këtu janë.

Dëbora ia zbuti shkopat Mark Çunit. I pa të gjithë midis qepallave të qullura dhe shkoi drejt e te plaku Gjin. U ul pranë tij dhe nga qjoksi i mbuluar nxori një libër sa një gisht të trashë. Thirri:

- Lexojeni, o bij!

Librin e mbante lart dhe në kopertinë e tij skuqin shkronjat e mëdha: «Dhjetë pika gjaku»!

- Jo ti, jo! Ta lexojë Gjin Kola...

- Po unë s'di, o Mark! - ngriti pushkën lart plaku Gjin, që po ndiente një gurgullimë në shpirt.

- Ta lexojë yt nip!

Sokoli ia rrëmbeu librin nga dora. Nëpër faqet e tij binin flokët e mëdhenj të dëborës. Megjithatë, ai dallonte emrin e partizanit Martin Kola, emrin e dashur të babait!...

Po fillonte të agonte, po dëbora e dendur e largonte dritën e mëngjesit. Megjithatë, po agonte dita e zgjedhjeve të para të lira.

Plaku Gjin i njihte të fshehtat e botës, siç njihte edhe të fshehtat e maleve ku kishte lerë dhe ishte plakur.

U ngrit nga quri ku qe ulur që pas mesnate, duke u mbështetur mbi supet e njoma të nioit të voaël. Pushkën e qiatë e ngriti lart në qiellin ende të errët. Fiollet e mëdha të dëborës i ranë mbi ballë e mbi vetulla. Përmes qepallave të rënduara vështrroi kullën, në pragun e së cilës qëndronte Lena, me duart e kryqëzuara dhe me një pikëllim të madh në fytyrë. Pastaj ktheu kokën e rëndë dhe vështrroi nga po lindte dielli. Tha çuditërisht i përmbajtur dhe i qetë:

– Ne s'kemi vdekje kurrël! Se filizat i kemi mbjellë me kohë maleve, që të na përtëritin!... Tani ora ka vajtur, Shkojmë e votojmë për pushtetin tonë e për Partinë tonë!

– Edhe për Martinin e djemtë që na u vranë, – shtoi Mark Çuni.

Bëri një hap drejt kullës, pa edhe një herë të renë dhe ia zgjati pushkën Sokolit.

– Jepi, o bir.

Djaloshi i gëzuar në kulm, e zbrazi pushkën pesë herë rreshtl...

«NËNTORI» nr. 5, 1980

PASQYRA E LËNDËS

Nga vëllimi «PIKA GJAKU» 1945

Djaloshi	7
Gjak mbi akull	10
Çeliku	12
Hallë Zikja	18
Fshati im	21
Lufton nëna	23
Zemër nëne	26
Gjergjevica	29

Nga vëllimi «GRURI NUK U DOGJ» 1949

X Gruri nuk u dogj	35
Leskovik, o gur	39
X Tregim i nënës	44
Nusja	51

Nga vëllimi «ZEMËR SHQIPTARE» 1954

Zemër shqiptare	61
Katanaja me yll të kuq	68
Zjarri	73
Artani do të bëhet agronom	79

Nga vëllimi «NË PRAGUN E JETËS» 1960

✓ Në pragon e jetës	93
Hamiti i vogël	102
Frymë e vjetër	107

Nga vëllimi «TREGIME TË ZGJEDHURA 1973

✓ Plagët	115
I fundit	128
✓ Kryetari	147
Nderi i plakut	154
Nata e parë	160
Pas martesës	166
Era	171
✓ Kur i je e vogël	180
✓ Portreti	187

Nga shtypi

Foleja e shqiponjave	209
Buka	232
Në behar kur korret gruri	242
Furka	278
Dëshira e fundit	287
Partizani i panjohur	295
Nata e fundit	306
Ata ishin tre	337
Në thellësi të maleve	361